

XHEMAL AHMETI

**KULTUROSFERA**

**NË APORI**

EV

*Xhemal AHMETI*

# Kulturosfera në apori

*Diagnozë tashmërisë*

Libri «Kulturosfera në apori» është rezultat i një studimi socio-antropologjik mbi trevjeçar që autori u bën sferave etnokulturore shqiptare në Ballkan dhe në diasporat e saja. Në libër analizohen, përshkruhen dhe trajtohen segmente të ndryshme të kulturosferës si politika, arsimi, religjionet, mediat, historia dhe atë si institucione ndikimi tek njeriu, grupet, dhe masat e ndryshme kolektive. Gjatë studimit të këtyre segmenteve e kategorive shpalohen dukuri të ndryshme here që determinojnë sistemin politik, atë kulturor dhe mental të sferave ku shtrihen apo dominon kultura shqiptare. Instrumentet metodike dhe ato paradigmatiche ilustrohen vazhdimisht me shembuj konkret dhe sekuenca empirike, të cilat e bëjnë librin të lexueshëm për gjitha nivelet.

Botoi: ShB *ExilVOX*, Bern 2019  
Copyright tek Autori

## PËRMBAJTJA

### PROLOG

Lugati i autofobisë 5

### I. NJERIU 10

Qenia në apori 11 / Subjekti në krizë 16/ Asketët e vetëmohimit - Meritokrati, vasali, nihilisti 21 / Semiotika e çyqjimit - Kohëvarri i idolit 26 / Superioriteti me plis – superiorët dhe inferiorët 30 / Sidoqenia e inferiorit 34 / Azazelët anti fortuna - I revoltuari, oportunisti, banali, neoromantiku 42 / Iluministë e iluminatë 47 / Snobët – live! 51/ Ecce homo alienatus 56 / Tjetri jam unë – Teori mbi empatinë 69 /

### II. SHOQËRIA 76

Hartë problemesh 77 / Evolucion semiotik sinjifikantësh 80 / Civiliteti si pushteti 85 / Etnoradioskopi 89 / Spinalongat e një etnosfere 92 / Republikat e sociopatëve 100 / Iluzionimi si koncept qenieje 104 / Racizmi si afekt eurocentrik 109 / Topologjia e dhunës 113 / Embrionet e vetëzhbërjes 119/

### III. POLITIKA 127

Nga perspektiva e gropës 128 / Politika në panoptikë 132 / Egotuneli i minitiranëve 136 / Pushteti dhe perversiteti 144/ Doktrina e “tokës së djegur” 149 / Metaforat e linçimit 153 / Festa e psikozave 158 / Paradat e irracionalëve 163 / Politika e vetëpërrjashtimit 167 / Neofitët e Katilinës 175/ Mutacionet kozmetike 181 / Udhëtimi me varkën e Karonit 185 / Gjeoracizmi në kosovarizëm 189/ Ç'është kombi nuk është shteti 195 / Manifesti i pragmatikëve 201

#### **IV. AGORAT 206**

Traktat dëshirash shqiptare 207 / Res publica literaria (albanica) 212 / (Anti)nacionalizmi shqiptar 216/ Dialektika e kosovarizmit 223 / Shoqëria si projekt intelektual 236 / Shoferët e Chomsky-t 240 / Wikimania 248 / Gramatologjia e “like”-ut 253 / Frika nga autokritika 258 / Radiokracia e varrit 262 / Eutopitë shqiptare 270

#### **V. MEDIAT 274**

Forcat e pushtetit të 4-t 275 / (In)konsistenca e intelektit 280/ Haraçi i subjektivitetit 288 / Mediat dhe gomari i Buridanit – Estetika e diksursit publik 292 / Kodet psikotoksike 297 / Tregu estetik i masmediave 301 / Grotesku dhe “tipat idealë” 305 / Seksi, puritanët dhe mediat 309 / Stresorët e opinionit 313 / Yjet e “nahisë” 318 / Anatomi e cyberozonës shqipe 322/

#### **VI. DEMOKRACIA 335**

Pushteti i polikracisë 336 /Tranzicion a subversion 341 / Demokracia autoktone 348 / Demodefektet 354 / Demodestrudot 358/ Katër “killer application-et e Fergusonit 365 / Postdemokracia dhe treni shqiptar 368 /

#### **VII. RELIGJIONET 377**

Platoni i ka të gjitha fajet 378 / Ciankalizimi i frymës 384 / Semantika paralajmëruese 389 / Fanatizmi për identitet 393/ Ultima ratio – Perënditë, frika, dhuna, uzurpimi, islamofobia 397/ Kanuni i sekularit 415/

#### **VIII. HISTORIA 420**

Historia si paranojë 421 / Si nuk shkruhet Historia 424 / Vallja e primatëve 458/ 3 teza mbi oportunizmin shqiptar 465 / Metafora e prushit 469 / Metanoja 474 /Ikonat e epokës që iku 482 / 1960 – 2013: Epokë e artë shqiptarësh 486/

#### **EPILOG 501**

Shqiptarët përtej blloqeve

## PROLOG

### *Lugati i Autofobisë*

Një lugat sillet ndër ne – fryma e negativitetit! Vaji dhe mallkimi hapin ditën dhe ato mbyllin pas mesnate dyert e mediave, shkollave dhe kafeneve. Një popull i ndryrë në frikë nga vetvetja?

Demonët e globalizimit kanë përfshirë qytetet shqiptare. Frikë gjithandej. Iluzionet janë furra e vetme që mban gjallë dhe ushqen depresivët, të zhgënjyerit dhe të çorientuarit. S'ka liri. As robëri. Vetëm hutim. Kaos dhe socialdarwinizëm të egër ka. Jo vetëm kolonia e miteve statuja pozojnë sikur mos ta dinë në cilin drejtim duan të ikin, por edhe njerëzit: ata sapo i bëjnë ca hapa drejt kishës zbrapsen për nga xhamitë. Duken si ata të burgosurit që u lejohen ecejaket vetëm brenda një zone të ngushtë hapësinore. Aty vërdallen si të përhumur, kosovarët e çdo mëngjesi, po si ata të dënuarit me një aparat të lidhur për këmbë që lëshon një seri elektrohokësh sapo i dënuari ta braktisë për disa milimetra zonën neutrale, atë ndërmjet lindjes dhe perëndimit. Ai nuk guxon ta kalojë linjën as për te njëra e as për te ajo tjetra, më e largëta, druan se mos digjet në vend – kështu duket t'i flasin sot dhjetëra perënditë e tij, shqiptarit. I detyruar të shkelë natyrën e vet historikisht nomade ai është ngujuar aty. Për të vegjetuar ndoshta? Kësaj radhe vullnetarisht?

Prishtina qyteti në sanduiçin e paradigmave, kulturave, ideologjive dhe gjithë paranojave të mundshme të postmodernizmit? Sociologët shkakun e hutimit që ka pushtuar shoqëritë shqiptare e kërkojnë tek papunësia, skamja, thonë se ato i çpneumatizon korrupsioni i pushteteve,

politikave, i kërcënon paperspektiva dhe diagnoza të ngjashme bourdieu-ane – se sa qëndrojnë këto pohime mund ta mësojmë vetëm pas studimeve konkrete, ende të pabëra.

*Kritika dhe histeria* - Matanë kësaj tabloje të zymtë që ta sposton përfytyrimin në Londrën e Oliver Twist-it dhe Faginit të shekullit 19-të (Charles Dickens: 1839), salloneve e klubeve ku gëlojnë përfituesit e çdo krize, lufte e paqeje, bota duket ndryshe, shumëngjyrëshe dhe plot shpresë: Ka vite që për shqiptarët ka filluar „epoka e artë“ – siç do të thoshte historiani plak e eurokomunist Eric Hobsbawm. Pas shekujsh skllavërimi, mposhtjeje, pakësimi në prag shfarosje dhe mbijetese në frikë, ata sot kanë dy shtete të cilat i qeverisin vetë, kanë më shumë liri se sa që kanë kapacitetin ta menaxhojnë dhe secila kullë tashmë mund t’ia qepë vetes një flamur, stemë, madje edhe një zonë sundimi privat çdo prijës mund t’ia sigurojë fisit të tij. Njëlloj si në kohën e familjeve feudale, aristokrate të Evropës së moçme. Skamja, papunësia, korrupsioni i politikave?

Sociologët dhe analizuesit e shoqërive shqiptare kanë të drejtë që çekanin e mbajnë gati për t’ia futur kokës politikës, sa herë që ajo ta favorizojë xhepin e pushtetarëve para qytetarëve. Prapëseprapë ata – sociologët, publicistët, moralistët – duhet paralelisht të kenë dinjitetin e nevojshëm, të tregohen objektivë dhe të pyesin zëshëm here pas here në mos scamja, papunësia, hutimi, robëria dhe kriza dje e njëmijë vjet, ishin më të pakta se ç’janë këtyre ditëve qyteteve semiurbane shqiptare.

Kritika është e domosdoshme, mirëpo kur ajo zhvishet nga objektiviteti dhe përzihet me mallkimin e injorancës, shndërrohet në murtajë kolektive vetëmohimi, depresioni dhe auto-fobish të shumta.

*Demoni im tek tjetri* - Një histori e mikut tonë, socioantropologut të njohur italozviceran Christian Giordano e ilustron më saktësisht se çdo gjë tjetër anatominë e „frikërave“ shqiptare: „Sa herë që shkoj në Ballkan e sidomos në Tiranë përballëm me sugjerimet e llojit „ma jep çantën mua se këtu ka shumë hajdutë“, „mbylle derën e hotelit mirë“ ose „kujdes kur të dalësh rrugëve se shumica këtu veç presin të të plaçkitin“. Kjo nuk më ndodhur kjo as në Malajzi, as në Afrikë e as në Azi siç më përsëritet në Shqipëri“. Pse kjo paranojë? Ose më mirë ta kërkojmë shpjegimin e saj në paradoksin e Epimenidit që thoshte „gjithë kretasit janë gënjeshtarë“, kështu duke na torturuar me njëjën që nuk e zgjedhim dot: Nëse gjithë kretanët janë gënjeshtarë atëherë edhe Epimenidi është i tillë sepse është kretan. Kush gënjen këtu? O të gjithë o asnjëri?

Në këtë drejtim e paraqiste gjendjen edhe formulimi plot mllef i studiuesit dhe romancierit Ag Apolloni kur tha: «Jam lodhur duke lexuar akuzat tona ndaj të tjerëve. Psikopati gjithmonë fajëson tjetrin, kurrë veten, rrjedhimisht, kam ardhur në përfundimin që ne si komb kemi një dërrasë mangut» (Zëri: 19.10.2013). Kur marrim parasysh këtë konstatim të autorit të „Ulurima e ujkut“ (Prishtinë: 2013) si detektor të frymës, kulturës e diskurseve dhe përmbajtjes së mediave shqiptare, atëherë vërtet përplasemi më zymtësisht me dramën që ka përpirë kulturosferat shqiptare.

Për dallim nga e shkuara kur „*Të tjerët*“ e Apollonit kanë genë robëruesit, „Europa shtrigë“ dhe gjitha ata miliona shqiptarofobë anekënd planetit e kozmosit, sot „*Të tjerët*“ nuk janë të huajt, por vetë shqiptarët e uniformuar herë me çallmën e wahabistit mjekërpluhur, herë me një kryq në ballë, shpesh tradhtarë e më së shumti plaçkitës e vjedhës bankash, arkash e grash. Qoftë edhe në kalkulimin më të imtë del se virgjëria qoftë si simbol, gjendje apo dëshirë, nuk mund të ketë prindër shqiptarë: në një mënyrë apo tjetër, të gjithë dalin



të mbushur më frymë destruktive. Janë të gjithë shqiptarët të kapur nga demonët e së keqes pra? Jo, sigurisht.

*Destruktorët e bashkuar* - Po ndoqëm cilëndo qoftë «afere publike», që nga starti e deri në ngritjes së saj në «problem kombëtar» nëpër rrjete sociale dhe media, do të mësojmë se si një fenomen qoftë edhe fare banal instrumentalizohet deri në histeri masive. Kryesisht fabrikimi gatuhet e hiperbolizohet nga grupe që punojnë e hanë bukë me biznesin e frikës. Grupe që u ka hyrë në palcë paranoja e humbjes së dominancës mbi një sferë të caktuar (shpesh imagjinare), kulturore, shoqërore. «Destruktorët», ata që me çdo kusht duan të instalojnë «paradigma» e të vërteta të «vjetra e të reja» në mendësinë e shqiptarëve, tashmë janë bërë ekspertë sensorë të reagimeve të këtij lloji dhe sa herë duan që të futen në aksion e deklarojnë ndonjë absurditet, akuzë, ofendim dhe rrinë të sigurtë këmbëkryq duke pritur efektin e fushatës së rradhës, nuk kanë nevojë të konsumohen për marketing sepse e dinë që kundërshtarët do ta bëjnë punën e tyre. Në këtë garë fobi-producentësh hesht shteti dhe janë memecëruar institucionet e ligjësisë: ato janë të kapura nga politika, e për të, çdo histeri, paranojë që largon vëmendjen nga dështimet e saj diku tjetër është më tepër se vetëm e mirëseardhur.

*Autofobia si burim drame* - Në fund të analizimit të çdo fobie ekzistuese nuk u ikim dot fakteve: mbizotëron prirja sidomos i «elitave intelektuale», opinion-bërësve dhe mediave që të favorizojnë të keqen. Ato folur me gjuhën e Baruch de Spinoza- s shfrytëzojnë edhe shkaqet më të dobëta ndërmjet frikës dhe shpresës për t'i skandalizuar deri në frikë kolektive (Në trajtesën teopolitike, parathënia) ose siç na thonë në kor gjitha teoritë dhe enciklopeditë e mundshme të vetëterrorizimit: reagimi psikoindividual e grupor ndaj

rreziqeve në të shumtën e rasteve është brum i frikës nga vetvetja.

Po kombinoam këto konstatime me natyrën e përhershme shqiptare të lëngimit publik, atëherë teza e *Nietzsches* se grekët qëllimisht e në mënyrë masive sajonin frikën për mos u ndier mirë (Morgenröte:156) vlejtkë më shumë për shqiptarët e sotëm se sa për tragjikët e djeshëm grekë.

Më shumë se demonët e globalizmit, skamja, papunësia, religjionet e përdhosura dhe paradigmat diktatoriale nga jashtë, shqiptarët i zymtësuaka lufta e thellë e brendshme me autofobitë. Të tjerët dalin vetëm si projekcion i mosdurimit të vetvetes dhe që nga pasiguria kanë gjetur frikën si mjetin më adekuat të vetëgërryerjes.

Shqiptarët më shumë se nga çdokush tjetër kanë frikë nga vetvetja! (2013)

PJESA E PARË  
*Njeriu*

1.  
*Qenia në apori*  
*Hyrje*

Me gjithë respektin ndaj figurave mendimtare shqiptare në modë (të vdekur e të gjallë) që merren si ideologë të frymës shqiptare të katër dekadave të fundit nuk mund ta mohojmë faktin se ata asnjë çikë ndihme etike nuk i dhanë dot njeriut shqiptar që të dalë nga balta, nga ajo baltë ku e kishin fundosur, ndër të tjera edhe ata vetë.

Historia shqiptare e tre dekadave të fundit është njëra nga episodet që për nga arritjet përkatëse, shqiptarët mund ta konsideronin si atë epokën e artë të Eric Hobsbawm-it. Shqiptarëve u ka qeshur fati si asnjëherë më herët. Paralelisht këtij fakti, megjithatë ajo është edhe periudha që ta përplas «surratit» aktgjykimin me dënimin për memecëri intelektuale. Pothuaj para çdo pyetjeje për akëcilin problem të kësaj periudhe kapitullojmë duarlart sepse nuk kemi referenca që ta ndërlihim me ndonjë dokument a proces të kronikës faktike shqiptare. Kështu na doli kur menduam për njeriun; çfarë i dhanë elitat shqiptarit para se ta fusnin atë me pahir «revolucioneve» demokratike; para se ta urdhëronin që të përflakë doktrinën komuniste; para se t'ia varnin pushkën fytit për ta «fituar» lirinë? Çfarë i injektuan elitat shqiptare njeriut të zakonshëm, i cili kurrë nuk u lodh të ndjekë, të sakrifkohet për ta.

Nga cilado pozitë e batakët dhe për cilindo ashik politik, njeriu jonë ka dhënë jo vetëm gjithçka nga vetja, por edhe

veten plotësisht. Edhe sot, tani, njeriu ynë, në pikë të agut ua hedh shikimin syperlotshtëm të vetëve barkboshë dhe e nis ditën me urdhërin e parisë dhe shoqërisë për ta kryer funksionin e tij social. Njeriu ynë, ai i «zakonshmi», kush është ai dhe ç'bëjmë ne me të? Si sillen të tjerët, armiqtë dhe miqtë e shqiptarëve me njeriun e tyre?

### *Historia e priftit nga fshati Lopuszna*

Disa muaj para «pranverës kosovare», në tetor të vitit 1980, në Wawel të Krakovës polake prifti Józef Tischner mban meshë për udhëheqësinë opozitare të sindikatës Solidarność. Fjalimi i nxënësit të Roman Ingarden-it dhe Husserl-it, filozofit të promovuar me «padesynë» e zezë të priftit si një rrufe zjarrpjellëse ndezi shpirtin e çdo njeriu polak; të intelektualit, të analfabetit, të punëtorit, të bujkut, të patriarkut, të nënës, të policit, të ushtarit, të komunistit, të liberalit, të të majtit, të të djathtit, të egoistit dhe të altruistit. Si ka mundësi? Si është e mundshme që fjalimi i një njeriu të jetë i çliruar nga çdo ideologji, nga çdo program, nga çdo koncept që nuk bie ndesh me ndonjë tjetër? Foli Jezu Krishti i priftit? Jo foli njeriu Józef Tischner për njeriun polak. Prandaj e kuptoj ky i fundit, e përpiu filozofinë e tij si frymë me të cilën u nis rrugës për ta zënë lirinë.

Nga këto fjalime doli vepra «Etyka solidarności i Homo sovieticus» (Etika e solidarnośc-it dhe homo sovjetikus – Paris 1982). Një përmbledhje që çdo polaku i shërbeu dhe ende i shërben si filozofi jete. Çfarë ka në atë libër vallë? Aty është i parashtruar koncepti filozofik i dialogut, të cilin me gjuhë edhe më shkencore Tischner e trajton në dy veprat e tij të mëvonshme «Drama njerëzore» (1986) dhe «Përplasjet mbi ekzistencën e njeriut» (1998).

Jo vetëm polaku i rëndomtë dhe ai intelektual, por sot edhe çdo njohës, ekspert, historian dhe politolog, qoftë edhe i jashtëm, konstaton të njëjtën gjë: Polonia e bëri tranzicionin e saj të suksesshëm, pa vënë asnjë çast në rrezik të rëndë ekzistencën e masave popullore dhe të së ardhmes së vendit, falë një koncepti të qartë të dialogut që në epiqendër pati vendosur dinjitetin, fatin dhe respektin e njeriut – pavarësisht pozicionit të tij ideologjik e shoqëror, falë filozofisë prijëse të intelektualëve të kalibrit të Józef Tischner. Këta pranuan të gjitha doktrinat dhe besimet e polakëve pa i armiqësuar ato dhe i vunë në shërbim të njeriut, të së ardhmes dhe mirëqenies së tyre.

### *Shumë koncepte pa asnjë shkronjë*

Hedhim tutje empatinë për polakun dhe le të ribëhemi sërish shqiptarë. Kërkojmë pandalur mendjes, arkivave, programeve, teksteve dhe historisë dhe dorëzohemi të revoltuar migjenshëm me dëshirën jo për t'ia futur me grusht ndonjë mali, por vetes. Pse?

Viteve 80-ë ashtu si në vendet e tjera të ish bllokut parasocialist, shqiptarët riintensifikuan aktivitetin e tyre në kërkim të lirisë. Shpërthyen demonstratat. Duan të thonë për bukë nga studentët e uritur; duan të thonë për shkak të masivizimit të idesë për shpëtim nga Jugosllavia e faktet dhe dokumentet përkatëse i favorizojnë të dyja këto shpjegime. Studentët vërtet jetonin në kushte mizerable. E gjithaq dëshira e grupeve ilegale kryesisht marksiste ishte që të shpëtojnë Kosovën nga Jugosllavia duke ia bashkangjitur atë – si ideal final – Shqipërisë së Enver Hoxhës. Filozofinë e veprimit e transportonin me mushka agjentët e Sigurimit shqiptarë në dy drejtime: për në Prishtinë dhe për në Beograd. Kështu thonë faktet. Viteve të fundit tetëdhjetë – kur kosovarët panë me sy Shqipërinë dhe veten – ra kjo dëshirë grupesh dhe i ktheu sytë

nga modeli shoqëror e liberal i Perëndimit. Dolën liderë të rinj. Konceptet e tyre?

Siç dokumentuan dy studiuesit Prof. Shenasi Rama dhe politologu Llukman Halili, Sali Berisha nisat tek studentët jo me koncept e filozofi përkatëse, por me udhëzimet e Ramiz Alisë. I njëjti njeri bashkë me të tjerë do të bëhet ideolog dhe do të udhëheqë masat drejt tranzicionit. Në Kosovë liderizohet shkrimtari dhe kritiku Ibrahim Rugova. Ishin të qarta preferencat e liderit Rugova se ai praktikonte kulturën politike të dialogut dhe kishte frymë të përvetësuar nga lufta e Pjetër Bogdanit që e bën të krahasueshëm me Józef Tischner-in. Megjithatë as ky i fundit nuk arriti të bëhet dot figura integruese e të gjithëve? Por i kontestuar fort edhe ndërroi jetë. Ka kjo të bëjë me ndonjë defekt mental të shtresave të caktuara që rëndë largohen nga doktrinat e që është ndërkaq diçka tepër tipike shqiptare? Jo. Ku qëndron problemi pra?

### *E pashkruara si telepati*

Asnjëri: as Ibrahim Rugova, as Sali Berisha, as Ukshin Hoti, as Rexhep Qosja (me librat e tij të Bashkimit) e as më vonë Arbër Xhaferi (tek ky kemi problemin më të madh për të gjetur ndonjë filozofi personale) nuk mund të krahasohen me një lloj lideri frymor të shembullit të Józef Tischner. E para sepse ata nuk kishin koncept për realitetin human të terrenit shqiptar – domethënë bindjet e tyre nuk i kishin fituar si analizë të gjendjes së masave popullore, por si bindje personale që donin t’ua impononin masave – dhe e dyta sepse edhe pasi të kemi lexuar çdo intervistë, çdo fjalim dhe çdo shkrim të personaliteteve të lartpërmendura nuk ia mveshim dot njeriut shqiptar akuzën të mos ketë kuptuar njërin apo tjetrin. E vetmja akuzë që mund ta lëshojmë në adresë të «njeriut të zakonshëm» është paaftësia telepatike.

Shqiptarët ndoshta do të ishte dashur të studiojnë psikanalizën para se të kërkojnë liri. Ndoshta këta të fundit kështu do ta kishin më lehtë të jetonin edhe me veprimet aq kontradiktore (ndaj vetë koncepteve që agjtonin) të figurave të të lartpërmendura.

*Njeriu, ah njeriu shqiptar!*

Njeriu shqiptar në asnjë moment të historisë së tij nuk ka genë si qenie në epiqendër të elitave intelektuale shqiptare. Ai u ka shërbyer si mjet grupeve dhe elitave që ata të realizojnë doktrinat e përvetësuara të cilat kanë besuar se janë më të mirat për të ardhmen e tyre. Pra jo në shërbim të njeriut po anasjelltas. Këtu ndoshta mund ta gjejmë përgjigjen që e parashtruam qysh në fillim: çfarë i jepet shqiptarit si koncept për betejën e radhës, si filozofi apo si besim i qartë, që ai ta dijë se përse po e sakrifikon jetën, veten; Asgjë tjetër përveç urdhrin të paarsyetuar. Në stilin „për komb e atdhe po lufton çfarë po do më shumë“? Jo, jo asnjëri nga idhujt, intelektualët shqiptarë as gjer te thonjt e këmbës nuk i afrohet ndonjë Józef Tischner-i, qoftë edhe me ndonjë filozofi të gabuar për njeriun e tij, ama një transparente do ta kishte. (2013)



2.

## *Subjekti në krizë*

Shumica e shoqërive shqiptare ndihen të jenë në krizë, jo vetëm ekonomike, por edhe morale, pa ardhmëni të qartë dhe pa orientim. Frustrimi dhe depresioni energjinë përkatëse e marrin sa nga trendet globale aq edhe nga ato lokale. S'ka rrugëdalje nga kjo apori vegjetimi kolektiv? Ka, mirëpo problemi është se si të dalë nga kriza njeriu shqiptar duke mbetur njëkohësisht i drejtë dhe i arsyeshëm? Politikat dhe shoqëritë shqiptare ende formësohen nga ato gjenerata që lindën e u rritën nën atmosferën e negativitetit. Në atë epokë të luftës darviniste për mbijetesë që i përngjante një aksioni kolektiv për ta jetësuar „Leviathan-in“ hobbs-ian në program funksionimi (a)social. Bombat ishin paradoksalisht ato që u perceptuan si pëllumbat e parë të lirisë. Shumëkush nisi të flasë për hyrjen e shqiptarëve në epokën e artë. Ashtu edhe dukej ajo: ra sistemi totalitar në Shqipëri; batalionet gjenocidale të Millosheviçit braktisën Kosovën dhe bota më në fund vendosi që të asistojë shqiptarët në bërjen e lirisë së tyre.

Sot 24 vjet më vonë depresioni kolektiv ka arritur po të njëjtën shkallë tensioni si në fund të viteve 80-ë. Atëherë kur të tjerët dhe diktatorët i toleronin shqiptarët të gjallë vetëm si skllevër. Po sot ç'u bë vallë?

### *Globalizmi dhe shqiptarët*

Duket sikur tepër vonë e kuptuan shqiptarët se çlirimi i tyre nga diktaturat ishte vetëm *akti* e jo edhe *liria* vetë. Të fundit nuk dinë ta bëjnë. Dhe as që i lënë ta bëjnë si do të donin vetë. Ndoshta është mirë kështu, mirëpo ata protestojnë me të drejtë: kështu nuk e ka liria!

Bashkimi European kërkon prej tyre t'i hiqen nacionalizmit në të njëjtën kohë kur organizata kontinentale rrezikon të vetëshkatërrohet nga egoizmi kombëtar i shteteve kryesore që e përbëjnë atë. OKB dhe Eulex erdhën «të ftuar», u pritën me këngë e lule, ndërsa sot edhe të dytën syresh vendasit e konsiderojnë t'ua zërë diellin.

Trendet, krizat globale më së pari i ndiejnë nën lëkurë të varfrit, demokracitë ende të pakonsoliduara – shoqëritë shqiptare janë të tilla. Besimi për mundësitë që i deklamonin programet si *Multinational Corporation* dhe *Globalisation of Markets* në interes të mjedisit (ekologjisë), paqes dhe zhvillimit, është transformuar tanimë në mllef. Revolta shqiptare aktualisht shfrytëzon „Rush –in“ globalist vetëm sa për ta manifestuar krizën psikosociale botës virtuale – dhe atë si nervozizëm hiperaktiv. Më tepër si „corpus captivum“ e Revolucionit 2.0 ata japin grahmën e fundit për të kërcënuar defektet e sistemeve të tyre – pra duke kërcënuar vetveten! Më shumë, mendojnë ata, s'kanë çfarë të bëjnë. Duken të pafuqishëm përballë klubeve që delegojnë dhe kontrollojnë pushtetet e tyre. Po ato klube të cilat nobelisti Joseph Stiglitz i përshkruan si «shkatërruese të ekonomive të popujve nëpërmjet përqendrimit të pushtetit te firmat që kontrollojnë tashmë shumicën e kapitalit botëror» (Hijet e globalizimit. Fq. 179-237: 2002)

### *Shteti dhe shqiptarët*

Sipas studimeve të porsapublikuara të Fondacioneve dhe instituteve gjermane për zhvillim dhe paqe (Globale Trends – Paqja, zhvillimi, mjedisi: 2013) globalizmi pjesërisht ecën si invalid e atje ku është mëse i nevojshëm, ai ka efektin e kundërt: demokratizimi i vendeve postsocialiste dhe atyre arabe nuk ndodh. Ato më shumë janë shtete reautokratike se

sa shoqëri pluraliste. Interesantja e shumicës së studimeve më të reja mbi globalizmin (Bach: 2013/Waaden: 2013/Gronholz: 2013/ Wellman: 2013 dhe Stiglitz: 2013) është se fajtorin – sidomos në vendet si Kosova – për dështimin e zhvillimit e shohin më pak në paaftësinë e qeverive vendore, por më shumë në rikonfigurimet e luhatshme globale, të cilat instruktohen jo *de facto* nga Qeveritë, por nga klubet (Bildberger, G8, G+, WEF, etj.) që përbëjnë të ashtuquajturën «*Informal Global Governance*». Dihet botërisht se këto organizata të prira parimisht nga lobet ekstraliberale, interesohen vetëm sa për fasadë për të drejtat dhe liritë e popujve, ato si ngushticë ekzistenciale dhe mjet të ruajtjes së primatit oksidental e kanë vënien nën kontroll të resurseve që i mbajnë mobile dhe industriale: naftës dhe gazit pra (Basedau/Kappel: 2013)!

Jo vetëm shqiptari, por edhe gjermani, francezi, arabi, afrikani, çdo njeri i informuar mesatarisht, i shkolluar dhe me sensin e demokratit dhe konkurrencës së barabartë në stomak, i përjeton këto trende si ditëvrasëse, fatpërdhunuese, depresion-nxitëse, zhvillime pra që askënd – përveç përfituesve të paktë – nuk e lënë indiferent. Komoditetin për t'u ikur (ose për të vepruar kokë më vete) imponimeve të kapitalizmit të egër të këtyre klubeve, e kanë vetëm shtetet me demokraci direkte ose semidirekte si Zvicra dhe SHBA –të (e fundit edhe për shkak të statusit të superfuqisë që gëzon). Tjerët o kërcejnë tangon e klubeve të tilla, o bien në faliment.

### *Fabrikat e depresionit kolektiv*

Për njeriun shqiptar, ky realitet global bëhet edhe më dramatik gjatë përbaljes së tij me qeverinë e vet. Pasi edhe shtetet e tyre funksionojnë po sipas të njëjtit model (klanet, qeveria si klub poliautokratësh, përqendrimi i kapitalit në duart e pushtetarëve dhe oligarkëve) frustrimi dhe revolta janë

të dyfishta: organizatat (shtetet, aleancat) e huaja, globale që veprojnë te ta perceptohen si qendra shkaktare të së keqes, ndërsa qeveritë kombëtare si ekzekutorët servilë të tyre. Kur kemi parasysh strukturën dhe gjendjen sociale të shoqërive shqiptare, atëherë pa kalkuluar gjithaq nuk kemi nga t'i ikim dot konstatimit se shumica absolute (95% po spekulojmë) e masave jeton me ndjenjën permanente paraeksploduese që i «thotë» atyre se qeveria tallet me inteligjencën e tyre emocionale dhe «intelektuale» duke ia vjedhur të drejtën për mirëqenie, liri dhe demokraci popullit. Në Shqipëri u bë tashmë një ofertë (Rilindja e Edi Ramës), e cila po qe se nuk mbetet teori demagogjike e një «klubi» politik të radhës, mund të shërbejë si model i imitueshëm edhe nga Kosova.

### *Si të menaxhohet revolta?*

Nëse analizojmë programet dhe veprimet ekzistuese të partive politike, lëvizjeve dhe organizatave relevante politike e intelektuale, si dhe diskursat kosovare atëherë kuptojmë edhe më qartësisht aporinë brengosëse të qytetarit: nuk ekziston asnjë ofertë serioze që do të ishte sajuar pas analizimit të problemeve konkrete shoqërore dhe që do të na bindte se dikush e merr vërtet seriozisht njeriun shqiptar në krizë dhe nuk e konsideron atë vetëm si subjekt vote dhe si konsumator të manipulueshëm.

Një zgjidhje ka. Mirëpo atë nuk mund ta sjellë as shpërthimi gati vandal i masave siç kërkojnë anarkistët e Bakuninit, as «miqtë e popullit» dhe atdheut, neojakobinët që sillen sikur Revolucioni francez sapo të ketë nisur, nuk janë rruga; ideologjitë transcendentale janë metoda më e përkryer e vetëvejetimit horizonteve e dimensioneve të paqena – sepse nuk presin sukses në këtë botë; ashtu siç tha Albert Camus në një fjalim gati të pabotuar kund me titullin «Krizë e njeriut», të mbajtur me 28 mars 1946 në McMillin, teatrin e

New York-ut: «Pikërisht se kjo botë është e padrejtë ne duhet të veprojmë me drejtësi ndaj tjerëve. Pikërisht sepse bota në thelb është absurde ne duhet të veprojmë me arsye». Afërmendsh se kërkesa e Camus-ë gjithë përgjegjësinë morale dhe humane ua hedh mbi shpatulla intelektualëve, atyre njerëzve që mobilizohen për ta shpëtuar njeriun nga kriza, mirëpo edhe aq utopike kërkesa nuk është: nëse jemi dakord se 90% e masave ndihet e revoltuar dhe vetëm 10% është e korruptuar atëherë qoftë edhe 30% nga grupi i të revoltuarve do ta gjuhëzonin çdo sistem. Një zgjidhje pra patjetër se ka – vetëm se timoni mungon. Mendjet që ndiejnë njeriun në krizë dhe ia shkruajnë atij manifestin se si të shpëtojnë nga vargonjtë. Ashtu siç bënë së fundi dy autorët e veprës së famshme «Empire» Michael Hardt dhe Antonio Negri me studimin e tyre «Commonwealth» (2009), respektivisht me manifestin e tyre (kapitulli i fundit) në mbyllje të librit «De singularitate – për institucionin e fatit». (2013)

### 3.

## *Asketët e vetëmohimit*

*Meritokrati, vasali, nihilisti*

Çfarë e lidh KEK-un me Isa Boletinin? Për ç'arsye klasa politike operon me histori? Vetëmohimi si strategji konstruktivi kategorish sociale që në realitet nuk ekzistojnë. «Jam nip i Isa Boletinit» dhe po me të njëjtën frymë një protestues tha: «nuk përgjigjem për bëmat e prindërve të mi». Këto dy fjali linçuese për logjikën dhe arsyen janë pjesë e një polemike mes një politikani dhe një aktivisti të ri të shoqërisë civile. Politikani akuzoi aktivistin të jetë bir i «një inspektori të sigurimit ish jugosllav» që e paska torturuar atë gjatë hetimeve. Aktivisti për të dëshmuar se nuk ecën gjurmëve të prindit ftoi në asistencë gjenealogjinë ku paska identifikuar një fije që e lidh atë – për nga nëna – me luftarakun rilindas Isa Boletini. Diskutohej aty për «Rolin e shqiptarëve në kohën e ish-Jugosllavisë» apo për «Jetën dhe veprën e Isa Boletinit me shokë»? Jo. Temë debati ishte KEK-u tashmë famëpërdhosur.

Skena është karakteristike sepse nuk ekspozon vetëm një moment të rastësishëm të diskursit, ajo shpalos rrënjët dhe efektin e një dyluftimi që e bëjnë mes veti kategoria e «meritorëve» dhe ajo e «kolaboratorëve». Dy grupe patogjene dhe masive që pengojnë diskutet eventuale në favor të progresit shoqëror.

*«Meritorët» dhe «Kolaboratorët»*

Politikani dhe aktivisti edhe pse i kanë akuzat dhe avokatitë verbale të fiksuara në një problem aktual, reflektimi

i tyre ua dekonspiron frymën, mentalitetin dhe kompleksin psikosocial nga i cili vuajnë. Politikani u përpoq që nëpërmjet një episodi të biografisë së tij të konstruktojë paraprakisht mburojën në stilin: «mos më akuzo se i bëj dëm Kosovës sepse kam qenë i burgosur politik». Si reagim tjetri: «mos vër në dyshim veprimin tim patriotik se jam stërnip i Isa Boletinit». E KEK-u, faturat? Akutshmëria e problemit të KEK-ut përdoret këtu vetëm si sirenë që fton dy polet e armiqësuar politike në përballje frontale. Konflikti s'ka të bëjë me faturat, por ai është i thellë, ai shpërthen nga sfera e tij nënlëkurëse sa herë që mundet dhe eksternalizon luftën që zhvillohet çdo ditë ndërmjet dy «kastave» specifike. «Meritorët» besojnë se janë bërësit e lirisë kosovare për dallim nga «kolaboratorët», të cilët nuk paskan marrë pjesë ose paskan penguar këtë proces. Ndërkohë që të parët – duke përdorur edhe mekanizmat e shtetit dhe institucionet e varura prej tij – vetë-kategorizohen si «meritorë», të dytët diskriminohen, ngushtohen dhe etiketohen nga të parët si të tillë. Nga kjo pozitë mbrojtëse dhe me armët e njëjta (si etiketuesit) «kolaboratorët» nuk bindin dot se s'janë të tillë.

### *Në ikje nga vetja*

Në konfrontim e sipër revanshi bëhet tragjikomik: Të dyja palët nuk argumentojnë, ato shpifin realitete në të cilat as si aksidente të një anomalie temporale nuk mund t'i imagjinojmë. Absurdi është i neveritshëm sepse aktorët përdhunojnë dhe përvetësojnë kujtesën kolektive, instrumentalizojnë origjinën biologjike (aspak domethënëse) në favor të performancës personale. Lloj komunikimi megjithatë që perceptohet krejt ndryshe nga mënyra se si e shpresojnë adresuesit: Frazat si «Nga nëna jam stërnip i Skënderbeut...» ose «Kur isha i ri...kam luftuar për ...» nuk sjellin utilitetin e synuar, por rezultojnë cilësime si:

protagonisti nuk e duron dot statusin aktual shoqëror, tenton t'i ikë përgjegjësisë për atë që bën ose përfaqëson. Ose personi ka probleme me origjinën e tij dhe vuan nga kompleksi i rehabilitimit duke bërë çmos të ngadhënjë mbi realitetin dhe kohën.

### *Anatomia e kategorive*

Në grupin e «meritorëve» rreshtohen ish të burgosurit politikë dhe pjesëmarrësit e luftës së fundit bashkë me fiset e tyre. Në atë të «kolaboratorëve» bëjnë pjesë në krye ata që kanë pasur funksione në sistemin ish-jugosllav, gjithë ata që nuk kanë qenë në burgje, ata që nuk kanë luftuar ose që s'kanë pasur mundësi ose vullnet të fotografohen me uniformë të UÇK-së. Kjo taksonomi na sugjerohet nga prijësit e dyja palëve.

Në njërën anë kemi tipin e shqiptarit që në vend të Titos besonte Enverin, luftonte e u burgos për të drejtat etnike, kombëtare dhe në anën tjetër kemi shqiptarin që lavdëronte Titon shante Enverin për të mbajtur gjallë familjen, kulturën dhe identitetin kombëtar. Përderisa luftëtari ishte zhytur në ndonjë gropë dhe mezi priste t'ia kapin sytë ndonjë kokardë, të tjerët me fëmijë që qanin në shpinë e krah, pa bukë shtyheshin me kondakë që të përfundojnë sa më shpejt luadheve, xhamive, çadrave të Maqedonisë, Shqipërisë, dhe Malit të Zi.

Ky krahasim i sapo bërë na thotë se në thelb se që të dyja kategoritë kanë bërë luftën e njëjtë nga pozita fort të ndryshme. Vetëm metoda praktike dhe ideologjike ndryshon. Ideologjitë, që të dyja ishin në praktikë çnjerëzore dhe as si lecka nuk iu nevojitën kosovarëve për ta bërë shtetin. Ato që kontribuan për ditën e bombës së parë të NATO-s ishin; i burgosuri që diti t'i sensibilizonte masat popullore për padrejtësinë dhe përkatësinë, duke e viktimizuar veten



burgjeve; mësuesi që shkollonte masat; oportunistët që duke viktimizuar veten me nënshtrimin ndaj okupatorit ndërtnan shkollat, universitetet, ruajtën gjuhën dhe identitetin dhe e përgatitën Kosovën (edhe pse me defekte) për të qenë e pjekur për t'i dhënë një dimension shtetëror vetes.

Po shohim se matematika historike na thotë se kategorizimi në fjalë është i shpifur. Asnjëra palë nuk ka të drejtë për privilegje ose anasjelltas. Për çfarë bëhet fjalë atëherë?

### *Sigjerimet irrelevante*

Bëhet fjalë për pak njerëz (sot në pushtet) që konkretisht manipulojnë duke sugjeruar se ata kanë qenë faktorët kryesorë që patën sjellë lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Deklarata e atij «politikanit» se paskësh qenë i torturuar nga «inspektori» është personale dhe pa asnjë rëndësi shoqërore. Fort manipuluese tingëllon sepse në nuk e njohim rastin në fjalë. Çfarë ndodh nëse dikur pasi t'ia kemi marrë dosjet Serbisë na del se politikanin i mësipërm ka denoncuar jo vetëm organizatën, por gjithë katundin e inspektori e ka lënë pa ndjenja nga druri që ai mos të fliste më, duke shpëtuar kështu një numër të madh njerëzish? Garanci nuk ka. Ata që qoftë si titistë apo enveristë kanë shkaktuar dëme të peshës së krimit kapital janë fatmirësisht aq të pakët dhe të sëmurë sa që edhe rehabilitimi do t'i vriste.

Jo pa asnjë arsye në demokracitë e konsoliduara personi vetëm atëherë perceptohet si relevant kur dëshmon autonominë, pra thotë «unë jam X dhe protestoj kundër Y» e jo «jam biri i babait tim dhe protestoj për faturat e fryra të gjyshes sime». Këto s'janë argumente që të autorizojnë të harbohesh me kërkesën që të të ndjekin masat popullore. Ashtu siç janë hiperbanale deklaratat «unë kam qenë ...» duke pezulluar qëllimisht si-në, pse-në dhe finalen e atij episodi.

Po KEK-u, fatura e fryrë e gjyshes? Presim që të bëhen histori se vetëm ashtu dimë t'i trajtojmë. (2013)

## *Semiotika e çyëzimit*

*Kohëvarri i idolit*

Pse asnjëri nga liderët e sotëm nuk thirret më «baba i kombit» apo «prijësi ynë i madh»? S'ka më personalitete të tilla apo shqiptarët tashmë gëzojnë lirinë për të qenë «secili mbret më vete». Idhujt dje dhe sot. Ai që dje sfilonte pors i yll province sot është antiheroi që bllokton. Aktualët prezencën e yjeve të djeshme institucioneve kulturore, politike, shoqërore, e konsiderojnë problemin rrënuese të demokracive dhe lirisë shqiptare. Kështu trajtohen idhujt e djeshëm nga shumica e të sotmëve. Qartë se nuk e kemi fjalën për «star»-ët e showbiz-it, filmit e gjëra të ngjashme, por për ata të cilët në episode të caktuara të historisë më të re shqiptare besoheshin pa kusht nga masat.

Asgjë tipike shqiptare: në çdo ndërrim dramatik modash, sistemesh kulturore e ideologjike shfaqet ky lloj procesi. Të «vjetërit» nuk i kuptojnë dot të «rinjtë» dhe anasjelltas. «Yjet» e sotme i akuzojnë ato në shuarje e sipër për prapambetje mendore e çmos tjetër, ndërsa të dytët i shajnë aktualët për degjenerim, nëpërkëmbje vlerash, sabotues të kujtesës, marioneta të modës ose që qenkëshin Rock 'n' Roll – istë kriminelë.

Në opinion ky konflikt perceptohet kryesisht si konflikt i natyrshëm moshash: Gjë që nuk është fare e vërtetë! Kemi të rinj që ende jetojnë viteve 1400 e ca mendësisht, ashtu siç kemi të moshuar që ende nuk pranojnë se në Woodstock nuk ka më festivale të hipive ose anasjelltas.

Gjatë përshkrimit të yllit të djeshëm do të shohim se problemi nuk qëndron tek subjekti i shenjuar. Duke analizuar yllin e sotëm do të bindemi se ai nuk ndriçon siç shkëlqenin e

plasnin yjet dikur. Janë larguar yjet edhe më thellë universit duke ikur nga ne apo ne kemi ndryshuar syzet dhe kriteret gjatë identifikimit, kategorizimit të subjekteve si idhuj dhe mite të gjalla? Dy shembuj nga kultura ose politika na shpëtojnë që mos të përhumbemi teorive abstrakte.

### *Yjet në shuarje*

Një personalitet që përfshin më shumë segmente: Adem Demaçi. Edhe ata që e kritikonin dhe shanin publikisht e simpatizonin ose si yllin e rezistencës shqiptare ndaj sistemit ish-jugosllav, ose si shkrimtarin, intelektualin që u bë viktimë për të drejtat nacionale dhe sociale shqiptare. Rexhep Qosja nuk ishte alfa dhe omega vetëm i institutit albanologjik dhe për ca shtresa ndoshta edhe bërësi apo zhbërësi i elitave të reja në shkencën e letërsisë, por ai kultizohej edhe si zëri kryesor intelektual në mbrojtjen e shqiptarëve në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi e gjetiu.

Pas viteve të 90-ta Ibrahim Rugova u bë ylli i natës dhe ditës kosovare, shkencëtari që me laps në dorë ishte nisur rrugës për të rrënuar muret brenda të cilave mezi frymonin njerëzit e tij. Gjitha këto personalitete të fuqishme – dhe ata që qëllimisht nuk i marrim si shembuj – për dekada shërbyen si fanarë që ndriçonin udhët shqiptare drejt aspiratave në atë kohë dhe ato rrethana. Sot dy të parët nuk marrin pjesë në asterikën e koncepteve shqiptare. Përkundrazi veprimet e tyre, nga një masë në rritje qoftë ajo intelektuale apo jo, kontestohen dhe merren si të demoduara, bllokuese. Pa i faktorizuar këtu edhe ata të ekstremimit që – folur me gjuhën e latinëve të vjetër – i shohin të njëjtët si «des astrum» – ët (yje fatkeqe, katastrofa) që pengojnë harmoninë ndërshqiptare. Madje edhe i ndjeri Ibrahim Rugova nga njëra palë shikohet kthjellët, nga tjetra hyjnizohet e nga e treta

kritikohet. Rugovën, në krahasim me të tjerët, mençuria nuk e la të narcizohet aq sa kërkon pozita e të qenët lider absolut.

Ç'po ndodh pra? Kush i zëvendësoi e ua zuri dritën yjeve të djeshme?

### *Mini-yjet*

Qysh ditëve të para të «hyrjes» në tranzicion u manifestua nga pak vërtetësia e atij proverbit që pohon se «çdo shqiptar është mbret për vete» (s'ia di burimin). Idhujt, udhërrëfyesit për nga nervozizmi, akuzat dhe vaji, të bënin të kuptosh se nuk ndihen aq të sigurt e shtrënguar samarit sa ç'kishin shpresuar. Qoftë prijësit e vjetër ashtu edhe këta që ende përpiqen të bëhen yje, shpejt u përballën me syrin – deri atëherë si duket pas hekurave të totaliteteve të ndryshme – skeptik, seleksionues. Sali Berisha kurrë nuk arriti ta zëvendësojë Enver Hoxhën për nga dimensionin e shtrirjes së kultit. Përkundrazi qysh viteve të para kur erdhi në pushtet kishte më tepër refuzues se sa duartrokitës.

As Nano s'kishte si të bëhet yll me gjithë ato hipoteka qafës. Edi Rama përditë i bën atentat karizmës si dukuri dhe vetes si politikan. Hashim Thaçin nuk e ndihmojnë as PR agjencitë, as shokët e shkolluar jashtë shtetit e as gratë simpatike të diplomacisë ndërkombëtare që bashkëshitetasit e tij ta marrin më seriozisht. Edhe atyre që e quajnë «profet» u lexohet në ballë utilitarizmi në formën e tij primitive. Ramush Haradinaj ia nisi mirë – e aktualisht as vetë nuk i beson vetes ketë potencial prej ylli.

### *Meteorët gjemborë*

Po shohim se yjet nuk u zëvendësuan. Në kontinuitet – nga 1990 e deri sot – ato humbin statusin që kanë pasur. E kjo nuk ka të bëjë me faktin se Hashim Thaçi është më pak i bukur

se Adem Demaçi apo se Sali Berisha është më arkaik se Edi Rama, porse shqiptari arriti ta mësojë dhe vërë në praktikë artin e shëndoshë të të dyshuarit – artin e të qenët skeptik para çdo vendimi. Rritet gjithmonë e më shumë numri i atyre që sot para se të tundin kokën si ndonjë pulë para autoriteteve – siç bënte dikur nga dhuna apo nga analfabetizmi populli – pyesin, janë kategorikë të dinë se si do duket liria, gjendja sociale ekonomike e politikë e tij para se t'i ngjiten pas ndonjë guruje. Ata duan të dinë se sa dijeni ka protolideri për solidaritetin social, moralin, kulturën.

Këtu qëndron problemi se pse nuk ka yje më.

Shqiptari i shekullit XXI duket ta ketë kuptuar më në fund poetin romak Publius Statius (shekulli i parë pas e.s.), i cili thoshte se «ndër të parët faktorë në botë, Frika krijoi perënditë» dhe të ketë vendosur që nga frika, nga mosbesimi ndaj vetes apo për shkak të dinamikës së turmës mos të kamuflojë, besojë apo ndjekë më verbërisht as perëndi, as yje e as prijës. Iku koha e liderëve? Jo yjet nuk shuhen kurrë, vetëm se ende nuk shporren mjegullat për t'i gjetur ballkanasit yjet e tyre që do tu ndriçojnë për tu mbrojtur nga meteorët gjemborë që vazhdimisht ua vrimëzojnë kokën. (2013)

## 5.

### ***Superioriteti me plis***

#### *Superiorët dhe inferiorët*

Në Prishtinë thonë se ata Tiranës sillen si superiorë. Sa qëndron kjo tezë?

Në njërin nga emisionet e shkuara të KTV-së me Adriatik Kelmendin u diskutua çështja e «Bashkimit Kombëtar». Nuk doli gjë e re përveç asaj që konstatohet që shumë kohë: Pragmatikët dhe Idealistët përpiqen të bëjnë për vete sa më shumë territor të «trurit» shqiptar. Për këtë pra është folur shumë. Le të pushojë pakëz kjo temë. Po merremi me temën tjetër që e shtroi Shkëlzen Gashi, njëri nga diskutantët e emisionit. Publicisti nga Prishtina akuzoi industrinë kulturore të Tiranës se ajo sillet me supremaci ndaj bashkëkombësve jashtë saj. Paralelisht pohoi një spekulim të kamotshëm se kosovarët ndihen inferiorë ndaj vëllezërve të tyre. Inferioritet që burimin e paska në dashurinë tradicionale të kosovarit ndaj shtetit shqiptar. Arsenali argumentues që shoqëroi këto «teza» u përbë nga: Fabrikat e letërsisë së Tiranës injorojnë përkthimet e bëra nga kosovarët qysh viteve 70-ë; kosovarët nuk janë pyetur gjatë standardizimit të «gjuhës kombëtare» dhe tregu në kontekstin e librit si mall është i pabarabartë, pra gjatë një panairi në Prishtinë 80% e librave të botuar kishin ardhur nga «Tirana».

#### *Superiorë sepse inferiorë*

T'ia nisim nga e mbara: Superiorë ndihen ato individë, grupe e shoqëri të cilët mendojnë se janë më të aftë, më të mençur, më dinjitozë se dikush tjetër pranë apo larg.

«Argumentet» e superiorëve si zakonisht janë seleksionim i qëllimshëm për çështje onanie dhe konkurrence. Ato nuk përfillin dështimet që janë po aq pjesë e rëndësishme e një habitusi sa edhe arrijtet. Nga epidemia e superioritetit janë të infektuara si vendet europaerëndimore, shtetet e zonës së standardit më të lartë ekonomik, të cilat çdo qelizë dinjiteti human e peshojnë me kandarin utilitarist, ashtu edhe zona e kombeve dhe popujve fukarenj të cilët superioritetin e argumentojnë me leksione nga biologjia dhe historia.

Tek problemet, preokupimet, analizat, studimet dhe diagnozat që shoqëritë i bëjnë mbi veten mund të gjejmë edhe përgjigjen se përse një shtet, një shoqëri apo një grup ka nevojë për ndjenjën e superioritetit. Në shoqëritë perëndimore që nga fillimi i viteve tetëdhjetë nga shkenca dhe masat akuzohen utilitarizmi, neoliberalizmi dhe globalizmi se paskëshin shkatërruar familjen, ndjenjën e solidaritetit shoqëror dhe sidomos se kanë paralizuar demografikisht kombet europaerëndimore duke ulur në mënyrë dramatike lindshmërinë e tyre. Këto akuza nuk janë të majta e të djathta, por përbëjnë frikën tashmë disadekadëshe e të gjitha politikave (me çfarë nënkuptohet edhe ringjallja e nacionalizmit ekstrem dhe konservatorizmi në rritje i socialdemokratëve) perëndimore ndaj tjetërsimit kulturor e identitar.

E kush rrezikon tjetërsimin identitar të perëndimorëve superiorë? Superiorët e tjerë që nga lindshmëria bombastik, formëkopeshë (solidariteti i tepruar fisnor e familjar) braktisin vendet dhe kulturat e tyre të «shenjta» për të siguruar mirëqenie tek të parët. Të parët ndihen inferiorë ndaj të dytëve sepse këta kanë ruajtur faktorët e rëndësishëm të hierarkisë tradicionale shoqërore e të dytët ndihen inferiorë ndaj të parëve sepse këta gjenden në kulmin e mirëqenies dhe zhvillimit. Të dy superiorë sepse inferiorë.



Po shohim se ku i gjejmë bakteret që këtyre dy kontrahentëve (jo vetëm në kuptimin e kundërshtarëve, por edhe të bashkëvepruesve), superioritetit dhe inferioritetit, u japin statusin e epidemisë? Sepse që të dyja kanë nisur konkurrencën vetëm me gjysmën e tyre.

### *Detyrat kombëtare të privatëve*

Të kthehemi sërish në Prishtinë e Tiranë. Po çfarë e përbën superioritetin shqiptar dhe inferioritetin kosovar? Ai përshkrimi që bëmë më lart nuk vlen në kushtet shqiptare. Pse? Sepse të dyja shoqëritë – ajo shqiptare dhe kosovare – kanë intensitet lindshmërie të njëjtë, janë të pandashëm në fukarallëk, në çështje të globalizmit, utilitarizmit, marksizmit, patriarkalizmit dhe gjitha izmave tjerë të mundshëm.

Ku atëherë? Shkëlzen Gashi superioritetin «shqiptar» e sheh sidomos në kulturë. Injorohen autorët, përkthyesit dhe mediat kosovare. Ka mundësi. Edhe pse ende nuk e kemi takuar asnjë intelektual «tirane» që mos të dinte se kush është Ali Podrimja ashtu siç nuk kemi takuar ndonjë «prishtinali» që nuk e di se kush është Ismail Kadare.

Po ashtu e dimë se mediat lokale gjithmonë kanë përparësi ndaj atyre nga jashtë. E dimë se qeveritë dhe shoqëritë duhet të bëjnë më shumë për komunikim kulturor ndër veti e ndër të tjera jo vetëm në relacionin Kosovë-Shqipëri, por edhe më gjere. Çështje këto që janë thënë e sterpërsëritur. Të shohim argumentet konkrete që u lansuan në emision.

E çfarë nëse ndërmarrjet private të Tiranës që merren me botimin e librit nuk i marrin përkthimet e viteve 70-ë të autorëve kosovarë thjeshtë për arsye komerciale, kur kemi parasysh se lexuesi i sotëm në Shqipëri është rritur e formuar ose edukuar nga familja me gjuhën «standarçe të Xhaxhit», të cilën autorët kosovarë të viteve 70-ë ende as që kishin filluar

ta përvetësojnë? Pse qenka detyrë kombëtare e një shtëpie botuese private në Tiranë a Prishtinë të përdor kuotën fifty-fifty (për Kosovë e Shqipëri) në prodhimin e saj të librave? Të kërkojë një gjë të tillë do të thotë ta censurosh lirinë e tregut (kësaj radhe jo nisur nga ideologjia komuniste, por ajo nacionaliste). E kjo nuk shkon në demokraci. Ç'argument «superioriteti» qenka panairi ku 80% e librave paskan ardhur nga Tirana? I ka urdhëruar ndonjë prijës Tirane që kosovarët mos të nxjerrin libra tamam në panairin që kanë organizuar vetë, apo ndoshta s'kanë pasur ç'të nxjerrin në ato momente?

Po ai «argumenti» se kosovarët ndihen inferiorë ndaj Shqipërisë nga dashuria...më mirë t'ua lëmë këtë punë psikologëve! Ata edhe profesionalisht e njohin më mirë termin që përshkruan gjendjen psikike të një njeriu që dashuron veç nga inferioriteti!

### *Temë aspakët*

Hulumtuar temën nga distanca, për të gjetur shkaqet dhe arsyet e superioritetit e inferioritetit ndërshqiptar, nuk na mbetet tjetër përpos të konstatojmë se ato nuk ekzistojnë si sëmundje me përmasa fenomen shoqëror, por vetëm si trauma personale individësh, arrivistësh të zhgënjyer ose të tillë që jetojnë me keqkuptimin dhe besojnë se shkathtësia retorike iu mjaftuaka si argument për t'u ndier superiorë. Sinqerisht nuk ka indikacione, argumente të tjera relevante! Temë aspakët. (2013)

## 6.

### *Sidoqenia e inferiorit*

Shqiptarët përfaqësohen keq në historitë e shumta botërore e kontinentale, ose aspak. Në diskutet intelektuale globale as si referencë nuk ekzistojnë. Pse? Faji i bigfoot-it apo ndonjë inferioriteti të kushtëzuar historik?

Intelektuali i njëmendtë, ku mbeti?

Dikur ai vegjetonte i kafazuar brenda degëve të dendura të asaj pemës biblike të dijes si një Bigfoot plotë frikë prej hominidëve tjerë cullakë të Edenit. Më vonë hoqi bananet nga fytyra dhe lëshoi këmbët e mëdha mbi dhé. Si rural i leshtë nisi odisenë klubeve dhe pufëve urbane dhe pas empirisë u trand e trondit: nisi të banojë në një fuçi të mbushur me klor, aty hynte për tu dezinfektuar nga vetvetja saherë; masturbonte rrugëve duke recituar vjersha arkaikësh e bukolikësh; me arrogancë refuzonte kategorikisht nacionalistët agresivë që e donin si primat, mit të fisit; urinonte tempujve të religjiozëve apokaliptikë dhe kontribut të vetmin për socialitetin kishte aksionin e herëpashershëm në autostradë ku i ndalte veturat e blinduara të politikanëve për t'ua pastruar xhamat dhe puthur këpucët.

Pastaj për një kohë të gjatë, u zhduk.

Ku mbeti?

### *Manifesti konvivalist dhe kombi*

Në vitin 2010, në Tokio, të thirrur nga grupi i intelektualëve si Alain Caillé, Marc Humbert, Serge Latouche e kompani u organizua një kolokium ku morën pjesë dhjetëra

shkencëtare të drejtimeve dhe bindjeve të ndryshme nga bota për të debatuar rreth një «arti të ri të bashkëjetesës». Substanca e debatit ishte: problemet globale si klima, varfëria, pabarazia sociale, krizat financiare dhe dështimi i shumicës së izmave dhe defektet e demokracisë, multikulturalizmit kërkojnë një formë të re të menduarit. Pasi «rastësisht» qëllova aty, dy miq të mi ndër organizatorët mu drejtuan: «ti do të ndihmojë shumë nëse me debatin i infiltron edhe kulturosferat ballkanike». Më duket se tunda kokën në shenjë pohimi pa e menduar fare kërkesën.

Në vitin 2013, kryesisht pjesa intelektuale franceze, dyzet prej tyre, pas një grindjeje ndërmjet shumëve, publikoi «Manifestin konvivalist – një deklaratë për interdependencën». Programi fillimisht nuk jehoi aq shumë sidomos ngase u sabotua nga kampi i të majtëve, atyre të ngjizurve për traktateve utopiko-radikale të tipave si Hardt & Negri e të drejtimit. «Manifesti» është pragmatik dhe konsensus përbashkues i shumicës së shkollave aktuale filozofike (në luftë me njëra tjetrën) prandaj parasuspendon nga debati çdo lloj ideologjie me të «vërtetën absolute në balle», siç janë sidomos këto njëdimensionalet postmarksiste.

«A bëre diçka. Është me rëndësi»? Kështu përmbajtja e e-mailit në vitin 2014 nga të njëjtët miq. Si a bëra diçka? Asgjë. Hyra mediave shqipe për të shpifur ndonjë arsye pro plogëtisë sime dhe shkrova: «Aktualisht nuk është koha e përshtatshme. Në debatet intelektuale mbizotërojnë sovranshëm temat mbi kombin, racizmin, fashizmin e të llojit». Reagimi ndaj përgjigjes time: «Qenkan ende në kohën e Herderit dhe Renanit». Shpëtova. Së paku për një kohë. Ndërkohë shpresoja se ndonjë publicist i ekziluar e kap temën dhe e shfytyron si rëndom e mua do më jepej një dëshmi se; ja Ballkani duhet ende të presë! Jo, as publicistë e askush tjetër

nuk e regjistroi debatin. Në të njëjtin vit Frank Adolf dhe Claus Leggewie e transportuan debatin edhe në gjermanofoni. «Manifesti» është nënshkruar kësaj radhe nga 50 sociologë, filozofë, politologë, antropologë, kulturologë, ekonomistë, gjithë eminentë, të cilët veprojnë me një pseudonim «les Convivalistes». Libri është në internet, falas.

Para disa ditësh sërish një mesazh: «Si është puna tash. A u bënë kombet? Dëgjo: ndoshta ty të janë bërë monotone këto programet idealiste që s'le vend pa i kritikuar, por ne besojmë se pikërisht në shoqëritë ballkanike mund të shpëtohet shumëçka se atyre nuk u ka humbur sensi për idealizëm dhe për ndryshim të botës. Përveç kësaj besoj thellë se në programin konvivalist gjenden përgjigje të shumta ndaj krizave identitare pas rënies së (i)realsocializmit...». Po si jo!

Viti 2016. Edhe një sy hulumtues mediave, rubrikave ku qërojnë hesapet intelektualët ballkanikë. Temat kryesore të debatit: Kombi, origjina, hajdutët dhe kaçakët në mbrojtje të kufirit. Temat tjera, ato me përmasa globale? «Hajt burrë se kush i merr parasysh shqiptarët», më tha një mik -autor. Pikërisht! Kush i merr parasysh shqiptarët?

## 2.

Ai ishte i skuqur si spec djegës. Doktor i historisë me origjinë shqiptare, në një universitet perëndimor, mu dukë të jetë bigfoot-i që në prag të paramodernës iku pa gjurmë nga pema e dijes dhe pastaj nga fuçia me klor. Sërish i trullosur. Edhe pse jo i mbilesosur më si bigfoot, tiparet tjera vrisnin çdo spekulim: Ishte njëri i kategorisë në kërkim të «prehistoric-survivor»-ëve. Nënçmimi i gjeneve, gjakut dhe racës e kishin shndërruar në reprotoksik, teratogen ndaj gjithë atyre që ia përshkruanin «popullin» ende me «bisht». Nuk i mjaftuan vetëm derrgërtit e kopshtit të vetë. Kishte kaluar kufijtë ashtu nga dega në degë, nga shpati në kulm dhe kështu

duke jetuar qençe nënurave të metropoleve akuzonte kontinente e planete për shpifjet historike? Në fund të defilesë epokave e qytetërimeve, së paku kësaj here, e pamë se ku hyri: në katakombet ku konservohen arkivat e akademive evropiane, aty u fut për të qëmtuar fijeflokët e primatëve të tij të supozuar!

### *Në vitrinën globale*

Në shumicën absolute të historive qofshin ato «botërore» apo «kontinentale», rrallë përmenden Ilirët dhe edhe më rrallë shqiptarët. Disa rreshtat për ilirët rrëfohen nga perspektiva e studimeve romake. Sidomos historia e Teutës dhe Agronit në mbrojtje të robërve të saj që plaçkitnin rend e pa rend anijet Adriatikut e jonit është saga më prominente. Kaq për Ilirinë nga shekulli 5 para erës sonë e deri në atë 6 pas erës sonë dhe njërën nga mbretëritë më të mëdha të rajonit. Në analogji me trimat e Hanibalit, hunët, vandalët, sllavët brutalë, germanikët handraqë dhe wikingët njerëngrenës, pirateritë e asokohshme të ilirëve dalin skena jo aq inspiruese për komedi lukianeske. Megjithatë vetëm kjo rrëfëhet e për tjerët ka studime me vagonë. Sekuenca e dytë më e përsëritshme në lidhje me shqiptarët në kuadër të këtyre metarrëfimeve, sërish nga një perspektive e lokalizuar hungareze, është ajo e Skënderbeut: jo siç e kanë pagëzuar papët dhe jo siç është faktografia rreth bllokimit të osmanëve, por përmendet vetëm si vullnetar, ndihmës pasiv i luftës së hungarezëve atje e për pushtimin e Bosnjës së sotme. Dhe minifragmenti i tretë, brenda të bëmave të posthominidëve me plis, është ai rrëfimi mbi prijësin legjendar Enver Hoxha. Portreti i tij në radhën e kokallave tjera historike si Stalini, Hitleri, Polpoti, Duçëja, Çausheku është kulmi komplet i përshkrimit të historisë së një kulture. Sërish kaq. S'ka dilemë se këtu ka bërë punë të madhe ductus-i historiografik sllavo-grek. Faj i tjerëve? Me

siguri se kanë nisur të shkruajnë propagandueshëm para shqiptarëve të Manastirit. Pse atëherë së paku në studimet e reja të veprave përmbledhëse mbi historinë dhe në fushat tjera shkencore nuk përfillen punët e shqiptarëve? Natyrisht se historikisht nuk janë «racë» Watt-ësh, Pasteur-ësh e Siemens-ësh, megjithatë a nuk është sot ndryshe?

### 3.

Ku mbeti ai bigfoot-i? Nuk doli nga arkivat ende? Po, po ishte arratisur vrapazi qëatje dhe ishte bërë profesor në njërin nga shkollat e shtetit me vetëm katër shtylla organizimi: gazetata, autostradat, sportelet për pasaporta dhe penicilinën! Bigfoot-it ia kishte kapur radaka qoftë edhe jashtë «pemës së njohjes»: se pa u bë shtëpia nuk nënshtrohet «komshia»! Rilindas ishte bërë dhe shpërndante frytet e pemës shkollave si kristalina ideore, si këshilla orakullore. Në këtë e sipër nuk bëri dot aq shumë intelektualë por së paku fabrikoi brigada publicistësh dhe epigonësh që me shkronjat si plumba e thirret si shpata jo vetëm pufet dhe klubet rurale i kanë bërë të dridhen nga frika por edhe akademive gjithandej globit u shërbejnë si helium – për te qeshur në raste vivisecimi.

#### *Projektet e panisura*

Shpërthimet e artistëve, personaliteteve në kulturë e shkencë me origjinë shqiptare gjithandej botës janë dëshmia kundër tezës që thotë se shqiptarët nuk disponojnë me kapacitete. Ato janë madje edhe shkundullues – por vetëm jashtë. Kapacitetet vetërealizohen vetëm me dy kushte: lindin jashtë ose ikin botës! Brenda dy shteteve e shoqërive shqiptare nuk kanë gjasa. Aty vegjetojnë dhe bëhen depresivë që mezi presin medikamente nga të afërmit në diasporë. Ata

përmythen me bërryla e nënçmim brenda llavës së divizioneve mediokre shtetërore dhe klubeve të pensionistëve në rehabilitim e sipër. Mediat kanë instaluar si yje një gjeneratë dhimbjeshumuesish që veçse nuk pëlcastin nga padija, infektojnë opinionin me të folmet aq të deformuara saqë s'ka gjuhë që s'i mallkon – shqipja si ashtu i shmang nga frika se përkeqet!

Pasi u bënë dy shtete me dy ministri kulturash sidomos idealistët e papërmirësueshëm besuan se edhe shqiptarët do të bëjnë çmos që së shpejti të flitet edhe për shqipefoninë si për frankofoninë e të ngjashme. Ortekshëm u shpërndanë idetë për shtabe ekspertësh që konkurrojnë me versionet e tyre të «historisë europiane», asaj «botërore» librarive të perëndimit dhe ku nuk mungon asnjë kulturë e kontinentit dhe ku asnjëri nuk e mallkon tjetrin të jetë fyer apo mohuar. Projektet në adresë të ministrave thonë se vërshuan si lumë për mbështetje të atyre pak intelektualëve që të marrin pjesë në debate si ai i «konvivalistëve» që e rrëfyem lartë, pa mbetur pjesëmarrja në duart e ndonjë emigranti që qëmoti është bërë i paafte të kuptojë mendësinë e shoqërive të origjinës. Flitej për bursa të veçanta që do të shpërndareshin akademike të gjuhëve imperiale e globale për studentë që do të studionin shqipen, kështu për të krijuar mundësinë e transferimit reciprok të dijes shqipezonë-perëndim. Asgjë nga të gjitha këto. Janë të zënë duke bërë kombe?

Problemi është edhe më i thellë!

#### 4.

Para se Bigfoot-i të tërhiqet në pemën e tij, të vetëve u kishte siguruar strehim në pemën tjetër – në atë të «jetës» që rin lapidar në kopshtin e Epikurit. Carpe diem është ligji që sundon tek ata. Nuk ia vlen të shkrihesh si pacient i Marksit, Nietzsches apo Freud-it në një shoqëri që me të drejtë Gabel,



Laning dhe Cooper besonin çdo ideologji saora ta shndërrojnë në skizofreni. Kështu flasin pasardhësit e Bigfoot-it. Si e komenton ai vetë këtë dështim të tij kolosal? A nuk doli nga pema për tu bërë demiurg i një mendësie të re? Para se të përbetohet se s' del më nga «pema e dijes», në një intervistë të fundit të tij me një zonjë të operas postmoderne zbërthen diagnozën: «ikëm se as pasardhësit tonë të parë, protohominidët nuk kanë qenë në këtë stad inferioriteti si këta të sotmit. Po të ishin kështu si këta nuk do ta kishin mundur natyrën duke u tjetërsuar në bigfoot-ë si unë». Ai është i bindur, bën bé në qiell e tokë shqiptarët të jenë të mallkuar nga perënditë me inferioritet. Prandaj nuk kanë guxim të lejojnë shumimin e «racës» së bigfoot-ëve dhe i detyrojnë të kafazuar të jetojnë pemëve të dijes, si majmunë që herë pas here lëshohen me ndonjë degë pranë tokës për të parë se në mos ka ndodhur ndonjë mrekulli, për të ikur pastaj për të njëmijtën herë brenda degëve duke qetësuar veten me bananet që ua kanë lënë trashëgimi uomo universal-ët e historisë së ideve e që tash janë izoluar në Olimpin e përtejesisë!

### *Tautologjia e një «inteligjencie»*

Inteligjencia shqiptare (kështu siç është) punon për ti bërë kombet e veta të mëdha brenda vetes. Tjerët bindin botën se janë të tilla duke u përpjekur të kontribuojnë për shpëtimin e planetit – në këtë e sipër edhe të vetes. Është detyra e politikave me demosët dhe demonët e tyre të përcaktohen për format e shtetit që duan. Është detyrë e akademive, ekspertëve të bëjnë historinë dhe tu ofrojnë intelektualëve bazë për debat publik. Detyrë e inteligjencies është të mendojë, reflektojë, konkludojë dhe gjykojë e jo të diktojë format e organizimit politik – ngase për këtë punë janë diktatorët, minitiranët, qeveritë, kastat politike. Detyrë e inteligjencies është të ofrojë forma të reja të jetës,

bashkëjetesës, politikës, për të përndritur opinionin me alternativat ekzistuese e jo t'i urdhërojë ato se po nuk jetuan siç thonë ata qenkan kotësira. Kjo lloj «inteligjencie» s'ka të bëjë me dijen, kulturën dhe as me bigfoot-in tanë si metaforë këtu, por është ajo kasta e devijuar që mund t'u shërbejë politikave për të mos u zhvilluar, ngase debatojnë me vite për çështje që janë e ecin vetvetiu, ngase janë procese historike e jo kauza të dirigjueshme – nëse po, nga kush se?

«Les Convivalistes»? Bota? Jo, se ende s'janë bërë për pemën e bigfoot-it. E ky i fundit rezistueshëm nuk pranon sidoqenien qoftë edhe duke u trashur me banane! (2016)

## *Azazelët anti fortuna*

*I revoltuari, oportunisti, banali, neoromantiku*

Ecën diçka mirë në shoqëritë shqiptare? Asgjë – thotë thuajse çdo artikull, opinion, libër ku mund ta hulumtojmë gjendjen e frymës intelektuale. Janë autorët dhe publicistët shqiptarë kryepesimistët e globit apo vërtet Fortuna, ajo perëndesha romake e fatit dhe lumturisë t’ua ketë suprimuar atyre të drejtën e haresë? Kështu duket sa herë që udhëton shkronjave shqipe, gati përherë ta dhurojnë përfytyrimin e dyluftimit ndërmjet Azezelit dhe të bukurës Fortunë, luftë që mbaron gjithnjë ngjashëm: Demoni i shkretëtirës zgërdhiet mbi perëndeshën e dërrmuar copash.

Shoqëritë shqiptare nuk janë për t’u imituar. Në plot sfera janë e keqja e vetes. E keqja më e madhe nuk është fakti se janë kështu si janë, por se u mungojnë alternativat serioze për ndryshim. Pse e si vallë?!

### *Teoritë*

Diogenes nga Sinopa predikonte shkatërrimin e strukturave të Poleiseve dhe kthimin e shoqërisë në lirinë absolute të natyrës. Nuk gjeti përkrahje dhe nuk dimë saktësisht se si e mendonte kiniku i Sinopës jetën bashkë me ujqit e Leviathanit. Asnjë ide s’kemi as se ku i identifikoi më vonë historiani Georg Adler (1863 – 1908) sekuencat paraprirëse konceptuale të anarkizmit tek Zenon-i i Kition-it? Këtë vijë e konceptoi skeletshëm me filozofinë e tij aforistike Freidrich Nietzsche, i konsideruari Ati i nihilizmit. Ky i fundit dinte fort më shumë se antikasisit. Nietzsche fillimisht kërkonte „zhvlerësimin e të gjitha vlerave“, atyre negative dhe pozitive, meqënëse vetëm pas një katarsisi të plotë do të mundej të krijohej dhe edukohej „një racë e epërme e përbërë

nga mbinjerëz“. Si të bëhej konkretisht kjo punë? Çfarë të bëhej ndërkaq me „parazitët e shoqërisë“, me „të sëmurët që vegjetojnë të varur nga praktikat e mjekëve dhe spitaleve“ (Në: „Idhujt e muzgut“ V.6 F.134)? Karakteri aforistik i filozofisë niçeane nuk është ai që zgjatet shumë për të shpjeguar. Nazistët pandehën ta kishin kapur filozofinë dhe dijen përkatëse se si realizohet ëndrra: Duke masakruar botën dhe pikë.

Karl Marksi sugjeroi se nuk ka nevojë për dalje në natyrë e as mposhtje të të gjitha vlerave, por veç për diktaturë: proletariati vendos për gjithçka dhe të gjithë bëhen të barabartë. E ata që nuk e duan, proletariatin çfarë thonë ndërkohë? Godwin, Proudhon, Thoreau, Bakunin, Kropotkin, Glodman e deri tek Ward-i i sotëm të zalisin krejt me arsye të shumta se përse Marksi dhe komunizmi s’ia vlejné fare sa i përket lirisë dhe në vend të koncepteve progresive reale na kënaqën thjesht me shakara pa kripë.

### *Exkurs I – Njeriu i revoltuar*

Rushiti futi doktoratën në trastë, hodhi ofertën e Universitetit të Zürich-ut për të punuar si hulumtues shkencor dhe udhëtoi për në Kosovë. Neomarksisti aktiv e tip revolucionari u nis ta realizojë ëndrrën e tij; ta ndihmojë atdheun – që ia lanë prindit trashëgimi – të tij në rimëkëmbje. U bë mësues në fshatin e të parëve. Në një shkollë pa dritare, me libra mësimi nga koha e Jugosllavisë dhe në një fshat ku vajzat i mbyllnin të mbuluara me shami nëpër shtëpi. Iu bashkua një organizate gatiluftarake. I shkruajti ndoca artikuj akuzues kundër qeverisë. Demonstroi sa herë që mundi rrugëve të Prishtinës. U arrestua. Një herë përfundoi në spital. I zhgënjyer nga politika e korruptuar dhe numri simbolik i demonstruesve mblodhi plaçkat dhe u kthye në Zvicër.

### *Ekstremistët dhe shakaxhinjtë*

Filippo Tomasso Marinetti nuk arriti t'i kuptonte dot anarkasitet, mirëpo Nietzsche po. Përmbysja e të gjitha vlerave duhej bërë gjithësesi. Artet, muzetë, kultura duhet bërë hi: të gjitha mite të false dhe veç pleh. Një kulturë e re duhej për njerëzimin. Marinetti ua kaloi të gjithëve sepse shkroi diçka praktike: manifestin futurist! U bë arkitektura, piktura, muzika, letërsia. Me këto u jetësua edhe vetë fashizmi i Duçes.

Hugo Ball, Tristan Tzara, Marcel Janco dhe Hans Arp nuk e bënë të njëjtin gabim, këtyre tipave nuk iu interesoi se çfarë kish për të ndodhur pastaj, por veç të përqeshin, banalizojnë, përgojnë ekzistuesen, historiken duke u tallur si mos më keq. Dadaizmi jeton edhe sot: Qerreti, Shkëndija, Arian Çani dhe miqtë e këtyre na zbavisin pafund.

### *Eksurs II – Oportunisti*

Mikut virtual të Rushitit, Beqës mezi ia pranuan doktoraturën e bërë lesh e li në Londër. Po me të njëjtën ëndërr si miku i tij u nis edhe ai drejt mëmëdheut. Atje seç i kish disa shokë të babait. I shkroi dy tre artikuj bëmat e mëdha të popullit shqiptar, universitetit, luftës e „hyqymetit“ dhe brenda disa muajve u bë profesor i sociologjisë, këshilltar i kryeministrit, drejtor i radios shtetërore dhe nuk ndalet së qëndisuri me tituj e medalje.

### *Ekskurs III – Neoromantiku*

Augustini pasi u lodh në ekzil duke bërë biznes, mbledhi paret dhe shkoi në qytetin e lindjes. Gjatë qëndrimit dyzetvjeçar në Gjermani kishte mësuar shumë se si ecën demokracia, shteti, ligji. Hapi një bankë. Shiste mend gjithandej se si funksionon shteti, politika. Ndërtoi ca hotele. I humbi të gjitha. Falimentoi. Dhe i ra ndërmend: se në ekzil kishte qene klient e jo themelues e drejtues banke. U kthye në Gjermani si antipatrioti më i madh që e gjen mbi këtë tokë.

### *Ekskurs IV: Pragmatikja*

Motra e Rushitit, Ilirja nuk e dëgjoji të vëllain që mos të kthehej. La vendin e punës si shefe e një supermarketi dhe më në fund realizoi ëndrrën e saj për të punuar si mësuese, pasi në Zvicër, përkundër shkollimit nuk kishte gjetur vend pune. U bë mësuese. Në zemër e prekën gjitha ato vajza që shkonin kulteve fetare, por jo në shkollë. Vizittoi katunde, qytete dhe konstatoi se dukuria ishte masive. Ditë e natë mendonte se si mundej të kontribuojë në këtë drejtim. Mori shënime, krahasoi dhe bëri një koncept për ndihmesën e mundur ndaj vajzave të fshatit. Shkroi edhe një libër me shembuj e alternativa konkrete. Libri pati jehonë në media dhe projekti i saj respektohet fort.

### *Kritika në mungesë*

Intelektualët me plis fatkeqësisht nuk veprojnë si Ilirja, por ka gjithandej nihilistë, revolucionarë të tipit të Rushitit që akuzojnë, kritikojnë, dinë gjithçka dhe? Të pakët janë ata syresh që ofrojnë sisteme ose të dështuara mijëra herë, ose të

pazbatueshëm në kushtet shqiptare. Grupin tjetër po aq të madh sa të parët, e përbëjnë tipat si Beqa të cilët vegjetojnë me oportunitetin e tyre egoist. Grupin e katërt e përbëjnë neoromantikët si Augustini që veç ulërijnë se kanë jetuar diku ku gjithçka mjalte e rregull ka, mirëpo që as me një fjali s'dinë ta artikulojnë të përjetuarën.

Nëpërmjet këtyre karaktereve fiktive që përbëjnë shumicën (jo të masave por të „elitës“) nuk ecën dot asnjë shoqëri përpara. Përkundrazi, sa herë që del diçka pozitive ta sjell parasysh Jakobin që ngatërrohet me engjëllin sapo e sheh porsë në pikturën e Gauguin-it (piktura lart). Kritikkat, akuzat nga njerëz që nuk kanë sesi ta kenë zgjidhjen konkrete në xhep janë mëma e depresionit shoqëror. Të fundmes nuk i duhen mohues absolut, as shakaxhinj, as snobë, por mendje që nuk demonizojnë gjithçka sikur të kënaqeshin me të këqijat se ndryshe s'kanë me ç'të merren. Objektivët i duhen tranzicionit pra, jo depresivët. (2015)

## *Iluministë e iluminatë*

UEFA, EULEX, Evropa. E para një klub gatiprivat pseudomagnatësh të sportit. I dyti një aparat burokratik, i përzier me të deleguar nga të gjitha vendet anëtare të Bashkësisë Evropiane. E treta; kontinent në të cilin jetojnë afër 50 shtete, rreth 750 milionë banorë dhe qindra identitete e kultura.

Kur UEFA e Michel Platinit dënoi padrejtësisht shqiptarët, mllefi ishte tifozerik, ekstrem mirëpo i arsyeshëm. Justifikativ ishte reagimi sepse racizmi dhe arroganca serbe që përllau me ditë tëra mediat e deri në kryehierarkinë shtetërore ishte gati programatike, tradicionale dhe e gjithë bota e perceptoi si dasmë lugetërisht mesjetarë. Jo vetëm shqiptarët reagues. Mediat gjithandej botës poashtu dënuan vendimin e Platinit dhe stafit të tij. Vetëm zëdhënësja e baroneshës Ashton, Kojançiq morri qëndrim proserb –për tu bërë referencë pozitive e Beogradit, e njëanshme dhe pa nevojë fare.

Disa javë më vonë ish prokuroerja Maria Bamieh nëpërmjet “Kohës ditore” plasi skandalin duke akuzuar funksionarët e EULEX-it për korrupsion; lidhje me nëntokën kosovare dhe bashkëpunim të ngushtë me shërbimet sekrete serbe. Gjëra që dihen më shumë se një vit dhe që frymëzënë funksionimin e EULEX në Kosovë dhe raportin e tij me qendrën në Bruksel tas e dy vite. Nga shumë njohës të aparatit hetues të BE-së, thuhet se shpërthimi i Bamieh do t’i bëjë mirë këtij institucioni tashmë aq të rjetëzuar dhe pjesërisht



sektaresk, sepse ose do ta minojë si të pasuksesshëm ose do ta pastroja nga tumorët e shumtë.

Mediave dhe rrjeteve sociale plasi një debat i ashpër, në të cilin secila ideologji, fé, parti e mendësi tentonte të përfitoj sa më shumë pika për kauzën personale.

### *Iluminatët*

Si në ofensivë vërshuan internacionalistët e gjelbërt. Ata që mezi presin «të ngulet Evropa» në ndonjë skaj nga ndonjë «përfaqësues» i saj, për të kërcyer me «imperializmin» që po eksploaton Kosovën materialisht (!) e në frymë; ata që çdo gjë «perëndimore» saora e me pak citate nga bodrumet e revolucionit të tetorit e determinojnë si komplot klubesh konspirative të kozmosit kundër kësulbardhëve dhe gjithë kombeve të kuqe globit. Internacionalistët të gjelbër, sepse po të njëjtët janë kryesisht edhe apologjetët e hipotezës; myslimanët në Kosovë të jenë të diskriminuar, duke e ushqyer këtë fantazmë me teorinë e ndonjë plaku dandi, ndonjë filozofi ekzotik të Parisit që duket si relik i viteve të 68-ta. Konkretisht; e kanë ruajtur internacionalen veçse doktrinën marksiste e kanë koktejizuar me islamin politik, kështu duke u bërë bartës të një «paradigme» aq paradoksale, naive sa që as të qeshësh s'bën se është banalitet i atij lloji që edhe humorin ta shndrron në aksion reference pro tyre (ateizmi komunist mbron religjionin??).

Ky grup diskutantësh jashtëzakonisht aktiv mirëpo është si magnet. Ai kanalizon shumë shpejtë, qëllimisht padiferencueshëm, mllëfin e momentit drejt një ksenofobie, racizmi drejt Evropës si simbol të imperializmit, antishqiptarizmit, antimuslimanizmit. Edhe pse është absurde adresat dhe skandalet që përmendëm lartë t'i plasosh apriori si Evropa vetë – pjesë e së vilës janë edhe shqiptarët.

### «Iluministët»

Nga ana tjetër bënë hatanë «antinacionalistët, kozmopolitët». Në një mënyrë këta, brenda këtij debati shpikën një nacionalizëm të paqenë, keqinterpretuan qëllimisht mllëfin dhe revoltën fare provizore shqiptare si të tillë (sepse nacionalizmi është edhe program, traditë e cila manifestohen me simbolikën e “Shqipërisë së Madhe”) për t’iu ligjëruar shqiptarëve se cilat qenka parimet e Evropës iluministe.

Studiuar gjithë kampanjën, debatet, tekstet dhe deklaratimet i tronditur përballesh me injorancë që asnjë fije lidhje nuk ka me ato çka sot në përfundim konsiderohet si «vlerë evropiane» e mos të flasim që asnjë indikacion minimal, asnjë shenjë dijeje nuk manifestojnë nga paradigmat tashmë historike rreth po atyre vlerave dhe atë duke filluar nga *Kanti*, *D’Alambert*, *Lichtenbergu*, *Smith*, *Locke*, *Tindal* e deri tek *Raynal*. Shihet se nuk njohin as paradigmat e «Frankfurtit», as të neomarksistëve të «Parisit» e hiç debatin aktual intelektual mbi ato vlera. E natyrshme sepse për këto probleme flasin publicistë e jo ekspertë. Edhe nëse flet njëri ik i hutuar frizurëpërpjetë se i shpifet diskutimi.

Nga kjo analizë e debatit të radhës ndoshta mësojmë se pse çdo debat shqiptar mbi kulturën identitetin, nacionalizmin dhe çdo tjetër izëm është i paradënuar të dështoj. Të dyja palët nuk kanë brengë temat që trajtojnë por duket se duan të imponojnë rrugë kah duhet të ecin shqiptarët, udhë që kurrë vetë as me imagjinatë nuk paskan qenë.

Universalistët (inegzistent – dhe herën tjetër mbi këtë temë) e kemi fjalën jo si mendimtarë të ndonjë drejtimi të ri, por si çelësa universal mendojnë se mund ta hapin secilën derë, vetëm se dikush ua botuaka çdo halucinacion. Muhabet kot mes diksutantësh edhe më kot mbi tema aq të rëndësishme për shoqëritë shqiptare. (2015)

## *Snobët – live!*

Snobë janë ata njerëz që vuajnë nga kompleksi i epërsisë dhe që mendojnë se meritojnë postin e Primatit. Sish që mendojnë të jenë të gjithëdijshëm dhe trajtojnë të tjerët sikur të jenë infantilë, injorantë. Snobizmi shqiptar është implikativ: ai epërsinë e shpifur e maskon me theksimin permanent të vullnetit në favor të shoqërisë. «Idiotin» e Dostojevskit, «Gjeniu» e Dreiser-it, «Lolitën» e Nabokov, «Emil»-in e Rousseau-së etj. i gjen në çdo katalog të kryeveprave universale letrare. Kësaj liste ndërkaq çuditërisht i mungon njëra nga kryeveprat, ndoshta edhe nga më të realizuarat në mesin e atyre që janë përpjekur ta përshkruajnë njërin nga karakteret më të përhapura njerëzore: «Book of Snobs» e William M. Thackeray-t (1868) nuk radhitet pranë atyre titujve që radhitëm në lart.

Përse vallë? Jo, nuk duam të besojmë se diskriminimi i këtillë i është bërë Thackeray-t për shkak se kanonet e letërsisë botërore i sajojnë vetë snobët. Domethënë genie të atilla që autori edhe më bukur se tek «Libri i snobëve» i lakuriqëson në romanin e tij «Vanity Fair, or, a Novel without a Hero» (1847 – shqip «Panairi i kotësive – një roman pa hero»). Personazhet kryesisht të paemër të Thackeray-t janë dendi arrogantë që «majmunërisht», me thonj e koketeri duan të ngjiten sa më lart hierarkisë shoqërore. Energjia e luftës së tyre burimin e ka në fiksimin patologjik se ata janë më të veçantë se të tjerët, por që ja fati keq ua ka rrëzuar qëllimisht shkallët që mos ngjiten atje lart, në pedestal. Shikuar mirë kjo është një

sëmundje. Madje tepër e rëndë. Është luftë kundër diçkaje që nuk ekziston, ose siç thotë shkrimtari Oliver Hassencamp: «Snobizëm është të luftosh kundër dallgëve, aty ku s'ka ujë». Kryesimptoma i epidemisë në fjalë manifestohet me epërsi intelektuale, arrogancë dhe injorancë ndaj të tjerëve.

Është modë të mendohet se vetëm shkrimtarëve, poetëve, në veprat e tyre imagjinatëplotë u lejohet komoditeti i dendizmit, thjeshtë sepse sa herë që ata të zihen ngushtë me një kritikë të tillë, pastaj gëzojnë mundësinë të thonë; «jo unë, por personazhi im, jo personazhi, por këtu ka diçka biografike» e kështu deri në çmendje. Gabim. Shkrimtarët, artistet në kontekstin e kategorive shoqërore, në këtë drejtim janë minoritarë, sepse shumicën e përbëjnë të tjerët.

### *Kryesnobët*

S'ka si të jetë ndryshe: listës së snobëve më të infektuar në shoqërinë shqiptare i prijnë politikanët. Ashtu e do natyra e punës që kanë. Ata janë të detyruar të jenë demagogë, të bëjnë sikur për çdo mëngjes ulen para një globi të qelqtë ku janë kondensuar trutë e gjithë qytetarëve për të parë e dëgjuar se çfarë dashka populli sot. Lidhin kollaren, ia fusin me shkëlm guas, e cila ende nuk ka mbaruar me lustrimin e këpucëve dhe si rrufeja shfaqen kuvendeve e para mediave për të deklamuar të vërtetat e ditës.

Shtresa e dytë, herë pas here me një potencial edhe më të madh se ç'kanë politikanët, janë gazetarët, opinionistët e mediave të ndryshme. Ata që dy publicistët dhe gazetarët gjermanë Markus Metz dhe Georg Seesslen i quajnë «makina të budallallepsjes – fabrikat e idiotësisë» (Berlin; 2011). Sa hapim gazetatat lexojmë udhëzimin e publicistit X-Y se si të dalim nga skamja; na tregon se kush jemi; ka duhet të ecim; na qorton se kemi harruar në cilin kontinent jetojmë; na shajnë e përgojnë me citate hundëve se nuk e

paskemi kuptuar në shkrimin e parafundit; ne të gjorët nuk ia kuptojmë as shkrimin e radhës, sepse ka harruar ai vetë se ku e kishte fjalën. Në çastin kur u themi se diku, ndokund kemi lexuar edhe një variant tjetër të së vërtetës, se citatet e tij nuk janë përkthyer si duhet dhe kombinohen jashtë kontekstit dhe në mënyrë tendencioze dhe se ai do bënte mirë që të na i ofrojë të gjitha variantet ekzistuese që ne vetë të zgjedhim atë çfarë na vjen përshtat, atëherë, atëherë e dini se çfarë ndodh. Na i djeg krejt të gjitha qelizat e trurit me mesazhin e radhës: Injorantë – na thotë dhe ne strukemi. Snobët janë agresivë për nga natyra.

Shtresën e tretë të popullatës së snobëve – sa keq, s’kemi nga t’i ikim atij proverbit kinez që së fundi ma përmendi miku im, kitaristi dhe përkthyesi Nehat Kollçaku e që mund ta përmbledhim në thënien «si mileti ashtu pushteti» – e përbëjmë ne, respektivisht mentaliteti snobist i shqiptarit për t’u shtirur si fort i ditur dhe i aftë në të gjitha fushat e mundshme. Që mos bëhemi edhe më abstraktë se sa që jemi, po e marrim një ilustrim nga përditshmëria.

### *Live*

Dhjetor 2012. Në një restorant në rrugën e pufeve Langstrasse të Zürich-ut takohemi me gjashtë shqiptarë. A është doktor i shkencave natyrore, B shkruan poezi, C është historian, politikolog apo kështu diçka, D është pronar restoranti, E shkruan tekste pa lidhje portaleve dhe F është autori i këtij teksti që nga snobizmi moti ka harruar se si ta quajë veten.

*B: Pasha Zotin popull i ngaeprapa po jemi?*

*D: Pse bre burrë kush ta prishi?*

*E: Mirë e ka B se përnjime hajvan popull jemi he nënën.*

*A: Kuku C a e mban mend atë shkrimin tem që e botova në gazetën*

BS?

C. Po si jo. Aaa shumë mirë e kisha qendis.

A. Po kush na e varrën neve burrë. Atje poshtë menojnë se han dituri me lugë.

D. He pra prandaj i kemi punët mozotmakeq, se njerzit si ju (drejtuar A dhe C) nuk e udhheqin popullin.

F. Pse nuk shkoni atje poshtë t'ia hapni sytë popullit?

A. Prit prit edhe pak. Se populli nuk ha bar. Do vie dita jonë.

C. Mos u bën merak se po zihet diçka.

(A zgërdhihet).

E. Hajde ishalla. Mos na harroni mua dhe F.

U bë pushteti i ardhshëm. Ai doktori i shkencave natyrore mezi kaloi me disertacionin e tij të dobët dhe tani punon në një firmë private zvicerane për kafshatën e gojës. Politikologu gjithashtu me tituj dr-mr mezi jeton nga subvencionet zvicerane falë projekteve ku shqiptarët përshkruhen si qenie me bisht dhe shkruan sikur të jetë duke arnuar tirqe me tekstile Stambolli. Pronari i restorantit na «lodhi» sa herë që i vjen ndonjë letër për t'ia lexuar se s' di të lexojë as gjermanisht as shqip. Poeti ende nuk ka dalë nga malet e Karadakut dhe duket sikur akoma po i numëron pemët aty. Autori i këtij shkrimi (F) shumë shpesh as derën e banesës së vet nuk është në gjendje ta gjejë e lëre më të mësojë popullin. Gjithë defekte. Megjithatë «po zihet diçka» dhe së shpejti do ta udhëheqim popullin.

### *Motivet e snobit*

Ndoshta nuk e kishim regjistruar atë skenën e mësipërme po të mos na kishte nxitur kureshtjen për shkak të karakterit që ka; ajo është omniprezente në çdo kremte shqiptare. Papritur e pa kujtuar gjendesh para specialistësh të bujqësisë, aeronautikës, publicistikës, politikës, ekonomisë,

jurisprudencës, djathbërjes, lopëshërimit, filozofisë, informatikës, pushtetit, popullit. Dhe sa të fillosh të merresh me kapacitetin intelektual të tyre, me biografinë, me gjendjen e tyre sociale, të bie të fikët dhe i lutesh Zotit mos të zgjohesh më aty ku ishe, por diku, në një ishull ku s' shkel këmbë snobi.

Nuk na intereson për «popullin». Për politikanët, publicistët dhe gjithë të tjerët edhe më hiç. Hall e kemi veten se si të ushtrohemi që apriori t'i mësojmë vetë gjërat mirë para se ato t'ia shesim plot pompozitet masës popullore.

Domethënë duke shkruar t'ia parashtrijmë vetes të gjitha tezat dhe antitezat e një problemi për t'i mësuar për vete dhe kur t'i kemi mësuar përmendësh ndoshta bindemi se informimi apo edhe motivi ynë iluminist deri në atë moment nuk paska qenë asgjë tjetër përveçse maskë, manifestim i snobizmit tonë. Ndoshta edhe humbim punën apo shoqërinë pas këtij kthjellimi. Sigurisht se keq, ama ky është çmimi: o snob o jo snob! Zgjidh e merr. (2012)



## *Ecce homo alienatus*

Ne nuk kemi pra asnjë bazë që na shtyn të flasim në formë rezultative mbi tëhuajësimin tërësor të individit, por vetëm për: Tendencën për shkatërrimin, pezullimin e lidhjeve individuale, grupe apo shoqërore me faktorët e natyrshëm identitarë (gjuha, tradita, kultura, zakonet) për të sajuar një identitet tjetër!

### *Problemi*

Vala e presionit të tëhuajësimit përfshiu fillimisht Shqipërinë: shkrimtarë që copën më të madhe të jetës e çjetuan lagerëve të diktaturës moniste, nisën të shpartallojnë urrithshëm «defterë», relikte, të shpiknin pseudogjenealogji për të gjetur qoftë edhe një semifakt sadopak aparent për ta arsyetuar jopërkatesinë identitare që kishin kultivuar deri para daljes nga qelitë. Të ikurit, sapo i shpëtuan përmbysjes, iu avitën deteve, me ta lëshuar këmbën e paçoraptë rërave bregdetare të Greqisë e Italisë filluan t'i ndërrojnë emrat, datat, pamjen. Përtej gardhit të parashtetit, ku masat në gurgule donin të shpërngulin me vete edhe përmendoret, varret, ëndrrat, andej, përtej Shqipërisë, të njëjtët për nga origjina kishin hall tjetër; shpëtimin nga diktati i tiranisë së huaj. Këta, skllëvërit e rraskapitur, në mbrojtje të po atij identiteti «hyjnor» që të bashkëpatriotët e tyre andej Korabit e nëpërkëmbnin, nuk pyesnin për shkaqet, por nga pozita e

Patrator-ëve «me tapi» dhe pa përdëllim gjykonin, dënonin, denonconin, fyenin të «përdalët e kombit», «tradhtarët» të përavullonin linjën historike të shqiptarit, kontinuitetin, mbijetesën pikërisht në «sekondat e fundit para shpëtimit».

Pas 1990 gdhju 2008-ta. Shkurt pas mëvetësisë së Kosovës edhe këndeje ngriti kokë dukuria e tëhuajësimit: dëshirës së pafre të tjetërsimit!

Në fazën e parë të tij, fenomeni dukej si nihilizmi i intelektualëve të përëndimit industrial pas hipi-revolucionit të Woodstock-ut. Po si ajo periudha e curriculumit evropian kur autorët gjermanë, austriakë, zviceranë, anglezë strehoheshin në Paris dhe i poshtëroje fort po t'i pyesje për përkatësinë e tyre kombëtare; ishte periudha kur kozmopolitanizmi internacionalist kishte vetëm dy antagonistë megaintelektualë, liberalët Raymond Aaron dhe Artur Köstler.

Në fazën e dytë të dukurisë, dallga e tëhuajësimit u kap nga menaxherë agjencish ksenofile, teopolitike që krehën xhami, shoqata bamirësie, portale dhe grupe të ndryshme qytetarësh të painformuar. Edhe më masivisht se ç'ndrruan identitetin skamnorët e Vlorës tok me zonjat e paperspektivë të Fierit, tëhuajësimi i shqiptarëve në Kosovë, Maqedoni, Luginë e gjetiu është më radikal, ngase ai nuk bëhet vetëm sa për optikë e formalitet akomodimi material, por është më i thellë, sepse nuk refuzon vetëm aktualitetin real, por mëton ta falsifikojë edhe retrospektivën deri në datën më të thellë të saj – natyrisht irracionalisht. Këta alienatë (të tëhuajësuar – nga latinishtja) janë sot në shënjestër të shumicës absolute: «mjekrat», siç i quan populli me neveri radikalistët e sotëm islam, këta qenkan domethënë demonët që rrezikuakan identitetin kolektiv shqiptar në shekullin 21.

Se sa masiv në të vërtetë është ky realitet, le të mbetet gjithësesi hall i instituteve hulumtuese që bëjnë statistika, ne na intereson më shumë arsyeja, origjina, shkaqet, përse-ja e

dukurisë, nga motivohen individë e grupe të këtilla t'i hynë një procesi të tillë? Pse kaq shumë njerëz të kësaj epoke përpiqen ta zhveshin identitetin e tyre. Pse pikërisht tani gjithëkaq njerëz duan të ikin nga identiteti i tyre, nga vetvetja?

## II. Parakushtet

Historia njerëzore ka plot shembuj e faza me të cilat mund ta ilustronim suksesshëm atmosferën psikopolitike, privilegjuese të tëhuajësimit. Ndër kronikat më të spikatura për ta bërë krahasimin është ajo e «*Depresionit të Madh*» amerikan të viteve 1929 – 1933 – kjo për shkak të trajtimit të tij në të gjitha fushat e dokumentueshme.

Letërsia, Filmi, Teatri, Muzika, dmth. artet, si zakonisht na ndihmojnë edhe vizualisht, pa mjegullime ekstrateorike, që të krijojmë empatinë e duhur për tu zhytur në fiziologjinë e dukurisë, ato na mundësojnë mjaftueshëm të futemi nën lëkurën e subjekteve me presionin e tëhuajësimit dhe të konstruktojmë procesin mundësisht sa më autentik. Lekturë interesante rreth kushteve që çojnë në prafullimin e alienatit, gjysmëfabrikatit ontologjik në kërkim të vetërealizimit, është proza e John Steinbeck-ut «*The Grapes of Wrath*» (*Frytet e Zemërimit*: 1939. Filmi: 1940), respektivisht rrëfimi i fatit dhe jetës së familjes fermere Joad.

Rrëfimi në linja të kondensuara: Kohë e depresionit të madh. Oklahomë. Pas një thatësie të gjatë klimaterike familja Joad nuk mund t'i paguajë dot kreditet ndaj pronarëve të tokave. Si shumë familje të tjera fermerësh edhe ata do të dëbohen. Të rrasur në një kamionetë gjysmëfunktionale, dy gjenerata nisin odisenë drejt perëndimit; gjyshërit, çifti Joad, djemtë, vajza me barrë, dhëndri Connie, fëmijët. Kryefamiljari thyhet shpirtërisht qysh në *mile*-t e para. Nga këtu tashmë dirigjon *Zonja e parë*. Rrugës vdesin të moshuarit: gjyshi dhe gjyshja – patjetër që nga tmërri, poshtërimi,

detyrimi për të emigruar. Dhëndri dhe njëri nga djemtë largohen nga familja. Në Kaliforni, në vend të punës, familja e përgjysmuar përballet me urinë, armiqtësinë, përjashtimin, nënçmimin, stigmatizimin.

Situata përkeqësohet kur Tomi, (i biri – njëherë i dënuar për vrasje) në demonstrata vret njërin nga pronarët e tokave. Këtë e bën në shenjë hakmarrjeje për vrasjen e mikut të tij, predikuesit shëtitës Jim Casy (Steinbeck vetë). Në fund, kryefamiljarit të dërmuar nuk i ka mbetur asgjë tjetër përveçse të vërë re skenën në fjalë ndërkohë që vajza e tij i jep gji një burri të uritur në grahmat e fundit.

### *II.1. Ekskurs kontrafaktik*

Të prishim qëllimisht ambalazhin e personelit dhe të futurizojmë kronologjinë e rrëfimit të Steinbeck-ut për një eksperiment tonin: Joad-ët i pagëzojmë me emrin Kryeziu. 1990. Përmbysjet soc-realizmi. Kryefamiljari humbet vendin e punës. Nis lufta. Pas kthimit – gjithçka e djegur. Asgjë nga prona private nuk ka mbetur tanimë. Nga të tjerët ata shikohen me sy të keq për shkak besimit në sistemin e vjetër, pa punë, të poshtëruar, të stigmatizuar. Çfarë të bëjnë kryefamiljari ose i biri tij – si në rastin e Tom-it Steinbeck-ian – para se të përjetojnë ngjarje të llojit se si vajza, motra e tyre ia derdh gjirin mbi fytyrë një të huaji, jo patjetër para vdekjes, por për shpëtimin e vetes nga skamja? Të ri-emigrojnë vallë?

### *III. Mentaliteti i improvizimit permanent*

Drama të këtilla – si në atë të *Depresionit të Madh* amerikan – janë masivisht evidente edhe ndër shqiptarë, mirëpo me një epilog krejt tjetërfare. Përkundër kushteve të rënda, shqiptarët bëjnë pjesë ndër ato shoqëri me funksionalitet paramodern fisnor (pa individualizimin ekstrem të shoqërive

postindustrial) të organizimit social, pra ku nuk mungon solidariteti kolektiv (diaspora etj.), e si të tilla ato nuk i shfarosin as krizat më të egra ekonomike. As nuk i sjellin në pozitën e Joad-ëve të Oklahomës së viteve 30-ë. Përveç kësaj, për nga mentaliteti, lirisht mund t'i numërojmë shqiptarët tek popujt me temperament të shquar të «improvizimit permanent» (koncepti letrar i John Cheever-it) si mjet mbijetese fizike. Në situatat edhe më tragjike, tirqebartësit ia dalin në njëfarë mënyre. Është për shkak të këtyre dhe shkaqeve të tjera që shqiptarët kanë mundur të shpëtojnë historikisht nga epidemitë e urisë, siç kemi parë në zona të tjera të globit.

E përbashkëta e dy rrëfimeve, atij amerikan dhe këtij shqiptarit, janë kushtet socio-ekonomike, gjendja identike ekzistenciale. Dakord. E njeriu ndërkaq? Ç'ndodh me psikën, shpirtin, frymën e tij?

Vazhdojmë më tej me një roman tjetër, të së njëjtës kohë dhe me të njëjtën temë për të ecur edhe sferave intime të njeriut.

Me Steinbeck-un pamë se cilat mund të ishin kushtet faktike që çkompaktësojnë grupin, familjen, shoqërinë, përmbledhshëm pra: e dekompozojnë atë: aty mësojmë për ndikimin e presionit të jashtëm (diskriminimi, përjashtimi, stigmatizimi) në tjetërsimin, respektivisht deformimin e njerëzve, mirëpo aty pak raportohet se ç'ndodh në zonat mendore, ndjesore të protagonistëve. Pastaj alternativat nuk kanë asnjë konkurrencë; mungon elementi kontrafaktik i rrëfimit. Për shembull: cilat mund të ishin alternativat për t'i ikur kulminacionit të dramës, çfarë do të ndodhte nëse Joad-ët do të kërkonin vetërealizimin dhe shpëtimin në ndonjë mënyrë tjetër jetese, ndoshta nëpërmjet ndonjë improvizimi mbijetues, duke braktisur profesionin e tokëpunuesve; duke kërkuar lehtësim me opiume; duke emigruar në Alaskë apo duke u rekrutuar në Legjionin francez të të huajve? Pse Joad-

ët në gjithë atë dramë dhe paperspektivë emigrojnë aq larg për të mbetur të njëjtët thelbësisht?

Teksa Steinbeck nuk na ndihmon për t'i provuar këto dilema, sakaq hapim romanin «*Bullet Park*» të shkrimtarit të mbiqajtur «Çehovi i paralagjeve», **John Cheever** (1912 – 1982), i cili poashtu brumin e opusit të të tij e përthith nga e njëjta dramë – depresionin e madh amerikan! Cheever, peizazhin e brendshëm të subjekteve të zhgënjyera nga «*ëndrra e madhe*» amerikane na e përçon duke filozofuar rrëfyeshëm: aty ai instalon teorinë e «*improvizimit permanent*» si teknikë ikjeje individuale nga depresioni i madh. Ja si i ikën vetvetes njeriu cheeverian.

*Rrëfimi:* Në pjesën e parë të romanit bëhet fjalë për familjarin Eliot Nailles. Ky njeri bën jetë monotone. Për ta duruar monotoninë e përditshmërisë ai përpin medikamente me grushta, nga të cilat është bërë totalisht i varur dhe pikërisht për këtë arsye ai ka probleme me familjen e vet. Në harmoni megjithatë, duket se funksionojnë marrëdhëniet e tij rrethin miqësor, për shembull, me fqinjin e tij Paul Hammer. Me këtë të fundit njihet në Kishë. Hammeri, bir jashtëkurore i një sekretare, braktis shtëpinë e një plaku që vrau veten duke ulëritur „*nuk duroj më*“, dhe zhvendoset gjithashtu në paralagjen fiktive të New York-ut, „*Bullet Park*“. Hammer është një Gin-Alkoholik. Dhe kjo është vetëm ana e ekspozueshme e njeriut që përveç veseve anti-konvencionale, zjen edhe përsërbrendshmi sepse gjykon të ketë humbur çdo gjasë vetërealizimi sidomos në atë kohë të rrënimt të ëndrrës së madhe amerikane. Pas udhëtimeve bizarre nëpër hapësirat e veta mendore e shpirtërore, Hammer sajon recetën se si do të shpëtojë nga „zbrazëtia asgjësuese“ dhe „se si do t'i hakmerret“ thyerjes së ëndrrës së madhe pikërisht në ditët më të mira të tij. Ai do të vrasë brenda në kishë Eliot Nailles-in (më vonë edhe birin e tij Tony). Pse vallë? Pas arrestimit të tij nga policia, pasi që i dështon vrasja e tretë rituale Hammer na

e shpërfaq arsyeën: „Desha ta tërmetoj botën, ta zgjoj atë“. Hammer prangoset me diagnozën: kriminel psikopat!

Për çfarë arsyeje donte vallë ta zgjojë, t'i shkundë themelet e botës John Cheever? Dëshirua ai ta globalizojë faktin se ëndrra amerikane është një shaka infektive, afektive që mund të plasë për çdo çast porsì ballonë, pasi t'i ketë dalë gazi nga ndonjë vrimë e padukshme? Pikërisht këtë kumt pati dashur ta përçojë Cheever.

Morali i dy rrëfimeve nga letërsia amerikane është ky: Zhgënjimi është porta e çdo emigrimi jofizik. Atëherë kur thyhet ëndrra pason edhe shthurja e grupit. Individit i mposhtur, i zhgënjyer, fillimisht zbrazet nga besimi, kuptimi në idealet kolektive, hapat e parë të tjetërsimit i bën duke shkëlur demonstrativisht normat shoqërore. Po në këtë proces progresiv dismorfik ai fillon përpilimin e planit konkret të hakmarrjes ndaj botës, jetës, shoqërisë, shtetit, grupit, familjes, identitetit ku bën pjesë. Të rrallë janë ata që vrasin veten (vetëvrasjet – përse-ja qëndron te natyra egoiste e njeriut), shumica ndërkaq veçse i zhbën të tjerët. Porsì Hammeri i Cheeverit.

Sa mundemi vallë ta përdorim këtë model amerikan për të shpjeguar zhgënjimin, shpërthimin dhe tjetërsimin e individit apo në këtë rast tendencën e tëhuajësimit të kategorisë së alienatëve shqiptarë?

#### *IV. „Ëndrrat e mëdha“ shqiptare!*

Është e gënjeshtërt teza e rënies së diktaturës në Shqipëri. Ajo nuk ka rënë, por ngadalë e me vështirësi po zbret shkallëve të mendësisë dhe jetës shqiptare. Po aq saç është e gënjeshtërt edhe saga rreth çlirimit të Kosovës: vetëm ikja formale (nga sundimi politik) e serbëve nga Kosova nuk garantuan dot çlirimin, metanojnë dhe lirinë. Kosovaret ende mezi marrin frymë brenda sferës mendore ku sundon

radiokracia e së djeshmes (Udba, lufta, titistët, komunistët, enveristët), ata ende veprojnë me monizëm të fragmentarizuar (mungesa e demokracisë nëpër parti, organizata) e jo me pluralizëm dhe diversitet për cilësi. Kështu që shqiptarëve gjithandej nuk iu tha asnjëherë – si në Kosovë ashtu edhe në viset e tjera, qoftë nga politika e qoftë nga intelijenca – se vetëm me rënien e Partisë së Punës dhe largimin e tankeve serbe nuk bëhet liria, as demokracia e asgjë tjetër. Atyre iu implantua në tru e shpirt dita zero prej ku mund t’i hynin realizimit të „ëndrrës së madhe shqiptare“: lirisë së pakufishme, mirëqenies dhe demokracisë në nivel subito, përnjëherë, pra u krijua iluzioni se shqiptari i kafazuar deri atëherë, mjaftonte t’i ngjitej anijes, ta kalonte detin, të marrë udhët e botës (po si Joad-ët e Steinbeck-ut) dhe t’i bënte të gjitha. Kosovarit i ishte ligjëruar me dekada se sapo të ikte çizmjja e fundit serbe Adami, Eva dhe Mutalipi e Iliri munden lirisht të kthehen në parajsë (në Bullet Park-un e Cheever-it) ngase zoti do ndryshojë mendje. Se që të gjithë mund të bëhen ministra, kryetarë, të hapin fabrika dhe pufe sa t’iu zë syri. Pas euforisë, dalldisë dhe vërdallosjes, edhe më i trashi e kuptoi se *ëndrra e madhe shqiptare* ishte asgjë më shumë se sa një gënjeshtër e madhe.

#### *V. Rënia e „kullave prej letre“*

Përpos zhveshjes së gënjeshtres ndodhën edhe këto gjëra: Para 25 viteve nuk filloi të rrënohet vetëm monizmi. Me startimin e rënies së sistemeve politike u përdhën (këto më ortekshëm) edhe shumë kulla e piramida tjera: U tha tashmë se historia qenkësh një konstrukt rrëfimesh të imagjinuara komunistësh faraonikë; se besimet qenkëshin drynosur për t’u fshehur skeletet e klerikëve intelektualë e në udhë të drejtë; u konstatua se vetëm përtej sferave jetësore e mendësore shqiptare njeriu mundej ta realizonte veten si autoprojekt me



dinjitet; u «dokumentua» vizualisht ditënatë se *patria potestas* e ligjëruar nga Kanuni, patriarkalizmi shekullisht i lapidarizuar shqiptar, ai pushtet atëror nuk vyeka për hiçgjë më shumë veçse për inçeste e për të vrarë vëllanë; u parashtrua zëshëm e me këmbëngulje pyetja legjitime se si kishte mundësi që një racë e popull kaq fisnik, kaq heroik, kaq i ngritur kulturalisht të mos ishte në historinë e tij kurrë në gjendje ta organizojë, gjenerojë lirinë e tij? Shumë nga këto apori të lindura pas cesurave radikale nga viti 1990 e këtej, edhe sot e kësaj dite kanë mbetur pa përgjigje të mjaftueshme.

Njeriu shqiptar i „periudhës së tranzicionit“ i përngjan atij artistit pa përmbajtje të filozofit italian Giorgio Agamben sepse edhe ky vetëm sa e zbraz veten duke prodhuar pyetje, dilema, tema, mirëpo sakaq nuk kompensohet me përgjigjet përkatëse. E në situata të këtilla, njeriu ashtu siç është për nga natyra nuk mund të jetojë si ato statujat e zbrazëta të perandorit kinez Quin (259 – 210) që besonte se një ditë ushtarët e tij të ngurtë do të ngjallen si armata më e fortë e botës, por ata janë *ousia* që nuk bëjnë dot pa *essentia*-n; njerëzit kanë nevojë t’ia gjejnë kuptimin pranisë së tyre në botë. Ky presion i kërkimit të kuptimit shpesh në histori i ka detyruar njerëzit të rreshtohen para kioskave të shumta pseudokozmogonike, nga ato që na i ofrojnë ideologjitë e panumërta, teofabrikat tradicionale, sektet, religjionet, gurutë, partitë parapolitike dhe çdokush që me idenë e tij mund të bëjë para apo të fitojë pushtet.

## VI. „Tëhuajësimi“ në praktikë

Gjenerata më e re, kjo e tranzicionit, erdhi në një kohë ku gjithçka kishte dështuar dhe asgjë konkrete nuk dukej në horizont. Shkollat dhe mediat mezi mbijetonin duke u përpjekur të imitonin keq gjithçka nga perëndimi. Njeriu në hutim frymor, pa siguri ekonomike, një pjesë e madhe e tyre

(e privilegjuar apo edhe si skamnorë me një lloj respekti dhe kujdesi) edhe nën stigmën e „heronjve të rinj të revolucionit demokratik apo të çlirimit“. Situatën e pikasën teofilët dhe u vërshuan xhamive për ta prodhuar njeriun e ri: Ekstrafetarin. Xhamive filluan ligjëratat që nuk ofronin vetëm vendin në parajsë ku dhjetëra hostesa sakrale e të virgjëra do ta presin të riun shqiptar, por edhe asistencë integrimi në një kategori, një grup të veçantë. Shenjat e para të tjetërsimit ishin semantike: (nga masa) rritja e mjekrës pa mustaqe – e cila edhe pse kërkohet nga shumica e dijetarëve islamë si shenjë devotshmërie, dekadave të fundit është ngritur në simbol politik të muxhahedinit njëlloj si edhe shamia -, pas mjekrës pasoi rikonfigurimi i emrit me një ul, al, ib apo zarzavate të tjera dekorative si finale mediave dhe vendeve publike primatët e agjencive, xhamive dhe grupeve shpalesën edhe doktrinën komplete të tyre, e cila përgënjeshtrohte komplet atë që e kultivojnë shumica shqiptare si histori, traditë, synime. Gjithë ky proces tjetërsimi nga shoqëria shqiptare perceptohet si tëhuajësim në favor të një identiteti të huaj: ai herë është arab, herë turk pra, siç argumentuam jo vetëm për nga zona eksterne e individëve dhe grupeve, por edhe nga ajo interne, sepse edhe besojnë të jenë ndryshe, pra lirisht mund të bërtasim sërish si Nietzsche, por ndryshe: ecce homo alienatus!

Në gjithë këtë çështje kemi një problem kapital: vetë të „tëhuajësuarit“ refuzojnë t’i kategorizojmë megjithatë si jo-shqiptarë! Ata thonë se mbi të gjitha kanë fenë (gjë që domosdoshmërisht sakralizon edhe pushtimin osman), por megjithatë mbeten shqiptarë! E këtë nuk e bëjnë se vërtet janë patriotë, porse nuk munden ndryshe. Nga një ekskursion nëpër shkollat filozofike rreth tëhuajësimit ndoshta e kuptojmë dilemën e shqiptarëve që s’duan të jenë shqiptarë, por që nuk munden ndryshe!

## *VII. Historia dhe e tashmja e një nocioni*

Nocioni i «Tëhuajësimit», ngase i përshkruar dhe përdorur nga të gjitha shkollat e mundshme filozofike është tëhuajësuar edhe në vetvete deri në pafundësi. Ciceroni, Liviti dhe Taciti foljen alieno, alienare, alieanatus e përdorin përherë kur duan të shprehin tëhuajësimin e ndjenjave, mendjes. Ciceroni (në veprat: Finibus, Inventione, De re publica, Legibus, In Catilinam) tëhuajësimin (alienatus) e përdor gjithandej kur bëhet fjalë për mutacione metafizike, atëherë kur subjekti braktis qëllimisht normat, elementet identitare sociale, kulturore e politike për të përqaftuar të tjera syresh, të ndryshme dhe të huaja nga ai i «natyrshmi» (me këtë nënkuptohet ai i originës). Me këtë term ai akuzon pjestarët e Senatit sa herë që ata të veprojnë për interesa të kundërta nga ato që përfaqësonte Roma.

Skolastikët (Akuini, Okham, Boetius) e mesjetës e deri tek ata të kohës se re (Descartes, Kierkegaard, Leibniz) konceptin e tëhuajësimit e transcendojnë për ta funksionalizuar në interes të religionit (gjithë ata që nuk ishin me Zotin konsideroheshin të tëhuajësuar). Jean Jacques Rousseau e ka tërësisht gabim kur tëhuajësimin e konsideron edhe emancipimin, zhvillimin, qytetërimin e njeriut, largimin e tij nga bruto-natyra, egërsia. Marksi e redukton konceptin në pikë kritike kundër kapitalizmit, duke thënë se njeriu tëhuajësohet nga produkti dhe vetvetja e tij për hir të përfitimit. Postmarksistët dhe Postmodernistët e përdhosin edhe njëherë nocionin në fjalë duke ngatërruar rëndë dhe qëllimisht koncepte e shkolla të ndryshme për llogari të tezës: «Subjektiviteti ka nevojë për tëhuajësimin» (Achim Trebes) ose «Tëhuajësimi është e vetmja mënyrë për ta ruajtur identitetin» (Jean Baudrillard). Kjo linjë diskursi është fare e kotë sepse ajo rikthen debatin në stadin e gabimit rousseauian duke shpërfillur dallimin ndërmjet zhvillimit (dimension

historik – koha e botës) si proces të përparimit modernizues pa deformuar përdhunshëm identitetet e veçanta (diversitetin, hibriditetin – kohën e njeriut) dhe tëhuajësimi si akt fraktal demonstrativ dhe të shpejtë – pavarësisht optikave perceptuese se konsiderohet intern apo ekstern, thyerja konstatohet edhe nga pozita neutrale sepse mëton të zëvendësojë një identitet faktik dhe material me një tjetër syresh.

Defekti tjetër i postmarksistëve, si dhe postmodernistëve të sotëm është keqkuptimi ose falsifikimi i teorive të tëhuajësimi në funksion të empatisë (pa të cilën nuk ka fluiditet interkulturore) siç janë; vetja tjetër (Aristoteli), jotjetri (Nikolaus von Kues = „De Non Aluid“), intersubjektiviteti (Fichte), bashkëqenia („Mitsein“, Heidegger), koekzistencën fizike (Marleau-Ponty), përfshirjen e tjetrit (Habermas), alteritetin (Derrida), tjetrin absolut (Levinas), për ta finalizuar thirrjen absurde të «pezullimit të tjetërshmërisë» (Gadamer), çka pra nuk shkon aspak sepse ka të bëjë me krijimin e subjektit absolut njëdimensional. Vetë tendenca e njeriut të sotëm për tu rilokalizuar si rezistencë ndaj globalizimit, flet kundër teorisë së pezullimit të identiteteve, ngase, siç nënvizon profesori gjerman Norbert Bolz: «Kultura e mbron njeriun nga kompleksiteti i kësaj bote» Ajo, duke folur me Nietzsche dhe Freud-in e emancipon atë për të mos qenë kundër vetes dhe e mbron nga natyra. Nga ky eksperiment i yni me „depresionin e madh amerikan“ dhe „depresionin e madh shqiptar“ (1989 – 2015) shohim se sado që të transformohet njeriu, kultura bazë është kusht për të shëtitur nëpër të tjerat syresh dhe mbetet dominuesja pavarësisht konstruksioneve dhe tëhuajësimeve kozmetike për t’u grupuar me një habitus të një kulture tjetër identitare. Si Joad-ët, ashtu Hammer-i, Resulët, Kryezitë dhe shqiptarët që janë veshur për t’u vetërekrutuar në ISIS ndoshta jo se nuk duan, porse nuk mundën të mohojnë origjinën e tyre totalisht.

Ne nuk kemi pra asnjë bazë të flasim në formën rezultative mbi tëhuajësimin tërësor të individit, por vetëm për: *Tendencën për shkatërrimin, pezullimin e lidhjeve individuale, grupore apo shoqërore me faktorët e natyrshëm identitarë (gjuha, tradita, kultura, zakonet) për të konstruktuar një identitet tjetër!* Gjë që siç thamë është e pamundur. E pamundur nga njëra anë sepse të alienuarit nuk e mohojnë dot origjinën e tyre – pra s'ka tëhuajësim total, por kombinim fragmentesh kulturash të ndryshme për ta ndërtuar një të tillë individuale, e në këtë kontekst një syresh të qëndisur në favor të terrorizmit proilsamik – dhe nga ana tjetër sepse ngarkuesit e tyre me detyrat përkatëse kërkojnë që ata të jenë misionarët e tyre në kulturën nga e cila ata ndërkaq duan të ikin.

### *VIII. Përfundimi*

Tëhuajësimi i të ashtuquajturve „mjekra“ edhe pse është kozmetik patjetër që shkakton tërmete kohezive në shoqëritë shqiptare, sepse ai del të na jetë si ai Hammeri i Cheever, i cili vetërealizimin beson se mund ta arrijë vetëm me zhdukjen e të tjerëve. Shumica e tyre as që e dinë se tëhuajësimin e kanë të pamundur dhe se doktrina me të cilën janë të hipnotizuar nuk ka të bëjë me sistemimin e tyre pozitiv në botën tjetër apo në këtë depresion ekzistencial, por sakaq ai u shërben agjencive teopolitike e kseonofile për ta rrënjosur pushtetin e tyre atje ku duan.

Tashmë është vonë që shoqëritë shqiptare të mundohen t'i risocializojnë nëpërmjet ndonjë programi a aktiviteti sekular të „tëhuajësuarit“. E vetmja rrugë ka mbetur ajo që e tha edhe politikologu kosovar Shpend Kursani se risocializimi i tyre mund të bëhet vetëm me autoritetet që i pranojnë ata; xhamitë me personel tjetër mund t'i dehipnotizojnë alieantët shqiptarë, duke ua bërë atyre të qartë se të zhgënjyer nga iluzioni i ëndrrës së madhe shqiptare ata

kanë rënë viktimë e iluzionit të ëndrrës së madhe islame që del të jetë edhe më boshe se e para. (2015)

## 11.

### ***Tjetri jam unë!***

#### *Teori mbi empatinë*

«Shqiptarët janë populli më paragjykses në botë» – “mendon” shumica. Sidomos ndaj Tjetrit. Ksenofobë? Racistë? Jo! Ata funksionojnë si gjithë të tjerët, veçse janë më të egër, më brutalë ndaj Tjetrit brenda tyre.

Tiranitë, etnokratitë dhe teokratitë, ideologjitë e tyre i mbajnë gjallë nëpërmjet miteve – kryesisht të gënjeshtërtë. Për këtë arsye ato konsiderohen edhe si megauzinat e paragjykimeve të përditshme ndaj gjithçkaje *tjetër* që mund ta nxiste qytetarin të kërkojë alternativa ndryshe politike, sociale e filozofike. Këtë përvojë, ballkanasit e njohin fort bukur. Jo vetëm sepse deri dje jetonin në sisteme të tilla, porse ende «refuzojnë» të shkëputen prej tyre. Shqiptarët nuk përbëjnë përjashtimin. Jo vetëm politikën [partitë, qeveritë] e tyre operojnë me hiperinstrumentalizimin e miteve dhe paragjykimeve, por të gjithë: institucionet e arsimit, veçanërisht mediat, njerëzit. Si ndodh kjo?

Çdo mendim publik pa arsyetim, pa së paku një listë të caktuar shkaqesh e faktesh është paragjykim. Përjashtim bëjnë reflektimet, opinionet e materializuara me elemente të dijes së afirmuar kolektive – shoqërore ose të përbotshme. Madje edhe këto „aposteriori“ s’kanë nga i ikin falsitetit eventual – pra janë të çmontueshme nga antitezat që burojnë nga iksvariantet humane mbi çdo të «vërtetë» sapo të pretendohet se është e tillë.

Nëse themi se X – politikani është i korruptuar, pa ofruar asnjë dëshmi të vetme [vendim gjykate, fotografi, video, dokument] – paragjykojmë dhe shpifim. Kur e lavdërojmë dikë se është kritiku, romancieri, gazetari më i mirë pa

radhitur më poshtë arsyet përse [qoftë edhe minimale: titujt, tezat, krahasimet, artikujt, skandalet që ka zbuluar e gjëra të këtij lloji] atëherë thjesht paragjykojmë; sa herë që gjykojmë dikë *tjetër* se qenkësh i paaftë, i aftë, tradhtar, patriot, kozmopolit, pa i radhitur sekuencat e tij biografike me dëshmi konkrete për atë që themi – gënjejmë, paragjykojmë dhe veprojmë në bazë të instinktit që na e jep emocioni i simpatisë, antipatisë apo interesit konkret egoist. E kështu deri në pafundësi.

### *Diskursi*

Po analizuam diskurset publike nga kjo perspektivë, nuk do të habitemi me funksionimin e reflektimit bardh e zi, të dykatedralizuar: shqiptarët dalin të dinë të gjykojnë o si egoistë o si altruistë. Në kuptimin: ose e ndjekin idhullin X deri në autoklonim të *Tjetrit* ose e urrejnë *Tjetrin* deri në nënçmim, mohim, duke mobilizuar edhe shpifjet [nuk iu mjaftojnë faktet edhe nëse janë negative] më të jashtëzakonshme të fantazisë jetësore që kanë. Ky nuk është paragjykim, por konstatim i ngritur në bazë të së ekspozuarës materiale [në këtë rast mediat, librat shkollorë, etj.]. Edhe shqiptari me lehtësinë më të madhe dhe pa fije përgjegjësie paragjykon dhe më shumë vetëm paragjykon, sidomos *Tjetrin*.

Është ky model funksionimi ndaj *Tjetrit* dhe *Tjetrës* i trashëguar nga tiranitë dhe kultura parademokratike në të cilën gjenden apo e kanë specialitet gjenetik? Jo – më pak njëra e aaspak tjetra. Kjo pyetje madje është irrelevante për shqiptarin e sotëm. Ajo çfarë ai duhet sot të mendojë është se si t'i ikë kësaj mendësie që pjell aq shumë konfliktualitet dhe armiqësi në jetën e tij të përditshme.

*Alter ego si problem universal: Egoistët*



Problemi nis që me «Njëshin» e pariformatueshëm të Parmenidit. Ishin atomistët si Demokriti, Epikuri, Lukreci dhe gjithë pasuesit e tyre (deri më sot) që këtë paradigmë e përgjithësuan si të vërtetën absolute ontologjike – domethënë jo vetëm si teori mbi substancën e pashpërbërshme të „prima materies“, atomit, por edhe si princip për origjinalitetin absolut të frymës, njeriut, njëshit. Kryesolipsistët Max Stirner [1806 – 1856] dhe Emmanuel Levinas [1905 – 1995] e formulojnë më së bukuri rezultatit e këtij drejtimi filozofik: I dyti me teorinë e tij «të tjetrit absolutisht ndryshe» dhe i pari me tezën «Unë nuk jam një ego përkrah unëve tjerë, por unë vetë» (Uni dhe prona: 1845).

Fabrikat i kësaj tradite filozofike është afirmimi i individualizmit absolut, i cili triumfoi veçanërisht bashkë me revolucionin industrial enkas në shoqëritë e perëndimit europian.

### *Alteristët*

«*Uni im tjetër*» i Aristotelit është iniciativa tjetër paralele që mundëson një shteg reflektimi tjetërlloji nga ajo e atomistëve të barrikaduar në fortesën e njëshit të «rumbullakët dhe të pashpueshëm». Mirëpo jo më shumë. Thomas Aquin-i do ta përpunojë, zhvillojë këtë iniciativë më tej në konceptin e tij të «*tjetrit tokësor*», mirëpo nuk sjell më shumë se Parmenidi që në thelb thoshte të njëjtën gjë me përkufizim tjetër: vetëm Zoti mund të jetë njëshi i pariformësueshëm dhe absolut dhe asgjë tjetër!

Kthesën e sjellin John Locke me «identitetin personal» dhe Johann Gottlieb Fichte me teorinë e «intersubjektivitetit». Dy filozofët për herë të parë e sjellin qenien njerëzore aty ku është, në tokë dhe marrin parasysht emocionet dhe individualitetin jo vetëm si njësi abstrakte, por edhe si

subjekte konkrete që kanë nevojë për njëri tjetrin dhe që janë të „paradënuar“ me një ndërvarësi të natyrshme; dy unikatët sado të ndryshëm që të jenë, çdoherë i detyron domosdoja e aleancës në shumëfishim, shoqëri dhe zhvillim, prandaj puna kryesore që dy subjektet duhet të bëjnë është marrëveshja reciproke se kush dhe cilin rol ka. Tezë që përputhet siamezisht me atë të Hegelit që ndante rolet e subjekteve në pronar dhe skllav dhe që harmoninë e shihte në pranimin (dorëzimin) e vetëdijshëm të këtyre të fatit, pra të pozitave sociale që kanë. Po si jo? Jo thotë Jean Paul Sartre sepse ky model konceptimi i tjetrit e vegjeton njeriun në „stand by“ modus të padinjitetshëm? E zgjidhja?

### *Debatet*

«Çfarë e mban një shoqëri të bashkuar?» – kështu titulli i një studimi [2013] të përbashkët që kanë bërë dhjetë profesorë dhe studiues gjermanë dhe e kanë botuar Michael Reder (Fondacioni Roottendorf), Hanna Pfeifer (Universiteti Magdeburg) dhe Maria-Daria Cojocar (Roottendorf – Instituti për mirëkuptim nder popujt). Tezat nisin që nga ritet, gjuha, tradita, kultura e mbarojnë në «konstruksionet» tashmë të stërpërsëritura politike, kombëtare, kontinentale e globale. Në bashkëstudim qëmtohen vlerat dhe normat e shoqërive të ndryshme europiane, arabe, orientale, oksidentale, trajtohen vendet e dominuara nga islami, konfucizmi me synimin për të dokumentuar se në ç’sad krize gjendet sjellja e njerëzimit me pluralitetin. Formula e shpëtimit del e paradhënë: shoqëritë që priren nga iluminizmi e kanë zgjidhur ose do ta zgjidhin problemin. Më lehtë nuk ka ku shkon. Problematike na del në këtë debat mirëpo fakti se edhe shoqëritë e prirura nga fryma e iluminizmit kanë probleme me pluralitetin atëherë kur në përbërjen e tij integrohen fragmente kulturash që nuk kanë origjinë oksidentale.

Projekti duket si humbje kohe. Jo patjetër për shkak se autorët ofrojnë një formulë të caktuar, por sepse nuk dalin kompetentë lidhur me atë që merren: është paradoksale të kërkohet një formulë sjelljeje koekzistenciale, harmonike, integruese me bazë pluralitetin si vlerë njëkohësisht duke murrëtuar hapësirën, duke paracaktuar, sugjeruar e privilegjuar një shkollë të caktuar mendësie si të vetmen alternativë të përshtatshme që mundet ta mundësojë mendësinë e pranimit të diversitetit si të shëndetshëm. Kjo formë qasjeje përveçse nuk merret me përbërësin themelor, thelbësor dhe praktik siç është individualiteti, ai gjithaq edhe e ripërzjashton paragykueshëm *Tjetrin* si të padenjë për kulturën e pluralitetit vetëm pse është i paaftë të largojë nga vetja moralin, emocionalitetin, pra profesorët dukshëm kanë harruar të rilexojnë ose nuk kanë lexuar asnjëherë kritikën e Hegel-it [iluminizmi i trurit të bën më të mençur, por jo edhe më të mirë], të Nietzsches [Defekti kapital i iluminizmit është përjashtimi i emocionalitetit njerëzor], të Max Weber-it [Intelektualizmi, racionalizimi dhe çmagjepsja vetë nuk përmirësojnë kushtet praktike të jetës] ose të dyshes Adorno Horkheimer [instrumentalizimi i arsyes në favor të një modeli të caktuar kulturor me synime totaliteti, pushtimi]. Gjithë këta dhe shumë të tjerë pikërisht këtu shohin burimin e krizës së modernitetit; në përpjekjen për ta kushtëzuar pluralitetin *pa Tjetrin* ose vetëm me *Tjetrin si unë*.

### *Ora e empatikëve*

Në pjesën e tretë të kryeveprës së tij «Qenia dhe hiçi» Jean Paul Sartre e trajton alter egon (Qenia për tjerët) nëpërmjet solipsistëve të idealizmit, realizmit dhe modeleve për zgjidhje të problemit që i ofrojnë Hegel, Husserl dhe Heidegger.

Teoria në vija të përgjithshme ecën këtyre stacioneve: 1. Fakti që ne jemi (ekzistojmë) ka si shkaktar *tjetrin*. 2. Gjuhën që ne flasim e kemi marrë nga *tjerët*. 3. Ushqimi, veshja, sjellja dhe pozita jonë sociale është program i të *tjerëve* me asistencën e *tjerëve*. 4. Më shumë se 90% e dijes sonë është meritë e të *tjerëve*. 5. Fundi jonë fizik celebrrohet nga të *tjerët*. 6. «Vazhdojmë të jetojmë apo jo» falë kujtesës së të *tjerëve* e kështu me radhë.

Ky ekskursion sartrik nuk na thotë vetëm se kemi lindur, jemi formuar, nuk mund të jemi, të ekzistojmë, të flasim, të arrijmë dhe ikim pa *tjetrin*, por ai nënkupton më shumë diçka tjetër (Nga stacioni 3 e tutje). Tezat na detyrojnë të bërtasim: *unë jam tjetri!* Dhe?

Sartre nuk na thotë qartë se për *cilin tjetër* (atë iluminist, atë oriental, oksidental, atë primitiv) e ka fjalën. Qëllimisht. Sepse nga këtu, nga ky stad i pranimit dhe respektimit të tjetrit – vetëdijshëm: tjetri jam unë – nis individualiteti i njëmendtë dhe konstruktiv, i cili asnjëherë nuk mund të çojë në mosdurime, konflikte, përjashtime, pavarësisht vendimit se ç’individualitet të shkon më shumë përshtat, qoftë ai fetar, doktrinor, pavarësisht nivelit intelektual, gjuhës, racës a kombit.

### *Sartre si shpëtues. Tendencat*

Demokracitë skandinave qëmoti kanë implementuar këtë «kërkesë» të ekzistencialistëve jo vetëm në diskurset publike e institucionale, por edhe në sistemin e tyre edukativ, arsimor. Në shoqëritë e tjera perëndimore (Zvicër, Gjermani, SHBA etj.) edhe pse nëpërmjet ligjeve janë arritur përparime të mëdha në drejtim të parandalimit të paragjykimeve dhe shpifjeve publike që çënojnë individualitetin (e brendshëm), ato nuk dallojnë nga ato ballkanike (gjykuar nga perspektiva

e temave të tjera), respektivisht shqiptare kur trajtohen individualitete (të jashtme), kultura e shoqëri të tjera.

*Tjetri* gjithandej problem.

*Tezë* – Siç shihet problemi me *Tjetrin* nuk është problem shqiptar. Nuk ekziston as *Tjetri* absolutisht ndryshe i Emmanuel Levinas as *tjetri* komplet identik. Deri sa të ketë njerëz me emocione, do të ketë edhe paragjykime – pra deri në fund të botës. Paragjykimet janë pjesë vitale e mendësisë humane. Dhe shikuar nga optika shqiptare nuk qëndron problemi këtu, por në një dimension tjetër: në atë kulturës së diskurseve dhe reflektimeve publike, të cilat sa më parë që të ndryshojnë aq më herët nisin drejt vetëkonsolidimit të shoqërisë shqiptare; në rrafshin individual dhe atë kolektiv.

Edhe shqiptarët duhet të mendojnë thellë në mos ajo që kërkon Sartri – nisja nga tjetri jam unë – dhe empatistët e sotëm si Jeremy Rifkin [Qytetërimi empatik: 2012] është rruga e tyre më e shëndetshme për ta dhe për *Tjetrin dhe Tjerët*. Kjo nënkupton parasëgjithash krijimin e një ligjësie që respekton tjetrin dhe mbron individualitetin dhe nisjebërjen e një kulture të re publike, aty ku paragjykimi të jetë i lejueshëm vetëm si fjali me pikëpyetjen në fund e jo si e vërtetë absolute që s'mund të jetë kurrë. (2013)

PJESA E DYTË  
*Shoqëria*

12.

## *Hartë problemesh*

*Hyrje*

Nacionalizmi nuk i mobilizon e as i përdhos më shqiptarët si deri para shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Armiqtë e huaj ngadalë ama sigurt braktisin fjalorin dhe psikozën e shqiptarëve. Ose ata zëvendësohen me të brendshëm. Kryesisht të imagjinuar, mirëpo jorrallë edhe konkretë. Të atillë formëdukurishë me të cilët ndeshet edhe demokracia më e konsoliduar e botës.

Konfigurimet aktuale politike ndërkombëtare nuk lejojnë më iluzione romantike së paku për do dekada të ardhshme shqiptarët duhet të pranojnë këtë gjendje gjeografike dhe të përqëndrohen brenda vetes. Të mësojnë që të trajtojnë negativitetet, dukuritë dhe krizat pa e shpallur menjëherë e zëshëm apokalipsën e tyre kombëtare.

Si çdo kulturë, shtet dhe demokraci tjetër që ka ecur përpara edhe shqiptarët duhet t'i sqarojnë do segmente kapitale të qenies së tyre. Segmente që po u lanë pa diskutuar, polemizuar e sanksionuar (ligjësuar) ato, kohë e pakohë do të tërmetojnë shoqëritë deri në eskalime të panevojshme, duke hedhur shqiptarët vazhdimisht prapa, atje ku filloi jo progresi por regresi, në vitet e dyzeta.

*Shteti dhe demokracia* - Nuk mjafton vetëm asistencë e të huajve për emancipimin e burokracisë shqiptare me rendin dhe kulturën e shtetit ligjor. Shteti edhe vetë duhet të nxisë e subvencionojë komisione, mekanizma e institute të pavarurra që merren me shkollimin, mbikqyrjen dhe sigurimin e kualitetit në praktikë.

Shteti, partitë dhe shoqëria civile janë të obliguara të bashkëpunojnë në formulimin e politikave kombëtare në relacion me atë ndërkombëtare. Parasësgjithash ta përcaktojnë veten: çka synon konkretisht, ku e gjen veten dhe cili mund të ishte kontributi i tyre rajonalisht e ndërkombëtarisht. Krijimi i parimeve të qarta, jo vetëm fragmentarisht mediave, por në formë programatike dhe të vendosur, konkrete do të kursente shumë grupe, organizata vendore e të huaja nga ëndrrat kot e vetësakrifikimi për ide e doktrina që në shtetet shqiptare nuk kanë se si të realizohen kurrë.

*Identiteti dhe historia* - Tashmë qarkullojnë versione të ndryshme të historisë shqiptare. Secila me më shumë fantazi se tjetra. Secila më tendencioze se tjetra. Edhe të huajt me stilin e dhaskalit me thupër në dorë përpiqen të emancipojnë shqiptarët me do „të vërteta“ diskursive dhe politikisht po aq tendencioze si të parat. Kjo polarizon dhe krijon konflikte të panevojshme si me tjerët ashtu edhe brenda vetes.

Shpesh dëgjojmë e lexojmë të punohet në këtë drejtim. Mirëpo me të drejtë dyshojmë në përmirësim; sepse në akademitë shqiptare ende janë divizionet e vjetra komuniste ose këto të rejat shfaqen të taborizuara, polemiste jo shkencore.

Është e një rëndësie të madhe që historia të punohet me objektivitet. Ashtu siç është e domosdoshme që dikursi mbi identitetin kulturor, nacional, politik mos të na lihet në duar ne publicistëve të izoluar që sipas erës së modës, si na merr mendja dhe pa pyetur as dy veta t'ua caktojmë identitetin shqiptarëve të shekullit XXI, por të organizohet nga akademitë e shkencave, nga institute të autorizuara të cilat në fund edhe mund t'i formulojnë tezat si rezultat i mbledhjes së informatave nga studimet e ndryshme konferencave shkencore.



*Religjionet* - Kohëve të fundit nuk është tepër nëse themi se eksponentë të religjionit më të madh ndër shqiptarë janë tërbuar aq thellë saqë haptas u thonë shqiptarëve që të bëhen gati për sheriatin. Nëse edhe shtetet dhe shoqëritë janë pro kësaj vijeje, atëherë dakord, reagimi do të ishte kot, fasadë, në të kundërtën shtetet dhe shoqëria duhet të reagojnë me kohë dhe në mënyrë preventive.

Duhet ligje rigorozë, të qarta dhe të aplikueshme rreth të së drejtës së bashkimit dhe grupimit qytetar. Qeveritë duhet të jenë transparente në njohjen e religjioneve dhe të caktojnë me vije të kuqe kufinj të e fushërveprimit të tyre. Ato duhet të respektojnë të drejtat e njeriut përpiktë dhe atë jo vetëm të atyre që konsiderojnë veten viktimë, por edhe të atyre që janë viktimë pa marrë parasysh volumin: sepse jo vetëm pakicat janë viktimë të shumicës, por edhe anasjelltas, shpesh edhe pakica dinë që me shoun e vetëviktimizimit ta torturojë shumicën deri në acarim.

Problemet janë të shumta, mirëpo demokracia, shteti, identiteti, historia dhe religjionet shfaqen aktualisht si akute dhe në këtë drejtim o bëhet diçka o eskalimet janë të paraprogramuara. (2013)

### *Evolucion semiotik sinjifikantësh*

Kozmopolitët kërkojnë vlera evropiane. Manistët dhe religjiozët duan ta kthejnë rrotën e shekujve nga e prapmja. Të dyja palët, faktikisht e në esencë, propagandojnë të njëjtën gjë; kultura dhe vlerat shqiptare qenkan në faliment! E vërtetë? E vërtetë: viteve të fundit vërehet një ndryshim radikal në përcaktimin e kodeve të vlerësimit. Ajo çfarë deri dje perceptohej si vlerë, sot denoncohet si komike dhe anasjelltas. «Kozmopolitët», ata që mezi presin që të tjerët t'i lavdërojnë si kampionë të vlerave evropiane flasin për (r)evolucion vlerash, kurse konservatorët vuajnë rëndë për rënien dramatike të do zakoneve të cilat paskan përbërë krenarinë e racës me plis si bora. Edhe pas një analize të mundimshme të diskursit (në të gjitha mediat e mundshme) rreth kësaj teme, identifikimi i vlerave konkrete që u shuajtkan apo i atyre që qenkan ngulitur së voni duket i pamundur.

Kjo ndodh sepse që të dyja palët, si «proevropianët» ashtu edhe manistët konservatorë bashkë me fetarët nuk bazohen në gjendjen faktike, në atë që ndodh realisht me sinjifikatët mbizotërues, por qoftë vajin e qoftë euforinë e tyre rreken ta shesin, imponojnë si aksiomë – që s'është aspak e tillë!

Se që të dyja palët bëjnë poza pa njohur realitetin real, këtë e tregon edhe uniteti i tyre afektiv: Sipërfaqësisht duken të jenë në antagonizëm, por thelbësisht në unison propagandojnë *falimentin kulturor* të shoqërive shqiptare, pa e argumentuar as minimalisht qëndrimin.

Ky paradoks vjen sepse internacionalistët argumentojnë vetëm politikisht (demokracia liberale) duke e bërë këtë në trajtën dëshirore (nuk jemi atje ku duam) e nacionalistët

përpiqen ta vrasin shekullin në të cilin jetojnë, duke kërkuar riinstalimin e mendësisë së epokës romantike (nuk jemi atje ku duhet) në kokën e ithtarit të James Andrew Arthur-it. Impossible.

Sipas diskursit mbizotërues pra, del sikur shqiptarët të gjenden në vakum, diku afër vrimës së zezë së kaosit.

Çfarë ndodh në të vërtetë me vlerat shqiptare?

## II.

*Kodet e vlerësimit publik* - Sidomos pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës duket të ketë filluar një ekonomi e re në sferën e sinjifikatëve, respektivisht aksiologjia shqiptare rikanonizon veten: në shumicën e mediave serioze (janë analizuar ato të Kosovës) janë rralluar ose kanë metamorfozuar konotacionin, kategoritë (zh)vlerësuese si patriot – tradhtar, komunist – kapitalist, armik – aleat, spiun – disident, katundar – qytetar, majtas – djathtas.

Klanet të cilat akuzohen se dëmtojnë qëllimisht vendin, shtetin, kombin nuk pagëzohen më si *tradhtarë*, por kryesisht si *kriminelë*, ashtu pra siç sugjeron filozofia ligjore, kushtetuta e jo manizmi. Ky rikonfigurim «degradues» semiotik mbjell optimizëm, jo sepse njëri kualifikim është më i butë se tjetri, porse i dyti implikon vepër konkrete penale e jo përgjithësim.

Komunisti nuk përshkruhet më si ai ushtari kokërruar dhe brutal stalinist që shqyen gra me bajonetë, por ai duket madje filozof me mjekër simpatike apo si intelektual socialdemokrat që kërkon komoditet edhe për skamnorët. *Kapitalistët* po detyrohen në pension nga biznesmenët *neoliberalë*. *Disidentët* dhe *spiunët* kanë pranuar të trajtohen si «relike» të historisë dhe presin gjykimin shkencor. Vetëm politikanët ende vazhdojnë ta mendojnë veten me shabllonet majtas, djathtas, sepse u duket më i lehtë pozicionimi, ndërsa në media, në analizat e «shoqërisë civile» dhe në komunikimin e

lirë e të përditshëm (rrjetet sociale dhe dialogu ndërpersonal) klasifikimi *majtas – djathtas* nuk ka asnjë kuptim dhe përdoret si fluskë e jo si sinjifikat me histori, përmbajtje dhe shenjim të një shtrese a grupi me vlera të caktuara. Të njëjtin fat e kanë edhe kodet si *besa, armiku, atdheu, mëmëdheu, babai i kombit*, e gjëra të ngjashme të cilat rrallohen jo vetëm në materiale të printuara dhe rrjetet sociale, por edhe gjatë festave ekstazike kombëtare. *Besën* e ka zëvendësuar kontrata e bazuar në ligj, *atdheu* për shkak të globalizmit zëvendësohet me vendlindjen, identitetin dhe kulturën lokale ndërsa *baballarët e kombit* qëmoti bëjnë aheng muzeve.

### III.

*Identitete vasale* - Ky evolucion semiotik sinjifikatësh bëhet edhe më i rëndësishëm shikuar nga perspektiva e së drejtës për individualitet, autonomisë dhe integritetit të subjektit të veçantë në shoqëri. Deri para 5-6 vitesh, kryesisht në vendet rurale, por edhe në ato urbane kosovare, dëgjohen si normale dhe pa intervenimin korigjues identifikime kolektive e personale si «e Skënderit», «Qy qy granija e Kryezive», «Mahmuti i Isuf qorrit» dhe gjëra të këtij lloji. Kjo mënyrë e identifikimit e injoronte individin si njësi autonome, me personalitet të vetin, e trajtonte atë si «meritë» gjenobiologjike të fisit apo patriarkut.

Parakomunizmi në vëllazëri me patriarkalizmin dhe matriarkatin me predikimin e saj të «bashkimit bën fuqinë» vazhdonte ta vrasë të drejtën e individit në favor të kolektivitetit të kamufluar për nevoja kontrolli. Sistemet e shkuara dhe mendësia arkaike e tashme e shfrytëzonin dhe përdornin vasalitetin e «natyrshëm» biologjik dhe patriarkal edhe për të mundur ta asgjësojnë personalitetin edhe të atij qytetari të mençur që nuk kapej e dërrmohej dot duke ia «riaktualizuar» bëmat e gjenit, fisit, gjyshes e gjyshit (biri i

ballistit, nipi i kolaboracionistit, mbesa e titistit). Sot, gjatë komunikimit ndërpersonal, në media tashmë po se po, përditë e sa më tepër kjo semiotikë vlerësimi perceptohet drejtë: si diskriminuese!

#### IV.

*Bankroti i elitave në ikje* - Si çdo zhvillim edhe ky ka humbës dhe triumfues. Gjenerata që është mësuar të jetojë me privilegjin e primatit vajton çarmatimin nga «kompetencat» për ushtrimin e pushtetit mbi fis e nahije. Jo fjala e tij (besa e burrit) është më alfa dhe omega mbi fatin e tjerëve, por e drejta e secilit në mendim, vendim dhe veprim brenda shoqërisë. Këtë gjendje e konsiderojnë të padurueshme konservatorët dhe primatët e të gjitha sferave.

Të ashtuqajturit kozmopolitë kanë të drejtë se sistemi politik në të cilin jetojnë shqiptarët ka bazat në vlerat qendrore evropiane edhe pse nuk dinë ta shpjegojnë atë: qëndron se vlerat që përbëjnë kulturën e sotme «perëndimore» bazën e kanë në filozofitë e imperativit kategorik të Kant-it, në lirinë individuale të John Stuart Mill-it etj. e mbi të cilat janë ndërtuar godinat e së drejtës dhe lirive njerëzore të «kontinentit plak», mirëpo «kozmosopolitët» shqiptarë – siç thamë në fillim – e kanë një problem kardinal që i zhvesh ata si të pabesueshëm dhe retardesk po si konservativët sepse kodin *bankrot kulturor* dhe të vlerave (!) e rezonojnë me argumentin e mosekzistencës së industrisë dhe klaneve kulturore ku ata do të kishin si dje timonin në dorë dhe do të determinonin vetë se çka duhet parë si vlerë e çka jo.

Në fakt as që ka bankrot kulturor përmasash siç supozohet, vetëm se ka filluar të zbehet ai hiperbolizimi i gjithçkasë, ai stil i bekimit apo anatemimit që e ushtruan aq gjatë primatët e kulturës gjatë kohës që iku.

Interesant. Në këtë kontekst, bazuar në këtë zhvillim që argumentuam lartë, shoqëria, të rëndomtë duket të kenë lenë mijëra kilometra pas elitat e tyre: Të «rëndomtë» ecin «elitat» mbesin! (2013)

## 14.

### *Civiliteti si pushteti*

Illuminizmi europian, sekularizmi dhe shumëçka tjetër me të cilën njerëzimi krenohet të ketë ecur vertikalisht, nuk janë vepra monarkësh, tiranësh e pushtetesh, por elitash rebele në aksion kundër tyre. Çdo (r)evolucion, bërthamën e ka pasur në masë, në aortën e saj, e cila ka qenë parakushti dhe promotori i çdo shpërthimi që u ka mundësuar subjekteve të rebeluara të realizojnë projektet e tyre. Grekët i thoshin „*politiké koinonia*“ (shoqëri publike), latinët e quanin *societas civilis*.

Adam Ferguson, teorinë e tij mbi „civil society“ e materializon po mbi këtë bazë. Domosdo në këtë vijë hedh hapat dhe endet divizioni i filozofëve dhe sociologëve të demokracisë deliberative (Bessette, Benhabib, Bohman, Cohen, Elster, Fishkin, Gutmann, Habermas dhe Thompson: 1980 – 2013) të cilët kanë shkruar biblioteka të tëra me libra për të bindur se pas-modernja do të jetë epokë jo e partive, por e shoqërisë civile. Ideali në fakt nis nga formulimi i skllavit, autorit të mimave dhe sentencave Publilius Syrus kur tha: *“Deliberandum est diu quod statuendum est semel”* (Kohë e gjatë duhet menduar për të vendosur mbi të përhershmen). Parim që hyri në të drejtën romake si ligj e që njihet si *Deliberandi ius* – e drejta e pjesëmarrëse e qytetarëve në reflektim, diskutim dhe vendimmarje rreth çështjeve me rëndësi të përgjithshme e kapitale.

Çdo pushtet – e sidomos autokratët, liderët e partive, minitiranët, pseduodemokratët, kuazipatriotët, megadespotët

– bëjnë çmos për të vënë nën kontroll pikërisht atë, *societas civilis*-in, qoftë për ta korruptuar apo si instrument për sigurimin dhe mbajtjen e pushtetit pa revolta të organizuara masash, pa kokëçarje.

Si sillen pushtetet shqiptare në këtë kontekst?

*Shoqëria civile* - Mediat, Kishat, Bashkësitë islame, Sindikatat, shoqatat që merren me të drejtat dhe liritë e njeriut, unionet e punëdhënësve, sportit, ekonomisë, lobistët e firmave, organizatat e majta, të djathta, ato të kulturës, hobeve të kohës së lirë e gjëra të ngjashme, përbëjnë shoqëritë civile shqiptare. Rigrupueshëm këto faktorë ndahen në më pak kategori; në konfesionale, qytetare (kryesisht si “Single issue groups”), ekonomike, politike dhe kulturore. Nëse analizojmë rrezën e ndikimit të tyre, do të konstatojmë se mediat, konfesionet dhe oligarkët kanë flamurin. Të parët nëpërmjet lexuesve, të dytët nëpërmjet fesë, të tretët nëpërmjet kapitalit me të cilin mbajnë për fyti të gjithë e kë t’ua dojë qejfi.

Viteve të fundit, për shkak të asistencës materiale e fizike të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, u faktorizuan edhe shoqatat e lëvizjet për të drejtat e grave, burrave, fëmijëve, shtresave e subkulturave të ndryshme. Asociacione që hiperbolizojnë ndikimin e tyre (shumica janë vetëm zyra që menaxhojnë mirë marrëdhëniet me mediat) për shkak të valencës në treg, mirëpo që megjithatë janë shumë të vyeshme, sidomos në rrafshin simbolik të manipulimit publik, sepse sugjerojnë faktorin e barazpeshëm juridik me shtetin dhe mediat edhe pse përballë tyre në realitet duken si miza përballë elefantit – kur kemi parasysh megastrukturat operative të shtetit dhe fuqinë e mediave në sajimin e opinionëve.



*Pseudoliberalët* - Veçanërisht gjatë “aferave” publike si ajo me Erdoganin, e soldnerëve në Siri, e problemeve mbi statusin e BIK-ut dhe predikuesve e profesorëve ekskesivë, pamë se pushteti mban nën kontroll absolut konfesionin më të madh të vendit. Kush ka ndjekur aleancat e oligarkëve të caktuar – jo patjetër që merren me politikë – ka vërejtur luhatshmërinë e ashpër të (ri)orinetimit herë pro e herë contra pushtetit të “ekonomisë private”. Sa herë që hulumtohet një relacion i këtillë dhe aq konfuz duhet të fiksohemi se cilët tenderë, çfarë kontratash dhe cilat projekte i synojnë oligarkët dhe kuptojmë dinamikën; kurdoherë që pushteti bindet se i duhen oligarkë të caktuar, ai shtrin ca kontrata të majme mbi tavolinë dhe aq. Politikisht, dimensionin kulturor i shoqërisë civile është i pranguar nga ministritë që dirigjojnë atë ose ai korruptohet me ca çmime për libra e ekspozita që nuk kanë asnjë ndikim e vlerë serioze.

Aderimet e fundit të ca “eminentëve” të civilizimit shpalsën strategjinë e pushtetit (edhe partive) për t’ia prishur edhe kotecin e fundit shoqërisë civile (më shumë simbolikisht sepse siç thamë ato janë veprime vetësocializuese të minigrupeve të ndryshme). E fundit ndodh sepse tashmë edhe të paktët ndërkombëtarë të mbetur këtupari tërhiqen ngadalë dhe arkat e financave tashmë kanë filluar të japin grahmën e fundit. Megjithatë kryeakti i dramës qëndron diku tjetër: edhe pse „pro forma“ *Deliberandi ius*-i është i shkruar kanuneve ligjore shqiptare ai nuk hyn fare në përdorim. Ngase duket që vetëm disa e fare pak personalitete janë intelektualisht në gjendje që të plotësojnë kushtin e Publilius Syrus-it, i cili kërkoi mendim të thellë, debat publik e të gjatë për çështje ekzistenciale të shoqërisë.

(S)ka idealistë. E intelektualë edhe më pak.

Çfarë mbeti? Të pakorruptuar ende kanë mbetur grupimet gati të kota ideologjike që vetëm rrjeteve sociale lëshojnë ndonjë virus mendor dhe ndonjë media. Më shumë jo.

*Subjekti si autoprojekt* - Ndërsa Kryeprimati bën punën e vet. Ai ka kuptuar diçka themelore dhe në trend; jo partitë dhe ideologjitë janë e ardhmja dhe burimi i pushteteve, por integrimi (kupto: kapja për kushtet shqiptare) i strukturave të shoqërisë civile dhe përqendrimi i tyre në një rrjet instrumental pro politikës së tij. Nëpërmjet zënies së kuaziprimatëve të shtresave, grupeve të interesit, komuniteteve, integron defaktorzueshëm shoqërinë civile në politikën e tij dhe e shfrytëzon atë për të siguruar votat e nevojshme për qeverisje. Eliminon korrigjuesit e mundshëm. Matematikë “legale” sunduesish e deficit dramatik shoqërisht që nuk dinë t’ia gjejnë portën lirisë. Ose angazhimin në shoqëri e besojnë ashtu siç e ekspozon piktori Hippolyte (Paul) Delaroche në punimin e tij “*Ngadhënjyesit e Bastille-s para hotelit De Ville*” (1839), ku çdonjërin revoltues e paraqet si subjekt me vullnet e fanatizëm për të hyrë në pushtet. (2014)

*Etnoradioskopi*

Kryq e tërthor hartës shqiptare. Nga Helvecia në Gostivar, nëpër Prishtinë e Tiranë për t'u kthyer prapë aty ku s'kishim qenë kurrë më parë: në Muçibabë. Oksidenti po degjenerohet. Kina ka nisur udhën të bëhet superfuqi. Orienti kërcënohet me mjekra, çyçekë dhe shami. Europa mohon të ketë pohuar se djepi i kulturës së saj ka qenë në Greqi. Altinit ende nuk i hiqej syve ëndrra e natës: do kanibalë ferexhebardhë ia kishin rrëzuar shqipen nga qielli dhe ia shqyenin me thonj, dhëmbë e thika si të përdalë.

Sfida të shumta kanë sërish shqiptarët gjithandej: islamistët ua sabotojnë idenë e tolerancës ndërfaqetare; amerikanët dhe europianët u urdhërojnë të «trusin» se ua lëshojnë serbët prapë në qafë – siç foli me gojën e tyre poeti Avni Rudaku; Erdogani ua fut kokës me shpuzore sa herë që ta marrë malli për djemtë e Anadollit.

Vetëm Hashimit nuk i bëhet vonë.

Ai, para stacionit të autobusëve shet libra të vjetër dhe thotë *«paj këta që ikin nuk po blejnë libra të rinj»*. Shqiptarët e Maqedonisë bëjnë gjueti pas minifundave- iu duken më të gjatë se duhet e në Shqipëri nuk pushojnë kurrë së kënduari refrenin «Dita, nata, erdhi Hita, iku Hata» dhe anasjelltas.

Dy shtete, plot vende, disa fe e dialekte e gjithandej i njëjti njeri – shqiptar!

*Tiranë* - Edi Rama fitoi. Sali Berisha ende nuk ka shkuar. Meta i di punët e veta. Asgjë nuk ka ndryshuar. Kryeqyteti është ndarë në dysh: në tropojanë malokë që kanë frikë për rob e shtëpi dhe në neoenveristë të «qelbur që nuk kanë ngé

për shqiptari». Mediave u paska ikur momenti kur u shpallën zgjedhjet. Shumica ende tifozojnë për këtë apo atë lider, për njëren apo tjetrën parti. Policët e pushtetit aktual qysh tani paskan nisur t'i organizojnë jetimët të lypin para hoteleve ku frekuentojnë të huaj e vendorë që do të punojnë nëpër ministri. Disidentët (kështu e quajnë veten) dhe Nihilistët së toku bëjnë gati një strategji të re. «Iku Sala po ç't'i themi këtij shkërdhatës tani», pyet njëri e sakaq tjetri: Bregoviq pra! «E të paçim mëndjen or gjeni», festojnë në kor intelektualët sigurimin e ekzistencës me moton «edhe pas Salos, Salua».

*Gostivar*- Shumica ndihen të tradhëtuar. Nga politika dhe patriotët u ka ardhur në majë të hundës: për inat të nacionalistëve kanë vendosur mos llafosen më në shqip. Janë lodhur se gjithë jeta në komunizëm u shkoi duke ruajtur e pastruar gjuhën nga «shkijet», e ç'fituan? Liderë që janë njëkohësisht edhe pacientë Perëndimi dhe kryetarë që duan t'ua bëjnë punën e Zotit, duke ua ndaluar ujin e bukën? Kështu thonë dhe me dorë në zemër e syfiksuar pas pjesës së mbrapme të do grave në kalim e sipër japin selam: «turk elhamdurilah, mashallah, mashallah!».

Për çdo ditë autobusët plot për në Shkup. Atje qenka rimishëruar Sulltani me shokë. Me vete ka edhe tapi saudite nga Meka dhe Medina; shëron gra, bën synet poshtë kërthizës e lart në tru dhe përbetohet të mos jetë manjak seksual, se edhe kur gabon gjithçka për Allah e Milet e bën dhe për hir të babës Devlet.

*Muçibabë* - Jo shumë larg qenka Muçibaba nga Gostivari. Një haxhi i shtyrë nga Hoxha i katundit i thotë Idrizit: «kallzoma kryqin katalik i dreqit». Heroi shqiptar injoron haxhinë dhe bën gojën gurrë. «Kallzoma se t'i shkuli mustaqet». Statuja nuk flet o haxhi, i bërtet Seferi prej një mjegulle mbi Prishtinë. «A po a?», përdhoshet Haxhia dhe ia

shkul mustaqet, ia merr alltinë, ia fut do grushta barkut dhe e përplas për toke Idriz Seferin. «Kuku ça i bëne Idrizit, Haxhi shkreta» i thotë i pari i kulturës që e sheh. «Ani si e lypi e gjeti kataliki, dreqi». Kur haxhia nga kulturaxhiu dëgjon se Idriz Seferi paska qenë mysliman çartet krejt: «Ah hoxhë shejtanin, ia mora ftyrën fisit...» dhe niset me dorën në brez drejt xhamisë.

Në kryeqytet thanë: Skandal! Po pse skandal e jo vetëm akt vandal. Sepse hoxha e ka nxitur. E kush e nxiti ministrin e Kulturës ta dëbojë demonstrativisht portetin e «Nënë Terezës» nga zyra? Pse hoxha? Sepse edhe ministri – thonë – se ka përdorur të njëjtin kod si haxhia, domethënë i ka thënë fotografisë: «kallazoma atë senin katalikja dreqit dhe pasi ajo e ka injoruar ky e ka dëbuar, krejt thjesht.

*Pseudorefreni* - Oksidenti po rigjenerohet. Jo Kina s’do të bëhet supërfuqi, është vetëm ideologji. Mos kini frikë nga Islami se nuk pushtohet bota duke qenë internati më i madh i të pashkolluarve të globit. Evropa qëmoti ka hequr dorë nga eurocentrizmi, kulturalizmat dhe legjendat. Më së shumti ajo është distancuar nga horror-përrallat ballaknike; ato me thika, super-raca dhe krekosje darvinisto-biologjike.

Altini veç ëndërr ka parë se askush nuk ia shkalafit dot shqipen. Avni Rudi ka të drejtë se vërtet aleatët e Kosovës kanë rënë në hall me ta: jo sepse nuk duan që shqiptarët, respektivisht kosovarët të pavarësohen maksimalisht, porse kanë frikë se s’do të mbijetonin as për një ditë – jo për shkak të armiqve të tyre, por për shkak të vetvetes. Jo të gjithë shqiptarët e Maqedonisë ecin për te Sulltani, së paku jo të arsimuarit dhe ata që njëherë kanë shkëlur botën jashtë periferisë ku sundon hoxha. Edi, si duket, e ka seriozisht; do ta bëjë Shqipërinë, e shqiptarët s’kanë ku ikin jashtë hartës së tyre. (2013)

## *Spinalongat e një etnosfere*

Harta sociale dhe psikologjike shqiptare është plot me ishuj, ku mezi mbijetojnë të mallkuarit: të papunët, femrat e diskriminuara, fukarenjtë dhe të izoluarit. Ata vegjetojnë nëpër getot e tyre. Kush janë fabrikuesit dhe kush viktimat që bëjnë jetë bërakoreve tona?

Ai mezi pret ta sigurojë një vizë dhe të ikë sa më larg. Ajo as në ëndërr nuk i shporr dot shushuritjet perverse të fqinjëve. Asaj ia këputën shkollimin në mes dhe e detyruan ta fusë në shtrat një gërmadhe skeletesh të huaj. Ata bëjnë jetë nëpër geto, të cilat jo vetëm shoqëria, por edhe zoti duket t'i ketë harruar: të hendikepuarit, matufët, pleqtë, të vejat e dëshmorëve, të papunët, femrat si viktimat të semifeudalizmit, fukarenjtë, intelektualët që s'ia varin fare ideologjive a feve dhe shumë tjerë të «kastave» të përtokëzuara shqiptare.

Këto shtresa që ekspozuam këtu përbëjnë atë «underclass»-in shqiptar, të cilin sociologu gjerman Martin Kronauer (Exklusion; 2002) e shpjegon kështu: «promotor përçarjesh masive shoqërore, ku eskalimi vonon, mirëpo sapo shpërthen ai menjëherë shkatërron çdo strukturë», një lloj vullkani, llava e të cilit dikur do shkrumbojë edhe atë që s'duhet.

Kategoritë e mësipërme përbëjnë copën më të madhe të fizionomisë aktuale, sociale të shoqërive shqiptare.

Ekzistenca e këtyre shtresave natyrisht është e evidente gati në çdo shoqëri përreth nesh apo edhe në ato me një kapitalizëm të zhvilluar, mirëpo asnjëherë me këtë brutalitet siç e hasim Sarandës, Shkupit, Prishtinës, Tiranës e

gjithandej. Ndërkohë që në shoqëritë perëndimore shteti “ndërron për çdo ditë” paradigmat për të gjetur modelin më të përshtatshëm se si t’i reduktojë padrejtësitë sociale, nënqiellit ballkani qeverit u ngjajnë uzinave që prodhojnë vetëm të kundërtën; getot e të përjashtuarve!

Politikat shqiptare të imponojnë përshtypjen sikur studimin fenomenal «Stigma» të Erwing Goffman-it (Londër; 1963) ta kishin lexuar për së prapthi, me synimin për të prodhuar sa më shumë devijime (kap.V) me sa më shumë viktima.

Spekulimi se qeveritë nëpërmjet devijimeve (si strategji) duan t’i paralizojnë masat popullore për t’i mbajtur ato nën kontroll duket se nuk është vetëm shpikje opozitarësh të xhindosur.

*Tiranë, qershor* - Ndër vizatimin megadimensional, ku burra e gra shqiptare, me pushkë, harqe e shpata ia kërcënojnë mëngjesin kryeqytetit, në shkallët para Muzeut Kombëtar të Tiranës, rri ulur Iliri\*. Ka derdhur trupin mbi një libër. Nga larg krijon imazhin e një thesi të hedhur nga ndonjë qytetar i papërgjegjshëm. Ashtu e ndjen veten edhe ai. Të hedhur, të lënë anash nga shoqëria dhe nga vendi, për të cilin ai para shumë vitesh, sapo mbaroi studimet, braktisi Zvicrën. Sytë i duken të shuar, sikur t’i ketë vdekur çdo shpresë përbrenda. «Po kush i pret këta socialistët të vijnë në pushtet?», thotë ai. Habitemi. Para 15 viteve, në aeroportin e Zürich-ut u ndamë nga ky njeri me betimin në trastë se kurrë nuk do t’i bashkohet ndonjë partie a politike; «qoftë ajo edhe më e shenjtja», na thoshte atëherë. Qesh kur e pyesim në mos i ka ndryshuar bindjet. «Jo» mohon në mënyrë kategorike. Pse socialistët atëherë?

Iliri është biri i një ish-funksionari të sistemit të vjetër, atij të diktatorit Enver Hoxha. Që nga viti 2005, kur partia e

«pasardhësve» – siç quhen socialistët e sotëm nga kundërshtarët e tyre – del në opozitë, Iliri humb vendin e punës dhe që atëherë punon gjithçka për të mbajtur familjen “disi gjallë”. «Të majtët padrejtësisht mendojnë se jam i majtë, të djathtët më urrejnë se kam qenë bir i babait tim e unë gjendem në sanduiç. Po nuk u pozicioneve edhe shumë më pisk e ke», ankohet ai. Paragjykimet meskine ndaj tij kanë arritur një efekt aq maksimal sa që ai mallkon çdo ditë të kaluar në vendin e tij. «Ndihem si në Spinalongën e 1913 këtu» thotë ai me cinizëm. (Aludon lidhur atë ishullin e mallkuar grek, sot Kalydon, ku grekët deri në vitin 1957 dëbonin aty lebrozët, të cilët jetonin kryesisht nëpër shpella. Atë koloni njerëzish që i përjashtoi shteti pa asnjë përkujdesje, duke i lënë në mëshirën e sëmundjes gjymtyrëngrënëse.)

Ai as nga «pasardhësit» e prindërve të tij – po qe se ata vijnë në pushtet – nuk shpreson ndihmë. «Atyre viteve të para u duhet kohë të sistemojnë militantët e tyre e pastaj shohin në mbetet diçka edhe për ne të mallkuarit» prognozoi ai.

Sa Ilirë i ka Shqipëria?

*Paragjykimet* - Iliri nuk është as socialist, as i djathtë, por një profesionist, demokrat, humanist i shkolluar Europës perëndimore. Haraçi që ai paguan nuk ka të bëjë fare me habitusin e tij, por me biografinë e prindërve të tij.

E kjo është diçka tepër diskriminuese dhe që shkel në kockë çdo të drejtë e liri njerëzore – kështu pra do të bërtiste psikologu social, amerikan Gordon W. Allport (*The Nature of Prejudice – Natyra e paragjykimit*; 1954 / 1979).

Në hartën e psikologjisë dhe në efektin e veprimit shqiptar paragjykimi është zot shtëpie. Perceptimi skajshmërisht i historizuar (historia këtu jo si shkencë, por si arkiv paragjykimesh) i ballkanasit nuk e lejon deklaratën



«nuk e di, nuk e njoh personalisht, të shohim pra biografinë» e individit në fjalë. Jo, ai automatikisht riprodhon atë që ka dëgjuar për fisin, prindërit a «gjakun» e personit në fjalë. Këtë formë paralinçimi e përdor aparati burokratik i shtetit, e djathta, e majta, masa, unë, ti, ajo, ata, të gjithë. Me këtë sjellje kundër-arsyetuese shoqëritë prodhojnë grupe të diskriminuarish, të cilët detyrueshëm ose e pranojnë statusin e të mallkuarve dhe vegjetojnë, ose e mobilizojnë veten (Steele, Claude; 1997) në rebelim.

*Tetovë, gusht* - Në kokë, në qafë dhe këmbëve e kanë ngarkuar Feriden\* me flori. Kur e përgëzojmë na thotë pëshpëritshëm se ndien veten si ata gomerët që mezi i mbajnë këmbët nga pesha e drunjve. Ajo qesh me zor. Lotët ia çajnë makijazhin dhe krijojnë kanale. Largojmë sytë nga drama për në dasmë. Dhëndri ka marrë pozën e gjelit, drejton kollaren me motive të Disneylandit dhe mezi pret natën. Në turmë kërkojmë të atin e Ferides. Mustaqepërdredhuri «vesves», siç na e përshkroi shoqëruesi jonë, gati ua këput dorën uruesve. Kur shoqëruesi i thotë se njëri prej nesh është gazetar ai papritmas e ashpëron shikimin. «Mos ia najсни ene ju si ki majku jem», na tërheq vërejtjen dhe «nauk lë unë të mbëhet cauca si ajo atje», bëri me gisht në drejtim të një zonje të bukur dhe të vetmuar në fund të oborrit. Ajo është një juriste që punon në një kancelari të qytetit, e pamartuar. «Shumë keq më vjen për Feriden» nis rrëfimin ajo dhe «gjithçka çfarë ajo donte ishte të përfundojë studimet. Edhe një vit ka». Edhe e bukura fillon të qajë. Kjo femër e ka fituar luftën me familjen e saj dhe ka fituar lirinë, mirëpo: «shumica e femrave tona përfundojnë kështu. Detyrohen të martohen me ndonjë person që as nuk e kanë parë kurrë më parë. Uh! sa më larg këtij vendi». Juristja e di se çfarë flitet për të poshtë e lart. Ajo ka zgjedhur me vetëdije lirinë individuale dhe me

këtë gjest i ka pranuar edhe shushuritjet neveritëse që jo rrallë e nxisin të ikë sa më larg vendit të lindjes.

Feriden e ka detyruar babai i saj autoritar të pranojë martesën dhe të ndërpresë studimet. Feridja nuk ka mbledhur dot atë guxim si shoqja e saj që dramën në fjalë (natyrisht e mllëfosur) e sheh si rezultat të një «autoritarizmi semifeudal e religjioz që prish jetën e femrave të kësaj ane». Dhe Ramizi, babai i Ferides, përndryshe mësues katundi, personifikon përkryeshëm formulën e juristes.

Sa Feride ka në Maqedoninë perëndimore?

*Patriarkalizmi semifeudal* - Autoritarizmi «privat», ai që vepron në emër të mbrojtjes së grupit, familjes në të shumtën e rasteve, është injorues ndaj rregullave të njerëzimit dhe rezultojnë domsdoshmërisht si çnjerëzor, konstaton në studimet dhe eksperimentet e tij psikologu i njohur Stanley Milgram (New York 1974).

I njëjti autoritarizëm, shikuar në përgjithësi – të cilin Adorno në F - shkallën e tij madje e quante edhe fashist, për shkak të elementëve etnonacionalë, religjiozë e kulturorë që përmban në vetvete – praktikohet edhe nga organizata që udhëhiqen nga autoritete; nga liderë partish, kryetarë shtetesh, monarkë. Gishtin e tyre, shumica e sociologëve të sotëm (si Altemeyer; 1981 / Schneider;1997/ Petersen; 2008 etj.) e vënë mbi rajonet, kulturat dhe shtetet nën ndikim të madh të feve, mbi shoqëritë në diktaturë dhe ato që “sapo” u kanë shpëtuar sistemeve totalitare. Për këto të fundit, filozofët dhe sociologët thonë se nga llumi kanë dalë vetëm ato vende që me seriozitet e kanë mposhtur mendësinë e vjetër, duke e zëvendësuar atë me të drejtat dhe liritë njerëzore individuale. Si Shembull merren Çekia, Polonia, Sllovenia dhe ca vende baltike. Rusët, serbët, grekët, shqiptarët ende nuk kanë mundur t'i ikin pushtetit të autoritarizmit – kështu thonë ekspertët – sepse nuk kanë

probleme vetëm me faktin se si t'i shporrin elementet e diktaturës nga mentaliteti i tyre, por ata bëjnë luftë edhe me «mbeturinat arkaike semifeudale» që në kushtet e pluralizmit politik i kanë rikthyer edhe më fort në aktualitet si formë veprimi social. Sa qëndron kjo tezë, kur kemi parasysh Ilirin dhe Feriden?

*Malishevë, shtator* - E shoqëronim një zvicerane, e cila në kuadër të një projekti zviceran, për vite me radhë kishte punuar fshatrave të Malishevës kosovare. Në fshatin shtëpi-shkapërderdhur gjejmë «kullën» e Jakupit\*. Ndërtesa formëvile ishte e ndërtuar për merak; tre kate, arkitektura e brendshme dhe orenditë të shtynin të ndihesh si në shtëpinë e ndonjë aristokrati anglez. Zvicëria dëshiron të dijë për ish-pacientët e saj; gjyshin dhe njërin nga vëllezërit e tij të hendikepuar nga dismelia (zhvillim i çrregullt i organeve dhe gjymtyrëve).

«Cili, tre i kam tash»? – thotë Jakupi duke lënë për të nënkuptuar njërin nga vëllezërit e tij që kishte qenë pjesëtar i luftës kosovaro-serbe. Në dhomë hyn babai i tij mbi 80-vjeçar që mezi ecte duke tërhequr zvarrë të birin e hendikepuar. Sa herë plaku – që ende merrte frymë rëndë – donte të thoshte diçka, aktivisti i njëjës nga partitë më të mëdha politike, me diplomën e një shkolle të lartë pedagogjike në mur, ia priste fjalën: «pi duhan e trus ç'aty». Jakupi ankohej që shteti nuk ndihmon asgjë edhe pse partia e tij ka timonin në dorë. Me një rrogë të ulët mban gjithë familjen 12 anëtarëshe (deklaratë që nuk shkonte me komoditetin që kishte). Kur e pyetëm për vëllain që kishte luftuar, ai serbisht; «za ideale gine budale» (për idealë vdesin budallenjtë) dhe bëri me gisht nga një grua, në prehërin e së cilës ishin ulur tre fëmijë të moshës së re. Jo vëllain e vdekur, por ato që ai i kishte lënë pas i quante Jakupi ashtu. Plaku nuk e çonte shikimin nga dyshemeja. Herë pas here tundte

kokën. Zvicrania, me kokë të futur në një shtëpizë gjysmë të rrënuar dhe formëkasolle pyeti: «Ku i ke lopët»? Jakupi i pakënaqur me ndërhyrjen që ia ndërpreu ligjërimin, që ato çaste ishte duke ligjëruar se si Kosova shumë shpejt do të bëhet si Zvicra shpërtheu: «Nuk kam lopë më. Aty flejnë këta sakatët e mi». E kishte fjalën për të atin e tij plak që ulërinte nga kurrizi duke hequr zvarrë të birin që tashmë ishte jargosur fund e krye.

Sa Jakupë i ka Kosova?

*Ekskluzionistët* - Qeveritë e ngatërruara në merimangën e korrupsionit, filcokracisë dhe injorancës së thellë politike e sociale nuk kanë as ide, as programe e as vullnet për t'iu dalë në krah viktimave të shumta. Kjo punë tashmë është bërë e qarte. Ajo çfarë diskutet tona ama si duket mbajnë qëllimshëm të tabuizuar është ajo gjysma tjetër e përgjegjesisë kolektive. Qeveria nuk është aty kur ne stigmatizojmë Ilirin sepse ka pasur prindërit funksionarë enveristë, duke ia suprimuar atij kështu apriori çdo të drejtë qytetare. Shteti nuk e shpëton dot Feriden duke ia rrëmbyer atë nga shtrati atij bylbylit me kollare të Disneylandit. Edhe po të ndërhyjë policia dhe ushtria Hashimi nuk do t'i hiqte «sakatët» e tij nga ajo kasolle pa nxehje dhe e zhveshur nga çdo mundësi banimi njerëzor. Hashimi përtopte qeverinë (e tij) vetëm sa për ta lehtësuar ndërgjegjen e tij, se diku thellë, në ndonjë cep minor të trurit dhe të shpirtit të tij ndoshta gjendet një qelizë humane që e trazon dhe nuk e le të qetë.

*Empatia e kontradiktorit* - Dukuritë e trajtuara më lart janë përfaqësuese dhe flasin vetëm për disa nga getot e shumta sociale e njerëzore që përbëjnë gjeografinë e mentalitetit të «racës më të lashtë» ballkanike. Arsyetimi i tipit «kemi qenë gjithmonë të shtypur» del i shkriptë. Thjeshtë sepse është kontradiktor me vetëbesimin gati onanik «kemi mbijetuar

sepse jemi raca më e qytetëruar e Ballkanit dhe kemi ruajtur identitetin tonë». Këto të dyja nuk shkojnë bashkë dhe demaskojnë ndoshta mentalitetin tonë historik si të deformuar në çdo kontekst të njerëzores dhe qytetares. Domethënë se në mentalitetin tonë virulojnë forma arkaike dhe destruktive të cilat kemi nevojë t'i lokalizojmë, identifikojmë për të dezinfektuar qenien tonë e për të siguruar mirëqenien e tjetrit.

Këto dukuri na mësojnë se ndërmejt pseudoaltruistit dhe egocentrikut, kulturës sociale shqiptare, i mungon empatiku i Jeremy Rifkin-it (The Empathic Civilisation; 2009). Ai njeriu i Michel Foucault që është në gjendje madje të bashkëndiejë edhe me të burgosurin, kriminelin e jo më me të afërmin e tij të hendikepuar; atij tipit të Niklas Luhmann-it që është në gjendje të futet në thelbin e idealeve dhe ëndrrave të vajzës së tij edhe atëherë kur duhet të flakë privilegjet si patriark i kopesë; atij nacionalisti që di të respektojë mendimin e komunistit; atij intelektualit që di të zbusë edhe shpirtin e fashistit; atij ateisti që di të drekojë edhe me fundamentalistin dhe kështu deri tek dialogu mes dy qenieve me kombësi të armiqësuar.

Ose e nxjerrim nga sirtari atë „golden rule-n“ e Etikës Praktike: «*trajtoji të tjerët ashtu siç do që të të trajtojnë ty*». Natyrisht se nuk kërkojmë që të fusim shqiptarin në një inkubator prej ku do të dalin pas ca ditëve zogjtë e lirisë dhe demokracisë, mirëpo të prirë nga ky motiv sigurisht se Ilirët, Feridet dhe Jakupët do t'i kishim vetëm si eksese sociale e jo si fytyrë kolektive që demonstroi dështimin human të një etnosfere.

*\*Emrat – të tjetërsuar nga autori. (2012)*

## *Republikat e sociopatëve*

Polici, qytetari, i riu, plaka, studenti, gazetari sillen sikur të kenë vetëm një synim: ta dëmtojnë sa më shumë shtetin, respektivisht të përbashkëtën. Ndodh kjo sepse shqiptarët nuk kanë kulturë sociale apo problemi është edhe më i thellë.

Udhës së kombit. Sapo hymë në Shqipëri na ndalën dy policë të këputur nga vapa: „Një çikë më ngadalë ore!“, i tha njëri prej tyre grahësit që ende nuk kishte kapur udhën si duhet pas daljes nga parkingu i një restoranti. „Ja“, bëri grahësi duke ia zgatur dorën me pesë euro. Polici shtrëngoi monedhën në grusht dhe na ktheu shpinën. Iku. Pas një oshëtime hapim një të përditshme shqiptare. Editoriali: „Kosova nuk është shtet“. Tema kryesore: „Qeveri hajnash“. Opinioni: „Apel për vrasjen e qenëve endacakë të cilët po tmerruakan sidomos klerikët që ende pa gdhirë duhet të shkojnë t’ua plasin veshët përmes altoparlantëve minareve të kryeqytetit“.

«98% të Letërsisë Shqipe do ta kisha hedhur me shumë ëndje në shportë» – kështu tha një kritik i ri, që dyshohet të ketë lexuar gjithë bibliotekën shqiptare.

Jo vetëm bijtë e funksionarëve e politikanëve sulmojnë pa drojën më të vogël policët dhe burokratët e shtetit, por shumica duket të ketë neveri ndaj uniformave që përfaqësojnë shtetin. Raportet që na tërbojnë sytë rreth korrupsionit në ndërmarrjet private, shtetërore, në institucionet e arsimit dhe sferave të tjera të përditshmërive shqiptare, tashmë janë bërë megabibliotekë më vete.

«Mos bre burrë mos i hidh plehërat aty», i tha një shoqëruer i yni një qytetari prizrenas që doli nga vetura me

një thes të madh dhe do lojëra të prishura fëmijësh dhe i vërviti ato nën një urë. E ai: «ç'a ke bre...mos ta ka ble baba urën?». «Jo» dhe vari kokën shoqëruesi jonë.

*Analiza e parë* - Çfarë mund të filtrojmë nga rrëfenja e mësipërme: Policë të korruptuar përballë qytetarit të korruptueshëm; Media që pa fije djersitjeje apo hulumtimi konkret përpilojnë editoriale pro-poetike e forma aktakuzash dhe lexues që konsumon gjithçka për të ushqyer paragjykimet dhe për të rimbushur me energji motorët e depresionit; apel të hapur për vrasjen e kafshëve të lira; mohim ekstravagant të letërsisë shqiptare pa thënë përse-në e pa treguar fare letërnjoftimin mandatues se kush, kur dhe pse e me çfarë na e dëshmon urtësinë që do të na shtynte t'i besojmë atij symbyllurazi; kemi përdhunim të ambientit me mendësinë e lirisë për të kontaminuar çdo copë toke që rastësisht nuk është «vakëf» apo e ndonjë personi konkret që do t'i dilte zot dhe qytetarë të aftë vetëm deri aty sa për të pyetur dhe për të heshtur.

I zgjodhëm ndërkaq vetëm ato sekuneca të përditshmërisë shqiptare që janë më masive, më të shpeshta apo më «normale». Padyshim se çdo njeri mund të bërtasë i zoritur: nga dolëm të gjithë sociopatë vallë? Ndërsa racionalisht do të bëjë diçka tjetër: ai do t'i vihet pas kauzalitetit për të kërkuar arsyet dhe mundësitë se si mund të dilet nga sociopatia kolektive.

*Teoritë* - Kur rrëfimin e mësipërm ia përsërisim kulturopsikologut Prof. Dr. Hede Helfrich nga Universitetet Chemnitz (Gjermani) dhe Dalian (Kinë) ai as që i rruhd vetullat nga habia. «Është krejt e zakonshme neveria ndaj gjithçkaje që ka të bëjë me shtetin», na thotë ai.

Pse?

Sepas kjo – sipas tij – ndodh tek të gjithë shoqëritë, etnia shumicë e të cilave ka pasur për një kohë të gjatë statusin e të robëruarit. Sa më pak liri aq më shumë depresion dhe aq më tepër përmbysje, revoltë dhe dëmtim të „fajtorit“. Në etnopsikologji, ashtu siç lulëzon disiplina e post-traumës individuale e rezultuar nga ndjekja politike e ekzistenciale ngulitet me sukses edhe ajo e diagnozës së post-traumave kolektive. Modelin më të përshtatshëm „shërues“, shkencëtarët e kësaj fushe e shohin tek angazhimi i shtetit nëpërmjet projekteve konkrete në arsim, institucione sociale, sidomos ato të shëndetësisë (për shoqëritë e traumatizuara) dhe ligjeve me qëllim të krijimit të kushteve dhe rregullave të koekzistencës së qytetarit me qytetarin dhe me speciat e gjësendet e tjera.

*Kultura sociale dhe shteti* - Manifestimet asociale që liston kjo „doktrinë“ vërtet përkrijnë me shumë aspekte të asocialitetit qytetar që janë kudoprezente në përditshmëritë shqiptare, mirëpo me diagnozën e kësaj teorie nuk shpjegojmë dot apelin për ekzekutimin e qenve; ç’faj ka ura dhe ambienti në këtë kontekst? Po polici që gjoja është i shtetit?

Mos shqiptarët, përveç të tjerave, kanë mungesë të kulturës elementare dhe nuk dinë si të sillen në socialitet?

Miles Hewstone dhe Robin Martin – që të dy të njohur për shkak të studimeve afatgjata rreth ndikimeve dhe ndërvarësive sociale – janë të mendimit madje se kultura, rendi, dhe rregullat sociale janë ato që e bëjnë shtetin e jo anasjelltas. Sipas këtyre «bazat zgjedhin përfaqësuesit e tyre, prandaj çdo ndryshim duhet të nisë nga poshtë – lart e jo anasjelltas». Përgjegjësia, nëse iu besojmë këtyre të fundit, atëherë i bie mbi supë më shumë shoqërisë civile, individëve «e sidomos familjeve».



«Jo» thotë profesori Helfrich dhe na përkujton sërish tezat e tij rreth shtetit, lirisë dhe organizimit të shoqërive dhe ligjeve nga këto. Sidomos vendet të cilat sapo kanë dalë nga diktaturat ose luftërat, sipas tij dhe dy sociopsikologëve Thomas Kessler dhe Amélie Mummenedey, pra vendet që përjetojnë ende kaosin e riorganizimit shoqëror, duhet të jenë shumë më ngulmuese në ndërtimin e ligjeve dhe rregullave që shoqërisë i japin përmbajtje, strukturë dhe funksionalitet të mbarë? Cila shtete? Këto shqiptaret? Po, thonë ekspertët që vetëm gjeografikisht kanë njëfarë ideje për qeveritë e shteteve në fjalë. Po presim shtetet atëherë? (2013)

## *Iluzionimi si koncept qenieje*

Epikuriani Ovidi thoshte se «në premtime është secili i pasur sa të dojë». Këtë maksimum si duket e kanë shpirtëruar dhe jetësuar politikanët e gjithë botës. Ata premtojnë tokeqieell sa herë që synojnë ndonjë post që varet nga vullneti, respektivisht vota e demosit. Veçanërisht vendeve në tranzicion premtimet janë aq absurde, saqë edhe matematikës ia shpifin ekzistencën. Nëse iu besojmë neoromantikëve atëherë shqiptarët qenkan njerëz të besës, «fjalës së burrit». Kur atyre ua përmend politikanët shqiptarë që qysh nga përfshirja e tyre në të e deri sot, ata sillen sikur të kenë të bëjnë me një shtresë që ua ka shpëlarë trutë ky apo ai armik. Tezë pa këmbë e duar kjo: pse pikërisht mjeshtërinë e së pavërtetës e kanë përvetësuar këta njerëz e të tjerat «vese» të huaja jo? Apo për ta fshehur dështimin e edukatës shtëpiake, të fisit e gjakut akuzohen veç të tjerët. Më shumë do të jetë ajo që mendonin hebrenjtë e vjetër kur tërhiqnin vërejtjen: «nëse i ke premtuar fëmijës diçka, atëherë më mirë plotësoja, përndryshe e mëson atë të gënjejë» (Talmudi). Po ja që pranojmë se vesi i premtimeve pa bazë, gënjeshtrove qenka e huazuar për shkak të sundimit të të tjerëve mbi shqiptarët e gjorë.

Po sot? Çfarë thonë ata, neoromantikët, patriotët e racës së përkryer? Politologët dhe historianët që kanë ndjekur fushatat elektorale që nga rënia e së kuqes me yll të drapëruar e deri sot kanë filluar të besojnë në antitezën rreth besës, e cila për afërsisht duket kështu: «shqiptarët oportunistë për shkaqe

mbijetese e kanë ushtruar rrenën për aq shumë shekuj sa që edhe në monolog nuk mund të bëhen më dot të sinqertë». Nga sociopsikologjia dimë gjithashtu se gënjeshtarët dhe manipulantët nuk e kanë fort mirë në shoqëritë me masa të pashkolluara, por në ato shoqëri të hapura për iluzione, të atilla që rrenën e konsiderojnë si mjet simpatik komunikimi dhe nuk e sanksionojnë ndokënd për një gjë të tillë, siç veprohet nëpër vendet e qytetërimit oksidental.

*Tradita e premtimeve* - As premtimet historike, me shekuj, ato në të cilat kanë besuar gjenerata nëpër epoka, ende nuk i ka realizuar shqiptari. Që pas Skënderbeut e deri sot, shqiptarët kanë luftuar duke premtuar se do ta shpëtojnë kombin nga njëra, e dyta, e treta, e katërta robëri. Secila «elitë» prej kohësh ka premtuar lirinë, pavarësimin dhe ka vdekur, ka rilindur si inventar mitologjik dhe është pluhurosur, është harruar e rizbuluar e kështu pafundësisht në rotacion, pa e përjetuar kurrë dritën e lirisë vetë. Të fundit dikur ua lejojnë të tjerët. Jo se nuk luftuan e dhanë çmos për liri, porse kurrë nuk arritën dot ta imponojnë vullnetin e tyre ashtu sa që të tjerët të ishin mbështetur me shpinë pas muri. E kjo pafuqi u ndodh si zakonisht shoqërive të paafta për ta menaxhuar veten, për tu konsoliduar pa ndihmën e të tjerëve.

Përse vallë?

Mund të ketë edhe shumë faktorë të tjerë padyshim, mirëpo sigurisht se vlen paksa më tepër kapitali edhe mentaliteti i vetëpërceptimit të rrejshëm, i ushtruar dhe farkëtuar në habitusin e shqiptarit dhe i cili historikisht dhe me faktografi duket të jetë haraçi kryesor i fatumit të kësaj etnie.

Shqiptari duket të jetë «gjenetikisht» i koduar që çdo dëshirë të veten ta shndërrojë në religjion, në besim që patjetër të jetësohet, sikur të kishte në pronë globin, të reshjet, urtësinë tokësore e kozmike e gjithçka tjetër. Dëshmia se historia e tij

do të ketë qenë kështu manifestohet edhe tek shqiptari i sotëm, në retorikën, sjelljen sociale të tij. Ai mund të veprojë si lider, politikan vetëm nëpërmjet indoktrinimit të masave duke premtuar të pamundurën.

Për ta konkretizuar dukurinë në fjalë edhe më kapshëm pra:

*Eksperimente* - Çdo parti politike sot e ka të qartë faktin se nuk do të mundet të sundojë përjetësisht. Nisur nga ky fakt ata premtojnë zgjidhje problemesh brenda katër viteve. Përveç kësaj në sistemet ku sundon demokracia pluraliste ato janë të detyruara që të qeverisin me koalicione dhe me bekimin e parlamentit për çdo «veprim» që kërkon kapital të lartë apo vendime të rëndësishme për vendin.

Nëse një parti, për shembull, premtën «bashkimin kombëtar» me ndonjë pjesë tjetër të etnisë atëherë ajo del të jetë fort e sigurt se brenda këtij afati kohor të mundet ta binda diplomacinë ndërkombëtare për ndërrimin e kufijve; ajo hamendësueshëm paskësh siguruar shumicën relevante në masë (referendum) për të ndryshuar kushtetutën dhe për tu bashkuar; ajo zotëron strategjinë se si do të ndodhë i gjithë procesi përkatës konkret praktik; ka marrë pajtimin e shtetit apo pjesëve të tjera (referendum po ashtu) që gëzojnë vullnet të bashkohën... dhe të tjera gjëra të këtij lloji. Nëse gjitha këto gjëra partia nuk i ka bërë ende, atëherë ajo vetëm premtën në ajër duke gënjyer me paramendim.

Ose shembulli i dytë: Partia X premtën 200 mijë vende pune. Domethënë që ajo të ketë tashmë të nënshkruara kontratat kondicionale me investorët përkatës, me hapësira dhe segmente ekonomike për biznes, me komuna etj; ajo duhet të ketë përkrahjen e Bankës Botërore (pasi vendi pjesërisht akoma buxhetohet nga ta); të ketë siguruar shumicën në parlament (që ende nuk ekziston) për biznesplanet e hartuara; të dijë se ekzistojnë kuadrot në rajonet e

ndryshme ku do të zhvilloheshin projektet dhe kështu me radhë. Gjëra këto (disa) krejt të pamundura sepse janë të ndërvarura nga procese të një legjislacioni e burokracie që akoma nuk dihet se si do të jetë e kompozuar.

Shembuj të këtillë mund të numërojmë në disa faqe dhe për secilën partinë veç e veç.

Na merr mendja se edhe qytetarëve nuk ju duhet aq shumë kokëçarje për të konstatuar se premtimet janë kot. Një dyshim i thellë ndaj shumicës së premtimeve të partive edhe manifestohet gjithandej mediave, rrjeteve sociale, rrugëve, kafeneve, dhomave e gjithandej qoftë. Atëherë përse rizgjidhen të njëjtët njerëz për disa mandate. Të njëjtët të cilët po të njëjtat premtime i kanë dhënë shumë herë dhe pa u skuqur fare në fytyrë dalin para masave me të njëjtën këngë?

Sepse edhe në mentalitetin e masave nuk ecën diçka në rregull.

*Iluzionimi si stil jete* - Shqiptarët janë njerëz të tipit që shumë shpejt dhe pa e menduar as disa sekonda përgjigjen, flasin. Për këtë arsye ata thuajse ndaj çdo pyetje kanë një përgjigje – kryesisht gabim. Për këtë arsye bëhet njeriu që as llogaritjen elementare nuk e ka mësuar si duhet në shkollë fillore, ministër i ekonomisë, ai që as dy libra nuk i ka lexuar ministër i kulturës e kështu deri në pafundësi. Një tip mentaliteti që i shkon formulës së Laotse-së i cili qysh në shekullin 6 para e.s. ishte i bindur se «njeriu që thotë shpejt po, vështirë se e mban fjalën».

(Vetë)mashtrimi ka lëshuar rrënjë dhe elitat, shkollat, mediat nuk bëjnë asgjë fare për të edukuar njeriun racional, i cili nuk do të prirëj nga dëshirat e veta irrealë dhe premtimet e politikanëve të bazuara po në ato ëndrra absurde, por do të sanksiononte megapremtuesit për t'i shkolluar të ardhshmit që të premtojnë vetëm të mundurën dhe që zhgënjimi mos të

shndërrohet në trazira masash. Votimi i të njëjtëve njerëz –  
premtuesve astronomikë – është vendim me paramendim për  
jetëzgjatjen e një shoqërie me mentalitet vetëmashtrimi  
permanent. (2015)

## *Racizmi si afekt eurocentrik*

Europa racizmin e ka jo vetëm në gjak, por edhe në tru. Iluministët përveç përjashtimit kategorik të femrës nga e drejta universale – shumica e tyre – ishin këmbekrye, herës pas here edhe racistë. Në antikitetin e famshëm të lindjes së poliseve, demokracia nuk ishte ndryshe. Barbaroit janë markë aristoteliane. Religjionet kryesore me misionin e tyre „hyjnor“ si të zgjedhurit e veçantë të Njëshit, si ashtu, vetvetiu nënkuptojnë çmimin e ulët të të gjithë të tjerëve. Racizmi ka qenë dhe është gjithmonë ndër ne: si vetëdije, si program kuaziracional, si sjellje, si instinkt, si emocion.

Veprat me Prosperot dhe Calibanët si ajo e Shkespirit „The Tempest“ (1611); romanet „Two Thousand Seasons“ (A.K. Armahs:1973); „Roots“ (A. Hayleys: 1976); „Beloved“ (T. Morrison: 1987); „The Longest Memory“ (F. d’Aguiars: 1994), filmat si „Middle Passage“ (1990), „Sankofa“ (1993), Amistad (1997); studimet me tonelata që janë prodhuar pas Luftës së Dytë Botërore na fusin, shëtisin botës së racizmit duke na tmerruar me egërsinë, njëanësinë, brutalitetin e njeriut kundër njeriut.

Ato na sqarojnë mirë apo dobët se si ndodh racizmi në veprim, konkretisht, mirëpo jo edhe gjithaq se nga vjen ai, ose na e vizatojnë sipërfaqësisht si konstrukt të injorancës humane, gjë që nuk qëndron. Ndoshta nga këtu edhe rrjedh pazotësia e shoqërive kundrejt përhapjes aq të shpejtë dhe kancerogjene të racizmit sa herë që grupet përkatëse acarojnë diskursin.

Para se të vërdallosemi teorive të ndryshme, ndoshta një biografi (e vërtetë) familjeje na ndihmon ta analizojmë më mirë natyrën, funksionalitetin dhe rezultatin e epidemisë:

*Drita dhe Maria* - Drita (emri është ndryshuar) kur erdhi në Zvicër ishte 19 vjeçe. Pas tri viteve martohet kosovarja me Filipin, sllovak nga i ati dhe zviceran nga nëna, i lindur në Bernë. Pas tri viteve jetë së bashku lind një vajzë. Vetëm tre muaj pas lindjes Drita dorëzohet në spital si paciente që vuan nga PTBS (posttraumatic stress disorder).

Bërtet në gjumë sikur mbrohet nga dhunuesit (paramilitarët serbë), ka paranojë ditën saqë shpesh e sulmon ndonjë polic duke e ngatërruar atë me ndonjë dhunues të saj – për shkak të uniformës – dhe të tjera skena të rënda dramatike të kësaj natyre.

Filipi dhe familja e tij ka tre vite që janë bërë peng të kësaj situatë. Balinti, i ati i Filipit, së fundi na rrëfeu se është paditur nga serbja Maria P. Pse? „Po erdhi të kërkojë punë në ndërmarrjen time dhe...“. Çfarë ndodhi? „I thashë se janë racë e ulët dhe se të tillë njerëz kurrë nuk do të shkelin me këmbën e tyre kriminale në firmën time”, kështu damarëfryrë përsërit sllovaku Balint J., i ikur para dyzet viteve nga Çekosllovakia në Zvicër. Jo vetëm Balinti, Filipi, e ëma e tyre, por edhe miqtë zviceranë, ndër ta edhe anglezë, gjermanë, francezë dhe tamilë që i takuam rastësisht në një rast, manifestonin po të njëjtin qëndrim ndaj serbëve në përgjithësi.

Të rikapitulojmë pra: Drama e Dritës së mitur, të dhunuar para shumë viteve, gjatë luftës së Kosovës, bëhet shkaku nga ku shpërthen urrejtja e familjes sllovak-zvicerane-kosovare ndaj serbëve. Gjatë ndërveprimit me miq, mjekë, të njohur kulturash po ashtu krejtësisht të ndryshme, që konfrontohen me rastin e Dritës dhe familjes së saj, përhapet mllefi dhe urrejtja ndaj serbëve si popull. Dhe urrejtja e akumuluar e



gjithë këtyre njerëzve manifestohet ndaj asaj vajzës që kërkoi punë tek Balinti, dhe për çdo ditë kjo gjë ndodh sa herë që dikush t'i përmendë përsëri serbët.

*Racizmi në iluminizëm* - Me dramën e rrëfyer më lart pamë se si lind dhe përhapet racizmi ndaj një kulture, grupi etnik, populli, tani parashtrohet pyetja: po përse gjithë të përfshirët në këtë situatë i urrejnë të tërë serbët kur e dinë se vetëm dy-tre paramilitarë kriminelë – që i gjen brenda çdo populli e jo vetëm aq – janë autorët e këtyre akteve çnjerëzore? Sepse përveç Dritës, asnjëri prej tyre as trajtat e fytyrës së kriminelëve serbër nuk i njeh, nuk i identifikon dot.

Kur mungon përgjegjësi konstrukto-konkret, është në natyrën e njeriut që të kapë përbindësia nga kapitali i memories dhe dijenive të tij për të shpjeguar dukuritë me të cilat kacafytet. Po ku i merr ai këto përbindësia sakaq? Gjithandej doktrinave, féve madje edhe vetë aty, në atë sferë ku ne evropianët e ditëve të sotme gjejmë shtratin e dëlirësjes nga lavdërimi i vetvetes; në iluminizëm (vetëm sa për të argumentuar se as ajo epokë që ne e konsiderojmë kulminante, nuk është aspak e mbrojtur nga racizmi)!

Jo vetëm botaniku Carl Linné (1707-1787), i cili në përpjekje për të argumentuar tezën e tij mbi „homo europæus“-in ndau globin në katër raca (bardhë, kuq, verdhacuk dhe zezak), por kësaj teorie më vonë do t'i bashkëngjiten si të paradhënë edhe David Hume, William Petty, George Buffon, Jean-Jacques Rousseau, John Lock-u, Hegeli, Merksi, Voltaire (me teorinë e tij të poligjenezës) dhe ati i iluminizmit si program, vetë Imanuel Kanti. Këto mendje të mëdha, brenda shtyllave kryesore të filozofisë së tyre si: Liria, barazia, vëllazërimi, drejtësia, arsyeja dhe

pjekuria, nuk përjashtojnë vetëm femrën si „qenie të dobët“, por edhe gjithë ata që nuk janë të bardhë nga lëkura.

Madje Kanti shkon aq larg saqë shpesh edhe pohon se ekzistenca e racave dhe popujve të ndryshëm të jetë krejt e pakuptimtë: „Gjitha racat do të asgjësohen (Amerikanët lëkurëkuqë dhe zezakët nuk e qeverisin dot veten dhe mund të mbijetojnë vetëm si skllëvër), vetëm të bardhët jo“, thotë ai (Skica nga koha e kolegjit në Shkrime të zgjedhura, Berlin-Leipzig, 1923, F.878). Në të njëjtën vijë ecin pothuaj pa përjashtim gjithë iluministët deri në vitet 50-ë të shekullit të kaluar. Diskursi kundër perandorisë filozofike iluministe të këtij drejtimi edhe sot është fare i paaftë (ndoshta edhe pse është sektaresk si feminizmi, postkolonializmi etj.) për të ofruar një drejtim konstruktiv drejt larjes së mëkateve.

Këndejpari i marrin edhe shqiptarët, sllovakët, anglezët, rusët, serbët, francezët përbindëshat e tyre kur kanë nevojë të shfryjnë urrejtjen e tyre, e cila gjithmonë ka një shkak dhe shkaktar konkret dhe mund t'i përplasat atij gjithnjë në fytyrë, mirëpo mungon.

Këtu edhe është qëllimi i kësaj eseje për të treguar se nuk ka recetë që do ta pakësonte përhapjen marramendëse të racizmit nëpër shoqëritë shqiptare, përveç se ato të bëjnë çmos që krimeve t'ua japin fytyrën konkrete që e kanë; të prangosin kriminelët dhe të kujdesen sa më shumë për viktimat e tyre, duke mosi mënjanuar ato dhe lënë të plasnin nga dhimbja dhe urrejtja, si dhe të shërbejnë si adresa justifikimi për masat që tek e fundit veçse mbysin veten me urrejtje e asnjë fije floku nuk ua trazojnë demonëve të së keqes. (2014)

## *Topologjia e dhunës*

Shqiptarët janë të natyrës agresive. Të tillë janë sepse i dhunuar shpesh gjatë historisë? Jo vetëm. Edhe te shqiptarët dhuna është veçse akti final i një urrejtje që kultivohet e përthithet çdo ditë e gjithandej.

„Grekët e konsideronin dhunën të domosdoshme, të pashmangshme“ me këtë fjali hap studimin e radhës filozofi i njohur koreano-gjerman Byung-Chul Han (*Topologie der Gewalt*:2011). Po si mendohet sot në raport me dhunën, aktualisht, në shekullin XXI? I njëjti autor mendon se si kurrë më parë njeriu ka kuptuar se jeta është e shenjtë dhe se dhuna është duke u pakësuar. Vërtet?

*Historia* - Thelbi dhe morali i sagës (Epit) të Gilgameshit gjysmëperëndi dhe gjysmëkafshën Enkidu është solidariteti i detyrueshëm i qenieve në favor të koekzistencës. Ishtareja – perëndesha e dashurisë, paraardhësja e Afroditës – frymon Gilgameshin me detyrimin që ta qytetërojë egërsirën. Një Epos pra, edhe pse pakëz antropocentrik, prapëseprapë i këndshëm. Mirëpo, ja që gjithësesi një Ep tepër i butë. Nuk na e ndez epshin sa duhet, nuk na i nxeh ndjenjat deri në parashpërthim, s’na i skuqin tëmthata në ballë as Enkidu e as Gilgameshi siç na mbush plot energji e zjarr Akili i shpejtë, asgjësues. Miti makineri që heq koka më shpejt se çdo sharrë ultramoderne. A do të ishte e mundshme ekstaza përshkruese e Homerit pa dhunën e tmerrshme të Akilit?

Jo pak historianë e filozofë lindjen e *res publica* – s (zanafillën e solidaritetit shoqëror, bashkësisë) dhe *parrhesia*-s (e drejta për të thënë gjithçka pa u sanksionuar) e lidhin me dramën e Lukrecias, vajzën e Spuriusit. Skenat e tragjedisë, së ngjarë (?) rreth viteve 509-508 para e.s., rrëfyeshëm na i sjellin Tit Livi dhe Ovidi, ndërsa në pikturë Ticiani dhe Antonio Bellucci: Në Romë, në tendën e Sextus Tarkuini-t, birit të tiranit Superbus, mbliidhen oficerë e ushtarë për të përfolur gratë. Romaku Collatinus preferon të lavdërojë gruan e tij. Rrëfimi do të ketë qenë aq erotik saqë përdezet keq epshin e „princit“ Sextus. Një natë më vonë ky i fundit futet në dhomën e Lukrecias për ta përdhunuar atë. Romakja reziston deri në çastin kur dhunuesi i thotë se pasi ta vrasë, do ta shtrijë pranë një skllavi dhe do të shpifë sikur ta ketë vrasë për kurvëri. Lukrecia dorëzohet. Pas aktit ajo thërret të atin, të shoqin dhe rrëfen dramën. Pas këtij veprimi vret veten. Tragjedia shkakton aq shumë neveri, revoltë dhe dhunë saqë pas pak kohe shembet tirania e Tarkuinëve.

Kjo ngjarje thuhet të jetë miti i themelimit të Republikës (s’ka fakte relevante historike për këtë). A do të kishte lindur republika romake po të mos kishte ndodhur „dhunimi i Lukrecias“?

*Perënditë dhe dhuna* - Këto momente përfliten e konsiderohen si zanafilla e procesit të civilizimit. Që të treja këto momente – Gilgameshi, Akili dhe Lukrecia – kanë të njëjtën arkitekturë: fiksimi i njeriut për ta detyruar në sistemin e vet social çdo specie tjetër që e percepton si të egër, të kapshme, të dhunueshme (Gilgameshi + Sekstus); fitorja, hakmarrja ndaj tradhtisë, së keqes, triumfi i drejtësisë janë të mundshme vetëm atëherë kur synuesi ka forcën e duhur (Akili kundër tradhtisë trojane + romakët e bashkuar kundër tiranit Superbus). Dhe çfarë bën i forti për të realizuar qëllimet, idealet dhe synimet e bashkësisë? Ushtron dhunën

deri në asgjësimin e tjetrit, kundërshtarit, armikut. Ky është morali edukues para- dhe post-antik i njerëzimit.

Sipas logjikës së kësaj tradite dhuna del motori dhe burimi i vetëm që e paska shtyrë njerëzimin të bashkohet kundër së keqes, ta çlirojë veten nga tiranët, t'i zbusë kafshët e egra dhe të fitojë lirinë e shprehjes totale.

Po të njëjtin sistem e përdorin edhe fetë: Që nga religjionet më të vjetra paraabrahamite nis udhën mendjes njerëzore (Epi i Gilgameshit si i pari) varka e Noes. Zoti përmbyt botën sapo krijesat e tij rebelohen. Me dhunë fillojnë t'i zgjidhin problemet Kaini dhe Abeli. Davidi nuk njih formë tjetër jete përveçse t'ua vjedhë gratë të tjerëve, të vrasë armiqtë dhe të rrijë fshehur shpellave deri sa flet me Zotin që pastaj të njëjtat gjëra t'i bëjë në emër të tij. As urdhëri për prerjen në fyt, flijimi i fëmijëve nuk mungon. Sodoma dhe Gomorra, ferret si Hadi, urdhërat që justifikojnë dhunën për ta sjellë njerëzimin në udhën e Jahwe-s, Krishtit, Allahut. Mëkati gjenetik, ndëshkimet dhe frika permanente janë vetëm disa nga përbërësit e dhunës hyjnore.

Ja u bë shekulli 21 dhe as mendjet më të ndritshme të njerëzimit nuk e gjetën recetën se si të iket nga ky rreth vicioz djallëzor dhune. Shoqëritë që nuk njohin histori tjetër përveç asaj të nënshtrimit me dhunë dhe luftërave, përjetojnë edhe sot krizat më të rënda të tyre në raport me agresionin në përditshmëri, me dhunën si mjet „të përshtatshëm“ për zgjidhje të problemeve, qofshin ato edhe më banale.

*Fabrikat e urrejtjes* - Bota duket të jetë e programuar me dhunë e për dhunë. Po në këtë planet, brenda kësaj kulture universale, janë rritur shqiptarët. Kryesisht në anën e viktimës. Antropologët e në veçanti psikologët do të mendonin: pikërisht një masë kaq e shkallmuar nga dhuna e të tjerëve dhe e veta do të duhej – në kushtet e sotme – të bëjë të pamundurën për ta refuzuar dhunën si mjet zgjidhjeje

problemesh! Po nuk është ashtu. Shqiptarët janë po aq agresivë si gjithë ballkanasit tjerë. Si gjithë ata që janë rrahur ose kanë rrahur të tjerët përgjatë historisë.

Përkundër këtij fataliteti, ose pikërisht për këtë, ia vlen të reflektohet se mos shqiptarët mund të bëjnë diçka më shumë në këtë drejtim: jo ta shporrin dhunën nga mendësia e tyre, por të luftojnë për ta reduktuar praninë e saj. Sidomos kur kihet parasysh fakti se dhuna është vetëm akti final i një urrejtjeje të akumuluar – pra i një jete, një përditshmërie të tensionuar, e cila domosdo saboton, deformon, depresionon dhe bllokon shumëçka në përparimin e shoqërive shqiptare.

Si kultivohet ajo, urrejtja kolektive, si e rifabrikojnë shqiptarët dhunën në mentalitetin e tyre?

Nga këtu qëllimisht përjashtojmë krahasimet me kulturat e tjera. Çfarë roli luan ose ku e hasim më shpesh predikimin e dhunës?

*Historia, letërsia, artet, folklori, tradita* përbëjnë sferat më të ndjeshme nga të cilat shqiptari i sotëm përcakton identitetin e tij. Këto sfera kanë ndikim parësor sidomos në shkollim, politikë, shoqëri dhe mendësi.

Cili është kapitali përmbajtjesor i këtyre sferave?

Kryesisht mite që ende mprehin shpatat për t'i vrarë armiqtë, saga mic-sokolësh të cilët me gjoks bllokojnë grykat e topave; me letërsi fishtiane që vret e pret për shqiptari e gjëra të ngjashme. Heronjtë, martirët, më shumë ekspozohen si të pathyeshëm, si të egër, të dhunshëm se sa si njerëz, heronj që me të gjitha të mirat dhe të pakëndshmet e tyre njerëzore u flijuan për lirinë e të tjerëve. Pas atyre me motive të viktimës, pikturat dhe statujat më të preferuara janë ato të prijësve luftarakë, mundësisht duke hequr zvarrë ndonjë serb, grek, osman. Sekuenca historike si të imagjinuara ashtu edhe reale

që paralelisht glorifikojnë ose demonizojnë dhunën, varësisht nga perspektiva e recipientit. Si duket kjo në përditshmëri?

*Sulltan Murati dhe Avatari* - Le të përfytyrojmë duke dramatizuar ditën e një filloristi në mëngjes: Rugës për në shkollë përshëndet gjithë ato përmendore heronjsh të armatosur që i kanë bërë roje natës shqiptare. I shtangur para portreteve të prijësve që kanë dhënë jetën për atdhe mezi pret që zilja ta shpëtojë nga lënda e matematikës. Në orën e gjuhës analizohet himni i flamurit: flijim për atdheun, tradhëtorët, armiqtë. Mësuesi i historisë herë shndërrohet në Skënderbe, herë Isa Boletini e në fund në Adem Jashar që me shpatat, revolet dhe mitralozat e tyre mbulojnë me gjak fusha e male duke masakruar osmanë dhe „shkije“. Në të kthyer nga shkolla i bie përmes një turme ku flitet për një politikan kundër korrupsionit, kriminit, tradhtisë së pushtetit, kërcënohet e kërcëllohet sikur që atë moment do të nisi lufta. I lodhur nga dita jashtë shtëpisë, ai më pas izolohet brenda: kap konsolën dhe luan Avatari – sunduesin e elementeve. Mezi pret të mbarojë darka; i ati i ka premtuar se do ta shikojnë bashkë trillerin më të ri të Budakovës „Haraçi“. Shkon në shtrat dhe nuk fle dot nga frika që mos i dalë në gjumë ndonjë sulltan Murat, Millosheviq, ndonjë nga ato figurat e gërditshme tek Avatari e në ato fytyrat e mafiozëve (reale, që i sheh rrugëve përditë) të „Haraçit“ as që guxon ta lejojë memorien të hyjë, as në ëndërr e as zgjuar.

Si do të silllet në shoqëri filloristi sot e çfarë presim prej tij nesër? Një qenie të qetë, të relaksuar, mendjekthjellët që nuk e shikon botën përmes syzeve të urrejtjes ndaj dikujt? Vetëm të çemocionalizuarit mund të mbeten indiferentë përballë një edukimi dhe formimi të tillë. E të tillë nuk ka, sepse si introvertët ashtu ekstrovertët e shoqërive të formuara në kushte të tilla kanë probleme me agresionin dhe e manifestojnë atë të internalizuar apo të eksternalizuar –

shkarkimi i urrejtjes duke u finalizuar në akte dhune do të ndodhë pashmangshmërisht.

*Racionilizimi kulturor* - Pamë se dhuna nuk është specialitet shqiptar. Historia e qytetërimit njerëzor është njëkohësisht edhe kronikë e dhunës brutale. Drejt rehabilitimit janë nisur suksesshëm shoqëritë, të cilat kanë arritur ta racionalizojnë historinë, ideologjitë dhe besimet e tyre. Së paku në institucionet e arsimit, media dhe sferat e tjera të komunikimit publik është i nevojshëm një ndryshim radikal – jo se kjo do të ishte gjë e mirë për miqësinë me të tjerët, porse askush nuk dëshiron të jetojë në një shoqëri agresivësh, brutalësh që as zënkën më banale nuk dinë ta zgjidhin pa duele me kallashnikovë. Ndryshimi nuk duhet të ndodhë duke falsifikuar historinë, as duke censuruar letërsinë dhe artet e djeshme, por duke i interpretuar të vjetrat dhe duke i krijuar të reja pa urrejtje, pa sugjestion, adresime.

Asgjë e fituar me dhunë nuk mbahet pa dhunë – tha Mahatma Gandhi. Shqiptarët as minimalisht nuk përdorën dhunë vetë për lirinë e tyre, kështu që as që kanë kurrëfarë nevojë ta mbajnë atë me dhunë. (2013)



## *Embrionet e vetëzhbërjes*

Shqiptari ushqehet si turku, italian; vishet si amerikani, francezi; shkruan e reflekton si gjermani, anglezi; beson si arabi, hebreu; dashuron si beduini dhe italian; vetëm politikën e bën si do vetë: për interesin personal, të fisit, klanit dhe të gjakut! Shqiptarët nuk janë as etërit e as trashëgimtarët e ndonjë ideologjie, religjioni apo koncepti frymor që do të mund të lokalizohet brenda pluralitetit të botëkuptimeve që përbëjnë të ashtuquajturën kulturë universale të njerëzimit. Gjithçka që janë ose pretendojnë të jenë, ata e kanë të huazuar: krishterimin, humanizmin, myslimanizmin, ateizmin, demokracinë, komunizmin, nacionalizmin, kulturën e shprehjes intelektuale, kulturore, artistike, politike e kështu deri te moda e kuzhina. Në çdo moment vetëdijesimi me këtë realitet, atyre sikur u ther veshi nga ulërima e Horacit: **O imitatores, servum pecus!** (Epistulae.1,19). Mirëpo kur u bie ndërmend se shumica e të mjerëve të globit kanë fatin identik të tyre, të atillë siç i pagëzon qortueshëm Horaci; imitues dhe të skllavëruar (ideologjish të huaja), gëzohen që gjetën recetën e vetëngushëllimit. Millefin e mbetur në shpirt, poshtërimin e shkarkojnë mbi gjithë ata që nëpër histori ua kanë zënë me dashje apo pa të, diellin.

Diagnozën e shtruar më lart mbi **momentin e vetëdijesimit**, megjithatë nuk e shpallim dot si **lex generalis** të shoqërive shqiptare, sepse sakaq kryesisht janë minoritarët e elitës, të cilët herë pas herë monologojnë mbi këtë realitet të identitetit të tyre: Disa prej tyre lehtësohen për shkak të shkundjes së përgjegjësive historike nga vetja (nuk kanë shpikur asgjë që t'u ketë bërë dëm të tjerëve) e pjesa

dërmuese e kësaj pakice depresionohet (me vetakuzën; «sa të parëndësishëm që jemi në konkurrencën e dijes mondane»). Sa herë që në mendimin intelektual identifikojmë këto dy gjendje – lehtësimin apo depresionin – seç na mundon përshtypja sikur reflektimet të kenë përherë për bazë dukuri singulare e jo tërësinë, domethënë ato kanë për pikënisje arsyetimi kryesisht vetëm njërën apo tjetrën pjesë të identitetit të njeriut postmodern shqiptar. Nuk marrin parasysh komplet **habitus**-in e subjektit që hulumtojnë. E faktin se habitusi i këtij njeriu postmodern nuk mund të përshkruhet vetëm duke hulumtuar eshtrat e gjyshërve të tij, por më shumë duke –siç kërkon Hannah Arendt me të drejtë – analizuar «se si vepron ai në përditshmërinë e tij kur është aktiv» e di ndërkohë çdo gjimnazist i zgjuar (Arendt.Vita activa: 1960).

### *I. Elementet e identitetit aktual shqiptar*

*Fetë:* Një pjesë e konsiderueshme e shqiptarëve janë të besimit islam. Atij religjioni të krijuar nga arabi Mohammed i fisit Quraisch të Mekës (sot Arabia saudite) diku në mes të viteve 610-620. Po ashtu një komunitet në rishumim janë edhe ata të besimit të krishterë (të të gjitha varianteve), besimit të themeluar nga predikuesi shëtitës hebre Jeshua nga Nazareti dhe i përhapur në shekullin e parë të erës sonë nga trashëguesit e tij. Veçanërisht akademikët (pjesa me shkollim të lartë), njerëzit e kulturës dhe shumica e të arsimuarve me qëndrimet e tyre (a)religjioze (ateistë, shekullarë, racionalistë, gnostikë, antroposofë, manistë [sakralizimi i primatëve, heronjve, gjenezës], humanistë, etj.) kanë atomizuar religionet klasike duke i detyruar në rolin e pakicave pa fuqinë e hegjemonitetit.

*Kultura:* Jo më kot kritikët letrarë Gjergj Fishtën e piedestalojnë si «Homeri shqiptar». Ky kualifikim krahasues është i nxitur nga fakti se si për nga forma, ashtu edhe nga

metoda «Lahuta e Malcisë» është një kopje e «Iliadës» apo «Odisesë» së Homerit, epe të shkruara në greqishten e vjetër. Ashtu siç janë homeriadat (850 para e.s.) kopje të gilgameshianës (1800 para e.s.) dhe vedave (1500 – 1300 para e.s.) hinduiste.

Deri më tani ende nuk kemi zbuluar ndonjë artefakt apo dokument të lashtë e të sotëm që do të mundeshim çekanshëm ta vulosnim me signaturën «**made in**» shqiptare. Po multiplikuam rastin e Fishtës do kemi listën e plotë të të gjithë autorëve të gjallë dhe të vdekur shqiptarë. Që edhe shqiptari dikur vonë të niste të shkruante i duhej formimi me alfabetin dhe letërsinë e të tjerëve. Nëpërmjet letërsive krijojmë shenjat tona, kapitalin intelektual, të cilin – nëse besojmë Augustinin dhe Umberto Eco-n – e përçojmë gjithashtu nëpërmjet shenjave në kokën e të tjerëve. Në fund matematika e argumenteve thotë se: vetëm akti i përcimit del i pastër, shqip, ndërsa origjina e shumicës së dijes (intelektuale) dhe përvojës s'qenka e shtëpisë, apo jo? Duhet të dëshpërohen shqiptarët pse qenka kështu. Assesi! Përkundrazi. Duhet të gëzohen që nuk janë viktimë vetëm e autogolave të tyre. Ajo çfarë ata duhet ta mësojnë mirë është të dinë zgjuarsisht ta bëjnë seleksionimin mundësisht sa më cilësor e racional të asaj që iu ofrohet.

Pikërisht falë kësaj gëlltitjeje vullnetare të imponimeve intelektuale eksterne shqiptarët bashkëbisedojnë pa u skuqur, në nivel të syve, pa u turpëruar me botën e qytetëruar, asaj suprasfere që operon me bagazhin e të ashtuquajturës kulturë universale (konglomerat fragmentesh dijeje me origjinë nga gjithandej e nga çdokush). Në këtë formë ai edhe komunikueshëm përçon vetitë e tij specifike tek të tjerët.

*Politika:* Që nga përmbysja e perandorive (sidomos asaj osmane) e këtej, për bazë funksionimi sociopolitik shqiptarët e kanë përdorur ideologjinë (më shumë si ide dhe më pak si program i materializuar) e nacionalizmit patriarkal. Asaj

ideologjie pra, që rezultoi si pjellë e Revolucionit Francez të sovranitetit të popujve. Po në stilin e gjermanëve të tipit Johann Gottfried Herder dhe Johann Gottlieb Fichte, ose atij italian Giuseppe Mazzini (doktrina – modele prijëse) e gjithë të tjerëve më lart, përreth e poshtë, edhe intelektualët shqiptarë të shekullit 19 përveshën mëngët për fabrikimin e miteve, legalizimin e gjuhës, përpilimin e historisë dhe konfigurimin e identitetit të popullit shqiptar. Në praktikë ky proces u bllokua deri atë ditë kur komentatori i RTP-së Llukman Halili zëtrumbetues shpalli të vdekur monizmin me fjalinë legjendare «Perandoria e kuqe ra!».

Etnonacionalistët kanë të drejtë kur ngulin këmbë se falë kësaj ideologjie – vullnetit për ta finalizuar projektin nacional – shqiptarët emocionalisht e psiqikisht nuk u çetnizuan dhe nuk u tjetërsuan nga joshjet e doktrinës qiell - e tokëpremtuese të gjermanit nga Trieri Karl Marks e as nga dominimi realpolitik i georgjianit Josef Wissarionowitsch Stalin. Kur kemi parasysh konvertimin aq automatik të shumicës së elitave shqiptare nga komunizmi në nacionalizëm, gjatë fillimit të viteve 90-ë, detyrueshëm që duhet t'i bindemi kësaj teze.

Sepse sot kur shoqëritë shqiptare aq me frenetizëm e fanatikisht e kanë përqafuar idenë dhe sistemin e demokracisë liberale, ende mbeten etnonacionalistë të spikatur të tezës se i ka «fajet» politika që përbën shtetin, pra opozita, pozita, partitë. Ato faktorë përgjegjës që aktualisht e fatkeqësisht janë, siç i quan megaliberali francez (me prejardhje hebreje) Raymond Aron «embrionet e vetëshkatërrimit të demokracisë liberale» (Aron. Demokracia dhe totalitarizmi, Gallimard,1965, Fq. 119).

*Përmbledhtas:* Shqiptarët besojnë në religjione që i kanë themeluar arabët (po si ata edhe numërojnë), hebrejntë,

indianët; besojnë në filozofira që i kanë formuluar të lashtët, gjermanët, francezët, amerikanët. Shqiptarët shkruajnë dhe reflektojnë sipas modeleve të gjetura në Uruk, Athinë, Paris, Trier e gjetiu. Shqiptarët e Maqedonisë hanë si turqit dhe egjiptianët, ata të Kosovës sapo kanë pasuruar kuzhinën me specialitete perëndimi, ata të Shqipërisë hanë çka gjejnë tokës e detit. Nuk ka studime se si dashurohen shqiptarët, mirëpo thonë se kryesisht dominojnë praktikat hajdutërishte si ato nëpër çadrat beduineske, ndërsa për nga intensiteti dhe ulërimat krahasohen me italianët (temperamenti).

Ndoshta këtu mund ta lokalizojmë edhe arsyen se përse shqiptarët ( si shumicë dhe kur s'është kohë festash kombëtare) në thelb e thellësi janë më tolerantë (së paku për dallim nga fqinjët e tyre) dhe zemërgjere ndaj të tjerëve. Freud duket se kishte të drejtë rreth pushtetit të pavetëdijes në veprimin social të njerëzve, pushtet që tek shqiptarët si duket paska madje më shumë ndikim sesa vetëdija (e instrumentalizuar). Për të mirë. Kjo si kapital në llogari të kulturës, elitave dhe pse jo edhe të masave.

## *II. Ndërmjet nacionalizmit dhe liberalizmit*

Jo rrallë, sidomos nga historianë të huaj, parashtrohet pyetja: Me gjithë këtë diversitet, në segmente të caktuara edhe konfliktual, çfarë i ka mbajtur shqiptarët megjithatë gjithmonë të bashkuar? Pikërisht kjo gjë pra; diversiteti tepër fragmentar i ka detyruar elitat e tyre që të përvetësojnë një ideologji të karakterit kulmëbërës, përbashkues siç është nacionalizmi. Deri me shpalljen edhe të Kosovës shtet kjo ideologji ishte e nevojshme dhe pragmatike. Tashmë ajo kështu siç dominon – si politikë zyrtare veprimi e ndërveprimi me masat -është vetëshkatërruese për shoqëritë shqiptare. Kjo për arsye se nacionalizmi i bazuar në rrënjë, gjuhë e gjak, konsiderohet kundërproduktiv sa për t'u përdorur si doktrinë

shteti dhe se demokracia liberale kërkon zbatimin e pakusht të të drejtave dhe lirive të njeriut, pra atij modeli shoqëror që filozofi i majtë francez Étienne Balibar në veprën e tij të fundit e përcaktoi si «égaliberté» (La proposition de l'égaliberté. Puf. Paris 2010) e që shqip mund të formulohet në imperativin «pa barazi nuk ka liri». Barazi për të gjithë pa dallim race, mendje, gjaku, religjioni, gjuhe e gjyshërisht. Model që në fakt është po aq i vlefshëm për shqiptarët si dikur etnonacionalizmi, sepse ofron një kulm edhe për nevojat brendashqiptare, sepse aktualisht është forma e vetme organizative që garanton stabilitet brenda diversitetit me potencial konflikti. Dallimi thelbësor ndërmjet dy modeleve: ndërkohë që nacionalizmi etnik kërkonte shpirtin, frymën dhe zemrën në funksion të kauzës (ideali i lirisë kombëtare), demokracia liberale synon veprimin konkret arendt-ian, racional sipas kushtetutës dhe ligjeve të shtetit, respektivisht shumicës që garanton égaliberté-n edhe për pakicat. Model që shqiptarët si shumicë edhe e kërkojnë (hyrja në BE etj.). Ku qëndron atëherë problemi? Pse shqiptari me qenien e tij aq mimikry-ke dhe konformiste në përvetësimin e të mirave të «huaja»- siç dëshmuam më lart – e ka kaq problem që edhe politikën ta emancipojë si të tjerët, madje edhe si miqtë e dëshmuar të tij, ata dashamirë të tij që edhe i shndërruan shqiptarët në faktor dyshtetësh në kontinent?

E për ta shpjeguar këtë duhet t'iu kthehemi «embrioneve të vetëshkatërrimit» të Raymond Aron-it.

### *III. Demokracia dhe diversiteti*

Demokracia, ndryshe nga sistemet tjera politike, përmban më së tepërmi farat e vetëshkatërrimit në vetvete – kështu thotë Raymond Aron në veprën e tij „Les guerres en chaînes“ (Gallimard, Paris 1951, f. 318 Shq. Lufta permanente).

Elementet që Aron i sheh si vetëshkatërruese për çdo demokraci liberale janë: Opozita që braktis parlamentin, përjashton sistemin ekzistues dhe bën lojën e vet politike rrugëve duke sugjeruar se zgjidhja e vetme është përmbyjsja e dhunshme e klasës sunduese, pra dëbimi i të korruptuarve nëpërmjet revolucionit (po aty); Pozita e cila defaktorizon partitë e tjera dhe lobet sociale duke i përjashtuar nga vendimmarrjet thelbësore për vendin; Popullimi i burokracisë administrative me sivëllezër ideologjikë dhe në baza nepotiste, që çon në diskriminime masive të profesioneve (Demokracia dhe totalitarizmi, Fq. 119); Privilegjimi apo diskriminimi i grupeve të caktuara religjioze, sociale për kalkulime elektorale nga partia në pushtet (Lufta permanente, fq. 335); «Kultura» e rivaliteteve partiake në disfavor të institucioneve të shtetit (policisë, gjyqësisë, etj.) dhe; Legjitimimi i korrupsionit si formë efikase, e natyrshme (nuk e shporrim më kënd dot krejt) e ekonomisë së tregut (Fq.119).

Këto janë embrionet kryesore raymondiane, të cilat e zhbëjnë tërësisht demokracinë liberale. Cili prej këtyre defekteve iu mungon shoqërive shqiptare? Po themi se gjitha këto përfundime logjike që i radhit filozofi kryesor i liberalizmit aktual janë logjike dhe i dinë të gjithë. I dinë sepse i përjetojnë përditë. Atëherë le të dihet se si e përshkruan ai edhe procesin, manifestimin final të kësaj zhbërjeje: Qytetarët që kanë humbur besimin tek sistemi kërkojnë alternativa të tjera. Religjionet, doktrinat kuazirevolucionare, sektet, lokalizmat, etnitë dhe grupe të llojllojshme përpiqen ta shfrytëzojnë vakumin, mungesën e shtetit për të krijuar principatat e tyre të sundimit. Diversiteti, nga pasuri kulturore shndërrohet në një dramë apokaliptike të vendit. Pasi rikthimi në sistemet pararendëse (komunizmi) është i pamundur, thotë Aron, – masat nuk do ta ripranonin kurrë një sistem të tillë – atëherë mbetet detyrë e organizatave supranacionale që për hir të paqes apo interesave të momentit ta stabilizojnë

hapësirën problematike. Si? Déjà-vu? Si do të kishin vepruar supranacionalët që ende e kanë një të një të brenda territoreve shqiptare? Pyetje që meriton analizë!

Ndoshta është momenti i fundit, kur shqiptarët të vendosin jo vetëm të hanë, flenë, sfilojnë e këndojnë, por edhe politikën ta bëjnë si të tjerët, si miqtë. (2013)



PJESA E TRETË  
*Politika*

22.

## *Nga perspektiva e gropës*

*Hyrje*

Dështimi i paraprogramuar i pseudokomunizmit la pas një gropë të madhe dhe zhgënjyese në frymën e të arsimuarve të shoqërive shqiptare.

Ndodhi më pak për arsye të respektit ndaj ideologjisë së kuqe e më shumë për shkak se të rrallë qenë ata që njihnin alternativa të tjera.

Kjo ndikoi që shumica prej tyre pa përtypur fare «receta» sferash tjera intelektuale u strehuan nën kulmin gati-virtual shqiptarocentrist: eufori për atdhe e parti! – kështu i ulërinin deri vonë mendjes shqiptare lokomotivat figurë-lideri që sot gati sa nuk rrëgjohen faljekërkueshëm për padijen, misionet e vjetra dhe drejtimet e gabuara, të cilat e kanë fajin përse zgavrave të politosferave të «tyre» ua shtupuan të tjerët, ata që prej së largu ua mbollën arave të frymës doktrinat mijëra herë të dështuara e në antagonizëm me çdo lloj izmi pragmatik, racional e libetar.

Për çka e kemi fjalën konkretisht? Për primatët politikë (partitë, qeveritë) që për interesa fare afatshkurtra dhe mospranim të padijes së tyre i kanë hyrë një lojë tepër të rrezikshme që shpie drejt një konflikti të rreptë ndër shtresa, religjione e opsione të ndryshme kuazispirituale – sikur shqiptarët ta kishin luksin të tepërt edhe për devijime të tilla.

*Historia* - Është metodë e vjetër që njerëzimit ia mësuan kolonialistët me anije si: Francisco de Almeida, Diego de

Azambuja, Bartolomeo Dias (shek. 15) Kristofor Kolombi, Ferdinand Magellani (shek. 16) dhe gjithë ai divizion (deri në shek. 20) misionarësh fetarë, eurocentrist e ekspansionist që me yll e hënë, me kryq në gjoks, me shpatë e sëpatë ua mësynin skutave të ndryshme të globit për t'i «shpëtuar primitivët» nga tjetërqenia, duke shkelur e asgjësuar kultura të tëra përtej e ndryshe nga Ötzi, mumia e Similaunit, që u gjet i konservuar në shkëmbinjtë e akullt të alpeve tiroleze. Esenca arsyetuese e këtyre ekspansioneve (shek. 15 – 19) gjithmonë ka qenë «civilizimi nëpërmjet teomoralit» të njëjës, së dytës apo së tretës mitosferë popujsh që kushedi përse nuk çlirohen as në këtë epokë hiperdixhitale nga morbo-besimi se qenkan të përzgjedhurit e perëndive për ta sunduar botën. Në këtë kontekst, një konstante i përshkon të gjitha veprimet ekspansioniste që nga para-antikiteti e deri sot: suksesin, efektin më të lartë e arrijnë në ato shoqëri ose që janë vërtet maksimalisht analfabete, ose të çorientuara aq thellë saqë dyshojnë në çdo dromcë të kulturës së tyre. Shqiptarët – që nga rënia e Bllokut soçrealist – gjenden në anën e këtyre të fundit.

*Misionet për zotërat-* Pse në Shqipërinë e ditëve të para postdiktatoriale agjenturat dhe misionet më të shpeshta «humanitare» ishin të karakterit religjioz? Evangjelistët, dëshmitarët e Jehovahit, ortodoksët, islamikët dhe pothuaj çdo sekt ekzistent brenda religjioneve abrahamite pushtuan vendin që nga Saranda e deri në Valbonë për ta shpëtuar Njeriun nga mëkatet.

Në Kosovë ende pa u pastruar shtëpitë e para nga predhat serbe se ç'u vërsulën po ashtu të njëjtët në mision. Në Maqedoni menjëherë nisi ndërtimi i shkollave turke, xhamive, mejtepeve (shkollave kuranore) dhe rekrutimi i çdo analfabeti funksional në shërbim të fesë.

Gjitha këto «misione» janë në shërbim të ideologjive të ndryshme, të cilat nuk dallojnë nga epoka e kryqëzatave, marinarëve pushtues portugezë dhe ekspansionistëve kulturorë të dy blloqeve të djeshme sepse në esencë piren nga strategji tashmë të dëshmuara pan-nacionaliste dhe kulturocentriste. Të gjitha janë përpjekje masivizimi të një identiteti të caktuar në dëm të tjerëve dhe subversion në konstelacion me diversitetin dhe multikulturalitetin.

Se të tjerët veprojnë në formën e përfolur është amorale, mirëpo prapëseprapë realpolitikë. Ata bëjnë të vetën dhe kanë arsyet përkatëse se përse me çdo kusht duan dominimin edhe mbi tokat e plisave të Ballkanit. Po si veprouan e veprojnë shqiptarët në këtë drejtim?

*Manifestimet* - Ka më shumë se dy vjet që «diskurset» shqiptare, gati për çdo temë, çekuilibrohen nga analistë, altoparlantë dhe gjojapublicistë që me çdo kusht duan të afirmojnë versionin e tyre të identitetit dhe detyrave të shoqërive shqiptare.

Imponueshëm e në formë kampanje si në politikë ashtu edhe në kulturë janë instaluar hobi-teologë dhe turbo-europianë që fabrikojnë mëri të shumta përmes «paradigmave» dhe «teorive» që përfaqësojnë: debatuesit proislamë ta shpifin islamin edhe pa e njohur fare, turboeuropeanët që kanë ngelur në nivelin e dijes së Ferdinand Magellan-it dhe kanë keqkuptuar BE-në si projekt të krishterë (krejtësisht e kundërta është) ta gërditin kontinentin dhe ta bëjnë simpatik çdo religion tjetër që nuk është i tyre. Qëmoti masat shqiptare janë ndarë në llogore armike në këtë drejtim, jo nga kundërshtitë mbi “filozofitë” e ndryshme, por më shumë për arsye gjeoracizmi, padijeje dhe injorance të thellë autorësh e mediash klandestine që rrogat i marrin ambasadave turke, arabe e gjithandej.

Ky lloj frymimi publik ka bërë që qindra të rinj shqiptarë t'ia mësyjnë hartave të injorancës religjiofanatike ose të mbijetojnë, duke iu bashkangjitur hallkave të korruptuara të politikës shqiptare.

*Qeveritë e gropave të huaja-* Qeveritë dhe politikat shqiptare mbajnë timonin e fatit të vendeve të tyre jo për ta ruajtur kompaktësinë e tyre, për të siguruar progresin kulturor e ekonomik, por siç shihet më tepër për t'ua ruajtur gropat hapur pan-nacionalizmave të gjithandeshme që ato të kenë vendin ku t'i depozitojnë ëndrrat e tyre që janë 1400 apo 2014 vite të vjetra e jo aq të moshuara sa qytetërimi njerëzor. Nga cilësia e debatit, diskurseve, nivelit të institucioneve të arsimit dhe sigurive shoqërore shihet se qeveritë dhe partitë shqiptare janë më injorantet e rajonit në absolut. Sepse nuk kanë arritur as 30 vjet më vonë të krijojnë ligjësinë mbi shkollimin, gjuhën, mediat, antiracizmin, shkollimin, synimet diplomatike, ekonomike, sociale, nuk kanë pra – asnjëra nga qeveritë – një «doktrinë» konkrete mbi shqiptarët siç ata janë mirëfilli dhe mbi shqiptarin se si është ai i dëshiruar të gjallojë brenda sistemit që i mbajnë meshë përditë – pa e kuptuar fare!

Me ardhjen e Edi Ramës në pushtet shumëkush mendoi apo shpresoi se nga Tirana do të na përfshijnë motorët e një frymë të re progresive, konkrete e përparuese, gjë që doli deri tani së paku, asgjë më shumë se grahje majtas e jo djathtas, por drejt po të njëjtës humnerë sidoqoftë.

Ose në mos ndonjëra nga qeveritë, elitat, partitë paskan filluar të mendojnë në këtë drejtim, që gropat t'i mbushin vetë për shembull? Jo. Shkupi është vetëm humnera pikënisëse. Të tjerat grova mund të dalin edhe shumë më të mëdha e më të kobshme. (2015)

## *Politika në panoptikë*

Shqiptarët nuk janë prekur nga zhvillimet epokale si industrializimi, «*Belle Époque*»-a, konsumizmi i «epokës së artë» të Hobsbawm-it për shkak të qenies në kafaze të ndryshme ideologjike, tradicionale dhe eksterne (pushtimet) e të tjera.

### 1.

Utilitaristi dhe juristi Jeremy Bentham në skicën e tij arkitektonike «Panopticon» (panoptes = gjithçka në dukje) shpërfaq planin e një burgu në formë arene, në rathë, me një kullë vëzhgimi në mes. Ideja e filozofit anglez ishte që me sa më pak personel të kontrollohen qindra të burgosur dhe njëkohësisht të munden të mbikëqyren edhe gardianët për ta ushtruar detyrën në mënyrë më korrekte dhe të disiplinuar: Gjithçka dhe gjithkush pra nën kontroll! Bentham, përndryshe pionier i së drejtës së grave për votim dhe lirisë së shtypit, anashkalon disa dimensione kapitale në skicën të tij: të drejtën e të dënuarit në ndërveprim (komunikimit me njerëz), në privatësi, dinjitet dhe çështjen se kush i sajton rregullat e «Panopticon»-it, respektivisht kush është mandatar i pushtet përkatës për të kontrolluar të dënuarit dhe kontrolluesit. Shteti?

Bashkëvendasi i tij George Orwell me romanin e tij 1984 (1949) vë në vitrinë, në panoptikum pikërisht këtë gjë, pra shtetin, për të demonstruar se çfarë do të thotë kontrolli total i qytetarëve nga ana e tij. Filozofi francez Michel Foucault (Vëzhgo dhe dëno – Lindja e burgut: 1977) këtë sistem panoptiku e mban si model përshkrimi të tendencës së kapitalizmit perëndimor (që nga shekulli 18 e kënde) që

nëpërmjet kontrollit dhe disiplinimit t'i përkryejë mekanizmat dhe teknikën e tij represive të kontrollimit të masave. Dhe ylli i ri i filozofisë gjermane (El Pais) Byung – Chul Han thotë se ndodhemi qëmoti në një fazë të tillë foucaultiane kur çdokush, gjithkënd dhe gjithçka e kontrollon, vëzhgon dhe orienton. Këtë gjendje vetëzhveshjeje masive Han nuk e konsideron si Orwell pasojë të ndonjë regjimi totalitar, komunizmit apo diktaturave pushtetare apo shërbimeve sekrete, por më shumë rezultat i grupeve neoliberales globale (Psikopolitika, neoliberalizmi dhe teknikat e reja të sundimit: 2014), të cilat jo nëpërmjet instrumenteve fizike represionale skllavërojnë njeriun, por nëpërmjet ofertave për konsumim të domosdoshëm e bëjnë të varur, duke ia kushtëzuar komunikimin dhe realizimin individual që nga «butoni Like», iphon-i e deri tek sigurimi i ushqimit dhe partnerit. Kemi të bëjmë me teori historike filozofesh apo vërtet qytetërimi ecën udhës së vetëskllavërimit?

Në cilin stad të këtij procesi gjendet shqiptari?

## 2.

Aktualisht është e pamundur të spekulosh mbi sjelljen kolektive të shoqërive shqiptare. Shqiptarët nuk janë prekur nga zhvillimet epokale si industrializimi, «Belle Époque»-a, konsumizmi i «epokës së artë» të Hobsbawm-it për shkak të genies në kafaze të ndryshme ideologjike, tradicionale dhe eksterne (pushtimet) e të tjera. Verifikimi i teorisë del i mundshëm vetëm në një segment; në atë të politikës! Respektivisht në sjelljen e elitave të shoqërisë shqiptare që janë të deleguara të jenë përfaqësues të shtresave, profesioneve, lobeve, kulturës, ruralitetit, urbanitetit e gjërave të ngjashme kërkojmë paralelizma ose diferenca të ndryshme. Le ta bëjmë për pak si dhomë eksperimenti, pra si «Panopticon»-in tonë «Parlamentin e Kosovës». Hapësira

duket të jetë një agorë ku çdokush sheh gjithkënd. Detyra e këtij forumi është ta kontrollojë qeverinë dhe grupet, konkurrencën. Dallimi formal midis panopticon-it dhe parlamentit qëndron diku tjetër: Fraksionet, grupet nuk duan të flasin me njëri-tjetrin, jo sepse si në projektin bentham-ian është i ndaluar ndërveprimi dhe gardiani nga kulla e vëzhgimit do ta gjuajë përvdekshëm deputetin llafazan, por se i fundit është i bindur, nuk ka vullnet, është i armiqësuar me tjetrin aq thellë sa që ka humbur edhe vetinë më elementare të kulturës njerëzore: të dialogojë me tjetrin! Madje edhe duke ushtruar një profesion të mandatuar për të komunikuar detyrimisht me synimin e mbrojtjes së interesave të atyre që përfaqëson. Deputeti kosovar as për nga zhvillimi individual, as për nga habitusi kolektivokulturor dhe historik nuk hyn dot në kategorinë e individit të skllavëruar nga procesi i teknikave sunduese kapitaliste, rrjedhimisht neoliberalë dhe shkon në konfrontim pikërisht me argumentin qëndror të teorisë së Han-it mbi komunikimin e pakontrollueshëm (për shkak të të cilit është i varur nga mjetet e tregut) sepse ai nuk komunikon fare dhe madje në fazën eskaluese të problemit zgjedh moskomunikimin si metodë koekzistence.

### 3.

Që kur filluan përhapjen e tyre televizorët e parë bardhezi nuk qenë të pakët filozofët që sajuan teoritë e tyre rreth manipulimit të masave nga ana e politikës përmes «kutisë së djallit». Tradita e këtij diskursi ka populluar biblioteka të tëra. Panopticon-i herë hapet e herë mbyllet, herë intensifikohet e herë harrohet. E çfarë na thotë vallë kjo? Se jo teknikat janë problemi kryesor, por sjellja, kultura dhe niveli arsimor i shoqërive kundrejt lirisë. Ndërkohë që perëndimorët vuajnë nga varësitë herë ndaj lëndëve narkotike, herë nga aparatet e herë nga banaliteti i jetës, lindorët vetëburgosen për shkak të



pamundësisë për t'i arritur të tjerët në rrugëtimin e tyre drejt banalizimit apo pasurimit të pafré. Nëse filozofia, elitat, diskutet më shumë do të përqendroheshin të përgatisin masat se si të sillen me zbulimet më të reja e më pak të kultivonin teoritë fobike të tyre edhe deputetët e Kosovës do të ishin pak më të ngitur, më pak primitiv dhe nuk do ta ndjenin veten në panoptikum. (2015)

## *Egotuneli i minitiranëve*

„Ajo çfarë neve na nevojitet është evolucioni e jo revolucionet», thoshte biokimiku dhe filozofi gjerman Frederic Vester. Formulë që më shumë se çdokush tjetër shqiptarët duhet ta bëjnë grafitin syplasës mureve të mjerimit të tyre. Nëse jo për ndonjë gjë tjetër, atëherë qoftë edhe sa për t'i luftuar tiranët e tyre të vegjël e të mëdhenj. Bernë, tetor – Biokimiku gjerman Frederic Vester (†2003) në studimin e tij gjurmëlënës «Tokë e re e të menduarit» (München; 1984) kërkonte nga raca njerëzore që t'i ndryshojë sa më shpejt strukturat e të menduarit, nëse kjo e fundit dëshiron vërtet t'i shpëtojë procesit të vetasgjësimit. Sipas tij çdo zhvillim teknokratik e kibernetik nuk ka ndikuar në favor të ndonjë emancipimi të trurit human. Përgjatë pesë mijë viteve të fundit ai nuk gjente dot ndonjë gjë që do ta katiste besimin e tij ndaj tezës personale. Nëse i hedhim një sy shtypit të kohës kur qe botuar libri i Vester-it, do të habitemi me betejën asgjësuese të gazetave perëndimore ndaj tezës së biokimikut. Edhe më shumë do të habiteshim nëse po të njëjtin shtyp e rilexojmë për të parë se si vlerësohet studimi «Egotuneli» (Berlin; 2009) i filozofit Thomas Metzinger, i cili ndryshe nga Vester nuk e analizon mendësinë e njerëzimit nga perspektiva e masës popullore, por nga ajo e species së veçantë. Konstatimet e Metzinger-it janë identike me ato të Vesterit. Pëmbajnë apelin e njëjtë për një filozofi tjetër që duhet ta kërkojnë dykëmbësorët nëse vërtet duan t'i shpëtojnë vendnumërimit. Kësaj radhe mediat e njëjta nuk linçojnë tezën e filozofit të radhës, por e katapultojnë atë në qiell.

Çfarë të ketë ndodhur vallë brenda 25 viteve të fundit që – aq sa është distanca mes këtyre dy botimeve – opinioni i përzgjedhur kontinental të jetë bindur përfundimisht mbi tezën e Vester-it? Shumëçka dhe asgjë. Nëse para 25 viteve pjesa dërmuese e njerëzimit paska patur mendësinë e vetëfikjes duke jetuar errtas korridoreve të grahmës sociale e kulturore, pse ajo sot na qenka papritmas ndryshe?

Është vërtet ndryshe vallë?

Nëse diku mund të ketë ndodhur kjo mrekulli neve na mbetet veç të harbohemi nga gëzimi, mirëpo njëkohësisht shtangemi tronditshëm sapo që arrijmë të kuptojmë se shqiptarët nuk janë ndër të mrekulluarit, por ata thjesht dergjen në shtëpi, në dhomën e vet me atë jetën e mërzitshme të tyre. Po kush duhet të ndryshojë mendje që shqiptarët të dalin nga ky ilaritet, të ikin nga kjo gërranë ku janë shtrirë sikur të ishin me pushime?

E dimë mirë se vërejtja e Timothy Garton Ash se «fajin për gjendjen e mjerë në të cilët gjenden popujt e lindjes e kanë më shumë se gjithkush tjetër, ata vetë» (Facts are Subversive; 2009) vlen gjithaq edhe për tirqebartësit e postmodernizmit, prandaj po në stilin e Pierre Bourdieu-së (La misère du Monde; 1993) nuk lëmë pa përgojuar edhe defektet e mentalitetit dhe masës, sakaq të vetëdijshtë se bllokada kryesore e çdo progresi është makineria e prijësve tanë në pushtet, duhet që të përpiqemi pra, që të nisemi nga psikogramet që kemi për ta, për prijësit tanë politikë. Konform analizave të Metzinger-it dhe Bourdieu-së, në përputhje me analizën «mbi elementet dhe gjenezën e sundimit totalitar» të Hannah Arendt-it duam të shohim se mbi ç'shkallare kanë parkuar këmbët ata që i kanë hyrë misionit t'i kapërrëcejnë do epoka për të shpëtuar shqiptarët nga vegjetimi. Me ç'modele politike, kulturore e intelektuale operojnë kryeqeveritarët shqiptarë?

*Retorikat dhe protokollet* - Deklaro (poho ose moho) – përsërit – transfero – bind! Kjo maksimë e çdo shkolle liderësh politikë, në kushtet shqiptare mund të përkthehet kështu: gënje – përsërit – beso edhe vetë! Shumëkush mund të thotë se kjo nuk është diçka fort e mundshme, mirëpo kush njih antropologjinë sociale, etikën praktike, studimet e lartpërmendura, rezultatet më aktuale nga psikanaliza dhe politikat ballkanike, e di se kështu janë gjërat vërtetë. Kemi të bëjmë me kategorinë bazike të (vetë)manipulimit masiv që e hasim në çdo deklaratë, nëpër protokollet dhe stenogramet e dialogëve ndër qeveritarë dhe në çdo fjalim të Sali Berishës, Hashim Thaçit, liderëve partiakë dhe politikanëve lokalë. Natyrisht se ndodh edhe ndonjë «përrjashtim» i lehtë dhe epokal si ai i Jakup Krasniqit që tha; «ne jemi hajdutë votash», e që tingëlloi praktikisht si: «krejt jemi hajdut votash», mirëpo kjo tentativë metanoike e mësuesit nga Drenasi as që e luhat dot sistemin hermetik të kullës retorike shqiptare. Thonë se logoreja e tejdukshme e Krasniqit ka të bëjë me plane rikonfigurimi brenda partisë së tij – pra duket se kjo na qenka një pendim i pasinqertë dhe në interes të ndonjë formule të modifikuar si kjo: gënje – përsërit – të të besojnë shpejt! Kështu thonë. Spekulum është. Nuk e dimë saktësisht. Protokollet e bisedave mes Cezarit dhe Arovis-it (58 p.e.s); ato të mbretit Bocchus dhe Lucius Cornelius Sulla-s; ato të Trozki-t dhe Kamenjevit dhe ato të despotëve të deridjeshëm ballkanikë me varësit e tyre nuk dallojnë as për një sekuençë nga protokollet, stenogramet dhe bisedat e kryeqeveritarëve shqiptarë sot. Po i njëjti ton, po të njëjtat formulime e para së gjithash po e njëjta strategji pushtetmbajtëse: Cilat grupe i ke nën kontroll? Sa vota mund të më sigurosh ? Cilën vajzë a djalë e do si ministër? Kë t'ia lëshojmë këtij apo atij? Cilat gazetarë i kemi bërë për vete? Paret jepja X –it se ai i menaxhon firmat e mia! Shko tek ai se e kam futur në borxh.

Thua atij të mos e hapë gojën aq shumë se ia nxjerrim „t'zezati mbi ujë“, e kështu me radhë.

*Diplomacia* - «Po u hoq ai, harroi kontratat me ne», kështu na tha një «miku» ynë se e paskëshin kërcënuar turqit Hashim Thaçin kur Hajredin Kuçi «dha» dorëheqje. Shpjegimi i informatorit «tonë» ishte ky: «Turqit Kuçin e kanë garanci në Kosovë se ai punon për ta». Ia futi kot gjë? Ne nuk i besojmë informatorit, të cilit as mjekra nuk ia zbut dhjamin pushtetar të fytyrës sa që si duket sikur vetëm me vinç arrin t'i ngrejë kapakët e syve. E dimë që ai është korruptuar nga «qeveritë» deri në sofër dhe ka mundësi t'a ketë thënë këtë version duke menduar se ne i dashurojmë turqit. Nga ana tjetër shumë njerëz që kanë pasur «fatin» të jenë prezentë në bisedat mes kryeqeveritarëve shqiptarë dhe atyre të huaj referojnë për një përlule fikane të burrshtetasve plisbardhë. «Shumë shpejt, ende pa dëgjuar mirë, tundin kokën si ato patat që zënë peshq...» kështu na nënçmoi një diplomat i BE-së (i cili simpatizon Tamilët për shkak të mirësjelljes përlulëse të tyre) korridoreve të Brukselit, kur ra fjala për dinjitetin e politikanëve nga Prishtina, Tirana dhe Tetova. Sipas tij, këtë ata e bëjnë sepse ndihen inferiorë. Ndërsa inferiorë qenkërkan sepse si zakonisht u shfaqkan gjithandej ose me strategjira infantile ose letra që fare qartë u duken gjurmët e kopjativës. Kur analizojmë protokollet dhe stenogramet ndërqeveritare përplasemi njëherë me injorancën dhe pastaj menjëherë me simptomat e minitiranëve arkaikë që çdo pyetjeje i përgjigjen buzagazshëm me refrenin: «në dorë i kemi, e rregullojmë». Moto që duket të jetë edhe esenca e realpolitikës shqiptare dhe që demonstroi më shumë nivelin e banditëve socialë fisnorë (Eric Hobsbawm) se sa të atyre politikanëve ma ca ditë shkollë fillore.

*Politika reale* - Nga luftërat e brendshme të dy partive më të mëdha kosovare PDK dhe LDK, nga betejat e brendshme që i shoqërojnë demokratët dhe socialistët e Tiranës dhe nga grindjet brendashqiptare në Maqedoni kemi mësuar shumëçka: Kemi mësuar se si nuk bëhet politikë; kemi mësuar se shqiptarët ende nuk kanë çizme për të kaluar shumë nga moçalet e tyre mesjetare; mësuam se mendimtarët e tyre jetojnë si ufot, si cybernautët dhe si fantazmat; mësuam psikologjinë e masave shqiptare, e cila gëlltit pa bërë gëk-mëk çdo fideizëm utopik; masat lebojnë çdo guru t'ua tërthurkojë trutë për t'ua flakur ferrave paradantike ; çdo ditë shohim politikanë intelektualisht impotentë që premtojnë, sharrojnë, vjedhin, harrojnë dhe burgosen; atë që siç duket shqiptarët – si masë dhe si individë – nuk e shohin e nuk e mësojnë (ose nuk e pranojnë dot nga dhimbja) është fakti se ata gjenden nën diktatin e tiranëve, despotëve, diktatorëve me psikograme nga më të çuditshmet që njeh historia e tiranëve të mëdhenj dhe të vegjël. Nuk ka analist dhe vëzhgues vigjilent që do ta mohonte dot faktin se luftërat brenda - e jashtëpartiake bëhen për shkaqe personash që shkelin qoftë edhe mbi kufoma për të ruajtur pushtetin që kanë zënë për fyti. Nuk ka luftëra rreth asaj se cili program social sjell më shumë të mira për shtresat e dërmuara shoqërore; nuk ka luftë se si të integrohet femra në shoqëri (me kuota apo pa to); nuk ka luftë se si të çlirohen universitetet dhe shkollat nga vartës prepotente semialfabetë që hiç më shumë se do semestra kanë kaluar universiteteve; nuk ka luftë se si ta njohin vendin e ri edhe më shumë shtete, por ka kërcënime ndër ish-shokë dhome të stilit «po e nguce edhe niherë Pacollin jep dorëheqje». Ka debate parlamentare kur kryeministri e kërcënon deputetin përkatës «ik ore se të [...] motrën». Ka fushata elektorale ku falanga nga Tetova dhe Zajazi kërcënojnë fshatarët me kallashnikovë. Ky është terreni real politik shqiptar.

*Tiranitë e etnosferës* - Të gjitha këto elemente të realpolitikës shqiptare janë mekanizma funksionale që përbëjnë diktaturën tiranike si model funksionimi. Tirani që për nuanca të caktuara ndryshon nga klasiket, pra ato të cilat dhunën e përhapur masive fizike e kishin mjetin efektiv të mbajtjes së pushtetit. Mirëpo nëse kalkulojmë duke shumëfishuar ekseset e përditshme do të kemi po të njëjtin total me ato të dhunës masive. Ndërkaq në format e tjera manifestative (psikike-manipulative, materiale, shpirtërore, përfshirëse dhe përjashtuese etj.) tirania shqiptare nuk dallon nga strategjia e cinikut të ç'iluzionuar dhe idealistit të diktaturës së përkryer Niccolò di Bernardo dei Machiavelli, i cili i shkruante shpjegueshëm princit se si ta keqpërdorte moralin, fetë, ligjet si fasadë për t'iu dhuruar masave një siguri të pavërtetë për hir të mbajtjes së pushtetit, me një fjalë për ta përjetësuar diktaturën si model e kulturë sundimi. Le të guxojë çdokush që mundet një analizë personalitetesh për Sali Berishën apo Edi Ramën, për Hashim Thaçin, Isa Mustafën ose Albin Kurtin, për Ali Ahmetin ose për Menduh Thaçin dhe sigurisht se nuk do të ketë rezultate ndryshe nga ato që pasqyrojmë këtu. Nuk do të hasë në ndonjë demokraci të brendshme, nuk do të hasë në shumëçka që do të rezultonte si arsye e mirëfilltë për të shpresuar, por vetëm defekte tiranësh të vegjël që përdhunojnë masat.

*Strategjitë e demoduara* - «Po kë ta zgjedh bre burrë?» na shkruante një miku jonë gjatë një bisede në facebook. Trilema e tij është karakteristike për gjendjen në të cilën gjenden shqiptarët: Ta zgjedhë tiranin e parë, të dytin apo të mos zgjedhë kënd – çfarë nënkupton njërin nga dy të parët. Revolucionet e stilit arab me instruktorë si Srdja Popoviç dhe Slobodan Dinjoviç, të cilët me një organizatë me emrin CANVAS (Centre for Applied NonViolent Action and

Strategies) mbajnë workshop-e gjithandej orientit e Ballkanit duke rifabrikuar strategjinë e Otpor-it serb që përmbysi Millosheviqin, po shihet se nuk pinë ujë. Albin Kurti mund të na këndojë edhe më zëshëm se Lepa Brena dikur, historinë e kësaj pune. Veçanërisht kur kemi parasysh modelin e veprimit politik të tij, i cili fatkeqësisht na ofron edhe një tiran më shumë sa që mund të durojmë. Jo pak lexues të nevrikosur do të na qortonin: ani çka atëherë? Dhe s'kemi përgjigje. Nuk është detyra jonë! Ne përshkruajmë, nuk japim urdhëra – do të mbroheshin gazetarët dhe gazetaret që përpiqen ta luajnë rolin e Mr. Nobody-t, po si Terence Hill në filmin e Tonino Valeri-t «Il mio nome è Nessuno» (1973). Mirëpo gazetarë të paktë në shtypin kosovar e kanë kuptuar drejtë gjendjen e shoqërisë ku jetojnë dhe protestojnë përditë me aq sa kanë valë në disponim. Po nuk i harruan njerëzit shpejt përmbajtjet e gazetave, atëherë do të shihnin se këtë pasqyrë e kemi akumuluar jo edhe pa ndihmën e gazetave të pavarura (pa përjashtuar as ato të opozitës dhe atyre të pushtetit që shërbejnë si organe vetëdenoncimi). Problemi më shumë qëndron te fuqia e tiranëve shqiptarë që nuk i tremb siç duket më asgjë. Ata paskan vendosur deri në vdekje të mos evolohen.

Intelektualëve nuk u mbetet gjë tjetër përveçse të veprojnë si profesori i Universitetit Princeton dhe udhëheqësi intelektual i «Occupy Wall Street», afroamerikani Cornel West që kërkoi nga çdo intelektual dhe gazetar që të «ulërijë aq shumë dhe aq qartë» pranë veshit të pushtetarëve që ata nga frika të ikin nga egotuneli i tyre tiranik. Ky është ai ish përkrahësi i flaktë i presidentit aktual amerikan Barack Obama që sot ligjëron gjithandej: «Obama është kriminel luftime» (Në një intervistë me Julien Charnay; 2012). Dhe në këtë kontekst ai nuk e ka fjalën si kriminel klasik luftime, por si kriminel i luftës për ekzistencë; sepse Obama gënjeu! Ai nuk realizoi as edhe njërën pikë nga programi i tij për nxjerrë



amerikanin e rëndomtë nga kriza disadekadëshe sociale. Sepse Obama «shkeli mbi fytyrën e Luther Kingut dhe çdo heroi tjetër me çizmet e tij prej një neoliberali të pangjyrë». Shikuar nga ky këndvështrim mund të pyesim se sa kriminelë lufte janë tiranët tanë? Sa duhet të ulërijmë ne që të tërmetojmë trutë e despotëve tanë për t'i nxjerrë nga ata egotunelet e tyre? Sa fuqi duhet të ketë zëri i intelektualëve shqiptarë që tu kërcejnë politikanëve tamponët nga veshët? Sa qartë duhet të flasin intelektualët që deri tani kanë shpëtuar të pakorruptuar? E dimë që Frederic Vester dhe Thomas Metzinger kanë më shumë se të drejtë rreth (r)evolucioneve sidomos në kontekst me shqiptarët; edhe apelin e Cornel West-it e kuptojmë drejtë. Çështja është se cilët intelektualë shqiptarë janë mbyllur në ndonjë skutë akademish për t'u djersitur duke menduar se si shqiptarët ta gjejnë portën hyrëse të evolucionit për të ikur nga tuneli 5028 vjeçar i Frederic Vester-it? Asnjë? Atëherë s'na mbetet gjë tjetër përveç Eskapizmit. (2012)

## *Pushteti dhe perversiteti*

Pushteti pervertet çdo njeri. Ai është diabolik thotë Cioran. Nuk ka pushtet të mirë apo të keq, konstaton Björn Kraus, por vetëm instruktiv dhe destruktiv. Si janë pushtetet shqiptare? Se pushteti dhe perversiteti janë binjakë e mësuam kësaj here “live” nga episodi i radhës i «Big Brother-it» me qeverinë kosovare. Më tepër se nga shumëçka tjetër njerëzit u irrituan nga perversiteti që protagonistët e politikës ia bënë idealit të tyre për shtet.

Ky çmontim i mitit të shtetit ndoshta nuk do të kishte shkaktuar kaq valë zhgënjimi sikur të tjerët përbrenda shoqërisë iluminueshëm të kishin sqaruar opinionin se me ç’pushtet do të kenë punë: Psikologët asnjëherë deri tani nuk janë marrë me psikogramet e figurave kyçe në pushtet, nuk kanë vizatuar dinamikën grupore e klanore të tyre; Sociologët dhe politologët u japin tëharrësve kosë plastike për të prerë nga faqedheu hithrat që me të madhe i prodhojnë strukturat e pushtetit (s’ka Power Structure Reserach), ata kurrë nuk na ofruan një analizë se si funksionojnë ato, se çfarë ndikimi ekonomik, politik e social kanë për shoqërinë; Pedagogët as gjëmimi i topave të ndryshkur rusë nuk i nxit që të analizojnë se ç’edukatë mbjellin veprimet e të të ashtuquajturave elita politike.

Listën mund ta vazhdonim me thujse çdo segment profesional e qytetar që pretendohet t’i shërbejë profesionit e detyrës së caktuar. Nuk ekziston pra një anatomi konkrete për atë se çfarë janë dhe si funksionojnë pushtetet shqiptare. E

«dimë» vetëm se ato funksionojnë keq. Nuk na intereson përse-ja e kësaj pune?

*Filozofia dhe pushteti* - Qysh në polemikën e Platonit me sofistët e kuptojmë një problem themelor teorik: filozofi antik papushtetshmërinë e pushtetarëve e sheh tek domosdoshmëria e tyre për të vepruar jo ashtu siç duan, racionalisht, por ashtu siç ju duket se do të ishte më mirë. Për kë dhe si do të ishte më mirë? Përkufizim fund e krye antagonist sapo hapim historinë dhe detyrohemi t'i bindemi konstatimit të Augustin-it nga Hippo se baza e çdo pushteti qëndron te kontrollimi i irracionalitetit të masave.

Augustin-i religjioz edhe pse keqpërdor tezën aristoteliane të «sundimit të të lirëve mbi të lirët» për të monopolizuar të drejtën e sundimit në adresë të Zotit (vetëm ky i fundit është i lirë dhe rezulton si „liri“) të tij e prognozoi një realitet që nuk iu hoq asnjëherë qafe humanitetit.

Historia ndërkohë e ka modifikuar tezën e Platonit në: Pushtetarët janë të papushtetshëm në të mirë! Mbërritëm tek realisti i të gjitha kohëve, i cili si duket do të jetë ideologu kryesor edhe i shumë pushteteve të sotme: Makiaveli u thotë sundimtarëve që të mos e çajmë kokën për autoritet e legjitimitet, sepse pushteti është diçka praktike, ashtu siç ligjëron edhe Thomas Hobbes tek «Leviathan»-i tij, veprim efektiv që realizohet me përqendrimin e gjithë pushtetit tek shteti – si individ abstrakt.

«Veprimin praktik» këta të dy e shohin tek monopoli i çdo force (dhune) nga ana e pushtetit, jo për diçka të keqe thotë Hobbes, por për të siguruar ekzistencën e homo lupus-it nga vetekzekutimi. Teori fisnike, por sakaq njëloj antagoniste si ajo e Platonit: nëse njerëzit nga natyra janë irracionalë, ujçer që mezi presin kanibalshëm ta zhbëjnë njëri tjetrin, çfarë janë ata që marrin pushtetin pra? Ufo?

*Homo homini lupus* - Veç në shekullin 19 diskurset filozofike bien nga qielli, përtokëzohen e bëhen më të kuptimshme sa i përket dëshirës se si duhet konceptuar (synuar) pushteti. Johann Gottlieb Fichte (më konkretisht se Kant-i) kushtëzon legjitimitetin e pushtetit me varësinë e tij nga drejtësia, respektivisht e sheh shtetin si produkt të një kushtetute republikane. Në vend të dhunës së monopolizuar vjen mekanizmi i kontratës politike mes shtetit dhe faktorëve kryesorë të shoqërisë civile (ideja e lindjes së sindikatave etj.).

Filozofia ia lanë borxhin shoqërisë dhe i jep një ideal në trastë. Max Weber as për një shekull nuk ia lejon ëndrrën banorit të «Leviathan»-it hobbsian: «Pushtet do të thotë të shfrytëzosh shansin e imponimit të vullnetit tënd përbrenda rrjetit shoqëror, përkundër çdo rezistence dhe pa marrë parasysh se në çfarë bazohet apo mundësi». Kjo i bie sikur ta kishim nxjerrë Makiavielin pas katër shekujve viteve prej varri. Rikthimi është djegës, por teorikisht real.

As teza e bukur e Hanna Arendt-it që thotë se «pushteti është bashkëveprimi i njerëzve të lirë në hapësirën politike në favor të shoqërisë» (Pushteti dhe dhuna) nuk na shpëton nga përvoja e pushtetit në praktikë. Edhe pse pushteti rishfaqet në të gjitha format e mundshme (është postpanoptik siç thotë Zygmund Bauman) një vijë të kuqe e mban përherë si flamur; perversitetin!

*Perversiteti i sundimit* - Nga teoritë më lart pamë se filozofia i ka kushtuar shumë pak vëmendje natyrës njerëzore si krijuesja dhe bartësja e pushtetit. Më tepër ajo është përpjekur ta studiojë atë krijesën abstrakte – shtetin. Meganihilisti i postmodernes, filozofi frankorumun Cioran në një bisedë me filozofin spanjoll Fernando Savater (1977) reflekton për thelbin e çështjes: «Besoje se pushteti është e keqja vetë, shumë i keq [...]. Kam njohur njerëz që u bënë me pushtet. Ishte diçka e tmerrshme [...] pyes veten si ka mundësi që një njeri

normal e pranon pushtetin. Padyshim sepse pushteti është kënaqësi, është ves. Prandaj nuk ka diktator që vullnetarisht tërhiqet nga pushteti [...] pushteti është diabolik. Djalli ishte thjesht një engjell që donte pushtet. Fiksimi për pushtet është mallkimi më i madh i njerëzimit». Cioran flet këtu për njeriun konkret. Me gjithë këtë njohje dhe reflektim të thellë Cioran nuk mund t'i kërkojë species me tru që t'i jepet anarkisë. Një hierarki, një rend është i paevitueshëm. Dhe në krye të kësaj hierarchie do të qëndrojnë gjithmonë njerëzit.

E ata njerëzit historikisht kanë qenë perversë në ushtrimin e pushtetit. Nuk ka nevojë të mbajmë ligjërata mbi atëvrasjet, incestet, vëllavrasjet dhe orgjitë e tjera antike për të skicuar karakterin e pushteteve antike. Nuk kemi nevojë të përshkruajmë mijëra librat që janë shkruar për diktatorë që nga mesjeta e deri te Hitleri, i cili mbante të kafazuar mbesën e vetë për ta keqshfrytëzuar si objekt seksual. Paranojën e Stalinit e mban gjallë Putini. Orgjitë dhe haremet e Berluskonit na bëjnë të qeshim me zor.

*Pyetje shqiptare* - Perversioni i politikës shqiptare manifestohet më shumë në pyetjet që kanë të bëjnë me njeriun, me personalitetet e jo me pushtetin si ansambël abstrakt: si ka mundësi që njerëz që thonë se deri dje kanë vepruar si komandantë të një lufte për të shpëtuar masën nga gjenocidi të korruptohen rëndë e rrastë sapo të ngjiten pushtetit duke eutanazuar dita-ditës sa më shumë po në atë masë? Si është e mundur që njerëzit të cilët krekosen sikur ata vetë ta kenë krijuar shtetin, pastaj rregullisht e përdhunojnë atë në çdo hap të veprimtarisë së tyre? Para së gjithash: Përse vallë shoqëritë shqiptare e lejojnë të ndodhë një trajtim të tillë? Si duhet të sillen ata kur pushtetet e tyre ia nxjerrin fundin popullit të vet me perversitetin e tyre, si ta mbrojnë veten?

*Vetëkontrolli në parademokraci* - Pikërisht për shkak se nuk ekziston garancia për karakterin e përkryer, – pra perversioni do të vazhdojë e jo vetëm në formë telefonatash që ndajnë joligjërisht vende pune – pushteti në pasmodernizëm që tipizohet jo në të mirë e të keq, por vetëm në instruktiv e destruktiv (Björn Kraus), mund të mbahet brenda kufijve të normales vetëm nëpërmjet atyre kontratave politike të Fichtes, atyre marrëveshje që bëhen mes kastave politike dhe sovranit (shoqëria civile, sindikatat, OJQ-të etj.) për të siguruar balancat e domosdoshme në shoqëri. Ndoshta ideja e hedhur qëmoti se demokracitë e brishta duhet që si vetëkontroll t'i delegojnë shoqërisë më shumë pjesëmarrje në politikë përmes referendumeve e iniciativave qytetare (demokracia direkte) do të ishte shpëtimi i vetëm i ruajtjes së shtetit nga përvetimi i tij.

Veçanërisht në këto kushte parademokracie kosovare pushteti del i paaftë për të operuar me strukturat e tij pa rënë ndesh vazhdimisht me ligjet dhe kushtetutën. Vetëm kështu me zgjedhjet elektorale nën buçimën e euforisë, turbopatriotizmit dhe dasmave publike po shohim se jo vetëm që nuk përparon, por edhe e përmbys shtetin e me këtë edhe shoqërinë sa më thellë në kriza. (2012)

## *Doktrina e «tokës së djegur»*

Ata erdhën, sunduan, grabitën çfarë mundën, dogjën dhe ikën – ka gjasa që ky të jetë konstatimi më i shpeshtë i historianëve të nesërm mbi pushtetet shqiptare të 25 viteve të fundit.

Gjatë e pas çdo sezoni elektoral kontinentalëve të perëndimit iu dridhen gjunjët nga frika se ç’do të ndodhë kësaj radhe tokave të kryemëdhenjve me plis? Do shkatërrohen depot e armëve si dikur? Do t’ia mësyjë opozita shesheve e kabineteve për të marrë pushtetin me dhunë ngaqë humbi zgjedhjet? Do t’i burgosin pushtetarët e rinj paraardhësit e tyre?

Kronika e ndërrimit të pushteteve në periudhën passocialiste shqiptare na e trashë edhe më tepër tezën që thotë se partitë politike shqiptare funksionojnë sipas mentalitetit të ngritur mbi taktikën politiko-luftarake të «tokës së djegur».

*Origjina* - Si praktikë luftarake, historikisht «djegia e tokës» iu atribuohet keltëve, të cilët në luftë me ushtrinë romake në frankosferë, para se të kapitullonin apo largoheshin digjnin grurin, misrin dhe kulturat e tjera agrare për të dëmtuar ekzistencën jo vetëm të ushtrive pasuese, por edhe të vetë banorëve autoktonë. E njëjta taktikë lulëzon – si strategji postluftarake – gjatë mesjetës.

Para çdo shpërngulje të legjioneve, një divizion i caktuar ushtarësh të specializuar kryenin helmimin e puseve, djegien e rezervave me drithë, shkatërronin hapësirat agrare dhe

gjithçka që i shërbente «ekonomisë elementare» të rajonit për mbijetesë. Ose më së voni njihen botërisht edhe asgjësimet brutale të duos tiranokriminele të Luftës së Dytë Botërore, Stalinit dhe Hitlerit.

Dy javë para marshimit të nazistëve gjermanë, Stalini urdhëron armatën e kuqe që të hedh në erë ura, fabrika e punëtori, të digjen rezervat dhe të helmohen të gjitha burimet e ujit në lindjen e Bashkimit Sovjetik. Të njëjtën metodë e urdhëron edhe Hitleri gjatë humbjes së betejës rreth Stalingradit me ç'rast urdhëron jo vetëm djegien e të mirave materiale, por edhe deportimin e të gjithë njerëzve të moshës 15-65 dhe vënien zjarrit të fshatrave, qyteteve dhe çdo elementi tjetër infrastrukturor.

*Shembujt aktualë*- Këto shembuj të historisë i kanë shërbyer politologjisë që ta identifikojë një metodë, e cila për nga «materializimi e finalizimi» nuk ndodh si në mesjetë apo si në epokën stalino-hitleriane, por që si doktrinë dhe efekt (madje edhe me një potencial edhe më perfid) vazhdon të përdoret jo vetëm nga shtetet ekspansioniste, por edhe nga kontrahentë politikë brenda një sistemi.

Rëndom vendeve të Afrikës, Azisë, atyre të Lindjes së Mesme (Libia, Egjipti janë rastet më të freskëta) asnjëri regjim nuk ia del të zëvendësohet nga tjetri pa ia vënë flakën vendit dhe pa burgosur apo ekzekutuar klasën pararendëse qeveritare.

Etnologu i njohur austriak Karl Kaser (Pushteti dhe trashëgimia: 2000) mbetjen e një mentaliteti të tillë në pasmodernizëm e lidh me kontinuitetin ose ngecjen e shoqërive parademokratike në organizimin strukturor tribal, patri - ose matrilinear. Ndoshta studiuesi austriak ia lehtëson vetes hulumtimin duke gjetur paragjykimin më prominent që përdoret gjatë përshkrimit të shoqërive ballkanase e më gjerë se përse ato edhe deri më sot kanë mbetur peng e një mizorie



të tillë johumane siç është kjo e «tokës së djegur», argumentet e tij pra – që janë veç një fajësim i traditës, ritualeve dhe miteve aktuale, por me data mesjetare – megjithatë ulërijnë nga kontradiktat sapo të vëmë në përdorim origjinën e metodës dhe praktikimin e saj historik.

Në këtë përpjekje e sipër ndeshemi jo me tradita e mentalitete arkaike, por më shumë me një mendësi primitive që nga kohët e lashta të cilën ndërkaq si doktrinë dhe sistem e hasim herë denoncueshëm e herë favorizueshëm tek Erasmus-i, Morus-i, Machiaveli, Botero, Bodin-i, La Bowtie e shumë filozofë themeltarë të mendimit kontinental. E këta të gjithë e deri tek pak filozofë të sotëm, mbijetesën e taktikës së «tokës së djegur» e lidhin me karakterin e korrumpuar dhe klanokratik të shtresave në pushtet, çka është edhe shumë më logjike sepse po të ishte ashtu siç thotë Kaser, atëherë do t'i binte sikur shqiptarët nga dëshira dhe mendësia do të donin që t'i qeverisin pushtetet që ecin edhe mbi kufoma për ta ruajtur pushtetin. Apo është vërtet kështu?

*Shqiptarët e «trurit të djegur»* - Është rëndë të argumentohet nëse Sali Berisha (Lufta civile), Fatos Nano, Edi Rama (Protestat me viktime) kanë qenë vetëdijshëm të prirë nga kjo mendësi e shtet-djegies sa herë që kanë fituar pushtetin, mirëpo nga rezultatet dhe nga situata ku gjendet shteti shqiptar, i cili nuk lëviz nga vendi në drejtimet më të domosdoshme të konsolidimit të tij, mësojmë se qeveritë janë Hadi i saj, respektivisht ikja shkatërrueshëm nga pushteti dhe ardhja demonizueshëm e sanksionueshëm në pushtet. Të njëjtën situatë tash e kemi edhe me qeverinë në ikje të Kosovës. PDK fitoi zgjedhjet, mirëpo për shkak se shumica parlamentare (legjitime) u krijua nga të gjithë relevantet të tjerë dhe pa eksponentë të saj, filluan publikisht të thyejnë nofka e dhëmbë me «luftë civile», konflikte e të ngjashme

duke kërcënuar kështu drejtpërdrejtë shtetin dhe demokracinë ende të njomë kosovare.

Dhe atë për çfarë vallë: për pushtet! Për asgjë tjetër. Duke njohur biografitë e plot eksponentëve të kësaj partie gjatë dy legjislaturave të fundit dhe duke pasur parasysh qeverisjen në dy mandate të lind me të drejtë teorizuese argumenti që thotë se motivi i «tokë-djegësve» politikë është klanokratik dhe antidemokratik e jo për arsye të mendësisë apo shkaqeve tjera. Nëse partitë kosovare – pa përjashtim – vazhdojnë me këtë taktikë morbide, atëherë do të kemi Kosovën edhe pas 30 viteve po në këtë stad ku gjendet Shqipëria – me medaljen e varur në qafë si vendi më i varfër dhe më i prapambetur i rajonit.

Ose të dyja bashkë do të konsiderohen si muzeu kontinental i trurit dhe jo vetëm tokës së djegur! (2015)

*Metaforat e linçimit*

Gjatë zgjedhjeve ka shumë racizëm. Jo pak parti dhe politikanë veprojnë me shpifje, linçime në baza grupore, etnike. Ndërkohë që ata e kanë vetëm për votë, njerëzit infektohen ndoshta përgjithmonë me viruset shpejt-përfshirës e rëndë të çrrënjoshëm të urrejtjes!

Degradimi i tjetrit si i paaftë, pa kapacitetet e nevojshme për të qeverisur, është pothuaj mesazhi i çdo metafore elektorale që përdorin partitë gjatë garës së tyre për pushtet. Asgjë e re dhe aspak tipike ballkanike. Partitë e mëdha sferës perëndimore të kontinentit shërbejnë po me të njëjtën teknikë manipulimi të masave: hiperbolizim i përparësive të programit personal në disfavor të konkurrencës. Deri në fillim të viteve të 90-ta edhe «shpifjet» dhe përshkrimet më të rënda të tjetrit e tjetrës nuk kalonin vijat e kuqe të kulturës së komunikimit publik: d.m.th. ato nuk ishin të personalizuara; nuk diskriminonin dhe fyenin në baza biogjenetike, kulturore, sociale e të ngjashme.

Pas viteve 90-ë, me themelimin e partive kryesisht të djathta, neokonservatore dhe nacionaliste, hapësirat e komunikimit publik u shndërruan në fabrika të përjashtimit, nënçmimit, poshtërimit, diskriminimit. Jo vetëm shtabet qeveritare dhe ato të OJQ-ve i zuri paniku, por edhe mediat, të cilat madje mbanin mbi shpatulla gjysmën e fajit në procesin e ndotjes masive të diskursit politik me racizmin në të gjitha format e tij manifestative, atë që e përçonin nga retorika e ksenofobëve për në trutë e qytetarëve.

*Historia* - Problemi është po aq i vjetër sa edhe vetë politika. Dhe ai nuk është vetëm produkt i urrejtjes që buron nga primitiviteti i dykëmbësorëve gjatë mundit të tyre për t'u humanizuar, por është programatikë që përbën një filozofi më vete; herë si teknikë, herë si botëkuptim e herë si metodë e djallëzuar manipulimi për skllavërim të masave. Madje baza e strategjisë së ekskluzionit vjen nga kuzhinat e atyre kryekokave që ne i konsiderojmë të jenë gjenitë e qytetërimit, atyre që i riprodhojmë pandërprerë edhe sot e kësaj dite. Aristoteli në kapitullin e 6-të të librit të 7-të të veprës së tij «Politika» jep recetën, e cila do të vlejë si formulë e gjitha aventurave të mëvonshme kolonizatore eurocentriste. Aty, ai duke bërë një kategorizim të caktuar, thotë se popujt e zonës së acartë (hapësira siberiane e karpateske e Europës deri në vendet e sotme nordike) janë trima mirëpo sidoqoftë trushkretë, prandaj shpejt e fitojnë luftën mirëpo dalin të padenjë për t'i sunduar fqinjët. Popujt aziatikë sipas tij, janë plotë art në shpirt, mirëpo shpirt-frikacakë kështu që mund të ekzistojnë vetëm si skllav dhe në shërbim të tiranëve. Grekët (e shkuara e të cilëve sot merret si baza frymore e Evropës) ndërkaq i paskëshin patur të gjitha vetitë për t'i sunduar të tjerët.

Ky program aristotelian do të bëhet inspirimi qendror edhe i Makiavelit për të zgjeruar doktrinën me përpikmëri (Princi) në favor të intrigës, teknikës së përsosur e djallëzore për kapjen e turmave. Në këtë vijë do t'i ndërtojnë metaforat e tyre të përjashtimit edhe ata të anës së kundërt (tejojksidentale). Metafora e «Pallatit të kristaltë» të Fjodor Dostojevskit në romanin «Shënime nga nëntoka [bodrumi në fakt]» (1864), nëpërmjet së cilës ai përshkruan «Ekspozitën Botërore» të Londrës së 1851 si seli të demonëve perëndimorë është pikërisht e kësaj mendësie. Ekspozimi i perëndimorëve, në metaforë, si klub ekspansionistësh që nëpërmjet parasë

duan ta përfytyrin botën, i përkon kësaj tradite ekskluzioniste të paraqitjes së tjetrit si defektiv, raketik, si destrudo dhe e keqja e lirisë.

Kjo formë metaforizimi, në kushtet e shoqërive ballkanike, natyrisht se edhe sot, në shek. 21, prodhon format më të egra të racizmit dhe linçimit publik, sidomos për shkak se ideologët, partitë dhe politikanët ende përdorin teknikën e militarizimit të ndjenjave të vartësve të tyre nëpërmjet elektrohokëve bioetnikë, racorë e të ngjashme..

*Praktika* - Si duket kjo formë e shpifjes ndaj tjetrit në realitet: Kur X politikani thotë se «Y» konkurrenti i tij qenkërka enverist apo titist në kokën e shumicës së shqiptarëve shpërthen një ortek imazhesh e përfytyrimesh që u kujtojnë gjindjes së vuajtur varfërinë, kampin e Burrelit, Spaçit, Idrizovës, Goli Otokut, vuajtjen për bukë, izolimin, ndalimin e gjuhës, flamurit, burgosjet e gjëra të tjera të këtij lloji. Edhe pse e dinë fort mirë se të gjitha këto nuk kanë aspak të bëjnë me personin konkret, metafora e kryen efektin e vet dhe perceptuesi krijon paragjykimin përkatës; tjetri pra qenkësh vetë rreziku i mirëqenies dhe lirisë së popullit, frika për identitet-humbje dhe demobilitet ia heq masës popullore dheun nën këmbë. Edhe më brutalisht ndikojnë metaforat e tilla kur u adresohen grupeve, kulturave, shtresave. Nëse agjitorët e një partie strategjinë e tyre elektorale e ndërtojnë mbi shpifjet ndaj një grupi të caktuar, ta zëmë, turqit në Maqedoni (qëllimisht merret një grup jo i shumicave etnike) dhe thotë: «Për shkak të tyre nuk mund të hyjmë në BE, sepse ata mbajnë demonstrata pro shteteve të huaja, kundër demokracisë dhe qeverisë sonë, akuzojnë duke gënjyer se nuk i gëzojnë të drejtat elementare njerëzore, duan që kryetari i shtetit tonë të flasë turqisht dhe se vetëm uniteti ynë i lë ata jashtë ndikimit politik», atëherë në kokat e të papunëve, të kufizuarve në lëvizje botës pa viza, automatikisht krijohet

fajtori i gjendjes ku mezi gjallojnë. Fajtorë, që në vijim do të jenë edhe sajuesit me fytyrë konkrete të frikës për ardhmëni, për «turqizim» të shtetit, për humbje identiteti, për mos-hyrje në BE, NATO e kështu deri në pafundësi.

Ndërkohë që synimi i politikave është – qoftë drejtuar individëve e qoftë grupeve – që nëpërmjet këtyre metaforave t’ua marrë votën njerëzve dhe pastaj të nisin pushimin e paguar në pushtet, teksa gjendja e të infektuarve dhe të atakuarve përkeqësohet pandalur: diskriminimet, urrejtja, frika nga tjetri, eksetet, mosdurimi i verbojnë, bllokojnë njerëzit, i bëjnë masat të paafta për të korrigjuar qeveritë dhe politikat në favor të të drejtave dhe mirëqenies së tyre.

Në këtë «rreth djalli» gjenden shoqëritë ballkanike sot.

Si e zgjidhën të tjerët këtë problem?

*Zgjidhja* - Paralelisht me sallonizimin e ekstremit të djathtë qeverive të Perëndimit, u aktivizuan edhe qendrat akademike në analizim të arsyeve që sollën tjetërsimin proracist diskurseve publike politike. Brenda 20 viteve të fundit janë bërë qindra studime të afirmuara rreth natyrave të shumëllojshme të përjashtimit. Një përmbledhje kompetente e rezultateve të këtyre studimeve dhe preferencave gjendet në vëllimin e dy profesorëve politologë të Universitetit Chemnitz Eckhard Jesse dhe Tom Thieme me titullin «Ekstremizmi në shtetet e BE-së» (Wiesbaden: 2011). Aty mësojmë për faktorët që normalizuan gjendjen këtyre pesë viteve të fundit. Faciti i veprës shkencore është deprimues, sepse nuk e shpall preventivën si shkakun kryesor në iluminimin e politikës që mos të jetë fabrika e urrejtjes, përjashtimit dhe shpifjes, por sanksionimin, ligjet. Që nga viti 2005 e deri më sot pothuaj të gjitha vendet e perëndimit i kanë ashpërsuar ligjet mbi racizmin edhe si krim verbal.

Vetëm në Zvicrën – si më të dalluarën në këtë drejtim – e stërdemokracisë, brenda 5 viteve janë dhënë dhjetëra dënime,

sanksionime e vërejtje ndaj partive, politikanëve dhe mediave që kanë shkelur ligjin kundër racizmit. Dhe situata vërtet ka ndryshuar pozitivisht. Çfarë nuk do të thotë se janë çrrënjosur frustrantët që gëlojnë në çdo shoqëri, porse dënimet arkazbrazëse të partive dhe politikanëve ndikuan aq shumë saqë partitë që politikën dinë ta bëjnë vetëm duke prodhuar metafora urrejtëse kanë filluar të flasin në një mënyrë të atillë saqë as vetë nuk i kuptojnë dot fjalët e veta.

Duke patur parasysh situatën jetësore në shoqëritë e posadalura nga diktaturat e luftërat, si dhe duke njohur përvojat e të tjerëve se si u sollën me këtë problem, atëherë e para gjë që BE do të ishte dashur të kërkonte si kriter themelor nga këto shoqëri do të ishte që «ta vënë gojën e tyre nën kontroll», pikërisht nga frika se mos i kap mat ligji i ashpër kundër racizmit. Ndryshe njeriu duket nuk mësuaka as në kohë të lindjes e as të perëndimit, as të jugut e as të veriut.

*Festë psikozash*

Kush i vrau aktivistët e partive të ndryshme kosovare para, gjatë e pas luftës? Njëra palë thonë se ata u ekzekutuan ndër veti. Pala tjetër akuzon funksionarët e partive të tyre: për të ruajtur fshehtësitë personale ata paskan eliminuar kolegët, dëshmitarët dhe gjithë tjerët që kanë pyetur për çështje, atëherë tabu. I treti grup beson që dorasët të jenë agjentët e shërbimeve të fshehta.

Nga i morën gjithë këto miliona politikanët e sotëm, ata ish-skamnorë që përvajshëm ligjërojnë se para dhe gjatë luftës paskan vuajtur edhe për ca dinarë, të braktisur pyjeve, pa cigare, me një plumb në pushkë, e që deri dje mundimshëm e nënshtrueshëm mezi paskan siguruar bukë për vete e për fis?

Është vjedhur “trepërqindëshi” apo çdo gjë është shpifje shpirtkeqësh? Janë përvetësuar hajdutërisht milionat e fondit “Vendlindja thërret” apo “krahu i paqes” nuk do të mbetet i vetmuar qelive, nesër e tutje, dhe akuzon për të njëjtën gjë “krahun e luftës”?

Janë këto neuroza e psikoza posttraumatike, të rezultuara si pasojë e robërisë, luftës së fundit ashtu sa për t’ua nxirë qëllimisht kosovarëve lirinë? Sidomos kur shihet se këto “çështje të hapura” janë njëri nga përrënjtë kryesorë që furnizojnë shtresa e taborrë me mllef, janë pra katalizatori i depresionit **permanent** të masave, i cili “rastësisht” intensifikohet saherë të jetë nevoja për të sabotuar tema tjera “të përkohshme”, trajtimi i tyre del i domosdoshëm. I përdorin koka të caktuara, të zgjuara, demoniake këto



neuroza me synimin për të manovruar me frymën dhe dinamikën e masave dhe të mediave, për t'i mbajtur ato nën kontroll, apo gjithçka është pjesë e natyrshme e një politike të korrumpuar, të paafte dhe regresive?

## II.

Këto tema përçapen gjithandej dhe nga gjithkush, qysh para lufte. Janë armët dhe arsenali më i shpeshtë i partive të ndryshme gjatë kampanjave të tyre për të akuzuar kundërshtarët. Mirëpo, politika asnjëherë nuk ka shfaqur interes serioz (si pozitat ashtu opozitat) për të bërë diçka konkrete në trajtimin e tyre. Përkundrazi; është bërë e kundërta dhe janë përheshtur si “legjenda analistësh bjerrakohës”, të cilëve u mungojnë idetë për zbatimje pak më kreative në kohë pushimesh.

Deri më tani edhe mediat janë dëshmuar jashtëzakonisht joserioze karshi këtyre “neurozave”. Herë pas herë ndonjë gazetar ka ndezur opinionin me ndonjë dokument të falsifikuar, të lëshuar klandestinç, enkas nga primatët në konkurrencë për t’ia nxirë datën njëri tjetrit, mirëpo jo më shumë.

Dokumenatët e “Zona Express” të Leonard Kerqubit sollën shkëlqyeshëm përmasat, afektin, demoralizimin që këto çështje e injektojnë në psiken e masave saherë të trajtohen ato publikisht. Temat duket sikur të jenë përforcuar në një agregat dis-sinergjishë, në një lloj destruktori që prodhon fragjilitet, labilitet, huti dhe neurozë masive .

Dokumentarët ashpërsuan mllëfin e masave edhe më tepër, edhe ngase ato përballën shtetin, shoqërinë, partitë dhe opinionin me grupe faktesh që nuk i ndryshon më kush dot:

1. Akuzat nuk janë të pabaza. Keqpërdorimet kanë ndodhur. Vrasjet poashtu. Njerëzit e pasuruar nuk dëshmojnë me asgjë serioze milionat e tyre, përkundrazi shihet se janë siguruar jolegalisht.
2. Askush nuk ka punuar për të zbardhur këto çështje pasi jo vetëm indikacione e dëshmitarë ka mjaftueshëm, por edhe adresat ku mund të sigurohet materiali i nevojshëm janë të qasshme.
3. Masat janë më tepër se të ndjeshme në këtë drejtim, prandaj shtresat dhe taborët janë kaq të armiqësuar ndërmjet veti, saqë ndikojnë drejt një psikoze, acarimi dhe bllokimi të shoqërisë në perceptimin e probleme ndryshe nga se ç' ndodhë – në mënyrë vetëdemoluese!

### III.

Si sillen protagonistët, të pandehurit kur përballen me këto çështje delikate. “Për momentin nuk muj me folë”, thotë njëri. Tjetri: “S’ka raporte. S’jam unë, pyetni tjerët”. I treti: “Arkëtari gjendet në amshim, prandaj s’po di”. “Pasurinë e kam nga gjyshja», thotë i katërti dhe kështu, absurdi, respektivisht tallja, s’kanë fund. Këto qëndrime mund të interpretohen vetëm në dy mënyra: a) Të intervistuarit janë me aftësi të kufizuara perceptimi dhe nuk e kuptojnë rëndësinë e problemeve ose b) veprojnë sipas modelit të kriminelëve të mençur: kallëzoj, pranoj vetëm aq sa dinë ndjekësit e mi, gjithçka më shumë kushton një vit më shumë qëndrimi në burg!

Kështu ngase në procese pandehjesh publike s’ka “nuk muj me folë” se lufta ka mbaruar qëmoti, dhe nëse në krye të vendit gjenden të inkriminuar atëherë ata duhet rrëzuar për hir të deblokimit të shoqërisë dhe të ardhmes së vendit. Po këtu nuk është çështja.

#### IV.

Pse masat dhe mediat janë kaq të fiksuara në këto të bëma të së djeshmes, pse nuk çlirohen prej tyre dhe të shikojnë përpara? Sepse nuk funksionon drejtësia dhe shumica absolute ka përshtypjen se “hajdutët” e djeshëm të jenë “primatët e tyre të sotëm”. Përbrenda kësaj mendësie nuk kemi elemente të ndonjë psikoze që mund t’i shpjegojmë me modelin e “*Contagion theory*”-së (infektimi gati hipnotik i masave me kauza grupesh e individësh) së Le Bon-it, Freud-it apo me teoritë e Clark McPhail-i dhe Norris Johnson-it për të konstatuar se kemi të bëjmë me panikë irracionale të masave gjatë kolizionit me të kaluarën e tyre ose me ndonjë frikë të përkohshme, ndonjë trend të sajuar enkas për t’i manipuluar masat për synimet e caktuara të ndonjë grupi, doktrine apo shtabi fashistësh. Totali i shqisave të masave është krejtësisht normal dhe konform natyrës së saj.

#### V.

Gjatë analizës së politikës në këtë kontekst lehtë lind dyshimi: partitë, grupet dhe individë të caktuar të besojnë se ekzistojnë psikoza e neuroza, të cilat mund të shfrytëzohen për nevoja të politikës ditore. Ata sillen në atë mënyrë sikur t’i përdorin këto psikoza për të spostuar vëmendjen në kohë që ato i konsiderojnë si kriza të cilat rrezikojnë ekzistencën e tyre në pushtet, apo si faktorë relevantë në politikë. Prandaj pyetja që parashtrojmë në fillim se “a i përdorin koka të caktuara, të zgjuara, demoniake këto neuroza me synimin për të manovruar me frymën dhe dinamikën e masave dhe të mediave, për t’i mbajtur ato nën kontroll, apo gjithçka është pjesë e natyrshme e një politike të korrumpuar, të paaftë dhe regresive?”, merr këtë përgjigje: Partitë dhe politika në përgjithësi gabimisht e trajtojnë mllëfin e akumuluar të

masave si psikozë irracionale në konto të manipulimit të tyre brenda politikës ditore. Revolta është e arsyeshme dhe ka kontinuitet vertikal dhe si e tillë do të bëhet sot a nesër varri i çdonjërës parti nëse ato nuk angazhohen seriozisht për të eliminuar me kohë eksponentët e tyre të inkriminuar dhe nuk veprojnë në përputhshmëri me kërkesat e masave për t'i trajtuar dhe mbyllur (së paku ligjërisht) këto çështje që përfolem. As për higjienën mentale të shoqërisë e as për të ardhmen e vendit dhe të partive, nuk ia vlen që të mbahen gjallë këto “psikoza”, vetëm sa për të mbrojtur hallkat dhe individët e korrumpuar brenda vetes. Askujt nuk i vlen një politikë që problemet e masave i trajton si psikoza, kur ato nuk janë aspak. Për rrjedhojë, si psikodefektë, pas kësaj analize, dalin vetë partitë dhe politika, që besojnë se një shtet, një vend, një shoqëri mund të mbahet peng me këtë lloj sjelljeje! (2016)

## *Paradat e irracionalëve*

Nga mënyra se si komunikojnë politikanët shqiptarë me masën mësojmë hartën e tyre mentale, synimet dhe esencën e veprimtarisë së tyre.

Në një intervistë dhënë revistës «Der Spiegel» (1969) njëri nga etërit e «Shkollës së Frankfurtit» Theodor W. Adorno tha: «unë bëra një teori kritike mbi proceset shoqërore dhe kurrë nuk më shkoi mendja se njerëzit do përpiqen ta realizojnë atë me koktej molotovi». Ky aludim iu adresojë studentëve të vitit 1968, të cilët edhe me dhunë donin ta përmbysnin qeverinë. Kishin keqkuptuar studentët ligjëratat e Adornos, ato lexime programatike që ndërtoheshin mbi pyetjen «a mund të jetohej pas Auschwitz-it? Jo pak analistë të kohës e mbrojnë Adornon me tezën e «pakontrollueshmërisë dhe irracionalitetit të masave».

Kjo diagnozë që «shpëton» Adornon nga përgjegjësia vjen nga kryevepra e José Ortega y Gasset, respektivisht nga studimi i tij i njohur «La rebelión de las masas» (Madrid 1929; Rebelimi i masave). Ky rehabilitim mirëpo ndez vetëm nëse qysh në kapitullin e parë na errësohen sytë nga kokëdhimbja dhe flakim librin në sirtar, pa u ndeshur me të ashtuquajturën «hipoteza Ortega». Filozofi spanjoll zhvillon këtu një hipotezë për të përshkruar përparimin dhe zhvillimin e një shoqërie. Ai thotë se përparimi në dije dhe shkencë nuk bëhet nga ky apo ai gjeni, por është më shumë rezultat i hapave të vegjël, pra i gjithë asaj mase shkencëtarësh mesatarë që bëjnë zbulime gati të padukshme. Le ta rrotullojmë këtë hipotezë duke ia dhënë përmasën universale dhe e (keq)përdorim në

aspektin politik: krijimi i një bindjeje që shtyn masat në veprim nuk bëhet nga ky apo ai «ideator», por nga një zinxhir sugjerimesh që i lëshon një elitë e caktuar.

Një shembull nga terreni shqiptar:

*Kur primatët flasin* - Kryeministri kosovar Hashim Thaçi gojëplotë e gishtkrekosur porositi «mos na i ngucni vëllezërit në Preshevë». Pas tij u ndezën bisedat dhe epidemishëm u aktivizuan politikanë e intelektualë, analistë, kollumnistë e hobiopinionistë për të akuzuar – me të drejtë – agresionin aktual e tradicional serb. Ademi Demaçi thirri shqiptarët e Luginës në një sondazh publik për t’iu përgjigjur pyetjes se a «duan luftë», respektivisht të vendosin sa më shpejtë që ai me shokë ta organizojë agjendën që me kohë t’i mprehë bajonetat. Thirrjet e intelektualit dhe shkrimtarit preshevar Naser Aliu «Dëgjo Preshevë» mediave të ndryshme shqiptare nuk ndikoi që problemi të trajtohet me racionalitet dhe pa histeri. Klubi Politik i Studentëve të Prishtinës organizoi një marsh të dinjitetshëm e paqësor rrugëve të Gjilanit me mesazhin e qartë «Lugina është Kosovë». Daçiçi e shkuli lapidarin si një bagren dhe –sipas shqiptarëve – ua hodhi imamëve të ndonjë xhamie në oborr. Vazhdon histeria. Kërcënimet e aspirantëve të vjetër e të rinj për pushtet vazhdojnë të na prishin nerva e vesh. Pragmatikët duarpërjetë thonë: silence!

Këtu ne nuk duam të gjykojmë kauzën e Luginës e as se a janë veprimet e masës kosovare në këtë çështje të nevojshme, të drejta apo jo. Kjo kronikë na shërben për t’i bërë diagnozë formës së komunikimit që vë në lëvizje masat. Tash parashtrrohet pyetja: çka nëse grupe të pakontrolluara dhe radikale nga masa i gjejnë ca kallashnikovë të ndryshkur dhe ia mësyjnë Luginës? Do të dalë nesër Thaçi në televizor dhe do të thotë «unë thash se duhet t’i mbrojmë vladimirat e Luginës tonë ama jo kështu me molotov e me

kallashnikovë?». Do të bërtasë Adem Demaçi plot mllef duke thënë «në fillim me pyetën ama pastaj nuk më dëgjonin dhe vendosën krye në vete si ata në Rambuje?»

*Në luftë, po si?* - Theodor Adorno nuk mund t'i ikë përgjegjësisë. Ashtu siç thotë Ortega në hipotezën e tij për shkencën vlen edhe në çdo segment tjetër të një shoqërie. Veprimet e masave janë kryesisht vepër e teorive dhe komunikimit të elitave të caktuara. Po e njëjta dinamikë e shembullit shqiptar u zhvillua edhe në «protestat» e 68-ës. Edhe atëherë kur perëndimit ishin bërë të njohura të zezat staliniste ikte Sartri atje për të lutur Bashkimin Sovjetik «të ndikojë» edhe më shumë për ta shpëtuar Perëndimin nga degjenerimi total kapitalist. Po të studiojmë paraqitjet publike dhe ligjëratat e Marcuse, Horkheimer, Adornos, Sartrit dhe pjesës dërmuese të elitave të asaj kohe do të shohim pa shumë mund se në to ulërinë kërkesa për ndryshimin radikal të sistemit. Ka mundësi që po e njëjta elitë nuk ka kërkuar eksplicit që ndryshimi radikal të bëhet me koktej molotovi, mirëpo ata as nuk treguan se si bëhet një gjë e tillë praktikisht, në terren përballë policëve dhe shtetit.

*Racionaliteti i masës* - Kështu siç nuk tregon as Demaçi, Thaçi dhe gjithë apellantët tjerë që kërcënohen se si duan ata t'i ndihmojnë vëllezërit e tyre të Luginës. Elitat evropiane atëherë kishin së paku teori, politikanët shqiptarë jo që s'kanë teori, por si duket as që kanë kapacitet për të gjykuar përgjegjësinë që kanë gjersa komunikojnë me masat. Përndryshe nuk do të shpërndanin tamtame pseudopatriotike për të cilët nesër as llogari s'duan të japin. Kjo s'është hiçgjë tjetër përpos keqpërdorim brutal i lirisë dhe pozitës në disfavor të ekzistencës së tjetrit; ndryshe nuk ka si kualifikohet një «apel» që nesër mohohet të ishte i tillë siç ishte. Këtu nuk kemi të bëjmë me irracionalitetin dhe pakontrollueshmërinë

e masave, por me një irracionalitet të egër të elitës politike kosovare. Manipulim dashakeq? (2013)



## *Politika e vetëpërrjashtimit*

Qytetari kosovar është i detyruar ose ta pranojë njërën nga të «vërtetat» e partive ose të nis ta urrejë vendin ku jeton. Ai që nga distanca i dëgjon të gjithë se si flasin për njëri tjetrin përballet me një Kosovë ku sundon mafia, krimi, paramilitarizmi dhe demagogët më primitivë të planetit. Historia e një vetëpërrshkrimi.

Një indian plak që jo vetëm se thithë por edhe hanë duhan. Kërcen nga drunjtë, nga shpellat, del papritmas nga uji ose nga ndonjë gërmadhë bërlloku dhe u hidhet në fyt njerëzve që kalojnë rastësisht atypari. Kur i fut armiqtë e tij në duar i masakron ngadalë me skalpel. Kështu përshkruan Karl May Winnteou-në në tregimin e parë të tij, në vitin 1875. Ky imazh është pasojë e asaj politikës eurocentrike që poshtëronte format e huaja kulturore me qëllimin për të justifikuar moralisht ekspansionet e kolombëve dhe vespuçëve. Edhe pse Karl May në romanet e tij me Old Shatterhand do ta estetizojë Winnetou – në deri në atë masë sa që aq lehtë dashurohet çdo femër oksidentale në të, shumicën e veprave të tij – dhe të tjerëve – atëherë e më vonë i përshkon kjo perspektivë poshtëruese narrative. Kjo metodë nënçmimi e «tjetrit» edhe sot është pjesë e pandashme e biografisë mentale evropiane, oksidentale e që do shekuj mund të pranojmë se metoda suksesshëm meriton statusin universal.

## I. TEORITË

Vitin e kaluar dolën dy studime kapitale rreth këtij problemi: Shkencëtari nga Universiteti i Hagenit Thomas Bedorf botoi librin «Tjerët» dhe sociologeja Sina Farzin e Institutit për Sociologji në Bremen nxori hulumtimin «Retorika e ekskluzionit». Përderisa i pari përshkruan historinë filozofike të konceptimit dhe perceptimit të «tjetrit» (*generalized other*), Sina Farzin konkretizon problemin e «tjetrit» (*other minds*) jo si problem ndër kultura, por si fenomen brenda shoqërive demokratike të perëndimit. Ajo analizon retorikat politike për të sjellë konstatimin se pse një praktikë e tillë ekskluzioniste jo vetëm që bllokoi jetësimin pozitiv e demokracive pluraliste, por edhe i rrezikon ato, duke ua kriminalizuar institucionet kyçe. Si përkthehet teoria e këtyre dy autorëve në kushtet shqiptare. Sidomos tre segmente bazike që përbëjnë analizën e tyre janë të rëndësishë së veçantë: legjitimiteti i politikave (partive), kultura retorike dhe teknika e inkluzionit dhe ekskluzionit.

## II. MATEMATIKË DEMOKRATIKE

Në fakt po përsërisim diçka që duhet ta dijë çdo qytetar: çdo politikan, pavarësisht pozitës së tij të mëvonshme institucioneve të shtetit i ka disa mijë vota të elektoratit, pra një pjese fare simbolike të masës (jo popullit e as shoqërisë). Domethënë baza e mandatit është reprezentimi i disa mijë qytetarëve. Shikuar nga ky kalkulum i thjeshtë politikasi që nuk ka të besuara poste legale nga institucionet demokratike (përfshi këtu edhe kryetarët e partive) saherë që flet «në emër të popullit» bën demagogji. Troç: manipuloni dhe shpif kur thotë «populli vuan dhe donë këtë apo atë...». Ai nuk e ka mandatin për t'u bërë zëdhënës i «popullit» sepse

është përfaqësues i elektoratit ose partisë që ka deleguar atë. Kur kemi parasysh sistemin se si funksionojnë partitë kosovare, respektivisht shqiptare (kryesisht nga lartë poshtë e jo anasjelltas) cilën nga partitë dhe politikanët mund ta çlirojmë nga akuza se bën demagogji të hapur?

Vetëm ajo qeveri që merr pëlqimin kualitativ rreth një dosje të caktuar në parlament (pra jo në saj të kamuflimeve numerike) mund të flasë në emër të shumicës, asaj shumice që jo apriori donë të thotë popull, domethënë as këtu (edhe pse e tolerueshme), ajo, qeveria, nuk ka mandatin të flas në emër të popullit, sepse sa herë që flet në këtë mënyrë ajo bën ekskluzion duke shpallur *jopopull* (bën përjashtimin automatik) gjithë ata që nuk janë dakord me qëndrimet e pushtetit. Kemi të bëjmë në thelb po me të njëjtën demagogji si ajo e një politikani të thjeshtë.

Tani sërish pyetja; a mund ta çlirojmë qeverinë kosovare nga akuza e të qenurit demagogjike?

### III. «KULTURA» RETORIKE

Parlamenti kosovar jorrallë i përngjanë një fabrike deliktësh penale për shpifje. Natyrisht se çdo parlament në botë është arenë ballafaqimesh ideologjish, politikash e vizionesh të ndryshme. Nuk e kemi fjalën për këtë, por për retorikat e ulëta që janë bërë komunikim standard ndërmjet faktorëve të caktuar politikë.

Shprehjet si «hajdutë», «kriminelë», «halabak», «rrugaç» përdorën më shumë se sa përshëndetjet e zakonshme ndërnjerëzore. Edhe pse shpesh këto «rrëshqitje verbale» janë materie konkrete për gjyqësorin tolerohen detyrueshëm, sepse shumica e reprezentantëve po të njëjtin nivel komunikimi kultivojnë. Në stilin «ti mu unë ty». Kemi të bëjmë me një retorikë degraduese që është shqetësuese sa i përket infektimit të masave: ai që adhuron politikanin e vetë përpiqet ta imitojë

atë në përditshmëri, në shkollë, në kafene, në shtëpi e gjetiu, kur flet për ata «të mendimit tjetër». Përgjegjësia publike e personave që gjenden në optikën e mediave është e qartë. Nuk mund të besojmë se një subjekt (natyror, juridik a politik) që shërbehet me një çedukim të tillë të elektoratit të vetë mund të kërkoj mandatin e «patriotit» apo mozomakeq edhe të ndonjë institutit moral në shoqëri. Nuk po duken të jenë aq trudërmuar liderët në fjalë, mirëpo megjithatë kështu veprojnë. Kontradiktë që e bën edhe absurdin camus-ian që t'i bie të fikët.

Tjetra: Së paku një politikan duhet ta dijë se akuzat e pamaterializuara juridikisht konsiderohen si shpifje edhe atëherë kur ekzistojnë indikacione se një institucion apo politikan nuk e ka pardesynë e pastër. Kalkuluar kështu ftohtë dhe me gjuhën e argumentit, në kërkim të një kulture korrekte politike shohim se kundërshtarët e acaruar politikë sigurisht se janë të vetëdijshëm se retorikat e tyre nuk kanë asnjë efekt konkret për shoqërinë. Del sheshit se nuk janë vërtet aq të interesuar të luftojnë devijimet e pushtetit, politikave dhe partive, por gjithë kjo shkon në konto të asaj politikës ekskluzioniste me synimin e përfitimit (kupto manipulimit) të pjesës sa më të madhe të tortës elektorale.

#### IV. EKSKLUZIONI SI TEKNIKË VEPRIMI

Shqetësimi pra, që duhet të trondiste më shumë shoqërinë civile kosovare vjen nga ekskluzioni jo si metaforë retorike manipulimi, siç përshkruam më lartë, por më shumë si stil veprimi politik. Si sistem që si finalitet sukcesi ka djallëzimin me çdo kusht të tjetrit, atij që është, që mendon dhe vepron ndryshe.

Po i mblodhëm përshkrimet fragmentare të partive, në media dhe nëpër fjalimet e tyre të veçanta fitojmë këto tablo, këto pamje për kundërshtarët e tyre politikë.

*PDK sipas VV-së dhe LDK-së* - Nëpërmjet një personalizimi shpesh grotesk paraqitet figura e Kryeministrit të Kosovës. Imazhi i tij në psikogramet që ia bëjnë kundërshtarët politikë del si bos i një mafie që ka kapur jo vetëm nëntokën, por edhe politikën dhe gjitha institucionet e porsalindura demokratike kosovare. Në shumë aspekte figura e Al Capone-s del miniaturë qesharake ndaj ish gjarprit me seli në Kukës. Ai qenka «tradhtar» i interesave kosovare sepse ulet pa kushte me ish vrasësit masiv dhe historik të kosovarëve. Ndërsa partia e tij qenka një organizatë profiterësh banditeskë, një grumbull «asasinësh», të cilët duke përdorur edhe mëtutje konspiracionet neoenveriste, staliniste operojnë nëpërmjet frikës, shantazhit, vrasjeve dhe plaçkitjes së ekonomisë dhe shoqërisë në përgjithësi.

*LDK sipas VV-së dhe PDK-së* - Partia e Isa Mustafës përbëhet nga ish titistë të përbetuar dhe me biografi fanatike projugosllave që me veprimtarinë e tyre paskan sabotuar gjithandej ku kanë mundur luftën e kosovarëve për shpëtim nga kthetrat jugosllave e më vonë serbe. Vetë kryetari i LDK-së paska qenë figura kyçe e zhvatjes së diasporës nëpërmjet 3 përqindëshit, të holla që i kanë keqpërdorur një rreth i ngushtë i kësaj partie. LDK manipuloka duke përvetësuar pa të drejtë heronjtë e luftës së Kosovës, të cilët kanë qenë jashtë UÇK-së, mirëpo as edhe lidhje me «rugovistët» nuk paskan pasur. Në këtë perceptim Isa Mustafa nuk ia kalon figurës së megakapones vetëm sepse nuk gjendet në pushtetin qendror. Kur thellohemi mirëpo në vijat kapitale të akuzave përballemi me një tip politikani të njëjte si ai i shefit të PDK-së. LDK nuk paska kapital historik kombëtar për të vendosur për fatin konstruktiv të Kosovës. Dhe po u erdhi atyre sërish në dorë do të ringjallin «jaranitë» e vjetra me kolegët e tyre në Beograd.

*VV sipas LDK-së dhe PDK-së* - Turmë rrugaçësh stalinistë që tentuakan me çdo kusht të sabotojnë proceset e shtetëjetesimit të Kosovës. VV qëllimisht kërkoka bashkimin kombëtar pikërisht në ato momente kur garantuesit e pavarësisë së Kosovës janë duke bërë çmos për ta integruar atë në forumet relevante supranacionale. Veprime, të cilat konkretisht qenkan në interes të drejtë të politikës serbe, e cila ditë e natë shurdhon botën me preventivën që duhet marrë patjetër për ta penguar atë «Shqipërinë që e realizoi dikur Hitleri me kolaboracionistët shqiptarë», pra atë të famshmen «Shqipëri etnike». Kjo organizatë, lëvizje dhe parti përnjëherësh vepruaka si shumica e organizatave radikale, semilegale që për ideal ka përmbysjen me dhunë të rendit ekzistues pa zgjedhur mjetet dhe pa i interesuar shumë se cilat do të ishin pasojat për ekzistencën e shtetit të Kosovës. Akuza që nuk dallojnë nga ato që i kemi dëgjuar për brigadat e kuqe dhe grupe tjera të dhunshme lartë poshtë Evropës.

*Facti:* Këto janë akuzat në vija të përgjithshme. Kështu përshkruajnë partitë njëra tjetrën raporteve për observatorë, mediave dhe nëpër kancelaritë e institucioneve ndërkombëtare. Ky vetëpërshkrim i faktorëve më relevantë të politikës kosovare na thotë se kemi të bëjmë me një shoqëri që udhëhiqet jo nga parti në kuptimin klasik të fjalës, por nga mafiozë, organizata paramilitare dhe demagogë që ecin edhe mbi kufoma për të mbajtur veten në pozitë që kanë ose për t'ia zënë vendin tjetrit. Kjo formë retorike vlen edhe për partitë që nuk i nderuam këtu duke i marrë si shembull.

## V. VEPRIMTARITË ILEGJITIME

Sa qëndrojnë këto akuza? Irelevante! Partitë nuk janë gjykata e as nuk kanë mandatin e institutit moral, madje as të elektoratit të vetë, sepse nuk janë as religjione e as fabrika për prodhimin e patriotizmit, por akterë potencial për të marrë

pushtetin politik. Ato nuk kanë mandatin për të vepruar si agjenci antikorrupsioni, as si OJQ e as si mediat publike për të mbrojtur të drejtat e «popullit», por për të përfaqësuar elektoratin e vetë në kuadër të atyre institucioneve ku kanë lejuar të votohen.

Jo vetëm partitë, por edhe individët pa funksione shoqërore kanë të drejtë të padisin institucioneve të shtetit ligjor nëse disponojnë me indikacione se dikush shkel ligjin. Nëse gjyqësori vërtet është i kapur nga strukturat e pushtetit atëherë ekzistojnë adresa tjera si Strasburgu dhe shumë institucione tjera ndërkombëtare ku pushtetarët kosovarë nuk kanë gjasa të përdorin influencën në vendimmarrje.

Kështu na del atëherë, pra nuk na mbetet shpjegim tjetër përveçse dëshpërueshëm të konstatojmë se partitë kosovare qëllimisht kanë zgjedhur politikën e ekskluzionit si metodë. E kur zgjedh një parti politike ekskluzionin si formë të veprimit politik (domethënë gjithë janë mafiozë dhe tradhtarë vetëm ne jemi të zgjedhurit e Zotit)? Atëherë kur një partie të tillë nuk i intereson kompromisi i shumicës për të mirën e shoqërisë, por kamuflimi i shumicës për kapjen e demokracisë për interesa të ngushta.

Ekskluzioni nuk ka nevojë për kulturë retorike të argumenteve, respektin për kundërshtarin dhe as për programe konstruktive qeveritare e partiake për shoqërinë, mjafton që atë Winnetou-në e Karl May-t ta përshkruash dhe akuzosh sa më zi që mundesh, pështysh dhe përjashtosh nga çdo e drejtë morale deri në momentin kur numri i ihtarëve të jetë rritur aq sa për ta marrë pushtetin ose për ta ruajtur atë.

## VI. DEMAGOGËT

Shohim krejt zi apo duhet të bindemi se partitë më të mëdha nuk kanë as kulturën elementare retorike ndaj njëri tjetrit? Kemi gabuar llogarinë apo vërtet shumica e partive u

marrkan me punë për të cilat askush nuk ua ka dhënë mandatin? Për një gjë jemi të sigurt, e dimë se as zi nuk jemi duke parë e as llogarinë nuk e kemi gabuar: demagogët, të cilët në mungesë të vizioneve flasin në emër të popullit, i kemi më tepër se sa që na lejohej. (2012)



## *Neofitët e Katilinës ?*

Në aferën e historisë me Turqinë dolën në anën a saj sepse historia vërtet duhet të rishikohet. Në kontestin rreth shamisë u rreshtuan krah atyre grusht zonjave që kanë të drejtë të vishen si të duan. Gjatë aferës me „UEFA“-n sulmuan Evropën, gjatë skandalit me EULEX-in sulmojnë po të njëjtën, tani ambasadorja amerikane iu dha shansin të zbavitën me temën më të dashur të tyre „imperializmin amerikan“. Analizë veprimtarisë së një rryme politike neofitësh katilinitë që më së paku sot Kosovës i duhen! Ka muaj që Kosova nuk drejtohet nga qeveria e saj, por më shumë nga konstrukte imagjinateve analistësh të pashkolluar për probleme adekuate. Partitë politike qëmoti janë në bankën e të akuzuarve dhe po i njësove, të japin si rezultat Katilinën. Shoqërisë gati i këputet gishti po si Ciceronit që e akuzonte psikopatin e Sulës për incest, plaçkitje dhe vrasje të farefisit. Ciceroni nuk pati sukses kurrë. Sa herë që i bëhej gjyqi katilit Katilina, ai qeshte. E dinte që konsujt e senatit do të ndërhyjnë dhe do ta lirojnë. Dhe ashtu ndodhte përherë deri sa e bënë shoshë me shpata në betejën e Pistoria-s. Katilinët shqiptarë madje janë të sigurt se as në betejë nuk do t'i shtrijë ndokush përdhë. Ata vetëdijsëm e jovetëdijsëm nuk mbrohen vetëm nga kolegët, bashkëlloji dhe tiranët e tyre, por paradoksalisht ata shpëtohen edhe nga pseudociceronët e shoqërisë kosovare, ata të cilët me këmbë jo se jo, por as me mendje e mendësi nuk e kalojnë pragun e odës së burrave ku janë formuar, sikur t'i kishte gozhduar historia pas murit të kullës së gurtë. Pse?

## 1.

Jo vetëm rusët në Ukrainë, izraelitët dhe sidomos shumë vende afrikane e arabe mezi presin fqinjët e tyre të dalin jashtë sistemit, pa qeveri, në protesta e «revolucionë», për të ndërhyrë që ta shpëtojnë pakicën e vetë nga lufta qytetare, nga «masakrimi». Nëse nuk kanë kënd atypari, luajnë me kartën e stabilizimit të rajonit, ruajtjen e paqes apo për të mbrojtur sigurinë e vendit nga depërtimi masiv i refugjatëve e gjëra të ngjashme. Kjo praktikë është gati e përditshme. Pas blic-hyrjes, pastaj duhen miliona orë, konferenca, ndërmjetësime me synimin pa efekt për të sjellë një lloj marrëveshje, e zgjidhje problemi jo se jo. Çfarë e mbron Kosovën nga një ndërhyrje e tillë serbe?

Një *revue* si histori për ata që harrojnë me qëllim:

1. Përkundër kontakteve të regjura të CIA-s dhe MI6 me rezistencën e organizuar kosovare kundër regjimit serb qysh në fillim të viteve 90-ë, edhe politika e këtyre dy vendeve të shërbimeve sekrete në fjalë ishin të lidhura pas idesë për shpëtimin e ish-Jugosllavisë.
2. Me instalimin e politikës së Millosheviçit rezistencës shqiptarë (të të dyja krahëve, atij ushtarak dhe atij diplomatik – siç i ndanin të huajt, ata të krahut të luftës me ata të LDK-së) iu shtuan gjasat për të bindur jo vetëm shërbimet, por edhe diplomacitë e disa vendeve se me serbët nuk ka koekzistencë në paqe.
3. Përkundër mospërcaktimit definitiv të politikës amerikane e britanike se si do t'ia dalin me Serbinë, shërbimet e përmendura bashkëpunonin me UÇK-në dhe e trimëronin për të bërë luftë në terren që më vonë – për çdo rast ndërhyrjeje – t'i kenë qoftë edhe si alibi.

4. Kosova u çlirua nga forcat e NATO-s pas ushtrimit të etnocidit nga ana e qeverisë së atëhershme serbe.
5. Para, gjatë dhe pas intervenimit, ishte një betejë diplomatike – edhe më e rëndë se sa ajo Pistoria-s ku u masakrua Katilina – e anglosaksonëve me BE-në dhe shumicën e shteteve evropiane që kishin marrë turravrap për ta shpëtuar Jugosllavinë. Këtyre në ndihmë iu dolën bashkë edhe forca intelektuale vendore. Mos të flasim për luftën me Rusinë, Kinën, vendet arabe dhe Turqinë dyfytyrëshe.
6. SHBA-të, Britania e Madhe dhe Gjermania janë vendet që kanë mbetur konsistente në këtë linjë që nga fillimi i viteve 90-ë e deri sot. Ato edhe sot bëjnë luftë me pjesë të BE-së dhe me pakte të tjera që ende nuk heqin dorë nga bllokimi apo rikthimi i Kosovës në „djepin e saj“ serb.
7. Prezenca e «ndërkombëtarëve» në Kosovë garantohet, sigurohet për çdo ditë, me sakrifica, me luftë diplomatike e prapaskenore po nga këto vende.
8. Me të gjitha dështimet e EULEX-it janë po këto vende që më së shumti e mbështesin dhe sponsorizojnë këtë mekanizëm të dalë udhë kohëve të fundit, sepse duket të jenë të sigurt se krimin e organizuar dhe krimin politik në Kosovë, shqiptarët, vendorët nuk janë në gjendje ta mposhtin vetë. Për këtë fakt jemi të bindur edhe ne.

## 2.

Këto janë arsyet se përse Serbia as që mund të ëndërrojë aktualisht për t'i mbrojtur «të vetët sa herë» që politikanët kosovarë me muaj grinden duke harruar shtetin, stabilitetin, sigurinë, me një fjalë qenësinë e Kosovës. Po mos të ishte kjo siguri, Nikoliçi dasmë do të kishte bërë nëpër Kosovë me

xhandarët e tij e Vuçiçi telefonin nuk do ta kishte lëshuar prej dorë duke qarë në telefon për viktimat, kishat e djegura, serbët e vetmuar, të përballur me egërsinë e njerëzve me bisht në «Kosmet». Këtë shane Serbia nuk e gëzon. Nuk do ta ketë derisa Jacobson me kolegët e saj do të munden të thonë nga zemërplasia edhe publikisht „Mos e dhini punën“! Po si dekodohet mesazhi i ambasadores amerikane? Çfarë do të thotë ajo me këtë: „mos na detyroni të ju lëmë në baltë, të ikim, mos u tallni me durimin tonë se mjaft probleme të tjera kemi“, ky është përkthimi. S'ka tjetër. Kështu do ta kenë kuptuar të gjithë ata që racionalisht e pranojnë historinë e bërjes dhe arsyet e qenies së Kosovës kështu siç është: shtet dhe e pavarur. Vetëm neofitët nuk duan kështu. Kush janë neofitët e Kosovës? Ata që i janë kthyer dhe janë pagëzuar në religionin e tyre të vjetër, atë të robit, duke punuar kundër lirisë së tyre, pa e ditur ndoshta as vetë se përse?

### 3.

Brenda spektrit politik kosovar ka një rrymë, të shpërndarë gjithandej partive politike e sidomos që vazhdimisht denoncon amerikanët si imperialistë kolonizatorë. Ky term perceptohet dhe agjitohet ashtu siç e thotë çdo fjalor – e sidomos ata skamnorët në shqipe: «tendencë e një superfuqie e cila pushton një vend a kulturë tjetër për të zgjeruar zonën e ndikimit në aspektin politik, ushtarak dhe ekonomik».

Kontrafaktet: Amerikanët nuk erdhën vetë në Kosovë. Bashkësia Ndërkombëtare me plot anëtarë brenda saj që madje kanë kundërshti ndaj «pax americana»-s u angazhuan në përzënie e ushtrisë serbe. Ishin parimisht arsyet politike, të imponuara nga shqiptarët/shqiptaret që bindën amerikanët dhe britanikët t'i shpëtojnë nga asgjësimi. Ndodhi etnocidi.

Çfarë profiti ekonomik mund të ketë një superfuqi si SHBA-të në Kosovë? Disa milionë për firmat e Madeleine Albright, e cila jo se fitoi por doli edhe përlyer në fund? Kërpuhat e Bahtirit të Mitrovicës? Miellin që nuk ia do Kosovës as binjaku i Skraparit?

Teza rreth imperializmit është aq zbrazët dhe infantile saqë mund të përdoret vetëm kur njeriu nuk gjen arsye tjetër për t'i demonizuar amerikanët dhe prodhon gjepura të tilla.

Skandali rreth «UEFA», veçanërisht lapsusi i Kocijançitit-s dhe rasti «EULEX» na ekspozuan po të njëjtët agjitorë, protestues protestave imagjinare që sapo konkretizohen përfundojnë me ndonjë militant elefant që fle para Kuvendit i vetmuar ose të shoqëruar me ca miq që pinë çaj dhe shajnë proletariatin e paguximtë. BE, «EULEX go home», ky ishte mesazhi. Ose i maskuar pak me diplomaci: „Ose le të japin rezultate dhe të jenë pa korrupsion ose le të ikin“ (pse kush i korruptoi individët dhe kush nuk bashkëpunon me ta saqë asnjë akuzë nuk e realizojnë dot)?

Tani po pyesim kthjellët: ja po na braktisën EULEX-i, BE, NATO, Jacobsoni ikën se s'dëshiron të përdorë më fjalorin adekuat për të vlerësuar politikën siç ajo është realisht? Të njëjtët njerëz do të bëjnë protesta sërish. S'ka qeveri. Partitë përleshën striptizklubeve snobeske të kryeqytetit plot gropa, pa ujë dhe me shkolla protestuese, situata do të dalë duarsh dhe pastaj çfarë? Kush është me logjistikë, ushtri, kapacitete luftarake nga fqinjët e në gjendje të ndërhyjë për ta ruajtur paqen dhe stabilitetin në rajon? Shqipëria me 2000 kallashnikovë të prodhimit kinez? Maqedonia me përmendoret idiote në vend të tankeve? Mali i Zi me peshqit e Ulqinit dhe muxhiburrahmanët e vet? Kush? Serbia natyrisht.

Askush nuk mund t'i akuzojë «antiimperialistët», «antieuropianët» e rinj kosovarë për politikë të kthimit nën

Serbi, sepse ata janë neofitë të pavetëdijshëm, qoftë edhe kur rrjedhin nga familjet tradicionalisht „projugosllave“ (edhe ky arsyetim ndaj individëve aktivistë është bioracist) ata nuk e kanë atë qëllim, veprimi politik i tyre (i analizuar tash e dy vjet) mirëpo ecën drejt synimit të agjenturave serbe të cilat punojnë natë e ditë që ta sjellin Kosovën në atë pikë kur nuk e sigurojnë më qenësinë e saj amerikanët, «post-hitlerianët» dhe britanikët e demonit «Toni Blair» që ua prishën ëndrrat e këtij shekulli. Ky është realiteti. Neofitët e Katilinës duhet ta kuptojnë një gjë shumë elementare; Se Pistoria kosovare është për momentin siguria e saj e jo ksenofobia qesharake ndaj po atyre që i urren edhe Serbia se janë aty ku janë. (2015)

## *Mutacionet kozmetike*

Partitë politike kosovare nuk janë as të majta e as të djathta. Ani çka janë pra ato? Nuk dimë. As ato vetë nuk e dinë. Vetëm liderët e dimë çka janë: kandidatë potencial për të hyrë për të keq në histori.

Majtas, djathtas drejt qendrës. Kështu ecë njeriu i lirë për atje ku donë. Po ç' bën ai nëse djathtas, majtas, drejt dhe në qendër presin kërcënueshëm brigada tiranësh për ta shtrirë përtoke? Në çdo drejtim të navigimit historik, shqiptarët e kanë pasur rrugën të bllokuar nga sundues, të cilët në emër të ndonjë ideologjie kanë justifikuar brutalitetin e përditshëm kundër lirisë dhe qenies së ballkanasit kësulëbore. Që njeriu shqiptar të kalonte barrikadat, i pamasakruar, duhej të dëshmonte se është asimiluar me mendësinë e udhëbllokuesve. Pamarrëparasysh se e ç' karakteri ishte ideologjia. Përndryshe bëhej kufoma e radhës për në galerinë e miteve.

*Tradita e mendimit politik* - Po studiuam historinë e mendimit politik shqiptar, respektivisht po analizuam veprimet politike të elitave shqiptare nëpër kohë do të kolidojmë me një pluralitet konceptesh që na pamundëson rreshtimin e tyre në ndonjë ideologji të veçantë. Po shkundëm qëndrimet e tyre në relacion me temat si kombi, atdheu, populli, nga thesi dhe varret na kërcejnë konservativë, patriotë, ultranacionalistë, nuk mungojnë as minimusolinë e prohitlerë; atëherë kur qëndrimet e të njëjtave elita i bastisim në relacion me ekonominë dhe socialitetin e masave habitemi

duke u pyetur në mos Karl Marx-i, Friedrich Engels-i janë inspiruar nga elitat shqiptare.

*Rekapitullojmë:* tek shqiptarët nuk ekziston tradita e mendimit politik të majtë apo të djathtë; këto ideologji politike metepër janë përdorur si mjet rezistence aktive, oportuniste për çështje ekzistence (elitat) ose si mjet për të maskuar diktaturën (Enver Hoxha dhe despotët tjerë të këtij lloji), kurse masat shqiptare deri vonë as që kanë pasur mundësi të frymojnë e lere më të praktikojnë jetën majtas apo djathtas (analfabetizmi dhe diktaturat).

Kjo është tradita ose historia e mendimit politik shqiptar në raport me megaideologjitë e epokave që shkuan. Si është puna sot?

*As djathtas as majtas* - Qëherët kryeredaktori i gazetës Express (Manipulimi ideologjik, 14.08.2009) Leonard Kerquki analizoi se: «konceptet vetëm të Djathta apo vetëm të Majta nuk mund të implementohen në Kosovë [...]». Këtë tezë autori e formulon duke pasur jo vetëm historinë e mendimit politik shqiptar, por më shumë duke argumentuar nga terreni, aktualiteti dhe atë pa pasur nevojë për referencë në paradigmat universale mbi natyrën e organizatave politike në kushte të globalizimit. «Politikanët e kanë për obligim që t'ua sqarojnë qytetarëve këta terma, e jo të manipulojnë me mungesën e njohurive të njerëzve», kështu atëherë Kerquki, kërkesë që edhe pse e shkruar katër vjet më parë mund t'i parashtrohet sot, pa asnjë ndryshim partisë në pushtet, sidomos pas emigrimit mental të shefave të saj në të djathtë.

*Çka lexojnë ekspertët e partive* - Ndërkohë nuk ekziston asnjë politolog, sociolog dhe filozof serioz në botë që pranon ndarjen shablonike të spektrit politik në të majtë e të djathtë. Asnjë parti politike që vepron brenda demokracisë dhe



pluralizmit parlamentar nuk mund të dëshmojë «higjienën» absolute ideologjike. Përkundrazi: Edhe partitë me shtabet më të ideologjizuara tashmë janë bindur se groposen si formacion me përmasat e një sektit nëse ndalojnë fraksionet ideologjikisht kontradiktore brenda vetes. Kur kemi parasysh këto, pra paradigmat shkencore dhe përvojën faktike mbi natyrën e partive politike dhe mungesën e traditës në mendimin politik shqiptar në të majtë apo të djathtë; ku bazohet atëherë PDK ose ndonjë parti tjetër shqiptare, kosovare për ta kualifikuar veten në ndonjërin prej këtyre taborëve të spektrit klasik politik?

PDK habiti të gjithë. E më së shumti veten. Në konventën e saj ajo tamtamshëm deklaroi se është e djathtë. Gjë që nuk është. S'mund të jetë – as për nga «tradita» e as për nga përbërja e saj. Pse?

*Historia e një «konvertimi»* - Mediat u hutuan me të drejtë pyesnin se çka nënkupton PDK me «nofkën» e saj më të re. E para, për arsye se nën mantelin e këtij spektri politik sot fshehen (verbalisht) që nga liberali i moderuar e deri tek fashisti më i egër dhe e dyta mediat u shtangën pasi kishin besuar se pjesa dërrmuese e bazës dhe hierarkisë drejtuese të partisë në fjalë përbëhet nga postenveristë, paramarksistë dhe socialdemokratë të fraksionit nacional-popullist.

Të paparashtruara mbeten pyetjet esenciale: Cilat kuvende të degëve të kësaj partie kërkuar që partia të shpallet e djathtë? Sa zgjati debati me bazën? Cilët ekspertë të kësaj partie hulumtuan bindjet e fraksioneve dhe të anëtarësisë për të konstatuar se konvertimi ideologjik është modifikuar aq thellë sa që një parti e perceptuar gjithmonë si e majtë në esencë qenka e djathtë? Na ka shpëtuar diçka nga mutacionet e kësaj partie apo qëndron ajo anekdota që tingëllon banale, mirëpo reale: Shefi me miqtë e tij në majën e partisë kanë vendosur një riorientim të tillë, pa përfill bazën? E kanë bërë

këtë për shkak të transformimit të tyre në oligarkë apo sepse kanë frikë se dikush kërkon prej tyre ta mësojnë përmendsh Manifestin Komunist. Mendojnë ata se për të qenë i djathtë mjaftojnë parullat për mbrojtjen e Preshëves, për madhështinë e Skënderbeut dhe trimërinë e komandantëve joideologjikë të luftës së fundit?

*Përrjashtuesit dhe demokracia* - Më shumë se manipulimi (si metodë standarde e partive) e frikshme rishfaqet metoda se si kjo parti operon brenda demokracisë kosovare. Me proklamimin formurdhëri «nga sot jemi të djathtë» ajo nuk shpalon vetëm mungesën e mendimit intelektual (historik dhe aktual), por në thelb dëshmon të jetë një parti e diktatit që apriori përjashton fraksionet brenda vetes, çka implikon suspendimin intern dhe ekstern të kulturës demokratike. Partia përjashton madje edhe veten sepse eliminon praktikisht edhe vetë strukturën e saj. Historikisht kështu kanë vepruar shtabet e prira nga Stalini dhe imitantët e tij të shumtë majtas dhe djathtas. Edhe vetëm si mutacion kozmetik për manipulimin e radhës, kjo aventurë e PDK-së legjitimon një shembull më shumë se destruktiv për demokracinë kosovare. (2013)

### *Udhëtimi me varkën e Karonit*

Problemet, krizat, rrahjet, vezët e gazet në Parlament i japin të gjitha argumentet e nevojshme për të pranuar pa dëshirë se shoqëria kosovare vazhdon të gjendet në kaos, nën sundimin e atyre figurave të Hesiodit dhe konstruksioneve tjera nëntokësore. Pas çdo krize vjen metanoja – thonë vetëngushëllueshëm optimistët. Para çdo katarsisi rradhën e kanë kaosi dhe paranoja – është i bindur pesimisti. Dhe i fundit ka të drejtë. Robëria e gjatë dhe lufta nuk lënë pas vete parajsën ku interiori është vetë kulmi estetik, por atë gjendje që hebrenjtë e quanin Tohuwabohu: zbrazët dhe shkretët! Gati të gjitha filozofitë e para, pikërisht nga krateri i këtij vakumi imagjinonin lindjen e zotave, religjioneve dhe ambalazhit mitologjik të njerëzimit.

Hesiodi (700 para e.s.) në Teogonie-në e tij po nga aorta e kaosit shpiku Gajan (perëndeshën e Tokës), Niks-in (zotin e natës dhe errësirës), Erebosin (zotin e errësisës së nëntokës), Tartar-in (bosin e nëntokës) dhe në fund Eros-in (zotin e dashurisë). Po analizuam kujdesshëm hierarkinë, kronologjinë e lindjes së figurave të Hesiodit, vërejmë se toka na del si megamateria statike, e paradhënë, ku ushtrojnë pushtetin kryesisht Niksi, Erebozi dhe Tartari që përkthyeshën në fjalorin e sotëm do t'i pagëzonim si tiranë, terroristë dhe mafiozë. Erosi si përfundim ende askund nuk ka mbërritur. Me shqiptarët, hëpërhë as takim nuk ka paralajmëruar.

Karakteret sunduese, dominuese në kohë kaosi më bukur megjithatë i gjejmë të përshkruar në letërsinë e modernizmit dhe pasmodernizmit. Kjo për arsye se nuk kemi aq distancë të madhe si me Hesiodin dhe se gjatë përholjes së karaktereve identifikohen shumë më lehtë homologët e tyre sot.

*Personeli* - Në mungesë të shtegut, kuptimit, jetës së papërballueshme në apati, njeriu kërkon dhe rëndom, në stacionin e parë përballet me Tartufin e Molière-it (Tartuffe ou L' Imposteur, 1664), atë hipokritin religjioz që i premton Orgonit të përhumbur parajsën përtej kozmosit të çorientuar, me të vetmin qëllim që t'ia pushtojë shtëpinë dhe t'ia marrë vajzën për grua. Orgoni i përhumbur humb edhe më thellë, duke ia shtuar jo vetëm vetes, por mbarë familjes kaosin.

Tartufi nuk është shpëtimtari, por kryekaoti vetë. I dëshpëruar, i traumatizuar nga lufta dhe humbjet, për të mbijetuar Orgoni bëhet Manolescu real, ai që i dhuroi shkrimtarit gjerman Thomas Mann brumin për ta shkruar romanin e tij të pambaruar „Rrëfimet e mashtresit Felix Krull“ (1905). Ky dendi, snob me tapi, do që me çdo kusht të ngjitet majave të shoqërisë. Nuk dorëzohet as atëherë kur tek kroati dhe kriminelin i parruar Stanko – i cili e mëson se si të fusë në treg arin e vjedhur nga Madame Houplé për t'u bërë i pasur shpejt e shpejt – sheh veten në pasqyrë.

Që në çastin kur Felix-i mund të ftojë „elitën“ e shoqërisë në *party*, ai vesh uniformën e dukës së Otrantos, shkëlqesisë së tij Joseph Fouché, i cili ecën mbi kufoma, pa ndërjegje dhe stoik rri ministër në çdo qeveri të mundshme; gjatë Revolucionit Francez, në kohën e perandorisë dhe gjatë restaurimit, ai të cilit Stefan Zweig ia bëri monumentin e jashtëzakonshëm me monografinë „Joseph Fouché, portreti i një njeriu politik (1929). Biografinë e të birit të Fushé-së, i cili është rritur pa kujdesin minimal të babait të korruptuar nga ideali i pushtetit dhe që ka emigruar në SHBA, e gjejmë në

romanin „American Psycho“ të Bret Easton Ellis-it. 27 vjeçari është bërë bankier.

Wallstreet-Yuppie me emër të ndryshuar – që mos e identifikojnë se bir i kujt është – Patrick Bateman jeton në banesa superluksoze, shikon gjithë natën filma dhe vërdallet klubeve më të shtrenjta ku organizohen Koks-Party dhe orgji. Askush megjithatë nuk e di se i njëjti njeri bën jetë të dyfishtë. I rritur me ndjenjën e të përjashtuarit, i kaotizuar edhe më tepër me drogë, luks dhe perversion, kuptimin e ekzistencës së tij Bateman e gjen duke dhunuar dhe mbytur gra natën.

*Asociacione* - Faza e tranzicionit në shoqëritë shqiptare duket sikur të jetë e dominuar nga karakteret e përngjashme me këto që i përshkruam më lart. Karaktere të tilla domosdo se ka edhe në shoqëri të tjera. Dallimi mundëson sidoqoftë dy grupe: në njërin grup të shoqërive psikot e llojit të këtyllë gjenden burgjeve ose para proceseve gjyqësore, në grupin e dytë ato janë pushteti, liderët opozitarë, funksionojnë si primatë „civilë“ apo oligarkë.

Problemet, krizat dhe polemikat e kohëve të fundit i japin të gjitha argumentet e nevojshme për të pranuar pa dëshirë se shoqëria kosovare vazhdon të gjendet në kaos, nën sundimin e atyre figurave të Hesiodit dhe të tjerëve. Debatimi mbi religjionet, identitetin, universitetin, udhëbërë, patriotët, enveristët, titistët, kaotët, studentët, korrupsionin, rrahjet e gazet në parlament, ia nxorën masës parasysh një rrjet njerëzish në politikë, në ekonomi, në media dhe në arsim, një rrjet njerëzish, një kastë specimesh kameleonike që vetëm në kaos mund të jetojnë të tillë.

*Varka e Karonit* - Protestat pro rektorit, egërsimi i mediave (sidomos atyre të korruptuarave vetë deri në palcë) kundër korrupsionit, pjesëmarrja aq masive e njerëzve në polemikat publike, arrestimet e rebelëve parapolitikë dhe aksidentet në

parlament e rrugë dëshmuar dhe sinjalizojnë për çdo ditë se masa është duke duruar në grahmat e fundir po si ai Karoni flokëthinjur në mitologjinë antike, që priste të transportonte me varkë, për një obulus (denar) përtej lumit Akeron kufomat për në mbretërinë e Hadit.

Në Kosovë njerëzit të lënë përshtypje sikur të jenë zgjuar dhe vetëm presin t'iu vdesin „zotërat“ e tyre të errësirës dhe nëntokës për të filluar ta rendisin jetën e tyre siç kërkojnë. Mungon vetëm metanoja (shpëlarja nga mëkatet nëpërmjet pendimit si kusht për një jetë të re), sepse pa këtë të fundit nuk ikën paranoja. E kjo e fundit është e të gjithëve. Këtë kusht e ka vënë Erosi para se të premtojë takim me shqiptarë. Se si t'i iket kaosit duhet të tregojnë të urtët. Se si të hyhet në kozmosin e të denjëve tashmë na e kanë mësuar. Dhe vetëm pas këtij procesi mund të paralajmërohet Karoni t'i bëjë gati varkat. (2014)

## *Gjeoracizmi në kosovarizëm*

Më shumë se lokalistë, më pak se racistë – janë ekskluzionistët e sotëm në Kosovë. Pseudodoktrina e tyre për bazë ka shtetin, respektivisht kombin kosovar, i cili për nga historia, politika (demokracia) dhe ekonomia del të jetë ende fetus. Dy eksese prominente ilustrojnë fenomenin më të ri ndër shqiptarë! Jo çdonjëri mund të filozofonte tribunave të polisit. Athinasit e dëbonin ulërishtëm çdo «barbaroi» që greqishten e fliste me theks mykenas, miletas, «të huaj».

E drejta e pjesëmarrjes në diskursin publik ishte e rezervuar apostafat për qytetarët që flisnin «gjuhën e Zeusit», atë pra e cila konsiderohej të jetë zyrtarja e polisit.

Refuzimi nuk ndodhte – siç pretendojnë ta interpretojnë sot kontrakulturalistët – për shkak të pozitës sociale, bazuar në vertikalen që nis nga skllavi për te aristokrati, por që parimisht ka për arsye të mospërkatësisë kulturore gjuhën e oratorit.

Ky përjashtim nuk manifestohej vetëm para oratorëve, por gjithandej ku shfaqej ai, i ardhuri prej diku dikur. Konform kësaj mendësie ishin ligjet, tregu dhe çdo sociosferë tjetër athinase. Koncept i hershëm etnogjenetik pra mbi bashkësinë. Dhjetëra shekuj para krijimit të kombeve njerëzit kanë paragykuar etnikisht. Edhe sot e kësaj dite aktualisht. Kështu kanë funksionuar turmat gjithmonë. Jo edhe ata me dy groshë tru, të urtit. Këta të fundit gjithmonë ngritjen dhe zhvillimin, dinamikën përparuese të bashkësisë e kanë kërkuar tek e kundërta – jo parakushti gjenopolitik i bën pra

qytetarët rrjedhimisht konstruktivë për polisin, por diversiteti, pluraliteti dhe fluiditeti intersocial.

Poezia programatike e burrështetasit dhe lirikut Solon (594) «Eunomia» (mit. perëndesha e ligjit, rendit dhe pages) – e cila nga eurocentrikët katapultohet të jetë dokumenti i parë i shoqërisë me barazi ligjore dhe shtetit të hapur (nuk është i pari, por këtu vlen si ilustrim)- është dëshmia se qysh herët të mençurit (frg. 3 dhe 23 sipas Diehl) kanë denoncuar si kancerogjen perceptimin e qytetarit sipas racës, gjakut e gjenit.

*Soloni në Drenas* - Gjatë një polemike parlamentare, kryeministri kosovar “urdhëroi” njërin nga kryeopozitarët «ik në Vladimir (fshat në Mal të Zi) dhe atje zgjidhi problemet». Pse politikani aktual prishtinas sot të mos ketë kuptuar atë që Soloni e predikonte 25 shekuj më parë? Apo Soloni nuk ka pasur të drejtë?

I vetmi informacion që i pari i qeverisë kosovare kishte për të ardhur deri tek kërkesa e tij kategorike ishte se prindërit e opozitarit Albin Kurti paskëshin origjinë nga një fshat malazez.

Në emisionin e një kanali televiziv kosovar të titulluar PULS edhe nëpunësi i Fakultetit të Mjekësisë me kandidaturën – sipas tij – gati për dekan, Azem Lajçi, iu drejtua redaktorit për çështje sociale të «Tribuna» -s me fjalët: «Ti me kanë i mirë s’kishe ardhur prej Presheve (Serbie) e me na ra ne hise. Ti s’me vjen as deri te...» (Burimi: Facebook e Alban Selimit). Këto dy raste nuk janë të izoluara, sepse fjalori i këtij lloji popullon edhe rrjetet sociale, tipi i mendësisë përkatëse që ka edhe plot traditë; dimë për shumë stereotipa si ato „brekëkuqt e gjakovës“ ose sot „talebantët e Gjilanit“, „sh...kosovare“, „makedoncët“ e plotë të këtij lloji. Përderisa këto epitete lokale fshihnin një racizëm të lehtë, më shumë spontan e neveritës, deklaratat përjashtuese të



primatëve të sotëm kosovarë duken të frikësojnë e sensibilizojnë ngase bazohen në atë «dialektikën e kosovarizmit» (06.09.2012 KD online) për të cilën kemi shkruar më herët.

Në këtë listë as që duhet të listojmë tiradat primitive dhe urrejtëse të disa publicistëve psikodelikatë që thonin se jokosovarët kontaminojnë ambientin e gjëra të ngjashme.

*Konkretisht:* jo vetëm qytetarë dhe shtetas por edhe primatë të politikës mendojnë që pjesëtare të kombit kosovar nuk mund të jenë ata që janë me origjinë nga jashtë kufijtë e ridefinuar së fundi nga perëndimi. Kjo vlen pra jo vetëm ata që kanë ardhur 20-30 apo 50 vitet e fundit nga Mali i Zi, Maqedonia, Lugina e gjetiu, por është përcaktues edhe për ata që kanë lindur në Kosovë. Si ta emërojmë këtë dukuri, këtë tip përjashtimi specifik me plis? Së pari t'i bastisim biografitë e poleve të kundërta e pastaj doktrinën e përjashtuesve!

Krejt i natyrshëm diskursi mbi «kombin» kosovar. Çdo shtet ka komb e as kosovarët nuk duhet të privohen nga ai. Një grusht intelektualësh argumenton me logjikën e «kombit qytetar», tjetri me atë të «kombit etnik». Njëra palë e sheh shtetin si bazë për konstruktimin e një kombi të ri e tjetra si mundësi për dëshmimin e një kombi të vjetër që ka ekzistuar përgjithmonë. Përtej diskursit të kosovarizmit është një masë e tretë që mendon se ekzistojnë dy shtete me politika gati identike shqiptare të një kombi kulturalisht, etnikisht, historikisht e tradicionalisht të pandashëm. Vetëm ky version i fundit është historikisht (ashtu siç është) i argumentuar (gjuha, kultura e përbashkët). Teza e tyre se «Kosova është shtet i kombit shqiptar që jeton në Kosovë» është aktualisht ajo që qëndron bazuar në çdo dimension verifikimi të mundshëm (simbolet, historia, tradita, gjuha standarde zyrtare etj. Elementë përcaktues të një kombi bazash etnike).

Dy të parët llafosen në stilin kontrafaktik (sikur të donim do të ishim...). Kjo për arsye se krijimi i shtetit të pavarur të Kosovës funksionon si demokraci e deleguar, me kushtetutë jo të rezultuar nga ndonjë plebishit shumice, por me diktat ekstern; “kombi” ka shumë historira përrallore, por jo të atillë që do t’ia mbushnin syrin edhe shkencëtarit më shkeleshko; «kombi» për gjuhë zyrtare- siç theksuam edhe më lart – ka standarten që e kanë edhe tjerët andej gardhit; «kombi» ekonomikisht është i varur nga asistenca sociale e emigrantëve të vet dhe organizatave supranacionale, të cilat i urdhërojnë të prodhojë sa më pak etnonacionalizëm.

Për më shumë as ekonomikisht nuk mbijeton dot pa një rrjetëzim me njësitë tjera shqiptare ose në drejtim të Serbisë. Summa Summarum: qoftë «kombi» etnik e qoftë ai qytetar kosovar, aktualisht janë të pabërë, është dëshirë publicistësh, lokalistësh, institucionalistësh (pa to) dhe politikanësh që ndoshta besojnë se një «komb» konstruktohet me urdhër, me parulla, me inate ndaj «principatave e vilajeteve» të tjera dhe mundësisht me duar në xhepa. Kosova mund të bëhet shtet qytetar edhe komb mund të bëhet (nëse dëshiron shumica- e këtë nuk e dimë), mirëpo jo sot, sot edhe njëherë: është pjesë e kombit shqiptar me shtet të vetin! Tani të shohim mosdurimin ndërmjet kosovarit dhe shqiptarit, ku bazohet ai?

*Gjueti pas një hipoteze* - Hashim Thaçi ka lindur Burojë të Skenderajt, ndërsa Kurti në Prishtinë; nuk kanë asnjë dallim nga njëri-tjetri në të folur. Që të dy deklarohen të jenë shqiptarë; që të dy deklarohen të jenë kosovarë; që të dy mbështeten në të njëjtën histori; që të dy kanë një mendësi – njëri në pushtet e tjetri në opozitë; që të dy kur u çlirua Kosova ishin jashtë Kosove (njëri në burg e tjetri në male) dhe kur u bë shteti ishin në të njëjtin qytet. Cili është dallimi që

mund t'i jepte të drejtën njërit të jetë më kosovar se tjetri? Po, katundi Vladimir që shtrihet në Mal të Zi. Origjina?

Nëse kryeministri reflekton bazuar nga hipoteza e «kosovarizmit etnik», atëherë a është ai i sigurt se para se stërgjyshërit e Kurtit të kenë banuar në Mal të Zi të mos kenë banuar në Skënderaj; Hashim Thaçi nuk e ditka që familja e tij deri vonë ortodokse ka ardhur nga malet e Malit të Zi? Si duket nuk do ta ketë ditur. Pra, i vetmi argument që kryeministri e përdori si mjet përjashtimi e që dukej logjik, faktik në fakt nuk është fakt e as indikacion që mund t'i shërbente «kosovarizmit» të tij, pra është një gjeofakt i kamufluar, shpifur, që në fund të fundit del autogol, vetëdiskriminim sepse vetë fisi tij vjen nga kodrat e njëjta. Nga perspektiva e “kosovarizmit qytetar” as që guxojmë të mendojmë se mos Soloni na çohet lugat.

Gjithë ky elaborim yni mohon çdo bazë, asgjëson ekzistencën e çdo argumenti racional që do të justifikonte qëndrimin përjashtues të Thaçit, Azem Lajçit dhe shumë të tjerëve, mirëpo ai nuk e bën të paqenë urrejtjen dhe aktet përjashtuese që ndodhin vazhdimisht. Me çfarë defekti kemi në të vërtetë të bëjmë këtu?

*Racizmi pa raca* - Gjithkush e di se ç'nënkuptohe me racizëm. Deri vonë si racistë kategorizoheshin të gjithë ata që manifestonin intolerancë, urrejtje, nënçmim ndaj të tjerëve për shkak të ngjyrës ndryshe të lëkurës së tyre. Që nga vitet nëntëdhjetë, megjithatë është zgjeruar etimologjia dhe përcaktimi i termit në fjalë: Stuart Hall (1989) dhe Étienne Balibar (1992) sollën – dhe argumentuan – ekzistencën edhe të racizmit pa raca, të quajtur edhe si racizëm kulturor apo neoracizëm, pra atij lloj ekskluzioni që nuk ka të bëjë me origjinën, gjakun, racën, por më shumë është tip ksenofobie që ka frikë se çdo element i ardhur nga jashtë mund të prishë formën e socialitetit ekzistues. Në thelb dhe në praktikë; të

infektuarit me këtë lloj racizmi kërkojnë mundimshëm e djersitshëm ta gjejnë një simbol (në këtë rast që trajtojmë me karakter gjeografik) për të arsytuar urrejtjen e tyre si të pranueshme ndaj tjetrit që nuk qenkësh anëtar i njëmendtë i bashkësisë, domethënë i diskriminuari nuk plotëson të gjitha kushtet për të qenë subjekt i dinjitetshëm social dhe si i tillë ai është i pavlerë për të mirën dhe mbarëvajtjen e kopesë.

*Racizmi si kamuflim* - Pasi aktualisht askush nga shqiptarët e asnjë pjese trojesh tonat nuk ka asnjë argument të vetëm, asgjë materiale, konkrete, racionale, të pranueshme si argument, subjektet e përfshira nga instinkti racistoid përdorin të vetmin që kanë: gjeoracizmin e kamufluar, praktikisht inekzistent.

Tani, për fund pyetja kapitale: Soloni dhe kryeministri kosovar – cili është dallimi ndërmjet tyre? I pari jeton edhe sot e i fundit bashkë me kolegët e tij ulërinin para tribunave antike për t'i përzënë “barbaroit”. (2013)

## *Ç' është kombi nuk është shteti!*

Demokracitë e zhvilluara bëjnë çmos për të gjetur formulën më adekuate të koekzistencës së kombeve në paqe brenda një shteti apo më shumëve, në Kosovë duan edhe një komb që ndoshta edhe e sajojnë si të dalë nga ky që është – shqiptar, por urojmë mos t'iu ndodhë si „maqedonëve“.

Si në shumë tema tjera edhe në këtë, rreth pyetjes se çka është kombi, ka një keqkuptim radikal. Mosmarrëveshjes i fryjnë kryesisht publicistë, poetë, kollumnist që po t'ua studiosh mënyrën e polemizimit nuk i dallon dot nga ata pseudoprofetët e «parahistorisë», të cilët betoheshin këmbeduar perëndia t'i ketë ngarkuar personalisht me misionin për tua normëzuar njerëzve jetën se si duhet të hanë, pinë dhe ti kryejnë ato punët tjera.

Kur i analizojmë tekstet ku tash e sa vite kacafyten autorët rreth kuptimit të nocionit komb të krijohet përshtypja se jo të «pashkolluarit» kanë problem ta ndajnë shapin nga sheqeri por pikërisht ata që ulërijnë të jenë ekspertët e fushës. Xhonglimi me paradigma, teza, definicione është eklatant – ato citohen, shkoqen, tjetërsohen aq keq sa që njohësit të tyre s'ka se si mos t'i rritet oreksi dhe dëshira për tu bërë censor i rreptë. Seleksionimi i argumentacionit në favor të njëdimensionalitetit personal, për ta mbajtur pra gjallë tezën e preferueshme është jo vetëm infantil por edhe neveritës. Shkurtë: jo vetëm debati por edhe vetë nocioni është banalizuar aq rëndë sa që sapo të përmendet ta shkakton diabetin.

## II.

Megjithëkëtë njerëzit si duket kanë nevojë për këtë term, ata shprehen ë hutuar saherë përdoret «kombi» në këtë apo atë variantë. Prandaj si e para punë iu drejtuam fjalorit shqip-shqip. Aty si zakonisht, si për shumë nocione tjera historibërëse e kapitalomëdha i gjetëm gjashtë gjysmërreshta farekoti që i përngjanin më shumë një diagnoze psikiatri për pacientë se sa ndonjë sqarim qartësues.

Ja në origjinal:

KOMB I m. sh. - 1. Bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, të territorit, të jetës ekonomike dhe të formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës. 2. spec. Shtet, vend. Lidhja e Kombeve. Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Edhe në fjalorët tjerë (tek ai elektronik ishte e shtuar edhe e drejta e vetëvendosjes dhe baballarët reaksionarë zogollianë) nuk gjetëm gjë serioze, prandaj detyrohemi që faktet neto rreth «kombit» t'i marrim nga enciklopeditë më aktuale të huaja dhe ato janë këto:

1. Aq sa mund të dokumentohet deri tash «**natio**» shfaqet për herë të parë në latinishte tek romakët dhe atë për grupet e huaja që jetonin në kuadër të *imperium romanum*, dhe që përdornin një gjuhë të përbashkët (pra jo latinishten), kishin rite, norma të dhe origjinë të përbashkët. Për këtë arsye romakët nëpërmjet dy ligjeve rregullonin raportin me etnitë e tilla dhe atë me: *ius gentium* = E drejta e popujve dhe me *ius civile* = e drejta e qytetarëve të perandorisë romake!

2. Në shekullin 16 dhe pastaj i kodifikuar në shekullin 18 me revolucionin francez «nacion»-i i përkthyer në shqipe si

«kombi» përshkruan popullin me origjinë, histori dhe gjuhë unike si konstitues i shtetit, që më vonë do të quhet si «kombi titullar» i shtetit.

3. Nga këtu – pas revolucionit francez – marrin dhënë teoritë që mëtojnë ta shpjegojnë «kombin», përmasat dhe ndikimet e tij. Pothuaj çdonjëra shkencë e jo shkencë, doktrinë e ideologji ka një recetë të veten se si duhet të kuptohet «kombi»!

4. *Kombi në shkencat sociale* – Sociologu gjerman Ferdinand Töniës thotë kombi është «shoqëri e dëshiruar». Irlandezi britanik linduri në Kinë që vdiq në Batu të Indonezisë Benedikt Anderson thotë kombi është «shoqëri prezantuese e shpikur», ngase «shoqëria e tyre bazohet në psikë», kjo për arsye se anëtarët e shoqërisë nuk njihen personalisht face-to-face. Antropologu Clifford Geertz thotë se kombi është grup i lidhur në baza primordiale (nga baza e origjinës bazë, prejardhjes). Klaus Hansen thotë është kolektiv dhe Anthony D. Smith thotë kombi të jetë kombinim nocionesh ekzistuese.

Shkencat sociale, siç shohim, kryesisht rikonfirmojnë kuptimin dhe perceptimin e «kombit», bëjnë lojë fjalësh ose nuk merren me falsicitetin e definicionit por flasin jerm. Natyrisht që njerëzit e të njëjtës gjuhë dhe histori dëshirojnë së pari të bëjnë bashkësi me të vetët se sa me tjerët me të cilët as që merren vesh (Töniës). Në asnjë segment të definicionit «komb» nuk thuhet se njohja interpersonale, fiziko-direkte është kushti se pse një shoqëri e paraqet veten si komb. Jo njohja personale por kujtesa (thirrja në të kaluarën), identiteti (gjuha sidomos) dhe kontinuiteti kulturor (tradita, institucionet, vendet) janë kombformuese (Anderson). Geertz thotë atë që thuhet që nga fillimi i vënies në qarkullim të termit «nacion», Hansen s'ka pasur ide tjetër dhe Anthony

Smith i metarializon edhe fragmentet terminologjike tjera në favor të kombit ashtu siç lexohej që nga fillimet e tij.

Në këtë linjë janë futur edhe plotë historianë, të cilët kombin e kanë përzier me ideologjinë nacionaliste, e cila është komplet një narrative tjetër dhe s'ka të bëjë me atë se si duhet të perceptohet nocioni komb.

5. *Kombi i OKB-së* – Kjo organizatë më shumë është për sherr se për të mirë. Gati njëjtë si fjalori shqip-shqip më shumë huton se zgjidh probleme. Anëtare e saj mund të bëhesh vetëm si shtet, megjithatë ngul këmbë dhe nuk riaktualizon çështjen e ndërrimit të logos. Ose vërtet «imagjinon e shpreson» që një ditë nenet 1 dhe 55 të kartës së saj që thonë: Popujt kanë të drejtë në vetëvendosje, pavarësisht se a janë pjesë e një shteti apo jo ngase synohet një gjendje ku: «çdo popull ta ketë shtetin e vetë». Në këtë paragraf është e qartë se organizata dallon kombin nga shteti dhe atë bukur, por jo në logen kontradiktore të saj.

Përveç OKB-së janë edhe plotë shtete e organizata supranacionale që e përdorin termin jo në kuptimin e drejtë të tij, por edhe për shtetin duke e barazuar me nacion: nacionalja zvicerane për shembull! Zviceranët mund të thirreshin de facto poashtu në pjesën e kulaçit të gjermanofonisë (se kombi titullar është gjermanofoniku) si austriakët, mirëpo ata reagojnë me aversion ndaj një pohimi të tillë se nënkuptohen si qytetarë, shtetas e jo si allemanë. Pse atëherë quhen nacion? Sepse u është imponuar dhe nuk iu pengon se nuk i japin fare rëndësi në kuptimin siç bëjnë ballkanasit me komb-etni!

6. *Kombi në shkencat politike* - në këtë rrafsh shkencore rishfaqet problemi romak ndryshe. Perandoritë nuk ishin të krijuara nga «kombi titullar i demokracisë» por nga shkaqe tjera universale, respektivisht qytetare dhe diskriminimi i grupeve etnike vinte nga këto. Në kohën pas epokës së



kombeve janë etnitë shumicë që diskriminojnë pakicat brenda shteteve – se kështu ua mundëson demokracia. Dhe ky nuk është më problem se si duhet ta konceptojmë kombin, por si ta bëjmë të mundshme jetesën e më shumë kombeve brenda një shteti.

Gjitha debatet përtej pyetjes së fundit nuk kanë të bëjnë me kombin se çka është ai (quaje si të duash kulturor, etnik, biologjik), por me problemin e barazisë qytetare brenda shteteve ku jetojnë më shumë se një komb – pra siç është rregulli. Domethënë kërkohet një shtet që vepron në baza të barazisë qytetare e jo në baza të përkatësisë kombëtare. Shtet mund të krijojë një komb apo disa prej tyre.

*Qartë:* jo ekzistenca e kombeve është problem por mënyra se si menaxhojnë ata jetën në koekzistencë me tjerët.

### III.

*Kombi kosovar?* - Tash problemi ynë: a është Kosova komb? Nuk u krijua si i tillë. Si shtet i kombit kosovar. Kosova u krijua si Republikë e qytetarëve të Kosovës ku «komb titullar janë shqiptarët». Për së dyti herë. Publicistë të ndryshëm të Kosovës kërkojnë që kosovarët të trajtohen edhe si komb i veçantë. Kjo donë të thotë se ata kanë kopjuar (mësuar) iniciativën e Titos dhe Dimitrovit që nga një dialekt i bullgarishtes ta nisin ndërtimin e një kombi më shumë sllav brenda «konfederatës së tyre të imagjinuar» ballkanike. Dhe e bënë. Artificialisht. Me një facit: nuk shkon edhe gjatë kombi maqedonas do të jetë ai vërtet i imagjinuari se pa anëtarë ose ndryshe dhe që në fund do të bëjë çmos së paku për ta ruajtur emrin. Pse është kështu? Pikërisht se kombi nuk imagjinohet dot pa qenë të dhëna disa kushte konkrete si gjuha, vendet dhe mitet e kujtesës, varret, monumentet, shkrimi, simbolet, reliktet, ceremonitë, etnogjeneza dhe një varg tjerash.

A bëhen këto? Njeriu kur donë edhe në hënë bënë pushime, por Kosova ka plotë probleme tjera më të rëndësishme, akute, konkrete se sa të merret me idetë qesharake të publicistëve religjio-eksesiv apo që s'dinë ta ndajnë kombin nga shteti .

Kosova është shtet. Ajo ka të drejtë të barabartë në kombëtarësinë shqiptare sa edhe shteti shqiptar, prandaj poaq ka të drejtë të quaj gjithçka kombëtare (në sajë të përbashkëtës dhe jo të veçantës, se të fundit as nuk e dinë) si; teatri kombëtar i Kosovës (se gjendet në atë rajon gjeografik të kombit), përfaqësuesja kombëtare e Kosovës – në futboll e kështu me radhë. Të dyja shtetet mirëpo duhet të mendojnë se a do t'i quajnë ato tilla – institucionet – nëse në to inkuadrohen edhe serbët, turqit, pra qytetarë që s'janë të kombësisë shumicë. Shtetet pra do të vendosin se si do të përfaqësohen e jo kombi.

Duhet të vendoset një ditë se shtetet e Shqipërisë, Kosovës a do të vazhdojnë të quajnë „kombëtares“ e tyre kështu apo ndryshe, si në realitetit edhe janë: ato me kushtetutë, ligje, formë funksionojnë si shtete qytetare e jo në sajë të Kanunit të Lekë Dukagjinit (i cili poashtu është kompilim të drejtash tjera mesjetare) apo në emër të gjakut, etnogjenezës, fesë e yjeve. E kjo nuk e dëmton kombin shqiptar, përkundrazi e lartëson – sa më shumë të njohë e pranoj tjerët aq më i madh bëhet!

Askujt nuk i duhet edhe më shumë se një komb. Shtete të afta, të barabarta iu duhen shqiptarëve pavarësisht se në cilin jetojnë. Jo gjithçka është konstruksion. Përndryshe ti mund të quhesh edhe perandori askush nuk të arreston për atë punë. Se si të shohin e pranojnë tjetër – është poashtu temë tjetër. (2016)

## *Manifesti pragmatikëve*

Dy mendësi paskan kapur diskurset shqiptare; prijnë nacionalistët dhe nihilistët. Vërtet? Të parët i hasim gjithandej, të dytët nuk i gjejmë dot. Gjatë «debateve» rreth identitetit, bashkimit kombëtar, religjioneve, përveç etiketimeve tashmë klasike; «patriotë» e «tradhtarë» u adaptuan edhe kategorizimet si «nihilistë», «kozmpolitë», «servilë», etj. Edhe pse kjo nuk është ndonjë risi e diskurseve shqiptare – kur dihet se ato tradicionalisht përdorin sipas interesit përdhunimin e nocioneve – është interesante t'i përshkruajmë ato për të identifikuar së pari origjinën e klasifikimeve të këtij lloji dhe së dyti ta kërkojmë qëndrueshmërinë e tyre në realitetin shqiptar. Kush janë adresatët e kush adresantët e këtyre etiketimeve?

*Etiketat dhe sugjerimet* - Si patriotë, nacionalistë, atdhetarë, etiketohen autorë dhe publicistë që besojnë në idealet tradicionale e historike (që nga lindja e kombeve) të shqiptarëve për bashkimin e tyre në një shtet; të atillë që besojnë në supremacinë e «racës» dhe kulturës shqiptare. Kjo kategori nuk lejuaka tolerancë, me shpirtin në hundë e papushim apeluaka për realizimin sa më urgjent të «amanetit të të parëve». Edhe pse brenda kësaj kategorie militojnë edhe racistë, fashistë dhe ekskluzionistë, pjesa dërrmuese e autorëve seriozë ruajnë baraspeshën në shprehje duke

mobilizuar precedentë historike në favor të idealit që përfaqësojnë.

Nihilistë, servilë dhe kozmopolitë të kamufluar qenkan të gjithë ata që kundërshtojnë realizimin e pakusht të idealeve historike. Këta madje mohuakan në stilin nietzsche-an të gjitha vlerat ekzistuese shqiptare duke synuar instalimin e një metaidentiteti të huaj, nga jashtë. Sipas nacionalistëve dhe patriotëve ky divizion mendimtarësh do të sakrifikonte gjithçka për t'iu serviluar sa më thellë e më bindshëm SHBA-be dhe BE-së.

Afresku i Raffaello Sanzios në bibliotekën «Stanza della Segnatura» të Vatikanit.

Sipas këtij (vetë)përshkrimi të «polemizuesve» shohim se kemi të bëjmë me një konglomerat etiketimesh që e ndajnë diskursin shqiptar në dy grupe; në nihilistë dhe në nacionalistë. Është ky «portreti» real i mendimit aktual shqiptar apo etiketimet e kanë krijuar një fasadë të atillë që ta bllokoi shikimin më thellë pa depërtuar dot brenda në frymën e debatit?

Pas analizës disamuajshe të gazetave dhe portaleve shqiptare (të Shqipërisë dhe Kosovës) do të lehtësohemi duke u bindur se situata nuk është vërtetë aq dramatike siç na sugjeron fjalori i ekzagjeruar i temperamentit ballkanik.

*Platoni dhe idealistët shqiptarë* - Në njërin nga dhomat e Vatikanit, të quajtur «Stanza della Segnatura» gjendet afresku i famshëm i Raffaello Sanzios «Shkolla e Athinës». Një vizatim i populluar jo vetëm nga filozofët antikë, por aty majtas ndodhet edhe Jezu Krishti, Micheloangelo dhe djathtas vetë Raffaello. Në qendër të këtij afresku diskuton dyshja e famshme e filozofisë antike: Platoni me gisht të ngritur përpjetë nga qielli dhe Aristoteli me dorë të drejtuar tokës. I pari përfaqëson idenë (domosdo spekulativen), atë përmbi rëtë, i dyti mëton të djersitet duke mësuar së pari se ç'i

thotë realiteti, e përjetueshmja. Idealisti në bisedë me pragmatikun.

Platoni besonte – para tij budistët dhe hindutë gjithashtu – se idetë nuk rezultojnë nga procesi i të mësuarit, por ato ekzistojnë gjithmonë, ne veçse rikujtohem lidhur me to, që do të thotë se shpirti ekziston gjithmonë në të njëjtën formë, ai vetëm sa nëpër kohë ndërron subjektet humane (pra trupat fizikë). Sipas kësaj teorie duhet të besojmë se shpirti i Skënderbeut ende është në veprim në trupin e ndonjërit prej shqiptarëve të sotëm, ashtu si ai i Esat Pashë Toptanit, Enver Hoxhës, Isa Boletinit e shumë të tjerëve.

Dihet ndikimi i Platonit në formësimin e frymës evropiane ose siç thotë Alfred North Whitehead në librin e tij «Procesi dhe realiteti»: «Karakterizimi më i sigurve dhe i përgjithshëm i traditës filozofike europiane është se ajo përbëhet nga një varg fusnotash tek Platoni». Ky ndikim – më vonë i përhapur sidomos edhe nga të gjitha religjionet e mundshme – natyrisht që është pjesë edhe e reflektimit intelektual shqiptar. Jo si koncept filozofik (idealizmi), por si mendësi që sajton ose përçon idealizma nga e kaluara në të sotmen. Natyrisht se nuk duam t’ia mveshim nacionalistit shqiptar vetinë fetare të rimishërimit (pasi nuk shprehen në këtë drejtim) mirëpo gjuha e tyre imperative që kërkon prej «çdo shqiptari të mirë dhe patriot» t’i nënshtrohet këtij apo atij ideali historik, ndër të tjera pavarësisht rrethanave dhe kushteve reale në të cilat gjenden shoqëritë, vetëpërshkruan modelin e tyre frymor.

Idealistët si zakonisht vuajnë nga mungesa e «argumenteve tokësore» (vetëm i interpretojnë si të tilla) prandaj edhe burimin qendror të debatit të tyre e kanë historinë, e cila iu shërben si mjet për të sakralizuar idealin që përfaqësojnë. Për shkak të dashurisë së sinqertë ndaj «popullit», «gjuhës», «atdheut» ata fare pak marrin guximin të akuzojnë qeveritë, politikat dhe gjendjet e dërrmuara sociale

e maksimalisht kapen për armiqtë të jashtëm – edhe atëherë kur ata s’janë aktualë dhe mezi mbijetojnë vetë. Kjo shihet edhe tek etiketat që prodhojnë si nihilizmi, servilizmi e gjëra të ngjashme. Pse?

*Ku janë nihilistët shqiptarë* - Po rikujtojmë – ky është definicioni i popullarizuar dhe kështu e mendojnë shumica e polemistëve shqiptarë: me nihilizëm nënkuptohet mohimi programatik i të gjitha vlerave të mundshme (pra edhe kulturore, morale, sociale, historisë, traditës e kështu me radhë). Sa për sqarim: ky megjithtë nuk është nihilizmi i Nietzsche-s, i cili u ngjiz në shenjë proteste kundër mësimëve platonike të «kthimit të përjetshëm në aktualitet të së njëjtës gjë». Në shekullin XXI është problem të besosh në formulën e kthimit të përhershëm të së njëjtës ide, sepse ashtu siç kishte kuptuar qysh në kohë të vet Herakliti se gjithçka ndryshon, ribëhet, pra është një proces progresiv, kështu do të duhej të besonim edhe ne. Në gjithë debatin dhe duke lexuar gjithë autorët në hapësirën shqipfolëse, nuk e gjen qoftë edhe një softy nihilist e lëre më ndonjë radikal. Përkundrazi edhe të etiketuariat si nihilistë herë pas here idealizojnë më shumë se sa duhet vlerat dhe virtytet lokale, rajonale, gjuhësore e kulturore. Nuk kemi nihilistë. Çfarë kemi atëherë?

*Fjala e pragmatikëve* - Sidomos në publikimet kosovare dominon fryma e pragmatikëve. Ajo shkollë që e njohim nga mësimet e Charles S. Peirce, William James dhe John Dewey. Ky arsytim për dallim nga ai platoniku që kërkon sqarime mjegullave, por aristotelçe pra, i vlerëson «të vërtetat», opinionet, idetë dhe teoritë në bazë të mundësisë së realizimit të tyre praktik. Domethënë këta njerëz idetë nuk i marrin apriori si telegrame të dërguara nga përjetësia dhe shpirtrat e rimishëruar, por si mendime që duhen futur në laboratorin e jetës praktike. Nisur nga ky aspekt nuk del fare

i habitshëm fakti se shumica e komentatorëve dhe gazetarëve seriozë kosovarë i përkojnë kësaj shkolle reflektimi, kjo ndoshta ka të bëjë edhe me profesionin e tyre prej gazetarësh të konfrontuar për çdo ditë me terrenin dhe proceset shoqërore reale.

Së paku ndër ata që bëjnë opinionet shqiptare nuk shquhet askush për nihilizëm qoftë atij të modelit nietzsche-an e qoftë atij radikal. Kemi idealistë platonikë dhe pragmatikë, të fundit kësaj periudhe kanë marrë fjalën. Dhe mirë që është kështu. (2013)

PJESA E KATËRT  
*Agorat*



37.

## *Traktat dëshirash shqiptare*

*Hyrje*

«Nenikékamen» (fituam) bërtiti korrieri që kishte vrapuar nga Maratona në Athinë për ta sjellë lajmin për «fitoren» e grekëve ndaj persëve dhe ra përtokë, vdiq. Kështu duket shqiptari që nga dita e rënies së komunizmit; që nga dita e çlirimit të Kosovës. Kohë bilancesh. Jo në stilin broshuresk të Sami Frashërit «ç’kemi qenë, ç’jemi e ç’do të bëhemi», por më shumë çfarë nuk janë e çfarë dëshirojnë shqiptarët; ata nuk janë dashnorë të realitetit që kanë. E urrejnë atë. E çmontojnë përditë, madje do ta kishin këmbyer edhe me sekuencat më banale virtuale. Dëshirojnë më të mirin pushtet në botë pa u detyruar për një pushtet më të mirë ndaj vetes, në shtëpi, në mentalitetin individual, familjar, grupor. Mendësi paradoksale. Kërkojnë të pamundurën? Jo, dëshirojnë minimalen e së mundshmes që në qytetin real të të urtit amerikan David K. Lewis (*Plurality of Worlds 1986, Blackwell*) janë praktikë jo vetëm filozofike; atë copë lirie që kanë, duan të jetë e dinjitetshme. Dhe siç thoshte shkrimtari gjerman *Peter Bamm (Adami dhe majmuni, 1969)* «një dëshirë s’ka ç’humb përveç vetes kur realizohet». Sa reale janë dëshirat shqiptare? Mbase nuk i kuptojmë dot ëndrrat pa realitetin: Si duket ai?

*Nga njëra anë – përparimet!*

Në krahasim me shoqëritë përreth inteligjenca e përfillur nga mediat debaton suksesshëm për çdo tabu; as përballë çështjeve seksuale nuk druhet më. Historia e humbi virgjëritetin e saj sakral dhe diskutohet racionalisht si në gjithë atë botën e çliruar nga lugetërit e nëntokave muzeale. Denoncohen pafrikshëm politikanët afektivë bashkë me mushkarët e tyre në terren. Mediat kosovare (kryesoret së paku) nuk heshtin më para krimit as atëherë kur kryepatriarku i fisit më të madh të vendit kërcënon me gisht revolverashi. Shkrimtarë, poetë, piktorë dhe krijues të zhanreve të ndryshme deri dje të modës, kanë pensionuar «vullnetarisht» lapsat e tyre për ta sabotuar traditën monotone soçrealiste, duke u hapur rrugë kështu atyre pak autorëve që i kemi të rrallë e për mall. E ata tani e kanë fjalën: me veprat e tyre do – Beqë Cufaj si shembull konkret – që sot kanë përllarë e shpuar këndej e përtej muret e «*Europa universalis*» – it me mesazhe estetike të origjinës shqiptare. Në klubet e ajkave sociale nuk hyhet më vetëm me pasaportë klanesh, por edhe me individualitet. Grykësve u është zënë fyti me tarifën që morën nga masat; u është thënë manifestueshëm se nuk gëzojnë asnjë privilegj më shumë se sa i vdekshmi, i zakonshmi tjetër pa asnjë qindarkë në xhep.

*Nga ana tjetër – dështimet!*

«*Nenikékamen*» (fituam) bërtiti korrieri që kishte vrapuar nga Maratona në Athinë për ta sjell[ lajmin për «fitoren» e grekëve ndaj persëve dhe ra përtokë, vdiq. Kështu na duket shqiptari që nga dita e rënies së komunizmit; që nga dita e çlirimit të Kosovës. Ai fitoi lirinë për të vdekur çdo ditë nga mjerimi, nga keqtrajtimi, nga ngulfatja politike. Demokracia

ecën si një adaxhio në ato gramafonët defektuozë, zëprishur të paraluftës së dytë botërore. Politikani dhe gazetari bëjnë lojën e maces me miun: njëri maskon, tjetri demaskon, i treti plaçkit dhe i fundit ulërin dhe i tretet zëri pa e dëgjuar kush. Ka edhe politikanë të pafajshëm që distancohen nga fabrika mizantropike pushtetare, të atillë që harrojnë të bëhen të sinqertë deri në fund duke pranuar se janë dekor, trumpakët ushtarë të po atij legjioni ditëvrasës si të tjerët.

Qytetari me fytyrë të përplatur pas ndonjë rrëpire ta shton mallin e atyre artefakteve arkeologjike që besojmë se na i kanë lënë dinosaurët me plisa si testament: në portretin e tij e shohim historinë e nesërme të pushteteve të sotme. Shkrimtarët, intelektualët, akademitë nuk arrijnë ta gjejnë përgjigjen ndaj përse-së ontologjike; pse janë pikërisht në këtë epokë? Nuk dinë dhe nuk e pranojnë që iu mungon kapaciteti të dekodojnë realitetin. E kur nuk pranon, nuk ndryshon, nuk mëson, ke jetuar dhe vdes kot.

### *Në thellësinë e frymës – dëshirat!*

Të përshkruash anatominë e dëshirave është njëlloj sikur të bëhesh autor i «Uchronia: The Alternate History List» të motivuar nga psikanalisti Immanuel Velikovsky (1895–1979). Kjo metodë kontrafaktike tashmë e adaptuar, qëllimisht akronike, është bërë seminar permanent akademik për diagnostikët e kohës, sidomos atyre që duan të lexojnë dëshirat (edhe historike) e masave. Në thelb qëndron pyetja; si do të ishte sikur? Me këtë pyetje ia nisim maratonës së spekulimeve: Si do të ishte sikur shqiptarët ta bënë vetëkritikën parim të reflektimit të tyre; çfarë do të ndodhte nëse mediat e Tiranës do t'i lejonin opinionet vetëm si shoqëruese hulumtimesh faktike – siç ndodh rëndom në ca pjesë të tjera të botës – duke mos luajtur më rolin e prokurorit që shpif ose maskon. Si do të ishte nëse mediat e Prishtinës

kohë pas kohe do të përjashtonin vullnetarisht edhe snobizmin e ca opinionistëve të tyre nga epiqendra, siç me të drejtë ua bënë politikanëve në numrat e tyre festivë – qoftë edhe për hir të rigjenerimit intelektual, moral ose së paku duke ia përshkruar lexuesit krimin me fakte në vend të bërtitjes tashmë neveritëse «Ja krimineli, kapeni, vritnja, mbytnja». A do t'iu emigronte letra gazetave të Shkupit sikur ta sabotonin vijën mendore njëdimensionale, qoftë ajo edhe më e përkryera? A do të rrëzohej kryeministri kosovar nga fronti i tij bodrumor nëse do ta fillonte një debat të drejtpërdrejtë e tradicional me kritikët e tij më të rreptë? A do t'ua përlyenin laraskat kollaret ministrave nëse ata do të ulerin me grupet e shoqërisë civile për të kërkuar zgjidhjen e problemeve të shumta, madje edhe të atyre që nga padija i fabrikojnë për çdo ditë vetë? Do të plakej vallë kryeministri i Shqipërisë nëse në institucione kërkon mendjet produktive, integruese në vend të suflerëve, servilëve dhe mbarsësve të infantilitetit politik? Çfarë do të humbte shqiptari nëse dëshirën nuk e mat me xhepin personal, por edhe me nevojën e skamnorit pranë? Çfarë do të kishte ndodhur sikur shqiptarët ta pensiononin krenarinë e tyre për ca vite dhe të pranonin pa smirë të mësojnë nga të suksesshmit, jo të përkryerit që nuk ekzistojnë, por nga ata që nuk kanë ende probleme të kuptojnë se si instalohet demokracia, si gëzohet liria dhe si respektohet tjetri.

### *Apeli si shteg i vetëm*

Në fakt lista e dëshirave të përmendura më lart duhet të jetë programi moral jo vetëm i pushteteve, por edhe i të gjithëve. Madje njerëzit normalë, ata me skrupuj në pozitë me përgjegjësi do të ishin djegur gjer në hundë nga skuqja, nga turpi, sepse të pretendosh të jesh anëtar i klubit të të përzgjedhurve dhe të mos dish të lexosh as dëshirat më

elementare të shoqërisë (të çdo shoqërie) është më shumë se sa shkas për tu shporrur që andej, nga posti e kemi fjalën.  
(2013)

## *Res publica literaria [albanica]*

«Res publica literaria [albanica]» – sot do ta përkthenim kështu: «Republika e intelektualëve [shqiptarë]». Ka një të tillë? Nëse po, si funksionon ajo? Deri në shekullin 18-të si pjesë e kësaj republike përllogariteshin ata që publikonin, punime shkencore, filozofike, vepra letrare, pra intelektualët. Britanikët të njejtin «rrjet» deri vonë e quanin «republic of letters», sot gabimisht e kanë zëvendësuar me togfjalëshin «scientific community-n, që vetvetiu është një reduktim i kuptimit dhe ndikimit të asaj republikës së mëhershme.

Duke filluar që nga vitet 50-ë janë botuar disa dhjetra studime – ne ndërkaq përdorim referencat më të freskëta – që flasin për «Projektin europian të ilumnistëve» (Manfred Geier: 2012), për «Diskurset, polemikat intelektuale» të shekullit 20 (Dietz Bering: 2011), për «Tekstet themelore të kulturës europiane» (Hanjo Kesting: 2012 I-III) e shumë të tjera të mëparshme. Si bazë për dokumentimin e ekzistencës së këtij rrjeti ofrohen letërkëmbimet e Leibniz, Linné, Voltaire, Rousseau, Franklin, Newton, Diderot, Zola, Camus, Beckett e shumë intelektualëve tjerë të formatit universal.

Monografët e këtij versioni historik kanë imponuar bindjen sikur epokat si ajo iluministe, moderne, postmoderne të qenë programe intelektualësh të përbashkuar, me një qendër koordinimi e cila është kujdesur vazhdimisht për akumulimin e ideve dhe ndërtimin e strategjive të ndikimit, realizimit të tyre. Qëndron kjo apo më shumë del të jetë vepër e imagjinatës së pasardhësve që besojnë në aksiomën e

modifikuar nietzsche-ane që thotë se; meqënëse individi nuk ka guxim të marrë përgjegjësi për gjëra të mëdha shpik kolektiva?

### *Lidhjet dje*

Realsocializmi marrëzisht e dashuronte këtë ide, sepse përputhej me idenë e tij të kooperativizimit të frymës intelektuale. Bazuar e mbështetur pikërisht në traditën e «res publica literaria»-s, formalistët rusë Viktor Shklovskij dhe Juri Tynjanov- i arsyetonin metodën e tyre të përhapjes së «evolucionit letrar» hapësirave të botës së kuqe me anë të lidhjeve të shkrimtarëve, instituteve dhe misionarëve që stërviteshin në Institutin Maksim Gorki e ngado. Ata me këtë shpresonin se si iluministët, idealistët do përshpejtojnë zënien e epokës me frymën që sajnin.

Shoqëritë shqiptare, si satelite të hemisferës me drapër, yll e çekan, përvetësuan këtë formë organizimi ashtu siç bënte Qendra. «Lidhjet e shkrimtarëve» shqiptarë imitonin zbehtë por njëjtë synonin masivizimin e evolucionit letrar – si Moska dhe Peking. Çfarë sollën ato si përfundim? Më shumë qenë vegël e shtetit në deshifrimin e teksteve antishtet; linçimin e talenteve që s'iu lavirohej fryma e shpirti për diktaturën dhe; gjallonin si forume parazitësh socialë që jetonin në kurriz të bujqëve që mezi siguronin ekzistencën dhe qytetarëve që kishin frikë ta lexojnë ndonjë libër të ri se në mos nesër deklasoheshin shkronjat brenda tij tradhëti. Ato shërbenin edhe si klane rekrutimi, afirmimi, përjashtimi apo gjykimi.

Pas rrëzimit të sistemit monist shoqatat dhe lidhjet e intelektualëve humbën pushtetin, mirëpo jo edhe ndikimin. Ato filluan të jetojnë pa ideologjinë dhe shtetin, të fragmentuara, por edhe më tej (d)efektive, nuk veprojnë më intelektualisht, por si klane, klube, më shumë grindanjoze se mbledhëtare.

### *Klubet sot*

Sferat kulturore (hapësirat shqiptare dhe në diasporë) janë të populluara me plot shoqata, klube. Ato mund t'i klasifikojmë në tri kategori: A. Trashëgueset e lidhjeve nga socrealizmi B. Klubet dhe shoqatat që janë krijuar për inat të të parave se të përjashtuar dhe C. Asociacione të krijuara nga individë për çështje socialiteti e vetëkonfirmimi (në diasporë sidomos). Pse ky gjykim? Për shkak të efektit të tyre. Grupi A merret me vetveten; botohet, vetëlavdërohet, shpërblehet, zhvat para nga shteti. Grupi B mblidhet herë pas here dhe belbëzon me vetveten, mban kumtesa që depërtojnë jashtë vetëm si një lajm përgjysmëlënë gazete dhe përpiqen t'a bëjnë gjithçka më mirë se A me qëllim që t'ua marrin bukën. Grupi C sa herë që mblidhet mendon se shërohet nga kompleksi i inferioritetit – qoftë ndaj letërsisë së origjinës e qoftë ndaj vendeve ku jeton anonim (Rroftë Nietzsche që kish patur të drejtë me individët pa guxim).

Është kjo res publica literaria shqiptare? Qenka katastrofë. Jo nuk është kjo. Ka një «Res publica literaria [albanica]», mirëpo ajo funksionon krejt ndryshe.

### *Fryma si zyrë*

Studiuesit që përmendëm, ata që pretendojnë të historizojnë «res publica literaria»-n e epokave, vetëm kamuflojnë! Synimi për ta menduar iluminizmin, idealizmin, romantizmin si epoka të koordinuara intelektuale është po aq i kotë sa edhe hovi i formalistëve rusë. Është e vërtetë se intelektualët nëpër shekuj kanë korresponduar me letra por si? Voltaire qorton Rousseau-në se ky i fundit ia paskësh futur kot me mendimet e tij publike; Zola proteston për rastin Deryfus (13.01.1898) pa u konsultuar me njeri; Krijuesit e



teatrit, filozofisë e letërsisë së absurdit Camus, Ionesco dhe Beckett as që kanë llogaritur njëri-tjetrit edhe pse kanë jetuar dhe kanë frekuentuar pranë njëri-tjetrit përgjatë promenadës së lumit Seine, etj.

### *Kthimi nëpër oda*

Edhe res publica lieteraria shqiptare përbëhet nga intelektualë individualistë që herë pas herë marrin diskursin dhe opinionin në dorë pa asistencën e ndonjë klubi apo lidhjeje. Në perëndim asociacionet e tilla luajnë më shumë rolin e sindikatave për mbrojtjen e të drejtave politike, sociale të autorëve – jo më tepër. Asociacionet ndërkombëtare të këtij tipi deri më tani kanë kryer dhe kryejnë funksionin e njohjes ndërmjet autorëve të kulturave të ndryshme, mirëpo asnjëherë në historinë e tyre nuk janë spikatur për ndezjen e ndonjë debati, diskursi a paradigme universale. Si tek shqiptarët.

Ajo çfarë mund të thuhet është se: Shoqatat, lidhjet, klubet e intelektualëve shqiptarë deri tani dalin të mira për komunikim brenda një grupi të interesit. Po a nuk e luajnë këtë rol madje edhe me më tepër dinamikë, harmoni dhe muzikë çajtoret, kafenetë dhe odat? (2014)

*(Anti)nacionalizmi shqiptar**Historia e një polemike*

Dy modele nacionaliste iu imponohen shqiptarëve: I pari kërkon prej tyre ta përqafojnë etnonacionalizimin, ndërsa i dyti apelon për një patriotizëm kushtetutar. Shkencëtarët kërkojnë diçka të tretë. Se çfarë duan masat nuk di kush gjë prej gjëje. Historia e një debati të kamufluar. Njëra palë e paraqet etnonacionalizmin shqiptar si lugat moroz që mezi pret natën për t'i tmerruar të gjithë ata që tërbueshëm ngarendin që së paku kësaj radhe ta zënë epokën në kohë. Pala tjetër mundohet me laps, simbole, me djersë e ulëritje dridhëse ta bindë opinionin se etnonacionalizmi shqiptar nuk është si të tjerët, por Gabrieli vetë, ai engjëlli kryesor i Zotit që ushqen njerëzimin me vizione paqësore. Kundërshtarët e etnonacionalizmit kanë mobilizuar tonelata citatesh nga diskursat kontroverse intelektuale të perëndimit për të denoncuar teorikisht vampirin që sipas tyre ka mbetur i gjallë bodrumeve të Prizrenit e Vlorës që nga koha e osmanlinjve.

Etnonacionalistët, sidomos tani, në këtë stinë kuqezi të flamujve, miteve dhe simboleve, kanë ndezur turbogeneratorët e tyre, kanë hapur librat e historisë shqiptare dhe rreken të dëshmojnë se përse nacionalizmi me tirqe është i domosdoshëm, i shenjtë dhe model për gjithë botën.

Po të hulumtojmë gazetatat e disa mujave me rradhë do të vërejmë se kjo temë jo vetëm tani gjatë festave të 100 vjetorit të pavarësisë së Vlorës është aktuale, por ajo është njëra nga

më jetëgjatat në mediat shqiptare. Polemika është rrallë ballore e shpesh e shpërndarë dhe pa adresatë konkrete. Qëndrimet janë të qarta: shqiptarët janë nacionalistë (fort specialë faktikisht) dhe shqiptarëve nuk ju duhet etnonacionalizmi (gjë që domethënë se ka mjaft prani të këtij fenomeni), por vetëm patriotizmi. Në thelb të dyja palët pohojnë të njëjtën gjë konform asaj thënies «të gjitha rrugët të shpien në Romë». Përse vallë? Sa janë të drejta konstatimet se shqiptarët sot qenkan etnonacionalistë, patriotë, nacionalistë? Para së gjithash shfaqen patjetër pyetjet se cili është motivi, natyra, legjitimiteti dhe synimi i këtij debati?

### *Parakushtet për debat*

Përtej gardhit shqiptar kështu hapen debatet për çështje si «nacionalizmi», «patriotizmi», «demokracia», «ksenofobia» etj, ndonjë institut shkencor apo ndonjë shkencëtar i afirmuar hulumton disa vite rreth temës, ta zëmë «Masmediat dhe demagogët». Ai bën anketa me përfaqësues të shtresave të ndryshme të shoqërisë, grumbullon statistikën, vlerëson, i krahason ato me të mëparshmet dhe në fund jep konstatimet, rezultatet para opinionit. Si zakonisht shkencëtarët e vjetër u dalin rezultateve të tyre në mbrojtje dhe publicistët, kritikët kërkojnë dobësitë e studimit. Hapet debati. Nis polemika pro et contra.

Si hapen debatet te shqiptarët? Ato shfaqen si ide dhe diskutohen publikisht herë në formë polemike e kryesisht në formën e predikimeve apelative morale. Bazë empirike nuk kanë. Apo mos na ka shpëtuar diçka?!

### *Argumentet e etnonacionalëve*

Fondi argumentativ i këtij grupi janë librat e historisë, këngët, simbolet, mitet dhe festat, të cilat i marrin si dëshmi

dhe manifestime nacionaliste të masave. Sipas këtij botëkuptimi shqiptarët janë njëra nga racat dhe kulturat themeltare dhe më civilizuese të kontinentit. Shkaqet për «vonesat» epokale në konstituimin politik të kombit, formulimin e alfabetit dhe në krijimin e shumë faktorëve të tjerë identitarë e shpjegojnë me krimin e vazhdueshëm të barbarëve përreth, të cilët i kanë penguar qëllimisht shqiptarët që ta kapin me kohë rrotën e përparimit të historisë. Edhe pse gjithmonë në gjendje të luftës për ekzistencë, mbijetesës, shqiptarët kanë traditat, kulturën dhe shumëçka tjetër që i karakterizojnë si njërin nga kombet më të shquara.

Etnonacionalistët kërkojnë nga çdo individ që t'i mbetet besnik prioritetit të kombit. Me një fjalë: Kombi mbi gjithçka! Se vetëm kështu shqiptarëve nuk do t'iu përsëritet historia dhe do të hyjnë me dinjitet në sallonet ku prijësit e kombeve të shumta vendosin për fatet e planetit. Çdokush që vë në pikëpyetje këtë të «vërtetë» nuk është shqiptar i denjë, tradhtar pra!

### *Argumentet e patriotëve*

Doktrinën patriotike që shpërndajnë në praktike qeveritë shqiptare mund ta përmbledhim në këtë citat të kancelares gjermane Angela Merkel: «Patriotizëm është të pohosh historinë e kombit me të gjitha majat dhe dështimet e tij, ta përqafosh kulturën, gjuhën, këngët, të duash rajonet dhe natyrën e vendit, të respektosh njerëzit sipas arritjeve të tyre dhe përveç kësaj të bësh gjithçka edhe për të tjerët në shoqëri me qëllim që Gjermania në sytë e botës të dalë si një model i suksesshëm[...]» (Die Welt, 9.11.2004). Kjo retorikë nxjerr në pak një nacionalizëm gjithëpërfshirës, që do të thotë se parakushti për të qenë gjerman, respektivisht është të bësh për vete (të asimilohesh, shkrihesh) kulturën «homogjene» të kombit shtetformues.

Në gjuhën e teorive ky koncept quhet nacionalizëm gjithëpërfshirës, sepse ndryshe nga ai etnonacionali që është përjashtues, ky i dyti «nuk e diskriminon» askënd që pranon kombin kosovar, shqiptar. Së paku kështu deklarativisht.

### *Ç'thonë teoritë?*

Çfarë thonë për këto dy modele ata që zotërojnë edhe përgjigjet empirike rreth nacionalizmave, patriotizmave dhe ideologjive të tjera identifikuese?

Sociologu i njohur gjerman Thomas Blank ndau – njëlloj si në debatin shqiptar – atdhetarët në dy kategori: në patriotë konstruktivë, të cilët e duan atdheun e tyre pa urreyer të tjerët dhe që angazhohen në jetën sociale, si dhe në nacionalistë, të cilët janë shovinistë dhe që bazohen jo në sistemet e sigurisë qytetare siç bëjnë ata të grupit të parë, por që hiperbolizojnë vlerat etnike, hegjemonitetin kulturor, dominancën dhe që thelbësisht janë ksenofobë. Këtë teori e hedh poshtë Prof. Wilhelm Heitmeyer i Universitetit të Bielefeldit, i cili drejton një hulumtim terreni që ka nisur në vitin 2001 në kuadër të Institutit për hulumtime interdisiplinare të konflikteve dhe dhunës (botohet çdo vit një vëllim me statistika dhe rezultate shkencore nën titullin «deutsche Zustände») i cili thotë: «Ndarja e njerëzve në nacionalistë dhe patriotë nuk ka bazë empirike, por është e motivuar politikisht».

Njëri nga psikologët më në zë që po ashtu me vite të ka hulumtuar në këtë drejtim është edhe prof. Christopher Cohrs (Oxford University Press, 2012) e ky nuk sheh asnjë ndryshim mes etnonacionalistëve dhe patriotëve konstitucionalë: «Qytetarët, të cilët prioritet kanë kombin, pra identifikohen me të, shumë shpejt shndërrohen në intolerantë dhe ksenofobë. Njerëzit me ndjenja patriotike nuk e refuzojnë nacionalizmin dhe nëse e bëjnë këtë gjë, kjo është diçka thjesht e natyrës kozmetike». Këtë fakt e mbështesin edhe

studimet e psikologut Seymour Feshbach, i cili për vite me radhë ka eksperimentuar në këtë drejtim. Gjatë provimeve Seymour ka dhënë si detyrë tema që kanë të bëjnë me atdheun, patriotizmin dhe herë ka vënë të dëgjojen këngë patriotike e herë jo, kështu, sa për të analizuar transformimin e ndjenjës. Rezultati; «Provimet nën muzikë gati sa nuk të tmerrojnë fare për nga doza e shovinizmit. Ato pa muzikë janë “patriotike”, por gjithësesi të kthjellëta». Prandaj Seymour është i bindur se mes patriotizmit dhe nacionalizmit nuk ka asnjë dallim, thjesht sepse bëhet fjalë për ndjenja. Aty ku ndizet ndjenja e grupit, përkatësisë, rrjedhimisht e pëson detyrueshëm Tjetri, sepse «njerëzit sa herë që ti pyesësh se çfarë mendojnë për atdheun e tyre, ata automatikisht bëjnë krahasimin e tij me të tjerët». Këtu edhe qëndron sipas tij rrënja e çdo patriotizmi dhe nacionalizmi. Të njëjtën gjë e konfirmojnë edhe rezultatet e Institutit të Heitmeyer-it.

### *Atdheu dhe shqiptarët*

Të gjitha studimet e lartpërmendura janë bërë mbi masat popullore e jo me ideologët. Do të ishte interesante sikur ndonjë institut a shkencëtar shqiptar për vite me radhë ta hulumtonte masën popullore (subaltern studies) lidhur me atë se çfarë mendon për modelet e sipërpërmendura: Të pyeste për shembull ish-ushtarët e UÇK-së që mërdhijnë nëpër odat e tyre me xhama të thyera se si e ndjejnë veten duke qenë qytetarë të Kosovës së lirë; të pyeten të rinjtë që mezi presin ndonjë arsye apo rast që të ikin sa më shpejt diku jashtë Kosove për arsye se nuk shohin perspektivë; të pyeten pensionistët që me të ardhurat që marrin as bukën e gojës nuk e sigurojnë dot gjatë gjithë muajit; të pyeten emigrantët se përse nuk kthehen nga dashuria e malli në vendet e tyre të origjinës; të pyeten të papunët, intelektualët, gazetarët, shkrimtarët, publicistët, akademikët, bujqit, mësuesit se përse

çdo mëngjes kur zgjohen e para gjë që u bie ndërmend është ai Ligji i Murphy't («gjithçka që është bërë për të dështuar, do të dështojë padyshim»)? Çfarë përgjigjesh do të dilnin vallë?

Nëse shikojmë nga kjo perspektivë, nisur nga kjo gjendje reale e shoqërive shqiptare padyshim dhe me plot bindje mund të pohojmë se jo teoria e Angela Merkel, ajo etnonacionalistëve pra, do të na dilte si përcaktim përkatës, por ajo e Max Horkheimer-it që thoshte: «Patriotizmi në Gjermani është aq i tmerrshëm pikërisht sepse ai është kaq fort i pabazë» (1959). Do të përballëshim me rezultate që – ashtu siç është e gjithë historia e shqiptarëve fundja – të cilat do të na bënin të krenohemi para botës si njerëzit më pak nacionalistë të kontinentit, sepse krejt ndryshe nga gjermanët, francezët, gjermanët, zviceranët që megjithatë jetojnë në standarde ekonomike, politike e sociale shumë të mira, shqiptarët janë qytetarë shtetesh në krizë permanente ekonomike, sociale e politike. Shumë keq kjo për qeveritë e partitë të cilat siç duket s'ju pjell dot truri gjë më të mençur se sa vetëm nxitje e përflakje turbopatriotike, nacionaliste, por ndoshta i del mirë së ardhmes së Kosovës.

### *Koha e demokratëve*

E thamë pra: Debati nuk ka asnjë bazë empirike. Askush nuk e di saktësisht se çfarë do vërtet shqiptari i sotëm. Grupimet me simbole nëpër festa kanë karakter kohor dhe nuk mund të merren si indikatorë identifikues të një mase të konsiderueshme. Ajo çfarë mbetet është veç polemika. Ajo vazhdon si kacafytje idesh opinionistësh që krijojnë korrelacione iluzore duke ndërlidhur fenomene që nuk shkojnë asnjëherë bashkë. U pa se modelet në thelb kanë vetëm një dallim, krejt kozmetik pra: njëri shfaqet si nacionalizëm gjithëpërfshirës e tjetri si përjashtues.

Shkencëtarët thonë se ndryshimi real mes këtyre të dyve nuk ekziston fare.

Motivi i mbështetësve të dy modeleve të mësipërme duket qartë se është imponues. Ata duan që shqiptarët të zgjedhin mes dy modeleve. Po çfarë ndodh nëse shqiptarët e vënë prioritetin diku tjetër, në variantin e tretë? Atë që e proklamoniin Jürgen Habermas dhe Dolf Sternberger e që sot përkrahet zëshëm edhe nga elitat shkencore gjithandej botës, si për shembull psikologët dhe sociologët Daniel Bar-Tal (Izrael), Wilhelm Heitmeyer (Gjermani), Christopher Cohr (Britani), Seymour Feshbach (SHBA), pra si i bëhet nëse para të gjitha religjioneve politike, fetare, mbi të gjitha para historive dhe legjendave, gjuhës, fisit dhe gjakut, shqiptarët pranojnë demokracinë dhe lirinë e fjalës si kriteret qendrore identitare? «Jo patriotët, por demokratët janë qytetarët idealë të shtetit. Ai që respekton demokracinë ka një qëndrim krejt të kthjellët, të shëndoshë dhe kritik ndaj kulturës së vet etnike», thotë Daniel Bar-Tal. Pse jo? Ndoshta kësaj radhe shqiptarët vërtet kanë kapur ritmin e kohës dhe kanë filluar të prijnë në diçka në veçanti. (2012)



## *Dialektika e kosovarizmit*

Çdo shtet e ka një identitet kombëtar. Shqiptarët i kanë dy shtete dhe ende nuk e dinë saktë se sa identitete kanë gjithaq. Do thonë një, të tjerët dy, të tretët pesë e nuk mungojnë as ata që janë të bindur për asnjë. Historia e një debati që sillet në rreth.

Që nga shekulli i 19-të e këtej shumica e shteteve identitetin e kanë përcaktuar falë kapitalit historik të etnisë shumicë, kombit bartës, asaj shumice që edhe sot luan rolin e *supremus-it* gjithandej. Kështu është madje edhe në vendet ku shumica ose është e kamufluar ose vetëm një 0.5 përqind e pozicionon si etninë kryesore të një shoqërie. Nuk është ndryshe as në të të ashtuquajturat shtete me demokraci të konsoliduar. Me të drejtë shumica e shkencëtarëve sot pranojnë se debati mbi konstruktivitetin e modeleve të nacionalizmit (qytetar apo kulturor) del si sekondar. Fillimisht – kështu shumica e tyre tani – duhen zgjidhur telashet që Demokracia i bart në vetvete si sistem politik, ato «defekte» që e bëjnë atë tejet të brishtë (Höffe, Otfried; 2009 dhe Nolte, Paul; 2012).

Kombet duke qenë në pozitën e sundimtarit patjetër prodhojnë diskriminim në disfavor të pakicave me të cilat i konstituojnë shtetet përkatëse. Problem historik, që demokracinë si sistem e mban në provë. Përderisa një llogore shkencëtarësh këtë e sqaron si afekt të paevitueshëm të Demokracisë si sistem, tjetri grup e konsideron këtë si një

sabotim të kombeve, të cilat nuk janë të gatshme ta harmonizojnë aq sa duhet Kartën e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut me sistemin e tyre politik.

Të dyja versionet qëndrojnë. Problemi mbetet. Ashtu siç kritikonte Tocqueville (Mbi demokracinë në Amerikë; 1835/40); tirania e shumicës siç duket nuk dëshiron ta dorëzojë pushtetin ndonjëherë, sepse demokracia apriori favorizon shumicën numerike.

Përkundër pesimizmit të mendimtarit francez të para dy shekujve, kontratat supranacionale kanë arritur megjithatë të krijojnë atmosferë optimiste sidomos sa i përket preventivës kundër krimit politik ndaj pakicave dhe anasjelltas. Jo se organizatat ndërkombëtare kanë bindur politikat kryeneçe kombëtare me idetë humaniste mbi koekzistencën, porse kontratat i kanë ndërlidhur si kushte të detyrueshme për ata që synojnë partneritet të barabartë, subvencione dhe mirëqenie ekonomike (Sent, Amartya; 2012).

Problemi ashpërsohet tek shtetet me identitete të kontestuara ose tek ato që gjenden në kërkim të një identiteti. Mos-stabilizimi i identitetit të shumicës bartëse bllokoi procesin e përvetësimit cilësor të kontratave universale, me këtë edhe të një demokracie të qëndrueshme.

Ndërkohë që Shqipëria nuk do që të merret me këtë punë, Kosova gjendet në aortën e këtij problemi.

### *I. Situata*

Shumëkush mendon se Shqipëria sillet ndaj shqiptarëve jashtë saj, si Gjermania e Otto von Bismarck-ut ndaj austriakëve dhe zviceranëve. Nëpërmjet politikës së «përkujdesjes vëllazërore» ajo më shumë krijuaka përshtypjen e prindit të brengosur karshi djalit ende në pubertet, sesa që shpreh respektin e sinqertë ndaj pjesëve të barabarta të etnikumit plisbardhë. Lufta e kosovarëve për identitet

origjinal, të vetin, ndryshe nga shqiptarët e tjerë, paska filluar të marrë përmasat e një depresioni «elitash», i cili po ua manifestuaka si obsesion për të «dëshmuar» atësinë, supremacinë historike e aktuale brenda fiseve, gjakut e gjuhës. Shqiptarët jashtë shteteve shqiptare kanë probleme të tjera: ata të Maqedonisë qenkan tepër të zënë me përkryerjen e zanateve të tyre tradicionale të «burekxhiut, bakllavaxhiut, faraxhiut». Ata të Preshevës as gjeografikisht nuk qenkan ende të sigurt se nga duhet t'ia mbajnë e të tjerët qëmoti kanë harruar se jerusalemët ose mekat e tyre qenkan Tirana dhe Prishtina.

Për të guxuar një (para)gjykim rreth këtyre «paradigmave», lundrimi nëpër çështjet kontestuese është mëse i nevojshëm.

## *II. Koncepti identitar «tiranash»*

Shqipëria (kupto: mekanizmat relevante kulturore e politike) është më pak e ndjeshme rreth problemit të identitetit. Jo pse është e sigurt në supremacinë e saj historike e aktuale, por sepse formulimin e identitetit kombëtar të shtetit e sheh si proces të mbyllur. Nga ana tjetër shoqëria shqiptare më lehtë merr vesh për debatet që zhvillohen rreth prostitutave të Berluskonit (mediat e diçiturës dhe skandalit italik) se sa për atë se ç' debatojnë intelektualët kosovarë. Ky injorim prodhon depresione. Zhgënjimi vërehet në reagimet e jo pak intelektualëve kosovarë.

Përndryshe koncepti i «kombit» në Shqipëri duket se ka krejtësisht tjetër konotacion. Numri i të lodhurve nga patriotizmi, kombi dhe shteti është më i madh se sa i atyre që emocionohen sa herë që të ekzekutohet himni i flamurit. Shtoi kësaj edhe përvojën në totalitarizmin specifik pseudonacional të Enver Hoxhës dhe çështja bëhet fare e kuptueshme.

Ajo pjesë që mendon se identiteti i kombit shqiptar është i kryer arsyeton nisur nga një mendësi statike, refuzuese ndaj fluiditetit, mutacioneve dhe riformimeve, të cilave iu nënshtrihen mentalitetet dhe identitetet kulturore nga epoka në epokë, nga koha në kohë. Shqiptari i djeshëm i robotizuar me komandën e ideologjisë nuk ekziston më. Nëse ai dje kishte identitetin e servilit, viktimës ose të militantit enverist, sot ai ka marrë tiparet e një klaustrofobi kulturor dhe politik, një subjekti të cilit shpejtësia e informatave dhe dezinformatave ia ka hequr çdo mundësi vetëkontrollimi – sa për ta kultivuar një identitet të shtangur. Kjo mund të përgjithësohet pa problem kur flasim për masat. Hibriditeti qëmoti ka kaluar vijën e kuqe dhe kërcënon në mënyrë permanente me tëhuajësime grupore e kolektive sa herë që të dështojnë politikat.

Qarqe të caktuara dhe minore që preokupohen me zhvillimet në Prishtinë e Shkup lënë përshtypjen sikur merren me tezat e tyre (dhe t'i pranojnë ato) nga ndjenja e dhembshurisë, sikur i publikojnë ata më shumë për arsye kozmetike e në favor të «një bashkëpunimi vëllazëror kulturor» se sa sikur vërtetë të kenë zbuluar vlera të përmasave interesante.

Me një fjalë: Shqipëria, problemet tjera – në krahasim me atë të përcaktimit të identitetit – i konsideron më akute.

### *III. Tezat nga «Prishtina»*

Në Kosovë situata është ndryshe. Kosova është shtet i ri. E pasi ende vlen formula: s'ka shtet pa identitet kombëtar (OKB) është krejt e natyrshme përpjekja e elitave kosovare që të djersiten për ta përcaktuar një syresh. Në këtë kontekst tashmë në opinion kanë zënë vend tre teza kryesore: 1. Disa nga intelektualet me turmë pas vetes janë të mendimit se kosovarët nuk kanë nevojë «për shpikje identitetesh» sepse e

kanë atë. Atë që ka Shqipëria. 2. Ca të tjerë pa turmë pas vetes thonë vendosmërisht e sipërfaqësisht (më shumë si parullë) se kosovarët kanë identitet europian dhe kosmopolitan. 3. Pjesa e tretë thotë se Kosova është epiqendra e qenies shqiptare (duke lënë anash humorin e atyre që thonë se Kosova është djepi i qytetërimit botëror) dhe nga ky kënd duhet përcaktuar identiteti i kombit kosovar.

Përkrahësit e «tezës» (1) që thotë se kosovarët e kanë identitetin e tyre (atë të Shqipërisë zyrtare) mbështeten te gjuha, traditat dhe historia e përbashkët që kanë Kosova dhe Shqipëria. Argumentet e tyre nuk injorohen dot për disa faza të caktuara të historisë së ngritjes së këtij identiteti që daton nga fillimi i shekullit të 19-të.

Promovuesit e tezës (2) mbi natyrën europiane dhe kozmopolite të kosovarëve fakticitetin e sajojnë duke u bazuar po ashtu në fragmente dhe segmente të caktuara temporale e shoqërore nëpër të cilat kanë kaluar kosovarët nga mbarimi i Luftës së Dytë Botërore e deri sot. Zhvillime që autorët e kësaj paradigme i numërojnë edhe si procese historike tipike kosovare (kulturore dhe politike) dhe që kanë ndikuar në ndërtimin e një identiteti të ri, tjetër nga ai që pretendon teza e parë.

Radikalët e variantit të tretë (3) shkundin çdo hartë, libër e katalog për të lokalizuar ngjarje të ndodhura në rajonin e Kosovës historike (si territor) për ta shpallur atë si qendër zhvillimesh me përmasa universale e kombëtare. Gjë që si veprim nuk do të duhej të nënçmohej –thonë «neutralët» brenda këtij debati – po të mos ishte i prirë nga logjika e konkurrencës që ka për synim supremacinë dhe mohimin e ekzistencës historike të tjetrit (në çdo aspekt të kuptimit).

#### *IV. Përpyekje për një sintezë*

HISTORIA. Nëse heqim anash iniciativat individuale dhe kryesisht joserioze të disa autorëve për të krijuar një lashtësi speciale brenda territoreve a provincave të caktuara, atëherë përballemi me një interpretim unik rreth lashtësisë dhe mesjetës iliro-shqiptare. Në këtë kontekst mund të gjejë vend spekulimi që thotë se: shqiptarët nuk kanë kontestime ndërmjet veti për këto epoka sepse ato janë «vrime të zeza» historike, pra mungojnë faktet për të prodhuar interpretime në favor të këtij apo atij rajoni.

Më gjithë ato fërkimet lokaliste rreth Kuvendit të Prizrenit dhe Lidhjes Shqiptare (1878 – 1881) edhe këtu ende nuk ka dalë ndonjë diferencë historiografikisht relative. Strukturat e çdo akti të rëndësishëm historik që kishin të bëjnë me ndërtimin e identitetit të ri kanë qenë gjithmonë rajonalisht e konfesionalisht të përziera e të prira nga qëllimi konkret për një identitet panshqiptar.

Konflikti i parë serioz historiografik shfaqet me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në Vlorë (1912). Edhe pse pazëshëm shumica e kosovarëve (jo vetëm historianët, ndoshta më së paku ata) me këtë datë asociojnë një akt të «nguljes së thikës pas shpine» nga ana e shqiptarëve të Shqipërisë së atëhershme që projeksionohet në këtë të sotmen. Dhe jo vetëm ata. As shqiptarët e viseve të tjera duket se nuk e kujtojnë ndryshe këtë akt historik. Një segment i historisë shqiptare që kërkon trajtim objektiv.

Ndarja historiko-politike megjithatë do të ndodhë gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Kosova nis jetën nën kontrollin e një gjendjeje të jashtëzakonshme ushtarake dhe policore jugosllave, ku nuk do të mungonin as batalionet e proletarëve nga mëmëdheu i tyre. Në Shqipëri Enver Hoxha dhe Partia e tij shumë si shpejt i futën masat në kontrollin

total. Nuk shkon gjatë edhe Kosova «gjunjëzohet» dhe (me përjashtime – rezistencë – më evidente se çdokund tjetër) i hyn mundit të integritit brenda sistemit jugosllav.

**POLITIKA.** Për dallim nga shqiptarët e Shqipërisë, të cilët gjendeshin nën terrorin e një diktatori dhe sistemi që vriste çdo ide qysh në shpalljen e saj në formë të ëndrrës dhe ishin të detyruar dhunshëm në një „vita contemplativa ad absurdum“, kosovarët, menjëherë sa u ngritën në këmbë (intelektualisht), do ta nisnin luftën e tyre për identitet herë duke (keq)përdorur lëvizjet sociale globale (1968) e herë duke u bërë qëllimisht pjesë e lëvizjeve reformiste brenda bllokut «komunist» (1981) me qëllim të përmirësimit të statusit të tyre. Në këtë kontekst kosovari mblodhi një përvojë dhe vetëdije krejtësisht ndryshe politike e sociale nga ai i Shqipërisë. Zëri i kosovarit shkaktonte diçka, zëri i shqiptarit nga qelia e Burrelit nuk shponte muret. Për ato dyzet e katër vjet u krijuan dy sisteme të ndryshme të sjelljes sociale, politike dhe kulturore. Ibrahim Rugova, ende pa u zgjedhur çështja e Kosovës, u bë nismëtari – ndoshta nga analiza e tij mbi dallimet e krijuara – filloi me qëndisjen e një identiteti të ri historik (Dardania) për të shpallur më vonë edhe atë të riun aktual.

Proces që u finalizua dhe me njohjen e Kosovës si shtet të pavarur. Politika kosovare pa ndonjë zhurmë të madhe pranoi sugjerimet dhe propozimet e ndërkombëtarëve – as s’kishte se si të bëjë ndryshe – për një identitet të ri shtetëror, me një komb bartës ndryshe nga ai i Tiranës.

**KULTURA.** Në vitet e para pas LDB shkalla e analfabetizmit në Kosovë ishte shumë më dramatike se në Shqipëri. Mësues dhe profesorë nga Shqipëria përulanë qytetet dhe katundet kosovare duke dhënë një kontribut historik për arsimimin e kosovarëve. Sapo u bënë shkollat e para

intelektualë nga gjithandej (viset e tjera shqiptare në Jugosllavi) do të zgjedhin Prishtinën si qendër të tyre. Kontributi i të «jashtëmëve» në ngritjen e alfabetizimit dhe institucioneve të para kulturore në Kosovë është enorm. Aspekt historik që po ashtu ka nevojë për një trajtim objektiv shkencor.

Diktatura në Tiranë e vdiste çdo shkrimtar, ideator dhe intelektual që hapte dritaren për të marrë frymë jashtë burgut ideologjik. Këtë ajo do ta bëjë deri në rënien e saj përfundimtare. Kështu veproi edhe Jugosllavia e tretë në «ditët e para» të jetës së saj. Veçanërisht kur tendenca të tilla shfaqeshin nga radhët e popujve që nuk i takonin krahut sllav të projektuar nga Tito dhe Dimitrovi. Falë elitave të atëhershme intelektuale sidomos në Zagreb, Ljubjanë e pjesërisht edhe në Beograd, në Jugosllavinë pasmoskovite nisi reforma liberale në kulturë. Nga Zagrebi dhe Beogradi – përkundër prioritetit që mbanin ato të spektrit të majtë – vinin vepra të përkthyer që më parë ishin të ekskomunikuara si reaksionare. Disa nga intelektualët shqiptarë të Prishtinës, veçanërisht shkrimtarët, përdorën këtë rrymë liberalizimi për t’iu shpëtuar direktivave moskovite mbi artin dhe letërsinë dhe sollën në gjuhën shqipe frymën pasmoderne. Kjo rrymë letrarësh – edhe pse minore – do të bëjë të mundur që brenda letërsisë shqiptare mos të lulëzojë vetëm socrealizmi. Nëpërmjet mundësisë së pluralizmit letërsia shqipe do të kapë valën e temave universale që zhvilloheshin në Evropën e asaj kohe. Kjo frymë do të zgjasë deri në fillim të viteve 80-ë, deri atëherë kur rikthehet tema kyçe e ekzistencës kosovare; ajo e mbijetesës kolektive si etni brenda Jugosllavisë.

Shqipëria vazhdonte të burgosë çdokënd që ëndërronte ndryshe.

Si në politikë ashtu edhe në kulturë shihet se ekzistojnë dy rrugë me destinacione të ndryshme nëpër të cilat ecën Tirana dhe Prishtina.



GJUHA është problemi më i vogël kur kemi të bëjmë me gjetjen e elementeve të përbashkëta identitare mes kosovarëve dhe shqiptarëve jashtë saj. Dita-ditës shtohet numri i intelektualëve në Prishtinë dhe Tiranë që thonë se duhen hequr konditat gjuhësore të vëna në epokën enveriste. Kondita që diskriminojnë njërin nga dialektet. Gjë që qëndron. Në terren dhe praktikë mirëpo edhe ithtarëve më të rreptë të këtij ndryshimi u lotojnë sytë nga përdhunimi i trurit kur detyrohen të lexojnë veprat e shkruara në dialektin që preferojnë. Nuk janë mësuar, sepse që pesë dekada janë formuar gjenerata (së paku ata që kanë vizituar shkollat me seriozitet) me të ashtuquajturën gjuhë «standarde».

Përkundër fryrjes mediale që i bëhet kësaj çështjeje, gjuha po duket se bën një jetë krejt normale dhe të krahasueshme me kulturat tjera që shoqërohen me kontroversa identike. Edhe pse në hapësirën gjermanofone mendohet të ketë një gjuhë standarde (Hochdeutsch) ajo në praktikë kultivohet në tre variante të ndryshme (në shkrim dhe në të folur). Austriakët dhe zviceranët nuk e shkruajnë dhe flasin të njëjtën gjuhë «standarde» si gjermanët dhe anasjelltas. Kjo pa i futur fare në lojë dialektet (zviceranët e kanë për çdo fshat një dialekt të veçantë). Të njëjtin zhvillim e kemi te Frankofonët dhe anglezët dhe shumicën e të tjerëve. Interesant në këtë drejtim është fakti se këto zhvillime nuk janë konstruktuar me kongrese, përkundrazi kongreset janë detyruar t'i institucionalizojnë ato.

Të njëjtin zhvillim e kemi edhe tek shqiptarët. Gjuha standarde e Prishtinës nuk është e njëjtë me atë të Tiranës, të Strugës apo Tetovës. Edhe këtu pa futur patjetër dialektet dhe nëndialektet në lojë. Dallimi kundrejt kulturave tjera, të cilat institucionalizojnë dallimet, është se shqiptarët nuk regjistrojnë e hulumtojnë gjendjen e tyre gjuhësore, por e

politizojnë atë duke u përpjekur t'ia japin asaj direktiva që nuk e ndihmojnë çështjen asfare.

Nëse kosovarët apo shqiptarët duan patjetër që nëpërmjet një kongresi ta rikonfigurojnë gjuhën e tyre, mund ta bënin këtë në çdo kohë, mirëpo gjithmonë duke pasur parasysh defektin e demokracisë, pra tiraninë e shumicës dhe instalimin praktik që do të kërkonte edhe ca dekada për ta institucionalizuar. Kjo do t'i ngjante asaj punës me legalizimin e votës së grave në botën perëndimore; deri në fund të viteve shtatëdhjetë ato humbnin referendumet, sepse burrat vendosnin se a duhet të votojnë ato apo jo. Atyre nuk u mbetej asgjë tjetër vetëm të luftojnë me burrat e tyre në shtëpi. Gjendje që ndryshoi veç me ratifikimin e Kartës së të Drejtave dhe Lirive të Njeriut edhe nga ato vende që gratë donin t'i mbajnë vetëm si shishe nxehjeje ditëve të dimrit.

Ata që gjithçka çfarë kanë krijuar deri sot – shumica e elitave intelektuale – e kanë në gjuhën standarde as për çështje «patriotizmi» e as për çështje «lokalizmi» nuk do të dorëzohen aq lehtë.

### *V. Konkluzione ose kosovarizmi*

Nisur nga kjo gjendje faktike shihet se nuk kemi nevojë të jemi edhe gjithaq të mprehtë për të kuptuar se kemi të bëjmë me dy identitete të ndryshme kolektivash. Të bën kjo që të vajtosh apo është shkak për festë? Irrelevante. Me rëndësi është që të shohim se cila tezë, nga ato që shpalosëm më lart qëndron dhe se cili është në të vërtetë identiteti kosovar sot.

Teza e parë se shqiptarët e kanë një identitet kombëtar të njëjte me atë të Shqipërisë nuk qëndron. Ndërkohë dallimet në mentalitet, kulturë, sjellje sociale janë më të mëdha se sa ngjashmëritë.

Teza e tretë që thotë se Kosova është epiqendra e ruajtjes së identitetit kombëtar është pjesërisht e drejtë, kur kihet

parasysh këmbëngulja dhe rezistenca e kosovarëve gjatë dekadave të fundit. Tendenca e saj mirëpo për supremaci është arrogante. Sidomos karakteri i saj ekskluzionist brenda shqiptarëve (duke mohuar kontributin historik edhe të shqiptarëve «jokosovarë» në këtë histori) e bën atë joserioze.

Ndër më të spikaturat del teza e tretë. Ajo e identitetit «kozmpolitan european» të kosovarëve. Nuk e analizojmë dot këtë tezë tejet interesante pa bastisur kapitalin tonë të dijes për të parë se çfarë është identiteti european dhe çfarë është kozmopolitizmi? T'ia fillojmë me kozmopolitizmin: Cinikët dhe stoikët me kozmopolitizëm nënkuptonin krijimin e një shoqërie botërore (e gjithë bota në një sistem) ku gjithë njerëzit do të ishin të vëllazëruar dhe të barabartë. I inspiruar nga kjo ide Gotthold Ephraim Lessing do ta shkruante traktatin e njohur «Edukimi i racës njerëzore», në të cilin hedh parimet qendrore të filozofisë së tolerancës si garante të paqes shoqërore. Po të njëjtën ide Immanuel Kant do ta riformulojë në esenë e tij të njohur «Për paqe të përjetshme», ku formulon «imperativin e tij kategorik» si bazë të «Republikës së hapur».

Më 24. Gusht 1944 amerikani Gary Davis (My Country is the World (1960) dorëzoi publikisht në Paris shtetësinë amerikane dhe e shpalli veten «Qytetarin numër një të botës». Këtu e ka zanafillën lëvizja botërore «citizen of the world», së cilës iu bashkëngjiten edhe shumë intelektualë të kohës si; Albert Einstein, André Gide, Albert Camus, Jean-Paul Sartre, André Breton, Abbé Pierre e të tjerë. Lëvizja me zanafillë që nga lashtësia, e konsideron gjithë botën si një atdhe të tërë të njerëzve të barabartë, është pra një lëvizje kundër nacionalizmit dhe provincializmit. E morëm vesh se çfarë qenka kozmopolitizmi?

Identiteti european. Kush e ka lexuar dokumentin bazë mbi identitetin european, të aprovuar në Kopenhagen («Bulletin der Europäischen Gemeinschaften», 12. 1973, Nr. 12, Fq. 131-134) e di që BE-ja zyrtare me fjalën identitet

nënkupton «qëndrimin e bashkuar dhe funksional të kombeve anëtarë të organizatës» dhe asgjë më shumë se kaq (Paragrafi I).

E këtu s'ka ç'kërkon kozmopolitanizmi?

Pra kozmopolitanizmi nuk shkon bashkë me identitetin politik evropian siç konceptohet dhe perceptohet sot. Në një studim që mori dhënë dhe u përkthye gjithandej («A kanë nevojë evropianët për një identitet- aspekte kulturore dhe politike», Luzern 2012) 11 shkencëtarë evropianë që njihen si ekspertë të identitetit evropian bien në një mendje se kriteret e vetme dhe kryesore që përbëjnë identitetin evropian (të anëtarëve të BE-së) janë: demokracia, integrimi ekonomik, shteti ligjor dhe të drejtat e njeriut. Segmente ama që nuk janë as gjetje e as specialitet i kontinentit të veçantë evropian. Konkretisht: Evropianët (BE) nuk e dinë se çfarë të përcaktojnë si identitet në kontekstin kulturor. E sot, kur pjesa dërmuese e anëtarëve të asaj BE-së politike dhe ekonomike përbëjnë raste të rënda sociale, ideja për një identitet të përbashkët ka përfunduar në kasafortën më të padukshme të arkivave të mendimit elitar panevropian.

Të kthehemi në odat tona: Të quash Kosovën kozmopolite është një ëndërr dhe dëshirë fisnike, mirëpo në realitet e dimë fort mirë se kjo është edhe më kot se të gjithë tezat tjera. Nuk njohim asnjë parti, asnjë shoqatë, asnjë shkrimtar, asnjë poet, asnjë intelektual që për program eksplicit do ta kishte përvetësuar ideologjinë e Gary Davis-it apo të ndonjë tjetri në këtë drejtim. Kjo madje nuk është e dukshme as në kohën e asaj fazës pasmoderne në Kosovë. Një fllad të tillë e ndiejmë me vite (sa i përket universalizmit dhe kozmopolitizmit) nga intelektualë e letrarë të Tiranës e jo të Prishtinës (e kjo ka të bëjë me kushtet që i numëruam më lart). Të thuash se Kosova ka identitet evropian në një kohë kur Demokracia, shteti ligjor, integrimi ekonomik dhe të drejtat e

njeriut (kriteret e identitetit të BE-së!?) as që duken në horizont është vërtet «depression elitash».

## *VI. Çfarë identiteti kanë kosovarët?*

Asnjërin prej atyre që na e sugjerojnë tezat e sipërpërmendura. Masa popullore, kosovari i «rëndomtë» gjendet në hutim, ashtu siç gjendet edhe tiranasi, tetovari, tërnovcaliu ose ulqinaku. Ndoshta që të gjithë presin nga qeveritë dhe partitë e tyre që ato më në fund të arrijnë të emancipohen sipas atyre kritereve europiane (që nuk kanë të bëjnë fare me identitetin kulturor e tradicional të shqiptarëve si etni e shoqëri) të demokracisë, ligjësisë, mirëqenies sociale e pastaj t'i konsultojnë fiset se ç'të votojnë në referendumin e gjuhës, sistemit politik, federatave, konfederatave, flamurit, stemave, identitetit e probleme tjera të shumta që kanë.

Për të skicuar vërtet në mënyrë deskriptive (jo normative) se cili mund të ishte identiteti kosovar aktual, duhet më shumë mund se vetëm ca citate dhe parulla publicistike. (2012)

## *Shoqëria, si projekt intelektual*

Cili është projekti individual i politikanit ose i intelektualit shqiptar në favor të përparimit të shoqërisë kosovare, shqiptare? Kjo pyetje buron nga supozimi: Njeriu që merret me politikë apo ai që vret mendjen për të mirën e vendit, shtetit, demokracisë, lirisë, rri natë e ditë ulur në tavolinën e tij private të punës, me dritë e pa të, studion, lexon, krahason, llogarit, mendon gjerë e gjatë dhe përgatit konceptin e tij personal të veprimit në favor të atyre për të cilët angazhohet politikisht apo si intelektual.

Skena të këtilla nga historia kemi mjaft. Iluministët për shembull. Francezi Didero me vite sajoi projektin e tij për masivizimin e dijes, e cila atëherë ishte e rezervuar vetëm për aristokratë, klerikë e monarkë. Rousseau dhe Dickens-i gati me dekada vunë gjithë potencialin e tyre intelektual në shërbim të së drejtës së masave në arsimim human, të barabartë.

Reformatori Martin Luther ia kushtoi gjithë jetën po ashtu projektit të tij të proletarizimit të religjionit, duke sjellë si bonus bashkë me këtë edhe gjuhën e sotme standarde gjermane. Si në rrafshin universal, por edhe në atë lokal (etnitë, kulturat, kombet). Shembujt e këtillë janë ndër kapitujt më të rëndësishëm të historisë njerëzore.

Në historinë moderne shqiptare personalitete (lokalisht) që shihet të kenë vepruar me këtë sistem (pra jo si liderë

kauzash të gjata, konceptesh tradicionale e proceseve që për kusht kanë rastësinë “të jesh në kohën dhe vendin e duhur”) mund të numërohen: Faik Konica (iluminizmin kulturor) dhe Gjergj Fishta (Alfabeti, Monumentalizimi identitar- epi, bashkekzistenca fetare etj.), tek veprimtaria e të cilëve qartë shihen konturet e një sistemi të menduar formëprojekti. Të tjerë? S’ka rëndësi. Si është puna sot tek shqiptarët sakaq?

### *Politikani*

Pjesa dërmuese e politikanëve sot rekrutohen dhe angazhohen sipas këtij sistemi: nëpërmjet afërsisë rajonale, fisnore, miqësore, lidhjeve dhe të interesit personal ata aderojnë në një parti politike. Sapo shfaqen publikisht ata varrosin individualitetin. Nëse ua analizojmë deklaratat publike konstatojmë lehtë se paragrafët e programeve partiake që i belbëzojnë gjithandej ose janë abstrakte (se nuk ua dinë origjinën) ose e kundërta e tyre. Po ua qëmtuam axhendën e aktiviteteve mësojmë se asnjë ide konkrete nuk e kanë se si të ndihmojnë elektoratin dhe zonën që përfaqësojnë. Nuk kanë projekt personal për përgjegjësinë që kanë fituar nëpërmjet votave. Ose premtojnë e sjellin ide që nuk përputhen me të mundurën, të realizueshmen, sepse nuk e njohin as vendin e as problemet që duan t’i zgjedhin. Në vend të studimit dhe thellimit mbi problemet përreth, ata shërbehen me tema të mëdha si: religjionet, dijen, demokracinë, lirinë, identitetin, çështje këto që nuk trajtohen e zbërthehen dot nga shumica prej tyre, sepse nuk ua mundëson as habitusi e as kapaciteti që vitrinizojnë.

Kjo vlen edhe për primatët e partive politike. Ideologjitë e derdhura në programet e tyre politike janë formula tashmë të demoduara të partive tradicionale e historike të Evropës e përtej oqeanit, si ish të shabllonit majtas-djathtas, kapitalizëm-komunizëm e të llojit të ngjashëm. Janë

prodhime absolventësh të freskët të shkencave politike që si duket kanë mësuar paradigmat përmendësh dhe nuk i njohin as minimalisht realitetet kulturore, autentike, autoktone të vendit ku funksionojnë punëdhënësit e tyre. Me një fjalë janë përkthime të pavlefshme doktrinash e sistemesh të huaja që gjenden në një stad «shekujsh» parashqiptarëve e që nuk ndezin në shoqëritë që sapo kanë parë dritën e vetëqenies dhe lirisë.

Në dialogun me Serbinë si asnjëherë tjetër u pa se Kosova politike nuk disponon aspak intelektualë të mprehtë brenda vetes. Bisedimet ishin njëdimensionale dhe vetëm në favor të projektit të BE-së dhe atij serb. Nga kronika e bisedimeve, protokolleve dhe ngjarjeve lehtë bindemi se të tjerët kanë shkrirë energji intelektuale dhe strategjike për të realizuar synimet e tyre: me finesa, truke, teknika, po si në një lojë shahu, ku mjeshtrit u lënë kundërshtarëve hapësirë të manovrojnë vetëm e zhurmshëm me «bujqit», të cilët të parët nisnin ofensivën e sërish të parët gëlltiten lehtë nga «kërcyesit», «dama», «mbreti».

### *Intelektuali*

Intelektuali. Flasin për atributin më të inflacionueshëm në gjuhën e shqiptarëve. Po vazhdoi kështu, nuk zgjat edhe shumë deri kur njerëzit do të shprehin mosdurim sapo t'iu themi se janë intelektualë. Çdo shkronjës, vjershëtor, autor i ndonjë libri, gazetar, publicist, absolvent fakulteti, moderues, deputet e quan veten dhe e thërrasin intelektual. Kjo ndodh në shoqëritë me atë stad arsimimi që ende nuk mund të bëjë dallimin midis dy sferave shumë të rëndësishme: nuk e dallojnë dot përshkrimin e situatave, shumëfishimin e tezave të moçme, protokollimin e realitetit, citimin nga mendimi i thellë, autentik, origjinal, i cili citimet e përshkrimet i përdor vetëm si ilustrim e jo si maskë për të fshehur padijen dhe



mungesën e autoritetit brenda një teme të caktuar. Intelektuali dijen e fituar e përdor si instrumentarium për t'ia provuar idenë e tij origjinale retrospektivitetit e aktualisht, e jo si varg të ndonjë libri të shenjtë me kërkesën: shihe se Marksia paska thënë kështu dhe hajti të bëjmë të gjithë të njëjtën gjë.

Nga gjithë ato libra që kemi lexuar (dhe ne nuk i kemi lexuar të gjitha ndërkaq), artikuj, paraqitje autorësh, diskurse etj, nuk e gjejmë dot sa për ta identifikuar e lokalizuar një mendimtar shqiptar që përmes publicistikës, letërsisë, arteve të tjera, ta ketë ndonjë segment projekti (si ata që përmendëm më lart; arsimin, dijen) të vetin intelektual, apersonal në favor të shoqërisë. Jo të llojit të fiksuar me temat e ditës (punë komentatorësh mediatikë), por të atillë që një dukuri, proces e kanë bërë projekt personal mendimi, reflektimi e kërkimi i zgjidhjeve dhe vepron konkretisht në atë drejtim.

Nuk mund të ketë veprim të njëmendtë intelektual tek shqiptarët se përndryshe shqiptarët e shek. 21 nuk do të kacafyteshin ende me konceptet identitare të shekullit 19, respektivisht të (ri)lindjes së tyre kombëtare; nuk do të flisnin të gjithë për shtetin e keq pa pasur pikë ideje se çfarë është realisht shteti i mirë; nuk do të shkruanin për dashurinë, duke urreyer veten më së shumti; nuk do të ulërinin për lirinë, duke dëshiruar prangosjen e tjetrit; po të ekzistonte fryma vepruese intelektuale as ne nuk do ta shkruanim tani këtë tekst, por do të deshifronim me kujdes veprimtarinë e intelektualëve për t'i përçuar ato tek masat.

Ndoshta shqiptarët nuk janë populli i privilegjuar i frymës universale. Ndoshta, ata kurrë nuk do të nxjerrin nga vetja Goethe, Hegel-ë, Diderot-ë e të kalibrit, ndoshta ata do të ishin të lumtur po të kishin të tillë në miniaturë; minididerotë, minidickens-ët, intelektualë që kapacitetin e tyre do ta përqendronin për të mirën lokale, rajonale të tyre e ku ta dish duan muzat e veta dhe nëpërmjet lokale bëhen modele të aplikueshme për universalen. Më mirë diçka se hiç! (2015)

## *Shoferët e Chomsky-t*

Në rast se ndonjë institut botëror do të bënte një statistikë se ku gjendet numri më i madh i intelektualëve, padyshim se listës do t'i prinin: Tetova, Beogradi, Zagrebi, Tirana, Prishtina, Sofja dhe Virpazari.

Në një seminar bëra pyetjen: çfarë është intelektual? Njëra nga përgjigjet ishte tejet shpresëdhënëse: «intelektual është ai që punon me mendjen». Pra ai që mendon? A mendon bukëpjekësi kur kryen punën e tij? Po. Përndryshe djeg bukën, tha njëri. A është bukëpjekësi intelektual? Jo-erdhi përgjigja shpërthyeshem nga tjetri. Domethënë me rëndësi është se çfarë mendon? Njëri: për botën. Tjetri: për njerëzimin. I treti për Zotin. I katërti për shoqërinë e kështu me radhë. Po a nuk mendojnë të gjithë njerëzit nganjëherë se ata gjenden në tokë, se ajo është e populluar edhe nga qenia njerëzore, se shumica janë pjesëtarë të një shteti dhe jo pak njerëz besojnë në Zot? Sipas kësaj logjike pra, çdo njeri që ka aftësinë e të menduarit është intelektual apo jo? Jo! Bërtitën seminaristët. Dakord. U morëm vesh. Vetëm të menduarit si akt (bashkë me mundësinë e mediatizimit) nuk është as kriter e as indikacion se dikush është apo nuk është intelektual.

E çfarë është intelektual pra? Seminari përfundoi e ne as që ia kishim filluar.

### I.

Intelektualët. Flasim për një kategori, e cila sidomos në diskurset e shoqërive postkomuniste, ka më shumë anëtarë dhe ithtarë se çdo lëvizje tjetër politike apo religjioze. Të

krijohet përshtypja sikur në gadishullin ballkanik qëmoti gratë të kenë vendosur bojkotimin e lindjes së fëmijëve «normalë», pra të atyre me një frymë e shpirt «tabula rasa». Ato pjellin vetëm intelektualë: një lloj specie që detyrueshëm (gjenetikisht?!) është e dënuar me një megatru. Aq të rëndë sa dhjetë harddisqe kompjuterësh industrialë bashkë.

Pse ky kualifikim, epitete apo kategorizim të jetë aq omniprezent në frymën dhe psikozën e pikërisht atyre shoqërive, të cilat, dorën në zemër, më shumë sillen sikur të udhëhiqen nga ndonjë magji e zezë se sa nga ndonjë parim që për parakusht do të kishte arsyen e shëndoshë.

Para se të filozofojmë edhe më shumë rreth biografive, defekteve dhe deformimeve të tjera në shoqëritë, elitat intelektuale në shoqëritë për të cilat flasim, është mirë të zhytemi në vetë historinë e termave intelektualë, intelektualizmit, dhe zarzavateve të tjera teorike që janë bërë rreth këtyre epiteve. Ndoshta kështu do të na mundësohet që më mirë të kuptojmë udhëtimin dhe efektin e këtij cilësimi deri në psikologjinë e atyre që me një «lehtësi të paduereshme» pjellin intelektualë.

## II.

Sipas të gjitha gjasave përhapja e termit në fjalë nis me skolastikët proaristotelianë të mesjetës. Filozofët mesjetarë si Alberti i Madh, Okhami, Akuini e paskan përdorur kombinimin terminologjik «intellectus agens» (fryma aktive) për të përshkruar atë lloj fryme intensionale që apriori qenkësh në gjendje të njohë kuptimin transcendental (të padëshmueshëm në sferën empirike) të Qenies. Kjo troç do të thotë: frymë aktive (pra me njohuri, logjikë, arsye) është ajo që pranon ekzistencën e Zotit edhe pse atë nuk e kap, prek apo sheh dot. Kanti i përbashkohet kësaj teorie dhe e konkretizon edhe më shumë detyrën intuitive të intelektit për

të njohur të mbinatyreshmen. Edhe idealistët e tjerë gjermanë (Fichte, Schelling etj.) i mbeten besnikë këtij versioni duke e shpallur çdo regjistrim të drejtpërdrejtë të realitetit nga fryma njerëzore si pasuri intelektuale. Kuptohet, reflektuar nga perspektiva filozofike.

Në diskurset bashkëkohore – përtej gardhit ballkanik-vërehet një modifikim i shëndetshëm (sidomos si ilaç kundër snobizmit dhe megalomanisë makiaveliste) i kuptimit terminologjik të «intelektualit».

Albert Camus thoshte se intelektual është «ai njeri, i cili është në gjendje të mbikëqyrë (njohë, kuptojë) frymën e vetë». Naom Chomsky i konsideron intelektualë vetëm ata njerëz, të cilët janë në gjendje të përdorin trurin dhe njohuritë e tyre si kontribut në progresin mbarënjëzor. Në një fjalim të tij para UNESCO-s Gorbaçovi tha se: «intelektual është vetëm ai që në fokusin e tij qendror ka njeriun. Gjithçka tjetër është e pamoralshme».

Me Jean Paul Sartrin nis teoria e dekonstruksionit. Ky thotë: «intelektualët janë njerëz që për këtë apo atë arsye në ndonjë fushë të caktuar (shkencë, letërsi, mjekësi) kanë bërë famë. Ata e keqpërdorin këtë famë duke braktisur specializimet e tyre për të kritikuar rendin ekzistues të shoqërisë dhe bindjet e njerëzve në emër të një dogme globale (moraliste, marksiste etj.)». Po me këtë ton flet filozofi dhe sociologu gjerman Arnold Gehlen. Ky i fundit intelektualin e sheh si një njeri që për vete kërkon liri absolute e për të tjerët (vetëm) barazi. Në këtë drejtim shkojnë edhe përcaktimet e Sofsky-t dhe Adornos etj.

Varësisht nga autori dhe doktrina, intelektualit shpjegohet herë si empirist, herë si racionalist, herë si idealist, herë si kritik e shpesh ndaj tij shpifet edhe si etiketë ngushëlluese e idiotëve me dy këmbë në luftën e tyre kundër komplekseve e deformimeve mendore. Një përcaktim përmbyllës rreth kësaj teme nuk ka.

### III.

Përtej këtyre laboreve të doktrinave e filozofive të shumta, ekziston edhe perceptimi kulturor e nacional i termit. Pra çdonjëra shoqëri sillet në mënyrë të veçantë me identitetin e intelektualit. Do të ishte një punë e mërzhitshme të udhëtonim (qoftë edhe vetëm mendërisht) në Riad, Nju Jork, Tripoli, Pekin, Kinshasa apo diku tjetër për të kuptuar se çfarë nënkuptojnë ato vende me intelektualizmin. Në botën anglofone, atë frankofone dhe këtë gjermanofone (sipas diskurseve publike) ekziston një kompromis se kush nuk mund të quhet intelektual: Listës i prijnë Akademikët! Pasonjë politikanët, priftërinjtë, imamët, menaxherët dhe gazetarët redaksionalë. Kjo listë nuk ka të bëjë me atë se asnjë akademik ose prift nuk mund të jetë edhe intelektual, porse akademikët, politikanët dhe gazetarët më së shumti kualifikohen automatikisht dhe gabimisht si intelektualë. Një citat i Chomskyt në këtë drejtim besoj se sqaron çështjen edhe më qartë: «...Disa njerëz janë aq të privilegjuar, të pushtetshëm dhe konformistë saqë pa problem gjejnë rrugën deri tek publiku (përhapin veten publikisht), kjo mirëpo nuk e bën askënd më shumë intelektual se sa një shofer taksie, i cili rastësisht është duke menduar e reflektuar mbi çështje të rëndësishme shumë më thellë dhe ndoshta është edhe shumë më mençur se sa ai që vetëquhet intelektual.» (Naom Comsky, maj 2002).

Përderisa Chomsky vë theksin tek dendit, snobët dhe njerëzit e pushtetit (që nuk le anash asnjë politikan) Sartri është edhe më absolut: intelektualit është i pakorruptueshëm!

### IV.

Në të gjitha teoritë e përfolura më lart, një kriter – pra si parakusht për ta kualifikuar dikë si intelektual – duket se mbetet konstant për çdo teori: Ideja (natyrisht autentike, jo e kopjuar) e tij duhet të jetë në shërbim (pozitiv) të njerëzimit dhe universalisht si e tillë duhet të jetë e afirmuar, pranuar!

Analizuar shumën e përdorimeve të epitetit «intelektual», duket se në psikologjinë e masmediave të pjesës perëndimore të kontinentit ka triumfuar ky koncept, pra ai i universalitetit të idesë pozitive e të afirmuar.

Si duket ky perceptim? Një shembull konkret.

Të nisim nga provinca: Po themi se në Zagreb, Tetovë, Beograd, Prishtinë apo Tiranë jeton një i urtë (pavarësisht profesionit, zanatit apo statusit social që ka), i cili terrorizon trurin – jo nga pozita e një asketi në kërkim të mundësive për të pozicionuar veten – për të gjetur kuptimin e konflikteve ndëretnike, ndërnjerëzore në gadishullin ballkanik. Po si Descartes-it në atë furën gjermane ku i lind ideja e famshme për të shpikur filozofinë karteziante me atë formulën «cogito ergo sum», i lind edhe, të themi kësaj radhe tetovarit, ideja se si mund të nxjerrë nga balta morale, psikike e politike fiset e acaruara ballkanike. Pasi që i urti nga Tetova rastësisht ka mësuar shkrim- leximin ulet dhe e materializon tekstualisht idenë e tij. Pason një bum masmediatik. Filozofia e tetovarit jo që kontribuon për pajtimin e banditëve politikë të Ballkanit, por ajo përfshin madje krejt kontinentet dhe gjithandej ku mbizotërojnë konflikte ajo shërben si alternativë e re. Nuk ka rëndësi se në ç'formë filozofi tetovar e ka pagëzuar tekstin: si roman, si ese, si teori shkencore apo diçka tjetër, rëndësi ka efekti i saj në trurin mondan. Tetovari vazhdon të pijë çaji rusi dhe ta vrasë trurin duke kërkuar zbërthimin edhe të problemeve të tjera e të shumta të botës njerëzore.

## V.

Pra si duket intelektual i falë teorive që qëmtuam më lart, duke ia dhënë «tetovarit» rolin ilustrues?

Kur është pra një njeri i aftë për të plotësuar kushtet që nënkupton perceptimi historik . Kur dikush e ka bërë një libër me poezi? Jo. Kur ka marrë titullin e profesorit në një universitet? Jo. Sepse është politikan, kryetar shteti? Për arsye se ka shkruar ca romane apo libra që kanë të bëjnë me botën, zotin, tokën, njeriun, universin dhe nëntokën? Ndoshta.

Diçka është e paevitueshme: ai, detyrueshëm duhet të zotërojë një njohuri të thellë të kapitalit ekzistues kulturor (universal). Ky kapital (përndryshe si krahasojmë, analizojmë e gjykojmë) duhet dëshmuar me vepra (jo me prodhim personal librash) të pranuar në ndonjë provincë, komb apo lagje ku vepron i urti. Intelektual mund të jetë ai, siç thonë Sartri dhe Gehlen, që bind me sovranitetin dhe pavarësinë e tij, nuk i nënshtrohet as një segmenti komprometues të shoqërisë, grupeve e klaneve, ideologjive, por të vetmen instancë referuese ka akrepin e frymës së vetë.

Ky tip njeriu që analizon, gjykon, argumenton, kritikon, proteston, uron, lavdëron dhe përmbys edhe atëherë kur gabon dhe dorëzohet, konsiderohet dhe preferohet si intelektual në botën perëndimore. Të tjerët quhen specialistë, bujq, tregtarë, pra konform profesioneve që bëjnë për të ekzistuar.

Ky ekskursion i imi ndoshta e shpërfaq arsyen se përse në diskutet e gjuhëve europere ndimore aq rrallë «etiketohet» dikush si intelektual, tregon po ashtu se përse aq pak dijetarë anekënd planetit ia mveshin vetes këtë kualifikim. Çdo i urtë që njëherë është përballur me anekdotën sokratike «e di se nuk di gjë» dhe ka lexuar diku atë divizionin që e listuam më lart nga Alberti i Madh e deri te Chomsky, nuk ka guxim madje as rastësisht t'ia thotë vetes fjalinë «jam intelektual. Është intelektual» e gjëra të ngjashme.

## VI.

Padyshim se në Ballkan ka intelektualë. Të atillë që me teoritë e tyre krijojnë koncepte, rrugë e modele ndryshe e të reja rreth problemeve që e shtrëngojnë humanitetin në fyt. Një shembull i tillë mund të jetë filozofi slloven Slavoj Žižek, i cili për çdo ditë na e ofron nga një model të ri, alternativë etike se si duhet të funksionojë bota postkomuniste e –liberale, librat e të cilit janë bestsellerë në më shumë se tridhjetë gjuhë edhe pse bota me të cilën merret dhe stilin që praktikon parakushtëzojnë lexuesin të jetë i përgatitur akademikisht.

Natyrisht se ka edhe të atillë që, siç kërkon Sartre, Gehlen dhe Chomsky, nuk ia shesin frymën asnjë ideologjie, asnjë doktrine e madje as egos së vet – të pakorruptueshëm pra. Ata janë diku, ama nuk ndodhen në skenën intelektuale që mendojmë dhe besojmë ne dr ata janë.

Fabrikimi mediatic e kolektiv i intelektualëve në Ballkan nuk vjen si pasojë e faktit se atje vërtet gratë lindin vetëm intelektualë. Është çështje mentaliteti. Besimi i tepruar në vete i cili transferohet në formë projekcioni edhe te tjetri. Po e pyete një traktorist se a dëshiron të bëhet ambasador ai menjëherë ta tregon shtetin se ku mund të kryente punë të mëdha diplomatike. Po e pyete një mësues se a do të ishte bërë ministër ai menjëherë ta tregon dikasterin (mundësisht atë të mbrojtjes ku ka revole) për të cilin ka talent të jashtëzakonshëm. Të rrallë janë ata që kur ballafaqohen me një pyetje të tillë, marrin frymë thellë dhe fillojnë të qëmtojnë habitusin e tyre, për të konstatuar se çfarë do ishte më mirë; të vazhdojë punën e traktoristit apo t'i hyjë profesionit të gazetarit, diplomatit, pilotit, historianit, ministrit e gjëra të ngjashme, pra t'i përveshet një detyre për të cilën nuk ka pikën



e njohurisë, porse ka fatin që tezaku, daja, halla, shoku i klasës a shoku ideologjik t'ia ofrojë një mundësi të tillë.

Në këtë segment të mentalitetit ballkanik duhet kërkuar arsyeja se përse numri më i madh i atyre që besojnë të jenë intelektualë ka origjinë ballkanike. (2013)

## *Wikimania*

Wikipedia – enciklopedia më e absorbuar e planetit ka revolucionarizuar perceptimin human ndaj dijes. Për të mirë apo për të keq? Historia kontroverse e një biblioteke pa libra.

Denis Diderot, Jean-Baptiste d’Alambert, Ben Kovitz dhe Larry Sanger: katër emra, dy epoka dhe një ideal. Dy të parët janë iluministët francezë të shekullit 18 që bënë Enciklopedinë e parë. Dy të fundit na sollën para 12 viteve Wikipedian. Që të gjithë synonin përhapjen e dijes.

Gjersa Diderot, d’Alambert me kompani hoqën të zitë e ullirit derisa i sajuan 72000 artikuj shkencorë, Kovitz dhe Sanger gjithë problemin e zgjodhë nduke përtypur steaks-a në një restorant nobël të San Diegos, gjatë një darke më 2 janar të vitit 2001: jo librat, arkivat dhe dijetarët – siç bënë «pararendësit» e tyre – do të jenë burimi i enciklopedisë së shekullit 21, por «Netcitizen»-ët, ata pra që dinë të përdorin internetin. Qëketej kjo kategori do të kujdeset për distribuimin dhe administrimin e dijes.

«Dija nuk është për në ankand», kështu thonë profesorët e kërcënuar të perëndimit. Në universitete dhe media serioze ende vlejnjë rregulloret për (mos)përdorimin e Wikipedias si burim për citim a referencë. Histeri e tepruar?

*Universalistët shqiptarë*

Habitemi, shtangemi, mbetemi gojëhapur kur na bie të lexojmë serinë e kollumnave të ndonjë opinionisti shqiptar; para një jave përfoli paradigmat në historiografi, pardje citoi Nietzsche-n, Arendt-in, Judt-in, Ash-in, Gellner-in, Anderson-in, dje përshkroi anatominë e sistemeve politike, sot me shembuj atipikë nga letërsia botërore kërkon korrekturën e domosdoshme në mendësinë shqiptare si parakusht për ta kuptuar demokracinë, liberalizmin, nacionalizmin, patriarkalizmin. Nga ku gjithë ky erudicion që përbashkon «aq harmonishëm» shkencat si historinë dhe politologjinë, filozofinë, letërsinë, psikologjinë dhe psikanalizën? Kemi të bëjmë me ndonjë «Genius universalis» ose na u rishfaqën Polyhistor-ët, siç do t'i quanin grekët e vjetër? Të atillë që kanë mbaruar së lexuari e konfirmuari gjithçka e tashmë shkruajnë vetëm post factum? Jo. Edhe analiza më sipërfaqësore e teksteve do të na zhgënjëjë, sepse: nuk kemi të bëjmë me universalistë iluminatorë, madje as me kondenzues dhe transferues modest e banalë tekstesh nga gjuhë të huaja, por përballemi me absorbues të egër dhe distributorë aktivë të «dijes» nga online-enciklopedia Wikipedia.

### *Skandalet*

Mijëra reagime dhe fyerje mori gazetari Hiawatha Bray i gazetës «Boston Globe» (2004) kur shkroi: «Sigurisht se Wikipedia është e popullarizuar. Madje më shumë se sa duhet, sepse asaj i mungon vetia qendrore e një enciklopedie tradicionale: Besueshmëria! Përderisa enciklopeditë tradicionale përpilohen nga ekspertë të fushave përkatëse, tekstet e të cilëve i redaktojnë dhe kontrollojnë lektorët po ashtu specialistë, në Wikipedia shkruan çdo njeri që e ndjen veten si ekspert». Bray u shpall antidemokrati i radhës dhe u

krahasua me kundërshtarët e Dideroit dhe d'Alamberit, të cilët këmbëduar luftonin kundër masivizimit të dijes.

Tre vjet më vonë skandali «Essay» i dha të drejtë Bray-t të difamuar përtoke. Në shkurt të 2007 gazeta «New Yorker» zbuloi identitetin e rrejshëm të njërit nga Community Manager-ët dhe përgjegjësit të «Arbitration Committee» (Instanca që vendos se cili informacion është burim i qëndrueshëm), i cili gjatë një konflikti me një universitet paraqitej si doktor i shkencave teologjike dhe profesor në një Universitet të Amerikës lindore. Në fakt «Essay» ishte student (24 vjeçar) i semestrit të parë në një fakultet juridik dhe punonte si ndihmës në një praksë avokatësh. I njëjti kishte vendosur ose përpiluar mbi 20 mijë artikuj të edicionit anglisht të Wikipedias. Përkundër zotimit të projektbartësve se «editorët» do të identifikohen Wikipedia u ndalua si referencë nga një numër i konsiderueshëm mediash dhe universitetesh.

### *Studimi*

Njëri nga studimet deri më tani më të afirmuara mbi karakterin e Wikipedias mbetet ai i profesorit të Universitetit Albany të New York-ut P. D. Magnus. Rezultatet e studimit disavjeçar epistemologu i botoi në revistën «Episteme» (Viti 6, Nr. 1, Faqe 74-90) nën titullin «On Trusting Wikipedia». Faciti: «Wikipedia nuk e plotëson asnjë kriter të vetëm që shërben për verifikimin e dijes, prandaj dhe nuk mund të përdoret si burim i besueshëm». Magnus – studimi i të cilit nuk ka përjetuar falsicitet as nga prindit e tezës «pjesëmarrja e sa më shumë kokave rit kualitetin e dijes» – nuk beson se ndonjëherë enciklopeditë e tilla do ta arrijnë atë besueshmëri që kanë bibliotekat dhe enciklopeditë klasike. Me të drejtë të moshuarit e tipit të Umberto Eco-s humbin orë duke u

vërdallë bibliotekave dhe duke refuzuar kategorikisht Wikipedia-n?

### *Stupipedia shqip*

Jo vetëm Wikipedia por interneti në përgjithësi ka banalizuar rëndë statusin e dijes. Përveç kësaj W3 dhe Web 2.0 kanë ndikuar që plagjiatura, keqcitimi dhe tjetërsimi të bëhet aq neveritës saqë jo pak specialistë të shkencave të ndryshme kanë krijuar alergji ndaj internetit. Ashtu siç mund t'i bëhen averzion çdo specialisti shqiptar gazetaret dhe portalet shqiptare ku citatet, përfolja dhe referencat janë tmerr që ta shkaktojnë epilepsinë. Sheshazi shihet se autori as ato dhjetë libra që ka në shqip nuk i ka konsultuar kur flet për paradigma, biografi, fenomene, filozofi e probleme.

Kjo përshtypje nuk krijohet vetëm atëherë kur zbulojmë se autorëve u mungon background-i i nevojshëm akademik (kjo nuk implikon se ndonjë që nuk ka kryer shkollë nuk mund të jetë Genius Universalis) porse lehtë e identifikojmë burimin, wikipedian, dhe sapo përvishemi ta gjejmë qëndrueshmërinë e paralelitetit brenda krahasimit të ekspozuar na del parasysht ai «Essjay» duke fërkuar hundën pas ndonjë avokati nervoz. Në të shumtën e rasteve jo vetëm konteksti është falsifikuar deri në asht, por shumica e civateve dhe paradigmave janë e kundërta e asaj që sugjeron cituesi për ta mbështetur tezën e tij.

### *Alternativa*

Në botën gjermanofolëse janë të rralla ato universitete që mbyllin njërin sy kur vërejnë të jetë konsumuar Wikipedia gjatë ndonjë punimi shkencor. Pjesën dërrmuese të mediave serioze të kësaj hapësire i shpëton sistemi se si punësojnë redaktorët dhe gazetarët: specialisti i ekonomisë është shëf i

rubrikës që merret me ekonominë, ashtu ai i politikës, letërsisë, historisë e kështu me radhë. Kjo nuk do të thotë se madje as Jürg Habermas nuk guxon të botojë reflektimet mbi tema që kërkojnë dije universale. Ky po. Ama jo gjithkush, jo çdo user që di të (keq)përdor Wikipedian. (2013)

## *Gramatologjia e «like»-ut*

Pse plotë autorë shqiptarë kanë drojë nga rrjetet sociale? Shumica prej tyre i përloçin ato.

«E dini se nëpërmjet linjës telefonike bëhet bartja e bacileve», thotë «gruaja e çmendur» në filmin «*Sisters*» (SHBA:1973), të Brian De Palma-s. Psikotrileri me aktoret famoze Margot Kidder dhe Jennifer Salt ndonëse s'ka për temë diçka si bacilofobinë, nomofilinë apo teknofobinë por çrregullimin disociativ në identitetin e njeriut, ai megjithatë transmeton një numër të madh kodesh që të bashkëshoqërojnë hapësirave të mentalitetit të kohës. Në njërën nga ato zona përballemi me frikën nga teknologjia (teknofobinë).

Në kryeveprën e tij «*À la recherche du temps perdu*» („Në kërkim të kohës së humbur“: 1913 – 1927) Marcel Proust na i përshkruan mahnitshëm arsyet e refleksit, si frikë për të qenën, nostalgji për të shkuarën dhe shok nga e panjohura, e reja. Shtresat më të prekura nga psikovalë kësodore, gjithmonë kanë qenë të paarsimuarat. Unikate janë rastet intelektuale që kanë mbetur si retro-simbol kundër zhvillimit, ndryshe kjo edhe do të binte në kundërshti me natyrën e tyre të supozuar avantgarde. Rastet e veçanta të refuzimit kokëfortë e të qëllimshëm të së resë, në histori kanë mbetur më shumë si akt rezistence ndaj kapitalizmit, komunizmit, imperializmit se sa si paranojë apo paaftësi e një gjenerate, që as për vdekje nuk lëshonte lapsin nga mesgishtat ose nuk e kapte telefonin me dorë.

Në këtë linjë, me këtë rrëfim mirëpo nuk e analizojmë dot distancën gati shqetësuese të «elitave» shqiptare ndaj rrjeteve sociale. E para: ngase Telefoni ishte një aparat që nuk paraprinte ndonjë mjet parapërgatitës, ai u shfaq si aparat demonësh që thirrke zërat nga fundi tjetër i globit, interaksion që deri atëherë ishte liçensë e rezervuar vetëm për shtrigat dhe magjistarët, ata që sajnin shtihanën e komunikimit me kufomat dhe e dyta: Treni i Proust-it, që poashtu si gogol frikonte apaçët, shkaktoi tërmet mental e frymor sepse vuri në pikëpyetje perceptimin e deriatëhershëm të kohës, pra sugjeroi tek normalët, të vdekshmit përshpejtimin e kohës, shkurtimin e jetës, që domosdo sugjeronte fobinë e radhës.

### *Problemi*

«Elitat» shqiptare para shpërthimit të mediave të reja kanë pasur mundësinë e integritit hapëror: domethënë njohin telegramin, fax-in, telefonin, makinën e shkrimit e kështu me radhë. Pra nuk përkon me biografinë e tyre frika nga aparatura dhe teknologjia e re.

Nga qëndrimet, shprehjet dhe deklaratat që kemi mbledhur në rrjete dhe nëpër media tjera mirëpo rezulton se shumica e shkrimtarëve me emër, të rinj e të vjetër, autorëve, intelektualëve, politikanëve, akademikëve, shkencëtarëve – edhe atyre që pro forma janë prezent në rrjetet sociale – të jenë përbuzës, përilloçës, injorues, fyes ndaj rrjeteve sociale. Nëse nuk është mjeti i interkomunikimit problem, atëherë çka? Njeriu që fshihet pas «liket»-ut apo frika e autorit nga përumbja, si i fundit i birës së fyellit për shkak të konkurrencës së madhe?

*Çka fshihet pas «like» - ut*

Michael Kosinski me kolegët e tij të University of Cambridge, në një studim (2013), gjatë të cilit hulumtuan,



analizuan dhe vlerësuan «like»-ët e 58 mijë përdoruesve të facebook-ut e krijuan një shabllon të shkëlqyeshëm se si nëpërmjet frekuencës së përdorimit të butonit të pëlqimit mund të shpalosh vetitë e profileve me një saktësi marramendëse prej 98%. Interkomunikimi dhe aktiviteti «live» po edhe ai i «përqendruar» japin madje informacione (gjatë analizës) të cilat përdoruesi – as në kontakt fizik – nuk i ekspozon kurrë. Pas publikimit të këtij dhe shumë studimeve tjera anësore facebook-u është bërë njëri nga referencat me verifikueshmërinë absolute si referencë për të ndërtuar psikografitë, gjendjet, prognozatat, në relacionin individ-grup-shoqëri, mbi interesat politike, kulturore, pra për të çdo segment që ta synoj hulumtumi.

Këtë metodë e përdorëm në kontekst me temën.

Për të filtruar sadopak sjelljen e «like»-rëve karshi prodhimeve intelektuale si; proza, anekdota, poezia, piktura, pra të atyre zhanreve nga të cilat jetojnë dhe kërkojnë lexues/recipientë/shikues të njëjtët autorë dhe «publicistë» që kanë probleme me rrjetet sociale. Të njëjtin hulumtim e bëmë paralelisht edhe në dy zona tjera; në atë zviceranën dhe në atë kroaten. Gjersa në atë zviceranën interregimi për zhanret që folëm pothuaj është inekszistent në atë kroaten, brenda komuniteteve të vogla dhe të specializuara, kujdesi ndaj autorëve ende nuk është zhdukur krejt. Në grupet, profilet, komunitetet shqiptare të facebook-ut rezultatet janë krejt ndryshe: mbizotëron një aktivitet i dendur jo vetëm «pëlqimesh sipërfaqësore» por edhe deklarimesh (komentet) që tregojnë për cilësinë e recipientëve si analizues dhe vlerësues të prodhimit».

Patjetër në këtë kontekst duke mos harruar se plotë edhe aktualizojnë atë problemin nga i cili kishte frikë Wittgenstein kur thoshte: «kur feston gjuha lindin problemet e vërteta filozofike», pra facebook dhe rrjetet tjera sociale nuk janë *florilegiumi* i perlave të të shkruarit bukur, mirëpo sot tashmë nuk mohohet

ajo që e kemi definuar para shumë viteve si «Cyberpoetikë shqiptare» (Ahmeti, Xh: 2012) dhe që është më dinamike se edhe vetë klasikja.

### *Frikat tjera*

Pse atëherë aversioni i autorëve? Problemi ekziston diku tjetër. Dhe ka të bëjë me statusin social si dhe kushtin e rrjeteve; ato përveç *neto-s* kërkojnë edhe *bruto-*prodhimin e krijuesit. Si duket nëse një poet si XY gjatë komunikimit të shkruante qoftë konceptualisht e qoftë gjuhësisht njëjtë si ndonjë komentues i frustruar, të cilin shpesh nuk e merr vesh se me kë është duke polemizuar? Do të dukej pra keq. Tjetra: deri vonë autorët kanë botuar libra, janë bërë ca recesione kryesisht afirmative, janë mbajt ca orë të kota letrare dhe autori është kthyer në studio për ta sajuar «kryeveprën e radhës». Distanca ka mundësuar legjendat, mitet, ruajtjen e kultit: *ja doli, vjen duke hapëruar, duke tundur kokën, shihe shihe ia dha dorën këtij, e njohka atë*. Sot kjo distancë dhe ekskluziviteti i përfojles së veprës vetëm nga mediat nuk ekziston më. Dhe autorët që nuk përfillen – përveç atyre që për shkak kualitetit barten edhe nga tjerët e nuk kanë nevojë t’iu përshtaten kushteve të kohës – nga rrjetet, grupet dhe komunitete sepse nuk i prek gjë në nerv, mbeten me 35 lexues dhe 12 lavdërues.

Përmbledhtazi: Aversioni i autorëve ndaj rrjeteve sociale, sipas hulumtimit mund t’i këto tri arsye:

1. Frika që të mos humb autoritetin nga interreagimi «live» se aty nuk janë redaktorët dhe korrektorët.
2. Nënçmimi i atyre që gjenden pas «like»-ut si turmë e pashkollë, primitive.

3. Arsyeja që mos të humb kohë (mirëpo këto nuk kanë përbuzje, nuk demonizojnë mediat sociale siç bëjnë autorët për të cilët e kemi fjalën, se megjithatë disa prej tyre janë aty). (2015)

## *Frika nga (auto)kritika*

Autokritika duket të mos jetë veti e plisbardhit. Sapo shfaqet ajo, menjëherë mobilizohen avokatët e racës dhe gjakut për ta denoncuar si tradhti. Janë shqiptarët të pagabueshëm, maratonomakë për nga pastërtia morale (cilado) apo kanë frikë të konfrontohen me veten? Millefin kundër «parajsës së derrave» – siç e quante Victor Hugo pushtetin e Napoelonit III– e shprehu nëpërmjet poezisë «Ndëshkimet» dhe iku nga vendi. Charles Baudelaire me «Lulet e së keqes» bëri portretin e një kryeqyteti të korruptuar, të zhytur në amoralitet dhe të ngjashëm me Hadin. Gustav Flaubert gjendej para gjyqit për romanin e tij «Zonja Bovary», atij romani të inspiruar nga një qytetare e vetëvrarë, e cila e nxiti autorin të vërë në pikëpyetje moralin dhe mendësinë e asaj kohe. Hugo, Flaubert dhe Baudelaire nuk ishin të vetmuar në luftën e tyre kundër diktaturës fabrikë-tmerri.

Përkundrazi: Nëse studiojmë letërsinë dhe publikimet e asaj periudhe franceze, nuk do të gjejmë gati asnjë shkrimtar të rëndësishëm që në një mënyrë apo tjetër nuk ka rezistuar ashpër kundër krimeve të shtetit. Se sa radikale dhe sa e hershme ka qenë kjo luftë intelektuale franceze kundër defekteve sociale e politike, dëshmohet edhe nga ky apel i poetit pak më të njohur Théodore Agrippa d'Aubigné, shkruar dy shekuj më parë kundër hierarkisë sunduese: «t'i hedhim të gjithë në pusin e harresës dhe ta mbyllim varrin».

Në historinë e kryeneçsisë intelektuale franceze edhe një segment tjetër është shumë interesant: edhe atëherë kur në krizat e vendit ka qenë shkaktar ndonjë faktor i jashtëm shumica e intelektualëve nuk e kanë shpërqendruar adresën e kritikës, por gjithmonë duke vepruar në bazë të asaj logjikës «të rregullojmë së pari shtëpinë, pastaj e kemi lehtë».

Ky ekskursion nëpër historinë e inteligjencës franceze natyrisht që na përball me pyetjen: si duket historia e intelektualëve shqiptarë në këtë drejtim?

*Vetmia e Faik Konicës*

Përjashto Faik Konicën – i cili megjithatë del i përmbajtur në këtë kontekst – nuk gjejmë figura intelektuale që t'i analizojnë gjendjet shqiptare dhe që për motiv do të kishin pasur iluminimin e tyre. Edhe autorët si Migjeni që mallkojnë mjerimin e dukuri të tjera kurritzhyese për shqiptarin e kohës, prapëseprapë nuk i dekonspirojnë shkaktarët, përgjegjësit, kështu që vaji del atopik, pa adresë. Natyrisht se kushtet në të cilat ka ekzistuar shqiptari nuk mund të krahasohen me ato të francezit dhe popujve tjerë perëndimorë të kontinentit, sepse njeriu shqiptar deri para dy dekadave (pjesërisht edhe sot) është komanduar nga instinkti i mbijetimit, ekzistencës. Luftë që nuk i ka lënë atij edhe gjithaq kohë që të reflektojë mbi pyetjen thelbësore dhe deri sot akoma pa përgjigje si: pse pikërisht ne? Pse pikërisht shqiptarët të jenë – krahasuar me të gjithë përreth, më të vonuarit, më të shtypurit, maratonomakë për nga përvoja historike e robit?

*Rënie vlerash? ku, kur?*

Ka mundësi që historia e shqiptarëve të jetë kaq dramatike pikërisht nga fokusimi përherë i eksternalizuar i matjes dhe analizimit të gjërave? Konkretisht: logjika e kërkimit të fajit gjithmonë tek të tjerët. Arsyetim që është përdorur ndoshta për të lehtësuar nga pak athëtinë e të qenit rob, mirëpo i cili njëkohësisht edhe i pati dënuar shqiptarët

(këtu: dhe ballkanasit në përgjithësi) me një vendnumërim intelektual. Në romantizëm intelektualët ishin të preokupuar me bërjen e identitetit dhe çlirimit nga të tjerët.

Në komunizëm intelektualët ishin oportunistë dhe aq hermetikë saqë as veten nuk e kuptonin.

Dy dekadave të fundit intelektualët shpëllajnë vepra, botojnë autolëvdata për të dëshmuar patriotizmin e tyre permanent, pra edhe atëherë kur patriotizmin e kuptonin ndryshe apo nuk e zotëronin fare. Sot po të njëjtët njerëz ulërijnë se ka rënie vlerash. Cilat vlera kanë rënë? Kush i ka krijuar, identifikuar, lokalizuar e trajtuar ato vlera, kur dhe si?

Nuk i akuzojmë shkrimtarët, intelektualët, autorët se përse nuk kanë vepruar e pse nuk veprojnë si intelektualët e shekullit francez të shekullit të 19-të. E para për arsye se luftëra të tilla në këtë epokë të revolucionit dixhital ndoshta shumë njerëz i konsiderojnë të demoduara dhe e dyta; edhe shqiptarët e kanë kuptuar domethënien e lirisë individuale dhe nuk duan të akuzojnë dikë pse ka këtë apo atë biografi. Çështje personale e tij. Absurde bëhet megjithatë puna kur pikërisht ata që nuk kanë ndjekur shembullin francez të iluminizmit, që nuk akuzohen nga ndokush, që ende nuk kanë guximin e autokritikës, pse jo edhe të një metanoje, rrinë e vajtojnë se s'paska më vlera.

Është e vërtetë se ka rënie vlerash. Çështja që shtrohet është: cilat janë ato vlera, që sidomos gjenerata e vjetër i vajton? Mendohet për dukuritë si: patriarkalizmi i cili humbet dita ditës fuqinë; liria e individit që edhe pse e keqkuptuar merr sa më shumë pushtet në jetën publike; klanet e dikurshme kulturore që janë zbehur në favor të një konkurrence të ashpër e të shëndoshë; autorët shqiptarë (letërsi e teatër) që kanë shpërthyer botës pa ndihmën e partisë; mediat që denoncojnë çdo rrëshqitje edhe atëherë kur akullit përplasen ndonjë lider, komandant apo hero i gjallë; mendohet vallë për këto e për shumë segmente etike si këto?

Nuk e dimë saktësisht sepse deri tani konstatimi «kanë rënë vlerat» na ofrohet vetëm si parullë!

*Avokatët e racës*

Duket sheshit se autokritika nuk qenka veti e plisbardhit. Kështu ka lexuar, mësuar, kështu është edukuar dhe kështu ka vepruar shqiptari deri sot.

Neveritës në këtë kontekst bëhet aksioni i intelektualëve që si duket as dje e as sot nuk i kanë bërë detyrat e shtëpisë dhe që nuk kanë kohë për vetëkritikë e për thurje programesh formë-diktati se nga duhet të ecin shqiptarët, gjejnë jo vetëm ditë por edhe muaj. Që absurdi të jetë edhe më banal: sapo del ndonjë diskurs autokritik, të njëjtët njerëz mobilizohen me mantelin e avokatëve të racës, gjakut dhe pragut dhe bëjnë çmos për të shtrydhur diskursin vetëm brenda një dimensionit: atij personal! (2013)

## *Radiokracia e varrit*

Vaji për ata që ikin prej nesh në këtë sezon vdekjesh është i natyrshëm. E panatyrshme dhe morbide është sjellja e pushteteve shqiptare ndaj atyre që i kanë varrosur për së gjalli. Një lloj historie mbi elitën shqiptare.

Fjalimi i Hashim Thaçit në Akademinë Përkujtimore të organizuar me rastin e vdekjes së filozofit dhe politikëbërësit Arbën Xhaferi i përngjante atij homazhit filmik «*The Last of the Mohicans*» (SHBA, 1992) që regjisori Michael Mann i bëri romanit të shkrimtarit amerikan James Fenimore Cooper.

Padyshim se Arbën Xhaferi meriton edhe më shumë nderim se sa që jemi në gjendje t'ia bëjmë atij. Ashtu siç meritonin edhe Tekiu, Aliu dhe ca të tjerë që u bënë viktimat të këtij sezoni ikjesh të dhimbshme. Vaji që manifeston përluljen dhe nderimin tonë të merituar ndaj personaliteteve të tilla përmban në vetvete edhe një dramë tjetër: dramën e të gjallëve!

Në këto raste doli edhe njëherë në pah më shumë aporia kolektive në të cilën kridhen shqiptarët sa herë që prej tyre largohet nga kjo jetë një njeri me peshë publike.

### *I. Vaji për «elitarët»*

Në analizë e sipër të fjalimit të kryeministrit kosovar, më shumë se sa me nderim e përlulje përballemi me alarm dhe panik: «Na iku i fundit mendimtar», ose «e humbëm edhe të fundit poet të madh», janë mesazhet kapitale që përçojnë këto fjalime, homazhe dhe situata, qofshin ato edhe të inskenuara për nevoja të përditshme politike.



Sado pikëlluese e frymëzënëse të jenë këto përkujtime e homazhe, më gjithë ritualitetin e ndershëm apo instrumentalizues që e mbajnë si stampë në ballë, nga substanca e tyre prodhojnë një konglomerat pyetjesh që kanë të bëjnë me gjendjen e shoqërive shqiptare: Vdiq vërtet

mendimtari më i madh që e patën shqiptarët?

Po poetët, dramaturgët, aktorët?

Të gjithë vdiqën gjë?

S'ka më elitë të gjallë që do të na lehtësonte realitetin me optimizëm e instruksione?

Apo gjithë këto ceremoni komemorative kanë synimin ta poshtërojnë të gjallin, pjesëtarët e asaj pjese të elitës, që ende nuk kanë pasur fatin të shpëtojnë, të vdesin? Është kjo pra një hakmarrje e masës dhe shtetit ndaj gjithë atyre që e konsiderojnë veten si elitarë?

Jo? Vërtet shkoi përtej njëherë e përgjithmonë elita shqiptare. Vdiq. Mbaroi? Para së gjithash: kush janë (apo ishin e shkuan) elitat shqiptare?

## *II. Historia e një polemike*

Sqaruar brutalisht – siç bëjnë fjalorët enciklopedikë – nocionin **elitë**, fitojmë këtë definim: Është grupi i përzgjedhur (electus) i personave të kualifikuar që prijnë segmentet kryesore të një shoqërie. Historia e terminologjisë (në kontekstin e temës sonë) dhe praktikimit fillimor të tij nuk janë aspak të komplikuar: Në kohën e revolucionit francez (1789 -1799) me **élite** nënkuptohej divizioni i atyre intelektualëve – për dallim nga kleri dhe aristokracia – që pozitën e tyre autoritative në shoqëri e kishin fituar falë meritave personale intelektuale. Iluministët si Didero, Alambert (themeluesit e Enciklopedisë), Voltaire, Kanti e shumë të tjerë të këtij kalibri, trajtoheshin si të tillë. Që nga emrat kuptojmë se për çfarë formati intelektualësh bëhet fjalë.

Të atillë pra, që me programet e tyre intelektuale ndikojn drejtpërdrejt në rrjedhat e shoqërisë – e në rastin e të lartpërmendurve edhe në formësimin e mendësisë së epokës.

Ky perceptim i formuluar në revolucionin francez do të rrenohet nga revolucioni rus (1905). Bolshevikët e përdorën termin sipas versionit napoleonik (elitë ushtarake) dhe e përhapën atë për të gjithë ata që do të rekrutoheshin si kuadro partiake, pavarësisht shkallës intelektuale apo kualifikimit profesional.

Nisur nga ky stad reflektuan më vonë ekzistencialistët e majtë (Sartre) dhe përpiluesit e «Teorisë kritike» (Adorno, Marcuse).

Ky version dominoi deri në fillim të viteve tetëdhjetë, deri atëherë kur neoliberalët e ushqyer konform frymës së Talcot Parson- it me kompani, ia arritën që ceremonialisht ta pozicionojnë **meritokracinë** e strukturalizmit funksional si teorinë më të përshtatshme për përshkrimin e kategorive sociale. Me këtë nuk iu bë ndonjë sabotim esencial versionit të majtë mbi elitat, për u soll një filtër që zëvendësoi servilitetin me djersën.

Jo të gjithë ata që shquhen si servilë të ideologjisë duhet që domosdo të jenë pjesë e elitës, por ata që me meritat personale (ashtu siç thonin edhe francezët) arrijnë në pozitën e primusit. Sipas kësaj logjike më shumë se trashëgimtarët e Didero-së, Zola-s, Voltaire-it, elitën e përbëjnë multimilionerët, topmenaxherët, kryespekulantët e kështu me radhë. Ndoshta Talcot Parson nuk ka dashur që gjërat të shkojnë kështu. Ndoshta ai ka menduar ndryshe. Mirëpo kështu sugjeron njëri ndër filozofët kryesorë e në modë në Evropën e sotme, Peter Sloterdijk – dhe jo vetëm ky (në veprat e tij «në thellësinë e botës së kapitalit» dhe «ndrysho jetën mbi antropoteknikën») – se pikërisht kështu ka rezultuar rezonimi meritokratik. E Sloterdijk nuk është aspak i majtë. Sidomos që nga fillimi i krizës globale është ringjallur debati

rreth dilemës se çfarë duhet të nënkuptojmë me termin „elitë“?

Në Evropë e SHBA – sidomos në qarqet akademike dhe mediat kryesore – debati vazhdon.

Shoqëritë shqiptare as që kanë nevojë për një debat të tillë!

### *III. Ku t'i kërkojmë elitat*

Po mbyllim librin e Historisë, atë të teorisë e flakim si ashtu ndër kanapë dhe ndezim televizorin. Në ekran hasim kokën e madhe të ndonjë ministri që flet para gazetarëve. Bëhemi dëshmitarë aksidentalë të një komunikimi që shoqërohet me abortime të përgjakshme estetike. Ndërron kanalin: një milioner, fytyra e të cilit i përngjan një fushëbeteje elementesh kozmetike, jep instruksione mbi «metodat» e express-pasurimit të vendit. Ndërron edhe njëherë kanalin: në sofër përballë gazetarit rrinë shtangur ca burra, të cilët përsërisin brengat e tyre në formë refreni duke u pozuar si ata «baballarët arkaikë të kombit», ndërkaq ne skenë përdhunshëm e përjetojmë si bashkëbisedim subjektesh pseudoaltruiste që veçse nuk eksplodojnë nga hipernarcizizmi. Telekomandën e shporrim sa më larg që është e mundur dhe hapim gazetën: një drejtor i porsazgjedhur teatri flet për veten, për teatrin s'ka ç'thotë.

Kurrë në jetë nuk e ka bërë një dramë, nuk e ka luajtur një rol të vetëm, asnjë studim a reflektim mbi teatrin prej tij nuk njihet botërisht. Pse atëherë qenkësh ky person drejtor teatri? Zgjedhësit kanë vepruar në afekt? Jo. Drejtori përvesh bërrylat e tij të ngurta. Ku t'i gjejmë elitat? Moderatorin humb përqendrimin dhe rras gishtin në hundë, ne humbim durimin dhe dorëzohemi.

#### *IV. Elitat shqiptare*

Shqiptarët nuk kanë qenë pjesë e diskurseve rreth teorive mbi kategorizimin e shtresave sociale, siç kanë qenë për shembull çekët, hungarezët, sllovenët e polakët edhe pse duke jetuar po si shqiptarët në bllokun e hemisferës komuniste. As pas rënies së sistemit monist, shqiptarët nuk kanë ndërmarrë ndonjë «aksion» intelektual e shoqëror për të hequr kufomat totalitare nga mentaliteti, historia dhe sjellja e tyre sociale. Gjendje kjo që na shpëton nga burimet e koklavitura shkencore dhe na detyron t'i besojmë analizës sonë spekuluese të perceptimit të elitave nga mediat, institucionet dhe masat.

Kë e konsiderojnë shqiptarët si elitë pra?

Në kushtet shqiptare njihen vetëm dy kategori: elita politike dhe ajo intelektuale. Në këtë të fundit futen të gjithë ata që kanë të bëjnë diçka me shkencat humane. Në rastin e parë bëjnë pjesë të gjithë ata që mbajnë poste politike. Elitë ekonomike, religjioze, ushtarake e kategori të tjera nuk ekzistojnë. Përderisa elita politike pranohet si e tillë vetëm atëherë kur një numër i madh i intelektualëve (sidomos më parë dhe në kushte të krizave nacionale) përfshihet aty – përndryshe nocionin elitë e zëvendëson ai i banditizmit dhe tradhtisë – elita intelektuale (si perceptim) është më permanente. Në këtë kategori futen të gjithë ata që konsiderohen si të «mençur», me shkollë, shkrimtarë, poetë, gazetarë, historianë, filozofë, sociologë, akademikë, mësues e kështu me radhë.

Si shumica e nocioneve tek shqiptarët, edhe ky i elitës është banalizuar deri në atë shkallë sa që ka humbur çdo kuptim e domethënie. Ngjashëm me stilin e proletariatit rus,

i cili rekrutonte si elitarë të gjithë ata që i donin partinë dhe ideologjinë verbërisht, shpallin pra edhe shqiptarët (si masë) si elitarë të gjithë ata që «luftojnë» për mëmë, atë, dhë e etni. Pra kemi një perceptim që elitat i fabrikon sipas «meritave» (meritokracia) politike (ideologjike) e jo sipas parimit bazë që vjen nga iluminizmi, e i cili, siç thamë më lart, e ka fjalën për intelektualë që me programet e tyre intelektuale arrijnë të vënë në lëvizje procese të mëdha shoqërore. Për nga forma pra kemi të bëjmë me një qasje iluministe ndaj elitave (për të mirën e të gjithëve) e në praktikë mbizotëron sjellja kuazimeritokratike (kush i mat meritat, kush i standardizon ato si të tilla?).

Kështu po spekulojmë se perceptohet elita nga masat. Se si reflektojnë vetë ata që besojnë të jenë apo se janë pjesë e elitës, mund të përshkruhet edhe shumë më lehtë. Ata që vërtetë janë elitarë nuk e dinë se jenë të tillë e ata që nuk janë të këtillë mirëfilli, ditënatë e deri në skizofreni bëjnë çmos që t'i dalin zot titullit të fituar nga «miletit».

Si është puna tani pra, kemi apo jo elitë, së paku, intelektuale?

#### *V. Arbën Xhaferri – mohikani i fundit?*

Padyshim. Shqiptarët kanë intelektualë. Arbën Xhaferi ishte vetëm njëri prej tyre – madje edhe atëherë kur dukej se po gabon epokën me hiperbolizimet e tij mbi racën që i takon. Ka edhe të tjerë që për nga potenciali dhe reflektimi mund tu dhuronin shoqërive shqiptare shumë. Ata janë detyruar në një egocentrizëm të egër mbijetimi. Do syresh madje janë bërë edhe pjesë e po atyre lloj pushteteve që gjenden në kundërshtim me çdo parim të tyre etik e intelektual, për çështje mbijetese thonë.

Vjen gjithë kjo nga qëndrimi i mësuar prej filozofit francez Jean-François Lyotard. Kur zëdhënësi i qeverisë franceze ftoi

intelektualët të debatojnë për të kërkuar rrugën se si të dilet nga kënetat ku ishte zhytur Franca, ky i fundit, Lyotard shpalli intelektualin si genie të vdekur («Gurvarri i intelektualit», Le Monde, 16 korrik 1983) duke thënë se ai formati i intelektualit të dikurshëm që luante rolin e nxitësit të ndryshimeve me votën dhe besimin e masave, pra intelektual i iluminist, ka cofur, sepse postmodernizmi është epoka e konkurrencës individuale dhe e specializimeve.

Nuk besojmë se elita shqiptare e ka përqaftuar këtë botëkuptim. Historia e fundit në hapësirat shqiptare dëshmon krejtësisht diçka tjetër. Si ta kuptojmë atëherë mërdhirjen e tyre? Janë hidhëruar ata sepse pushtetet shqiptare nuk i lusin të marrin pjesë në debate të tilla siç bëri qeveria socialiste franceze dikur?

Si më reale imponohet ajo hipoteza e eliminimit nga skena me dhunë. Në një shoqëri ku burokracia (Bërrylokracia) është aq e pamëshirshme si në hapësirat shqiptare elitës, nuk i mbetet asgjë tjetër përpos të kërkojë strehë të izolimi.

## *VI. «Elitat» në vepër*

Po shohim se problemi nuk qëndron te fakti se i kemi keqkuptuar nocionet «elitë», «meritokraci» e të tjera të ngjashme, apo se shqiptarët nuk kanë personalitete me mendje elitare, porse ata, shqiptarët, elitarët i identifikojmë vetëm kur vdesin, gjersa janë akoma gjallë i përdhunojmë skutave duke i injoruar, duke i poshtëruar dhe jo rrallë duke i vdekur për së gjalli me vlerësimin tonë bardh e zi, o tradhtar o shqiptar. Kur flet ndonjë zë elitar ne nuk e përfillim sepse jemi kureshtarë të shohim se ç'ka prodhuar mendja e tij, por për të kontrolluar nëse mendimet e tij a përputhen me ato stereotipet, mendimet dhe besimet tona. Ora e intelektualëve servilë është kjo pra.

Shqiptarët nuk i dëgjojnë elitarët e tyre sepse ata ua prishin sistemin e mbijetesës sociale. Në vend të mendimtarëve, profesionistëve, diplomatëve dhe individëve të tjerë meritore institucionet e shoqërive shqiptare i udhëheqin fiset. Shqiptarët priren nga «akademikë» me disertacione që në FAZ, Times, Le Monde apo NZZ as si raport mesatar nuk do t'i kishin pranuar, të atij lloji që nuk kanë marrë postet e dëshiruara sepse kanë merita, porse o janë të privilegjuarit e kastës aktuale pushtetare o i kanë bërërylat si të atij drejtorit të teatrit. Bërërylokracia gëzon primatin në shoqëritë shqiptare e jo meritokracia neolibérale apo neoiluminizmi i zgjuar vonë Ballkanit tragjik. Kjo është gjendja.

### *VII. Etika e ligjëratave postmortore*

Nuk duhet ta korruptojmë shpirtin deri në atë masë sa që të dyshojmë në sinqeritetin e kryeministrit kosovar kur mbante fjalimin për të ndjerin Arbën Xhaferi. Ashtu siç nuk mund të prostituojmë karakterin tonë duke mbyllur sytë para realitetit që prodhon mënyra e sundimit të tij politik, para këtij realiteti aparatësh pushtetare të mbipopulluara me divizione bërërylokratësh.

Kështu lotët tona gjatë varrimit të «mohikanëve tanë të fundit» shumëkush mund t'i marrë si aktrim kur sheh varret masive në të cilët gjenden të gjallët tanë. (2012)

## *Eutopitë shqiptare*

Shqiptarët kapen pas utopive, qendrave e kulturave të tjera jo për të bërë shamatë, por për t'iu ikur qoftë edhe vetëm falë fantazisë qeverive të pacipa që i mbajnë ato peng. Në romanin e tij, të shkruar latinisht në fillim të vitit 1516, Sir Thomas Morus e ka një fjali ku shpjegon se titulli i librit «Utopia» (vend inekzistent) lirisht mund të zëvendësohej me «Eutopia» (vend i mirë). Nëpërmjet këtij sqarimi dhe pozitës prej burrështetasi të Morus-it kuptojmë se përse autori veprën e tij e maskon me aq irrealitet, jo vetëm për atëherë, por edhe për kohën e sotme. Kontrasti na lejon thellimin. Morus është burrështetas i një «Dystopie» (anti-utopia, vend i keq).

Gjendja politike e Evropës së atëhershme ishte katastrofale. Qendrat kryesore të kontinentit digjeshin flakë nga topat e religjioneve. Vendin e autorit e udhëhiqnin grykësit, dendit, despotët që mjeshtri kishin zhgjakjen e të varfërve, krimin, korrupsionin, shtypjen dhe që nga shpirti refraktar vrisnin çdo ide përparuese sapo ajo shfaqej në sipërfaqe. Të diturit përhimnonin pronarët sipas torbës me monedha e të paditurit nuk i nxinin kishat luftarake.

Meqënëse nuk ka ku të ikë realisht, Morus përandit imagjinatën në ishullin e tij gjasme «protokomunist» Utopia. Sapo ta sterilizojmë librin nga angullimat simbolike, menjëherë përballemi me kërkesat kyçe të Morus-it. Ai kërkon luftimin e intolerancës fetare, barazinë ndërgjinore, garantimin (jo patjetër financimin) e të drejtës për arsim për të gjithë dhe barazinë e secilit njeri para drejtësisë. Se nuk bëhet fjalë për **utopi**, por **eutopi** në BE dhe vendet e tjera perëndimit, shqiptarët jo vetëm që e dinë, por edhe e kanë përjetuar në lëkurë.



Gjendja e shqiptarit sot është po aq e llumtë si ajo Thomas Morus-it asokohe. Një pjesë e shqiptarëve ikjen e realizojnë realisht duke emigruar e shumica syresh sillen njëlloj si Morusi: me frymë e shpirt! Do ta ndiejnë faktin se Europa dhe SHBA-të qenkan vallë Eutopia e tyre, ndërsa të tjerët rrëfaten drejtimeve të tjera; ca ndalen në Stamboll e të tretët kanë arritur tashmë në Riad, Vatikan e Mekë.

### *Mediat dhe diskurset*

Dhe shqiptarët si edhe mbi temat e tjera, nuk debatojnë përse-në e kësaj teposhte permanente, por gjykojnë garueshëm e potershëm Thomas Morus-ët tanë, të cilët të shtyrë nga ekzistenca barkboshe, paperspektiva dhe diskriminimi, kanë krijuar ishujt e tyre fiktivë. Ndërsa mediat edhe kësaj radhe nuk mundën apo ditën ta kanalizojnë dhe drejtojnë debatin, por qysh në prelude e bajgëzuan atë krejt. Fatkeqësisht!

Mprehja e shpatave mes «nahive» për të identifikuar e lokalizuar llogoret brenda mendësisë për historinë, fetë dhe Turqinë, ishte e domosdoshme dhe e dobishme edhe për analizimin e raportit të shoqërive shqiptare me Europën, respektivisht Bashkimin European. Këtë segment e kishin filtruar edhe analistët e institucioneve të BE-së.

Brenda shumicës u ekspozuan katër rryma kryesore që përbëjnë relacionin shqiptar në këtë kontekst. **E para** [patriotët] integrimin e plotë në BE e konsideron aspiratë të natyrshme të një vendi e kulture që historikisht paska qenë promotore e që aktualisht padrejtësisht përbën veç një protezë të kontinentit. **E dyta** [pjesa e motivuar fetarisht] e percepton dhe eteron **idenë evropiane** si një «projekt të krishterë» që duhet zhvatur financiarisht e që paskëtaj duhet shporrur apo tjetërsuar përsëbrendi, ngase jo në Europë ndodhet gama e identitetit të tij, por diku tjetër, aty ku synon të emigrojë. **E**

**tre**ta, me integrimin në BE beson në konsolidimin juridik e demokratik të shoqërive shqiptare [shumica e intelektualëve] gjë që nënkupton automatikisht mirëqenien, drejtësinë dhe shkëlqjen e tëharrave socialdarwiniste nga fryma shqiptare. **E katërta** përbëhet nga të rinj të ndikuar nga teoritë postkoloniale që diktatet e Brukselit i konsiderojnë si formën më të re të imperializmit.

### *Analiza*

**Pa filozofi:** askush nuk ikën dot as realisht as me fantazi vullnetarisht nga shtëpia. Ose grupi i atyre që organikisht s'duron mendësi e farefisni është fare simbolik.

**Me histori:** Të gjitha dyndjet e mundshme (jashtë pushtimeve, sepse shqiptarët nuk imagjinojnë a dëshirojnë vende për t'i pushtuar, por për të shpëtuar) janë nxitur nga dhuna politike, ekonomike, grupore etj.

**Me Biokimi dhe Psikologji:** jo vetëm qenia humane, por frymorët në përgjithësi instinktivisht nisen udhëtimit sapo t'i zërë frika e ekzistencës.

**Me Filozofi:** «Esenca e lirisë së njeriut nuk përbëhet nga parimi se mund të bëjë çfarë të dojë, por nga parimi se mos detyrohet ta bëjë atë që nuk dëshiron ta bëjë» (Jean-Jacques Rousseau).

Nisur nga kjo premisë duhet kërkuar shpjegimi i katër kategorive ekzistuese në raport me idenë europiane të cilët deshën apo s'deshën shqiptarët, të shtëpisë e kanë gjithësesi (qoftë edhe vetëm gjeografikisht).

**Të parët** [patriotët] pëlqejnë metaforën e të qenët protezë e kontinentit, ngaqë nuk duan ta pranojnë paaftësinë e shoqërive të tyre për të hyrë në klubin e atyre që kanë plotësuar kërkesat themelore të Thomas Morus-it.

**Të dytët** [pjesa e motivuar fetarisht] nuk dëshiron të kuptojë se BE nuk është ent social ku arkëtarët naivë u

shpërndajnë të holla «skamnorëve» të zgjuar. Përveçse një qëndrim i tillë përdhos çdo moral, ai është krejtësisht iluzion. Europa nuk është e fortë sepse qenka në duart e atyre që janë duke realizuar «projektin e krishterë». E kundërta është realiteti: Shtetet kryesore të BE janë të forta sepse i kanë shkolluar masat e tyre deri në atë shkallë sa që të jenë zotër të lirisë dhe mirëqenies së tyre. «Marrja e kalasë nga brenda» është matematikë e gabuar, sepse integrimi i individit në Europë bëhet detyrueshëm nëpërmjet shkollimit dhe integritit, kështu që fanatikët e çdo lloji janë të paradënuar pa ato turmat e nevojshme që verbërisht do t'iu ecnin pas. Dyshimet e grupit të **katërt**, atyre që druajnë nga globalizmi imperialist nuk janë të paarsyeshme. Kontradiktorë brenda këtij grupi janë «çegevaristët» që luftojnë imperializmin liberal me internacionalizmin komuniste.

**E treta** është e vërteta. Grupi i tretë, eurosimpatizantët janë pragmatikë. Këta besojnë në faktin që ndoshta duhet shkruar për çdo ditë mureve shqiptare: konsolidimi i shtetit të së drejtës dhe demokracisë!

S'ka alternativë tjetër që s'do të ishte miope. Rruga e vetme shqiptare detyrueshëm është Europa qoftë si ide e qoftë si BE. Çdo skenar tjetër është utopi. Meqë distopitë qenkan tunelet e vetme nëpërmjet të cilave shqiptarët u dashka të dalin në eutopitë e tyre, atëherë po qenka e qartë se çfarë duhet bërë. S'ka tjetër zgjidhje as larg, as afër, as imagjinueshëm e as zgjuarsisht! (2013)

PJESA E PESTË  
*Mediat*

***Forcat e pushtetit të 4-t****Hyrje*

Veç pasi analizojmë procesin që nga plasimi i temave të caktuara dhe deri në reagimet e para të shoqërisë dhe shtetit ndaj tyre mund të kuptojmë rolin e dobët apo të fortë të mediave brenda një gjuhosphere. Është e gabuar përshtypja e plotëve që mendojnë se mediat shqiptare nuk kanë asnjë ndikim, janë xhungëll, madje pa asnjë lloj fuqie për të lëvizur diçka. Kush ka ndjekur luftën e Mero Bazës me PD-në e Sali Berishës që nga fillimi e deri tek zgjedhjet e fundit; kush ka ndjekur luftën e mediave kosovare kundër korrupsionit, radikalizmit teokratik dhe ojq-ve të shumta që ushqenin ideologjitë e shumta radikale do të bindet se në etnozonën shqipe mediat janë më të fuqishme se kudo tjetër në rajon e më gjërë.

## I.

Duoja Carl Bernstein dhe Bob Woodward vazhdojnë të jenë legjendat, ikonat dhe referencat historike e çdo storie mbi pushtetin, fuqinë e medias. Dy gazetarët e Washington Post-it që në filmin «All the President's Men» të Alan J. Pakula-s (1976) zëvendësohen nga Dustin Hoffman dhe Robert Redford janë pionierët e asaj gazetarie hulumentuese nga e cila edhe sot dridhet, trembet çdo pushtet i kacavarur cergës së merimangës ku tjerret korrupsioni, nepotizimi dhe çdo ves e veprim tjetër ilegal, antidemokratik.

Deri në fillim të viteve të 80-ta mediat e hapësirës anglofone dhe gjermanofone zhvilluan një kulturë denoncimi të ngjashme me atë të „Watergate“-s. Ndikonin në mënyrë permanente jo vetëm në korrigjimin e pushteteve, por edhe të vetë demokracive perëndimore. Ato ishin nergut aktive, konstruktive edhe në luftën e tyre kundër monopolizimit të kapitalit global nga „fondacione e banka“ oligarkësh si dhe çmaskonin kampanjat e industrisë në kapjen (blerjen, korruptimin) e pushteteve të botës së tretë nga koncerne e „fondacione“ kryesisht eksploatuese.

Dy dekadave të fundit është krijuar përshtypja sikur vrullit medial për ta shpëtuar botën nga e keqja t'i jenë harxhuar bateritë. Njëri tabor i medianalistëve këtë zhvillim e lidhë me banalizimin e imazhit të mediave që solli interneti, ndërkaq tjetri mendon se vetë mediat kanë rënë nën kthetrat e oligarkëve monopolistë që blejnë, instrumentalizojnë apo shuajnë mediat serioze.

Sido që të jetë: mediat gjithandej, në perëndim e më hijë në anët tjera të globit nuk janë më ato që ishin dhe nuk u ka mbetur shumë sa për tu krekosur të jenë fuqia e katërt në shoqëritë ku veprojnë.

Cila është gjendja e mediave shqiptare në këtë relacion? Gjenden ato jashtë këtij trendi teposhtëz apo edhe në këtë sferë shqiptarët sillen ndryshe, si ekzotë të papërmirësueshëm që janë?

## II.

Mediat shqiptare që funksionuan gjatë sistemeve moniste nuk mbijetuan. Ose nuk patën mundësi reformimi për të vazhduar (si në hapësirën e ish Bashkimit Sovjetik ose në ish – Jugosllavi) matej si gazeta shtresash ende të pashkëputura nga e kaluara parademokratike. Kjo vlen vetëm për aspektin ideologjik e jo edhe për atë profesional, sepse deri vonë

shumicën e mediave të reja i popullonin gazetarë të shkolluar dhe formuar në sistemet e vjetra.

Sot situata ka ndryshuar.

Pothuaj në pjesën dërrmuese të gazetave, televizioneve dhe portaleve (serioze) informative shqiptare redaksitë përbëhen nga redaktorë, kolumnistë e gazetarë të shkolluar e të pashkolluar në fazën tranzicionale. Përkundër defekteve që manifestohen si pasojë e diktatit të botuesve, interesit dhe njëmendësisë së tyre pothuaj në çdo media veçohen gazetarë, individualistë që duken të frymëzuar nga soji i Bernstein-ëve, Woodward-ëve e të ngjashëm. Është meritë e tyre që mediat shqiptare – përkundër presionit të pronarëve, grupeve, politikave – dallojnë esencialisht (sidomos ato të Kosovës) nga simotrat e tyre në rajon dhe ecin madje drejt një trendi diametral në krahasim me ato të perëndimit e veriut evropian.

Në dy aspekte, gjatë dy dekadës së fundit, mediat shqiptare demonstuan pushtetin dhe ndikimin e tyre si kurrë më parë: në politikë dhe në luftën kundër korrupsionit ato nuk justifikuan vetëm ekzistencën e tyre profesionale por edhe triumfuan në shumë kauza që buruan drejtëpërsëdrejti nga ato.

### III.

Me vite dy media nëzë (Tema dhe Dita) të Shqipërisë ushtruan denoncim të hapur të çdo dështimi, çdo lidhjeje të dyshimtë të pushtetit dhe grupeve mafioze që favorizonin atë deri në gjuhëzim, humbjen e klanit të Sali Berishës në krim të organizuar. Rokada politike që pasoi as që mund të paramendohet pa luftën sistematike të këtyre mediave pro çlirimit të politikës nga bestialiteti i klaneve dëmtuese për parademokracinë shqiptare.

Edhe më fuqimadhe dhe me ndikim të pakontestueshëm media u tregua gjatë zgjedhjeve vitit 2014 në Kosovë. Atje, ku

askush, muaj më herët, nuk besonte se vetë elektorati do të shembte „kullat“ e pushtetit të disa warlord-ëve që sillleshin aq të sigurtë në fitoren e tyre. Disa javë me radhë gazeta e televizione (duke përjashtuar ato që haptazi u prononcuan të vënë mediat në shërbim të ndonjë partie a alternative) organizuan debate, emisione dhe ballafaqime objektive, profesionale që padyshim se do të jenë objekt i historisë së mediave të rajonit dhe më gjërë.

Nëse zgjedhjet ishin një episod ku „pushteti i katërt“ mezi mblodhi energjinë e dukur për të rikonfiguruar perceptimin e masave ndaj politikës, lufta kundër korrupsionit material, strukturor e ideologjik del një proces shumëvjeçar, të cilin shumica e mediave kosovare duket ta ken bërë motivin qëndror të tyre. Me dhjetra artikuj e hulumtime ato u bënë shkaktare të proceseve të ndryshme gjyqësore në luftën e shoqërisë kundër korrupsionit dhe anomalive të shumta që kanë përparë shoqëritë në konfizionin parademokratik.

#### IV.

Pa dilemë se edhe sferat shqiptare i ka kapur moda ku „populli“ e „atdheu“ me zor por të detyruara ikin në pension duke ua lëshuar vendin zëvendësve të tyre „shoqëri“ e „individë“. Përkundër këtij procesi të individualizimit, çka është edhe paradoksi esencial sidomos në relacionin individ-shoqëri: brenda masës subjekti nuk identifikohet më me konture të qarta, qenie specifike për ta dalluar, por më së shumti regjistrohët si një element abstrakt brenda lumit alkimik të idesë kolektive. Mediat (serioze) janë ato që krijojnë urat e domsdoshme të komunikimit ndërmjet socioferave të ndryshme; ato absorbojnë idetë dhe propozimet e individëve në një sintezë frymore të domsdoshme në favor të shoqërisë. Përveç kësaj rëndësie ato – folur në mënyrë kontrafaktike – po njohën si kolegët e tyre



perëndimore nevojën e koordinimit gjatë krijimit të agjendave të përbashkëta mediale (në shumicën e vendeve ekzistojnë „konferencat e kryeredaktorëve“ që diskutojnë për rregullat, etikën dhe agjendën e vitit) do të ndikonin edhe më shumë sa gjatë këtij viti në përparimin e shoqërive ku publikohen. Atëherë madje nuk do të detyroheshin shpesh të shndrrohen në Jerry Fletcher e Alice Sutton (Conspiracy Theory; 1997) por do t’iu qëndronin më besnikë kolegëve të tyre nga afëra „Watergate“. (2014 – 2016).

*(In)konsistenca e intelektit*

Intelektualët, gazetarët, autorët, publicistët asnjëherë nuk mund të akuzohen për inkonsistencë. Përse vallë? Sepse janë mendje aktive. Historia e një keqkuptimi. Feridi faqen ndërron dhe shante...sot lëvdon». Këtë varg nolian për Konicën e lexojmë gjithmonë kur dikush rreket të vërë në dukje inkonsistencën e ndonjë publicisti, politikani, autori apo gazetari. Ky slogan tanimë përdoret për të përshkruar; labilët, njerëzit karakterllastiktë, kameleonë, etj. Njëlloj edhe denoncimi që – shikuar më thellë – nuk është i atypëratyshëm, por ka traditë, ai ka rrënjë të lëshuara në mentalitetin dhe biografinë shqiptare dhe tek të gjithë të tjerët me qëndrim ambivalent ndaj ekzistencës së evoluimit (si zhvillim, pasurim).

«O me ty jam burrë, ki të drejtë ama nuk guxoj se ia kam dhënë besën atij», i thotë Hyseni Jakupit. Çfarë arrijmë të kuptojmë nga ky dialog. Hyseni ia ka dhënë dikujt **besën** për diçka. Shkon tek Jakupi dhe ky i fundit e bind me argumente se puna, realiteti pra, qëndron ndryshe. Hyseni bindet, mirëpo ka bërë veten peng sepse ka dhënë besën dhe: «Burri nuk e ndërron fjalën». Ky tip dialogu edhe pse arkaik për nga origjina, është ende fort i konsiderueshëm në përdorim. Edhe gjenerata e fundit është rritur me përrallat rreth legjendaritetit të besës e lere më të moshuarit.

I pranishëm është madje edhe në polemika ndërintelektuale. Reagimet e tipit: «dje tha kështu e sot thotë ndryshe, është i paqendrueshëm. Nuk e mban fjalën!», e kanë burimin po në këtë mendësi. Fjalën ndaj kujt është dashur ta mbajë i kundërshtuari? Ndaj opinionit? Jo konkretisht. Mirëpo të tjerët e kanë perceptuar kështu ama.

Para se të zhytemi edhe më thellë në temën në fjalë, le të shohim pak se ç'është konsistenca? Cili është raporti i saj me intelektin dhe bartësin e saj. Sa i përputhshëm është **mentaliteti i besës** me nivelin aktual arsimor, i cili pretendon se gjithçka qenkërka relative?

### *Konsistenca*

Në fjalorin e gjuhës së sotme shqipe (Toena, 2002) Konsistenca nuk figuron as si emër as si folje. Në njërin prej fjalorëve gjermanisht – shqip (Langenscheidts, 2000) e gjejmë të përkthyer si përmbajtje (?!). Në fjalorin latinisht (burimor) folja **consistere** (< consistens) shpjegohet si «diçka me përbërje të qëndrueshme». Në fjalorët aktualë të atyre 10-11 gjuhëve që i kuptojmë dhe në ato 5-6 me të cilat operojmë, konsistenca kryesisht përshkruhet si: «gjendje, veti, natyrë pa kundërshti», diçka stringente pra. Varësisht nga perspektiva shkencore me të përshkruhen; betoni, procesi numerik në matematikë, ligjet natyrore e të ngjashme.

Konform natyrës së temës sonë, e cila më tepër është filozofike, antropologjike dhe etike, ne na intereson se si trajtohet konsistenca në këto fusha të dijes. Përderisa në shkencat natyrore ekziston një traditë e pasur teorike (Newcomb, Haider, Read, etj.) mbi konsistencën kognitive, në shkencat humane – me përjashtim të teorive fetare të cilat doktrinat e tyre i shpallin botërisht si «etika konsistente të jetës», pra morale, njëherë të shkruara e përgjithmonë të padiskutueshme – nuk ka asnjë teori të vetme që do ta

trajtonte konsistencën në raport me frymën, intelektin dhe etikën humane.

Në edicionin më të ri Brockhaus (2009) për filozofi, përkthimi nga latinishtja i bëhet në këtë mënyrë: «still stehen» [s'leviz], «dicht werden» [hermetizohet]. Pason zberthimi: «Një teori konsiderohet konsistente atëherë kur nëse shumica e fjalive nga të cilat ajo përbëhet nuk përmbajnë kundërshti (antagonizma, kundërthënie)». Kaq. Në asnjë fjalor apo leksikon të etikës, filozofisë, letërsisë, kulturologjisë (në gjuhët e Mainstreamit) nuk gjen më shumë material, e në shumicën prej tyre asgjë. Konkretisht: konsistente qenka një ide, mendim, opinion, doktrinë që ka karakter të përhershëm, të pakundërshtueshëm.

### *Intelekti*

«Grekët» e vjetër me **nous** nënkuptonin aftësinë, instancën humane për të njohur gjërat nëpërmjet frymës, mendjes. Ky përcaktim i para-sokratëve, Aristotelit dhe Platonit, mbizotëron deri në epokën e skolastikëve të mesjetës, të cilët dolën me përcaktimin **intellectus agens** (mendje aktive). Gjë që edhe **nous** –i aristotelian çoku e përmban në vetvete, pasi kemi të bëjmë jo me një proces statik, por dinamik; fryma patjetër nevojitet të jetë aktive për ta kapur «formën» që paskëtaj ta njohë objektin. Me *intellectus agens*, megjithatë nuk lidhet vetëm ky zgjerim definimi, por një doktrinë e caktuar, e cila përpiquej të përdorte filozofinë aristoteliane për të dëshmuar aftësinë e njeriut për ta njohur Zotin vetëm nëpërmjet frymës. Metodë, të cilën shumë më herët e kishin instrumentalizuar edhe filozofët islamë. Në këtë vijë duhet ta kuptojmë ulërimën e Descartes-it «cogito, ergo sum» (mendoj, pra jam) dhe intelligibel-in e Kantit si thirrje kundër përvojës empirike, racionales.

Sot madje edhe fetë – që më së shumti përfitojnë nga përjashtimi i përvojës konkrete nëpërmjet shqisave – e kanë kuptuar se përfytyrimi, perceptimi, imagjinata dhe përvoja formësohen jo nga komunikimi me ndonjë mjegull hyjnore e formënjeriu, por përcaktohen nga rrethanat sociale, kulturore, gjuhësore, domethënë nga faktorë konkretë e aktivë që programojnë qenien njerëzore. Në lidhje me këtë tashmë ekzistojnë mijëra teori. Edhe studimi i fundit dhe famëzhurmshëm i profesorëve të mjekësisë gjenetike, fizikës dhe sociologjisë Nicholas A. Christakis dhe James Fowler (Connected: The Surprising Power of Our Social Networks, 2011) të cilët për më shumë se 30 vite analizuan sjelljet e 12 mijë banorëve të qytetit Framingham të Massachusetts-it, dëshmoi bindshëm se intelekti i është nënshtruar një «infektimi» permanent social e kulturor. **Faciti** i këtij studimi është logjik: Sa më shumë arsimim, informata, dije, aq më shumë pluralitet, alternativa e hutim për intelektin njerëzor (ndërlidheni këtë me luftën e feve kundër përhapjes dhe përkthimit të librit; me censurën komuniste dhe të tjera gjëra të ngjashme). **Finalja**: Intelekti është i detyruar që të fekondojë dijen me arsyen për ta zgjedhur alternativën që i përshtatet. Nuk ka rrugëdalje tjetër. **Dhe ja ku e kemi mendjen aktive dhe të lirë të njeriut pasmodern!**

### *Rezistenca*

Edhe pa shëtitjen tonë nëpër të gjitha këto teori, prapëseprapë e dimë se jetojmë në një epokë informacioni agresiv, i cili sfidon qenien njerëzore në çdo moment kur ai të hapë sytë. Duke folur në këtë kontekst, gjatë një bisede me dy filozofët dhe gazetarët francezë Charlotte Pineau dhe Martin Legros (Në Louvre, Janar 2013) i urti nga Piemonti Umberto Eco tha se edhe «gjuha është një revolucion permanent». Ne

themi se vetë njeriu, qoftë nga pamja apo brendia e tij, gjendet në një revolucion permanent.

Mjeshtëria e intelektit të njeriut pasmodern nuk përbëhet nga refuzimi (i pamundur), por nga seleksionimi ose zotërimi i një dijeje që ofron mekanizmin e një update-i pa viruse e viruse trojanë. I arsimuari i sotëm – për të mbetur në hapin e kohës – është i detyruar vazhdimisht ta vërë në përdorim arsyen dhe nëpërmjet saj të marrë qëndrimin përkatës për një problem a dukuri të caktuar. Probleme, fenomene dhe zhvillime që shfaqen në jetën shoqërore, në përditshmëri dhe të cilat veç pas ekzistencës së tyre i kapim, i arsyetojmë, i luftojmë ose i përdorim për ta kuptuar botën ndryshe nga ç’e kishim kuptuar deri dje.

Ose ekziston edhe një armë tjetër rezistimi që e vë mendjen aktive në «stand by»- modus: Injorimi qëllimshëm i realiteteve dhe Injoranca! E këto dy të fundit janë dashnore të përbetuarra të konsistencës. Pse?

### *Raste konkrete shqiptare*

Pas shembjes së Jugosllavisë shumë njerëz publikë ndryshuan lëkurë dhe u shndërruan në demokratë të orëve të para duke u bërë aktivistët më aktivë të pluralizmit, liberalizmit. Përkundër kësaj metamorfoze ata edhe sot pas më shumë se njëzet viteve akuzohen si komunistë jugosllavë. Madje edhe fëmijët e tyre denoncohen si të tillë. Pas hapjes së Shqipërisë shumë shqiptarë (të të gjitha hapësirave) të cilët enverizmin e kishin besuar me dekada gati si religjion, përnjëherë e braktisën atë, duke e dënuar në mënyrat më drastike që ekzistojnë. Megjithëkëtë të «kthjelluarit» për shumicën vazhdojnë të mbeten enveristë dhe çdo lëvizje e tyre në drejtim të kundërt cilësohet si taktikë, pozë e tij për tu dukur më «katolik se papa». Ka njerëz që deri dje kanë qenë ateistë agresivë (për nga veprimi konkret social) e që sot janë

shndërruar në predikuesit më fanatikë të njëjës apo tjetrës fe. Edhe këta vërdallosen me të njëjtat etiketa biografike në ballë.

Edhe më konkretisht:

X-i mbaron medresenë në Shkup. Studion në Damask teologjinë islame. Për studime pasdiplomike vjen në Evropën perëndimore. Në një seminar të Historisë së Kulturës, ku trajtohen dokumentet kryesore të shkruara të trashëgimisë njerëzore, nga kureshtja (dhe sepse nuk i ka njohur krahasueshëm) kërkon që të shkruajë një studim krahasues për Epin e Gilgameshit, Biblën dhe Kuranin. Pas disa muajve e takojmë të depresionuar, të parruar dhe përtokë në një restorant të Bernës. Ç'u bë? «Varka e Noss», na thotë, duke pohuar se «ajo ma ka tollovit botën». X-i konstaton shkronjë për shkronjë sagat, ligjet dhe format identike në të treja dokumentet e përmendura dhe ka rënë në pikë të hallit për të kuptuar se kush është shfaqur më parë në botë; veza apo pula! Pas një ekskursioni nëpër evangjelizëm, marksizëm, nihilizëm, ai para do muajsh u doktorua në antropologjinë sociale. Familja e tij është mëse e zhgënjyer. Rrethi miqësor e quan viktimë të djallit. Evangjelistët e konsiderojnë të luhatur, të paqendrueshëm. Marksistët shpresojnë që të kthehet prapë në gjirin e tyre, ndërsa ai vazhdon të lexojë e studiojë si i çmendur!

### *Intelekti në stand by modus*

Sa kemi të drejtë ta gjykojmë si inkonsistencë ish komunistin jugosllav; ateistin e shndërruar në fetar; X-in e çliruar nga doktrinat e mëhershme; enveristin (si individ) e transformuar në pluralist, demokrat e kështu me radhë? Para së gjithash nga vjen kjo mendësi, kjo liri gjykimi aq e përhapur?

Patriarkët dhe njerëzit me shkallë të ulët arsimimi domosdo që bien në kurthin e besës së atypëratyshme dhe çdo ndryshim e perceptojnë si tradhëti, faqendërrim, apo moral të luhatshëm. Kjo gjë ndërkaq nuk iu lejohet atyre që kanë ndonjë rol në krijimin e kulturës sociale. Numri i atyre pedagogëve, «intelektualëve», profesorëve, politikanëve, publicistëve të cilët që nga dita e diplomimit nuk kanë marrë kurrë më libër në dorë duhet të jetë tmerrësisht i madh. Intelekti që është aktiv vetëm deri në një moment të caktuar dhe pastaj pushon së konsumuari, duke riprodhuar kapitalin e dijes së fituar ndoshta edhe dekada më parë, jo se është i demoduar, por ai është edhe dijebllokues për shoqërinë. Është sugjerim i hapur për betonim të mendjes.

### *Betoni është konsistent*

Po shohim se mendja aktive dhe konsistenca nuk shkojnë bashkë. Përkundrazi ato janë në armiqësi me njëra-tjetrën. Le të marrim një shembull krejt banal e të kapshëm: Nëse një publicist apo gazetar (kjo është shtresa profesionale, të cilën më së paku kemi të drejtë ta vëmë në ndërlidhje me konsistencën, kur kemi parasysh hulumtimin e tyre të përditshëm) dje ka shkruar, ta zëmë «Sali Berisha ishte lideri i demokracisë shqiptare» dhe sot thotë të kundërtën «Sali Berisha është bllokuesi i demokracisë së njëmendtë shqiptare», nuk mund ta vulosim si inkonsistent, por duhet automatikisht të kuptojmë se autori në fjalë ka lexuar studime të reja, ka studiuar e analizuar ndërkohë historinë e zhvillimeve politike të Shqipërisë postdiktatoriale dhe ka krijuar një përvojë të re argumentesh në kontekst me presidentin shqiptar. Vetë fakti se ai është transparent në qëndrimin e tij, tregon haptas se ai ka ndryshuar mendim. Domethënë ka mendje aktive. E drejta jonë nuk është të gjykojmë moralin e publicistit, por të peshojmë argumentet e



reja që atë e sjellin gjer në një qëndrim ndryshe nga ai që ne e mbajmë mend nga biografia publicistike e tij.

Pra nëse vëreni se në këtë ese ka reflektime që bien ndesh me ato të ndonjë shkrimi të djeshëm mos u brengosni duke pandehur se mos më ka infektuar inkonsistenca, luhatshmëria, por gëzohuni për faktin se në trurin tim ende qarkullon gjaku.

Mendoj, mësoj, zhvillohem, ekzistoj pra! (2013)

## *Haraçi i subjektivitetit*

Shumica absolute e teksteve, në mediat shqiptare, duke filluar nga titulli e deri në legjendën e fotografisë ulërijnë nga emocionet, preferencat, perspektivat dhe interesat personale të autorëve. Gjë kjo e lejueshme për autorë librash e opinionesh fare koti mirëpo jo për media dhe institucione të dijes. A mund të jetë gazetari shqiptar objektiv? A është e mundur të jesh shqiptar dhe objektiv? Të mundesh të përshkruash ekstremizmin e një grupi njëkohësisht duke ekspozuar dhe alarmuar kundër tendencës për stigmatizimin e mbarë grupit; të shpalosësh defektet e një partie duke mos harruar edhe anët pozitive të saj; të lavdërosh kauzën e një shtrese duke mos harruar edhe të metat e saj; a është e mundur të hedhësh teza, hipoteza, antiteza në një tekst të vetëm pa u shpallur si guru, pa të listuar përkrah militantësh semimediokër si vëlla tarafi e misioni; pa të proklamuar si ndjekës shtrigash apo censor, inkuizitor, që duhet kërcënuar me vdekje, që duhet fyer me farefis, me të lindur e të palindur? A është e mundur të mbetesh neutral brenda një mentaliteti, i cili me përjashtime minimale vepron sipas formulës bipolare heraklitiane të shabllonit bardh-e-zi dhe nuk lë shteg për asnjë alternativë tjetër të mundshme, pa mes e anë pra?

Kush ndjek shtypin dhe mediat e tjera shqiptare gjatë dy viteve të fundit do ta grushtojë tavolinën triumfueshëm duke garantuar: s'ka laps objektiv shqiptar!

Vërtetë është problem ta lokalizosh një autor që në kontinuitet jep maksimumin të mbetet objektiv, madje edhe kur temat, polemikat, debatet ia përfshijnë me dhunë personalitetin, dinjitetin, integritetin dhe nuk u ikën dot flluskave kundërsulmuese subjektive në shkrim.

Është gjë e keqe vallë fakti që shqiptarët janë të «paradënuar» me një temperament kaq eksploziv apo mirë? Po ç'na duhet objektiviteti?

### *Paradigmat*

As termi «objektivitet» nuk ka mbetur i virgjër nga reflektimet dhe definimet maratonike pothuaj në çdo shkencë e fushë të dijes humane. Ranke, Gervinus-i, Marks-i e deri tek Droysen (Historika: 1858) që e trajtonin nocionin nga perspektiva e filozofisë së historisë mendonin se shpëtimi nga debati qysh atëherë i mërzitshëm dhe virulent, do të ishte afirmimi dhe pranimi i një metode universale (ballafaqimi i njohur i argumenteve „pro et contra“ para „conclusios“) të aplikueshme zyrtarisht në të gjitha institutet e dijes. As kjo paradigmë droyseniane megjithatë nuk mundësonte llogore për t'u mbrojtur nga manipulimi subjektiv i metodës. Pikërisht atë problem që e shpërfaqti edhe Charles Sanders Peirce kur shkruante se «asnjë objekt nuk mund të kapet objektivisht sepse mediumi që e interpreton atë është përherë subjektiv». Max Weber-i i vuri vulën versionit të bashkëkohësit të tij duke thënë se çdo metodë – sado teknike të jetë ajo – materializohet (dekorohet) po me ato argumente (favorizuese) të perspektivës së subjektit që trajton temën (Weber. Werke: 1991 Stuttgart). E ky i fundit do ta formulojë edhe përfundimin falë vlerave që i mendon vetë si më të mirat. Qenka objektiviteti iluzion ndoshta? Po thonë edhe Niklas Luhmann i cili madje nuk sheh asnjë dallim ndërmjet objektivitetit dhe subjektivitetit, por i konsideron terma të

njërta në sisteme të ndryshme (hajt po luajmë teze) dhe që varen nga perceptimi i shoqërisë, pra „causa publica-ve“, mainstream-it. Mohikani i fundit i shkollës së Frankfurtit, Jürgen Habermas (Mercur: 1965) – në një trajtesë anti-Hans-Ulrich Wehler e hedh poshtë ekzistencën e objektivitetit dhe gjithçka që kërkon është veçse «bërja transparente e metodës dhe interesave të «hulumtuesit». Përkthyeshem domethënë kjo: një institut që merr të holla nga Partia X mjafton vetëm të bëjë transparente se për interesat e kujt e ka bërë anketën (pra të partisë X) dhe në rregull është. Çfarë pastaj? Muhabet kot.

Vërtet është i pamundur objektiviteti? I mundur është, por pse jo në Ballkan ende, si në pjesët tjera të kontinentit?

### *Gadishulli subjektiv*

Nuk është çudi që po këtë defetizëm kundrejt dualizmit objektivitet-subjektivitet e vërejmë në gjithë letrarinë shqipe dhe ballkanike (dhe gjithandej në vendet postsocialiste). Shoqëritë shqiptare, respektivisht elitat e tyre të pakta kryesisht janë të formuara gjatë periudhës së monorealitetit realosocialist. Një nivel dijesh që përfundon tek Marksi, Peirce dhe vazhdon me Luhmann, Badiou e kompani (neokomunistët) dhe tek një pjesë tjetër vazhdon si alternativë zëvendësuese teoria e Max Weber-it (neoliberalët). Të dyja këto rrugë shpien sidoqoftë drejt Romës së njëjtë. Dallimi i vetëm mes tyre është cilave prej të dyjave është më kategorike në mohimin apo banalizimin e objektivitetit. Këtu filozofët ndoshta duhet edhe të kërkojnë pamundësinë e një komunikimi paqësor ndërmjet ideologjive, doktrinave, etnive, kulturave të Gadishullit sepse ato janë të formuara me besimin e mosekzistencës së objektivitetit racional – ata frymojnë, kalkulojnë, ëndërrojnë dhe luftojnë vetëm subjektivisht, duke u nisur nga e xhungla e emocioneve në

stomakun të tyre e jo nga pasioni për ta gjetur zgjedhjen, kompromisin koekzistencial dhe human.

### *Shqiptar dhe objektiv?*

Në letrarinë shqiptare nuk ekziston fare (ose rastësisht, aksidentalisht) ndonjë indikacion që do të na jepte shenjë për ekzistencën e kokave që njohin edhe ofertat teorike të racionalizmit kritik të nisur nga Karl Popper (1902 – 1994), të përhapur e të definuar formëformule në të gjitha akademitë perëndimore si «pavarësi e mendimit dhe gjykimit nga perspektiva e subjektit, nga situata, preferencat, interesat e tij personale». A është e mundur të jesh publicist, autor shqiptar dhe të jesh objektiv? Po. Shqiptarët nuk janë më të paaftë apo me gjenialë se tjerët. Mediat dhe institutet e dijes duhet të mësojnë nga homologet e tyre perëndimore ku është ndryshe, ku së paku ekziston një standard se si të sillen me problemin e objektivitetit – veçanërisht në sferën e raportimit, informimit dhe seleksionimit të relevancave ditore, mediat ende nuk ia kanë nisur punës. (2015)

## *Mediat dhe gomari i Buridanit*

*Estetika e diskursit publik*

Përse në hapësirat si ajo frankofone, latinoamerikane dhe kjo shqiptare nuk ka sukses shtypi i verdhë? E kundërta ndodh në Gjermani, Britani të Madhe dhe Serbi ku pikërisht shtypi i verdhë «bën» opinionin dhe diskursin publik? Konstatim dhe paradoks: Sa më shumë që të arsimohen masat, aq më shumë banalizohen mediat!

Banaliteti në këtë kontekst nënkupton zhveshjen kockë e lëkurë, pezullimin pothuaj total të çdo dekorit estetik nga komunikimit publik. Këtë trend, të filluar nga vitet 80-ë e këtej, studiuesit kryesorë të komunikimit masmediatik (Bonfadelli, Meier, Berelson, etj.) e diagnostikuan si domosdo të imponuar nga kushtet agresive të tregut të lirë. Çshpirtëzimin e idesë së transferimit të dijes dhe (a)moralizimin e gjuhës, teoricienët e lidhën pra me procesin e sendëzimit edhe të sferave frymore humane nga ana e tregut. Teza qëndron, mirëpo vetëm si gjysmë e përshkrimit të problemit. Jo vetëm diktati kapitalist për ekonomizimin e çdo gjëje është fajtor në krijimin e «njeriut pa përmbajtje» — siç thotë filozofi italian Giorgio Agamben (Milano; 1970) — por edhe vetë konsumatori, njeriu, i cili për nga natyra duket të jetë i paraprirë të garojë me shpejtësinë e kohës dhe në hektikë zgjedh si ushqim për formim dhe shumim përherë «fast food»-in, çfarëdoqoftë ai.

«American way of life», amerikanizmi ka thyer traditën perceptuese gatikontemplative të europianit, përndryshe tejet të thellë, dhe është në udhë e sipër të nxjerrë me dhunë nga

çadrat edhe rrëfyesit dhe dëgjuesit e palodhshëm të përrallave orientale të «1001 netëve» – kjo është teza e dytë dhe më e përdorura që mëton të shpjegojë «banalizimin kulturor global» si proces me origjinë amerikane. Zakonisht e gojëplotë këtë e përsërisin amerikopatët e gjelbërt, ekstramajtistët e Evropës dhe ideologët e paradigmave pro-orientale. Padyshim se edhe kjo tezë është e njëanshme. Në kontekst me «mediat» dhe «diskursin publik» madje ajo nuk qëndron fare. Pse?

### *Banaliteti – made in Oxident*

Bulevardizimi i mediave është specialitet evropian e jo amerikan. Adresa e themeluesve të biznesit me thashethemet e salloneve nga vërdallej Jetset-i gjendet në Industrinë e mediave britanike, italiane dhe gjermanofolëse. Edhe aktualisht, në këto tre vende shtypi i verdhë mban flamurin në tregun e mediave. Mjafton të përmendim titujt si «Bild» (Gjermani), «Blick» (Zvicër), «Kronen Zeitung» (Austri), «The Sun» (Britani) dhe kemi bërë listën jo vetëm të gazetave më të mëdha dhe më me ndikim në vendet përkatëse, por kemi renditur edhe «makineritë kryesore për budallallepsjen e masave kontinentale» siç i quajnë dy gazetarët dhe komunikologët gjermanë Markus Metz dhe Georg Seesslen (Fabrikimi i stupiditetit, Berlin:2011) titujt në fjalë. Po në këtë listë lokalizojmë edhe burimin e «zbavitjes deri në vdekje» të masave dhe kulturave konform teorisë së shkencëtarit amerikan Neil Postman (Amusing Ourselves to Death: 1985 – krijimi i opinionit në epokën e industrisë së mediave zbavitëse).

### *Anarkia si causa finalis?*

Nga fillimi i viteve 70-ë e deri sot janë bërë qindra studime serioze rreth ndikimit të shtypit të verdhë në zhvillimin kulturor, politik (Alberts:1972), intelektual, arsimor (Prokop:1995) e gjuhësor (Rucktäschel:1987). Sipas rezultateve të shumicës së studimeve si «**causa finalis**» e këtij zhvillimi del konstatimi: Ky trend ka demontuar rëndë hierarkitë, kufijtë dhe vlerat e tre sferave ekzistenciale të shoqërive në fjalë — duke përdorur si filtër kategoritë e filozofit danez Søren Kierkegaard (në «Enten – Eller»:1843) — dhe atë; etikën (si konglomerat moralesh dhe identitetesh të veçanta), estetikën dhe (a)religionet.

Argumentit antropofilozofik se trendi në fjalë ka rezultuar nga lufta e mondanitetit për një «vullnet të lirë absolut, i cili nuk dëshiron të orientohet më sipas mostrave etike, estetike e kulturore në fuqi» e jo si efekt i formës së komunikimit masmediatik. Moralistët, ideologët, konservatorët dhe estetët e shumtë i kundërpërgjigjen me gomarin e Buridan-it (filozof i skolastikës, të cilit i mveshët autorësia e krahasimit në fjalë): Po qe se gomari, i cili gjendet në distancë të njëjtë përballë dy tufash identike bari, nuk do të dispononte më ndonjë mekanizëm seleksionimi (të natyrshëm apo të ritualizuar), katërkëmbëshi do të cofte urie nga hamendja se cilës tufë t'ia mësyjë së pari.

Përkthyer për dykëmbëshin: njeriu i paparimeve (estetike, etike, rituale, (a)religjioze apo diçka tjetër) s'ka ku të përfundonte tjetër përveçse në shpellë o si «Homo homini lupus est» i Plautus-it apo Thomas Hobbes-it në qoftë se nuk do t'iu nënshtrohej dot parimeve e kondicioneve estetike gjatë perceptimit dhe shprehjes.



## *Debati mbi diskursin publik*

Në kushtet shqiptare paradoksi dhe konstatimi i fillimit të këtij teksti shfaqet i modifikuar: sa më shumë të arsimohen masat aq më pak lexohen mediat! Ka ndezur apeli i shkrimtarit Albatros Rexhaj për t'iu bërë «refuzim estetik» gjitha formave banale të komunikimit (Së fundi në «Zona e debatit», 25.04.2013) pavarësisht se nga vijnë ato; perëndimi apo lindja?

Kjo do të implikonte që mediat shqiptare t'i kenë hyrë (me vonesë) stadi të zverdhjes, bulevardizimit. Përgjysmë po. Në Republikën e Shqipërisë gazetatat nuk dallojnë nga simotrat e tyre që përbëjnë atë «sporco giornalismo»-n e famshme italiane. Në Kosovë situata është krejt ndryshe: disa nga titujt që e provuan bulevardizimin, banalizimin si stil transferimi informatash ikën ende pa hyrë mirë në treg. Mediat e tjera duket ta kenë kaluar fazën e «imitimit» me çdo kusht të stilit bulevardesk perëndimor dhe ristabilizohen ose kanë nisur rrugën e lamtumirës.

Përse vallë shqiptarët (si perceptues) ndryshojnë nga fqinjët e tyre serbë ku gazeta e verdhë «Blic» (produkt i «Blick-ut zviceran) ka përfshirë tregun mediatik, përse ndryshojnë nga miliona lexuesit e «Hürriyet» (Turqi), Nový Čas-it (Blick – Sllovaki) e kështu me radhë? Nuk kanë «kulturë leximi» si të tjerët? Ose pyetur ndryshe: pse në Francë, SHBA, nuk ndez aspak bulevardizmi dhe gjithashtu pothuaj në shumicën e kontinenteve të botës, por vetëm në sferat gjuhësore që përmendëm më lart?

Qëndron teza, së cilës i vjen erë racizmi kulturor që thotë se; ka «kultura që kanë afinitet ndaj vetëdeformimit (ose mutimit), banalizimit pra, dhe kultura me integritet që përballojnë madje edhe ndikimin e rrjeteve sociale që kanë

thyer të gjitha kufijtë estetikë, etikë e politikë? Hë për hë shqiptarët vërtetë duket sikur «refuzojnë» imponimet që do të banalizonin diskursin e tyre publik. Dhe mirë nëse është vërtet kështu! (2013)

## *Kodet psikotoksike*

### *Lajmet*

Çfarë asociacionesh mendore dhe shpirtërore mund të ngacmojë ta zëmë fjalìa: Isa Mustafa duke qeshur dhe duke e përshëndetur në serbisht ia shtrëngoi dorën kryeministrit serb Vuçiç, i cili ia ktheu në anglisht» (frazë e huazuar nga mediat), në psikën e konsumuesit pa kushtetutë personale perceptimi?

Le të spekulojmë pak.

Kjo mund të ishte piktura e brendshme mendore që lexuesi (shumica) vizaton për skenën: Isa Mustafa është tip i nënshtruari, servil; i zgërdhiet kryeministrit të atij shteti që ushtroi gjenocid mbi ne dhe të cilin as perënditë nuk e shtyjnë të kërkoj falje. Ndërkaq kryeministri serb paska integritet; nuk ia varka fare dhe nuk ia kthen njëlloj, por demonstroi se nuk i duron lëpirjet.

Tani fjalìa në një version tjetër:

«Kryeministri kosovar dhe homologu i tij Vuçiç u takuan sërish në Bruksel...».

Cili është dallimi midis këtyre dy titujve? Në esencë që të dy kumtojnë të njëjtën gjë. I pari, informatë kryesore, sugjeruese ka karakteret e dy protagonistëve, ndërsa i dyti takimin si aksion konkret dypalësh. Fjalìa e parë nxit urrejtje (apo simpati, varësisht nga identiteti i recipientit) tek lexuesi, e dyta në formë neutrale sjell lajmin duke mos prekur autonominë reflektuese të lexuesit, pra ai ka lirinë të asociojë e mendojë vetë se si e vlerëson dialogun kosovaro-serb.

Duke njohur mediat shqipe pyesim: Cili nga dy titujt është shkruar me paramendim, me synimin për të shkaktuar një efekt apo afekt të caktuar? Asnjëri. Secili prej të dyve është «vepër» e ndonjë redaktori që pa vetëdije transmeton botën e tij të brendshme (paragjykimet, ndjenjat, frymën) tek masa e lexuesve, pa u menduar gjithaq, ndoshta edhe në hutim, hektik se si mund të ndikonte mesazhi. Mediat shqiptare nuk janë si ato perëndimore me redaktorë të stërvitur apo të angazhuar enkas (shefat e prodhimit) në raport me gjuhën që përdorin, titujt, mesazhin etj. Me përjashtime minimale, kjo është natyra e komunikimit, në relacionin media-lexues, në hapësirat shqiptare.

### *Opinionet*

Opinionistët janë kategoria publikuese që vetëm gjuhësisht (nëse ndodh kjo mrekulli me rigorozitet) korrigjohen nga redaksitë dhe pasi është kështu ata përbëjnë uzinat më infektive në krijimin e humorit dhe gjendjes shpirtërore të masave që i konsumojnë ato. Kategoritë – për shkak se çdonjëri autor sjell natyrën e tij personale – mund t’i grupojmë në tri drejtime: në neutralë (objektivë), pozitivë dhe negativë.

**Neutralët** janë autorë, të cilët për parim kanë objektivitetin. Gjatë thurjes së tekstit ata kujdesen vazhdimisht t’i përshkruajnë të gjitha palët, paradigmat me zërin autentik të tyre. Konstatimin personal qëllimisht e lokalizojnë qoftë grafikisht apo duke e nënvizuar si të tillë që të kapet nga recipienti si qëndrim i tij personal.

**Negativët** – që janë populluesit absolutë të mediave shqiptare – identifikohen lehtë për nga toni që ua përshkon mbarë tekstin: përbuzin, përqeshin si zakonisht adresa abstrakte (pushteti, partia, organizata, grupi); mbi 80% e fjalorit të tyre përbëhet nga kode negative si «asgjë, neveri,

skandaloz, nënshtrim, krim, kriminel, hajn, vrasës, evitim, padije» e gjëra të këtij lloji. Fjalitë i kanë të ndërtuara gjithmonë si gjykuese, pra jo të tipit: «Qeveria nuk aprovoi buxhetin për kulturë», por «Qeveria pa kulturë». Autori domosdoshmërisht krijon krahë të ndryshme tifozerike lexuesish sepse duke gjykuar e sugjeron veten si instancë kompetente gjykimi e morali. Në këtë përpjekje e sipër nuk ka rëndësi se a disponon argumente të mjaftueshme apo jo.

**Pozitivë** janë të pabesët. Autorët që qëllimisht operojnë me kode pozitive dhe të mëshirëpasjes si: «atdheu i shkretë; ia dogjën të ardhmen rinisë; shqiptarët vetëm vuajnë», ose në stilin «gjuha jonë e çmuar prishet nga akademikët e paditur, të cilët nuk janë të këqinj, por ashtu i kanë pasur kushtet».

Në këtë grupim bëjnë pjesë edhe grupet që tentojnë të imponojnë një axhendë apo një temë të caktuar në mendësinë e masave. Metoda u përngjan trukeve të agjencive turistike, të cilat në vend të reklamës për një destinacion të caktuar (Kroacinë, Turqinë) botojnë artikuj pro natyrës, bukurive, mikpritjes, kulturës gazetave të mëdha – kështu duke sugjeruar parajsën. E njëjta gjë ndodh edhe në drejtim të kundërt. Në krahasim me negativët kjo subkategori është më pak e dëmshme sepse ka për bazë mashtrimin si këmbim për një shërbim dhe evitohet pasi «konsumatori» të jetë kthjellur. Ndërkaq negativët ndikojnë në sfera komplekse dhe organike të njeriut, duke ia dërrmuar sistemin nervor, duke nxitur depresione masive e të llojit.

### *Lexuesi*

Lexuesi, pavarësisht nivelit të tij arsimor iu nënshtrohet përditë «aksioneve» të këtilla të manipulimit masiv nëpërmjet mediave. Për shkak të intensitetit dhe përthithjes së shpejtë që imponojnë lajmet, çdo mekanizëm mbrojtës pothuaj është i pamundur. Të paktë janë ata (profesionistët) që kanë një

«kushtetutë» personale perceptimi, pra janë të ushtruar si lexues të vetëdijshëm me problemin që trajtojnë.

Problemi i këtillë do të ekzistojë gjithmonë për sa kohë që të komunikojnë njerëzit. Ky as që është qëllimi i këtij teksti. Siç thotë edhe titulli, alarmi ka një adresat tjetër: mediat! Ato meqënëse ndikojnë shumë në gjendjen psikike, shpirtërore të masave. Nëse shumica e mediave të një hapësire kulturore prodhon kryesisht dhe vetëm publicistikë negative apo pozitive (sipas kategorive tona) shoqëria asnjëherë nuk mund të shpresojë në elita racionale, pragmatike që do të mundën ndonjëherë ta marrin timonin e përparimit. Elita të tilla nuk do të kenë sukses madje as po i morëm nga jashtë dhe t'i instalojnë në një hapësirë të tillë kulturore ngase do të përjashtohen nga masa ose do të kuptohen kur edhe elitat do të operojnë me shigjeta psikotoksike. Është koha kur mediat shqiptare duhet të mendojnë seriozisht mbi gjuhën e tyre! (2015)

## *Tregu “estetik” i masmediave*

Ishte libri publicistik i Blendi Fevziut, moderuesit televiziv, mbi ish-monarkun shqiptar Ahmet Zogu, ai që nxiti një kuazipolemikë rreth rolit të mediave, në raport me veprat e reja të artit.

Ndoshta për arsye se debati mbeti në duar kolumnistësh, autorësh e joprofesionistësh të fushës ai u reduktua në pyetjen: A është e drejtë që mediat t’i japin jehonë të madhe një veprë vetëm se autori është i rrjetëzuar fort në sferën e masmediave, apo ngase ai është menaxhues i shkathët i prodhimit të vet, pra di se si ta shesë atë e të mos përfillen fare veprat e atyre që nuk i kanë mundësitë e njëjta.

### *TEZA ishte:*

Mediat nuk duhet të korruptohen në atë mënyrë, duke sugjeruar en mase si megavlerë diçka që nuk është. Ato duhet t’iu përmbahen standardeve të barazisë së trajtimit të autorëve dhe artistëve e para së gjithash ato duhet të ofrojnë kritikë profesionale kur raportojnë mbi botimet e reja, ekspozitat artistike, autorët.

### *ANTITEZA thoshte:*

Kritikët e masmediatizimit të veprave në sajë të lidhjeve, reputacionit dhe shkathtësisë menaxhuese të autorëve janë njëdimensionalë, të ngurtë, zemërngushtë dhe duan të mbajnë monopol, të jenë instancë që na thotë se çka është vlerë e çka jo.

Para se t’i diskutojmë, analizojmë objektivisht tezat për ta tentuar një konkluzion, dy krahasime; një nga kulturosfera

shqiptare e një nga ajo perëndimore. Cila është udha e një vepre artistike, ta zëmë në Zvicër e cila e asaj në shqipë.

### *Si ndodhë në Zvicër?*

Autori përgatit tri kopje të manuskriptit të tij final dhe ia dërgon atë një shtëpie serioze botuese. E fundit ua shpërndanë tre lektorëve të saj (lexuesve profesionistë; kritikë të dëshmuar të letërsisë, shkencëtarë të letrave, gjuhëtarë) dhe pret mendimet e tyre. Pas mendimeve të tyre SHB formulon përgjigjen me kushtet, planin e plasimit në treg, mediave, bibliotekave, orarin e leximeve dhe detaje të tjera. Botohen një apo dy mijë kopje dhe u dërgohen mediave serioze, kryesore. Numri i ekzemplarëve të veprës varet nga vlerësimi i mediave: Nëse NZZ, FAZ, SZ, “Der Spiegel”, “Focus” dhe TV formatet e njohura televizive kulturore e vlerësojnë kryesisht si modeste e deri të mirë, nis shtypja industriale e veprës.

### *Si ndodhë në Ballkan*

Versioni i parë: Autori duhet ta njohë dikë personalisht, të ketë lidhje, miqësi me ndonjë botues që ai t’ia botojë librin. Dhe atë pa e lexuar fare. Kryesisht autorët paguajnë harxhimet e shtypit. E qëndisin librin vetë grafikisht dhe zgjedhin se sa kopje të botohet. Pas botimit sërish është detyrë e autorit që ta gjejë ndonjë „recensent“ për t’ia bërë një „kritikë“ afirmuese. Ndodhë eventit final: Autori promovon librin në ndonjë bibliotekë, librari a kafene dhe kaq. Versioni i dytë: Pas rënies së monizmit, kohëve të fundit edhe shqiptarët i përvëlloi marketingu i egër jo vetëm i materialeve teknologjike dhe tekstileve, por edhe ai i prodhimeve frymore. Masmédiat dhe rrjetet sociale katapultojnë çdo opsion politik, lider apo libër në megaevent të ditës, javës muajit: për pare



natyrisht. Në “Facebook” të mjaftojnë disa mijë euro për t’i blerë brenda disa ditëve qindra mijë „like“ e ndjekës që pastaj t’i manipulosh me aksionet private. Se si funksionon ky lloj marketingu tashmë kemi raste konkrete. Librin pra mund ta shtypësh edhe vetë dhe brenda disa minutave e sheh çdokush. Kjo nuk do të ishte gjithaq dramatike, sepse ndodh gjithandej – kudo ka shpirta estetikisht me receptorë të paedukuar që mund t’i përdorësh si lolo. Problemi qëndron diku tjetër: gjersa në vendet perëndimore FAZ, ZDF, NZZ, etj. (ndodh që veprojnë nga mëshira ndonjëherë pa dhënë vlerësim) nuk pranon të bëjë intervistë me para me ndonjë autor a snob për ta plasuar si do ai, por lejon vetëm „reklamën“ transparente, masmediat shqiptare nuk e praktikojnë këtë: ato nuk shpalojnë se kur është fjala e natyrës së biznesit e kur jo, kështu që një autor të rëndomtë e sheh në të gjitha kanalet televizive, nëpër gazeta e gjithandej, e tjetrin që të shkruan me art as që e përfol kush.

### *Konkluzioni*

Paraprakisht ta evitojmë një keqkuptim: Libri i Fevziut po aq sa ai i fundit i Mustafa Nanos janë libra të mrekullueshëm brenda zhanrit. Edhe pa insistimin e tyre dhe me reçensa profesionale ato ndoshta do të popullarizoheshin edhe më shumë se sa me debate të aranzhuara dhe spektakle mediale.

*Teza dhe antiteza:* Kritikët e spektakleve të aranzhuara mediale qoftë edhe intuitivisht (nëse nuk janë specialistë të estetikës, kritikës apo shkencëtarë) e kanë kuptuar një gjë që Platoni e kishte kapur edhe atëherë kur nuk kishte media e as estetika nuk njihet si shkencë: Në Phaidros dhe Philebos ai kërkon ngritjen e atyre ideve mbretërinë e të cilave e përbëjnë e Mira dhe e Bukura, sepse vetëm të fundit, në aspektin etik dhe politik ia vlejnë të perceptohen dhe të shumohen.

Aristoteli në „Retorikën dhe poetikën“ e tij e bën një listë kushtesh se çka mund të jetë estetike e çka jo. Kant-i në „Kritikën e arsyes së pastër“ definojnë të domosdoshmet, „mësimet elementare“ për edukimin e sensoriumit human për ta civilizuar atë edhe më tej si qenie humane, pozitive, etike e jo luftarake, seksualomanjake, perverse e kështu deri në pafundësi.

Që nga A.G. Baumgartner (1714 – 62 – themeluesi i estetikës si disiplinë) e deri më sot masmediat, SHB-të dhe institucionet që merren me vlerësimin e vlerave në Art iu përmbahen kanoneve universale të kritikës të ngritur nga ky proces kulturologjik. Kritika e Arteve më vonë, duke u nisur nga kjo bazë ka krijuar instrumentet tekniko-shkencore për ta bërë vlerësimin sa më objektiv të veprave artistike. Arti nuk është shije, sepse aty ku i vjen era mund të jetë gjellë apo pleh, mirëpo kurrë artefakt me të cilin duhet edukuar njeriun, qoftë edhe këtë të irrituarin e postmodernës.

Antiteza është mediokre! Masmediat si përçuese direkte kanë një përgjegjësi të madhe në këtë drejtim! (2015)

## *Grotesku dhe «tipat idealë»*

Nateditë akuzohen mediat për mungesë etike dhe profesionaliteti. S'dinë ata më mirë, apo problemi është diku tjetër? Masat i detyrojnë ata të sjellin vetëm lajme groteske, ngase ky është kushti për t'i konsumuar.

### I.

Disa ditë më herët: në një gjërmadhë çarkitektonike u gjet 93-vjeçja Qamile Poroshica para vdekjes, pa bukë, e sëmurë e braktisur nga të vetët. Ngjarja tronditi opinionin për mjerimin material dhe moral ku kanë rënë kategori të shoqërisë që nga pushteti e deri tek individët.

Dje edhe një lëkundje emocionale që shkaktoi mllëfin e masave: ish folk-këngëtarja Shyhrete Behluli me një dasmë të shfrenuar, ku hidheshin qindra eurot gjokseve të kolegeve të saja si gjethe dushku, martoi të birin.

Në të njëjtën ditë një revistë që nuk druan as nga perversitetet antifamiljare ia bën portretin nënës së fyesit maratonik alias Gold AG, e cila paska qenë mësuese dhe media në fjalë s'ka shteg tjetër veçse të dorëzohet: «E neve nuk na mbetet vend për dyshime, pasi që Zonja Ilmije ka një djalë si Ariani». Portretin e përfol edhe media me mbi një milion lexues «GazetaExpress». Rrjeteve sociale nuk munguan fyerjet fatkeqe edhe ndaj nënës së pseudoreperit islamofanatik, e cila – kështu sugjerimi – pasi paska edukuar në këtë mënyrë fëmijën e vetë, si mësuese paska prodhuar zombi, masa mercenarësh që ecin pas ideologjive të huaja dhe fyejnë çdonjërin që u del përballë.

Po dje publicisti i mirënjohur Veton Surroi përdhose ndaj gazetës «Blic» dhe fyen rëndë si tejmashtuese median tjetër «Express», duke u kërkuar profesionalitet mediave gjatë citimit të njërës nga intervistat e tij kronike mediave të veta. Edhe ndaj reagimit të Surroit nuk mungoi tarifa: Mediat nuk paskan gënjyer kur shkruajnë se Surroi dikur donte pjesëmarrjen e kosovarëve në zgjedhjet jugosllave, pasi që të fundit kishin shpallur republikën e tyre. Si ilustrim u sollën artikuj nga ish Rilindja ku autori vret e pret emigrantët pse demonstironin në perëndim për «Kosovën Republikë».

Mediat poashtu nuk paskan dezinformuar kur implikojnë që Surroi të aludojë në gjykimin e Thaçit dhe UÇK-së, ngase këtë e kërkon edhe me veprat e tij pseudoletrare dhe tekstet e tij të panumërta që i vetëquan si «teoria politike» e «bullshit»-izmit. Dhe për fund si qerasje natyrisht akuza standarde: Veton Surroi qenka bërë milioner me subvencionet e dedikuara për zhvillimin e mediave të lira në Kosovë si dhe gjitha frustrimet i dalin nga dështimi në politikë, prandaj nuk paska kapital të na shes moral.

## II.

Qëndrojnë këto për Vetonin? Nuk jemi gjykatës! Kjo minianalizë ka tjetër synim: ne duam ta lokalizojmë modelin e njeriut që mediat ia imponojnë opinionit dhe arsyet se pse pikërisht ky model ndez e aktivizon aq trandshëm interesin e masave, të cilat pastaj i përfolin këto «agorave» të tyre virtuale?

Me çfarë tipa njerëzish kemi të bëjmë? Me një plakë paravdekjes si pasojë e dështimit të shtetit dhe familjes; me një këngëtare epesh romantike që s'dinë kur t'i çojë paret dhe i hedh, i shkel ato me këmbë dasmave edhe pse i fiton duke kënduar ilahije bashkë me tipin e radhës; kemi të bëjmë me një nënë që ka dështuar në edukimin e të birit dhe të tjerëve,

duke i sjellë shoqërisë një (plotë) zombi që fyen, akuzon, nxit dhe rekruton me pseudoartin e tij xhemat për imamët radikalë dhe për fund kemi të bëjmë me një që profesionalitetin dhe mediat e tij i përdor si pardesy për zbrazje mllefesh, teorish bullshitiste dhe akuzon tjerët për atë që bën vetë.

Pra modelet janë; viktima e skamjes dhe imoralitetit; përfituesja e skamjes dhe ekzekutorja e imoralitetit që hedh pare kur tjerët vdesin urie; perversin, amoralin e shturur që përfiton nga skamja mendore e kategorive të caktuara të shoqërisë dhe kemi moralistin e gjithë këtyre që bën dhe shanë mediat që i pasqyron gjithë këta bashkë – pra edhe vetë atë! Gjithë këta tipa janë të dështuar, me fajin e vetë apo të tjerëve.

### III.

Ka vdekur ajo kohë kur mediat si kyreparim kishin «edukimin e masave me progresivitet». Ligjet e konsumizmit sot ia kanë ndryshuar drejtimin rrotës: mediat janë të detyruara të prodhojnë atë «bullshit» që kërkon tregu, që e kërkojmë ne. Mediumi i kërkesave janë reagimet e lexuesve, pra detektimi i interesimit të masave, bëhet nëpërmjet intensitetit të reaksionit të klientëve. E cili është reagimi ynë ndaj 95% të informatave që s'kanë të bëjnë me tipat e përshkruar lartë? Minus zero? Interesi i masave aktuale shqiptare është për tipat si Shyhretja, Cyanid AG, Vetoni dhe mjerisht edhe për viktimat si Nënë Qamilja, jo se duam t'i ndihmojmë porse na shërben për të zbrazur mllefin e akumuluar që mund ta shporrim vetëm kur është në pyetje *Tjetri, Tjerët*. E si i kemi hallet vetë?

Këto do të jenë arsyt e dështimit të këtyre tipave të shumtë, arsyt janë masat që i konsumojnë si «tipa ideal» për çka? Masa që po u hulumtuan e zënë vendin e parë në botë si populli me perceptimin dhe veprimet më groteske në botë! Është kërkesa e masave për groteskën problemi kryesor e jo

individët në fjalë. Pa interesimin e opinionit as ata vetë nuk do ta dinin kush janë dhe për çka janë, ngase do të kishin dështuar që në hapin e parë! (2016)

## *Seksi, puritanët dhe mediat*

«Na mbytën portalet shqiptare me femra cullak», ulërijnë puritanët dhe i luten Zotit të tyre që mediat mos vendosin ndryshe!

Të gjithë i shikojmë, klikojmë, sodisim dhe pastaj i shajmë për pamoral: ato dhe mediat që i publikojnë. Cullaket e bukura, seksi, eksituese, ato që na zgurdullojnë sytë deri tek veshët, vënë në aksion epsheet tona dhe si duket na tundojnë aq saqë pastaj i bëjmë temë diskursi. Puritanët janë më të zëshmit, ata të cilët – po u besuam psikanalitikëve – janë ndoshta frekuentuesit më besnik këndeve eroseksuale mediave shqipe.

Që nga shfaqja e tyre, përafërsisht më shumë se një dekadë pas rënies së monizmit politik, kritika më e shpeshtë që e dëgjon dhe lexon ndaj mediave, veçanërisht portaleve shqipe është ajo mbi pervertimin e tyre në aspektin moral dhe atë pikërisht për shkak të rubrikave të pagëzuara si; showbiz, showtime, lifestyle e të ngjashme, brenda të cilave redaksitë kanë ndarë vendin më dominant për femrat si Kardashian, Kallash, Shkëndije Mujaj dhe gjithë ato të botës që pranojnë të fotografohen zhveshur, me gjoksin, prapanicën jashtë, në bikini ose për të atilla që postojnë ndonjë selfie duke e bërë atë punë dhe çmendin e kënaqin totalisht miliona tifozë nga Alaska e deri në Bajnicë të Gostivarit.

Tash pyetja kapitale: Kush i ka fajet për këtë «(a)kulturë skandalizuese morale»? Ajo që bëri selfie nga shtrati në tërmet apo miliona recipientët që së paku për disa çaste e ndiejnë veten në kulmin e kënaqësisë, pa u interesuar se ç'bëjnë pastaj? Askush! Asnjëra palë nuk i ka fajet, ngase kështu është njeriu i programuar si qenie. Pse?

### *Aspekti historik*

Kush e bind dhe si Enkidu-në gjysmanimal të zbres në Uruk tek Gilgameshi? Šamhat-i ajo zonja me gjimnastikën aq të pasur seksuale që një javë e «terrorizon» luadheve të gjorin deri sa e bind të përballet me qytetërimin, të zbres poshtë, ngase i realizuar (seksi si portë drejt qytetërimit). Në Antikë e deri me rënien e Romës banjat publike ishin domicilet më prestigjioze ku skenat seksuale ishin të rëndomta dhe më të respektuarit ndër senatorët, filozofët ishin ata që pranë vetes kishin edhe ndonjë bukurosh. Epikurianët, pitagoreanët dhe shumë klube tjera antike na mësojnë për episode aq të hapura të shoqërive ndaj seksit, erotikës, duke e trajtuar atë si një aspekt të bionatyrshëm, të domosdoshëm të specieve, frymorëve. Ardhja predikuesve të religjioneve abrahamite në skenë (në veçanti) e ndryshon këtë qasje radikalisht. Mesjeta në këtë drejtim është e tmerrshme. Në skenë shfaqen eunukët, gratë klitorisprerë dhe predikuesit e ashpër që seksin e agjitojnë si vepër demonësh. Gjitha këto morale mirëpo nuk dëshmojnë për reduktimin e veprimit seksual të njerëzisë, përkundrazi ai shumëhet, mirëpo i kriminalizuar, egërsuar, primitiv, sidomos ndaj grave dhe të pafuqishmëve. Saherë që të shëtisim Biblës ndeshemi me Davidët që ua marrin gratë tjerëve me zor e me dhunë dhe skena tjera brutaloseksuale. Sa herë të shëtisim botës gjeografikisht aq të kufizuar të Kuranit na parafytyrohet Muhamedi që vërdallet me një divizion grash gjysmë – të – zhveshura (poashtu disa të marra me dhunë nga tjerët) rrugëve. (Në këtë e sipër duhet të na kujtohet edhe vërejtja e një miku të tij që i thotë t'i mbulojë pak gratë se eksitohen meshkujt, prej ku edhe ideja e normës rreth mbulimit). Përtej synimit të kastrimit të së drejtës seksuale në emër të librave të «shenjtë», mirëpo në to direkt kemi aq lojëra të bukura seksuale saqë edhe erotikëve më me



imagjinatë të së sotmes u merren mendtë. Kjo dëshmon se duhet ta ndajmë botën reale të Biblës dhe Kuranit nga interpretimet e tyre nga kohë në kohë.

Në komunizëm veprimi seksual u shndërrua në detyrë partie. Aty ku nuk ishte i tillë zhvillohej ashtu siç ishte trashëguar nga patriarkalizmi primitiv ose religjionet.

### *Racionalizimi i seksualitetit*

Pas Woodstock-ut në vendet e industrializuara nis revolucioni i njëmendtë i emancipimit seksual. Historianët që kanë shfletuar shtypin e viteve të 60-ta, 70-ta e dinë se si është dukur histeria e religjioneve, puritanëve dhe konservatorëve. As që mund të krahasohet me reagimet paktymqitëse të shqiptarëve tolerantë dhe juglindorëve tjerë të kontinentit. Gazetat si ajo gjermania BILD, ajo zvicerania BLICK e të sojit kërcënohen me gjithçka, për shkak të fotografive tyre nudo. Në fund të viteve të 80-ta u shua histeria dhe fotografitë me gjoksin jashtë të yjeve hollywood-iane i shihje të ngjitura vetëm traktorëve, buldozerëve e vinçave nga ndërtimtarët e huaj. Çka ndodhi? E braktisën mediat përfitimin nga seksi? Jo. U racionalizua perceptimi i shoqërisë në relacion me seksin. Mediat u ndanë në «bulevardeske» dhe në «serioze», të citueshme dhe të pa ndikim. Ato që trajtojnë seksin vazhdojnë edhe sot të kenë më shumë lexues, mirëpo ky është aspekti gati anësor i temës. Ajo që bëri epokë – sado paradoksale të duket – ishte revolucioni emancipues: nëpërmjet madje edhe banalizimit të seksualitetit si mall për treg njeriu postmodern edukoi veten me magjinë estetike të polit tjetër gjinor. Gruaja, ai «objekt i mistershëm», i mbuluar që pret pushtimin e egër, brutal të mashkullit paraeksplodues, atij që gjithë fiksimin e ka përqendruar tek verifikimi i virgjërisë nëpërmjet «atij sendit» transformohet në subjekt kompleks estetik që ka nevojë për soditje, përjetim, dashurim,

njohje, domethënë «objekti i mistershëm» shndërrohet në një subjekt të barabartë i cili mund të «përvetësohet» vetëm nëpërmjet kriterëve të nevojshme optike estetike dhe komunikimit si urë përafrimi fryme e shpirtrash. Në këtë revolucion u çlirua erotikja, u dekriminalizua seksualiteti nga demonizimi dhe eksploatimi i tij brutal që e trashëgoi humaniteti nga mesjeta.

### *Bukuria e qenies dhe perceptimet e puritanit*

Në kushtet shqiptare: revolucioni ndodhë në një hapësirë dhe kohë tjetër. Pasi nuk është i programuar (nuk ekziston ndonjë konferencë e kryeredaktorëve për ta seksualizuar shoqërinë) procesi del i natyrshëm. I vonuar por i domosdoshëm. Duket të jetë rrotë historike që nuk ndalet as nga puritanët më të çmendur, siç janë sot fetarët, sidomos ata që nuk e kanë lexuar si duket asnjëherë as Biblën e as Kuranin e lere më Gilgameshin apo historinë kulturologjike të njerëzimit.

Portalet shqiptare janë në funksion të një detyrë të domosdoshme historike. Është herët të kërkosh prej tyre të ndajnë «rubrikat në serioze dhe joserioze» ngase masat ende nuk janë të racionalizuara në atë shkallë sa që t'i shtysh ta lexojnë lajmin serioz pa i ngacmuar me prapanicën e Kardashianit apo gjoksin ende legjendar të Samantha Fox-it. Proces i emancipimit sapa ka nisur dhe ai nuk ka pse mos të përfundojë si gjithandej: duke u edukuar shqiptarin me vlerat estetike të njeriut që ai, tjetri qoftë mashkull a femër, të mos kalkulohet si objekt seksual apo mjet për vetërealizim por si bashkëqenie komplekse me bukurinë, shëmtinë, frymën dhe botën e barabartë të tij e të saj. (2015)

## *Stresorët e opinionit*

Opinionbërësit mediave shqiptare sillen sikur jo vetëm ta kenë studiuar por edhe ta kenë përjetuar personalisht zhvillimin kulturologjik të humanitetit. Në fakt më shumë përballemi më një shumicë „intelektualësh“ stresorë se me të atillë me tru të kërcënuar ndonjëherë nga brisku i Ockhamit.

„Foli Arifikmet AbdylMenafi. Urime, urime, urime!“ – kjo ishte motoja e aktorit negotinas Xhevdet Jashari në komedinë seriale „O sa mirë“ me Enver Petrovcin dhe Koçe Devolen. Komedia pa hamendje mund të përjetohej edhe si ekspozitë e funksionimit të mendësive shqiptare. Enkas Arifikmeti. Figura që haharisej, duke parodizuar mëdhesën parakulturore ku banon qenia semifeudale, naive, simpatike, ajo figurë me tirq e cila kur hynë në interaksion shpërfaq dytësorin omniprezent brenda socialitetit shqiptar – Inkubusin me fëmijët; arkaikun, autoritarin, snobin, egocentrikun, narcisin me nënën e tyre; Dominaren.

Ku në realitet përballemi më së shpeshti me këtë figurë sa komike aq edhe të padurueshme, me këtë tip dykëmbëshi që nuk dinë të flas e as të shkruaj pa na torturuar me refrenin „fola unë, unë“ dhe me sy e vesh gyporë pret të bëhemi sirenë konfirmimi: urime, urime, urime? Mos atë e hasim të numërt sidomos aty ku trajtohen temat që lidhen me res publica -n: në media? Po. Të ashtuquajturit „opinionistë“ akuzohen të jenë grupi ku kanë gjetur shtëpinë fëmijët e Inkubusit dhe Dominares.

Pse ky (para)gjykim dhe sa i drejtë mund të jetë ai?

## *Kategoritë*

Në analizë kyçim (gazetat, televizionet, radiot) mediat, të cilat biznes nuk e kanë vetëm distribuimin e informatave – të gjitha pra – por veçohen edhe me tendencën e të qenurit tribunë ndikimi në proceset shoqërore. Për nga volumi i opinionistivë, në këtë kontekst, prijnë printmediat, ndërsa për nga efekti dhe ndikimi televizionet duket të kenë fjalën. Parasysh kemi të gjitha mediat e Kosovës dhe Shqipërisë.

Grupi i republica-ntëve mund të degëzohet në katër kategori:

**Redaktorët** - Kjo subgrupë përmbledh në vete ata që kanë kryer gazetarinë apo gjuhën e letërsinë. Në krahasim me kategoritë tjera këta „opinionistë“ janë më abstinentë karshi megatëmave dhe dinë të përqendrohen lokalizueshëm në temën që trajtojnë, pra pa u katandisur zonave për të cilat nuk janë kompetentë.

Më të shpeshtit mediave shqiptare janë bërë (viteve të fundit) **Opinionistët me detyrë** - Autorë të ngarkuar e obliguar nga partia, organizata, lobi, doktrina ideologjia për të masivizuar perspektivën monodimensionale të tyre rreth dukurive, problemeve dhe sferave të ndryshme të shoqërisë. Është kategoria detyrueshëm dhe automatikisht më transparentja e mendimit publik. Kategoria e tretë janë **Publicistët e lirë**: aktivistë, profesionistë fushash të ndryshme brenda shoqërisë civile që japin mendimin e tyre duke shfrytëzuar fjalën e lirë ose mundësitë e reja të shprehjes publike. Dhe grupin e katërt e kanë të parët: **Allrounderët** - që edhe konsiderohen si analistë, specialistë, opinionistë me ndikim në mendësinë kolektive.

## *Analiza*

Në kushtet e mediave shqiptare ende nuk janë krijuar linjat e nevojshme profesionale ndërmjet zhanreve të gazetarisë. Shumica e **gazetarëve dhe redaktorëve** luajnë rolin e gjithabërësve – qoftë ngase kushtet ekonomike janë siç janë e qoftë nga natyra gjithandej hundëfutëse e të zanatit. Pavarësisht nga kapacitetet dhe talentet. Kjo vërdallje, ky mospërqëndrim nuk lejon specializim. Prandaj një numër i madh i gazetarëve dhe redaktorëve (ndër ta profesionistë të mirë) pensionohen atyre korridoreve monotone të publicistikës shqiptare pa ua mësuar kush emrin si duhet. **Opinionistët me detyrë** janë kategoria më me pak ndikim, madje edhe atëherë kur ndër ta ka autorë të mirë, mirëpo që çdo tekst u lexohet gjithmonë me të njëjtën titull: në emër të partisë! **Publicistët e lirë** janë problem në vete: pjesa dërrmuese e tyre, në kushtet e mediave normale as që do të botohej. Të paktët, të cilët mediat bëjnë mirë që i botojnë sikur t'i ndjek frika e shuarjes duke botuar sa më shumë që është e mundur, rend e pa rend, për tu zhdukur dikur sikur të mos kishin qenë. Kjo kategori fabrikon edhe një telash tjetër që ka të bëjë me vendet e punës: për shkak numrit të madh të voluntaristëve botuesit punësojnë më pak redaktorë e gazetarë se sa është nevoja, paguajnë keq, nuk i lënë redaktorët të shkoqen nga desku dhe ofrojnë pas asnjë kompensim mendim për grithke, gjithçka dhe në çdo kohë.

Për temën që trajtojmë tre kategoritë e mësipërme – ndër të cilët ka edhe autorë të shkëlqyeshëm – të gjitha bashkë megjithatë nuk janë alfakafshët e mendimit publik shqiptarë, por **allrounder-ët**. Alfata pra i gjejmë në kategorinë e katërt, në atë allrounder-ve, ndër të cilët ka kollumnistë, botues, kryeredaktorë, publicistë dhe që perceptohen si bërës, farkues,

intelektualë dhe stimulatorë të opinionit publik– matur edhe nga intensiteti i reagimit ndaj opinioneve të tyre.

### *Diagnoza*

Të gjitha kategoritë e kanë një të përbashkët: autorët iu drejtohen lexuesve të tyre nga pozita „foli Arifikmet AbdylMenafi“, nga froni i arkaikut snob, nga instanca morale, kompetente, me një gjuhë shpesh të sojtit të aktgjytimeve sovjetike, ku argumentet, procedurat, s’kanë çka kërkojnë. Ky ves – që te tre kategoritë e para është nuk ndez se nuk ndikon – egërsohet të kryeopinionistët, të cilët të lënë përshtypjen sikur jo ta kenë studiuar, por edhe ta kenë bërë vetë historinë e qytetërimit, politikën, sociologjinë, filozofinë, mjekësinë, astronominë, matematikën. Nga analiza, krahasimi, verifikimi i teksteve të shumicës së „eruditëve të popullit“ që aq shpesh hidhërohen kur masat nuk ua bëjnë idetë libër të shenjtë, program jete e funksionimi, mësojmë se kemi të bëjmë me një kategori intelektualisht të shpifur, pa thelb që më shumë shkruan, pak ose hiç lexon, nuk mëson dhe veçse nuk eksplodon nga tendenca për ta mësuar shoqërinë si ta flakë mizërinë. Pyetjes se pse intelektualisht të shpifur e japin tekstet e tyre: asnjëherë ose më pak se rrallë mëson për kauzalitetin e çështjes që trajtojnë; nga erdhi, pse është, nga kaloi, por gjithmonë tregojnë se problemi duhet të zgjidhet, pa treguar si, kur, pse. Një ligjërim i këtillë publik publicistësh me tru asnjëherë të kërcënuar nga brisku i Ockhamit nuk kanë se si ofrojnë modele, alternativa për progresin e shoqërisë, përkundrazi ato janë në funksion të stresorëve (\*nga Hans Seyle dhe etabluar në gjermanishte = faktorë që tensionojnë në aspektin psikik dhe fizik) të përditshëm të masave.

Kjo është gjendja, tash dilema: pse masat ndikohen nga stresorët, inkubusët e jo nga redaktorët, komentuesit,

profesionistët dhe kollumnistët që mendimin e japin me modesti pasi t'i kenë shtruar të gjitha faktet, anët pozitive, negative, origjinën e çështjes që publikojnë? Sepse kështu i kanë trajnuar me dekada po të njëjtat: mediat! Ato kërkojnë suksesin nëpërmjet elektrizimit, skandalizimit e jo nëpërmjet iluminimit, prandaj edhe kriza e tyre. (2013)

## *Yjet e «nahisë»*

Mediave shqipe frekeuntojnë gjithmonë të njëjtët analistë – që thirren si specialistë për të gjitha temat e mundshme, që nga përbërja e mineraleve të Trepçës e deri në zbërthimin e kodeve gjenetike të gjallesave johumane. Si dhe pse ndodhë kjo?

Konspiratorë, alarmantë, «analistë» shkollë e gjuhëkëputur, zyrtarë e akrobatë fjalësh boshe na sjellin mediat si shpjegues të çdo teme e krize. Aty ndonjë Jazexhi që me vite paguhet nga shërbimet e lindjes për të helmuar me portale e aksione kundër perëndimit, ai pra që me vite përgatiti trutë e shqiptarëve të rinj për luftën e Shamit; këtu ndonjë Kastriot që ka zbuluar qëmoti se Obama është alien dhe ka ardhur ta shpartalloj Tokën në favor të planetit të Hyrës: atje një detachment tjetër kumtarësh bedelë të histerishëm që nuk qetësohen derisa sigurohen se opinioni i tyre nisi udhën si parafinë mbi ujin e ndotur të mendësisë shqiptare dhe gjithandej, patjetër altoparlantët postraumatikë si Lubonja i Tiranës, ai i Prishtinës, ai Shkupit, janë figurat që këmbë, sy e llapëhapur shesin pseudoversionet e tyre se si ndodhi dhe se çka duhet të ndodhë jo vetëm në tokat e gjuhës ku kanë nderin të shëmtojnë infosferat por edhe më gjerë, edhe më larg ngase globi del i vogël për ta.

Kjo ndodhë rregullisht e saherë të plas ndonjë krizë diku, brenda gardhit apo jashtë – nuk ka rëndësi, «ajkës» së plisave nuk i duhet kohë analize racionale, objektive, ngase të gjitha



paraprakisht i di, më fortë se hyjnorët, më kristaltë se profetët, ajo i dinë të gjitha se beson e kalkulon me sy demiurgjesh, të tillësh që sajnin katastrofa imagjinare natën për t'i paralajmëruar ditën.

Kjo është gjendja e mediave të ditëve të fundit. Jo ajo e rrjeteve sociale ku çdo trushkretë mund të bëjë krahasimet më debile të mundshme, por aty ku redaktorë mendjemëdhenj pozojnë sikur të punojnë. Po çka te bëjnë ato të shkretat tjetër? Kështu pyesin dhe përgjigjen vetë: këta jemi ne! Ndonjë shikues me dy gram tru formënjëjtë pyet e ulërinë: këta jeni ju? Mos qofshi kurrë! Dhe sa po zbrazet racional i vazhdon të pyes:

## I.

Si ka mundësi që në formatet televizive që shikohen me qindra mijëra shqiptarë të sjellësh pseudohistorianë, nxitës e prijës aksionesh protalibaneske, botërisht të njohur si të paguar nga shërbimet sekrete turke, arabe me rrogë e me shkollë ta shpjegojnë terrorizimin islamik dhe sulmin e Parisit me bombat e NATOS kundër Serbisë? Digjet e vuan dikush për të sjellë drejtësi për Serbi? Atë të Millosheviçit natyrisht. Sulmon ISIS perëndimin për këtë punë? Jo. Po kjo edhe s'ka fare rëndësi se nuk bëhet fjalë për analizë por për multiplikim të një propagande që është vetë nëna e krimit sidomos në Shqipëri: ajo ndihmoi ISIS-in të rekrutojë plisa me fëmijë.

## II.

Si ka mundësi që për politikë, ekonomi, bagëti e bujqësi, terror në Paris, Shangai apo Bejrut, për homoseksualizmin, bletarinë e format e reja klonike të fekondimit të ekspozosh trione njëjtë nga Tirana, Prishtina e Shkupi që edhe asgjësë i përgjigjen me të njëjtën formulë të shpartallimit të

autofrustrimit personal, gjë që nuk ka dhe nuk do të ketë kurrë të bëjë me diçka përtej fizikut të tyre të thyer, po, mjerisht të përdhunuar ose të privilegjuar nga gjithë ne. Ai i Tiranës veçse nuk e kapërdinë çdo gjë që duket shqiptare nga urrejtja që ia detyrojnë traumat. Ai Prishtinës mirë që nuk e ka shpallur gjithë botën përtej Kosovës si iluzion që duket e që realisht nuk është, nuk ekziston. Ai i Shkupit edhe kuajt e bardhë i përshkruan si mushka të zeza apo si deve. Se ç'kanë të bëjnë këta me zhvillimet globale dhe efektin e tyre në shoqëritë shqiptare vetëm sponsorizuesit e tyre po aq injorantë mund ta dinë. Shtova këtyre edhe gjithë ata teorizues koti që për t'i ikur shpjegimit konkret strehohen citateve asgjëthënëse të ideologëve të shekujve të lënë pas dhe sallata nuk dallon nga koshi i bërllokut.

### III.

Si ka mundësi që editorialet, komentet e shumicës së mediave të shkruhen nga autorë, tekstet e të cilëve vajtojnë nga padija, nga mungesa e informimit me atë çka ka ndodhur, çka e si ndodhë në ato kulturosfera të krizës. Tekste që të duken betejë e përgjakshme vetë, ku fjala përdhunon brutalisht e hapur fqinjën e saj; ku shkronjat sillen kundra njëra tjetrës si ndonjë i isis-it ndaj ndonjë perëndimori të rrëmbyer. Jo aq të ngushtë e të ngurtë nuk jemi; natyrisht se njerëzit e mediave duhet të komentojnë e analizojnë, mirëpo pse as Wikipedian joshqip nuk e shfrytëzojnë? Pse vjedhin në atë formë paragrafë të mediave të botës, të cilat në kompilim e sipër duken sikur gjysma e gjymtyrëve të kufomës së ndonjë viktime të Parisit të ketë fluturuar e përplasur mu në sheshin «Nëna Terezë» të Prishtinës?

Si ka mundësi... Eh si ka mundësi? Kështu është. Mediat shqipe sidomos atëherë kur duhet, gjatë krizës humbin rrugën goftë edhe në sheshin më të ndriçuar të botës. E bëjnë me

qëllim? Nisur nga përmbajtja, autorët dhe figurat që ofrojnë nuk besojmë. Thjeshtë nuk ua kap rradakja se ç'përgjegjësie kanë. Nuk janë në gjendje të mësojnë se janë shkaktare për mbizotërimin e opinionit konstruktiv apo injorant, se mundet të zgjedhin ndërmjet informimit objektiv apo dezinformimit për qëllime propagandash, paktesh e shtetesh të ndryshme.

Jemi vërtet këta e s'kemi ç'bëjmë, siç na tha një redaktore që e konfrontuam me këtë mizerie? Jo. Plotë ka që nuk janë si mediat dhe figurat e tyre. Nuk qëndron problemi te mospasja e kuadrove analizuese edhe të problemeve kaq të komplikuara por thjeshtë sigurimi i ekspertëve sipas temës dhe problemit është punë e mundimshme dhe kushton. E këta që i shohim saherë hapim kanalet televizive dhe gazetat s'kanë punë tjetër, ngase gjithë ditën e lume presin ndonjë telefonatë redaksie për t'ia mësy për të llogotitur kot fare, kot mirëpo çorientueshëm, qëllimisht rrejshëm e duke nxitur opinionin dhe duke krijuar imazhe konform frymës apo kuletës së tyre. (2015)

## «Anatomi» e cyberozonës shqipe

### 1. MOBBINGU – AFEKTI I PARË

Ka ikur ajo kohë kur vuaje duke dërguar letra me gomar nga krahina në krahinë për ta fituar një mendim konfirmues apo refuzues për atë që ke shkruar. Të rrallë janë ata merrnin ndonjë mesazh shpresëdhënës. Shumica ose vazhdonin të krijonin nga inati ose kërkonin me hutim ndonjë profesion tjetër. Për ta bërë sa më vizuale këtë histori le të kujtojmë atë anekdotën rreth dilemës së Rousseau-së pas marrjes së letrës nga Voltaire. Kur Rousseau pati marrë letrën e patriarkut të kulturës franceze të asaj kohe, i cili e uronte për shkrimin e radhës ku e kishte shpallur suksesshëm njeriun si kafshë, autori i kontratës sociale u krodh aq fort në depresion sa që seriozisht kacafytej me dilemën që e shtynte të mos shkruajë më fare. Si do të qëndronte puna nëse Rousseau do të jetonte në kohën tonë, në epokën tonë të Facebook-ut. Ndoshta nuk do të brengosej fare nga fjalët e ashpra të «Kandidit optimist» dhe do ta ngushëllonte veten me shifrën e lartë të miqve e fansave që do të kishin klikuar mbi butonin «like». Miqtë do ta shpëtonin ndoshta nga dilema dhe depresioni.

Ndoshta?

Sot nuk besojmë se një histori e tillë i ndodh madje edhe ndonjërit që as emrin dhe mbiemrin e vetë nuk arrin ta shkruajë si duhet. Ai nuk ka më nevojë t'i drejtohet askujt për të marrë analizë rreth cilësisë së shkrimit që ka lëvruar. Sot çdokush që ndez kompjuterin depërton si urith në labirintet komplekse të World Wide Web-it, me apo pa vullnet ai hyn

në listat e google & Co. dhe amshon veten si *tag*, si *keyword* apo qoftë edhe si hieroglifë e padekodueshme që ka gabuar epokën dhe modën dhe pa dashje shumëfishohet qindra herë në ditë nga php-skriptet e automatizuara të makinerive të kërkimit.

Individët që me qëllim dhe plan duan të krijojnë identitetin e tyre në rrjet, shfrytëzojnë Facebook-un, Google+ apo formularët e kontaktit të mediave të ndryshme për t'u shprehur, për të filozofuar, për të qenë aktivë apo edhe vetëm sa për ta ndarë frustrimin personal duke ulëritur bashkë me gjithë komunitetin e përfshirë në forumin e një web-i.

Sa e shëndetshme është kjo censurë? Kjo kulturë e re komunikimi publik?

Ka vite që ekspertë, filozofë e moralistë të ndryshëm kërkojnë përgjigje rreth këtyre pyetjeve dhe nuk dalin dot nga kafazi i botëkuptimeve të përvetësuara, të cilat shtrihen që nga anarkizmi total (Julian Paul Assange) e deri tek shpirtngushtësia totalitare e censorëve kinezë.

Debati pra i nisur që nga dita (1989) kur Sir Timothy John Berners-Lee hodhi hypertekstin e parë në rrjet, nuk do të përfundojë kurrë. Së paku jo deri atëherë kur planeti të popullohet dhe drejtohet nga dykëmbësorët. Prandaj edhe qëllimi i këtij teksti nuk mund të jetë dhënia e kontributit në këtë debat të mërzitshëm apo dëshira për të transferuar atë në diskutet shqiptare, synimi i këtij reflektimi ka për adresatë mediat me përgjegjësi kolektive; gazetat, mediat elektronike, botuesit e të tjerë të ngjashëm. Dëshën apo jo këto faktorë shoqërorë, po si institutet e arsimit (madje edhe më efektshëm, sepse nuk varen nga kushti i detyrimit dhe sanksionimit) mbajnë përgjegjësi, jo për fenomenet e pashkaktuara nga to, si për shembull, për atë fjalorin e egër të pseudoreperëve ose për stilin « F... yourself» të „brezit-SMS“, por kanë përgjegjësinë e tyre për legalizimin e kësaj (a)kulture komunikimi.

## 1. Fjala e lirë dhe anticensura

Një miku ynë që punon si redaktor në njërin nga gazetat relevante na tha kështu: «Paj nuk e di, ne nuk i përzihemi webmasterit. S'ka censurë më o mik, liri shprehjeje e mendimi. Le të bëjnë muhabet mileti». Ky ishte *statement*-i, përgjigja e tij ndaj pyetjes sonë se nëpër ç'redakturë kalojnë komentet e lexuesve.

Po i nënvizojmë edhe njëherë kriteret; webmasteri, duke respektuar shprehjen e lirë dhe dëshirën e «miletit» për të bërë muhabet dhe duke manifestuar deri në skaj anticensurën gjykon se cilin koment duhet bërë publik e cilin jo.

Dhe ja rezultati:

«Ah-ti-fete k...», «Kosova është mafi», «O kte...vetëm plumbi e drejton», «hajna, tradhtarë, konopi u vjen hakut», «po hiqju ktij burrë se spiun tan jetën ka qenë», «Ç' kopili ore. Është mësuar ore kjo shkërdhatë Tropoje të na...» e kështu me radhë. Këto janë disa nga shembujt e marrë nga forumet e ca mediave serioze shqiptare. Qëllimisht nuk janë zgjedhur ato më brutalet dhe ato që kanë të bëjnë me emra konkretë.

Më interesantja: Në shumicën e webfaqeve të gazetave shqiptare qëndron edhe kjo vërejtje:

*«Nadalohet përdorimi i gjuhës denigruese dhe fjalëve ofenduese ndaj individëve dhe grupeve specifike (...).»*

Dhe problemi shikuar më thellë nuk qëndron vetëm tek «gjuha» perverse e *user*-ëve (kryesisht anonimë), por më shumë tek shpifjet e tyre « ndaj individëve dhe ndaj grupeve specifike». Shumica e komenteve që analizuam ne as që kanë të bëjnë me temën ose e përdorin temën si shkas për të fyer ose për të ...

Se monologët, shpifjet e cituara më lart nuk kanë asgjë të përbashkët me fjalën e lirë dhe luftën kundër censurës e kupton madje çdo gjysmë-analfabet. Dihet përbotshtëm se fjala (shprehja) para se të bëhet e lirë (publike) duhet që të mos i kalojë kufijtë minimalë të nivelit kulturor. Qëndrimi i dikujt kundër apo pro dikujt tjetër nuk mundet kurrësesi të futet në mullinj të shumëfishimit publik pa u konfirmuar parimisht në aspektin nivelor të shprehjes e pastaj, gjë edhe më e rëndësishme, në rastet shpifëse e denoncuese, nuk publikohen komente pa u analizuar ana e tyre argumentuese. Se a mund të sjellë dikush argumente për jetën seksuale të presidentes së Kosovës apo për atë se ç’duhet menduar për një medium që nuk druan të publikojë edhe komente ku bëhen thirrje me «plumba e konopë» është çështje edhe më e ndërlikuar se sa kjo me të cilën merremi ne.

## *2. Terapia e user-ëve*

«Pasha zotin më luajnë mëndët me nuk qenë interneti». Kjo është thënie e njërit të fisit tim për të cilin di se për çdo muaj e ndërron psikiatrin. I cili po ashtu herë pas here kërkon që t’ia lexoj ndonjë koment që ka shkruar për tekstin e këtij apo atij autori. Mendova se ai diskutimin forumeve e përdor për të lehtësuar depresionet. I çuditshëm në këtë histori është fakti antagonist se qoftë në faqen e tij të Facebook-ut e qoftë në websitin e tij personal për të cilin kujdeset nuk e gjen asnjë shprehje si ato që i shkruan në forumet e mediave që i frekuenton.

Nuk jemi kundër mundësisë (kur kemi parasysh rastin konkret) që forumet të luajnë edhe rolin pozitiv të terapisë psikike të user-ëve apo edhe të vetë webmaster-ëve, mirëpo nuk besojmë se patjetër forumet e masmediave duhet të luajnë rolin e psikiatrit publik. Thjesht për shkak se lloji i diskutimeve të tilla nuk kontribuon në asgjë tjetër përveç

infektimit të diskutimit publik me shprehje të shumta ordinere. Kuazipolemika që s'janë asgjë tjetër përpos protokolle fyerjesh dhe përgojimesh që jemi mësuar t'i konsumojmë, rrugëve, kafeneve, pra atje ku edhe duhet të kenë ambientin jetësor.

### *3. Kultura e webmasterëve*

Pa nënçmuar webmaster-ët si kategori profesionale. Shumica e tyre janë gjuetarë hiperaktivë plugin-ësh, skriptesh, trojanësh e freeware-sh, ata fare pak kanë kohë të lexojnë komente e të rrallë janë ata që lexojnë e shkruajnë shqip si duhet. Homologet evropiane të masmediave shqiptare, madje as që u kërkojnë webmaster-ëve të luajnë ndonjë rol sa i përket publikimit apo mospublikimit të komenteve (edhe atëherë ku ata do ta plotësonin një kush të tillë). Çdonjëri medium serioz ka të punësuar një redaktor-online, i cili kujdeset për «higjienën» e forumeve. Kuptojmë situatën financiare të mediave tona (e cila nuk krahasohet me ato gjermane, zvicerane e të tjera të ngjashme), megjithatë problemin nuk duhet ta zgjidhin nëpërmjet metodës anarkike të publikimit. Madje disa nga mediat që në impressum pozojnë të kenë redaktorë të tillë, kanë forume edhe më të pakontrolluara se ç'i kanë ato që nuk e bëjnë transparente këtë punë.

### *4. Përgjegjësia e masmediave*

Edhe pse shumëkush dëshiron që masmediave (gazetat, televizionet etj.) t'ua mohojë pushtetin, ato natyrshëm e mbajnë flamurin në formimin e kulturës së komunikimit publik. Me këtë edhe përgjegjësinë. Ato nuk duhet ta imunizojnë lexuesin (secila për vete) me një komunikim ordiner, sepse automatikisht sugjerojnë shpifjen, sharjen, fyerjen dhe ofendimin si shtylla normale të anticensurës dhe



fjalës së lirë. Edhe pse urrejmë çdo censurë, në këtë rast pezullimi i mundësisë së komentimit do të ishte diçka shumë më e dinjitetshme se ç'është gjendja aktuale e forumeve. Për krijuesin serioz sot është shumë më mirë t'i ndërsejë gomerët për ta siguruar një feedback, qoftë ai edhe dëshpërues, se sa të bëhet pjesë e një interaktiviteti nga më ordinerët që njih historia e komunikimit. (2012)

## 2. MORFOLOGJIA E CYBERINJORANCËS

Vdiq letra, rroftë interneti? Jo, thonë ekspertët dhe shkencëtarët. Konkurrenca ndërmjet mjeteve të informimit dhe transferimit të dijes nuk është problemi, por injoranca humane e cila emancipimin me inovacionet e përjeton gjithmonë si Apokalips. Historia e një histerie.

Cyber-futuristët e subvencionuar nga Apple, Microsoft & Co. si dhe militantët e Open Source iniciativave (në rënie) qëmoti kanë festuar pasmodernizmin si epokë të Cybernautit. Motivet janë komerciale dhe ideologjike. Shfaqja e internetit trazoi thellë jo vetëm të moshuarit refraktarë, por hutoi në veçanti industrinë e dijes, atë të librit, të gazetave, autorët dhe bibliofilët. Ndërkohë që ekonomistët, menaxherët dhe bankat ende nuk kanë gjetur ishullin ku pa hektikë, të çliruar nga frika e përhapur gjithandej, do të reflektonin për ndonjë strategji si të reduktonin tjetërsimin, vjedhjen dhe përhumbjen e kapitalit fizik kanaleve virusale virtuale, filozofët dhe historianët vijnë të pozojnë “cool” dhe të mos thonë më shumë se: «Déjà-vu. Për ne debati ka përfunduar»! Edhe avokatët, censorët dhe policitë besojnë që më në fund të njohin mjetet efektive për t'i burgosur në karantinë cyberkriminelët dhe hakerët. Këto sinjale mirëpo jo gjithandej janë shtendosëse. Histeria dhe tonet apokaliptike ende nuk janë mbytur sa duhet.

## *5. Debatë shqip*

Edhe në letrat shqiptare qysh herët ka filluar diskutimi publik rreth rolit dhe «pasojava» të internetit. Assesi me atë energji, cilësi dhe fabrikim teorish si në gjuhët e tjera, mirëpo sidoqoftë ka ndodhur diçka. Janë botuar dhjetëra artikuj e trajtesa rreth kësaj çështjeje. Vendimi i së përditshmes prishtinase «Express» që të heqë dorë nga letra ringjalli diskutimin e nevojshëm, vitrinëzoi pozitën dhe nivelin e reflektimit të intelektualëve shqiptarë mbi këtë proces: ai doli aktual dhe analog me konstatimet mondanisht të afirmuara mbi këtë temë. Sidomos Astrit Gashi dhe Artan Muahxhiri dhanë një kontribut të veçantë duke shpjeguar paradigmat e kohës si dhe mënyrën e funksionalitetit të kësaj zone në gjuhëzonës shqipe.

Megjithatë pyetja si sillet «homo cyberius» shqiptar brenda realitetit virtual, kërkon përgjigje specifike. Përtej hapësirave shqiptare debati shumëvjeçar rreth rolit dhe fuqisë së internetit ka ndarë mendësinë (globale) në tre drejtime kryesore. Pesimistët vajtojnë, cyber-futuristët duartrokin, ndërsa shkencëtarët kanë dorëzuar teoritë dhe sintezat e tyre.

## *6. Evokimet e pesimistëve*

Sipas pesimistëve radikalë interneti prish socialitetin sepse e ka shndërruar njeriun tashmë në një zombi të palëvizshëm. Cybernautët luftojnë me peshën, vetminë dhe me antidepresivë të shumtë përpiqen ta zbusin sistemin e hiperelektvizuar dhe agresiv nervor. Ka kohë që spitalet perëndimore kanë hapur reparte për sëmundjen më të re: «pathological internet use», kështu quhet diagnoza për përdoruesit ekszivë të Internetit. Jo pak publicistë dhe filozofë kanë botuar libra e teori me teza si; «Interneti –

fabrika të budallallëkut», «makineria për banalizimin e dijes» ose «hapësira e injorancës dhe deformimit kulturor». Antropologët dhe sociologët i akuzojnë rrijetet sociale dhe industrinë teknologjike se fabrikojnë në seri gjenerata që s'dinë më asnjë gjuhë ta shkruajnë si duhet (sms-generation); se e bllokojnë njerëzimin nga lëvizja e domosdoshme në natyrë dhe se kanë pamundësuar kontaktet jetike e fizike të individit me shoqërinë. Sekte të ndryshme nateditë mbajnë ceremoni e luten në pritje të blackout-it dixhital. Pedagogët kanë gjetur fajtorin e debilizimit të nxënësve dhe studentëve të tyre: interneti!

### *7. Teoritë dhe cyberfuturistët*

Ekonomisti amerikan Jeremy Rifkin me veprat e tij «The End of Work» (1995) dhe «The Age of Access» (2000) qe i pari që e ushqeui këtë panik. Në librin e parë ai «dokumentoi» faktin se përkundër rritjes ekonomike vendet e punës avullohen (për shkak të kompjuterizimit) dhe në veprën e dytë doli me tezën se aksesit në idetë (informatat), mallrat dhe shërbimet është sot aq i lehtë, i tjetërsueshëm dhe falas, sa që ekziston rreziku i deformimit kulturor të identiteteve të veçanta. Nga kjo ide, ky alarm i Jeremy Rifkin mbi globalizmin dixhital dhe paskapitalist, si dhe atë të «modernizimit të dytë» të teorikut gjerman Heinrich Klotz (Moderna – Pasmoderna – Moderna e dytë; 1999) ideologët e dixhitalizimit global e arnuan «teorinë» mbi varrimin e paevitueshëm të letrës si mjet primitiv komunikimi (koinçidon me parrullën e drejtuesve të gazetës «Express»).

Në llogaritë të kësaj prognoze natyrisht se shkoi edhe paniku i printmediave dhe industrisë së librit, të cilat u bënë viktima të prognozave euforike mbi revolucionin dixhital.

## 8. Histeri dhe injorancë

Revolucioni digjital ka ndodhur. Dhe ka përpirë çdo kënd të globit. Sërish i urti nga Piemonti, Umberto Eco solli kryepikëpamjen: «A do të ishte holokausti i mundshëm po të ekzistonte që atëherë interneti? Dyshoj!» (Paris:2009). Këtë rol sot askush më nuk ia mohon internetit: fuqinë e mobilizimit përmes rrjeteve globale sociale. Për gamën e problemeve që parashetrojnë pesimistët si: trashja, depresionet, banalizimi i dijes, etj. një përgjigje adekuate ka megafilozofi koreano-gjerman Byung-Chul Han (Hiperkulturaliteti – Kultura dhe globalizimi: 2005): «Në fillimet e çdo inovacioni me përmasa globale, historikisht janë shfaqur të njëjtat dilema, debate dhe në fund janë ofruar përfundime identike: absolutisht kontestin nuk e përbën konkurrenca midis mediave të printuara dhe atyre dixhitale, problemi ka të bëjë me injorancën e njerëzimit që deri sa ia gjen vendin të resë vajton pa arsye për të «vjetrat».

Rezultatet e dhjetëra kongreseve shkencore, hulumtimeve disavjeçare mbi mediat dhe internetin materializojnë tezat e Hani-it dhe ofrojnë simetrinë empirike të gjendjes aktuale . Libri vazhdon të mbajë primatin: edhe tek e gjenerata më e re, e jo vetëm si mjet studimi, por edhe si «ishull relaksimi e emancipimi». Gazetat serioze – së paku për hapësirën gjermanofolëse dhe atë frankofone ekzistojnë statistika konkrete – tashmë kanë rikthyer dhe stabilizuar tirazhin.

Ato që e kanë pësuar keq janë gazetatat bulevardeske të të gjitha hapësirave. **«Të kishim kuptuar qysh më herët se jo ne duhet të vallëzonim sipas ritmit të internetit, por anasjelltas meqë cilësia dhe besueshmëria është në anën tonë, besoj do të kishim më pak dëme gjatë euforisë»**, na thotë njëri nga menaxherët e gazetës zvicerane NZZ. Eksperti Alexander

Otto ( Homo Digitalis – Evolucioni digjital: 2013) madje beson se me krijimin e kartave globale juridike rreth përdorimit apo shpërdorimit të përmbajtjeve dixhitale do të ndryshojë shumëçka, respektivisht do përdoret ashtu siç kanë nevojë njerëzit e jo si botë paralele e kësaj që kemi. (2013)

### 3. CYBERORACIZMI – AFEKTI PERMANENT

Me rishpërthimin e konfliktit palestinezo-izraelit sferës së virtualitetit shqiptar u rindezën polemika, përgojime, denoncime, kërcënime aq barbare, raciste dhe primitive si kurrë më parë. Në epiqendër të demonizimit: Izraeli, katolikët, etnocentrikët, properëndimorët, të krishterët, ateistët dhe myslimanët moderatë. Sulmuesit: shqiptarë të versionit islamo-alkaidesk, kryesisht gjysmanalfabetë në shkrim dhe në perceptim, të asistuar nga blogje e faqe Facebook-u pa adresë, me profile anonime ose me pronarë arabë, serbë, rusë, turq e të listës.

#### *9. Kauza palestineze*

Shumica absolute e debatuesve (me përjashtime simbolike) rrjeteve sociale nuk argumentonte pro kauzës arabofile, duke ripërsëritur versionin e përbotshëm të «pushtimit» hebre truallit të Palestinës post-osmane e kolonialo-britanike, por sulmonin, fyenin, linçonin «jehudët» si racë, kulturë, identitet akuranor, biblik dhe me ta gjithë ata shqiptarë, që tentonin të mbeteshin objektivë rreth një lufte të largët mes dy vendeve që jo patjetër sillen korrektësisht ndaj shteteve shqiptare e të cilat me respekt dhe subvencione trajtojnë ish-tiranët e kësulëbardhëve.

Mosargumentimi pra me historinë rreth Mandatit të Lidhjes së Kombeve 1920 – 1948 mbi krijimin e Izraelit nëpërmjet trinitetit të njohur Jewish-Jischuw-Alija,

programatikë që realizohej nëpërmjet migracionit, dhurimit të tokave kompakte hebrenjve, shtetëzimin e pakusht të tyre drejt krijimit të shtetit izraelit (e as me njohuri aktuale rreth konfliktit), dëshmoi se kemi të bëjmë me një turmë të organizuar, orkestruar që mezi pret ndonjë temë për të shpartalluar frustrimet në formë agjitimi aktiv pro politislamit ekstrem.

### *10. Mediat, shteti*

Falë metodës të «përshkrimit neutral» të mediave dhe të politikës deri më tani laissez-faire të strukturave të shtetit ata besonin të kenë sensibilizuar opinionin në llogari të tyre. Këtë sukses ndoshta e «shpikin» për arsye se jo vetëm autoparlantët zëgërryer të qarqeve ultra-ekstreme ulërinin, sado të mundeshin pro xhihadizmit edhe ndër shqiptarë, por edhe shumica e mediave «sekulare» më shumë i pasqyruan sesa i hulumtuan, cullakëruan, më tepër i njoftojnë se ç'ndodh botës së tyre sesa t'i alarmojnë për kanibalizmin çnjerëzor, që e bëjnë divizionet e krimit (ISIS, Boko Haram, Irani, Al-Qaida etj.) në emër të fesë së tyre.

Ato, mediat dhe shteti, asnjë milimetër tash e ca vite nuk ndërморën për t'i shpjeguar të çorientuarve se ideja e tyre për të krijuar kalifate nuk është e re, por e Augustinit të shek 5, i cili njëlloj si xhihadistët sot ndante kozmosin në shtet tokësor (i djallit) dhe atë qiellor (i Zotit). Koncept që përfundimisht u varros qysh në mesjetën e heliocentristëve të shek 16 për të mos u rishfaqur më kurrë perëndimit, por vendeve arabe, të cilat përbëjnë 88% të analfabetizmit mbarëbotëror.

### *11. Si agjencitë e prostitucionit*

Prezenca e grupeve radikale islamike virtualitetit nuk dallon nga ajo e agjencitave të prostitucionit, të cilat janë

kryesisht pa impressum dhe pozojnë vetëm të dhëna mbi konturet fizike të femrave e të meshkujve. Përderisa agjencitë e prostitucionit kanë frikë se sulmohen nga konservatorët e shoqërisë për tregtim me seksin, nga çfarë paskëshin frikë islamoradikalët ndërkaq? Nuk besojnë as vetë në kauzën që duan ta përfaqësojnë dhe detyrohen të fshihen e ndryhen në terrin elektronik porsitrojanët e viruset e sferave dixhitale? Shumëçka që nuk mund të mbrohet ballëhapur dhe publikisht, është demonstrim jo vetëm i ndonjë pseudokauze dhe irritimi parakriminal, por dëshmon edhe për potencialin sociopatik dhe skizofren të bartësve të saj, kështu në sintezë thonë shumica e teorive të psikologjisë mbi çështjen. Këtij detashmenti natyrisht se i bashkohen edhe shumë portale tjera pa impressume korrekte që s'kanë të bëjnë me radikalët, por që përdorin të njëjtën formë propagande dhe mobilizimi.

Ajo që kriminalizon veprimtarinë e këtyre mediave religjioze janë edhe aksionet e tyre shpifëse e kërcënuese kundër rendit, Kushtetutës, shtetit dhe personaliteteve publike që reflektojnë mbi problemet sociale të shoqërive shqiptare. Fenomen, që para disa ditëve në një shkrim të tij e trajtoi edhe Naser Aliu (Lis Bukuroca).

Paradoksin, skizofreninë në veprim ua sjell vetë maska pas së cilës duan të fshihen: thonë se e kanë për viktimat e jo përkatësinë, njëkohësisht duke i kategorizuar viktimat myslimanë si «shehidë» e kufomat tjera si domosdo «ciklike e normale të natyrës drejt higjienizimit të planetit», njëlloj pra siç kanibalizonte simpatizuesi i dikurshëm i tyre Adolf Hitler. Sociopatia ka të bëjë me intolerancën, që manifestojnë ndaj gjithçkaje sociale që nuk përputhet me «standardet» e haditheve dhe programeve jashtëkuranore të grupeve të ndryshme ku militojnë.

## *12. Origjina dhe aksioni*

Shërbimet sekrete të vendeve që nuk donin faktorizimin dhe pavarësimin e shteteve shqiptare qëmoti tentojnë ta bindin botën se shqiptarët pra, si myslimanë janë rrezik për lirinë dhe paqen e kontinentit. Prandaj, nuk është asfare e çuditshme që shpesh identifikojmë portale nxitëse dhe faqe të mediave sociale që për mirëmbajtës kanë emra serbësh e të tjerësh të ngjashëm. Sidomos tani me arrestimet dhe aksionet e Policisë antiterror kundër çerdheve të grupeve të tilla, ato do të riaktivizojnë luftën e tyre ndofta edhe shumë më egër.

Ka gjasa që instancat e sigurisë të shteteve shqiptare do ta marrin seriozisht këtë fenomen më tepër se destruktiv dhe do të veprojnë njëllor si shtetet perëndimore, duke formuar njësi kundër cyberterrorizmit, racizmit dhe dukurive të tjera që trazojnë dhe rrisin konfliktualitetin brendashoqëror. Mundësinë e kanë. Vullnetin deri më tani nuk e kishin aspak të tillë gjithaq.

Aksioni i fundit jep shpresa, por nuk garanton shumë, nëse ai nuk zhvillohet në formë konstruktive e ligjore e jo si ndjekje shtrigash për interesa pushtetesh e lidhësh. Para së gjithash: shqiptarët që aq mijëra vjet kanë qenë vetë viktima të racizmit, të urrejtjes, të terrorizmit të organizuar dhe shtetëror e ndaj nuk kanë asnjë arsye pse të jenë tolerantë ndaj këtyre grupeve të importuara nga gjithandej orientit. (2015)



PJESA E GJASHTË  
*Demokracia*

## *Pushteti i polikracisë*

Noli njihete Athinën, Aleksandrinë, Amerikën, mirëpo shumë pak Shqipërinë, prandaj nuk instaloi dot demokracinë në mëmëdhe. Rugova i njihete të gjitha, por për kohën që pati nuk demokratizoi dot as partinë e tij. Politika shqiptare sot edhe me asistencë nuk ia del dot të demokratizojë vendin. Dy përpjekje në dy epoka të ndryshme, gjithmonë pa sukses, përse vallë? Më shumë se sa në një sistem politik të demokracisë pluraliste, shoqëritë shqiptare duket të gjenden në një vakum, të çorientuara dhe pré ideologjish e doktrinash që në Evropën perëndimore janë në grahmen e tyre të fundit. Nga erdhi kjo situatë vallë, kur kihet parasysh se shqiptarët janë historikisht ndër të parët e rajonit që provuan instalimin e demokracisë si sistem politik. Historianët dhe sociologët, të huaj e vendorë, i kanë disa teza, mirëpo ato deri më tani nuk dalin të bindshme se nuk thonë gjë. Shqiptarët sërish pas perdes së kohës: teksa bota postindustriale përpiqet të gjejë një formulë pajtimi ndërmjet kapitalizmit dhe demokracisë (sepse deri tani nuk ka demokraci moderne pa ekonomi kapitaliste ashtu siç nuk ka kapitalizëm jofashist, nazist e diktatorial pa demokracinë – Paul Nolte:2012) pjesë elitash shqiptare koketojnë ende me manifeste të dështuara utopike ose me doktrina fetare që trembin edhe vetë mendjemesjetarët ndër ne.

Për të gjetur pse-në ndoshta më mirë do të jetë të shohim se në ç’relacion qëndron historia shqiptare me demokracinë?

## *Demokracia në dy skena*

Skena e parë – Noli e provoi i pari. Dështoi dhe iku. Po si francezi Alexis de Tocqueville edhe ky mësoi dhe përjetoi demokracinë në SHBA. Përderisa i pari e interpretonte atë kritikueshëm në favor të aristokracisë, i dyti me plot pasion donte ta instalojë atë në vendin e tij.

Peshkopi dhe eruditi ortodoks shqiptar Teofan Stylian Noli ishte ai i cili pas Luftës së Parë botërore bindi kryetarin amerikan Woodrow Wilson të përkrahë pavarësimin e Shqipërisë në Konferencën E Paqes të Parisit (18.01.1919 – 21.01.1920). Njohja e Shqipërisë nga Lidhja e atëhershme e kombeve (1920) u bë pikërisht falë kësaj „aleance“ shqiptaro-amerikane.

Një vit më vonë, me në trastë modelin e demokracisë amerikane hyri prifti në parlamentin shqiptar si përfaqësues i liberalëve të partisë Vatra. Pas ekzekutimit të një liberali nga Zogu (Avni Rustemit), dhe ikjes së këtij të fundit tek miqtë e tij jugosllavë, tre vjet më vonë (1924) Noli u bë kryeministër i vendit të njohur ndërkombëtarisht tre vjet më parë. Agresiviteti i Nolit përmes të cilit ai donte ta delegojë instalimin e demokracisë të tipit amerikan nxiti kundërshti dhe refuzim të elitës së atëhershme politike, dhe, disa muaj më vonë, në Krishtlindje të po të njëjtit vit, varësit e Zogut me azil në Beograd ia morën pushtetin. Shqipëria mbeti feudale. Demokracia u kthye atje nga kishte nisur. Zogu e shpalli veten mbret.

Skena e dytë – Sot ish presidenti i SHBA-ve Bill Clinton gjithandej rrëfen se dy njerëz e kanë bindur për të dalë përfundimisht në anën e shqiptarëve: Nënë Tereza dhe Ibrahim Rugova! E para mbeti atje ku ishte për ta shpëtuar botën nga skamja dhe teposhta, i dyti 78 vjet më vonë (2002) se Noli u kthye për ta demokratizuar lirinë e vendit të tij. Shkencëtari i letërsisë, intelektual i Rugova kishte disa

përparësi në krahasim me Nolin e lindur në Traki, të shkolluar Athinës e Aleksandrisë egjiptiane e që banonte cepave të largët të botës.

Njëra nga përparësitë qendrore të admiruesit të „*cuneus prophetarum* – ëvë“ me origjinë shqiptare ishte lindja, rritja dhe formimi aty ku ai donte ta shndërrojë demokracinë pluraliste kosovare. Tjetra përparësi që kishte Rugova ishte përvoja; Ibrahim Rugova ishte i specializuar në historinë e Fan Stilian Nolit dhe dinte gjithçka për ngritjen dhe rënien e tij. Katër vite më vonë vdiq Rugova. Vendi i tij valëvit ku të mundet anembanë botës flamurin e demokracisë pluraliste, mirëpo ai nuk konsiderohet akoma si i tillë. Ose sillet ashtu sa për sy e faqe të botës.

*Epilogu* – Qeveria demokratike e Fan Nolit jetoi vetëm disa muaj. Historianë, studiues të kësaj epoke trashin tezën se atëherë me shumë gjasa mund të mos ketë qenë koha e përshtatshme për një sistem të tillë pasi skamja, analfabetizëm dhe struktura tejet arkaike në parashoqërinë shqiptare e pumundësonte këtë gjë. Teza në fjalë është më e thjeshta, prandaj ndoshta e kotë të merresh seriozisht me të, sepse ajo nuk qëndron askund qoftë për shkak se as popujt e tjerë të globit nuk kanë qenë gjeni demokracie në kohën kur e kanë përvetësuar këtë formë qeverisjeje e qoftë për faktin se nuk janë masat popullore që nxisin procese të tilla, por elitat. Dhe ato ishin të pranishme në kohën e Nolit – si në raste të tjera tjetërkund – dhe sidomos në rastin e Rugovës. Ku qëndron problemi atëherë? Përse të dyja përpjekjet, në dy epoka e stade të ndryshme dështojnë në të njëjtën kulturo- e etnosferë?

### *«Histori» e shoqërisë shqiptare*

Nëse endem atje-këtej hartës ballkanike për të lokalizuar fakte etnologjike, historike, kulturore rreth organizimit shoqëror të etnive, do të konstatojmë se: shqiptarët janë ndër popujt që si bazë asnjëherë nuk kanë jetuar të integruar në ndonjë sistem politik. Këtë mund ta përshkruajmë kristalshëm për periudhën romake, për atë bizantine, për atë osmane e më së miri teza materializohet (për shkak edhe të faktografisë) për periudhën pas Luftës së Dytë Botërore. Elitat kanë bashkëpunuar (më së shpeshti si „thikë pas shpine“) me sistemet, sunduesit dhe shtetet e ndryshme, mirëpo jo edhe shtresat e tjera të hartës etnike shqiptare.

Në secilën epokë e deri nga fundi i viteve 80-ë (terreni i hulumtuar ka të bëjë vetëm me Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë), janë pleqtë (si maja hierarkike e njëjësive gjeopolitike) ata që mblidhen odave (si kuvende rrethi familjar, shoqëror) për të diskutuar, falur, gjykuar, dënuar apo për t'u marrë vesh se në kullën e cilit mal (parlamenti) do të mblidhen burrat për të vendosur mbi ndonjë punë të madhe. Nuk qenë shteti dhe policia ato që me prezencën e tyre ndikonin që i riu të ketë frikë mos të vulozet si destruktiv, por presioni familjar e fisnor që me çdo kusht donte të mbajë pastër, fytyrën e familjes, fisit“. Edukimi i brezave në dimensionin social, politik, historik, estetik e etik, ndodhte odave nëpërmjet muzikës, rrëfimit të gjallë të historisë dhe riteve kolektive e më pak institucioneve të shtetit.

Përkundrazi ata që thyenin ligjet e shtetit, e kundërshtonin atë, festoheshin si „banditë sociale“ në favor të polikracisë shqiptare. Ky mentalitet, kjo kulturë sociale e lehtësoi aq shpejt mundësinë e krijimit të një shteti paralel krahas atij serb nga Ibrahim Rugova.

Se sa e fuqishme ishte polikracia shqiptare na e manifestoi qartësisht edhe aksioni i pajtimit të gjajaqeve – kemi përshtypjen sikur Anton Çetta pikërisht edhe këtë gjë donte t'ua kumtojë elitave shqiptare.

### *Vakumi si bllokadë*

Noli ndoshta as që ishte i informuar mbi funksionalitetin e polikracisë shqiptare. Ibrahim Rugova po. Ishte formuar përgjysmë në gjirin e saj. Nuk pati kohë sa duhet? Mbetet për tu analizuar në formë të thellë. Ku qëndron puna sot? Vitin 1989 shqiptarët e shndërruan në 1968: Thyerja e komunizmit nuk u kap gjithaq si alternativë e re për organizimin e lirisë së tyre ndryshe aq sa u kap si ofertë, thirrje për të shpifur ndaj saj, për ta refuzuar, shpallur si arkaike dhe të dëmshme polikracinë konservatore (si elitat e viteve 70-ë të Europës perëndimore). Për një kohë fare të shkurtër pleqtë, odat dhe kullat humbën pushtetin e tyre dhe nuk ishin më si më parë mbikëqyrësit dhe korrektorët e sjelljes publike dhe solidaritetit social. Vetëm gjatë luftës kullat u ripërdorën si azile për ushtarët e plagosur të UÇK-së e jo më si institucione me rëndësi shoqërore.

Afërmendsh se shekulli 21 nuk funksionon më në atë mënyrë. Këtu as që qëndron problemi. Gabimi ndodhi se ato u prishën para se të bëhet shteti, kështu duke krijuar një vakum që edhe sot e kësaj dite u bën vend edhe formave më destruktive që fabrikojnë grupe të caktuara. Në vend të pleqve dhe odave socialitetin shqiptar sot e ndikojnë guru religjionesh e doktrinash retarde, joprogresive dezorientuese.

Me të drejtë na thotë miku jonë në Londër Bujar Dibra, se pikërisht në këtë segment ka ndodhur „dështimi më i madh i elitave dhe politikës. Injorimi, mospërfillja e strukturave ekzistente, mosdija për të krijuar kanalet e komunikimit me to me synimin për t'i vënë në funksion të ndërtimit të

demokracisë është shans i humbur historik“. Patjetër. Ku ka  
demokraci pa demosin!

## *Tranzicion a subversion*

Në ç'sistem politik gjenden shoqëritë shqiptare? Në demokracinë pluraliste? Në fakt ato gjenden në një tranzicion dyfish subversiv, i cili paralelisht, nga njëra anë bllokton jetësimin e demokracisë cilësore e nga ana tjetër prish kulturën e tyre tradicionale të solidaritetit social.

Një fjalë e urtë pa autor thotë: „Qeni i mbajtur përherë lidhur, sapo të zgjidhet ngarend i çorientuar dhe kafshon kë ta zërë rrugës”. Kjo ishte njëra nga metaforat e preferuara, që publicistët e sferës veriperëndimore përdornin në fillim të reportazheve dhe analizave të tyre kur përshkruanin situatën e shoqërive në braktisje të monizmit. Në gjysmën e parë të saj, metafora përputhej me realitetin që ishte: masa njerëzish nga lindja ia mësyjnë perëndimit për të zbuluar botën, pa ditur fare se ku do të përfundojnë dhe si do të jetojnë. Të tjerët brenda vendit vërdalloseshin duke mos ditur çfarë të bëjnë me lirinë lakuriqe e cila nuk iu ofronte atyre asnjë garanci ekzistence.

Pjesa e dytë e metaforës nënkupton spekulime, interpretime dhe pyetje: mos synonin vallë publicistët e sferës kapitaliste të lëshonin alarmin për turmat që ishin nisur për të „kafshuar“ mirëqenien e vendeve të tyre? I paragjykonin ata vallë lindorët si njerëz me mungesë racionaliteti, pa sens për ligj, rend, kulturë e kuvend të postmodernizmit neoliberal? Apo ishte më shumë ky një kumt edhe më i thellë: popujt e çorientuar, deri dje të mbyllur në hapësirën prapa perdes së hekurt, nuk dinin se si ta menaxhonin veten jashtë realsocializmit dhe si kurrë më parë shfaqej shansi për t'ua bërë atyre – siç thotë Don Corleone në filmin legjendar „The



Godfather“ (1972) – „ofertën që nuk kishin mundësi ta refuzonin dot kurrë”! Si dukej oferta e botës së lirë ndaj pjesës themeleshembur të saj? Oferta ishte don-korleoneske meqënëse askush nuk njihte ndonjë alternativë më serioze: pas komunizmit popujt e “tij” s’kishin ku të shkojnë përveçse drejt demokracisë pluraliste. Këtë të fundit, e përqaftuan pa kushte, me eufori, madje edhe verbërisht padyshim edhe shqiptarët. Bënë mirë që përzgjedhën këtë rrugë vallë?

## I.

Dëshira e shqiptarëve për demokraci pluraliste dhe oferta për asistencë nga ana e organizatave supranacionale dhe vendeve perëndimore, nuk ishin isokrone vetëm për shkak të ngjarjeve globale gjatë përdhosjes së bllokut të kuq, ngase ato (interesi dhe ndihma) kishin një traditë të nisur qysh në fillim të viteve 80-ë. Kosova, respektivisht diaspora shqiptare në SHBA dhe në veriperëndim të Europës (pa të majtën e përqendruar në vendet gjermanofone) qëmoti lobonte korridoreve qeveritare e bodrumeve agenturore me doktrinën ku kishte fuzionuar zgjidhjen e çështjes kombëtare me instalimin e demokracisë pluraliste. Se ky fuzionim ishte vetëm ideor, sipërfaqësor dhe jo i thelluar, shihet qartë sot. Tash mund të thuhet pa spekuluar aspak se programet e shqiptarëve për zgjidhje të çështjes së tyre kombëtare mjaftonin vetëm sa për nxitje të euforisë dhe mobilizimit spontan të masave e hiç për më shumë. Edhe më të papërgatitura elitat e atëhershme dalin në relacion me sistemin e ri politik – me demokracinë pluraliste. Të tilla janë ato edhe sot – njohin vetëm kornizat e funksionalitetit të sistemit politik në të cilin jetojnë: Qeveritë shqiptare duken sikur mos të dinë nga t’ia nisin, akademitë, elitat dhe shoqëria civile ngatërrohen për banalitetet të përditshmërisë për t’iu shpëtuar problemeve të thella. Jashtë gardhit ballkanik e shqiptar, me të madhe diskutohen

fenomenet që kërcënojnë demokracinë pluraliste jo vetëm në vendet e ngecura në tranzicion, por edhe në ato vende që konsiderohen të konsoliduara.

## II.

Mesazhi ishte i qartë: vendet e dala nga blloku i vendeve kuazisocialiste mund të aderonin në organizatat e perëndimit (BE, Bankat, NATO etj.) vetëm nëse pranonin (mos kishin ndonjë rrugë tjetër?) demokracinë si sistem politik. Jo çfarëdo demokracie, por atë neoliberalen, ku përveç zgjedhjeve të lira, principit të shumicës, respektimit të opozitës politike, kushtetutshmërisë, mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe mendimit të lirë, kërkohej edhe respektimi i pakushtëzuar i pronës private dhe tregut të lirë; dy elemente këto të fundit që ekzistonin ose kufizueshëm e kontestueshëm (prona private) ose që gjendeshin në fazën më brutale ilegale (tregu i lirë) të tyre.

Kushti perëndimor nuk ka dilemë që ishte teknokratik, hiperracional. Ai iu parashtruar mbi tavolinë liderëve të rinj e të papërvojë si një „dummies-doracak“ i shkencave politike prej ku ata duhej të mësonin se si bëhen demokracia pluraliste dhe tregu i lirë. Për dallim nga të tjerët, vetëm akademitë dhe elitat çeke, polake dhe hungareze, hyrjen në sistemin e ri nuk e morën pa diskutime, studime dhe analiza rigorozë paraprake. Madje polemikat e ashpra çeke – ku mernte pjesë edhe vetë Vaclav Havel-i me bashkëpunëtorë – u përçuan si diskutime edhe në mediat dhe konferencat shkencore të perëndimit europian dhe në SHBA.

Si promotor të diskursit çekët kishin teorinë e shkollës së Frankfurtit. Atë botëkuptim që kritikon iluminizmin dhe bashkë me të edhe të gjitha llojet e liberalizmave si fabrika të çemocionalizimit, sendëzimit total të kulturave dhe frymës individuale si dhe rrjeteve tradicionale sociale shoqërore

(Horkheimer / Adorno në „ Mbi kritikën e racionalitetit instrumental“ dhe „Dialektika e iluminizmit“: 1944 – 1947).

Debati vazhdon edhe aktualisht dhe është i ndarë në dy dimensione dominuese: nga njëra anë janë korrektorët që kërkojnë më shumë barazi dhe drejtësi në ndarjen e mirëqenies dhe më shumë solidaritet në relacionin ekonomi – shtet – qytetarë si Michael J. Sandel (Justice: 2009), Amartya Sen (The Idea of Justice) dhe Kenneth Minogue (The Servile Mind: 2010) dhe nga ana tjetër kërcënojnë radikalët e popullarizuar që shkrihen akumulueshëm në teoritë e Hardt & Negri-t (Commonwealth – 2009), Eric Hobsbawm-it (How to Change the World: 2011) e të tjerëve, duke ofruar programe postrevolucionare për rikonfigurimin e demokracisë pluraliste nëpërmjet revoltës. Pas krizës së fundit financiare globale neoliberalët e Benthamit dhe Smith-it duket të kenë humbur çdo energji moralizimi dhe kanë përjashtuar veten. Ose nuk i dëgjon kush më.

Në sintezë që të dyja palët debatuese (sa i përket diagnozës së gjendjes aktuale) nuk dallojnë, pikëtakohen në kritikën e Adornos dhe Horkheimer ose i riaktualizojnë ato duke pranuar tezat e Minogue, të parashtruara në veprën e tij „Mentaliteti demokratik skllavëror“ (Titulli në gjermanisht).

Aty kristalizohen dy akuza themelore: Kapitalizmi i egër i libertarianëve (sa më pak shtet dhe sa më shumë kapital në duart e disave) rrezikon të mbysë përfundimisht edhe fijet e fundit të çdo solidariteti shoqëror. Mbirregullimi (ligje, nene, rregullore për çdo gjë ) shtetëror, kontrollues edhe i sferave nënlëkurëse, private, individuale (paradoksi qendror i liberalizmit) degradon e demokracinë pluraliste në shkallë të Entertainment – it. Njëllor siç akuzon edhe nobelisti peruan Mario Vargas Llosa në veprën e tij më të re “Kultura e

spektaklit – kush e humbet kulturën e vet, humbet edhe vetveten” (Madrid: 2012).

Çfarë do të thotë kjo për shoqëritë shqiptare, të cilat pikërisht falë solidaritetit të tyre të brendshëm historikisht edhe paskan mbijetuar?

### III.

Në këtë debat shqiptarët s’janë të epokës. Për një arsye logjike: Edhe sot modelin e importuar të demokracisë pluraliste e trajtojnë si një libër të shenjtë që vetëm duhet lexuar kurrësesi, që do mësuar përmendsh, pa e vënë në pikëpyetje qoftë edhe nëse nuk ecën fare dhe nuk implementohet dot.

Pasoja e kësaj sjelljeje është e natyrshme: as politikologu më i mprehtë i globit nuk di saktë të thotë se në ç’lloj sistemesh politike janë dergjur shoqëritë shqiptare realisht. Ose kemi të bëjmë me sisteme politike ku gjejmë elemente të demokracisë pluraliste (zgjedhjet e lira dhe këtu mbaron gjithçka), dëshmi të autokracisë, feudalizmit, monizmit, madje edhe vetë koncepti i demokracisë defektive i Wolfgang Merkel dhe Aurel Croissant (Demokracitë defektive në lindje: 2003) del tepër i butë, sidomos kur ndeshemi me nepotizmin, korrupsionin, burokracinë raketike dhe simptomat paratiranike të liderëve shqiptarë.

Nuk është rastësi që të gjitha këto devijime i kanë pikërisht vendet të cilat shtetin ligjor, demokracinë pluraliste dhe ekonominë e lirë të tregut i marrin vetëm aq seriozisht sa për të bindur botën për subvencione, të cilat humben rrugës ende pa arritur në arkat e shoqërisë.

#### IV.

Akademitë, sociologët, politologët shqiptarë deri më tani kanë bërë një punë kolosale duke përkthyer e kopjuar njëpërnjëshëm vepra e ese të shumta teorike mbi demokracinë, që në përfundim ishin standarde deri para 30 viteve, mirëpo ato dalin fare të paafta për ta bërë atë që bënë çekët, polakët, pjesërisht edhe kroatët, sllovenët, të cilët me studime konkrete (jo plagjiaturë debatesh terminologjike të para 20 viteve) serike shkencore, konferenca e debate analizuan demokracinë pluraliste në kontekst me traditat, kulturën, mentalitetet dhe psikologjinë e masave popullore të tyre.

Në bazë të këtyre studimeve ato shoqëri formuluan kushtetutat, ligjet dhe sistemin arsimor të tyre. Madje edhe vetë shoqëritë e konsoliduara demokratike si Zvicra, Gjermania, Norvegjia, SHBA-të, angazhojnë herë pas here institute private e akademike për të bërë studime në këtë drejtim: të shqyrtojnë nivelin cilësor të demokracive të tyre. Shqiptarët nuk e bënë këtë përpjekje asnjëherë. Ata nuk kanë diskurse rreth specifikave të tyre identitare, kulturore, historike në relacion me sistemin politik që synojnë. I dinë të gjitha, mirëpo nuk ua do ënda?!

Me këtë sjellje shqiptarët gjenden në një tranzicion subversiv. Të dyfishtë për më tepër: njëherë kundër rrënjës së cilësore të demokracisë pluraliste dhe së dyti kundër identitetit, kulturës dhe vlerave të tyre tradicionale, disa prej të cilave padrejtësisht diskreditohen si relikte primitive e që në fakt mund të eksportoheshin si shembull i solidaritetit dhe rrjetëzimit social. Hipoteza se shqiptarët asnjëherë e asnjë

punë nuk kanë ditur ta bëjnë si duhet në historinë e tyre në këtë rast gradon veten në definicion!

## *Demokracia autoktone*

Oligarkët, grupet, klanet kanë kapur pushtetet, këto tentojnë ta korruptojnë demokracinë në favor të të parëve. Ky sistem ekziston sa vetë demokracia. Pikërisht këtu ngecin edhe demokracitë shqiptare.

Filozofi i popullarizuar gjerman Peter Sloterdijk veçse nuk ia thuri himnin ish kryeministrit të Singaporit Lee Kuan Yew kur ky shpiku „kapitalizmin me rrënjë aziatike“. Kinezët po ashtu. Të fundit për më tepër u zotuan se Singaporin do ta marrin si shembull për reformimin e Kinës moniste. Sloterdijk lavdëroi aq shumë ngaqë pandehur se Yew paskësh zbuluar më në fund formulën që fuzionon suksesshëm trinitetin: kapitalizëm – demokraci – autoktonitet. Demokracinë autoktone pra! Euforia nuk zgjati shumë se skandalet e para. Në dhjetor të vitit 1997, në një artikull për „Foreign Affairs“ politologu dhe gazetari Fareed Zakaria e cilësoi Singaporin si regjim hibrid dhe Lee Kuan Yew-in e radhiti në të njëjtën listë me Slllobodan Millosheviqin, Sali Berishën (1992-1997), Leonid Kutschma-n (Ukrainë), Vladimír Mečiar-in (Sllovaki) e tjerë të të kalibrit të tyre. Gjithë këta konsiderohen si liderë të zgjedhur me një proces demokratik, mirëpo që sundonin në mënyrë diktatoriale, pasi që sheshit shkelnin institucionet dhe të drejtat e masave në favor të pushtetit personal, ideologjik apo oligarkik. Shumica e teoricienëve të demokracisë, në unison dolën me tezat që rrekeshin ta lokalizonin defektin. Dhe ai, dështimi nuk buronte vetëm nga natyra e liderëve despotikë, por: “demokracia që me çdo kusht rreket të

integrojë vlerat endogene (kulturat vendore = autoktone) dështon sepse shumëçka në traditat e popujve të ndryshëm nuk përputhet me standardet e të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht në shoqëritë etnikisht heterogjene, fragmentare“, kështu thotë sintheza tematike e hipotezave të tyre.

Janë kulturat autoktone të papërshtatshme ndaj demokracisë si sistem pluralizmi politik me një ekonomi kapitaliste? Teza në fjalë edhe pse vendos dy pole të pabarabarta në peshore (organizimin e sistemit politik e krahason me kulturën e një populli, gjë që nuk është mirëfilli kështu, por vetëm një segment i saj) pjesërisht e për raste të veçanta qëndron. Sa vlen kjo tezë për ta ndërlidhur me përshkrimin e demokracive shqiptare?

Koha për të kontrolluar mushkëritë e demokracive tona. Të shohim pse ato nuk dalin dot nga faza e subversionit dhe sa ndikojnë në këtë kontekst mentaliteti dhe kultura e masave?

### *Regjimet hibride*

Shqipëria edhe në vitin 2012 gjendet në vendin e 90-të, e kategorizuar si regjim hibrid. Kosova nuk figuron në lista ende, mirëpo konsiderohet njëlloj, pra të jetë regjim hibrid, e jo demokraci e përfunduar.

Siç shohim (*Democracy Index* dhe Sali Berisha), matësit eksterne të demokracive i kualifikojnë sistemet politike shqiptare të jenë regjime hibride (= demokracia përfundon me numërimin e votave dhe këtej e tutje nis autoritarizmi) sepse ato qenkan të paafta të instalojnë shtetin ligjor dhe të garantojnë të drejtat dhe liritë qytetare sipas doracakut europerëndimor. Ky zhvlerësim i magnetshëm për mediat dhe ndikues për imazhin e shteteve dhe shoqërive shqiptare, megjithatë duhet të jetë shqetësimi ynë më i vogël, sepse ai është vetëm maja e ajsbergut të një problemi më kompleks



dhe para së gjithash rangimi i këtillë është rezultat i një krahasimi që përjashton çdo logjikë serioze shkencore – i bie sikur në një garë pjekurie të skualifikosh gjashtëvjeçarët e njëzetvjeçarët për arsye se nuk kanë përvojën e njëqindvjeçarëve.

Ne thamë (*Tranzicion apo subversion*) se tranzicioni i shteteve shqiptare për në demokracinë pluraliste është subversiv jo sepse ato, shoqëritë shqiptare, janë të papërputhshme me normat dhe konditat eksogjene (të krijuara jashtë). E kundërta del nga analiza: ato nuk rezultojnë funksionalitet efektiv pikërisht sepse përjashtojnë realitetet endogene (që mbizotërojnë brenda kulturës autoktone). Integrimi bëhet nga e prapshmjia, është difektoz: në vend të përpjekjes për ta integruar demokracinë në kulturën dhe realitetet shqiptare, kërkesa ultimative e politikës, indekseve dhe organizatave supranacionale është që shoqëritë shqiptare t'i përshtaten sistemit politik që është në modë duke shpërfillur veçantitë e veta sociale, ekonomike e kulturore, gjë që shihet qartë se nuk shkon.

Gjithë këto teza, hipoteza, kalkulime, ankesa do të mbeten abstrakte nëse nuk hulumtojmë konkretisht se çfarë pati kuptuar qytetari shqiptar me demokracinë dhe ekonominë e tregut të lirë dhe si trajtohen ato aktualisht laboratorëve shkencore të botës jashtë sferës shqiptare.

### *Neveria ndaj turmave*

Kur ra realsocializmi (i paqenë realisht) shumica besuan se paskëtaj bota dhe jeta do të funksiononin sipas maksimës „Have fun“. Gjithçka lejohet – Shpifjeve, retorikës linçuese dhe diktatit të doktrinave të caktuara ende nuk u kanë shpëtuar dot shqiptarët. U banalizua deri në palcë letërsia,

artet, mendimi publik dhe kultura e komunikimit. Gjenerata e vjetër mallkonte kohën e re e kjo e fundit besonte se me dërrmimin e çdo gjurme të së vjetrës arrihet të kryhet më shpejt kapërcimi epokal. Të dyja dështuan. Të dyja palët ende akuzojnë njëra tjetrën sepse kokëfortësisht nuk duan t'i pranojnë dështimet e veta.

„*American Way of Life*“ sikur mezi priste tek pragu i kufirit shqiptar për të hyrë sa më shpejtë shtëpive të cullakosura shqiptare. Të rinjtë, vargun migjenian „Qeshu, rini! Qeshu! Bota asht e jote“ e bënë për moto jete. Pasi zhgënjimi i madh: Bota nuk ishte e tyre. Ata duhej të ndërtonin një të veten, të re, aty ku kishin jetuar, në tokën e tyre. Ia nisën pa plan, me arkitektë që dinin të ndërtojnë vetëm bunkerë dhe kasolle barinjsh e jo pallate të kohës si ato të Wall Street-it. E pranuan, e perceptuan demokracinë jo si formë organizimi politik, si formë konkrete qeverisjeje, ndryshe nga ajo ku sundonte vetëm një parti, por si jeta vetë, gati si religjion. Dhe si duket sot pallati? Themelet nuk durojnë as tërmetin më të lehtë. Diçka tjetër mbi to ende nuk është ngritur.

Që ta bëjmë rrëfimin më të kapshëm do t'i „shpikim“ dy personazhe: Demosin dhe Kratosin. I pari është i ati e i dyti i biri. Demosi, patriarku i odës dhe kullës e zgjedh njërin nga bijtë e tij si përfaqësues në Kuvendin e Vendit. Kratosi i papërvojë në politikë shpejt rekrutohet nga lobistë oligarkësh, klubesh, grupesh interesi dhe përpiqet sa më shumë të evitojë Demosin. Kur ky i fundit merr vesh për korrupsionin e të birit as që mundet ta ndërrojë (ligjet elektorale) e ta zëvendësojë djalin plangprishës me ndonjë pjesëtar tjetër të familjes së tij të madhe. Duhet të presë disa vite. Por, sa garanci vallë ka Demosi se përfaqësuesi i radhës nuk do të korruptohet përsëri?

Kjo ndodhi në Singapor: Korruptimi i demokracisë në favor të libertarianëve (shteti në shërbim ekskluzivisht të tregut) nën patronatin e makinerisë pushtetare. Kjo ndodh vazhdimisht në demokracitë shqiptare. Rotacioni vazhdon. E kjo tani, sa ka të bëjë pra me vlerat dhe kulturën autoktone të një populli, cilidoqoftë ai? Asfare. Kemi të bëjmë me njërin nga konfliktet e stërlashta që ndërliiden pazgjidhshmërisht me demokracinë, qysh nga antikiteti e më pas. Kontest ky të cilin Platoni e quante „*Tirania e Numrit*“ e që Tocqueville do na e ekspozojë sinqerisht si rrëfim të vetin në një artikull të New York Daily Tribune të datës 25 qershor të vitit 1853 ku shkruan: „*Kam një dobësi racionale për institucionet demokratike, megjithatë për nga instinkti jam aristokrat. Çka nënkupton se i përçmoj dhe ua kam frikën turmave. E dua lirinë dhe ligjësinë, por nuk e dua demokracinë*“.

Po të ishin të sinqertë, shumica e politikanëve shqiptarë në pushtet do ta nënshkruanin këtë qëndrim të Tocqueville-it si të vetin. Masat janë të paparashikueshme dhe të rrezikshme, prandaj mobilizimi i tyre është i nevojshëm vetëm gjatë votimeve e pastaj duhen zbrapsur, fladitur e mbajtur sa më ashpërsisht nën kontroll.

Të rrallë janë ata politofilozofë e sociologë perëndimorë (ndër të cilët: Ranciere, Bensaïd, Agamben, Innerarity, Couch, Sloterdijk, Nolte, Höffe, Ross, Nancy etj.) që nuk shohin pikërisht në këtë segment dështimin më të madh të demokracisë pluraliste, respektivisht suspendimin e barazisë sociale nga pushtetet në favor të pronarëve të kapitalit.

### *Aristokraci komuniste?*

Rezultat i kësaj „kulture politike“ është edhe metoda „më e re“ e politikanëve shqiptarë për të premtuar në çdo fshat, odë e qytet qindra miliona. Sugjerimi për aristokratizimin e qytetarit – për çka në fakt copyright-in e mban me meritë

komunizmi e jo neoliberalizmi – është njëra nga dëshmitë e vitrinizuara të shtetit të kapur nga kapitali, i cili duket të priret nga mendësia se paraja është simboli të cilin masat nuk e refuzojnë dot. Edhe pse vetëm me iluzion ai ndez sepse – kështu logjika pushtetyre – aty ku premtohet mirëqenia aristokrate, asnjë lloj morali, etike, ideali nuk ka gjasa të bëjë dot konkurrencë.

Në shoqëritë e varfra, ende pa traditë demokratike, rreziqet e korrupsionit janë shumë të mëdha. Ato shoqëri që me kalimin e kohës arrijnë ta autoktonizojnë sistemin politik, në këtë rast demokracinë, janë më immune kundrejt manipulimeve, hektikës së konsumimit, dezinformimeve, keqpërdorimeve dhe më lehtë integrohen në dinamikën, tempon dhe kthesat e nevojshme. Ato që gjithçka e kapin si shabllon për realizim personal, nuk e kanë seriozisht me veten. (2013)

## *Demodefektet*

Dramaturgu George Bernard Shaw besonte se «demokracia është procesi, i cili garanton që ne të qeverisemi aspak më mirë se sa që e meritojmë». Kjo thënie politologjike dhe cinike e gjenit irlandez do të përbënte substancën e çdo sistemi shoqëror me demokraci pluraliste për ta vlerësuar faktin nëse demokracia jonë është defektive apo progresive, nëse ndërkaq do t'i përjashtonim të gjithë faktorët ndikues që konfigurojnë, tjetërsojnë, riorientojnë mendësinë e masave para se ata të lëshojnë votën në kuti.

Kjo ndodh në të gjitha demokracitë, pavarësisht standardit jetësor në të. I vetmi dallim brenda këtij procesi ndërmjet demokracive në stadin e startit dhe atyre të konsoliduara qëndron në mungesën e imunitetit ndaj manipulimeve tek masat e tipit të parë (shoqëritë e tranzicionit). Ose siç e formuloi më bukur e saktë filozofi dhe psikiatri gjerman Karl Jaspers kur do të konstatonte se «Parakushti për mundësimin e demokracisë është *ratio*, arsyeja (racionaliteti) e masave, të cilën ajo (demokracia) së pari duhet vetë ta krijojë». Kur përkthejmë këtë tezë të Jaspers –it kuptojmë dy gjëra: E para; Instalimi i sistemit pluralisto-demokratik dhe e dyta; iluminimi, racionalizimi dhe edukimi i masave me sistemin e ri. A kanë ndodhur ky zhvillim në shoqëritë shqiptare?

Cilat segmente të shoqërisë janë përgjegjëse për «edukimin» e demokracisë dhe pluralizmit në shoqëri? Shteti, mediat, «elitat intelektuale», institucionet arsimore, iniciativat qytetare, politika e listës. Nëse analizojmë

veprimtarinë e këtyre faktorëve në raport me zgjedhjet e 8 qershorit ç' rezultat do të na dalë vallë?

### *Shteti*

Shteti i Kosovës që nga fillimet e tij nuk ka investuar në këtë drejtim. Nuk njihet ndonjë aksion apo program i ndonjërës nga qeveritë që do të merrej me supervizionimin e zhvillimit të demokracisë në sfera të ndryshme të funksionalitetit të saj. Në asnjë formë nuk ka ndodhur analiza në raportin shtet – qytetar – demokraci. E vetmja organizatë (bjerrakohëse përndryshe) që gabimisht është perceptuar si e këtij drejtimi është agjencia antikorrupsion, e cila për «mision» nuk ka demokracinë për luftimin e mafias. Të tjerat – OJF-të – kanë shërbyer më shumë si dekor i një «ekskursioni» të përkohshëm militarist se sa kanë ofruar udhëzime të vyera.

Mund të spekulohet në shumë variante se pse qeveritë nuk kanë vepruar ose nuk kanë qenë të interesuara. Një pjesë thotë sepse është e korruptuar e tjetra pjesë mendon Kosova nuk i posedon ende kuadrot për një vetanalizë të tillë të sistemit politik. Si të parët ashtu edhe të dytët kanë pjesërisht të drejtë. Megjithatë më shumë duket të jetë puna te mosgatishmëria e qeverive për një proces të tillë e jo te mosekzistenca e kuadrove në shoqëri – pasi të tillë Kosova ka plot.

### *Arsimi*

Institucionet e arsimit në këtë drejtim kanë kopjuar qeverinë. Nuk kanë bërë asgjë në këtë drejtim, qoftë edhe si diskurs interuniversitar (me studime, disertacione, kurse). Përkundrazi ato kanë bllokuar për shkak të paaftësisë së kuadrove akademike, edhe iniciativat që kanë dalë nga studentët (me punime e tema) në këtë drejtim. Se qeveritë

mund të kenë interesin e natyrshëm në lënien pas të kulturës demokratike në masë (sa më pak marrin vesh qytetarët aq më i sigurt sundimi) është diçka që bën logjikë, po cili është interesi i arsimtarëve, mësuesve, pedagogëve në këtë drejtim? Ndoshta as ata vetë nuk e dinë. Dhe ky spekulim duket të jetë realiteti. Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Kulturës si promotore të «edukimit», janë njëkohësisht defektet më të mëdha të shoqërisë kosovare.

### *«Elitat»*

Edhe gjatë këtyre zgjedhjeve nuk pati diskurs ndërintelektual rreth alternativave dhe programeve politike në garë. Pati analiza, kolumna, qëndrime „pro et contra“ mjaftueshëm, por nuk pati debat midis «të urtëve» rreth neoliberalizmit, neomarksizmit, nacionalizmit, të drejtave të njeriut dhe minoriteteve, nuk pati analiza vlerësuese për punën e ministrive të veçanta, nuk pati reflektime se ku ngec e ku ecën demokracia dhe pluralizmi në Kosovë. Kjo manifeston mosekzistencën e ndonjë «elite» intelektuale që djersitet me tru e objektiv për përparimin e shoqërisë. Vlerësuar deri pas këtyre zgjedhjeve, formula e Jaspersit modifikohet detyrueshëm në këtë rikonstrukcion: «Demokracia kosovare ende mbetet e paaftë për të prodhuar racionalizëm, sepse ajo ende nuk ka ardhur vërtet, por vetëm ka paradërguar mantelin e saj si paralajmërim».

### *Mediat*

Mediat në Kosovë nuk janë pasqyrë e asaj që ndodh në shoqëri. Shumica e tyre edhe në këto zgjedhje (përveç Tribunës që u vu në shërbim absolut të AKR-së dhe Behgjet Pacollit dhe ndonjë tjetre) mbajtën po atë kurs kritik ndaj

alternativave si qysh muaj e vite më parë. Kryesorja megjithatë, lavdërimi që shkon në llogari të tyre është fakti se ato – të vetmet në shoqëri – zhvillimet i matën dhe i vlerësojnë me peshoren e demokracive të konsoliduara dhe shtetet ligjore perëndimore. Gjë që tregon se vetëm mediat (ato seriozet) në Kosovë janë demokratike, gjithçka tjetër mbetet në parademokraci.

### *Faciti*

I radhitëm të gjitha segmentet e shoqërisë për të përfshirë sa më shumë faktorë në dështimin shqiptar të radhës. Për të zëruar faktin se jo vetëm qeveritë dhe partitë janë përgjegjëse për status quo-të, anomalitë përkatëse, por e gjithë shoqëria ose pjesët kryesore të saj, të cilat duhet të rimendojnë ekzistencën e tyre dhe të rreken të bëjnë një masterplan funksionimi drejt prosperitetit edhe kur qeveritë nuk duan të janë timonieret e tyre. (2015)



## *Demodestrudot*

Tranzicioni në Kosovë nuk do të mbarojë ndonjëherë, sepse ai as që ka filluar. Një përpjekje për të përshkruar anatominë e demokracisë kosovare, e cila qëndron stoikisht në listën e shteteve joliberalë dhe të deleguara.

Një studim i universitetit evropian “Viadrina” të Frankfurtit (2001) konstatoi se në vendet passocialiste pati dështuar instalimi i demokracisë si formë qeverisjeje. Në fakt ky studim është një sintezë e studimeve të politologut argjentinas në Universitetin e Notre Dame, Guillermo O’Donnell (Baltimore 1993), i cili më herët bëri kategorizimin e demokracive në defektuoze, joliberalë, delegative dhe të konsoliduara. Shumica e shteteve ballkanike nuk gjen vend në hierarkinë e sistemeve të konsoliduara shtetërore. Kosova është edhe më dobët.

Që nga përcaktimi i kategorizimeve nga O’Donnell e më vonë, të mbështetura e të përhapura edhe nga politologu harvardian dhe redaktori aktual i CNN, Fareed Rafiq Zakaria, debati nuk ka të ndalur. Tri paradigmat kryesore polemizojnë rreth çështjes së lokalizimit të fajtorit për këtë dështim. E para na thotë se fajin e ka mentaliteti eurocentrik i “The West and the Rest” (Stuart Hall: 1994) e dyta ngul këmbë në paaftësinë e elitave passocialiste për të vënë në lëvizje procesin e tranzicionit dhe e treta sugjeron përjashtimin duke u përpjekur ta bindë botën se kultura e mentaliteteve të caktuara nuk janë dhe nuk do të bëhen të përputhshme me demokracinë liberale për arsye se refuzojnë të përpijnë idealet e projektit iluminist.

## *Eurocentrizmi dhe demokracia e SMS-ve*

Përse të gjitha studimet në unison thonë se transicioni në Ballkan, respektivisht në Kosovë, nuk ka mbaruar, sepse ai as që ka filluar. Kjo tezë që së fundi u sugjeruar nga profesori italo-zviceran Christian Giordano (2011) bazohet në teoritë e socioetnologëve dhe historianëve si Pierre Bourdieu, Norbert Elias, Clifford Geertz dhe Reinhardt Koselleck.

Baza empirike e këtyre shkencëtarëve nis të përvijohet nga paradigma kundër eurocentrizmit dhe dështimin e tranzicionit e lokalizon bindshëm tek mendjemadhësia dhe paaftësia e organizatave supranacionale perëndimore, të cilat dërgojnë “instrukturët e tyre të demokracisë” nëpër vende të ndryshme pa pasur pikën e idesë mbi “habitusin shoqëror” (Bordieu) të atyre popujve, duke mos përfillur fare “traditat sociale dhe lokale” (Elias) të kulturave vendëse dhe duke injoruar në mënyrë eklatante “dimensionin e përvojës historike”(Koselleck) si akrep shoqëror të elitave. Kjo tezë e Giordanos që bazohet në teoritë deskriptive të autorëve të mësipërm qëndron!

Një pjesë e konsiderueshme e instruktorëve të dërguar që do të ndihmonin në rrënjosjen e demokracisë në Kosovë vinin nga vende ku demokracia as që i është afruar pragut të tyre (OKB), ose pjesa kryesore dhe më relevante ishin ato lloj instruktorësh që ngritjen e institucioneve kapitale të shtetit e delegonin nga kafenetë nëpërmjet SMS-ave, gjë që konfirmon djegshëm kulmin e arrogancës së motivuar nga ajo mendësia “The West and the Rest” e Hall-it.

## *Defekti i eksportuar*

“Teoria e elaboruar më lart është e njëanshme dhe euforike” (Nolte, Paul: 2012), kështu skualifikojnë studimet

më të reja dhe ato pararendëse. Të njëjtin konstatim e manifestojnë zëshëm e vazhdimisht edhe analizat e OJQ-ve dhe instituteve ndërkombëtare që merren me monitoringun e zhvillimeve politike në Kosovë. Kjo për arsye se analizat si ajo e Giordanos me gjithë synimin pozitiv për të argumentuar se shtetet passocialiste me një shpejtësi marramendëse dhe në mënyrë që të vetëmodernizohen dhe ecin përpara, ajo i mohon, i hesht defektet e brendshme, të cilat madje as që kanë të bëjnë me papërputhshmërinë e kulturave dhe identiteteve përkatëse, si dhe as me mospërpirjen e idealeve të iluminizmit evropian – siç përpiqen të na bindin ndoca profesorë eurocentrikë që me dekada nuk kanë dalë nga bodrumet e pluhurosura të universiteteve ku ligjërojnë.

Teza e papërputhshmërisë mund të qëndrojë për shoqëritë të cilat parimisht nuk e pranojnë demokracinë si model qeverisjeje dhe si pasojë Perëndimi përdor mjete edhe jodemokratike për të instaluar rendin demokratik atypari. Kjo tezë ama nuk qëndron kurrësesi për shtetet, masat popullore të të cilave, madje jo rrallë edhe në mënyrë të ngazëllyer, demonstrojnë vullnetin e tyre për rend ligjor, të drejta dhe atë formë qeverisjeje që sundon në vendet kyçe të Evropës së ngushtë. Përkundër ca grupeve minore që besojnë në zotat e tyre etnokratikë ose religjiozë, shumica e kosovarëve vuan për një shtet të tillë siç e kanë njohur falë migrimeve të fundit të tyre.

Defektet e brendshme që listojnë OJQ-të dhe institute të tjera serioze të cilat katapultojnë shoqërinë kosovare si të paaftë për instalimin e njëmendë të qeverisjes demokratike dhe të shtetit ligjor, pra nuk kanë të bëjnë me vullnetin e masës, as me kulturën e tyre, por me strukturat pushtetare e sidomos me “elitën” komanduese të atyre strukturave. Përse vallë?

## *Matematika e shtabeve zgjedhore*

Rasti i zgjedhjeve të fundit në Maqedoni mund të merret si shembull tipik i defektit kryesor që në shumicën e shoqërive ballkanike saboton idealin për instalimin e demokracisë dhe shtetit ligjor. Para se të mbahen zgjedhjet disa media publikuan “rekomandimet” drejtuar familjeve me njerëz të punësuar në vendet publike që të votojnë partinë në pushtet, pra atë të Gruevskit. Mesazhi: përndryshe s’ka punë për të afërmin, i cili ishte bukëdhënësi i vetëm i gjithë familjes e në raste edhe më dramatike edhe i krejt fisit. Në këtë rast dolën letrat në sipërfaqe, mirëpo ato nuk ndikuan fare që qeveria e Gruevskit ta marrë pushtetin. Kjo është e dukshmja, ndërsa e padukshmja e këtij sistemi, që të gjithë e dinë dhe përjetojnë, kalon kufijtë e një drame që vazhdimisht do të na shtynte të qajmë.

Kërcënimi i lart-evidencuar ishte i përlllogaritur mirë matematikisht.

Si ndodh te ne ndërkohë? Cila është metoda jonë e sigurimit të elektoratit për të fituar apo për të mbetur në pushtet? Dalin partitë me programe sociale, ekonomike e politike dhe me muaj përpiqen që sa më thjesht e konkretisht t’ia deklamojnë masës ato për ta bindur atë se përse duhet të votojnë për atë ose për këtë parti? Jo, asgjë nga kjo punë. Partitë ulërijnë me parulla etnofolklorike dhe premtime boshe, me të cilat masat janë ngopur qëmoti? Atëherë pse fiton kjo ose ajo parti?

### *Manipulimi permanent i elektoratit*

Sipas raportit të një diplomati zviceran qeverisë së vet, pas shërbimit mëse njëvjeçar në Kosovë dhe i cili në fund ndoqi edhe zgjedhjet e fundit në Kosovë, kjo qenka strategjia e partive kryesore në Kosovë se si e rekrutojnë elektoratin:

Puna me masat: Fillimisht krijohen listat e të privilegjuarve nga pushteti; qoftë të atyre me pozita nëpër vende publike apo qoftë të atyre që kanë përfutur nga tenderët, lejet për biznese e gjëra të ngjashme. Pastaj bëhen listat e “patriarkëve” ende të pakorruptuar dhe me ndikim në fshatrat ku jetojnë. Në “odë të burrave” flasin të deleguarit me t’parin e fisit për lavditë e shkuara dhe planet qëllim-mira të partisë ose pushtetit. Në katër sy beson edhe shqiptari zemërgur. E sidomos ai që ka vajzën apo djalin me studime e që punët materiale i ka si mos më keq. Premtohen poste nëpër përfaqësitë diplomatike e deri edhe traktorë e lopë.

Puna me mediat: Gazetarët e infiltruar në interes të asaj apo kësaj partie janë argatët më të vyer, sepse këta merren me “listat negative” të partive. Me lista negative nënkuptohen ato personalitete e “patriarkë” me ndikim, që megjithatë janë në krahun e gabuar. E meqënëse secila parti përdor të njëjtën metodë rekrutimi, materiali komprometues për njërin apo tjetrin sigurohet fare lehtë. Ky segment është më efikas sesa komentet servile dhe lajmet për arritjet e faktorëve politikë.

Puna me OJQ-të dhe organizatat civile: Veprimi i shtabeve zgjedhore me këtë segment të shoqërisë civile është një përzierje e dy metodave të para. Edhe aty prin tendenca e infiltrimeve, privilegjeve dhe kërcënimeve. Kështu që organizmave udhëheqëse të tyre u dalin dy alternativa për

seleksionim: kush premtion më shumë ose kush kërcënon më pak.

Natyrisht se kjo analizë e emisarit zviceran duhet të merret me rezervë. Sidomos nga ata që kurrë në jetë nuk janë ndeshur me një praktikë të tillë. Me rezervë nuk merret sidoqoftë dot nga ata që përballen me faktin se shumica e analizave kanë po të njëjtën gjuhë. Janë rreshtuar gjithë ekspertët kundët Kosovës e Ballkanit të gjorë?

### *Paraliberalizëm apo korrupsion total*

Shumë si tepër ministra, drejtorë, kryetarë komunash e funksionarë të ndryshëm po arrestohen për korrupsion sa për ta mbajtur fenomenin brenda kornizave të një fenomeni eksisiv dhe të izoluar korrupsioni, pra për të thënë se janë raste kriminale që ndodhin gjithandej. Çështja bëhet edhe më fatale kur studiohen biografite e personave të inkriminuar dhe kur përplasesh me faktet se shumica prej tyre janë rekrutuar me sistemin që përshkruajnë ekspertët e huaj dhe se të dënuarit apo të akuzuarit ideologjikisht, familjarisht apo për shkak të biznesit, janë persona fare të afërt të personave kyç të pushtetit aktual dhe partive kryesore.

Pothuajse asnjë tender deri tani nuk doli i fituar nga kompani a njerëz që nuk janë parë salloneve me njerëz kyç të pushtetit e partive kohë më parë.

### *Si të zgjidhet ky problem?*

Teoria e O'Donnell sa i përket Kosovës qëndron. Forma e qeverisjes kosovare është dyfish e deleguar (nga jashtë dhe nga brenda). Ekonomia kosovare është paraliberale, sepse korrupsioni i organizuar dhe «legal» nuk e lëshojnë timonin nga duart. Faktorët relevantë politikë matematikën elektorale e bëjnë në bazë planesh e strategjish manipuluese,

antidemokratike, prandaj për shumë ekspertë është e vështirë të gjejnë kufirin se ku mbaron kriminaliteti e ku fillon së paku zona gri që do të jepte shpresë se edhe ai stad do të kalohet për të ecur drejt shtetit ligjor dhe një demokracie të konsoliduar.

Edhe një herë kosovarët gjenden në zgrip: ata që thonë se institucionet ndërkombëtare me sjelljet e tyre qofshin injorante apo arrogante bllokojnë hyrjen e Kosovës në një demokraci me shtet ligjor kanë të drejtë. Ata që thonë se tipi i qeverisjes kosovare është larg sistemit të pluralizmit demokratik po ashtu kanë të drejtë. Ata që thonë se korrupsioni ia bllokoi krejtësisht jetën ekonomisë kosovare dhe pamundëson liberalizmin, po ashtu kanë të drejtë. Pra të gjithë kanë të drejtë.

Ashtu siç kanë kosovarët të drejtë t'ua refuzojnë votën atyre që ua mbysin zërin e pastër të tyre për demokraci dhe shtet ligjor! (2012)

## *Katë «killer application»-et e Fergusonit*

Politikanët sugjerojnë shqiptarët të jenë të paaftë për të pranuar demokracinë si model shoqëror? Është kjo një e vërtetë apo shpifje tradicionale politike?

Në çfarë sistemi politik jetojnë shoqëritë shqiptare? Kush beson se në Kosovë është instaluar (qoftë edhe në fazën fillestare të saj) demokracia liberale është po aq i manipuluar sa gjithë ata që besojnë se letra dhe shtypi janë zbulime të gjermanit Johannes Gutenberg në shekullin 15.

Dakord: për këtë tashmë janë shkruar qindra tekste medieve shqiptare dhe mbizotëron përshtypja sikur të merremi me një temë të tejbanalizuar. Gjithë e dinë pse liria shqiptare është e pastrehë. Formula më e përshtatshme, më e përhapur dhe redundante që në këtë kontekst përdoret është ajo e historianit të ekonomisë David Landes –it («The Wealth and Poverty of Nations»:1988 – “Pasuria dhe varfëria e kombeve”), e cila thjesht, shkurt dhe qartë definojnë çështjen: S’ka përparim pa qeverisje të mirë, institucione të forta (parlamenti, ligjësia..etj.) dhe pa një administratë të disiplinuar publike (shtetërore). Bukur. Dhe çka më tej?

Pra, kjo implikon shqiptarët të jenë kolektivisht vetëfajtorë për gjendjen që kanë. Ose mediet kanë predisponim të mbrapshtë ndaj qeverive dhe për hir të sensacionit, tregut, klaneve e shtrembërojnë realitetin? Edhe pse apriori kuptojmë se ky lloj arsyesimi është shakaja më debile e të gjitha kohëve, ia vlen që shkurt të analizojmë se sa



e drejtë është akuza që thotë se Kosova nuk disponon me sistem demokratik liberal. Si ta bëjmë këtë? Le të zgjedhim modelin më të përhapur të kohëve të fundit. Atë të historianit të ekonomisë në Universitetin e Harvard-it Neil Ferguson, respektivisht e analizojmë sistemin aktual politik kosovar në ato gjashtë «killer application»-et (që në fakt janë katër) e tij:

### *1. Decentralizimi i ekonomisë*

kjo në analizën e Fergusonit do të thotë se shteti luan rolin e referit të drejtë ndërmjet palëve pjesëmarrësve në organizimin e tregut. Pra, ai i organizon ligjet dhe institucionet që mbikëqyrin kartelet dhe ndarjen e kapitalit në mënyrë të sigurimit të mirëqenies shoqërore. Çka ndodh në Kosovë? Jo nga frazat mediale, por nga proceset gjyqësore dhe dështimet e mëdha si papunësia, varfëria dhe mosekzistenca e prodhimit vendor mediet flasin për një monopol të kriminalizuar të ekonomisë nga ana pjesëtareve konkretë të qeverisë. Pra, shteti (tenderët për shembull) nuk luan rolin e «ndërmjetësit» në organizimin e kapitalit, por është kapoja. Qeveria në forma të ndryshme dëshmon se ajo vendos në bazë të lidhjeve e jo ligjeve se si duhet të qarkullojë kapitali në Kosovë.

### *2. Arsimi dhe shkenca*

Ferguson thotë se me garën në fushën e dijes dhe shkencave përparojnë edhe ekonomikisht ato vende, të cilat bëhen pronare patentash e licencash, pra zbulimesh në farmakologji, kompjuteristikë, etj. Cilat zbulime i kanë sponsorizuar qeveritë shqiptare deri më tani? Po se do të harronim: ka zbuluar se shqipja në flamur i ka pasur krahët ndryshe se ç’kemi besuar deri dje. Përndryshe asgjë.

### *3. Politika ose shteti ligjor*

Shteti kujdeset për ligje dhe rregulla që vlejné për të gjithë njëjtë dhe të cilat sidomos në mbrojtjen e lirisë dhe mirëqenies individuale nuk krijojnë gropa ndër shtresat e shoqërisë. Këtë Ferguson e sheh si bazën kryesore për ta kualifikuar një vend demokrat apo jo. Përveç problemeve të shumta që janë përmendur gjithandej qeveria kosovare si sistem i deleguar politik nga tre qendra diametralisht me interesa të kundërta (BE-SHBA-dhe klaneve që devijojné nga dy politikat e para për të siguruar pushtetin) e ka të pamundur aktualisht përforcimin e një shteti ligjor që nuk përshtatet me rrethanat autoktone. Këtu kanë të drejtë politikanët që thonë «vetë kosovarët i kanë fajet» (sikur të kishin ndonjë zgjidhje tjetër?!).

### *4. Etika e punës*

Shteti duhet të përpilojë ligje e të vërë rregulla të punës. Kështu duke siguruar barazi dhe moral në tregun e punës. Edhe para aferës së «prontove» gjithë e dinë se si sigurohet vendi i punës në shoqëritë shqiptare. Nepotizëm pur!

Sigurisht se kësaj liste mund t'i shtohen edhe qindra «killer application»- e tjera, mirëpo nëse Neil Ferguson këto i vjen si kushte që duhet patjetër plotësuar për ta kualifikuar një vend si demokraci liberale në kushtet aktuale, atëherë Kosova s'është e tillë. Çka atëherë? Ndoshta ekspertët qeveritarë e dinë këtë punë më mirë se ne. Çka dimë ne është se realiteti shqiptar nuk është as gjetje qëllimkeqe e medieve e as të shqiptarëve me «relacion të sëmurë ndaj shtetit», por janë vepra konkrete të qeverive, qëllimisht apo jo: s'ka rëndësi! (2013)

## *Postdemokracia dhe treni shqiptar*

Demokracia nuk po ecën. Idenë e tregut të lirë e tjetërsuam në treg të zi. Religjione të caktuara kërkojnë rend shoqëror, i cili qysh në mesjetë shihej si i prapambetur. Nga ky çorientim përfitojnë radikalët e çdo sekti e krahu të mundshëm.

Sa herë që subjektet ndihen në krizë ekzistenciale, ideologjitë, religjionet dhe utopitë bëjnë gati instrumentet për dasmën e tyre të radhës. Predikuesit e doktrinaeve dhe féve e dinë se aty ku gëlon skamja, çorientimi shoqëror, politik e social aty i kanë pacientët, klientët e tyre të sigurt.

Që nga shpërthimi i krizës globale financiare zëri i transcendentëve është bërë veshplasës. Motoja e tyre – asgjë e re – është: nuk ka shpëtim nga sistemet që i ka sajuar mendja e njeriut! Perënditë e tyre po na kthehen marshueshëm dhe puthin çdo dhi të përhumur ndërurave të metropoleve europiane. Edhe pse profetët kësaj radhe kanë veshur jeans-a, enden lart e poshtë me iphon-ë, ata nuk ofrojnë ndonjë mendësi të ndryshme nga ajo që qytetërimi e njeh që mijëra vjet. Përkundër kësaj ata festojnë «ditën» e tyre dhe masat popullore, njerëzit u ngarendin pas si kopë lopësh që kanë mbetur asht e lëkurë.

Profesori i London School of Economics John Gray, njëri nga filozofët më të rëndësishëm sapo hulumtoi tendencën në fjalë, bërtiti me sa zë që kishte: «Ju kanë lënë mendtë? Nuk keni mësuar asgjë nga historia? Larg duart nga politika apokaliptike e religjioneve dhe doktrinaeve» («Politika

apokaliptike», München, 2009/2012). Pak e dëgjuan e shumica e «skualifikuan» si ateist të radhës. Sot, disa vite më vonë, edhe ata që e stampuan si panikbërës e kanë shndërruar atë në referencën kryesore për t'i ngritur teoritë e veta rreth rreziqeve të «reja», dhe më e rëndësishmja; kritikët u dorëzuan dhe e pranuan haptas se John Gray s'ka të bëjë fare me ateizmin, por me terrenin, ai nuk ideologjizon, por përshkruan me përpikmëri problemet aktuale.

### *Ekskursi i parë*

Në mediat shqiptare tashmë kanë rënë kambanat e para të alarmit. Fundamentalistë mjekroshë, të ardhur apo të shkolluar nga përtej urës së Bosforit radikalizojnë, respektivisht instrumentalizojnë shoqëritë shqiptare deri në atë shkallë saqë përmbyskan tolerancën aq të lavdëruar ndërfaqetare. Psika shqiptare sërish në rrezik! Kësaj radhe ajo nuk qenka në rrezik vetëm nga serbët që këmbëduar luftojnë kundër mëngjesit për të mos dalë nga ëndrrat, por edhe nga ish-komunistët e tjetërsuar në imamë, nga nacionalistët e shndërruar në turbokapitalistë dhe nga patriarkët e egërsuar në kauboj. Turmën më të madhe megjithatë e përbëkan ata që ende nuk kanë vendosur se nga t'ia mësyjnë.

### *II. Komunizmi vdiq – rroftë Karl Marksi*

Terry Eagleton pati thënë: «Komunizmi vdiq, kapitalizmi është i sëmurë – rroftë Karl Marksi» («Pse Marksi ka të drejtë», Berlin 2012). Historiani Manfred Hildermeier («Historia e Bashkimit Sovjetik 1917 – 1991», München 1998), i cili një jetë ia ka kushtuar studimit të anatomisë së sistemeve socrealiste, shtrëngon kryet me duar dhe nuk e kupton dot botën. Emeritusi oksfordian Archie Brown

(«Ngritja dhe rënia e komunizmit», London 2009) qesh prej zori.

Che Guevara i shkencave të historisë Eric Hobsbawm del pro teorisë së Terry-t («Si ta ndryshojmë botën – mbi Marksit dhe marksizmin», München 2012) dhe elegantshëm degradon habinë dhe shokun e të tjerëve si mosdije. Ata – kështu thotë Hobsbawm – historianë që mendojnë se ka përcaktuar koha e Marksit, duhet të gjejnë rrugën për të dalë jashtë arkivave të tyre dhe të ballafaqohen me botën dhe kohën e sotme. «Asnjëherë më parë, si tani, Karl Marks nuk ka pasur të tillë sukses» i thotë ai magazinës gjermane «Philosophie» (Nr.05/2012). Epoka e njëmendtë marksiste tani ka filluar, siguron Hobsbawm. Edhe ky pra mendon se zhdukja e shteteve socialiste jep mundësi që Marksit ta kuptojmë ndryshe, drejtë, ashtu siç është vërtet.

Nuk ka dyshim se as Hobsbawm dhe Eagleton një kohë të gjatë nuk e paskan shkundur pluhurin e arkivave nga vetja. Ta kesh Kinën, Korenë, Kubën përballë syve dhe të konstatosh se ka vdekur mosrealizimi, është më shumë se të jetosh si i humbur në mjegull. Socializmi real i këtyre vendeve ende pretendon komunizmin si finale. Pra komunizmi në formën që ishte, ai faktikisht aty është ende, ai nuk ka vdekur.

Filozofi Slavoj Žižek ka gjetur formulën se si t'i shpëtojë dy të sipërcituarit nga paradoksi i tyre: «Komunizmi është idé e përjetshme. Ai në situata të reja duhet të zbulohet nga fillimi» shkruan marksisti sloven në librin e tij «Shpirtrat e këqij të sferës qiellore – Lufta e majtë për shekullin 21» dhe sipas tij – siç thotë edhe Hobsbawm – tashmë është një kohë e tillë. Mungon vetëm thirrja proletarëve dhe një internacionale e re. Kënga How We Do (Party) e Rita Orës do të ishte një propozim fantastik. Sidomos refreni i parë i këngës: «And party and bullsh-it / And party and bullsh-it (...) do ta detyronte edhe vetë Stalinin të braktisë varrin.

## *Ekskursi i dytë*

Kur nisi epoka moderne 99 përqind e shqiptarëve ishin analfabetë. Ende pa marrë vesh se në cilën epokë gjenden, ata u bënë pjesë e sferës së skuqur të kontinentit. Marksini dhe Leninin e njohën nga radiot dhe pamfletet e parakomunistëve, shumica e të cilëve as vetë nuk dinin të lexojnë. Kur ia nisën të lexojnë, Marksi kishte kohë që ishte kthyer muzeve, në vend të doktrinës së tij, shqiptarët «kënaqeshin» me direktivat faraonike të despotëve të tyre e të huaj. Përveç floskave dhe parullave bajate të shkëputura nga «manifesti komunist», si masë ata as sot duket se nuk dinë ndonjë gjë më shumë. (Po të dinin se Marksi dhe Engelsi dikur kërkonin «fshirjen e barbarëve sllavë nga faqja e dheut» («Neuen Rheinischen Zeitung», Nr. 149 vom 13. Januar 1849) ndoshta ende nuk do t'i kishin hequr statujat e tyre nga odat dhe zyrat. Ndoshta?)

Disa qindra të shkolluar në sistemin e vjetër që pjesën ideologjike të marksizmit e kishin mësuar përmendsh, qëmoti janë konvertuar në patriotë apo ekstrafetarë. Shumë pak kanë mbetur ata që do të merrnin guximin me zë të reflektojnë mbi marksizmin si rrugë të mundshme shpëtimi.

Nga diktatorët e tyre megjithatë – masat popullore - me sukses kanë përvetësuar mënyrën e funksionimit në shoqëri. Po u bëmë një analizë partive, shoqatave dhe organizmave të tjera shoqërore lehtësisht do të vërejmë se procesi funksional demokratik është vetëm fasada e hollë e një sistemi të vjetër: atij totalitar, me elemente të mbijetuara të patriarkalizmit feudal. Apelet për konfrontim me të kaluarën komuniste, siç bëri këto ditë e shoqja e Dioguardit, Shirley, mund të dalin vetëm nga njerëz që shqiptarët i njohin vetëm nga perspektiva e réve. Enverizmi nuk ishte komunizëm. Ashtu edhe titizmi. Komunizmi si ide as që i ka arritur ndonjëherë tokat

shqiptare. Socializmi nuk ishte sistem, por maskë e krimit të organizuar politik.

Analiza përplotë shpresa e marksistëve Hobsbawm, Eagleton dhe Žižek mund të ndezë zemrat në Venezuelë apo diku tjetër, tek shqiptarët ajo as gjasën më të vogël nuk e ka. Fat apo tragjedi? S'ka lidhje. Ky është realiteti.

### *III. Postdemokracia*

Me vdekjen e Tony Judt neoliberalët humbën avokatin e tyre kryesor. Për të kompensuar këtë vakum, një ringjallje ceremoniale përjeton antimarksisti Sir Karl Raimund Popper (1902-1994). Eseja i tij kundër marksizmit «Shoqëria e hapur dhe armiqët e saj» botohet në të gjitha variantet dhe gjuhët e mundshme. Shumica e intelektualëve më në zë që deri dje mbronin neoliberalizmin, tanimë kanë ndërruar frontin. Nuk janë bërë marksistë, por as neoliberalizmit nuk i besojnë. Do prej tyre madje po si shqiptarët nuk e dinë se ç'kompas do t'i shpëtonte nga hutimi.

«Valës globale të demokracisë liberale», që shpërtheu me rënien e murit të Berlinit, i është zënë pra fryma në gjysmë. Diagnostikët e sistemeve politike kërkojnë terma të reja për të përshkruar situatën më të re. Politologu Colin Crouch i Universitetit të Warwick-ut ka dhjetë vite që e mban një syresh në xhep: Postdemokracia (Post-democracy, Polity, Cambridge 2005)! Kështu duhet pagëzuar epoka e shekullit 21! Dhe në librin e dytë « Mbijetesa defektuoze e neoliberalizmit» (Cambridge 2005) lavdërohet se qysh në librin e parë kishte të drejtë kur thoshte se «Demokracia nuk është në rrezik nga religjionet dhe marksizmi, por nga koncernet transnacionale që sabotojnë tregun e lirë dhe akumulojnë pushtetin dhe financat vetëm në disa qendra të caktuara». Kërkesa e tij prandaj është që njerëzit ta qëndisin sa më shpejt një doktrinë të re, atë të konsumatorëve.

Konsumatorët duhet të iluminohen deri në atë masë që mos të lejojnë përqendrimin e kapitalit siç bëhet tani.

Edhe një utopi më shumë? Madje po aq paradoksale porsia ajo e Euromarksishtëve të Hobsbawm-it. Baza e neoliberalizmit është tregu i lirë. Nëse presim që njerëzimi dikur të heqë dorë nga kompjuterët për t'ia minimizuar kapitalin Bill Gates-it, atëherë fort gjatë e deri në kapitullim do të presë bota.

### *Ekskursi i tretë*

Edhe në këtë rrafsh shqiptarët përsëri të vonuar. Ata ende pa e mësuar demokracinë qoftë edhe në letër, bota sakaq flet për postdemokraci. Është thënë pra disa herë se Tranzicioni (instalimi i demokracisë dhe tregut të lirë) edhe në shoqëritë shqiptare nuk ka pasur sukses. Po si në shumë vende të tjera të botës së «tretë» ashtu edhe në hapësirën shqiptare para tregut të lirë u preferua tregu i zi. Këtu nuk janë fajtorë vetëm partitë dhe politikanët që janë të detyruar të sigurojnë elektorat, por madje edhe më shumë ai tip mentaliteti që korruptohet për ta fituar përfshirjen në sektorin e parakapitalistëve, pikërisht atyre të kastës së parë shoqërore sa më lehtë që është e mundur. Pasurimi pa djersë është metoda më e përhapur ndër shqiptarë. Edhe po u ngritën nga varri Marksia dhe Adam Smith vetë për t'u sqaruar shqiptarëve se ç'është drejtësia shoqërore, ata nuk do ta zgjidhin problemin e tyre, sepse origjina e problemeve të tyre më shumë sesa nga ideologjitë e transportuara është e shtëpisë. E konfrontimin me vetveten – si shumica e popujve të Ballkanit – shqiptarët e urrejnë më së shumti.



#### *IV. Politika apokaliptike*

Qenie në kushte të rënda sociale, të rinjtë që nuk dinë se si do të duket e nesërmja e tyre, të shkolluar, të zhgënjyer që nuk i përfill kush, njerëz me përjetime të rënda e të lënë anash nga shoqëria, pleq që fëmijët e tyre i kanë hedhur në bodrum, injorantë që për shkak të kompleksit të tyre të inferioritetit kundrejt të tjerëve janë në gjendje të shndërrohen në bombë ambulante dhe njerëz që nuk funksionojnë pa ideologji, që konvertojnë nga një ekstrem në tjetrin, janë vetëm disa nga kategoritë sociale që gjenden në udhë e sipër për të gjetur «shpëtimin». Janë gjenerata disa herë e shumëfish të zhgënjyera me sisteme politike (realsocializmi, demokracia, etnokratia) dhe që kanë humbur çdo besim në to. Në vendet me një krizë permanente ky proces edhe pse kontradiktor (kanë nevojë për bukë e pajtohen me ideologji që u premtan komoditet veç pas vdekjes) historikisht është i natyrshëm. Kjo gjendje i bën fetë tërheqëse. Ato tashmë e disa vite kanë nisur harikirin e tyre gjithandej.

Njerëzit e kanë humbur kuptimin e jetës. Dhe kur nuk e gjejnë atë në tokë, më pas e kërkojnë në qiell, mendon John Grey me të drejtë. Sado absurd e kontradiktor që të jetë ky fakt, terreni na bind se religjionet apokaliptike, ato përjashtuese (vetëm Zoti im ekziston), ato që rekrutimin e realizojnë përmes frikës dhe kërcënimit sistematik (po nuk erdhe me ne përfundon në ferr) janë rrezik për funksionimin dhe zhvillimin e shoqërive në krizë. Sidomos aty ku dhuna legjitimohet si mjet i domosdoshëm. Aktualisht në këtë drejtim islamizmi (jo Islami), si doktrine politike me synime ekspansioni (shpëtimin të botës!?) mban flamurin para të gjithëve.

### *Ekskursi i fundit*

Shoqëritë shqiptare aktualisht nuk përballen me marksistët e përdhosur, kryqëzatat e as me budizmin, por me turbokapitalizmin e egër dhe islamizmin radikal që ka filluar të përlejë pjesë të shoqërive të tyre. Mediat dhe gazetarët nuk mund të shpikin fenomene që nuk ekzistojnë. Ata përshkruajnë terrenin dhe tendencat. Mund të diskutojmë për karakterin e Islamit si histori e si fe më vete, ashtu siç mund të debatojmë edhe për fétë e tjera. Ajo çfarë mbetet e padiskutueshme është fakti se liderë dhe organizata islame indoktrinojnë gjerësisht masat me mekanizmin e dhunës. Ata marrin në mbrojtje terroristë. Shpifin ndaj rendit të synuar shoqëror si të ishte fjala antizotin dhe preferojnë Sharia-n. Nënçmojnë dhe shajnë personalitete të historisë shqiptare vetëm për arsye se janë të besimit tjetër. Ngjallin atmosferën e frikës ndër skamnorët dhe shtresat e viktimëzuara nga shteti. Nxisin dhe përçajnë. Tjetërsojnë identitetin historik e aktual të shqiptarëve dhe rrezikojnë të jenë destabilizuesët e çdo përparimi.

Alarmi për të ndërmarrë – siç bëhet gjithandej – diçka kundër tendencave të këtilla nuk vjen si pasojë e urrejtjes ndaj besimtarëve islamë që e kanë kuptuar se nuk gjendemi më në shekullin e 15, por në atë 21, por ndaj të sëmurëve brenda tyre. Shoqëritë shqiptare kanë probleme të mëdha edhe një syresh më shumë do t'i fundoste ato në kaos, dhunë dhe krim.

### *V. Ide për diskurs*

Urtia vjen nga India. Nobelisti dhe profesori i Oksfordit Amartya Sen e pranon se demokracia si sistem nuk është e përkryer, mirëpo mendon se ato vende që ia kanë dalë që Kartën e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut ta praktikojnë me

përpikmëri brenda ligjesisë dhe sistemit të tyre politik, rezultojnë shumë më shumë barazi shoqërore dhe racionalitet se sa gjithë të tjerat («Ideja e barazisë», München, 2012).

Shqiptarët po duket se nuk e duan marksizmin, neoliberalizmi nuk e di as vetë se çfarë dëshiron, demokracia e dëshiruar sabotohet nga mentaliteti dhe probleme e tjera specifike të brendshme, religjionet po na kërcënojnë me rende shoqërore që edhe në mesjetë kishin probleme legjitimimi. Një shoqëri të këtillë pa sistem dhe pa orientim nuk e do realisht askush. Mendojnë shteti, akademitë dhe «elitat» për këtë punë apo do të duhet ta pranojmë studimin e profesoreshës së etnologjisë kognitive pranë Universitetit të Göttingen-it Julia Fisher («Shoqëria e majmunëve», Berlin 2012) si sistemin më të mundshëm shoqëror. Më mirë se kështu! (2012)

PJESA E SHTATË  
*Religjionet*

***Platoni i ka të gjitha fajet!****Hyrje*

Pse duhet të tërbohemi kur ndonjë religjioz thotë se Hëna është prej çokollate? Në fakt duhet të qeshim – me kushtin që të mos jetojmë në Ballkan. Gadishulli ynë ende është zona ku irracionalët e kanë fjalën! Veprën e tij „Përvoja historike“ (Groningen: 1993) profesori holandez Frank R. Ankersmith e hap me këtë citat të David Humes-it: „Gjitha gjërat e të menduarit dhe studiuarit njerëzor natyrshëm mund të ndahen në dy kategori: në raporte të përfytyruara (Relations of Ideas) dhe në fakte (Matters of Fact)“. Duke filluar që nga Kanti e deri tek Quine, Goodman, Kuhn, Rorty dhe Faoucault nuk ka mbetur thujt asnjë filozof serioz që nuk i ka replikuar sensualistit dhe empiristit përherë të sëmurë e të vetmuar skocez. Sipas divizionit të listuar të mendimtarëve universalë, arkivat e dijes, kujtesës, ideve dhe artefakteve njerëzore nuk shabllonizohen dot në këto dy kategori të ngurta, ngase as fakti nuk legjitimohet dot si i tillë pa përfytyrimin, idenë apriori që ai të jetë fakti dhe as ideja ndërkaq nuk regjistrohet si e tillë pa e siguruar së paku një “corpus materialis”, një subjekt bartës të saj. E qartë: për gjithçka duhet ta kemi një ide nga ku nis udhëtimi ynë për ta racionalizuar apo për ta ruajtur si pasuri irracionale për nevoja, ta zëmë, të ruajtjes së kohezionit grupor apo shoqëror. Bota nuk popullohet vetëm nga racionalët. Përkundrazi racionalizimi i gjithçkaje – sado paradoks që të jetë – më shumë prish kompaktësinë e turmave, grupeve dhe shoqërive se sa i bashkon ato.

Le t'i përfytyrojmë pakëz shpendët, kafshët si qenie racionale; a do të shtegtonin në turma aq kompakte qiellit nga njëri cep në tjetrin të globit po të ishin specie racionale, sigurisht se jo, nuk do të kishin kohë ngase do të debatonin, hulumtonin, përlësheshin, çaheshin dhe ndoshta në fund duke përfytyruar se çfarë mund të ishte e çfarë s'mund të ndodhte do t'i vriste ndonjë befasi klimatike.

Ne mendojmë se Ankersmith, Kanti, Foucault & Kompani harrojnë (qëllimisht ose ne na duket ashtu) ta lexojnë Hume-n deri në fund duke u rrekur të kuptojnë për çfarë e ka fjalën: Është absurde të sugjerosh se Hume ndarjen e aktivitetit mendor e material njerëzor e paska bërë në dy kategori statike ngaqë qenkan dy pista rrugës për në adresën e njëjtë. Hume para së gjithash si historian dhe ekonomist synon ta zgjidhë një problem tjetër të përbotshëm e të përhershëm; formulimin e një konsensusi që do t'u shërbente dykëmbësorëve të egërsuar racionalë dhe irracionalë që mos shkaktojnë luftëra e ta prishin koekzistencën.

Faktin se përpjekja e Hume-t ende nuk ka përfshirë as sot në shekullin 21 një pjesë të madhe të mentaliteteve e kulturave të ndryshme, e dëshmoi polemika e fundit shqiptare rreth hoxhës prishtinas që mbështeste tezën se Sulltan Muratin të mos ketë ardhur me shpatë në Ballkan, por me hordhi sorrash për t'i sqepatur sytë e sllavëve që i ngacmonin shqiptarët. Si ide teza e tij mund të jetë sim- apo antipatike, mirëpo ç't'u bëjmë fakteve historike se?

Me këtë fjali të fundit erdhëm te tri singularët: Histori, Realitet dhe Njeri! Me këtë hyrje prekëm tri zona tejet ngucakeqe të pseudodiskursit aktual shqiptar.

## II.

Në një ceremoni turke i pari legal i myslimanëve të Kosovës tha se Sulltan Murati është gjallë dhe se nuk ka qenë pushtues ashtu si edhe perandoria osmane. Kjo do të jetë një ide, mendim i tij, sepse biografia studiuese e Naim Tërnavës nuk na jep asnjë element që ta besojmë që ai të jetë marrë me fakte. Në Medresenë „Alaudin“ ai ka mësuar bazat e Islamit. Në Kajro ka mbaruar filozofinë pranë shkollës „Usul-Ad-Din“ që merret gjithashtu me bazat e fesë islame, respektivisht pesë shtyllat: Tauhid (njëshmëria e Zotit), Adl (Drejtësia, barazia e tij), Profetësia (Nubuwwat), Imamti dhe Ringjallja (Qiyam- kush?), respektivisht jeta e përtejshme (Maad). Atje e këndej Tërnavë mund të ketë mësuar edhe paradigma perëndimore, si për shembull neoplatonizmin me dorën përpjetë, por jo historinë, historinë e filozofisë, metodat e hulumtimit shkencor, madje as të periudhës osmane në Egjipt, ashtu siç e përfytyron ai për shqiptarët, sepse në mësimet publike të vendit të atëhershëm postfaraonik dhe sekular, pushtimi osman ka trajtim racional njëlloj si tek popujt tjerë.

Nga ku pra Tërnavë e paska fituar bazën faktike për konstatimin e tij konfliktual?

Se problemi nuk qëndron vetëm tek Tërnavë irracional, por edhe tek perceptimi i mediave dhe publikut u pa nga reagimet e mëpasme. Pohimi i kryesajuesit të magjive transcendentale i tërboi mediat dhe shoqërinë civile. Përse vallë? Sepse nuk e sintetizuan atë thjesht si një masturbim fantazmagorik siç doli të ishte, por e trajtuan veç nga frika si diçka kontigente (që në ndonjë këndvështrim mund të ishte e vërtetë).

Një dilemë tjetër tashmë na shfaqet gjithaq: se a duhet të reagojnë në atë mënyrë mediat, dhe vetë shoqëria kur një person irracional lëshon një bombë sado absurde të jetë ajo?

### III.

Interesante në këtë kontekst është që t'i shikojmë debatet e zhvilluara në shtypin francez pas skicës, vizatimit të piktorit Salvador Dali (1947), i cili duke u nisur nga erotologjia platonike përqeshi në njëfarë mënyre perpjekjen e kontrahumëve për t'i shfaqur si diadë të harmonishme dy kategoritë e racionalistëve anglezë, duke e kryer këtë akt për ta acaruar edhe më shumë diksursin, duke fuzionuar qëllimisht dy polet në mashkull e femër sipas stereotipeve seksuale. Ndërkohë që religjionet u shkrinë duke e përvetësuar si qëllim të mirë studimin e Dalit, shkollat e ndryshme filozofike apelonin që ekscentriku të mos merret aq seriozisht se ishte thjesht një irracional. Në fakt Dali, po të ishte gjallë të njëjtën sintezë do t'ia bënte edhe diksursit shqiptar, do ta përqeshte dhe do të mbytye nga të qeshurat me dramën e mentalitetit ballkanik.

Veçanërisht pas debatit tjetër kontinental që shkaktoi filmi „The Rocky horror picture show – Give Yourself Over to Absolute Pleasure“ (1975) i Jim Sharman-it dhe Richard O'Brian, jo vetëm Dali, por të gjithëve do t'u binte të fikët nga sjellja e intelegjencave ballkanike ndaj referateve të fetarëve. Filmi – ku autorët hiperbolizuan skenat e Rok-skenave për të shtjelluar një „përrallë djallëzore që i ngjan përjashtimit nga parajsja“ – u shfrytëzua nga konservatorët ngutazi për ta shpallur atë si një dokumentar faktik mbi gjendjen dekadante të shoqërive perëndimore të viteve 70-80-ë, dhe shkaktoi një polemikë intelektuale që zgjati me vite e që përfundoi me biblioteka të tëra botimesh në këtë kontekst.



Dakort, nëse shoqëritë perëndimore e kanë zgjidhur këtë problem ato ballkanike ende jo sidoqoftë, prandaj edhe reagimi. Në shembujt më lart i bëmë si kronikë për të dëshmuar se shoqëria shqiptare ende nuk ka ecur polemikave e diksurseve të tilla as me film, as me pikturë, e aq më pak me filozofi. Prandaj edhe reagimi i ashpër i mediave dhe opinionit publik ndaj një fetari jokompetent as në filozofi e as në histori.

#### IV.

Seriozisht duhet të merren masturbime të tilla teofilike patjetër sepse siç pamë ato përçajnë shoqëritë skajshëm. Janë të rrezikshme.

Çfarë do të thotë kjo?

Të popullarizohet ideja humane e ndarjes së zonave intelektuale: religjionet janë irracionale dhe s'kanë pse merren me fakte historike. Sulltan Murati nuk është shpallur nga Vatikani apo Muhameti profet dhe figurë e shenjtë. Ai është dervish dhe figurë historike e dokumentuar deri në numërin e opingave majëpërpjetë. Imamati ka për detyrë të interpretojë atë çfarë shkruan Kurani e aty nuk përmendet Sulltan Murati, as Erdogani e me shumë gjasa nuk ka sesi të hyjë aty as vetë Tërnavë sepse paskësh përmendur në xhaminë e Sulltan Muratit, një emër vrasësi dhe pushtuesi – për këtë nuk ka asnjë dilemë racionale. Instancat religjioze po mos të qenë mashtrues eklatantë, do të duhej të thoshin gjithandej se mësimet e tyre janë irracionale, ide, hamendësime, besim që më së shumti mund të dalldisen duke supozuar se Paltoni me dorën përpjetë e kishte fjalën edhe për Allahun (çështje interpretimi), por më shumë se kaq jo.

Krejt fajet i ka Raffaeli që e vizatoi Platonin me dorën përpjetë. Apo vetë Platoni na i solli gjithë këto sherre? Përgjigje ndaj kësaj pyetje ka sepse kemi tekstet e Platonit:

filozofët islamë dhe skolastikët në përpjekjen e tyre për ta bërë filozofinë skllave të besimeve të tyre, përziën dy zona që edhe sot e kësaj dite bëjnë të mundur që të na shurdhojnë irracionalët me hamendësimet e tyre! (2015)

## *Ciankalizimi i frymës*

Pse aq lehtë u krijuan grupet radikale ndër shqiptarë? Ka kjo të bëjë me nivelin e ulët arsimor, me primitivitetin e përhapur apo se shqiptarët i përkohjnë asaj kategorie të masave që lehtë kapen fort pas modeleve të huaja kulturore dhe ideologjike sepse asnjëherë nuk kanë mësuar të merren me veten? Si emigrim pra nga vetja, shqiptarët i kanë gjetur modelet e gatshme, konceptet kulturore e morale që bien vazhdimisht ndesh me natyrën e tyre? Një misionar austriak i viteve 30-ë dhe Ortega y Gasset thonë se kështu veprojnë primitivët, ata që s'janë të aftë për të mësuar asgjë dhe që së tepërmi i urrejnë shkollat. Sa qëndron kjo kur shqiptarët i bëjmë objekt eksperimenti ndërkaq?

### I.

Misionari dhe etnologu austriak Paul Schebesta që hulumtoi në xhunglën tropikale me besimin se atje ndodheshin popujt më të vjetër të botës, në veprën e tij «Bambutët, xhuxhët e Kongo-s» (1932) shkruan: «Ata janë të paaftë për përqendrim. Ata janë aq thellësisht të mobilizuar nga ngjarjet e jashtme, saqë e kanë të pamundur të ndjekin ligjërimin. Uljen në bankat shkollore e përjetojnë si tmerrin më të madh. Prandaj edhe detyra e mësuesit dhe misionarit me këta njerëz është e pamundur» (Cituar sipas José Ortega y Gasset në «El hombre y la gente»: 1957). Nëpërmjet këtij definimi Schebesta dhe Gasset mëtojnë të përshkruajnë

stadin e kolektivit paraindividual, primitiv të njeriut, atë fazë kur njeriu nga mosnjohja e botës tëhuajësohet dhe jeton vetëm për të reaguuar ndaj faktorëve të jashtëm.

Çfarë nuk shkon këtu?

Boshti i teorisë është gabim sepse Schebesta përjashton veten: a nuk është edhe ai një «faktor i jashtëm»? Nëse xhuxhët nuk janë të aftë të brendëzohen për shkak të orientimit të ndjesive të tyre në favor të jashtësisë, atëherë përse nuk ndez ndërveprimi i Schabesta-s? Frustrimi i Shebestës pra është më shumë i një karakteri tjetër: xhuxhët janë rezistentë ndaj ligjërimit të tij si misionar e jo ndaj natyrës apo ambientit përreth. Sipas tyre primitiviteti del të jetë ai episod njerëzor ende jo i gatshëm për perceptimin e programeve të shumta kulturore. Xhuxhët e Shebestas janë të paindoktrinueshëm. Mirë a keq? Ta provojmë një paralelizëm me njeriun e këtij shekulli.

Në cilin stad gjenden shqiptarët kur kemi parasysh vijat e ngjashme të tyre me Bambutët?

Është i përbotshëm fakti se shqiptarët në përgjithësi nuk janë heronjtë e shkollës. Shqiptari historik deri tek ky i sotmi jo nga «primitiviteti» si bambutët, por gjithësesi duket t'i ketë rezistuar me shpërqendrim «ideologjive kulturalisht eksterne» për shkak të kauzës nacionale, kulturalisht interne të çlirimit fizik. Edhe atëherë, siç pamë pas rënies së monobotës së kuqe, kur janë treguar të intimiduar me këtë apo atë tufë idesh ekspansioniste, ata e kanë pasur thjesht për oportunitizëm e jo si shpirtërim.

Kur konsiderojmë ekzaminueshëm teorinë e Shebesta-s dhe Gasset-i si metodë për të hulumtuar shqiptarët, atëherë shohim se bambutët dhe shqiptarët jo nga primitiviteti, por nga refleksi i mbrojtjes dhe me synimin për të mbetur brenda natyrës së vet unikalë, kanë refuzuar modelet misionare. Ose kanë lejuar të influencohen vetëm nga ato ndikime që nuk kanë rënë ndesh me identitetin dhe formën e lirisë së tyre.

Për shkak të robërimit dhe kushteve të mbetjes pas dyerve të çdo zhvillimi, shqiptari nuk e njeh individualizmin. Gabimi fatal i komunizmit, që dërrmoi në këtë drejtim edhe shqiptarët, ishte paaftësia e tij që Njeriun e Ri ta ribëjë si Individ e jo siç e robotizoi në produkt të konstelacioneve kolektive, „një për të gjithë“ e ansjelltas, pra pa i siguruar atij së pari lirinë e njëshit për veten.

## II.

Sot kemi një shqiptar që ka jetuar: a) Në fazën e tëhuajësimit brenda shablloneve të imponuara e kulturalisht të huaja sepse i ka kapur ato si metoda të çlirimit fizik; b) Kemi anëtarin e kolektivit që «vita activa»-n e tij e bazon në ato koncepte të lehta indoktrinuese që konsumohen më lehtësisht (fetë, ideologjitë, moda). Shqiptarëve iu mungon stacioni i mesit: ai i «vita contemplativa»s (jo si veprim filozofik, por personal, individual), ai korridor që e bën njeriun racional, që ia mundëson individualitetin.

Institucionet e arsimit, shteti, shoqëritë shqiptare pikërisht në këtë fazë dështuan. Ata dështuan ta kapin shqiptarin e dalë nga kazermat e ideologjive të ndryshme dhe ta stërvisin atë me racionalitetin: nuk arritën ta edukojnë atë që para se të përballet me konceptet e shumta të tregut virtual e fizik, ai së pari të thellohet brenda vetes. Ai bëhet shpejtë islamist i mirë, radikal i dhunshëm, shndërrohet menjëherë në oksidental militant dhe intelektual neomarksist sepse gjitha këto janë oferta të gatshme, eksterne, skllavëruese që kërkojnë asketizëm për t'i pëlqyer Zotit, Perëndimit, konceptit të një rryme shoqërore, për të shkuar në parajsë e gjëra të ngjashme, por ato asnjëra nuk mund të jenë zgjidhja frymore, e aksionit, e individit në një situatë dhe kulturë krejt ndryshe nga ajo se ç'e dëshironte Marksi, Adam Smith, apo siç e ligjërojnë profetët e para dy mijë viteve në një gjuhë krejt

të largët. Vetëm „homo rationalis-i“ është në gjendje që nga të gjitha këto të zgjedhë më të mirat syresh për ta ndërtuar veten, për të qenë objektiv dhe që t'i shfrytëzojë modelet e shumta për realizim të vetes, të tjerët janë të instrumentalizueshëm, viktimat të atyre që i kanë mësuar përmendësh shabllonet dhe i përdorin ato me synimin makiavelist që të krijojnë zona sundimi.

### III.

Pindari në etikën e tij kondensueshëm prodhon imperativin «Bëhu ai që je». Paradoks? Jo. Një shembull konkret: Njëri që fal namazin, për shembull, përfytyron se si me një mercedes të tipit më të ri i kalon anash fqinjës dhe ajo i ngjitet në veturë dhe ia fusin për në Karaibe. Sapo ia shpon veshët zëri i imamit ai ul kokën dhe bën «subhanallah» dhe lavdëron Zotin, pejgamberët, fukarenjtë etj. Ëndrra e mercedesit dhe fqinjës janë Ai, ndërsa recitimi i lutjeve lavdëruese për Zotin janë të fesë. Të parat, të tijat, e detyrojnë atë të punojë e të pasurohet që të arrijë deri tek vetura luksoze dhe fqinja e tij seksi, ndërsa religjioni i thotë se kjo botë s'ia vlen fare, veç lutu e ulurij që të mos përfundosh në ferr.

Pra nga ky shembull shohim se vegjetimi, ky ciankalizim i vetvetes nuk është rezultat, siç pandehet rregullisht, i lapidares injorancë, primitivitet por efekt i dëshirueshëm i koncepteve apokaliptike fetaro-abrahamite, të cilat në unison njeriun e kanë shpallur qysh në gjenezën e tij si qenie që vetëm e vdekur, përtejtes, në «parajsë», ia vlen të jetojë. Ideologji, të cilat mallkojnë jetën dhe finalen e mirësisë e nisin me aktin e vdekjes e jo me atë të lindjes: njeriu si e keqja e kozmosit?

Dallimin ndërmjet këtyre dy botëve është në gjendje ta kuptojë vetëm reacionalisti, këtë faktor që e kemi me shumicë në perëndim, e gjen me plot mund në lindje. Tek shqiptarët

gjithashtu fort rrallë. Këtyre shtigjeve duhet të ecin elitat dhe shkollat tona nëse duan të kemi shoqëri individësh të painstrumentalizueshëm. Ndryshe s'bën!

## *Semantika paralajmëruese*

Nëpër filmat horror kemi parë atë skenën ku viktimat përpigën të tmerrojnë dhampirin duke ia mbajtur një kryq para hundëve.

Ose kemi shikuar mijëra skena ku ndonjë bukuroshe për mos u kafshuar në qafë zvarritet për të hapur perdet për ta shporrur lugatin me dritën e diellit. Si kryqi ashtu edhe drita e diellit në këtë rast janë simbole që përdoren kundër së keqes. Ato janë të tilla sepse ne si shikues i perceptojmë ashtu. Kryqi për shembull jo gjithkund perceptohet njëjtë: ka kultura ku ai shihet si shenjë e gozhdimit, brutalitetit e në tjera konsiderohet të jetë simbol i viktimëzimit të perëndisë për çmëkatimin e njeriut.

Pra kryqi varrësisht nga rajoni e kultura ka kuptim tjetër perceptues. Ndërsa drita pothuaj në mbarë globin ka kuptim të njëjtë, pra pozitiv dhe si simbol është universal. Gjersa simbolet pozitive depërtojnë shumë më rëndë në stadin e semantikës universale ato negativet shpërndahen si rrufe dhe fiksohen në mendësitë e kulturave të ndryshme me një shpejtësi marramendëse.

Varrësisht nga ideologjia që transportojnë ato, merren si shenja për të identifikuar një mesazh politik, fetar, kulturor, apo grupor dhe ngase negative perceptohen edhe si frikë, kërcënim ose si flamuj të luftës, martirizimit, eksploatimit, pushtimit. Hiç më vonë se dje u pa se ç'force kanë madje edhe pozat e inskenuara me njerëz që konsiderohen si simbol i së



keqes brenda një kulture të caktuar. Imami Shefqet Krasniqi qëmoti sidomos në Zvicër, për shkak të lidhjeve të tij me një grup talibanesk e që funksionon si filiallë për menaxhimin e kapitalit të organizatave islamike, konsiderohet figura kosovare e rrjetit për furnizimin e terrorizmit.

Fotografimi i tij me Xherdan Shaqirin nxitë skandal, sepse i fundit luan për nacionalen zvicerane, pozë që sugjeronte: koketimin e terrorit me sportin zviceran! Deri para marrjes së pushtetit nga Homeini, shamija, ferrexhet dhe mbulesat tjera të botës islame nga të tjerët konsideroheshin si elemente kostumografie ekzotike, folklorike, pra elemente që u përkonin kulturave të caktuara.

Homeini ishte ai që gjatë revolucionit të tij i politizoi këto duke i shpallur semantikë politike për të paralajmëruar ose kumtuar depërtimin e islamit gjithandëj ku jetonin myslimanë. I njejtë politizim ndodhi më vonë edhe me minaren perëndimit nga shoqata të ndryshme radikale islamike, të cilat e ngritën atë në shenjë të simbolit politik, ngase as fetarisht e as teknikisht nuk e arsyetonin dot. Kohëve të fundit pas shfaqjes së ISIS kësaj semantike i janë shtuar edhe gishti përpjetë dhe mjekrra pa mustaqe. Masivizimi dhe popullariteti i kësaj semantike nuk ekzistonin para shfaqjes së grupeve terroriste.

Po pas shfaqjes së tyre këto shenja mbrritën edhe në hapësirat shqiptare. Vetë kronika dëshmon se depërtimi i këtyre simboleve dhe sjelljeve vjen ndër shqiptarë veç pas daljes në skenë të islamizmit luftarak dhe terrorist. Pra burimi origjinal i semantikës janë Al – Qaida, ISIS dhe grupet tjera islamike terroriste në Lindje e gjetiu.

Më herët ato as që janë njohur në ballkan e madje as në vendet e shumta të botës sot islame. Arsyetimi i shumë klerikëve dhe politikanëve që operojnë me këto simbole e sjellje dhe që thonë se ISIS e tjerët i kanë keqpërdorur shenjat

në fjalë nuk mund të besohen, sepse nuk kanë përgjigje ndaj pyetjes: pse pikërisht pasi që ato u keqpërdorën nga fanatikët i zbuluat edhe ju? Pse jo më parë? Pra arsyetimi është i rrejshëm, dyftyrësh ose aktrim për t'i ikur ndjekjes ligjore.

Dyftyrësh për arsye se plotë shqiptarë i bartin ato edhe për çështje parashë, nuk janë fanatikë por për çështje interesi ekspozohen tek radikalët si figura të tyre dhe aktrim është justifikimi të mos jenë radikalë dhe pro kalifatit. Me këtë njohuri dhe vetëdije pyesim: Pse në mënyrë grupore e çojnë gishtin përpjetë ushtarët e kazermës “Skënderbeu” të Ferizajit? E para; ata nuk i kanë uniformat e FSK-së dhe nuk hanë bukën në kazermën e shtetit për të bërë rituale fetare e për më keq të demonstrojnë simbolin e njëjtë me ata kokaprerësit e ISIS-it?

Po të njëjtën eskpadë e bëri edhe kryetari i Gjilanit Lutfi Haziri duke mbledhur gjithë LDK-në dhe politikanë të partive tjera për të çuar gishtin për një fotografi, një e tillë që përdoret nga kushdo botës për të dëshmuar Kosovën si shtet islamik radikal. Gishti përpjetë, shamia, mjekra pa mustaqe janë sot semantika që nga dy botët e ndara (orient – oksident) konsiderohen në dy kuptime kryesore: nga perëndimi ato merren si shenja demonstruese të pushtetit islam politik pra si paralajmërim të inslaimit të shariatit, ndërkaq nga islamistët ato përdoren ato për të manifestuar vullnetin e tyre luftarak në pushtimin e botës dhe përhapjen e islamit politik – qoftë edhe nëpërmjet të terrorit.

Kush e i përdor këto simbole publikisht dhe me demonstrim – le të thotë çka të dojë për veten – ai/ajo përceptohen në botë ose si luftarakë për kalifat osi si përkrahës të terrorizmit islamik. Ky është realiteti. E sa për të qenë i devotshëm si mysliman nuk nevojiten shenjat optike, simbolika sepse Zoti i sheh si ashtu të gjitha – apo jo? (2015)



## *Fanatizimi për identitet*

Përpjekje për të depërtuar në psikën e ekstremistëve. Ku janë gjithandej – fanatikët brenda etnohartës shqiptare? Ata nuk kërcejnë lavshëm – siç pandehim – vetëm nga fundësia ekstreme e fesë së konsideruar shumicë, por i hasim po aq historikë edhe kategorive të tjera: manistët, ateistët, etnocentrikët dhe neomarksistët nuk janë më pak agresivë. Si t'i kuptojmë? Ose ku na çojnë?

Veçanërisht gjenerata e hershme e historianëve të filozofisë, alergjinë e Paltonit ndaj doxa -s (mendimit të lirë, publik) dhe përjashtimin e retorëve gojëflakë nga shteti i tij e shpjegojnë me formimin e tij në kushte të luftës permanente. Platoni rritet dhe formohet në kohën e luftërave të Peleponezit dhe gjatë pushtimit spartan. Lufta që e skëterrosën Athinën aq fort sa që nuk mori veten as pas shuarjes së kryefilozofit postsokratik. Në shumicën e dialogjeve dhe në vetë kryeveprën e tij „Politeia“, megjithatë një episod nga jeta e tij identifikohet si më ndikuesi; koha e sundimit të „Triakonta Tyrannoi“-ve (tridhjet tiranëve). Për gjatë tetë muajve Athinën (Gusht 404 deri në Mars 403) e sunduan tridhjetë oligarkë kriminelë, të cilët brenda një kohe fare të shkurtër ekzekutuan 1500 kundërshtarë politikë. Çdo ditë, në Agora (vendi publik i debateve) të Polisit, shfaqeshin oligarkët luftarakë dhe nxisnin për debat të lirët, që pastaj natën t'i masakrojnë e çojnë në botën e përtejme. Platoni gjithandej opusit të vet përpiqet ta diagnostifikojë këtë tip manipulatori dhe jo rrallë e stampon atë si „poet“, jo për shkak të retorikës me rimë gati homerike, por për shkak

shpikjes së *momentumeve* kuazireale me synimin për t'i greminuar naivët gojë - e syhapur që rrinë ulur shkallëve të Agorës. Platonin e tërbonte suksesi i oligarkëve vrasës, sepse ishte i bindur se ata nuk i njihnin as ata që mbronin e as atë që i sulmonin.

### *Asketët e Nietzsches*

Gjatë polemikës që u përndez së fundi hapësirave debatore, miniagorave shqiptare, si pasojë e rrëzimeve, fyerjes dhe përçmimit të personaliteteve shqiptare si Gjergj Kastriot dhe Nënë Tereza, analizuam eksponentët kryesorë të palëve në diskutim. Ata të krahur fetar që të plasnin sy, tru e shpirt me mosdijen e tyre, dhe me dhunë të detyronin ta marrësh në duar „Gjenealogjinë e moralit“ të Friedrich Nietzsche dhe dhjetëra herë ta lexosh përgjigjen që ai i jep pyetjes: „çfarë duan të thonë idealet asketike“? Dhe Nietzsche e shpjegon çështjen, konform realitetit të atëhershëm: Inferioriteti, i pakënaqur me situatën e tij anonime në shoqëri, rebelohet për t'u tjetërsuar. Për tu pasuruar me kulturë, dije. Mirëpo meqënëse lufta e tij nis nga pozita zero, dmth nga instinkti, është e ngutshme, shpirtkafazuar, ai paragjykon, prodhon frikë, rreziqe që nuk është në gjendje as t'i përshkruajë e lëre më që pastaj t'i argumentojë. Mirë kjo për shekujt që shkuan ai, po përse kanë nxitësit e tillë sukses edhe në këtë shekull ndërkaq? Dhe përgjigja tipike nietzsche-ane: Urrejtja ka përparësi në dyluftim me çdo emocion apo tufë tjetër ndjenjash sepse është me e shpejtë, përfshirëse, bën tregti me spontanitetin duke e nderur atë llavë sa herë që të shfaqet, i mjaftojnë vetëm do agjitorë kaste që të fillojë rreshtimi i kopeve brenda turmës.

Po në këtë përshkrim të Nietzsches mirëpo as që mundemi t'i përjashtojmë, as platonikisht, edhe manistët etnocentrikë, neoateistët luftarakë që thuajse po shndërrohen

në sekt të veçantë dhe neomarksistët që me parrulla, njëlloj si fetarët flasnin për „shumica, për identitete“ e çmos më tepër, pa dhënë si dëshmi qoftë edhe një peticion të familjes së ngushtë që të jetë e atij mendimi.

Origjinën e tipit të agitatorëve mund ta shpjegojmë me Platonin, me Nitzschen dhe me vetë historinë më të re shqiptare; shumica e tyre janë rritur dhe formuar në kohë retorikash agresive, në kohë luftërash dhe masakrimesh. Agorat (ku bëjnë pjesë edhe media të caktuara) shqiptare as sot nuk dallojnë shumë nga ato që kishin pushtuar oligrakët vrasës të Athinës. Kjo mund të thuhet edhe për realitetin e shoqërive shqiptare, e cila mbytet e vdiset për çdo ditë nga oligarkët e sotëm të tyre, të cilët jo vetë, për çështje maskash, por si agitatorë kanë angazhuar klerikë, injorantë, turbopatriotë e plot të tjerë kulturëmangët.

### *Epilogu i çdo fanatizmi*

Tani pyetja se ku i çojnë ekstremistët e tillë shoqëritë shqiptare?

Tregimi i Hermann Hesse-s mbi „Fundin e Dr. Knölges“ (1910) edhe sot e kësaj dite përbën psikografinë më të shkëlqyer mbi njeriun që kërkon parajsën e përmasave utopike e ku në kor bëjnë pjesë të gjithë ata që me radikalizëm e përgënjeshtrojnë tjetrën: Për shkaqe të shëndetit filologu Dr. Knögle bëhet vegjetarian. Lë punë e vend dhe ia mësyn botës për të kërkuar shoqërinë e përkryer ku bashkëjetojnë vetëm vegjetarët, vegjetarianët, frugivorët (frutangrënësit) e të tjerë të llojit të tyre. Nga shokët e diktaturës së vegjetariatit mëson se në Azinë e vogël është krijuar një mbretëri më vete me emrin Quisisana vetëm për njerëz si ai. Dr. Knögle si fanatik i doktrinës që është shndërruar, pranohet menjëherë atje. Atje mirëpo frugivorët bëjnë probleme se nuk i durojnë njerëzit që përveç frutave hanë edhe perime. Jonasi njëri nga frugivorët

me nofkën „Gorrila“ e sulmon Dr. Knögle dhe ky budallai, nxehet dhe kapet me të. Jonasi e vret doktorin – kaq e pati edhe parajsa. (2014)

*Ultima ratio**Hyrje*

Dikush i hoqi kapakun shishes magjike; nga gryka e saj nuk i doli korrieri ekzotik për t'ia plotësuar dëshirat, por përkundrazi nga aty i shpërthyen shpirtrat e muxhahidëve autobombë dhe ata të kalorësve të inkuizionit dikur oksidental e sot oriental. Ka kohë që lugetërit e rizgjuar, fanatikët e çdo feje e sekti paskan bërë diellin, eterin e qiellin përmbi shqiptarë pistë irfanësh, urbanësh, pseudoprofanësh që në trans mezi pritkan sinjalin hyjnor që t'ia heqin kokën vetes dhe tjerëve përreth.

Po analizuam distancuar polemikat rrjeteve sociale, komentet e apelet mediave, dy pyetje imponohen si start diskursi: Paska qenë edhe toleranca aq e lavdëruar ndërfitare tek shqiptarët një mit kot? Dhe e dyta pyetje, më shumë diagnozë: vлека ajo hipoteza që thoshte se sa më shumë të humbë terren lufta kundër armikut të jashtëm aq më e ashpër bëhet lufta kundra armiqve të brendshëm?

## 70.1. JAHWE E ALLAHU ME TIRQ

*Prada e fanatikëve* - Konflikti u aktivizua qysh me publikimin e parë të kushtetutës së shtetit kosovar.

Klerikët e religjionit më të „madh“ [spekulim është: viteve të fundit sidomos në Kosovë ka një rikonfigurim kompleks në lidhje me përkatësinë fetare. Grupi i refuzuesve të konfesioneve klasike abrahamite është shumë më i madh se sa perceptohet. Po ashtu numri është i madh i atyre që ndihen të besimit të krishterë e llogariten në statistika si myslimanë,



etj.] protestuan kundër përcaktimit laik e sekular të vendit të tyre.

Ca kohë më vonë kërkuan legalizimin politik e juridik të shamisë si simbol identifikues religjioz institucioneve publike. Në shenjë proteste kundër prezencës së katedrales katolike disa organizata myslimane kërkuan ndërtimin e një katedraleje, respektivisht xhamie islame. Partisë islame të Drejtësisë iu shtua edhe ajo e më fanatikëve „Bashkoku“.

Viteve të fundit imamë e agjitorë të ndryshëm që numërohen në taborin në fjalë, shpallën Islamizmin (doktrinën) si mburojë të identitetit shqiptar; reduktuan heroin dhe kryemitin e shqiptarëve Gjergj Kastriotin në primat katolik/ortodoks, ia dhanë të famshmes shqiptare Nënë Tereza biletën për në „xhehmem“ dhe „epoletizuan“ gjitha femrat shqiptare pa shami e burka me etiketën serbishte „kurva“. Aktiviteti, strukturat dhe kronologjia nuk lënë vend për hamendje: islamistët kanë strategji, program, agjendë dhe financa të rregullta.

*Ku shteti?* - Kundër këtij zhvillimi natyrshëm reagojnë pjesët joislamiste të shoqërisë. Ato që frikohen se lëvizjet radikale janë në rrugë e sipër ta çmontojnë demokracinë, shtetin dhe të instalojnë sheriatin. Frika – kur kemi parasysh gjendjen e përshtuar lartë – është më shumë se e arsyeshme. Kisha katolike nga halli i bie fyellit të ekumenizmit dhe gabon duke lëshuar komunikata që më shumë acarojnë polemikën se orientojnë atë: vota e saj në rastin e muxhahidit nga Shkupi Kim Mehmeti më shumë u perceptua si tendencë e këtij institucioni për të monopolizuar historinë e mbrojtjes së identitetit shqiptar se sa shqetësim legjitim në mbrojtje të vlerave evropiane shqiptare.

Reagimi i shtetit pothuaj nuk ekziston. Partitë në qeveri e afër saj numërojnë vota e aleatë dhe nuk kanë kohë të merren

me ruajtjen e rendit dhe sistemit. Deputete e pjesë intelektuale të shoqërisë kundërshtojnë marshin aktual të të „sëmurit nga bosfori“, mirëpo konform buxhetit të aspaktë nuk arrijnë të mobilizojnë opinionin.

*Polemikat* - Problem i njëmendtë apo i kamufluar? Panik kot, histeri apo eutanazi siç analizojnë areligjozët? Përtej polemikave e zyrave planifikuese të religjioneve, syhapur, irrituar e objekt gjahu rri i zakonshmi, i „vdekshmi“, i cili për shkak të gjendjes së rëndë sociale ia jep shpirtin të parit që e vëren atë. E ne pikërisht ky, i „vdekshmi“ jonë na intereson, ai që nuk ka të holla për të blerë e lexuar edhe mendimin jashtë kopertinave të ndonjërit nga librat e shenjtë, që në fund vetë të vendos se ç’donë të bëjnë me vullnetin e tij të lirë. Në disa vazhdimë ne do të parashtrojmë pyetje dhe do t’iu përgjigjemi atyre me gjuhën, argumentet, tezat e antitezat e myslimanit, të krishterit, manistit, deistit, ateistit, gnostikut e kështu me radhë që në fund në sajë të kësaj matematike faktesh të përpiqemi për një analizë sa më të paanshme, objektive. (2013)

## 70.2. FÉ SE FRIKË

Arkeologët thonë se frika ka qenë motivatori zanafillor nëpër artefaktet me karakter religjioz. Jo pa të drejtë: Të parat vizatime e skica, të zbuluara shpellave të orientit (datuar dyzet mijë vjet para e.s.) ekspozojnë dukuri, momente dhe figura që në atë kohë janë konsideruar si rreziqe konkrete për njeriun. Paleontologu francez André Leroi-Gourhan [Religjionet e parahistorisë; 1981] është i sigurt se veçanërisht frika nga e panjohura, padija është burimi i çdo feje. Të njëjtin shpjegim e gjejmë gjithandej teksteve antike: Në një satirë (450 para e. s.) që i mvëshët dajës së Platonit Kritias e që mendohet ta ketë shkruar Euripidi, Sizifi thotë:

*«Na ishte njëherë një kohë kur njerëzit jetonin pa rend, njëlloj si shtazët grabitqare me dhe nën thundrat e dhunës më primitive. Atëherë të mirët nuk shpërbleheshin dhe të këqijtë nuk dënoheshin [...] pasi njeriu nga njeriu s'kishte frikë, të mençurit shpikën zotërat, ata që shohin gjithçka dhe dënojnë (apo shpërblejnë) gjithkënd për veprimet që i kryen në tokë»*

në këtë mënyrë sofistët të parët denoncojnë instrumentalizimin e frikës ndaj perëndive në favor të rendit, ligjit dhe koekzistencës postbarbare. Edhe fjala Religjion është konform këtij shpjegimi satirik: ajo burimin e ka në religio-n ose relegere-n latinishte që do të thotë: respektim i rregullave dhe shenjave!

*Humanistët* – Nga kjo traditë arsyetimi nisej edhe Islamologu Prof. Dr. Josef van Ess kur shkruante: «sa më i arsimuar dhe sa më i perëndimorizuar të jetë fetari, aq më shumë tërhiqet në privatësinë e tij dhe i bindet sekularizimit si formë të vetme harmonie shoqërore» [Pesë fetë e mëdha: 1991].

*Neoteistët* si Christopher Hitchens, Daniel Dennett, Michel Onfray, Sam Harris dhe Richard Dawkins e përdorin pikërisht këtë teori për t'i kategorizuar fetë si «fabrika idiotësh që kanë për qëllim sundimin nëpërmjet frikës, kërcënimit, poshtërimit të qenies njerëzore dhe përdhunimit e inteligjencës së njeriut». Jo kështu ashpër, por me burime të pakontestueshme historike argumenton autori i mëse 50 studimeve mbi kulturat dhe religjionet dhe njëri nga shkenctarët më të vlerësuar në lindje dhe perëndim Jan Asmann. Në veprën e tij «Dallimi mosaik (Moses, Musa) – ose çmimi i monoteizmit» [2003] Asmann që nga primatët e

religjioneve pranohet si neutral dhe religjionet monoteiste i konsideron si burimin e intolerancës, dhunës, përjashtimit dhe urrejtjes.

*Religjionet* natyrshëm kundërshtojnë tezat e kundërshtarëve të tyre duke argumentuar me ortodoksinë se besimtari i sotëm jo nga frika, por nga nevoja për mbrojtje, vetëkontroll, shpresë në pavdekësi, meditim dhe respekt ndaj traditës kulturore e shoqërore ushtron realigjiozitetin e tij. Kjo është edhe ortopraktika e shumicës së besimtarëve të pesë feve të mëdha.

*Analiza* - Neoateistët shikuar nga perspektiva e të gjitha dokumenteve të lirisë dhe të drejtave të njeriut, ushtrojnë racizëm kulturor ndaj gjithë atyre që moralin personal e arsyetojnë me fetë. Humanistët dhe neutralët vazhdojnë qëllimisht ta shfaqin vetëm njërin anë të medaljes – atë negativën. E se kjo e fundit aspak nuk iluminon, por vetëm dëmton, e dimë ndërkohë të gjithë.

Pas Iluminizmit, sekularizimit dhe ngulitjes së demokracive sidomos në sferën përëndimore të Europës, padija dhe frika edhe pse ekzistente, tashmë nuk përbëjnë më instrumentet kryesore të shumicës së feve të mëdha. Ato më shumë i përkojnë etikës së individit fetar se sa ndonjë programi misionar. Ose atyre nuk iu lejohet një mundësi e tillë. Problemi – që te krishterët është hipotekë historike sepse deri para epokës së sekularizimit fillimisht krishterimi dhe pastaj kisha katolike kanë përdorur frikën për dhunë, kanë instrumentalizuar për të sunduar – në kohë tjetër dhe në sfera të tjera është shfaqur në Lindje dhe në pjesët e tjera ku ekstremistë myslimanë luftojnë për islamizimin e shtetit. Kështu që myslimanizmi sot bën më shumë luftë me rrymat e shumta radikale brenda vetes se sa ka ndonjë mision.

Grupet të cilat me dhunë dhe terror duan të kapin, asimilojnë ose asgjësojnë shtetet dhe madje botën nëse ato nuk pranojnë diktatin e tyre, përbëjnë sot imazhin edhe të vetë Islamit. Mirëpo, po studiuam e analizuam gardën e liderëve të këtyre rrymave, programet dhe strategjitë që ata kanë, nuk na duhet shumë zgjuarsi të konstatojmë se në thelb nuk kemi të bëjmë me ndonjë mision «islam», por më shumë me aspirata grupesh që duke frikësuar e keqpërdorur masat e tyre popullore të sinqerta e të painformuara, duan të kapin pushtetin në vendet ku operojnë.

### 70.3. DHUNË HYJNORE?

Si erdhën religjionet tek shqiptarët? Dy pseudoparadigma mbizotërojnë opinionet: njëra palë thotë se religjionet u imponuan dhunshëm e brutalisht, tjetra beson se Zoti (njëri prej tyre) pasi eroj e shpëtoi gjitha racat e turmat orientit u përball me kontestin: t'i fuste shqiptarët tok me kafshët në kopenë e të pafeve apo t'i pneumonte edhe ata me shpirtin e shenjtë? Dhe për fatin e mirë apo të keq të shqiptarëve do prej tyre i fryu, të tjerëve, kokëfortëve ua dërgoi ca barbarë e «kanibalë» që t'i lakojnë drejt Jerusalemit, Mekës apo Vatikanit.

Kështu shpjegohet popullorçe publicistikës bjerraditëse shqiptare ardhja e religjioneve Ballkanit e botës. Cergurina areale, ashkencore?

*Faktet* – Së paku që me pagëzimin e trakasit nga Dacia mediterranea e prefekturës së Illyricum-it Petrus Sabbatius, alias Justinian si perandor më 1 janar 528, disponojmë me tonelata fakte që flasin për gjenocide fizike dhe kulturore në favor të përhapjeve së religjioneve. Që me firmosjen e dekretit të parë justinianik, i cili shpalli perandorinë të krishterë dhe kërkoi nga çdo banues ta mësonte përmendsh dhe ta

zbatonte *codex Iustinianus* –in, nisin fushatat gjenocide ndaj paganëve, heretikëve, heterodoksëve dhe gjithë atyre që refuzonin krishterimin dhe perandorin si *ek theou* (zëvendësim i Zotit në Tokë).

Së paku prej shekullit VII e këndej, prej kur shpatat e kalifëve Umar ibn al-Kattab dhe Utman ibn Affan shndërruan orientin (Irakun, Sirinë, Palestinën, Egjiptin dhe Iranin e sotëm) në thertore njerëzish e kulturash nuk mund ta ndajmë historinë e përhapjes së religjioneve nga ajo e dhunës dhe kimit. Kjo mënyrë përhapjeje, lufte e eksploatimi vazhdoi deri para instalimit të shekullarizimit që e pollën Revolucioni francez dhe Socializmi.

Këto janë faktet. Ky është realiteti historik.

*Shqiptarët* – Ilirët e më vonë shqiptarët historikisht nuk përbëjnë taborin e të kursyerve nga dhuna religjioze. Religjionet e sotme abrahamite ndër shqiptarë janë finale e kësaj historie. Mbase qëndron teza se inteligjencia religjioze brenda debatit aktual ndërshqiptar qëllimisht përpiqet ta fshijë nga kujtesa dhunën historike të feve sepse curriculumi i tyre (feve) ose është plotësisht në kundërshtim me atë çka besojnë ose sepse mënyrat e përhapjes së dikurshme demaskojnë strategjitë e sotme të tyre. Përderisa të krishterët e bëjnë mohimin për shkak të kundërshtisë totale të historisë luftarake me «dhjetë urdhëresat» (aseret ha-dibberot ose deka – logos) e Moisiut dhe «Predikimit në mal» (Mt. 5–7), myslimanët që akuzohen të «egër» dhe «terrorist» përpiqen me çdo kusht të instalojnë imazhin e paqësorëve.

Në këtë sqarim mund të identifikohet edhe esencialiteti i polemikës shqip, respektivisht arsyeja se pse ajo ec në këto dy linja: A) Krishterimi ndër shqiptarë është përhapur qysh në kohën e ecejakeve të Palit Ballkanit e jo me ndëshkime. Krishterimi i ka shpëtuar shqiptarët si identitet dhe kulturë

nga sundimi shumëshekullor osmano-islam dhe B) Përhapja e besimit muhamedan ndër shqiptarë është bërë ndërmjet kolonisë ose klanit tregtar mekan Mahzūm që operonte nga Sheva (Shoa) amariko-etiopeke e jo me shpata. Islami shpëtoi shqiptarët nga sllavizimi.

*Analiza* – A) Ka mbishkrime e kronika antike që dokumentojnë krijimin e komunave të krishtera ndër ilirë. Mirëpo ato nuk mjaftojnë për të përkrahur tezën e konvertimit me dëshirë të masave. E kundërta ta mbushë bibliotekën me fakte: Përhapja masive e krishterimit vendbanimeve ku lokalizohen ilirët ndodhë më vënien si kushte ekzistence pranimit e religjionit perandorak dhe organizimin në kisha. As në kronikat e Shevës e asnjëherë më vonë (kronikat osmane) nuk gjejmë indikacione për asimilime pa dhunë. Çka gjejmë janë deplacimet e familjeve të «tregtarëve ambasadorë» qendrave të Ballkanit, kryesisht «administratorë» të përkohshëm. Padyshim se ka ndonjë që nga «qejfi» ka pranuar ndonjë nga fetë, mirëpo ato nuk kanë asnjë vlerë relevante historike në procesin e asimilimit masiv të popujve të Ballkanit.

B) Është fakt që nuk kontestohet se rezistenca kryesore antiosmane është organizuar e udhëhequr nga klerikët katolikë shqiptarë që nga mesjeta e deri në Kongresin e Alfabetit në Manastir; është e mëdukshme se i gjithë arsenali faktik e historik kulturor shqiptar nga mesjeta e deri në Rilindje ruhet e zhvillohet nga po të njëjtët ashtu siç është i pakontestueshëm fakti se kultura shqiptare (artet dhe «shkencat») janë produkt i kësaj tradite. Fakt është gjithashtu se klerikët e Rilindjes nuk kanë vepruar të organizuar për interes të fesë, por janë udhëhequr nga doktrina e tyre shqiptariste. Se cili është roli i Islamit, respektivisht myslimanëve në mbrojtjen e shqiptarëve nga asimilimi sllav – në kollumnën e radhës!

#### 70.4. ISLAM APO IMAN?

*Dje* – «Mo luni football se bëni gjynah, është isto sikur me lujt me krajen e Muhamedit» u thoshte hoxha fëmijëve që nga frika shtangeshin si statuja. «Po rajtet cauca, po rajtet», e sinjalizonte imami ndonjë prind, vajza e të së cilit sapo kishte filluar t'i japë shenjat e para të femërisë. Prindi i zënë keq e në turp me vajzën që po i bëhej «grua» ia kthente klerikut të bërë hundë e buzë: «Ëni be hoxhë ëni, çë ene ni mot e sosën tetëvjeçaren ene e martoj. Mo ma baj gajlen se nauk e lë t'boet shkinë».

Listën e sekuencave të tilla mund ta vazhdonim deri në pafundësi. «Udhëzimet» e klerit mysliman në Maqedoni dhe viset tjera të ish – Jugosllavisë nuk preknin vetëm sportin, seksualitetin dhe arsimin, por ato ndikonin në çdo segment të përditshmërisë shqiptare: Aty ku nuk ndiznin «arsyetimet reale» përdoreshin besëtytnitë, hajmalitë dhe presioni i grupit apo edhe asistencë e shërbimeve të sigurisë së shtetit.

Nisur nga kjo atmosferë lehtë kuptojmë se pse veç në fund të viteve të tetëdhjeta ca familje morën guximin që të shpërfillin diktatin e imamatit duke lejuar ndonjërin nga vajzat që të shkonte në shkollë të mesme, edhe pse kjo ndodhte përmallë, shumë rrallë [në 10 mijë banorë vetëm një apo dy vajza shkonin në shkollë të mesme].

*Sistemi* – Kjo metodë veprimi e klerit mysliman shqiptar nuk u ngrit mbi rrënojat e ndonjë tradite përkohësisht të suspenduar nga «komunizmi» e që si program e anakroni do të riaktivizohej do dekada më vonë, por ishte më tepër zanafilla e një dukurie të re. Kështu sepse jo vetëm nga opusi letrar, por edhe në burimet tjera të kësaj periudhe mësojmë për pjesëmarrjen aktive të hoxhallarëve në luftërat e



ndryshme [deri pas mbarimit të LDB-së] për formimin kombëtar të shqiptarëve. Madje disa prej atyre imamëve, në portretim e sipër, dalin të kenë qenë edhe megancionalistët e orëve të para dhe për më tepër disa prej tyre dalin edhe si rezistues aktivë karshi versionit të Mit'hat Frashër Beut (ideologut të ballistëve) që turqishtja të merrej si bazë e alfabetit shqip.

Dikur, pas «kthesës së madhe» të Titos [zbutja karshi religjioneve dhe braktisja e elitës pansllaviste serbo-moskovite] në fund të viteve të 60-ta, edhe në viset e banuara me shqiptarë u intensifikua organizimi hierarkik, sistemor dhe faktorizues i Bashkësive Islame. Qëkëtej – madje mund të datohet e përshkruhet me një saktësi të tmerrshme – nis edhe forma e ligjërimit dhe veprimit siç e pasqyruam në fillim të kësaj kollumneje: destruktive, diskriminuese dhe stagnuese.

Tezën; hoxhallarët të kenë vepruar ashtu vetëm nga «injanca e tyre personale» e përmbys koherenca e sistemit, uniteti në propagandë i të gjitha bashkësive në ish-Jugosllavi si dhe krahasimi me bashkësitë tjera fetare, të cilat edhe pse të nënshtruara nuk i shërbenin sistemit e pushtetit me aq servilizëm e militantizëm sikur myslimanët. Pse vetëm ndër shqiptarë veproi kështu kleri mysliman?

*Analiza dhe sot* – Nga dy alternativat; ndërmjet hoxhës shqiptarist dhe atij servil (propushtetit jugosllav), një pjesë e konsiderueshme e klerit të sotëm myslimanë kanë zgjedhi të dytin si model. Për arsye se «karakterit» i dytit përmban në vete edhe mundësinë e internacionalitetit, çka i pari, ai shqiptarocentrik e përjashton. Ulërimat e imamëve: «po humbin vlerat, morali dhe nderi» shqip do të thonë «nuk na ec fjala si etërve tanë në kohën e Titos» e jo se dikur paska sunduar ndër shqiptarë sheriatit e tash s'qenka më. Sulmet ndaj religjioneve tjera e veçanërisht atij katolik kanë të bëjnë

më shumë me pseudokonstatimin klerikal: «e gjithë kultura, me këtë edhe identiteti shqiptar është kap në kurth të versionit katolik – properëndimor», çka implikon perceptimin e identitetit ekzistues shqiptar si konkurrencë dhe pengesë të ndonjë tjetrit. Kujt?

Problemi buron nga një kontradiktë e përjetshme interislame. Baza e çështjes së pazgjidhur fillon në suren 3:19; «Si religjion te Zoti vlen vetëm Islami», potencohet në 5:3; «unë zgjodha islamin si religjionin tuaj» dhe vulozet në suren 49.16 të Koranit ku arabët detyrohen të përsërisin «ne pranuan Islamin»! Drejtëlexuar: jo pranuan imān –in (besimin) por islām-in (religjionin). Ku është dallimi këtu? Që nga paramoderna e deri sot shumica e dijetarëve islamë kërkojnë që në fillim të favorizohet imān –i si mjet ekspansioni e jo islām-i, sepse i fundit perceptohet edhe si identitet, hapësirë kulturore, etnologjike, sociale e ekonomike me arabët si primatë dhe si i tillë krijon konflikte me identitetet tjera nacionale.

Me të drejtë.

Për çka?

Ngase Islami në vete më shumë se sa besim (për mu'minin – edhe në Koran del sekondare) funksionon si sistem, identitet me synimin fundamental e kapital për të «rregulluar» mbarë jetën e një shoqërie, shteti, kombi. Apo është ndryshe? Si e debatojnë myslimanët shqiptarë këtë konflikt? Hiç? Si e perceptojnë ata veten ndërmjet imanit dhe islamit? Si do të reasonin myslimanët po që se shtetet shqiptare do të kërkonin nga Bashkësitë islame të marrin qëndrim të prerë pro iman-it apo islami – t, pra të vendosnin bashkë me të gjitha fetë tjera ndër shqiptarë në ndonjë Konventë se vetëm besojnë e jo edhe ëndërrojnë rrëzimin e demokracive, shteteve laike dhe instalimin e shariatit?

## 70.5. SHTETI SI PROJEKT UZURPIMI

Shteti kapet e korruptohet për çdo ditë nga grupe, persona, ideologji dhe religjione. Analizë korrupsionit (i)material dhe strukturor në shoqëritë shqiptare. Politologu dhe filozofi Arthur Fisher Bentley në librin e tij «The Process of Government» (Procesi i qeverisjes:1908) e përcaktonte politikën si kacafytje midis grupeve që synojnë «kapjen» e një cope sa më të rëndësishme të (pu)shtetit, respektivisht përvetësimin e institucioneve kyçe të qeverisjes. Në shoqëritë shqiptare, parë me syzet e mediave, përqendrimin e ka monopolizuar lufta kundër korrupsionit qeveritar, gjë që nënkupton se sensorët jo vetëm të fuqisë së katërt, por edhe ato të mekanizmave më të rëndësishme të shoqërisë energjinë e tyre e shpenzojnë duke analizuar «kronikën e zezë» politike dhe ekonomike. Ky fokusim që përngjason me aporinë e Sizifit në pikturën e Tiziano Vecellio-s (1480-1576) është i drejtë, i domosdoshëm, i nevojshëm, mirëpo gjithaq edhe një problem i përhershëm që realisht vetëm shteti juridik mund ta luftojë.

Pse ky fiksion na ndërlidh me pyetjen: Mos për shumë analistë, institucione dhe organizma të shoqërisë civile ky monopërqëndrim duket të jetë një lloj azili, një mënyrë ikeje nga munda për t'u preokupuar edhe me probleme tjera, më pak abstrakte dhe po aq akute sa edhe ulërimat kundër korrupsionit juridikisht pa adresë? Dhe pyetja multiplikohet vetvetiu: Ka apo jo dhe nëse po, sa i rrezikshëm është korrupsioni imaterial dhe strukturor në shoqëritë shqiptare?

*Korrupsioni (i)material* - Paraprakisht, bën edhe për të paraevituar spekulimet, nuk është keq ta sqarojmë se ç'kemi parasysh me **korrupsion imaterial dhe strukturor**. Bëhet fjalë për një veprim sistematik, të planifikuar mirë dhe afatgjatë nga persona, grupe, klane të cilët nëpërmjet

shërbimeve materiale e imateriale synojnë të dominojnë (ose kapin) politikën, kulturën apo ekonominë e një shteti.

Me këtë modifikim korrupsioni kompresohet ashtu siç e definojnë politologët e Chicago School; Harold Dwight Lasswell dhe Arnold A. Rogow në veprën e tyre «Power Corruption and Rectitude» (1963): «Korrupsioni është akt destruktiv në dëm të interesave të përgjithshme (shumicës) dhe në favor të përparësisë speciale të një ideje a grupi brenda përgjegjësisë publike dhe qytetare».

Shqip del kështu: Nëse një grup a ideologji ia arrin që të kapë një ministër për të realizuar qëllimet e veta, atëherë bën korrupsion masiv, sepse çkonfiguron axhendën e një pjese të shtetit në interes të vetin, për të cilën shumica nuk e ka thënë fjalën e vet (votën).

**Korrupsion imaterial dhe strukturor** ushtrojnë pa përjashtim të gjitha grupet, pavarësisht nga ajo se a perceptohet botëkuptimi apo aktiviteti i tyre nga shumica si pozitiv apo negativ. Më shumë se qëllimi final, në këtë kontekst luan rol metoda, pra forma e organizimit dhe arritjes së synimit. Që një grup apo person të marrë pozitën e «lojtarit» të rëndësishëm në një shoqëri, ai, nëpërmjet shërbimeve konkrete apo ideve korrupton funksionarë qeveritarë, media, grupe të tjera e sa më shumë ithtarë. Si e bëjnë konkretisht këtë personat, grupet ose mediat e caktuara?

*Operatori si person dhe si grup* - Na duhet një «sekret publik» që manifeston përfshirjen dhe metodën e personit si subjekt dhe njëkohësisht përshkruan mënyrën strategjike të ndonjë grupi, pra që ilustron atë korruptimin strukturor që e «përcaktuam» më lart. Eksperimenti nuk ka për qëllim të gjykojë, por të instrumentalizojë qëllimisht spekulimin në favor të teorisë që shpalosëm.

Qëmoti qarkullojnë rrëfime mbi rolin e poetit dhe profesorit Milazim Krasniqi në favor të Shefqet Krasniqit dhe grupeve radikale islamike të Kosovës. Sipas kësaj teorie erë-konspiracioni Milazim Krasniqi përdor të birin, ministrin e kulturës Memliun, për të lobuar në interes të krijimit të privilegjeve për myslimanët radikalë. Pandehmat shkojnë deri në atë shkallë saqë edhe fotografitë e Milazim Krasniqit të bëra në „sokak lezzetleri“ të Stambollit (në facebook) merren si fakte për ndikimin e tij në raportet e Republikës së Kosovës me Turqinë dhe qendrave arabe.

Po qe se ky spekulim del real, atëherë kemi të bëjmë me një korrupsion strukturor që ka për qëllim faktorizimin politik dhe kulturor të ideologjisë (jo besimit) islamike në nivelin e një doktrine identitet-formuese të shtetit të Kosovës. Nëse këto manovrimet i vëmë në inkubatorin e realpolitikës atëherë më qartë arrijmë ta deshifrojmë aksionin për partizim të besimit, aspirimin e Shefqet Krasniqit për një Kosovë islamike dhe manifeste tjera të këtij lloji.

Korrupsion sepse procesi nuk përdor mjete legale, transparente brendapërbrenda demokracisë dhe shtetit, porse zhvillohet në prapaskenë si komplot kapjeje fragmentesh të caktuara të shtetit përmes lidhjeve (i)materiale, ideologjike apo grupore.

*Labiliteti qeveritar* - Strategji të këtilla, shikuar nga këndvështrimi i autorëve të tyre, janë madje legjitime. Dëshira e ekspandimit politik e kulturor historikisht del të jetë gjymtyra kryesore e çdo grupi politik e religjioz. Me një fjalë: ato bëjnë punën e tyre. Ashtu siç bëjnë punën e tyre evangjelistët, katolikët, katolibanët, muxhahedinët, europatriotët, raciopatriotët, demopatriotët, retropatriotët, ateistët, ateotët, teokratët, idiokratët, maskulistët, mediokratët, klimofobët bashkë me gjithë kratët, istët dhe inët

e tjerë që militojnë brenda shoqërive shqiptare. Ata as që do të ishin problem, respektivisht janë po aq problem sa edhe korrupsioni material sepse herë shumohen e herë pakësohen, mirëpo nuk ikin përgjithmonë. Një pjese të tyre as që ua dëshirojmë hadin: kush donë të jetojë në një vend monoton dhe pa diversitet?

Problemi qëndron diku tjetër: tek mungesa e shtetit! Shoqëritë shqiptare drejtohen nga qeveri, të cilat nga prostitucioni dhe injoranca bëhen viktimë e përditshme grupesh, ideologjish e idesh që janë krejtësisht në kundërshtim me sistemin politik, kushtetutën dhe axhendat shtetërore.

Shteti i pakorruptueshëm në drejtësi dhe demokraci stabilizon koekzistencën e grupeve duke ua siguruar atyre lirinë për veprim apo duke i sanksionuar nëse shkelin vijën e kuqe dhe sakaq iu garanton atyre integritet brendapërbrenda harmonisë së detyrueshme. Shtetet shqiptare, gjithmonë në alfa-version, për shkak se janë të korruptuara nuk janë të forta mjaftueshëm sa për t'u konfrontuar me këtë diversitet. Meqënëse është kështu, atëherë qoftë edhe grupet më ekstreme bëjnë orgji me institucionet e shtetit sa herë që të zgjohen të mpirira nga gjumi.

## 70.6. ISLAMOFOBËT

*E di ndërkohë edhe myslimani se kush është «Antikrishti»?*

Tendencat e disa paradigmave të reja për t'i kategorizuar pjesëtarët e religjionit islam në mysliman dhe islamistë kanë të bëjnë me qëndrimin refuzues të do akademive perëndimore kundër paushalizimeve mediale dhe politike. Është mekanizëm në mbrojtje të idesë së heterogjenitetit interislam. Në taborin e myslimanëve „rekrutohen“ gjithë ata që praktikojnë pesë shtyllat e Islamit dhe jo më shumë, ndërsa në grupin e të dytëve futen militantët me synime

ekspansioniste (civilizatore). Etimologjikisht të dy nocionet kanë pothuaj të njëjtin kuptim. Një seleksionim të tillë, mirëpo përdorin edhe vetë teologët arabë – si primatë të religjionit – duke kërkuar dallimin më kategorik ndërmjet Islamit si sistem politokulturor dhe besimtarëve të „rëndomtë“ (*Gardet. Islam. I. Definition and Theories of Meaning“ in The Encyclopaedia of Islam*).

Për ideatorin (dhe nxitësin) e rimëkëmbjes panislame në librin e tij «The Clash of Civilisations» (1996) Samuel P. Huntington kategorizimet e tilla ishin kot. Në dy teoritë kryesore që shtroi: «Resurgence of Islam» (91-95, Rimëkëmbja islame) dhe «Fault line war» (266-300, Teoria e friksionit) ai argumenton pro një islami homogjen që bëhet gati t’ia mësyjë botës përtejarabe me dhunë, mjekrra, shami, shpata për ta shndërruar oksidentin në shkumb e hi. Telelogji apokaliptike, histeri apo frikë e kuptimtë.

Si e përjetojnë shqiptarët këtë?

*Kosova si shembull* - Një grup i vogël panislamistësh luten ndoshta ditë e natë që Huntingtoni të kishte të drejtë. Shumica tjetër edhe në këtë aspekt preferon mjegullën. Qeveria bën sikur agjëron, gjersa partitë mirëpresin çdo konflikt për t’i shtuar apo humbur edhe do ithtarë.

Brenda komunitetit islam nga njëra anë kemi institucionet zyrtare të këtij religjioni të cilët herë pas here deklarojnë se «Bashkësia Islame e Kosovës është kundër çfarëdo rryme ekstremiste fetare dhe ... se asnjë parti politike në programin e saj nuk proklamoi mbrojtjen e vlerave islame» (Hajrullah Tërnavë: 09.07.2013) dhe nga ana tjetër kemi LISBA-n kërcënuese, klerikun wahhabi Shefqet K. bashkë me një rrjet ekstremistësh të xhamive shqiptare dhe një grup semiakademik, gjurmët e të cilit mbërrijnë deri në shtrojat e zyrtare të ministrit të kulturës kosovare. Përtej tempujve të këtij religjioni dhe zyrtarëve të sekteve e grupeve radikale apo të

korruptuara shumica e shqiptarëve (edhe shumica myslimane) kacafyten me varfërinë, përditshmërinë nënçmuese, lirinës dhe nga aporia herë marrin anën e „xhehnetit“ e herë të realitetit.

*Islamistët* - Pjesa dërrmuese e myslimanëve shqiptarë – nga reagimet, debatet dhe numri i militantëve institucioneve të religjionit – manifeston përkrahje për islamin si besim, pra siç i quajmë ne këtu, janë imanofilë. Këtë qëndrim ata e demonstrojnë sidomos me qëndrimin karshi shtetit të tyre parademokratik dhe laik. Në këto kushte e disponim ç’efekti kanë grupet radikale dhe islamistët? Aktiviteti i tyre ndikon në dy dimensione: 1. Militantizmi i tyre agresiv nxit ashpërsimin e nacionalizmit shqiptar; detyron shtetin të mbrojë veten me ligje edhe më rigorozë që patjetër do të diskriminonin edhe imanofilët dhe; i japin politikës një „fajtor kujdestar“ për t’iu ikur përgjegjësive që ka. 2. Wahhabitë prodhojnë domosdoshmërisht imazh të keq, intolerant ndaj myslimanëve shqiptarë – pra bëhen fabrikë stigmatizimesh që prodhojnë jo vetëm më shumë nacionalistë shqiptar por edhe islamofobë; Korrupton strukturalisht një pjesë të shoqërisë me një „ideal“ jokompatibël me kohën, kulturën dhe traditat e shqiptarëve, i gënjen dhe manipulon ata me premtime që edhe në filmat science –fiction do të ia ftohnin çdo absurditeti. Pse?

*Realiteti* - Sepse islamistët premtojnë instalimin e një sistemi kulturor, politik që ka ngelur në shekullin 14 dhe asnjëherë nuk ka reformuar veten (Bassam Tibi. Sfida islame:2007). Sepse bota nuk bëhet vetëm me kryqëzim (çka përëndimi e kuptoi me kohë) permanent e as po i ra me kokë dheut edhe 20 herë në ditë. Sfera islame sot është pjesa më e varfër, më e prapambetur (në shkencë, teknologji, politikë, ekonomi, militarizëm) e globit. Mbi 80% të analfabetizmit



botëror e përbëjnë vendet ku dominon religjioni islam. Tiranitë dhe despotët më arrogantë ndaj popujve të tyre banojnë atje. Me ç'argumentesh manovrojnë islamistët shqiptarë atëherë? Se islami qenka rruga e mirëqenies dhe paqes, porse arabët nuk ditën? Se këta do t'i dëshmojnë Allahut se ka bërë gabim që ka zgjedhur Muhamedin profet të tij e jo ndonjë Flori a Laur?

Përderisa ndaj këtyre pyetjeve s'kemi përgjigje bindëse atëherë analizojmë ndryshe: Për nga efekti, nga ai që rezulton puna e radikalëve islamikë u përngjajnë atyre shërbimeve sekrete të disa shteteve dhe ideologëve të homogenitetit (Huntington) që nuk i zë gjumi nga islamofobia, çka do të thotë se: në praktikë islamistët janë edhe islamofobët më aktivë. Perëndimi pati sukses në neutralizimin e ekstremistëve, shtetet shqiptare nuk dinë si. Si duket çelësi i shekullarizimit shqiptar?

**Po edhe myslimani e ka mësuar se kush është «Antikrishti»: Islamisti!** (2013)

## *Kanuni i sekularit*

Sekularizimi\* nuk nënkupton asgjësimin e ndonjë religjioni apo botëkuptimi, përkundrazi ai është i vetmi sistem që mundëson sociodiversitetin, koekzistencën e të shumtëve brenda një hapësire. Ai shërben si preventivë për ruajtjen e paqes shoqërore sidomos në ato hapësira të cilat përbrenda kanë ideologji e subidentitete me synime ekspansioni global. Sa vlen pra, ose sa praktikohet sekularizimi ndër shqiptarë? «Tirania funksionon edhe pa besime, ndërsa liria jo», kështu mendonte Alexis De Tocqueville (1835) i shekullit të 19-të. Nëse liria nuk mund të funksionojë pa besime (religjione) atëherë çfarë jete bën ajo me to? Pas francezëve (Laicité, 1789) SHBA-të qenë të dytat që në vitin 1791 kushtetutën e tyre e hapën me nenin e parë nga Bill of Rights që në histori hyri si «Wall of Separation» e iluministit Thomas Jefferson-it e që thotë: «Kongresi nuk duhet të aprovojë asnjë ligj që ka të bëjë me themelimin e ndonjë religjioni apo që ndalon ushtrimin e ndonjë feje...».

*Modeli amerikan* - Në vitin 1995 ish-presidenti amerikan Bill Clinton do ta shpaloste paradoksin para studentëve me fjalët: «Në këtë kohë të hipersekularizimit global SHBA – të, në kuptimin konvencional të fjalës, janë më fetaret ndër vendet e industrializuara». Mirë a keq? Pasardhësi i tij Georg W. Bush që alkoolizmin e mundi nëpërmjet anglikanëve dhe metodistëve, ende pa u bërë president njihej si fundamentalist i lëvizjeve evangjeliste amerikane, organizata të cilat patën ndikim shumë të madh tek presidenti sidomos në politikën e tij ndaj Lindjes së Mesme dhe të ashtuquajturës Botë e Tretë.

Për shumë kronistë të kohës, kjo fazë presidenciale amerikane për historiografinë do të jetë ndoshta më kritikja, jo vetëm për politikën diskriminuese ndaj ndonjë pjese të globit, por më shumë edhe për balancimin brendasocial ose siç e prognozoi tri vite para nominimit të Bush-it për kryetar shteti gjykatësi i «Supreme Court of the United States» Harry A. Blackmun: *«Nëse Qeveria gjurmën e saj e vë në shërbim të një religjioni të caktuar, atëherë përçon mesazhin e përjashtimit të të gjithë atyre që nuk janë pjesëtarë të religjionit të privilegjuar»* (1997)!

Shikuar nga aspekti ligjor George W. Bush nuk ka shkelur aspak «First Amendment»-in e kushtetutës amerikane e as ndonjë kod tjetër që përcakton detyrat e presidentit të shtetit. Besimi i tij është një e drejtë e garantuar në fjalinë e dytë të po të njëjtit amendament. Amerikanët e dinin religjiozitetin e kandidatit para se ta votonin; ku qëndron problemi domethënë? «George W. Bush gjatë fazës elektorale nuk bënte evangjelizëm, por siguronte mirëqenie, premtonte siguri dhe rikthimin e imazhit të SHBA-ve në superfuqi me ndikim. Edhe gjatë odiseve luftarake në vendet arabe ai – megjithatë – nuk ishte aq i paditur sa të misionojë me dashurinë e Krishtit (sepse kjo do të ishte edhe diçka fort kontradiktore) por ia nguliti çdo amerikani frikën në palcë nga terrorizmi ekzistent islamik, ndërkaq në thelb shumicën e vendimeve i merrte si fundamentalist, gjë që më vonë edhe e konfirmoi duke thënë se «lutja (e krishterë) është veprim standard në qeverinë time» (Der Spiegel: 01.02.2001). Emërimi i politikanëve të njohur fundamentalistë si John Ashroft (i akuzuar për racizëm nga demokratët) dhe Robert Zoellick në poste ministrore vuloste spekulimin për «pushtimin e pabesë dhe të suksesshëm të politikës nga një religjion i caktuar».

Nëse sekularizmi amerikan doli i pambrojtur nga kapja e shtetit prej fetarëve, atëherë sa të mbrojtura janë shtetet shqiptare në këtë kontekst?

*Ministritë fetaropolitike* - Zhurma më e madhe për rrezikun nga fundamentalizmat vjen nga Shqipëria. Me të drejtë. Atje as kisha ortodokse progreke e as qarqet katolike (grupi i deputetëve katolikë) nuk i fshehin aspiratat e tyre për ta zënë politikën ose përmes saj ta popullarizojnë besimin e tyre si „prima doctrina“.

Organizatat islamoradikale edhe pse të organizuara si në sferat tjera shqiptare (nga atje rekrutohen oratorët dhe agjitorët për në vendet tjera) nuk e kanë të njëjtin ndikim si në Kosovë dhe Maqedoni. Kjo jo për arsye të nivelit të lartë të analfabetizmit në të fundit, por më shumë për shkak të support-it qeveritar: Në Maqedoni radikalizimi i religjionit ndër shqiptarë përdoret nga shteti si favor sidomos në fushën diplomatike të tij dhe në Kosovë për shkak të infiltrimit të segmenteve islamoradikale në qeverinë aktuale. Rasti i Kosovës, respektivisht dështimi i shtetit për të mbrojtur sekularizmin ka ngjashmëri – për nga metoda horizontale (e jo vertikale), sepse suksesi ka arritur deri në nivele ministrore e drejtorësh e jo deri në presidencë e kryeministri – me atë të SHBA-ve.

Organizata si AKEA, Vëllazëria Myslimane me nënsatellitë të ndryshëm tash e më shumë se katër vite llobojnë dhe rekrutojnë njerëz që janë në qeveri dhe të tillë që u kanë ndihmuar të futen atje. Nëpërmjet Memli Krasniqit AKEA ia doli që ta legalizojë veprimtarinë e sajë si „bamirëse“ dhe botuese (promovohesgin libra të Milazim Krasniqit, Nexhmedin Spahiut e të linjës së tyre të mendimit) pa e bërë fare transparent qëllimin dhe financimin e saj konkret. Synimi qendror i AKEA-s ishte ajo që për herë të parë Ahmet Davutoğlu‘ e bëri publike në 70 vjetorin e neosmanistit dhe

ballkanologut prof. Halil Incalik të Universitetit të Bilkenit në Pallatin e Kulturës së Stambollit më 14. Nëntor 2009: «Incalik na ka mësuar ne (nxënësve të tij) që nga viti 1965 e deri më 2008 që nëpërmjet diplomacisë tonë turke ta rikthejmë praninë tonë gjithandej. Me „*libra nëpër këmbë*“ ne do ti *pushtojmë prapë hapësirat tona*“. Doktrinë që me hollësi i njëjti e shpalos në «Stratejik Derinlik: Türkiye'nin Uluslararası Konumu» (Thellësia strategjike: Pozicioni ndërkombëtar i Turqisë. Stamboll: 2001).

Përveç këtyre, AKEA në raportet e ndryshme të perëndimit gjendet në listën e organizatave militante, ku bëjnë pjesë edhe brigada të caktuara terroriste në Siri, Irak – dhe që financoheshin nga një fond i veçantë i shërbimeve sekrete turke edhe pse kjo e fundit transaksionet semilegale i bën nëpërmjet ministrit të pakicës turke.

Ministri Krasniqi dhe Mahir Yagcilar jo rrallë (dhe më së shumti) merr pjesë në ceremonitë parimisht fetare të kësaj organizate, madje edhe duke përshëndetur e kënduar në arabishte. Kjo do të thotë se të dy vunë ministritë ku janë drejtues, në shërbim josekular, shtetëror sepse njëlloj si ata ministrat e Bushit të akuzuar për racizëm sabotonin dhe minonin paanësinë e shtetit në shërbim të një feje (madje edhe të një shteti tjetër) apo etnie të caktuar.

Po në të njëjtën variant tentuan të kapin sa më shumë ndikim edhe sauditët nëpërmjet shefit të AKR-së Behgjet Pacolli. Përpjekje bëjnë edhe religjione të tjera – në Kosovë më shumë nga frika se sa nga ekspansioni.

*Ekspansionet hyjnore* - Në shoqëritë si këto shqiptare, ku diversiteti fetar përmban të gjitha të mirat dhe të këqijat abrahamite dhe joreligjioze, sekularizimi është i karakterit ekzistencial. Kushtetuta e shteteve shqiptare duhet të jetë më strikte, më rigorozë se sa ajo e SHBA-ve. Ashtu si në Francë duhet të jetë, pa asnjë vrimë nga mund të dalë orteku i

abuzimeve të mundshme: fetë janë të ndara nga shteti dhe gjithandej ku është primare shoqërorja, s'kanë çfarë kërkojnë mësimet fetare.

Asnjërës nga religjionet pranishme ndër shqiptarë nuk iu mungon mesazhi i ekspansionit, të qenët më e drejta, më e vlefshme, më fitimprurësja, më meritoreja për shoqërinë. Kjo maksimë mund të mbahet e kufizuar në letër e këngë vetëm me një shtet të disiplinuar që ua njeh të gjithëve të drejtën e ushtrimit, por nuk i le t'ia hanë kryet njëri-tjetrit dhe të rënojnë koekzistencën në paqe sa herë që të zgjohen agresivë apo se kanë folur me ëngjëjt për t'i vrarë gjithë jobesimtarët apo për ta çuar mesazhin e Zotit deri qoftë edhe në atë cep të globit ku jetojnë vetëm pinguinët.

Çdo model tjetër përveç sekularizmit dhe laicitetit do të shpinte në thellim të armiqësimit ndërmjet llogoreve të fiksuara në pseudokonceptet e tyre, grupe që doktrinën edhe pse i kanë referencë të vazhdueshme duket mos t'i kenë kuptuar ato fare, por verbërisht e instrumentalizueshëm i përshpirtërojnë si melheme antidepresioni e eutanazie! (2015)

### *Glosar*

(Si janë përdorur termat në këtë tekst)

*Sekularizimi* = Proces mendor i ndarjes së shtetit nga feja.

*Sekularizëm* = Ndarje konkrete e shtetit nga institucionet religjioze).

*Laicizmi* = Sipas konceptit Ferdinand Buisson që luftonte për shkolla të çliruara nga besimet fetare.

PJESA E TETË  
*Historia*

## *Historia si paranojë*

*Hyrje*

Byung – Chan Han ka pjesërisht të drejtë. Në esenë e tij «Shoqëria e lodhur» filozofi koreano-gjerman thotë se që nga fundi i shekullit 20 e këtej njerëzimi nuk lufton më me epidemitë, nuk ka frikë më nga neoperandorë shtazarakë dhe luftëra frontale me bajoneta dhe raketa, sepse ekzistencën e tij e sfidojnë pandemitë neuronale, agripale.

Jo infektimet bakteriale e virale e shkallmojnë fizikun pra, frymën, harmoninë dhe stabilitetin social të njeriut pasmodern, por infarktët, të cilat përshkallëzohen si faturë e sindromave dhe sëmundjeve si depresioni, hiperaktiviteti nga kompleksi i inferioritetit (ADHS), postraumat, «borderline» çrregullimet (BPS) apo «burnout» (BS) diagnozat e modës (Han. Berlin: 2010).

Qenkan vërtet këto sindrome përcaktuesit e hartës patologjike të shekullit 21, siç pretendon Han? Sipas raporteve të ndryshme, sidomos zonave të pasura të globit, po. Teza qëndron. Megjithatë paskan lindur këto sëmundje veç pas emërimit të tyre? Disa edhe ndoshta. Historikisht megjithatë kemi të bëjmë me aspektin e priorizimit, sfidën e radhës së planetarëve: në kushte lufte kundër të tjerëve ose vetë natyrës, autodiagnoza është irrelevante sepse kauzë bëhet qenia apo mosqenia e jo me *sigenia* e njeriut. Nga çastet



kur rreziku nga faktorët e jashtëm bëhet jo akut, kulturat, popujt, shoqëritë nisin luftën me frikërat e shtëpisë.

Kjo fazë dukshëm ka përfshirë edhe shqiptarët.

Pas mbarimit të diktaturës komuniste dhe luftës së fundit, shoqëritë shqiptare nuk u senzibilizuan rreth çrregullimeve dhe bllokimeve që sjell me vete pas-trauma kolektive. Ndodhi edhe më keq: dalja nga gropat e betejave kundër të tjerëve, kthimi në shtëpi dhe përballja me veten nuk startoi nga pozitat e viktimës së dëmtuar, por nga inskenimi i superioritetit së racës së mbijetuar; autoprojekti i konsolidimit në liri nisi pra në gjendje hipnoze. Në atmosfera të llojit zakonisht e vetvetiu pezullohet e tashmja dhe e ardhmja në favor të së shkuarës, asaj që konsiderohet histori. Sepse ajo është «e dhënë», e «muzeuar» dhe shërben si mjete më i përshtatshëm i rikonfirmimit të vetes ashtu siç preferon të të pranojnë tjerët.

Në debatet rreth «Skënderbeut», «titistëve dhe enveristëve» dhe «UÇK» apo «FARK» dolën konturet e qarta dhe të sakta të hartës patologjike shqiptare. Jo versionet, «të vërtetat» ishin zymtësia, por mënyra e polemikës, debatit të mediave, rrjeteve sociale dhe të gjitha kanaleve interaktive ku mund të shprehen lirshëm sot shqiptarët. U përballëm me një shoqëri që ka frikë të mos jetë ndryshe nga ajo çfarë beson të jetë; me shtresa që nga presioni për t'u rehabilituar mezi marrin frymë, të tilla që falsifikimin biografik e shohin si të vetmen alternativë riaktualizimi si njësi relevante të shoqërisë; kulturosferat shqiptare i pushtuan doktrinat më të çuditshme, të cilat besojnë se sa herë njerëzit gjenden në hutim, depresion, përhumbje, paskan etje për identitet e të vërtetë sipas modelit të tyre vetjak – dhe ata e gëzuakan si të drejtë të tyre personale «të vërtetën absolute» që nga dita kur Adami bëri dashuri me Evën; atopia – jemi apo s'jemi në Evropë, pra a jemi realisht këtu apo është iluzion – manifestoi madje edhe një skizofreni klaustrofobe të mentalitetit

shqiptar, një gjendje tejet të vështirë psikike si kurrë më parë. Këto janë vetëm disa nga simptomet e sindromet që kanë kapur për fyti shoqëritë shqiptare. Po të kishin shqiptarët psikanalitikë, sociologë, antropologë do ta kishin bibliotekën më të pasur të kontinentit në këtë drejtim.

Teksa demokracive perëndimore shërimi kërkohet në deklubizimin e kapitalit në favor të përhapjes së mirëqenies dhe barazisë drejt sa më shumë shtresave të shoqërisë, në Ballkan medikament i vetëm është veç historia. Por ndërkaq jo si mësuese, siç na çajnë kokën vetë historianët pareshtur, por si azil i nevojshëm nga gjendja e sotme, nga e nesërmja që s'dinë dhe nuk duan ta bëjnë realitet se ajo kërkon shumë mund, ajo, historia u hynë në punë kryesisht si fabrikë opiumi për të përballuar sëmundjet dhe frikërat e shumta.

Kjo mënyrë e të jetuarit megjithatë ka vetëm një rezultat logjik: jetën në gjendjen e pacientit që vetëm mund të jetojë, mirëpo jo edhe të veprojë.

Historia si *morbo laborare* qenies shqiptare?

Po.

Politologu dhe filozofi holandez Johano Strasser (Shoqëria në frikë: 2013) ka të drejtë kur konstaton se shoqëritë që nuk arrijnë të racionalizojnë frikërat, mitologjinë, religjionet dhe ideologjitë, ndër të tjera, në stilin e nihilistëve apo duke filluar si kartezyanët që shkundën edhe më të shenjtën nga vetja për ta rishikuar kthjellët, nuk arrijnë kurrë të ecin pa paranoja drejt së nesërme. Në kontekst me shqiptarët – shumë të drejtë ka! Dhë pikërisht nga këtu duhet ta nisë çdo projekt të saj inteligjenca shqiptare. Shtetet nuk do të investojnë në këtë drejtim sepse më mirë se frikërat, asgjë tjetër nuk i mban të skllavëruara masat. (2014)

## *Si nuk shkruhet historia*

Para do kohësh, në Prishtinë u publikua libri trevëllimësh me titullin «Kosova – Antika, Mesjeta, Perandoria Osmane, nga Konferenca e Londrës deri në Protektoratin ndërkombëtar» (Prishtinë/Huston. ShB. Faik Konica & Jalifat Publishing, 2012), autori i të cilit është Jusuf Buxhovi.

Libri në fjalë bëri një jehonë të madhe dhe nga një numër i konsiderueshëm i mediave kosovare u prit me pompozitet.

Libri i Buxhovit hyn ndër ato libra, që janë pjesë e polemikës historiografike, e cila ka më shumë se njëzet vjet po përkujdeset gjithandej për trazira dhe thellim armiqësishë ndër popujt e Evropës juglindore. Polemikë, e cila mund të cilësohet si luftë historianësh, në garën e tyre se kush prej tyre do ta gjejë recetën më të mirë për të dëshmuar autoktoninë e këtij apo atij populli. Secili komb, pavarësisht se a është i «lashtë» apo i «ri» – në shumicën e rasteve i përkrahur me subvencione shtetërore apo nga arkat partiake – përpiqet të sjellë argumentin më bindës rreth të drejtës së vetë natyrore për të sunduar mbi toka të caktuara ballkanike. Thënë troç, gjithë kjo ka të bëjë me pyetjen: kush ishte i pari këtu?

Brenda hapësirës shqiptare deri më tani pati vetëm disa kritika simbolike rreth «teorisë më të re» të Buxhovit mbi etnogenezën e shqiptarit të sotëm. Në librat e tij autori dërgon një kritikë të ashpër në adresë të Universiteteve shqiptare dhe Institucioneve tjera arsimore, të cilat, sipas mendimit të tij, janë bërë instrument i historiografisë

tendencioze serbo – greke, sidomos për faktin se me injorancën e tyre këto institucione, famën antike ua kanë lënë pa të drejtë grekëve. (Buxhovi: Kosova, Libri parë, fq. 270).

Me një vetëbindje gati narcisoide, gazetari kosovar apelon për një historiografi shkencore, të pastër dhe objektive. Historianët tjerë, ata të cilët etnogenezën shqiptare e shohin ndryshe nga Buxhovi i difamon si albanofobë.

Po çka nënkupton Buxhovi nën togfjalëshin «historiografi objektive dhe shkencore»?

## REAGIMI

I lexova me kujdes tri vëllimet e librit «Kosova...» të Jusuf Buxhovit. Tezat të cilat i paraqet Buxhovi, sikur që do të shohim më poshtë, nuk janë të reja. Kësisoj përpjekjesh datojnë që nga shekulli i 19-të – e re është gjeografia e tyre dhe mënyra e interpretimit. Aty formulohen teza , të cilat janë në kundërshtim dhe përmbysin gjitha studimet e bëra dyzetvjetët e fundit mbi Europën Juglindore në hapësirën anglosaksone, gjermanofone dhe frankofone.

Vendosa të reagojë, ngase, fatkeqësisht u desht të kosntatoj se Buxhovi jo vetëm se keqpërdor burimet në mënyrë dramatike gjatë interpretimit të tyre (si Ciceroni, lexo më poshtë) por shpeshëherë ato që ai i prezenton si burime, nuk janë fare të tilla, por riprodhime e interpretime të huaja, të cilave poashtu u mungojnë burimet primare.

Pa pretendimin të testojë metodën e dekonstruksionit të Derridas mbi kurrizin e historiografisë shqiptare, por thjesht shfaqet si obligim për të marrë anën për një historiografi objektive dhe të dijes. Për një histori të «ad fontes», për një histori të burimeve ashtu siç janë edhe atëherë kur ato burime do të thenin ëndërrat tona romantike duke na përplasur para pasqyrës e duke na dhënë një identitet krejt ndryshe nga ai tek i cili kemi besuar tërrë jetën. Jam i vetëdijshëm se mund të

akuzohem me gjithfarë epitetesh nga ata që janë mësuar ta shkuajnë historinë si ep apo si këngë dasmash folklorike, por për hir të një katarsisi të nevojshëm në shoqëritë tona, po e marr rrezikun e fyerjeve të mundshme duke apeluar për një histori objektive dhe pa urrejtje.

## FALSIFIKIMI SI OBJEKTIV

«Historia magistra vitae» (Cicero. De Oratore, II, 36) kështu thoshte Ciceroni në librin e tij të dytë të *de oratore* dhe vazhdon: ajo – Historia – është drita e të së vërtetës dhe shkenca e njëmendtë, ngase ajo është «dëshmitare» e kohërave (Po aty). Por për çfarë i shërben Ciceronit kjo dëshmitare e kohërave të vjetra? A i shërbente ajo me mitet dhe heronjët e saj Ciceronit si mjet manipulimi për të liruar klientin e tij, të akuzuarin Sextus Roscius, nga akuza për vrasje? (Cicero. Pro Quinctio in Fuhrmann/Gigon/Kasten von Artemis & Winkler 2008) Poashtu. Të bëmat historike të të shenjtëve, të heronjëve dhe mitet ai i transferon si vlera të mishëruara në personalitetin e klientit të tij. Masa u hipnotizua. Gjykatësit kishin frikë. Vrasësi u lirua. A e ka rrëfyer Ciceroni historinë në mënyrë objektive? Ndoshta. A e ka falsifikuar ai historinë për të liruar një vrasës? Po. Ai e keqpërdori të kaluarën, duke intepretuar atë qëllimisht në një mënyrë për të asyetuar një veprim të kryer në kohën e tij (Po aty). Pyetja se a i falsifikoi Ciceroni burrimet – duke i paraqitur si fakte ndryshe nga se ç'ishin – në këtë kontekst nuk është gjithaq relevante. Me rëndësi në këtë e sipër është fakti se Ciceroni me ndihmën e Historisë falsifikoi të aktualitetin dhe nëpërmjet këtij falsifikimi shndërroi një vrasës në fisnik. Ai mashtrroi bashkëkohanikët, verëbëroi ata duke i shndërruar në marioneta të paafta, qeni pa mundësinë në mendimin e pavarur dhe personal. Nëpërmjet autoritetit të tij prej dietari,

siç u tha, për qëllime të ulta personale, ai ia rrëmbeu masës të drejtën në racionalitet.

Në vend të Ciceronit marrim historianin. Të eksperimentojmë më tutje. Në vend të historianit ftojme në skenë Jusuf Buxhovin (apo ndonjë nga kolegët e tij nga Beogradi, Shkupi, Tirana, Sofja, Zagrebi etj.)

Gjatë gërmimeve të tij, një arkeolog, gjen një shpatë dhe dëshiron ta identifikojë atë si armë të Skënderbeut. Buxhovi duhet të kontekstualizojë këtë gjetje dhe ta shkruajë historinë. Buxhovi e di, që masat, heroin nacional e nderojnë si Zot dhe duhet të vendosë se si duhet ta shkruaj historinë e shpatës. Shkenca e detyron atë të përdorë sistematikën e Droyzenit ( që nga Heuristika deri në interpretimin e ideve). Ai nuk e ka harruar maksimumin e Max Weberit, e cila kërkon prej tij të ndajë botëkuptimin nga shkenca! Megjithatë, ai është në dilemë. Ai gjendet para katër alternativave:

**Alternativa e parë:** Ai e paraqet shpatën si armën e një të shenjtë dhe heroi të drejtë dhe asgjë më shumë. Rezultati: Populli e don atë. Festohet.

**Alternativa e dytë:** Ai e don profesionin e historianit, qëndron objektiv dhe thotë: Kjo është arma e një burri që nga masa është pranuar si i shenjtë. E një trimi i cili vrau brutalisht shumë njerëz duke mbrojtur vendin e tij. Për disa ai është një i shenjtë dhe hero, për të tjerët tradhtar dhe kriminel. Objekti – shpata – i shërbente atij për të vvarë, etj. Rezultati: Populli e urren atë.

**Alternativa e tretë:** Ai e paraqet shpatën si armë të një pirati të parëndësishëm nga Karibiku. Rezultati: Ai shpallet si i sëmurë psikik.

**Alternativa e katërt:** Ai nuk thotë asgjë dhe merret me tema të tjera të historisë. Rezultati: Askush nuk e di se kush është ai. Jeton në anonimitet.

Para kësaj dileme gjenden plotë historianë të Evropës Juglindore. Shumica janë përcaktuar për alternativën e parë. Jusuf Buxhovi poashtu.

## METODA DHE BURIMET

Strabon (Στράβων) shndërrohet në Strobanis, Paul Kretschmer në P. Kreschmer (Buxhovi; Libri 1, 35-36), Georg në Gerog (Po aty; 50), Jens Reuter shndërrohet në Ernst Reuter (Buxhovi, libri 3, fq. 912), Bartl Peter shndërrohet në Bartel Petr (Buxhovi, libri 3, fq. 918), Troebst Stefan shndërrohet në Troenst Stafan (Buxhovi, libri 3 Fq. 919), Libal Wolfgang shndërrohet në Libald Wolfgang (Buxhovi, libri 3 fq. 919), Jokl N. shndërrohet në Jockl N. (Buxhovi, libri 2, fq. 636), Kraft Ekkehard shndërrohet në Kraft Ekkerard (Buxhovi, libri 3, fq. 918), R. Schwanke ripagëzohet në R. Schanke (Buxhovi, libri 2, fq. 633), Oschlies Wolf merr nofkën Olschli (Buxhovi, libri 3, fq. 915) dhe kështu deri në pafundësi. Kurse senzacioni më i madh është se në librin e tretë të Buxhovit, gjejmë edhe libra që nuk kanë ekzistuar fare si të tilla. P.sh. në Buxhovi, libri 3, fq. 914 del një autor me emrin Libald Michael të jetë autor i studimit «Der Balkan», të botuar në München. Ky autor ama nuk ekziston fare. Botimi në fjalë poashtu. Shumica e emrave të autorëve janë ose të shkruar gabimisht ose bëhen autorë citatesh të huaja (dëshmitë e autorëve antikë paraqiten si rezultate të cituesve paraprakë). Kapituj të tërë janë pa fusnota (pardon; ai e citon vetveten si burim të vetëm shkencor; 626-670). Kapituj të tjerë janë përkthyer gati fjalë për fjalë dhe janë përvetësuar si autorialë. Kështu kapitulli mbi «Pansllavizmin», i cili në mënyrë fragmentare i është rrëmbyer librit «Ballkani – Historia e një qytetërimi», e autorit amerikan Ferdinand Schevill (1868-1954) (Buxhovi; Libri 2, 168-175).

Shihet sheshazi se autori përjashton me qëllim të gjitha ato burime, studime, të dhëna arkeologjike dhe literaturë sekondare me rëndësi, ato studime që mund të ishin në disfavor të tezave të tij. Para së gjithash, në bibliografinë e Buxhovit mungojnë studimet e 30 viteve të fundit. Burimet e pakta janë kryesisht nga autorë dhe rezultate shkencore të viteve 1880-ta dhe 1920-ta. Përkundër pohimeve se sjell fakte të reja mbi antikën (kjo edhe është baza e popullaritetit të librit të tij), ai nuk thotë asgjë për diskutet aktuale mbi të ashtuquajturën «çështje homeriane» (Vetëm si shembull: Alfred Heubeck: Die homerische Frage. Ein Bericht über die Forschung der letzten Jahrzehnte, Darmstadt 1974) dhe «debatin mbi Trojën» (Christoph Ulf (Hrsg.): Der neue Streit um Troia – eine Bilanz. C. H. Beck, München 2003 / Gregor Weber: Neue Kämpfe um Troia. Genese, Entwicklung und Hintergründe einer Kontroverse. In: Klio 88, 2006, S. 7–33. / Frank Kolb: Tatort 'Troia'. Geschichte. Mythen. Politik". Ferdinand Schöningh, Paderborn - München - Wien - Zürich 2010), edhe pse hipotezat e tij i bazon po në Homerin dhe Trojën.

Si burim kryesor për autorët antikë atij i shërben libri «Albanesische Studien» (Albanesische Studien, Friedrich Mauke, Jena, 1854) i juristit gjermano-austriak dhe albanologut Johann Georg von Hahn (Hahn 1847 ishte Konzull në Janinë, 1851 në Syra dhe që nga 1869 konzull gjeneral në Athinë. Ai merret si themeluesi i hulumtimeve për Shqipërinë, i cili mbledhi material, mësoi shqipen dhe argumentoi se gjuha shqipe bën pjesë në grupin e familjes së gjuhëve indoeuropiane).

Me një analizë më të thuktë të faqeve 31-121 (libri i parë) në të cilën autori plason tezën e pellazgëve ne gjejmë një ngjashmëri mahnitëse stilistike dhe strukturore me «studimin historik kritik» të Wassa Efendiut (Pashko Vasa), i cili është



botuar në vitin 1879 (dhjetë vjet pas vdekjes së Hahn) dhe është publikuar edhe gjermanisht në Berlin.

Libri i Ellis Hesselmeier, i cili me veprën e tij «Çështja pelasge dhe zgjidhshmëria e saj» (Die Pelasgerfrage und ihre Lösbarkeit. Franz Fues, 1890) pa sukses përpiqet të sjellë argumentimin gjuhësor e hapësinor mbi ekzistencën e pellazgëve si një popull jogrek dhe joilir nuk përmendet askund.

Në njërën anë Buxhovi diskualifikon me të drejtë historinë zyrtare shqiptare si prodhim i pseudohistorianëve komunistë e në anën tjetër e përdorë atë si burim të vetëm për të shkruar historinë e tij. Denoncon historiografinë serbe si të rrejshme, por nuk «shfrytëzon» asnjë burim konkret. Replikon gjithë kohën pa përmendur burimet e historiografisë së falsifikuar dhe pa sjellur njoftime se prej nga vijnë hipotezat e tij.

#### TEZA MBI PELLAZGËT

Buxhovi injoron rezultatet e vjetra e të reja që kanë dalë nga hulumtimet linguistike dhe arkeologjike. I merr burimet e Hahnit (me të gjithë riprodhuesit e tij në hapësirën shqipfolëse) mbi gjenezën pellazge të shqiptarëve një për një dhe i paraqet në një formë shkencore mjaft të dyshueshme si të të vetat.

Teza e tij e parë, përmbledhtazi, duket kështu: Dardanët janë sikur të gjitha – fiset tjera ilire – pasardhës të pellazgëve. Ata luftuan për shpëtimin e Trojës. Përmes mijëra viteve ata u mbijetuan të gjitha invazioneve të mundshme deri në ditët e sotshme kur Kosova e shpalli pavarësinë e saj. Për këtë shkak dhe për arsye të rolit të saj (pellazg) në krijimin e qytetërimit perëndimor, Kosova është qendër jo vetëm e historisë shqiptare por edhe të asaj perëndimore. (Buxhovi: Libri 1. F. 8-9.).

Faktografia e Buxhovit rreth dëshmisë dhe kontinuitetit pellazgo-dardan-shqiptar ka në esencë vetëm një burim: Homerin! Këtë çështje ai e «zgjedh» duke përsëritur për të satën herë burimet që i kemi lexuat tek Hahn-it dhe te «Historia (zyrtare) e Popullit Shqiptar» (Buxhovi: Kosova. Libri 1, 13 -19 dhe 31 – 50). E tërë hipoteza konstruktohet gati pa asnjë burim tjetër (si burime të vetme i shërbejnë edhe Fjalori Mitologjik dhe 5 vargje të Homerit, ku flitet për Dardanosin. Po aty, 121-128.).

Po çka thonin në fakt Homeri, Hesiodi, Herodoti, Thukididi, Isokratesi, Demostenesi etj., të cilët Buxhovi i përdor si burime për të argumentuar tezën se pellazgët janë paraardhës të Dardanëve dhe Ilirëve? (Buxhovi, Libri 1, 13 -19 dhe 31 – 50).

T'i rilexojmë përqëndrushëm këto burime.

## POETËT

a) **Homeri.** Po lëmë anash atë «çështjen homeriane» mbi të cilën debatojnë shkenctarët e letërsisë dhe po analizojmë homerin jo si poet, por sikur të ishte një burim i besueshëm shkencor. (Që don të thotë se ne këtu funksionalizojmë parimin e kontingjencës filozofike – e marrim diçka si të mundshme edhe paralelisht si të pamundshme). Në ndihmë e thirrimit studimin e Profesorit të emerituar heidelbergas Armin Wolf, i cili me dekada të tërra humumtoi për të rekonstruuar një gjeografi të saktë të vendeve homerike. Në veprën e tij «Udhëtimi i Homerit – gjurmëve të Odiseut» (Wolf, Armin: Homers Reise. Köln/Weimar/Wien/Böhlau, 2009, 393-409) nuk hasim vendet e Buxhovit. Në listën e emrave dhe vendeve, në fund të librit nuk gjejmë as Ilirët e as Dardanët (por Dardanelet si lokalitet ku ekzistonte Illioni). Për herë të parë Homeri i paraqet pellazgët si banorë të Arbosit (Homer,

Ilias, 2, 681. Übersetzt von Johann Heinrich Voss, erschienen bei Parkland, Köln 2000). Njëqind e gjashtëdhjetë rreshta më tutje Homeri thotë:

*«Dhe Hipotosi udhëhiqte fiset e mjeshtëurve në gjuatjen e shtizës.  
Pellazgët, banorët e Larisës tmerrmbjellëse» (Homer, Ilias, 2.  
840)*

Homeri Pellazgët i paraqet si një popull shumëfisnor. Në këngën e dhjetë sërish pellazgët fisnikë së bashku me paionët, lelegët, karët dhe kaukonët (Homer, Ilias, X, 426-429). Më vonë në këngën e gjashtëmbëdhjetë pellazgët kanë edhe Zotin e tyre, Zeusin, i cili jetonte në orakullin Dodona të Epirit (Homer, Ilias, XVI, 233-235). Tek Odiseu Homeri i gjenë pellazgët fisnik duke banuar së bashku me dorët dhe kidonët në ishullin Kreta, ku jetonin të përzier shumë «gjuhë dhe popuj» (Homer, Odyssée, 19, 170-178).

**Pra, sipas Homerit pellazgët ishin njerëz fisnikë, të cilët jetonin gati gjithandej: në Kretë, Epir, në Larisë, besonin Zeusin dhe ishin shigjetarë të mrekullueshëm.**

Paralelisht Homeri ka edhe një nënrrëfim, atë të Dardanëve. Në këngën e dytë të *Iliadës*, Enei, i biri i Afroditës është aleat i Trojës dhe udhëheqë dardanët në luftë (Homer, Ilias II, 819). Në këngën e tretë flet Agamemnoni dhe thotë: «...Dëgjoni fjalën time ju trojanë, ju dardanë dhe miq të tyre» (Homer, Ilias, III, 456). E njëjta thirrje e Agamemnonit paraqitet edhe në këngën e shtatë (Homer, Ilias, VII, 348). Në këngën e tetë Hektori i këshillon luftëtarët e tij dardanë, trojanë dhe likenas që të luftojnë me trimëri kundër grekëve (Homer, Ilias, VIII 173).

Homeri i paraqet Dardanët si pjesë të Trojës (si banorë të qytetit Dardanos, lexo më poshtë Herodotin), pra si banorë të bashkësisë trojane të cilët shkojnë në luftë për të mbrojtur

mbretërinë e tyre nga armiqtë e jashtëm, po si likenasit dhe fiset tjera që popullonin Trojën e e atëhershme.

**Në dy epet e Homerit nuk ka as edhe një fakt, sipas të cilit pellazgët fisnikë të Epirit, Larisë dhe Kretës, do ti asocionte, pra do t'i vënte në kontekst me Dardanët.** Meqenëse në botën e Homerit të dy fiset jetojnë në të njëjtën kohë e në rajone të ndryshme dhe me karakteristika të ndryshme, do të dilte jashtë logjike rrëfimi nëse Homeri do t'i paraqiste pellazgët si pasardhës të dardanëve.

b) **Hesiodi** e përsëritën atë (sipas Strabonit, *Geographica*, 7.7.10) që thoshte Homeri, përkatësisht: Zeusi ishte Zoti i pellazgëve dhe më tutje plotëson; emrin e tyre pellazgët e morën nga babai i tyre Pellazgos, i cili ishte edhe babai i mbretit Lykaon dhe të atij të Arkadisë (Arkadia shtrihej – hulumtuesit edhe për këtë nuk janë unik – në Sicili ose në Peleponez). Përndryshe nga këtu nuk rezulton asgjë relevante që do të hynte në funksion të sqarimit të çështjes pellazge.

c) **Letrarët e tjerë: Eskili** në pjesën e tij mbi Danaidën thotë: Të ikurit nga Egjipti gjetën mbrojtje te mbreti Pellazgos nga Argosi (Aischylos, *The Suppliants*, Zeile 249-25t). Sipas tij ky rajon gjendej në Mikenë, ne pjesën e Thesalisë. **Sofokliu** i përshkruan tyrsenoi –pellazgët si populli më i vjetër i vendeve Argos, qendra e të cilëve ishte Larisa (Sophokles, *Fragment Die Männer von Larissa*, 61-64, 157 -58) dhe *Fragmenti Inachos* 347 (243.) në gjermanishte përkthyer nga Dietrich Ebener, Aufbau Verlag, Berlin, 1995). **Euripidi** Argosin pellazg e vendos si skenë të tragjedisë së tij *Orestia*. (Euripides, *Orestia* S. 197 in der Übersetzung von Johann Gustav Droysen, Kröner Verlag, Stuttgart 1944.)

Ndërsa poeti i mëvonshëm romak **Ovidi** proklamoi pellazgët si aleat të grekëve:

«Parisi nuk ishte aty [...] ai që solli luftën e kobshme në atdheun e tij

Bashkë me femrën e rrëmbyer, Atë e ndjeknin anije të përbetuara, mijëra sish,

Dhe e gjithë bashkësia e fisit pellazg». (Ovidius Naso, Publius: Ovids Metamorphosen. 3 Bde., Berlin, Band 3, S. 31-56).

Edhe tek Ovidi shihet se Homeri ishte burrimi dhe inspirimi kryesor i poetëve dhe shkrimtarëve të antikës dhe pasantikës. Versioni i tij i historisë mbi pellazgët, aty këtu me ca nuanca, rrëfëhet edhe më tutje njëjtë. Më vonë Pellazgët gjithnjë e më shumë zhduken si motiv nga krijimtaria letrare e kohës.

## HISTORIANËT DHE GJEOGRAFËT

Historiani dhe gjeografi milezian **Hekati** nga **Mileti** (560-480 p.e.s. meret si historiani i parë i njohur) në veprën e tij *Genealogiai* shkruan dy herë për pellazgët, të cilët i paraqet si «genos» që në përkthim do të thotë «fis», «klan» (Hecateus von Milet von Klausen, Rudolf Heinrich, Berlin 1831, Fragment 224, f. 140 dhe Klaus Meister: Die griechische Geschichtsschreibung. Stuttgart 1990). Në një fragment tjetër ai rrëfen që Pelasgos ishte biri i Zeusit dhe Niobes dhe që ai – Pelasgos – kishte një djalë me emrin Lykaon, i cili themeloi dinastinë e mbretërve të Arkadias (Po te Klausen, fragmenti 224).

Pasardhësi i Hekatiotit, **Hellanikos nga Lesbosi** (480-400 p.e.r.) në fragmentin e tij të 76 numron disa mbretër pellazgë: Frastorin, Amyntorin, Teutamidesin (të cilin e përmend edhe Homeri si Teutames) dhe Nasasin. Mbretër që sundonin zonat e Thesalisë dhe Peleponezit. Si pasardhës të pellazgëve Hellanikos i sheh Etruskët, të cilët edhe te Sofokliu paraqiten

si Tyrsenoi-Pelazgë (Hellanicus, Sturz & Canteri, 1826, S.108-109).

Nga Etruskologjia e sotme, e cila aktualisht është ngritur në një disiplinë shkencore, mësojmë se Etruskët nuk janë mit por realitet. Edhe Hellanikos mund të akceptohet si dëshmitar i kohës. Pasi në këtë hapësirë kohore Etruskët janë një perandori e cila në mënyrë permanente gjendet në luftë – Beteja e Cuames 474, Lufta kundër Samnitëve 430, Lufta me Romën 406 etj., (Weltgeschichte, dtv, München, Vëllimi i aktualizuar. 3, 2010, 73). Që nga mesjeta e vonshme deri më sot janë gjetur dhe janë studiuar një numër i madh artefaktesh arekologjike dhe linguistike që kanë të bëjnë me epokën e etruskëve. (Po aty.)

Në vitin 2007 Universiteti i Turinit u bëri një hulumtim gjeneve të elementeve etruske dhe erdhi në përfundimin se Etruskët ishin të ardhur nga Lydia antike. Etruskologu **Guido Barbujani**, i cili gjenotipin e studioi në mënyrë krahasuese konstaton që një e treta e aleleve mitokondriale (kjo në fushën e hulumtimit të gjeneve përcakton formimin e një gjeni i cili gjendet në një vend të caktuar në kromozom. Përmes variacioneve në bazën e Analizës së Gjeneve krijohen forma të ndryshme) janë të njejta me ato të popullatës anadollake (Guido Barbujani: Die Etrusker - eine populationsgenetische Studie. In: Günter Hauska Hrsg.: Gene, Sprachen und ihre Evolution. Regensburg: Universitätsverlag 2005, 185.). Shpërnguljen e Etruskëve nga Azia e Vogël për në Itali Gjeoarkeologu **Eberhard Zangger** e spjeron me krizën politike të shek. 12 në Azinë e Vogël e cila u krijua me përmbyshjen e shumë mbretërive në fund të epokës së bronzit (Eberhard Zangger: *Ein neuer Kampf um Troia. Archäologie in der Krise*. München: Drömer-Knauer 1994.).

Padyshim se **Hellanikos von Lesbos** nuk ia qëllon rreth prejardhjes së Etruskëve, por jo edhe Herodoti i cili e rrëfen një histori e cila në asnjë mënyrë nuk kundërshton Barbujanin dhe Zanggerin (Herodot, Historien. 1, 94, përkthyer nga A. Horneffer dhe riedituar nga H. W. Haussig, Alfred Kröner Verlag, Stuttgart, 1971, 48). Përkundrazi; nga studimet e reja kundërshtohet teza e hulumtuesit gjerman të pellazgëve Eduard Meyer (Meyer, Eduard: Geschichte des Altertums. Vëll. 5. Berlin: 1884-1902 si dhe ribotime të shumta pastaj) i cili historitë e Herodotit i gjykonte si gjysmëfiktive, sepse ai shkruan për një qytet Kresto (edhe pse arkeologu dhe profesori Richard Lepsius qysh në vitin 1842 mund të argumentonte se Herodoti flet për qytetin Kroton në Umbri, pra aty ku në të vërtetë jetonin pellazgët. Në: Lepsius, Richard: Über die Tyrrhenischen Pelasger in Etrurien und über die Verbreitung des italischen Münzsystems von Etrurien aus, Georg Wigand Verlag, Leipzig, 1842, 3.) në vend të Kroton, qytet i cili nuk duket të ketë ekzistuar ndonjëherë.

**Herodoti** rrëfen historinë e Pellazgëve kështu: Në librin e tij të parë, fragmenti 57 ai e pranon që nuk njeh gjuhën e pellazgëve; se pellazgët ishin fqinjët e mëhershëm të Dorëve dhe e banonin Thesalinë, Plakinë dhe Skylakën dhe se shumica e tyre ishin bërë (asimiluar) helenë. Në fragmentin 146 ai replikon kundër supozimeve që jonët na qenkan «gjak i pastër» dhe numëron një numër popujsh të cilët banonin në qytetet jonase e në mesin e tyre edhe akadianët pellazgë.

Për të theksuar edhe më tej procesin e përzierjes së popujve dhe kulturave të atëhershme, ai në librin e dytë të tij shkruan se shumica e emrave të Zotërave të helenëve ishin me prejardhje egjiptase dhe pellazge. Në librin e katërt Herodoti flet për një konflikt në mes të pellazgëve dhe argonautëve, gjatë të cilit të parët i përzënë të dytët nga Lemnosi. Pas një

kohe edhe vet pellazgët përzëhen nga Lemnosi dhe Imnosi nga persiani Otanes, sikur që thotë Herodoti në librin e pestë fragmenti 26. Në librin e gjashtë, fragmenti 136, pellazgët përmenden në kontekst të një procesi gjyqësor kundër Miltiades. Si rrethanë lehtësuese mbrojtësit e përmendin luftën heroike të Miltiades në betejën e maratonit kundër pellazgëve. Në librin e shtatë, fragmenti 97, Herodoti përmend Joninë (venbanimi i jonëve ishte para së gjithash Greqia Qëndrore – Atika me Athinën e mëvonshme dhe Euböa).

Në librin e tij tetë, fragmenti 44 Herodoti thotë se Hellasi (Hellas rrjedh nga emri i fisit të Thesalisë Jugore dhe nga emri i qytetit jo larg nga Farsalos, tek Homeri si Distrikt Phthia stërgjyshi i të cilit ishte Hella) më herët kishte qenë në duart e Pellazgëve (Herodot: Historien. I 56ff, 146; II 50ff; IV 145; V 26; VI 136ff; VII 94f; VIII 44.).

Për Ilirinë dhe Ilirët Herodoti flet shumë pak, por me aq qartësi sikur bashkëkohësit e tij ta dinin saktësisht se për cilin vend është fjala. Kur ai pas udhëtimit të tij provon t'i përshkruaj zakonet e asirasve, i krahason zakonet e tyre me ato të fqinjëve të tij ilirë. Në përpjekjen e tij për të skicuar një gjeografi të Skytisë ai e përmend edhe lumin Angros, i cili atje rridhte nga Iliria. Në librin e tij të tetë, fragmentin 137 Herodoti rrëfen historinë e ikjes e tre vëllezervë Gauanes, Aeropos dhe Perdikkas, të cilët përmes Ilirisë arrijnë në Maqedoninë e Epërme (Linguistët dhe shkencëtarët e gjuhësisë si Otto Hoffmann, Ivo Hajnal, Hermann Bergston dhe të tjerë Maqedonët i radhisin si fis grekësh, të cilët ishin të veçantë, pasi ata ishin përzier me Ilirët dhe Thrakët. (Herodot. Historitë, I 196; IV 49; VIII 137; IX 43.)

Për Dardanët Herodoti flet në librin e tij të parë, pestë dhe shtatë. Kur Herodoti raporton për vendin Dardanos i cili



përkalohet nga mbreti pers Kyros, gjatë pushtimeve tij në Babiloni, pa dyshim se e ka fjalën për qytetin në bregun aziatik të **Turqinë e sotshme, Helespontin**, respektivisht provincën **Çanakkale** ku më vonë edhe ndodhi beteja e famshme e Galipolit. Për të njëjtit dardanë ne lexojmë edhe tek **Tukididi** (8.104) (Thukydides: Der Peloponnesische Krieg. Në gjermanishte përkthyer nga Georg Peter Landmann. Düsseldorf 2002.). **Straboni** (13,1,28) rrëfen se si gjatë luftës në mes të Romakëve dhe Antiohisë, Dardanët e Hellespontit iu bashkuan romakëve. Për çka banorët e qytetit Dardanos pastaj u shpërblyen nga Roma me statusin *civitas libera*, gjë që mund të lexohet edhe te **Titus Livius** (38,39,11) (Po aty, I 189; V 117; VII 43.).

Edhe historianë dhe gjeografë të tjerë të kohës antike si **Eforus, Dionisos, Pausianus** e përsërisin të njëjtën teori pellazge e cila fillimisht gjindet te Homeri dhe Herodoti.

Po konstatojmë se asnjë poet, shkrimtar tragjedishë dhe gjeograf i antikës së hershme dhe të vonë nuk na jep asnjë arsye – madje edhe asociative – që Pellazgët të kenë ndonjë lidhje me ilirët, maqedonët apo grekët. Një ndërlidhje e tillë ekzistonte, mirëpo me Dardanët e Dardanellës së Ilionit e jo me të tjerët. Buxhovi me qëllim ndërron Dardanos me fisin e Dardanëve (që nuk luanin ndonjë rol më herët), i cili jetonte në periferi të Ilirisë Jugore dhe më vonë themeloi edhe mbretëritë e veta.

Deri më sot nuk ka asnjë indikacion, i cili do të konfirmonte fatin e pellazgëve në njëren apo tjetren fazë të historisë. Ndërtimet cikloprike, të cilat Buxhovi i paraqet si specialitet pellazg (Buxhovi, Kosova, Libri 1, 66.), janë arkitekturë dhe formë vendbanimi karakteristike e kohës së vonë të bronzit në Transkaukaz (1500-780), siç na dëshmojnë arkeologët dhe historianët Bernbeck dhe Kohl (Bernbeck, Reinard: Politische Struktur und Ideologie in

Urartu. Archäologische Mitteilungen aus Iran und Turan 35/36, f. 267-312 për kohën e vonshme të hekurit shih edhe Kohl, Philip L: Migrations and Cultural diffusions in the later Prehistory of the Caucasus. Në: Ricardo Eichmann/Hermnann Parzinger Hrg., Migration und Kulturtransfer. Bonn: Habelt 2001, S. 324).

#### «ARGUMENTI» MITOLOGJIK

Mitet që në studimet mbi mitologjinë antike njihen si *cikli tebanik* (Kereneyi, Karl. Die Mythologie der Griechen, dtv, München, 22. Auflage, 1960/2008.) në librin e Buxhovit transferohen si botë mitologjike pellazgo-dardane (Buxhovi, Kosova, Libri 1, 57-65.). Pohimet e tij mbështeten në dy indikatorë: 1 Herodoti pohon që Helenët i kanë Zotërat e tyre nga egjiptianët dhe pellazgët dhe 2. Biri i Kadmosit dhe Harmonias quhej Illyros, ky i fundit themeloi Illirinë.

Llogaria duket mjaft e thjeshtë dhe logjike. Megjithatë nga kultura oborrtare e epokës mikeno-mionike, nga Teba në Boeti, aty ku gjeneologët i gjetën këto rrëfime mitologjike (750 – 500 p.e.s.) dhe i shkruanin në heksametrin daktilik të greqishtës së vjetër, kanë mbetur rrënime dhe mbishkrime të cilat tregojnë një histori krejtësisht tjetër dhe të veçantë, kështu duke rrëzuar çdo autoritet të miteve për të shërbyer si argumente shkencore. Ato nuk shërbejnë gjithaq kur tentojmë të bëjmë rekonstruimin e identitetit kulturor të fiseve. (Kereneyi, Karl: Die Mythologie der Griechen, 7-42.). Pse?

Kadmosi - babai i Illyros – ishte i biri i Agenorit dhe mbreti më i madh i Tebës. Përtej botës së legjendave, sidomos atyre me kulçedrën dhe themelimin e Tebas, (të cilën Buxhovi e integron në sqarimin e tij të miteve pellazgo-dardane) ekzistojnë qindra gjetje të cilat vënë në në dritë historinë më

të faktizuar të këtij rajoni dhe rikonstruktojnë përmasat religjioze të kohës.

Në një numër të madh tabelash lineare B janë mbi njëqind vula asirike nga shekulli 13, të cilat e argumentojnë varësinë e Tebës nga mbretërit e Mesopotamisë. Shumica e hetitologëve nisen nga fakti se tebanët janë pjesë e diasporës së mbetur nga invazionet e hershme të ardhura nga rajoni i lumit Tigris. Ky supozim forcohet edhe më shumë për shkak të luftërave të vazhdueshme të Tebës kundër Athinës dhe për përkrahjen permanente që tebanët ua bënin asirasve, persëve dhe perandorive tjera të Azisë Qëndrore dhe Anadollit. (S. Deger-Jalkotzky, O. Panagl (Hrsg.): Die neuen Linear B-Texte aus Theben Akten des internationalen Forschungskolloquiums an der Österreichischen Akademie der Wissenschaften am 5. und 6. Dezember 2002, Wien 2006.).

Domethënës në këtë mes janë letrat e përmbledhura në alfabet pykor dhe në një hetitishte të çalë e të cilat i ishin adresuar mbretit hetit *Hattušili II*. Hetitologu dhe orientalisti i famshëm Frank Starke i dëshifroi ato si raport të tebanëve për mosmarrëveshjet ndërmjet tyre me ishujt tjerë të egjeut verior që kishin rreth çështjes së Trojës. Shumica e letrave përmbajnë emrin e Kadmos dhe Etokles. (Starke, Frank: Die keilschrift-luwischen Texte in Umschrift. Wiesbaden: Harrassowitz 1985.)

Kjo gjendje e fakteve, karahasuar me historinë e rekonstruktuar të Buxhovit, rezulton një përfundim logjik, e cila historianit kosovar sigurisht se nuk do t'i pëlqejë fare:

- a) Kadmosi fillimisht ishte një mbret hetit. Duket sikur – sipas autorëve antik të cilët i citon edhe Buxhovi – edhe Pellazgët dhe të tjerët ta kanë pranuar Kadmosin si mbret/zot të tyre.

- b) Është e sigurt që hetitët ishin një popull i Azisë së vogël i cili jetonte në Sirinë dhe Palestinën e sotme.
- c) Është e sigurt që tebanët korrespondonin në gjuhën hetite madje edhe atëherë kur greqishtja vlente si «gjuhë univerzale» e rajonit. Për këtë arsye edhe epiteti «barbar» i Herodotit për pasardhësit e hetitëve, të cilët nuk flisnin greqishten.
- d) Sipas kësaj sage, Illyros është biri i Kadmos dhe gruas së tij Harmonia (ose Niobe, varësisht nga forma e recipimit).
- e) Illyros themeloi mbretërinë me emrin Iliria.
- f) **Conclusio:** Pra, ilirët, dradanët, respektivisht shqiptarët dalin si (sikur edhe pellazgët, pasi që Kadmos ishte edhe babai i Pellagosit) etni me prejardhje hetite, respektivisht siriko-palestineze.

Këtu ne nuk dëshirojmë të shumëzojmë edhe më tej spekulimet lidhur me prejardhjen e Ilirëve, Pellazgëve Thrakëve etj., por vetëm shërbehemi me formulën zenonike të paradoksit, për të tërhequr vëmendjen në kontingjencën (kontingjencë – nga logjika – formë e dëshmisë e cila sikur që mund të jetë e saktë mund të jetë edhe e gabuar) të cilën e përmbajnë shumica e e teorive që përpiqen të dëshmojnë prejardhjen etnogjentike të popujve në sajë të arsenalit mitologjik.

Shkencëtari i letërsisë Hanjo Kesting, para pak kohësh solli një analizë të mrekullueshme krahasimtare të teksteve më të vjetra të qytetërimit. (Kesting, Hanjo: Grundschriften der Europäischen Kultur- Antike, Mittelalter, Renaissance und Neuzeit. 3 Bde. Göttingen: Wallstein Verlag 2012). Në librin e tij të parë mbi antikën, gjatë krahasimit të Epit të Gilgameshit, veprave të Homerit, Biblës dhe autorëve të tjerë

deri te *Germania* e Tacitit ai në mënyrë tejet koncize mund të tregojë se si mitet dhe ndodhitë (?) e botës mesopotamike të Gilgameshit mund të gjinden edhe tek veprat e Homerit, Bibla, te Eskili, Sofokliu, Platoni, Vergjili, Ovidi e kështu me radhë. Zotërat në mënyrë permanente ndryshojnë emrat, gratë dhe fëmijët e tyre, ndërsa narrativja mbetet gjithmonë e njëjtë. (Po aty. Libri 1 mbi antikën). Madje edhe Herodoti tërheq vëmendjen të ketë ka patur zhvendosje mitesh në mes të popujve dhe fiseve. Nga historia e kulturës së antikës dimë që bota e zotërave dhe të ashtuquajturave vende të shenjta shërbenin si pikëtakime për grupe të ndryshme gjuhësore dhe kulturore. Atëbotë – kur nuk ishte prezente ideja e kombit, etnisë – dyndjet e popujve, përzierjet, lidhjet dhe asimilimi ishte një normalitet shumë më i fortë se sa më vonë. (Bringmann, Klaus. *Kulturgeschichte der Antike*, München 2011, S. 139-141.)

Termet kryesore *Helenët* dhe *Barbarët*, të cilat Buxhovi i përkthen si ilirë dhe grekë, në fjalorin e autorëve antikë nuk kishin asnjë kuptim tjetër përpos se për të dalluar njerëzit në greqishtfolës dhe jogreqishtfolës. Në historinë e apostujve (6.1) edhe hebrenjtë që jetonin atje definohej si helenë (Thompson *Studien-Bibel. Ribotim i reviduar* 1984). Hebrenjtë – sikur që dihet – nuk kishin të bënin asgjë me religionin dhe kulturën greke. Madje si barbarë janë etiketuar edhe vet grekët që nuk zotëronin pa gabime gjuhën, pra të tillë nuk janë quajtur vetëm «fiset e prapambetura» dhe brutale, që kundërshtonin t'i dorëzonin armët në portat e Polisit (Todorov, Tzvetan: *Die Angst vor den Barbaren*. Hamburger Edition, 2011. f. 28-28), por gjithë ata që nuk flisnin gjuhën e Homerit.

Përveç të gjitha problemeve të cekura më lartë, sa i përket rolit të miteve në identifikimin e kulturave të veçanta, as në

intepretimim mitologjik nuk ekzistojnë nje familjare e kombinacione që do t'i lidhnin konkretisht e qartë pellazgët me Ilirët ose Hetitët, Etruskët, ose Tebanët me Dardanët ose Ilirët.

Mitologjia si e tillë duket sikur tu ketë takuar të gjithëve. Secili popull i ka interpretuar e përdorur ato sipas nevojave të veta. Shkenca e mitologjisë deri më sot nuk ka mundur të thotë (dhe duket mjaft vështirë se do të sqarojë diçka edhe në të ardhmën) se cili zot kujt i ka takuar, ashtu siç thotë Arkeologjia sot se në Evropën Juglindore kanë jetuar një numër i madh i kulturave, religjioneve dhe popujve, të cilët në mënyrë koalicionesh formonin rajone dhe mbretëri për të mbijetuar nëpër kohë dhe situata. Prandaj me plotë të drejtë profesori dhe specialisti i Europës Juglindore nga Mynihu Edgar Hösch me tezën e tij shkruan se: «Përzierja irrituese etnike e Evropës Juglindore është rezultat i proceseve asimiliuese ndërmjet popujve autoktonë dhe dyndjeve që kanë ndodhur vazhdimisht e ndër shekuj» (Hösch, Edgar. *Geschichte der Balkanländer*, C. H. Beck Verlag, München, 2. Aufl. 1993, S. 21.).

Historia e antikës romake (Huttner, Ulrich. *Römische Antike*, Attempto Verlag, Tübingen, 2008.) dhe ajo e antikës së vonshme (Demandt, Alexander. *Geschichte der Spätantike – Das Römische Reich von Diokletian bis Justinian*, C.H. Beck Verlag, Aufl. 2, 2008.) sjellin argumente të mjaftueshme për atë se parimi ligjor romak «*Dum nullum fastiditur genus, in quo eniteret virtus, crevit imperium Romanum*» (shqipëruar: «pasiqë askush nuk u përjashtua në sajë të prejardhjes dhe ajo (Roma) pranoi çdo njeri të zellshëm u rrit perandoria Romake», cituar sipas Demandt Alexander, *Geschichte der Spätantike*, S. 288.) i ka rrënjët qysh më herët, në imperitë

madje edhe të shekullit 20 p.e.s, si në orient ashtu edhe në okcident. (Po aty.)

## ÇËSHTJA ILIRE

Historiografi i sotshëm është i detyruar që edhe strukturat organizative politike e kulturore të mbretërive Ilirë dhe dardane t'i vështrojë nga ky kontekst. Posaçërisht në Ilirologji, kjo lloj perspektive është me rëndësi kapitale, ngase, gjersa tek grekët dhe romakët mund të fiksohen disa karakteristika kulturore-identitare, tek figurat sunduese ilire kjo gjendje është shumë më komplekse dhe më spekulative. (N. G. L. Hammond, *Illyrians and North-West Greeks*, in *CAH: VI2* 1994, 427 f.; J. MORRIS, *Archaeology and Archaic Greek History*, in: N. FISHER, H. VAN WEES [s. o. A. 2] 40 f.; 50; 57). Studiuesi i antikës, i vdekur në vitin 2001 Nicholas Geoffrey Lemprière Hammond përshkruan raportet e brendshme të Ilirisë si një konglomerat bashkësisë fisnore dhe popujsh (Koinons), të cilët zinxhirin e urdhërave mbretërorë i akceptonin vetëm në kohëra lufte, atëherë kur viheshin në rrezik resurset e tyre ekonomike. (Po aty.)

Tek të njëjtat rezultate vjen edhe arkeologu gjerman i mesjetës së hershme dhe editori i Leksikonit Real të Antikës gjermane Heiko Steuer, i cili shkruan se në Iliri mbreti kishte kompetencë vetëm në kohëra lufte përderisa në kohë paqeje zotëronte një «liri, një an-arki në kuptimin më burimor të fjalës» (Steuer, Heiko. Artikel: Häuptling, Häuptlingstum, në: *Reallexikon der Germanischen Altertumskunde* 13 (1999) 291-31, 1 298 f.). Pierre Carlier në studimin e tij «*Rois illyriens et „roi des Illyriens“*» konfirmon edhe më bindshëm këto rezultate duke shpjeguar se pikërisht kjo mungesë e fakteve materiale është arsyeja se përse mbi perandoritë mbretërore ilire ekzistojnë aq pak fakte (me përjashtim të disa monedhvea në greqisht dhe latinisht), gjë që pamundëson krijimin e një

historie më pak spekulative rreth rolit të Ilirëve në kohë të caktuara. (Carlier, Pierre. Rois illyriens et „roi des Illyriens”, in Ill. I [s. o. A. 1] 39-46, N.G.L. HAMMOND, The Illyrian Kingdoms, circa 400 – 167 B. C., ABSA 61, 1966, 239-253. 6 z. B. „Könige” der Encheleis, Taulantier, Ardiaier, Stellen bei CAarlier 47. 1994.)

## PARADIGMAT DHE MUNGESA E FAKTEVE

Përkundër kësaj faktologjie gati inekzistente (një ankesë e ardhur kryesisht nga arkeologët) në Ilirologji ka një paradigmë e cila përfaqësohet nga shumë shkenctarë seriozë, në mesin e tyre edhe historianë me nam të kohës si: Peter Bartl, Peter Jordan, Klaus Steinke, Wilfried Fiedler, Walter Raunig, Noel Malcolm, Edgar Hösch, Karl Kaser, Wolfgang Zeitler, Joachim Matzinger, Stefan Troebst etj. Ky ekip hulumtuesish nuk përmendet fare në historiografinë e Buxhovit, ngase këta kontinuitetin e shqiptarëve të sotëm nga Ilirët e paraqesin vetëm si të mundur (kontingjent – e mundshme ose jo). Në historiografinë e Buxhovit për Ilirët, Dardanët dhe Shqiptarët paraqitet vetëm doktrina shtetërore e «Historia e Popullit Shqiptar» (Akademia e Shkencave, Toena, Tirana, 2002.), e shoqëruar me citatat e tjetërsuara të Peter Bartl, Stadtmüller dhe shkenctarëve tjerë të variantës së kontingjencës. Ai harron në listën e burimeve ta përmend Michael Wheatmann (Balkanchronik), historianin aktual i cili është në po të njëjtën linjë me të dhe me historinë zyrtare. Burim kryesor (madje edhe duke keqpërdorur, sikur që do të shihet tek çështja dardane) të dy librave ka vetëm *Historinë* zyrtare.



## DARDANIA – TRAKE APO ILIRE?

Grupin tjetër të shkencëtarëve, të cilët e përjashtojnë teorinë e prejardhjes ilire së shqiptarëve, Buxhovi e denoncon si propagandues të historiografisë serbe (në fakt historiografia serbe bën gjithçka që shqiptarët të i lokalizojë si të ardhur nga Kaukazi ose Palestina, çka edhe Buxhovi e bën padashje me argumentet e tija mitologjike). Buxhovi e hesht faktin se kjo teori që indentifikon shqiptarët si pasardhës të trakëve rrjedh nga linguistët me famë botërore si Gustav Weigand, Georg Solta, Françoise Bader, Claude Brixhe etj. Për ne mjafton vetëm të dijmë të lexojmë për të parë se këta autorë nuk janë serbë. Edhe pse Buxhovi përjashton tezën trake, ai si duket «pa vetëdije» bëhet përkrahës i saj. Si?

Për arsye se Buxhovi Dioklecianin dhe Justinianin i paraqet si figura që sigurojnë kontinuitetin e traditës pellazgo-iliro-dardane, mbretër që kontribuojnë që Dardania të ngritet në djepin e fundit dhe më me rëndësi të kulturave antike. Me këtë Buxhovi *in silentio* provon ta ushqejë tezën e supermacisë kosovare ndaj trojeve tjera shqiptare. Që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, shtresa të caktuara intelektualësh kosovarë, në favor të krijimit të një identiteti të veçantë, tentojnë që famën e Ilirisë ta bartin nga Dalmacia dhe Adriatiku shqiptar i Durrësit – në të njëjtën formë sikur edhe ilirologët modern slloveno-kroat – e ta deplasojnë në Kosovën e sotme. Me këtë Buxhovi tenton të vë në lëvizje një rikonfigurim të vetëdijes panshqiptare, e cila nuk do të absorbonte më Shqipërinë si «mëmëdhe» sikur deri tani, por Kosovën. Një strategji identike me atë të serbëve, të cilët

dëshirojnë të stampojnë Kosovën si «djep të kombit serb». (Buxhovi, Kosova, Libri I, 235-499.).

Të kthehemi tek «mbretërit pellazgë, ilirë dhe dardanë Diokleciani, Konstantini dhe Justiniani» të Buxhovit.

Në 30 vitet e fundit janë bërë studime të panumërta për figurat qëndrore të perandorive romake. Në kuadër të kësaj edhe shumë monografi shkencore mbi tre mbretërit e lartpërmendur. Në mënyrë të akumuluar i gjejmë rezultatet në studimin e profesorit të Historisë së Vjetër në Institutin Goethe të Frankfurt am Main-it, Hartmut Leppin. Libri i tij «Justiniani – eksperimenti i krishterë» vlenë si libri më i mirë dhe më ekzakt ndër monografite e publikuara deri më tani për Justinianin.

Çfarë shkruan Leppin?

Justiniani, respektivisht Petrus Sabbatium sikur që ishte emri i tij i vërtetë, rrjedh nga prefektura Illiricum, nga rajoni në mes të Scupi dhe Naissus (sot, Nish, Shkup). U lind në vitin 482 në Tauresium (Maqedonia e sotme). Për shkak të prejardhjes së tij, bashkëkohësit e atë e quanin *Traku*. Sikur që e thirrnin edhe Dioklecianin, Konstaninin e Madh dhe Valentianin, ngase që të gjithë kishin të njëjtën prejardhje. Justiniani kishte vëllezër e motra, në mesin e tyre edhe një motër me emrin Vigilantia. Justinianin prindërit e tij e pagëzuan sipas perëndisë trake Sabazius. Emër, të cilin ai e fshehte me qëllim për të bërë karrierë ushtarake në perandorinë romake. Për shkak të dialektit të tij trak, ai fliste një greqishte të çalë, por të njëjtën, sikur që e argumentojnë korrespondencat e tij, e shkruante në mënyrë të përkryer. (Leppin, Hartmut. Justinian – das christliche Experiment», Klett -Cotta Verlag, Hamburg 2011.).

Të marrim për ndihmë silogjistikën aristoteliane:

**Fjalia e sipërme:** Justiniani ishte trakas. Kishte emër të zotit trakas Sabattius (një zot i përafërt me Dionisin). Se çka ishin stërgjyshërit e tij (pellazg, hetitë apo diçka tjetër) nuk mund të argumentohet. Është e sigurtë se nuk ishin ilirë, ngase në kohën e tij njëkohësisht jetonin edhe fise të tjera të njohura si ilire. Në të kundërtën ai në burimet e kohës do thirrej «Iliri» e jo «Thraku». Logjike, apo jo?)

**Fjali e poshtme:** Ai fliste trakisht dhe një greqishte të çalë por shkruante shumë mirë në të dyja gjuhët. U bë perandor i Perandorisë Romake dhe e krishtëroi atë.

**Konkluzioni:** Justiniani nuk mund të ketë qenë pellazg apo ilir. Dardan ishte me siguri, ngase jetonte në provincën autonome historike të Dardanisë e cila ishte nën sundimin romak, provincë në të cilën jetonte një përzierje e fiseve, popujve dhe kulturave të ndryshme.

Me të njëjtën formë silogjike mund të funksionojmë edhe me dardanët e tjerë të Buxhovit. A ishin dardanët trakë dhe të fundit apo të parët shqiptarë? Edhe teza e Weigand nuk mund të merret seriozisht, ngase Dardania nuk kishte një strukturë homogjene kulturore. Weigand mund të mos ketë të drejtë, por Buxhovi edhe më pak, ngase ai në mënyrë indirekte e konfirmon Weigandin ama njëkohësisht dëshiron të mbetet ilir. Kundërshtitë në librin e Buxhovit janë të panumërta. Praktikisht secilen tezë të tij, po në këtë mënyrë, mund të trajtojmë deri në ad absurdum.

## TEZA APO PARULLA

Po shohim se në literaturën antike (që nga Homeri e deri te Ovidi) nuk ekziston as edhe një referencë e cila do të përkrahte qoftë edhe për së afërmi tezën pellazgo-ilire të Buxhovit. Asnjë nga shkruesit antikë të historisë dhe gjeografisë (që nga Herodoti, Tukididi, Straboni, Titusi e deri

tek Pausianus) nuk i sjell pellazgët në një lidhje me Ilirët e edhe më pak me Dardanët. Mitologjia nuk tregon asgjë tjetër përos faktin që zotat dhe format tjera fiktive ishin migrantë të përjetshëm nëpër popuj e kultura. Mitologjia mbetet një letërsi e bukur, një botë përrallash të cilat neve prifti Gustav Schwab na i ripërsëriti duke na i bërë edhe më të bukura, por ajo, tradita mitologjike, nuk guxon assesi të keqpërdoret për të rikonstruktuar ideologji të reja identiteti. Ne kemi ardhur në përfundim se rezultatet e reja shkencore nga linguistika, arkeologjia, historia e dyndjes së popujve, antropologjia, etnologjia dhe së fundmi edhe analiza e ADN flasin kundër mozaikut të hipotezave të Buxhovit, por edhe kundër doktrinave të shumta rreth autoktonitetit që shpërndajnë historiografitë e Evropës Juglindore.

Çka mbetet më e qëndrueshme në tezat e Buxhovit?

Si duhet të kuptojmë konstatimin e Buxhovit se; Autorët antik me fokusimin e tyre tek pellazgët dhe vlerat e tyre si paraardhës të helenëve i kanë hedhur për tokë të gjitha teoritë joshkencore të filohelenëve?

Cilët autorë antikë?

Ata të cilët ne posa i trajtuam dhe mbi të cilët duhet të ketë ndërtuar Buxhovi teorinë e tij, thonë krejtësisht diçka tjetër. Pikërisht për këtë shkak u hodh poshtë nga ilirologët, specialistët e antikës dhe të tjerë edhe teoria pellazge e Hahn-it. Për shkak se ajo është një interpretim i pasaktë i teksteve të autorëve antikë.

Teza e tij «Dardanët sikur të gjithë tjerët – fise ilire – janë pasardhës të pellazgëve dhe të gjitha tezat tjera në librin e parë janë për tu refuzuar si parolla të konotuara ideologjike dhe joshkencore.

Historiani romak Ammianus Marcellinus (330-400) shkruante: «Fara e gjithë të kqijave dhe zanafilla e katastrofave të shumta [...]sikur që kam kuptuar unë kishte këtë shkas: Popullin e Hunëve [...]» (Ammianus Marcellinus: Römische Geschichte von Wolfgang Seyfarth, Berlin 1968–1971 (Schriften und Quellen der alten Welt 21, 1–4). Buxhovi pohon të kundërtën: Ishin sllavët ata që në shekullin e VII e mallkuan Evropën duke e ndarë në lindje dhe në perëndim. Nga të gjithë «pushtuesit, sllavët ishin më barbarët», thotë autori (Buxhovi. Libri I, 330-350). Si burim referues për këtë pohim Buxhovi paraqet librin e Noel Malcolm «Kosovo a short History» (Pan Books, 2002). Por, në faqet e cituara (23-42) të Malcolm dhe të autorëve të tjerë (Jireçek, Ostrogorski), të cilat Buxhovi i përdor si referenca, sllavët nuk paraqiten aty më barbar se sa Hunët, Avarët dhe ekspansionistët tjerë. Natyrisht, të gjithë ishin brutalë, pra edhe sllavët.(Malcolm. Kosovo, S. 22-23) Do të ishte edhe e dyshueshme sikur Malcolm të pohonte diçka të tillë, ngase në 50 vitet e fundit (pas Jirecek, Ostrogorski dhe Shevill të viteve të 20 –ta und 40 –ta të shekullit të kaluar) janë bërë qindra studime të cilat përpos tjerash arritën të datojnë saktë valët ekspanduese drejt Evropës Juglindore. Në këto studime, sikur edhe te Malcolm (Kosovo, S. 22-23) dhe Jireçek (Historia e serbëve, ribotuar nga Jovan Radoniç, Beograd, 2006, Fq. 46), pushtimi sllav nuk datohet me shekullin VII sikur që thotë Buxhovi (Kosova, Libri I, 336), por në mesin e shekullit të VI, më saktë në mes viteve 547-550. Po këto data na i sjell edhe Profesori i Kings Colleg-it nga Londra Peter Heather me librin e tij «Invasion der Barbaren (Klett-Cotta Verlag, 2011, Stuttgart). Buxhovi keqkalkulohet për rreth 100 vjet.

Në këtë kapitull gati pa burime (ose me burime të falsifikuara) ekspandimi i avarëve, gotëve, hunëve të Attilas dhe Udines përkundër edhe burimeve të kohës (psh. Olympiodori, Prokopi, Hieroklesi etj.). sugjerohen si më pak brutale dhe më të parrezikshme se sa ato të sllavëve barbarë, të cilët në fakt vijnë nga të njejtat stepa dhe rrethina sikur edhe kolegët e tyre hunë. Seleksionimi i sllavëve si më barbarët dhe fajtorët për shkatërime nuk është i papritur, mirëpo shkencërisht i paqëndrueshëm (Demandt. Geschichte der Spätantike, F.1-8).

Ndërkohë, gati është e qartë se hunët para se të marshonin për në perëndim, jetonin në mes të lumenjve Don dhe Wolga në stepat euroaziatike (Rusia e sotshme). Sa i përket prejardhjes së hunëve, shkenca ushqehet me supozime. Disa i shohin ata me prejardhje kineze, disa të tjerë si iranianë turkfolës dhe grupi më i madh i hulumtuesve mendojnë se ishin paraardhësit e proto- dhe Wolgabullgarëve të cilët më vonë ndahen në dysh: në fisin e krishterë sllav (protobullgarë, shekulli 10) dhe në atë musliman (Wolgabullgar). (Jonathan Shepard: Slavs and Bulgars. In: The New Cambridge Medieval History. Bd. 2. Cambridge 1995, S. 228ff).

Heather, Demandt, Hösch, Malcolm dhe posaçërisht historianët e Historisë Romake, Huttner dhe Leppin, fajn për shkatërrimin e strukturës së popullatës dhe tregtise së Evropës Juglindore të asaj kohe e adresojnë tek hunët dhe avarët, e jo sikur që thotë Buxhovi, parimsht tek sllavët. Në kuptimin lokal dhe në një kuptim të kufizuar kohor Buxhovi ka të drejtë. Në fakt ishin sllavët ata që në vitet 547/548, demoluan dhe pushtuan Trakinë dhe Ilirinë deri në Epidamnos (Durrës). Të inkurajuar nga këto fitore, 13000 sllavë marshuan drejt Selanikut. Mungojnë dokumente për atë se deri kur mund të meren sllavët si zotërues të trojeve ilire. Është e sigurt se që nga viti 602 ndryshon historia kur

perandori i hershëm bizantin Maurikios i shtyu avarët dhe antët për të i përndjekur sllavët deri në Dalmaci dhe për të i shkatërruar ata. Diku rreth vitit 604, në Iliri hynë në fuqi sërish rrethanat romake. (Heather, Peter. Die Invasion der Barbaren, 364-365.). Më vonë, deri në shekullin e dhjetë sllavët dhe pasardhësit e tyre ishin të pushtuar nga të tjerët. Vetëm nga viti 950 e këtej historia merr shënim për ekzistencën e tyre, atëkohë kur fiset sllave provuan (dhe dështuan) të organizonin një kryengritje kundër perandorisë bullgaroperëndimore të Carit Samuel (Hösch, Edgar. Geschichte der Balkanländer, 57-5).

**Faciti:** Përpjekja e Buxhovit për të bërë vetëm sllavët përgjegjës për shkatërrimin e qytetërimit antikoeuropian është joserioze. Sulmet sllave ishin një pjesë e ekspansioneve që restrukturuan, prishën dhe rikonfiguruan demografinë dhe pluralitetin kulturor të popujve të asaj kohe në Ballkan, mirëpo krahasuar me ato parapraket e më të vontat, triumfi i tyre ishte fare i shkurtër dhe i pakrahashueshëm më dhunën e hunëve dhe avarëve.

Teoria e Buxhovit mund të kuptohet vetëm nga aspekti kontrafaktik: Nëse Iliria me të vërtetë ka qenë çerdhe e civilizimit antik, atëherë Buxhovi do kishte të drejtë. atëherë sulmet sllave do të ishin fajtorë për shkatërrimin e qytetërimit antik të europës juglindore. Natyrisht pra shikuar në mënyrë kontrafaktike.

#### BIBLIOGRAFIA SI ILUSTRIM

Lexuesit mund të mbeten të qetë. Ata të cilët kanë lexuar njëherë «Historia e popullit shqiptar» mundet të lënë anash librin «Kosova- Perandoria osmane», sepse s'do të humbin gjë. Është një përsëritje e mërzitshme e historiografisë

shqiptare. Aty-këtu Buxhovi përmend libra si «Kosovo a short History» të Malcolmit, «Crescent and the Eagle» të Georg Gawrych (London: I. B. Tauris, 2006.) ose atë të Oliver Jens Schmittit «Skanderbeg» (Skanderbeg – Der neue Alexander auf dem Balkan. Pustet Verlag Regensburg, 2009), por ato ai nuk i përdorë vërtet. Ai komenton dhe replikon me «Skënderbeun» e Schmittit pa bërë transparente se çfarë ka shkruar Schmitt. Asgjë nuk argumenton, por vetëm shkruan se studimi i profesorit nga Vjena nuk qëndron dhe pikë.( Buxhovi, Kosova, Libri II,71)

Indikatorë tjetër që flet për huazimin komplet të «Historisë e Popullit shqiptar», është edhe mungesa e informacioneve dhe dijes nga ana e të dyja palëve. Sikur «Historia» ashtu edhe Buxhovi shkruajnë për proceset e kohës osmane pa pasur ndonjë ide që vetëm në mes të viteve 2001 dhe 2007 janë botuar së paku 50 studime në anglisht, gjermanisht dhe frëngjisht, libra që sjellin burime të reja dhe të detajuara e që demantojnë interpretimet e shumta të viteve të pasluftës së dytë botërore e deri në vitet e tetëdhjeta.

#### ASNJË BURIM I 50 VITEVE TË FUNDIT

Vetëm një historian i cili nuk i ka bërë detyrat e shtëpisë si duhet guxon që panslavizmin ta reduktojë në një konflikt ruso-osman (Buxhovi. Kosova, libri II, S. 168-175). Pansllavizmi më shumë ishte një program kulturor antiperëndimor (N. J. Danilewskij. Rusia dhe Evropa Europa, 1880. Iwan Krijewski und Aleksej Chomjakov), i cili mbijetesën e sllavizmit e shihte vetëm përmes shkatërrimit të perëndimit (të inkurajuar më vonë edhe nga Oswald Spengler). Buxhovi tematizon pansllavizmin sllavojugor dhe nuk din të thotë se përpos serbëve, të gjithë sllavët e tjerë nuk ishin kundër vetëm monarkisë Austro-Hungareze dhe



Osmanëve por edhe kundër Ruisë sikur që mund të lexohet edhe në deklaratën e dalë nga Kuvendi i popujvë sllavojugor të mbajtur në Nish, më 7 dhjetorë të vitit 1914. (Withmann, Michael. Balkanchronik, 2000 Jahre zwischen Orient und Okzident, Teil III. Pustet/Styria Verlag, 2. Und erweiterte Auflage, 1997).

## VETËM DY BURIME NUK MJAFTOJNË

Duke ditur që ekzistojnë disa projekte të cilat mirren me rishkrimin e historisë shqiptare mendojmë se një debat edhe më i thellë me «Historinë e Popullit Shqiptar», të prodhuar nga kuzhinat ideologjike të së kaluarës do të ishte i tepërt, edhe pse vetë debati me Buxhovin është paralelisht edhe debat me «Historinë» e rrëmbyer nga ai.

Dy pjesët e para të librit të tretë (15-455), konform gjithë librave të tij, janë një përsëritje jokritike e «rezultateve hulumtuese» nga autorët e «Historia e Popullit Shqiptar» dhe të historiografisë serbe. Të reja këtu janë dy studime të cilat kanë të bëjnë posaçërisht me Kosovën në kohën e Jugosllavisë: Libri publicistik i Viktor Meier «Wie Jugoslawien verspielt wurde» (Beck Verlag, München, 1996.) dhe libri i edituar nga Dunja Melčić «Der Jugoslawien Krieg – Handbuch zu Vorgeschichte, Verlauf und Konsequenzen» (Verlag für Sozialwissenschaften, 2 Aufl. Wiesbaden, 2007). Në fakt kjo pjesë nuk sjell asgjë të re për hulumtuesit e gjuhëve të huaja, por për historiografinë shqipe po, ngase këtu për herë të parë ka të dhëna për burimet (së paku ë bibliografinë e librit të tretë, faqet 911-920.) të cilat janë një referencë e mirë, sidomos kur dëshirojmë të dijmë se si reflektojnë intelektualët vendorë mbi historinë e shkatrrimit të Jugosllavisë, tekste të cilat janë kryesisht korrekte dhe të ndërtuara në bazë të metodologjisë shkencore gjermanofone.

Me gjithë «alergjinë» që Buxhovi ka ndaj hulumtuesve joshqiptarë, ai është dashur patjetër të i lexojë studimet më të reja të dy instituteve (Instituti i Europës Juglindore dhe Instituti i Historisë së Europës Lindore) në Regensburg dhe Vjenë, poqëse ai me të vërtetë do dëshironte të bënte një punë shkencore. Në «Albanische Geschichte – Stand und Perspektiven der Forschung» të edituar nga Oliver Jens Schmitt dhe Eva Franz (Oldenburg Verlag, München 2009) janë rezultatet shkencore të autorëve më të rëndësishëm gjermanofonë (Matzinger, Schmitt, Schumacher, Koller, Clayer, Fischer, Schmidt-Neke, Pichler, Elsie, Malcolm, Bartl, Hösch), të cilët vlejné si referencë primare për të gjitha universitetet e Europës Perëndimore. Për të shkruar për raportet shqiptaro-serbe pa lexuar gjë nga studimet e Holm Sundhaussenit (Geschichte Serbiens. 19.-20. Jahrhundert, Wien 2007); për të bërë histori për shqiptarët dhe Kosovën pa marrë parasysh studimet e Oliver Jens Schmitt (**Kosovo**: Kurze Geschichte einer zentralbalkanischen Landschaft: Köln, UTB, 2008), Konrad Clewing (/ Jens Reuter (Hg.): Der **Kosovo**-Konflikt: Ursachen, Verlauf und Perspektiven: Klagenfurt, Wieser Verlag, 2000.), Rafael Biermann (Das Scheitern der internationalen Krisenprävention vor Kriegausbruch, Paderborn 2006) dhe shumë autorë tjerë fare pak mund të flitet mbi një mundësi për një historiografi shkencore siç pretendon Buxhovi. Shumë më shumë kemi të bëjmë me një polemikë gazetareske me adresatë anonimë.

#### AUTORI SI BURIM?

«Dosja Jusuf Buxhovi – materialet e LDK-së, kutia 1», kështu burimi 503 në pjesën e tretë të librit të tij. Kutia ekziston me siguri. Në arkivën e Beogradit të Jugosllavisë Socialiste me siguri se ka edhe më shumë të tilla (një burim interesant për historianët e rinjë). Ngase Jusuf Buxhovi është

dëshmitar i kohës dhe një intelektual jo me pak rëndësi i Kosovës së kohës së Jugosllavisë. Nga 1976 deri 2000 (sipas biografisë së tij në facebook) ai ishte korrespondent i të përditshmes shtetërore socialiste «Rilindja» në Gjermani. Ai është autorë i 34 veprave letrare, gjysmëletrare dhe publicistike. Është një nga bashkëthemeluesit e «Lidhjes Demokratike të Kosovës».

Këto të dhëna biografike të tij nuk duhet injoruar. Sepse teksti që ka të bëjë me historinë m të re Kosovës është rrëfyer në mënyrë tejet subjektive dhe të njëanshme. Posaçërisht në kapitujt dhe paragrafet ku flitet mbi demonstratat e 68-ës, 81-shës si dhe mbi luftën e Kosovës duhet të kemi mjaftë kujdes. Së pari, sepse ai historikisht është vetë i involvuar (ne nuk e dimë si ishte qëndrimi i tij si gazetar në Rilindjen shtetërore kundrejt ngjarjeve të 68 und 81, por ne e dimë që Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë kurrë nuk do të lejonte që në Gjermani të shkonte ndonjë përkrahës të atyre demonstratave) dhe së dyti ai ka anësi partiake (LDK) të cilën ai e deklaroi në mënyrë të hapur dhe pranoi se favorizon perspektivën e partisë në fjalë - e cila si të gjitha partitë tjera ka interes që gjithçka potzitive t'ia mvesh vetes.

## FUSHATË VETËREHABILITUESE

Formulimet i tij si «Themelimi i një partie me orientim të djathtë dhe...» (Buxhovi, Kosova, Libri III, 467.) tregojnë për nevojën e ngutshme të një gjenerate për rehabilitim (se nga çka duan të reabilitohen pjestarët e kësaj gjenerate vetëm mund të spekulojmë, e sigurtë është ekzistenca e fenomenit), shtresë njerëzish publike, të cilët si duket të ketë një ndërgjegje të grrithur për biografinë e vet në kohën e Jugosllavisë. Paraqitja e themeluesve të LDK me orientim të djathtë është një falsifikim tjetër i radhës, kur dihet fakti se shumica e këtyre

themeluesve deri atëherë ishin antarë, deputetë dhe funksioner të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë.

Motivi i Buxhovit për të ngritur Kosovën historikisht në djep të qytetërimit evropian ka dështuar tërësisht. «Metoda e tij shkencore» nuk prodhon njohuri por vetëm stereotipe të reja. Është një tip i të menduarit që është ngritur mbi gjëmat e «Historisë (shqiptarokomuniste) të Popullit shqiptar» dhe që tenton të ikë në një drejtim tjetër ideologjik: në atë shovenizmit!

Argumentet janë të qarta: Buxhovi nuk punon në mënyrë shkencore por provon të rrëfejë një histori duke keqpërdorur burime dhe duke përvetësuar plagjiatshëm tekste.

Njerëzit e traumatizuar nga luftërat i adhurojnë këto historira dhe «intelektuali» në këtë mënyrë mund të arrijë edhe pozitën e presidentit, mirëpo nëse mendojmë në mënyrë afatgjate, ai në këtë mënyrë u bën vetëm një shërbim të keq atyre që i besojnë. Posa ata të kuptojnë – dhe një ditë do e bëjnë këtë – se janë mashtruar, ata do të frustrohen ngase gjithmonë vlenë: më mirë është të qenit i dëshpëruar një herë (duke e kuptuar të vërtetën) se sa jeta e përjetshme në mashtrim.

Buxhovi del nga ata historiografët të cilët thënie e Ernest Renanit: «Nuk ka komb pa falsifikim të historisë», e marrin më seriozisht se sa që është e lejueshme. (2012)

*\*Teksti u shkrua nga autori në gjermanishte. Shqipërimin e bëri Blerim Canaj, Vjenë.*

## *Vallja e primatëve*

Përderisa historia shkruhet nga subjektet nuk ka histori objektive. E rrezikshme bëhet ajo kur primatët e sotëm e përdorin atë si mjet rehabilitimi dhe shërimi nga paranoja e stampimit të gjurmës historike.

Histori! Gjithandej nëpër media lexojmë tekste që zbulojnë, rizbulojnë e «ndriçojnë» skena në të cilat primatët (kupto këtë në aspektin biologjik), të urdhëruar nga perënditë dhe të përkrahur nga yjet e lazduara të kozmosit luftojnë kundër djajve. Mbijetojnë, triumfojnë dhe gjithmonë lënë trashëgimtarë sizifianë që garantojnë lidhjen deri tek primati i fundit, ai primat që sot na dëshmon se si ka qenë puna deri dje, si është sot e si do të jetë nesër.

Historia si duket gjendet në kulmin e saj të popullaritetit. Jo vetëm te shqiptarët, ballkanasit, arabët, gjermanët, por vërtet gjithandej.

E kjo domosdo të shtyn të reflektosh e të kërkosh shkaqet se ç' burimi ka kjo famë, cilat janë funksionet dhe efektet e saja.

Si bëhet kjo pa djegur këmbët e duart në hithrat e shumta që i kanë mbjellë gjithë ato teori e hipoteza?

*Festat kombëtare* - Kur kombet kanë festat e tyre kombëtare historia manifeston pushtetin e saj absolut. Zvicranët i sheh të turren rrugëve duke imituar Wilhelm Tellin, amerikanët ngjyrosin veten flamur, shqiptarët çojnë hundë e gjoks për tu dukur sa më skenderbenj se ç' është e mundur, hungarezët për

çdo ditë i janë nënshtruar diktatit të aktrimit në rolin e János Hunyadi-it, serbët vuajnë e vajtojnë për çdo ditë nga dashuria ndaj humbjes dhe dëshira për të hyrë në katalogun e sveti-ve të tyre që popullojnë kishat, e kështu me radhë deri në pafundësi.

Nga ky realitet syvrasës mësojmë diçka konkrete nga funksioni praktik i historisë: Të gjithë e përdorin atë për të manifestuar, demonstruar hyjninë e primatëve të tyre, rolin e tyre shpëtues të gjeneve, racës, turmës. Nëpërmjet tyre primatët sot t'i thënë botës, të tjerëve, se humaniteti keq do t'i kishte punët pa primatët e tyre. Jeta në planet do të ishte edhe më dramë pa të parët që kanë mundësuar ekzistencën tonë si primatë të ardhshëm, si *pars pro toto* të planetit.

*Teoritë mbi kujtesën* - Jo. Pa i djegur këmbët hitrave teorike nuk shpëtojmë dot. Aleida Assman («Hapësirat e kujtesës», München 1999) do të thoshte se kombet, shtetet, politikat kanë nevojë për përdorimin e këtyre të kujtesës për të sforcuar identitetin e përqafuar. I shoqi i saj egjiptologu Jan Assman («Kujtesa kulturore», München 1992) do të ngulte këmbë për të na bindur se gjithmonë, që nga lashtësia kështu ka qenë dhe se nuk ekziston asnjë arsye e shëndoshë që do të na bindte se tash e tutje do të bëhet ndryshe. Benedict Anderson i shoqëruar nga Hobsbawm, Brubaker dhe gjithë ajo kompania e konstruktivistëve nuk na lënë të qetë me akuzat e tyre se po shpikim historira për qëllime të politikës së përditshme. Robert O. Paxton («Anatomia e fashizmit», New York, 2004) edhe më pamëshirshëm na akuzon se sillemi si fashistë ndaj tjerëve duke keqpërdorur qëllimshëm rrënjët dhe kujtesën kulturore, frymore dhe emocionale të masave për të «dëshmuar» një supermaci fiktive.

*Orvellianët që nuk i kemi* - Pse tentojmë me çdo kusht të bëhemi si figurat e shekujve më parë? Sepse nuk ia besojmë

vetes asnjë kualitet minimal për të lënë gjurmë në mbamendjen brenda kopesë, racës e botës? Pse jemi aq të sëmurë për të bërë gjurmë, duke imituar një kohë të paimitueshme? Sillemi me një besim të tillë sikur vetë të kemi qenë mijë vjet më parë pranë kësaj apo asaj figure historike. Kemi ndonjë problem mental?

Filozofi austriak Paul Watzlawick na ngushëllon aq sa mundet, duke na thënë se ne jemi viktima të një ideologjie që shpik realitete për të na mashtruar vëmendjen, që ajo të mos merret me realitetin siç është. Kjo, e ngjashme me atë thënien nihiliste: «bëjmë art për ta mbytur realitetin e egër». Filozofi italian Giorgio Agamben *ideologjisë* së Watzlawick jep emër, e pagëzon si «*dorë e fshehur*», e cila kujdeset për të mbajtur të fortë pushtetin. Kush është dora jonë e fshehur? Pushtetet që gatuajnë strategji në «*pallatet e tyre të ëndrrave*» se si më së miri të mbajnë nën kontroll trutë e qytetarëve të tyre? Për fat pushtetet ballkanike nuk kanë pasur ndonjëherë një aftësi të tillë orvelliiane. (Me gjithë përpjekjet që kanë bërë as nivelin e amatorëve nuk e kanë mbërrit).

Më lehtë iu besojmë shpjegimeve të Elias Canetti-t (Masa dhe pushteti) dhe Hannah Arendt-it (Elementet dhe origjina e pushtetit totalitar). *Dirigjentët* (Canetti) tanë nuk shpikin ideologji për të na shpëlarë trutë. Ata janë pjesë e jonë. Ata e dinë se çka duam ne. Ata e bëjnë të zëshme vetëm atë që ne e shfrytëzojmë si zjarr në gjoksin tonë: urrejtjen si motor kundër kompleksit të inferioritetit. Le të pyesim veten se çka do t'i bënim një politikani që do të sajonte një ideologji, e cila do të sugjeronte se një pjesë e madhe e shqiptarëve është e përzier me romët apo turqit dhe si pasojë një pjesë e konsiderueshme e popullit është me origjinë (gjene) të dy popujve në fjalë? Edhe po të kishte ai dëshmi të pakontestueshme ne do ta shpallnim idiot, armik, kriminel. Ndërsa i njëjti po të na bërtiste se ka gjetur ndonjë dëshmi (të pamundshme) se njëri nga djemtë e Adamit/Ademit është i

pari banor i tokave shqiptare frenetakisht do t'i aplaudoj. Ndoshta edhe më konkretisht: A do të ndezte fushata e ndonjë partie politike, e cila do të bënte çmos për të prezantuar një program ekonomik që premtonte se do t'i nxjerr masat nga lloçi social? Jo. Shumicën vazhdimisht e fitojnë parti e organizata, të cilat ulërijnë parulla nacionaliste, euforia patriotike mbetet receta më e efektshme për t'ia marrë votën ballkanasit.

Politikanët pra nuk bëjnë send tjetër vetëm se instrumentalizojnë arsenalin ndiesor të elektoratit për të fituar mandatin e sundimit sa më pa djersë.

*Dashuria ndaj gënjeshtërisë* - Gjitha këto teori – dorën në zemër se janë interesante dhe të angazhuara deri në palcë – nuk ndikojnë as një milimetër për të na prishur vallen, dasmën tonë, e cila si akt (jo si formë) ndoshta është ngjarja, historikisht, më e argumentueshmja. Dhe nëse dikush si kryeintelektuali izraelit Shlomo Sand («Shpikja e popullit hebrej», Tel Aviv 2008) donë të na prish orgjitë etnonacionale e lidhim këmbëduar dhe e fusim në qelinë e anonimitetit.

Nëse nuk duhet të festojmë, çka të bëjmë atëherë? Të praktikojmë si ai artisti amerikan Ryan Bingham metodën e *Ascetic emptiness* (nihilizmi praktik) dhe të vërdallemi qiejve ulur në frontin e «zogjve të hekurt» pa munduar trurin rreth statusit tonë historik dje, sot e nesër?

Jo. Ne jemi me devizën e Hannah Arendt-it. Ne jemi të lindur për një *vita activa*, e jo për një *mortus vivendi*. Le të festojmë deri sa të na mbajnë këmbët.

Nuk janë problem festat tona. Problemi qëndron diku tjetër. Pyetjeve pse dhe si festojmë duhet t'iu gjejmë përgjigjen adekuate. Nëse jo për diçka tjetër, atëherë për të mirën e shëndetit tonë, për të mirën e sistemit tonë nervor dhe për hir të trurit dhe shpirtit tonë të përdhunuar.



Pse-ja dhe si-ja e festave ballkanike nuk ka nevojë për ndonjë mbikëqyrje shumëvjetëshe për t'u përshkruar, sepse ato janë të përditshme, të gjithandejshme.

Çka i nxit, motivon kryesisht festat kombëtare ballkanike. Kanë ato karakter tubimi qytetar, domethënë kujtohen heronjtë si shkak për një komunikim të nevojshëm social apo si akt respekti ndaj lirisë së fituar nga heronjtë e caktuar, apo na shërbejnë ato më shumë për të zbrazur frustracionet personale, grupore e kolektive?

E festojnë shqiptarët Gjergj Kastriotin në shenjë respekti sepse ka bërë çmos për lirinë, apo më shumë i nxehe ata, i bënë t'i kërcëllojmë dhëmbët, i shtynë të krisin qiellit, i deh trimëria e tij, duke parafytyruar e kënduar atë si ua heq kokat fesëkuqe ushtarëve të sulltanëve osmanë. Ky model mund të transportohet edhe për festat e heronjve tjerë me armiq më aktualë. Festë pas festë shumëkujt i akumulohet e i betonohet bindja se si «paska qenë historia» për këtë apo atë luftë. Kështu e krijojmë kujtesën tonë. Në saj të kësaj kujtese unë, ti ai dhe gjithë kallamkusuret që dinë të kapin kalemin shkruajnë, jo, sakralizojnë të shkuarën deri në atë masë sa që as Zoti nuk u del dot në konkurrencë heronjve tanë. E meqë shkollat nëpër Ballkan ende janë institute në shërbim e jo për edukim të turmës dhe si të tilla nuk luajnë asnjë rol për të sqaruar, të parët e turmës kanë fjalën. Primatët. Këta primatë janë përgjegjës për krijimin e projeksioneve për nipërit e feskuqëve dhe gjithë të tjerëve pas tyre. Në të vërtetë ne vuajmë, digjemi nga urrejtja e tepruar ndaj gjithë atyre shumë armiqve nëpër histori, plotë nesh madje identifikojmë simptoma të një paranoje kolektive, megjithatë ne i dëgjojmë primatët, u duartrokasim, i votojmë, i duam se flasin nga zemra, nga shpirti jonë. Ata, primatët mbajnë gjallë dasmën tonë.

*Përdhunimi i heronjve* - Përderisa historia shkruhet nga subjektet nuk ka histori objektive. Në këtë kontekst as marrëveshja që t'ia shkruajmë historinë njëri tjetrit nuk na shpëton nga monarkia e pathyeshme e emocioneve. Derisa historiani të ketë lirinë dhe të drejtën (që duhet gjithmonë ta ketë) e sistemimit dhe interpretimit personal të burimeve, askush nuk mund të vë dorën në zjarr për këtë apo atë version të historisë. Po edhe pse të vëmë dorën në zjarr? Historia nuk është kadastër ku popujt kërkojnë drejtësi për copë tokash që u paskan takuar stërgjyshërve të tyre. Historia është dije. Përpjekje për të rikonstruktuar të shkuarën me synimin për të kuptuar si ecë rrota e kohëve. Madje edhe për të mësuar se nga, si dhe pse lindi gjuha, identiteti im. Është një metodë e natyrshme e humanitetit në luftën e tij kundër harresës. E jo siç e përdorim ne; si luftë për ta mbytur të tashmen. Luftë kot. Historia nuk prodhon bukë. As siguri. Sapo të na dalë rakia nga gjaku përballëmi me ndonjë ushtarë të NATO-s që është zgjuar keq, ose nga gjumi na zgjojnë trokitjet e para mbledhësit të firmave energjetike që kërkon t'ia paguajmë llogarinë për gjithë atë rrymë që kemi harxhuar duke festuar ditë e natë. As primatët nuk ndihmojnë dot në këto punë. Ata nuk «çajjnë dërrasa» për shkak të masave, por për të bërë veten të durueshme si qenie. Ata i ndjek paranoja e gjurmës. Mendojnë se do të lënë gjurmë brenda kopesë në kurriz të heronjve, legjendave, martirëve dhe atë pa e lëvizur prapnicën, por vetëm duke ulëri nëpër media e dasma.

*Historia si hobi popullor* - Askush nuk ka të drejtë të kërkojë që njerëzit t' dorëzohen harresës. As atëherë kur arkat e sigurimit shëndetësor nuk funksionojnë për shkak të numrit të lartë të pacientëve që vuajnë nga depresionet. Kujtesa i ka funksionet e saja pozitive, sidomos kur ajo nuk shfrytëzohet për ta vrrarë realitetin e sotëm dhe veten. Nuk

vritet realiteti me kufoma, qofshin ato edhe të balsamosura e të bëra gurrë.

Po kuptojmë se popullariteti i historisë vjen nga keqpërdorimi i saj për interesat nga më të ndryshmet; politike, personale, shëndetësore, kulturore etj. Gjithë kjo na përkujton ato laviret klasike të romaneve franceze. Historia në shërbim të të gjithave e secilit.

Për t'i shpëtuar paranojës së primatëve nuk na mbetet tjetër përveçse; shkencës historinë, ne mirëqenien, lirinë dhe shëndetin. Amen! (2012)

### *3 teza mbi oportunitizmin shqiptar*

Edhe ai që ne na duket të ketë vepruar në formën më destruktive përbrenda sistemeve si ai osman apo jugosllav ka qenë kontribues aktiv i finales: dy shteteve shqiptare! «M'i përshkruaj pak shqiptarët. Si janë ata?», kështu më pyeti një mik i imi zvicerian me të cilin dikur kishim studiuar bashkë në Universitetin e Freiburgut. Diplomati që do ikte në Kosovë donte të mësonte, për jo më tepër se dyzet e pesë minuta, sa më shumë për popullin «atje poshtë», për historinë, politikën, mentalitetin, veset, ritet dhe traditat. Më tërhoqi vërejtjen: «Para se t'ia nisësh me përshkrimin tënd mos e harro atë përfundimin e mikut tonë Prof. dr. Christian Giordano që thoshte se shqiptarët janë ndër ballkanasit që prijnë për nga vetëpërshkrimi negativ». Tepër vërejtje me vend: modë është bërë tanimë portretizimi plot veturrejtje ndër shqiptarë!

Vetëm edhe një orë kishte mbetur për të formuluar opinionet, ligjëratën mbi qenien shqiptare. Si rezultat i atyre shënimeve dolën 12 teza mbi qenien shqiptare, pjesë e të cilave janë edhe këto 3 tezat e mëposhtme mbi oportunitizmin shqiptar:

#### TEZA E PARË – Vetëkritika si imponim

E urrejnë pra veten shqiptarët, meqë para tjerëve flasin gjithherë keq për veten? Këtë do ta pohonte çdokush që i njeh vetëm sipërfaqësisht shqiptarët. Ose që shfrytëzon edhe atje ku s'duhet metodën aristoteliane të induksionit. Portreti autark negativ më shumë duket të jetë rezultat i një lodhjeje

kronike nga «fatumi i padrejtë» dhe «dështimet» e elitave të tyre për t'ua sjellë lirinë sa më herët. Me një autosugestion frytplotë ata ushqejnë përshtypjen sikur kurrë t'i mos kenë kapur në kohë epokat; gjithmonë me vonesë të madhe qenkan bërë pjesë e procesit të iluminizmit, arsimimit, shtetësisë e kështu me radhë. Europiani me plis mallkon veten jo ngaqë urren apo dashuron tjerët, por sepse ndihet xheloz për fatin e të tjerëve që e kanë lënë atë pas në mirëqenie dhe në civilizim – çfarëdo që të jetë kjo e fundit. Vetëpërshkrimi negativ dhe specifik i shqiptarit del pra nga grindja e përhershme me vetveten, nga refuzimi i statusit në të cilin gjendet, ai gjithmonë pretendon të mos jetë apo jetojë ashtu siç është dhe jeton, por ndryshe, më mirë. Kemi të bëjmë në fakt me një mentalitet që dëshiron progresin permanent? Vetëkritika (edhe pse tmerrësisht agresive) si motor shtytjeje përparimi? Pjesërisht qëndron edhe kjo. Mirëpo më shumë se ky motiv, vetëkritika shqiptare është pjesë e një strategjie mendore, të cilën shqiptari e ushtron me shekuj.

#### TEZA E DYTË – Oportunizmi si strategji mbijetuese

Meqënëse shqiptari gjithmonë mendon se nuk e ka gjetur formulën e duhur se si duhet jetuar më së miri, ai është fort elastik. Jo rrallë edhe aventurier altruist. Aq elastik saqë arrin ta bindë edhe tiranin më mizantrop që të jetë qeni më besnik i tij. Gati çdo perandor i ka konsideruar gardën më besnike të tij. Thuajse çdo religjion i numëron si të vetët, ndërkohë që të gjitha ideologjitë (komuniste, liberale, fashiste, naziste) i kanë trajtuar ata si mëkëmbësit më efikasë në terren. Dhe në çdo bilanc final kemi parë se ata, shqiptarët, nuk janë besnik të asnjërit dhe askujt. Po me atë lehtësi që i përvetësojnë situatat, ata edhe i shporrin, sikur kurrë të mos kishin qenë komunistë, sikur kurrë të mos kishin besuar te Hitleri e sikur e gjithë

përpjekja për të qenë jugosllavë sa më origjinalë, s'ishte gjë tjetër përpos aktrim i zakonshëm për ta siguruar mëditjen.

### TEZA E TRETË – Formula e tolerancës

Se çfarë lloj oportunistësh maratonmakë dhe të përkryer janë shqiptarët dëshmon edhe historia e elitave të tyre: ata luajtën e vijnë të luajnë rolin e hoxhës, të klerikut, të gjeneralit, të beut a valiut, të ultrakomunistit a fashistit, të demokratit apo anarkistit, pa dyshuar askush ndonjëherë në autenticitetin e tyre. Të veshur si priftërinj dhe nëpërmjet «fjalës së Zotit» krijuan gjuhën dhe alfabetin, të veshur si osmanë shpallin pavarësinë, të rreshtuar si stalinistë volën Rusi, Kubë e Kinë, duke u shtirë si jugosllavë ndërtuan e finalizuan edhe një shtet të ri.

Nga këtu rrjedh edhe diversiteti kulturor, fetar dhe ideologjik i shqiptarëve. Fakti që gjithë këto botë kulturash, fesh e doktrinash – të cilat janë armike të mërzitshme ndër veti – nuk kanë arritur ta përmbytin qenien shqiptare në ndonjë konflikt nuk është meritë e «tolerancës gjenetike shqiptare» siç duan të na i shpëllajnë trutë me akull irracionalët, por është rezultat i oportunitetit tradicional të elitave shqiptare nëpër histori.

«Nëse elitat shqiptare e kanë bërë këtë me qëllim, të themi, si një doktrinë mbijetuese atëherë qenkan më të mençur se të gjithë», brofi zvicerani. Nuk kemi të dhëna historike që shqiptarët të jenë sjellë kështu për çështje taktike. Ata kanë vepruar kështu. Kjo është historia e tyre. Dhe kjo teori natyrisht se mund të përdoret edhe nga më destruktivët për të justifikuar rolin e tyre në këtë apo atë sistem. Pse jo? A nuk do të ishte fantastik një pajtim mes veti? Së paku në shenjë kremte ndarëse nga oportunitizmi, i cili vetëm për diplomatët është i shëndetshëm! (2013)

## *Metafora e prushit*

Ese mbi qenien shqiptare

Mitet, magjikja dhe identiteti i një populli evropian që «lindi» nga gërmadhat e një perandorie lindore. Shqiptarët «ç'kanë qenë, ç'janë e ç'duan të bëhenë»? Teksti «Le destin de la Grèce moderne» [Fati i Greqisë moderne] që filozofi franko-grek Kostas Axelos e botoi në revistën *Esprit* (qershor 1954) i tmerroi grekët dhe eurocentrikët. Grekët u përdatën sepse Axelos nuk gjente asgjësend konkrete sociologjike, psikologjike e etnologjike për ta shpallur athinasin e sotëm pasardhës të asaj «racës» së pashme të Epikurit, ndërsa eurocentrikët dhe konservatorët urrenin rëndshëm sa herë që t'ua kujtoje faktin se trashëgiminë e mendimit oksidental e shpëtuan filozofët persë e islamë Averreos [ibn Rushd], Suhrawardi dhe Avicenna [ibn Abdullah ibn Sina].

Axelos, grekun e sotëm e shihte si identitet të lindur nga hiri i krematoriumit ku u dogj Bizanti. Këtë tezë filozofi e mbështeste me *credon* nacionale të shekullit 19, respektivisht me ideologjinë e Rilindjes greke të *Megáli Idéa-s*, e cila ëndërronte ringjalljen e perandorisë bizantine e jo pra atë të *Magna Graecia-s*. Kështu ngase Bizanti si amalgamë e juridiksionit romak, religjionit të krishterë dhe kulturës greke – siç konstaton bizantinisti Georg Ostrogorsky – më shumë shkruan se sa trash fijet lidhëse me antikitetin. Historiani Johann Gustav Droysen, «hellenismós»-in e shpjegon si «përpjekje për ta imituar antikitetin» [«Helenizmi» në Leksikonin e vogël të Helenizmit Fq. 1-9, gjer.], ndërkaq

historiani antidemokrat Oswald Spengler konceptoi idenë se grekët e vjetër janë diçka «si botë magjike» që ekzistuaa vetëm në mendjen e europianëve që s'kishin me çfarë tjetër të konstruktojnë bazën e identitetit të tyre kontinental.

Që nga «konsolidimi» (1967 e pastaj), stabilizimi i shtetit grek dhe 13 vjet pas botimit të esesë të Kosta Axelos-it, politika zyrtare e Athinës vendosi për konstruktimin e një identiteti proantik. Ia doli vallë? Jo. Njëra nga «pengesat» themelore për ribërjen praktike të «Greqisë antike», kështu thonë grekologët e huaj, është populli i saj ortodoks, i lidhur shpirtërisht e fortë me sferën sllave, e cila ende ngul këmbë në idenë e historianit dhe teologut kroat të shekullit 17 Juraj Križanić, i cili kërkonte bashkimin e gjithë sllavëve [ortodoksë] nën flamurin rus dhe si e tillë qenka «jokompatible» me botën dhe frymën antike.

#### SIMBOLIKA E PRUSHIT

Të urtit e lindjes [Upanishadat, Samkhya, «Rrota budiste e jetës»] dhe më vonë edhe ata të perëndimit [Herakliti, Demokriti, Epikuri...] besonin se gjithçka që *Bëhet* primamaterie [prakit ose atom] i nënshtrohet metamorfozës permanente deri në [antikiteti] *Zhbërje*. Sot as shkencat ekzakte e as Religjionet nuk besojnë në përjetësinë e Tokës, secila ka mbushur pantallonat nga apokalipsi i vet.

Si duket nga ky panik, për t'i ikur këtij «realiteti», njeriu i të gjitha racave, kulturave dhe sferave gjeografike – paralelisht me teoritë e lartlistuara – gjeti azil te *Shpirti* (që përzihet me frymën), i cili herë evidentohet si individual, herë si racor, kulturor, kombëtar, universal [„anima mundi“ ose „psyche tou pantós“] dhe herë siç bëjnë religjionet të cilat frymën e përdorin si mjet të Zotit për të shpirtëruar gjallesat.

Filozofi frankogrek Kostas Axelos shihet qartë se nuk bazohet në teorinë e *bërje-zhbërjes* kur ndërton, por aludon në



të dytën, sepse vetëm ajo e çabsurdizon sadopak «metaforën» e tij të «prushit». Kjo teori u shërben sidomos biologjistëve, nacionalistëve dhe gjithë atyre që besojnë në pashprishmërinë e gjenit, gjakut dhe racës.

## NGA I CILI HI MBETI PRUSHI SHQIPTAR?

Dolën edhe shqiptarët nga hiri dhe gërmadhat e perandorisë osmane? E kanë edhe këta po të njëjtën hipotezë si grekët: ndonjë fe të trashëguar nga ndonjëri pushtues që nuk i le të hedhin hapat «vertikalisht»? Ndoshta. Sidomos për nga kronologjia po.

Metafora e «prushit» [nga nënhiri prushi antik rindez shpirtin grek] që Axelos e përdor për t'i dhënë orientimin «proantik» identitetit të grekut modern për nga përpjekja faktike i shkon më shumë shqiptarit pasmodern. Pse?

Ndoshta ishin studiuesit e oborrit austrohungarez dhe gjermanët kontribuesit iluministë që nuk i lanë shqiptarët të gabojnë si grekët, pra duke luftuar për ta ruajtur «identitetin» e imponuar të perandorive nga «dolën».

Përveç kësaj, së paku edhe dy traktate themelore të asaj kohe shfaqin refuzimin absolut të vetë shqiptarëve që të kenë diçka të përbashkët me perandorinë osmane: Pashko Vasa në studimin e tij «E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët – një studim historiko-kritik» (1879) e kërkon vetëdijesimin e popullit «më të lashtë» me gjenealogjinë e tij, duke nënkuptuar orientimin që ai duhet të ketë për të ardhmen. Pas guvernatorit osman të Libanit Vaso Pasha [Feja e shqiptarit është shqiptaria] edhe më konkretisht, 55 vjet para grekut Axelos doktrinën e formulon njëri nga etërit e identitetit modern shqiptar, i cili paralelisht ishte edhe kryekulturëbërësi i osmanizmit; Şemseddin Sami [«Dielli i religjionit»], vërtet Sami Frashëri në traktatin e tij «Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet» kërkonte kategorikisht «varrosjen sa më

urgjente [Pjesa e dytë] të kufomës osmane». Ky, ashtu si më vonë edhe komplet elita rilindase shqiptare, do të propagandojë versionin iliro-antik si bazë mitologjike e historike për të krijuar shqiptarin e ri pasosman.

Më vonë asnjëherë – në stilin e intelektualëve grekë – nuk pati diskurs shqiptar që do të analizonte gjendjen reale dhe do të skiconte orientimin e synuar të tyre. Sistemi protokomunist i Enver Hoxhës me tendencën për ta bërë «Njeriun e Ri», internacionalistin, njëkohësisht duke i mbetur besnik linjës së rilindësve, dështoi ta bëjë të «riun» dhe përdhunoi edhe atë që ishte.

E njëjta gjë ndodhi edhe me shqiptarin jashtë kufijve, në Kosovë e Maqedoni, atje ku hutimi madje mori përmasat e skizofrenisë, sepse shqiptari i pasluftës u detyrua të notonte në një biotop identitar ku çdo amebë brenda tij ishte e predisponuar ta kapërdijë tjetrën.

## BOTA SIÇ ËSHTË

Sot kthjellët, sa herë që analizojmë hartat aktuale etnologjike, kulturore, sociologjike, politike e antropologjike të dy kombeve në krahasim e sipër, detyrueshëm i nënshtrohemi botës kështu „siç është», pasi për atë «se ç’ka qenë» as idenë nuk e kemi, na mungon materiali dhe nuk na ndihmojnë as metaforat e bukura të *prushit* dhe *shpirtit*, as magjika e as astarimet mitike për t’i ikur atopisë. Të ndikojnë shqiptarët munden vetëm në kontekstin e asaj se «ç’do të bëhet». E kjo e fundit nuk kërkon vetëm intelektualë të tipit të Axelos-it, por para së gjithash i vë kushtin kapuçbardhit që apriori ta pranojë veten kështu siç është; polihybrid, në modusin e «species» jo të konservuar muzeve antike, por gjithmonë nën rrotat e transformimit permanent. Ndoshta, ndoshta me këtë vetëdijesim kundrejt realitetit do të mundeshin edhe shqiptarët ta skicojnë një orientim

intelektual se ç’lloj identiteti do të ishte më i përshtatshmi për të siguruar paqen ekstratemporale në biotopin e tyre. (2013)

## *Metanoja*

Është e «natyrshme» që serbet nuk duan të pranojnë se «zemrën» nuk e kanë në Kosovë. Kështu sillen shumica e «humbësve» në kohë shoku. Paradoksale është sjellja e kosovarëve: me gjitha shanset e tyre për të ecur para, ata vazhdojnë të mbeten pengj të miteve dhe «lugetërve» të tyre të gjallë e të vdekur.

Me rënien e bombës së parë të NATO-s mbi kokën e pushtetit serb, në shpirtin dhe frymën e kosovarëve u duk sikur filloi procesi i një metamorfoze radikale karshi historisë dhe fatit të tyre: E nxorën Evropën nga pufi i përjetshëm ku e kishin konzervuar historiografët e mjerë shqiptarë dhe më në fund u bindën sikur ta kenë sqaruar botën se jo ata, pra shqiptarët, por serbët janë me bisht, ata paskëkan ngatërruar shenjat e qytetërimit dhe epokave. Triumfi edhe pse nuk përmbante elementet e një revizioni të organizuar elitari, ai sinjalizonte një shpresë, e cila krijoi përshtypjen sikur shqiptarët më në fund të kishin zbuluar instrumentet dhe mënyrën e funksionimit të politikës jashtë kullave të tyre, dhe se që aty e tutje, çdo gjë do të ecë sipas radarit të tyre.

U mbushen 12 vjet nga rënia e bombës së parë në favor të lirisë së kosovarëve. Ç'bëri Kosova me lirinë e saj? E solli atë po në atë qeli të pufit ku për disa dekada kishte mbajtur robe Evropën dhe gjithë ata që ia ushqenin statusin e martirit të mallkuar nga Zoti? Pse titulli i këtij eseu «The lost cause of kosovars» (kauza e humbur e...) e jo «The lost cause of

serbians», siç do të ishte edhe më logjike, kur kihet parasyshë origjina dhe historia e termit në fjalë?

## 1. ORIGJINA DHE HISTORIA E KAUZËS SË HUMBUR

Pas humbjes së luftës qytetare amerikane (1861-1865) shtetet jugore u gjendën në një katastrofë jo vetëm politike e ekonomike por edhe psiko-sociale. Për të mbajtur gjallë identitetin e sidomos krenarinë e tyre ata krijuan një memorie kolektive, e cila dështimin, humbjen e arsyetonte me egërsinë, pamoralshmërinë, tradhtinë, kafshërinë e kundërshtarëve të tyre nga veriu. Gjeneralët Lee dhe Jackson prezantoheshin si njerëz me vrytite dhe «patriotë hyjnorë» – edhe pse luftonin kundër heqjes së skllavërisë – ndërsa kundërshtarët e tyre Sherman dhe Sheridan përshkruheshin si kriminelë ordinerë që fituan luftën, vetëm për shkak se dispononin me më shumë forca dhe mjete ushtarake.

Ky diskurs dominonte në gjithë aspektet e kulturës: në Letërsi, Histori, Arsim, Politikë e kështu me radhë. I njëjti diskurs madje edhe sot e kësaj dite dallon aty-këtu rezonimin intelektual të jugorit nga veriori.

Të njëjtën kulturë memorie – e cila në historiografi hyri si «the lost cause thoery»- përdorën nazistët për të ngritur monumentet e tyre të primaracës arike. Humbjen gjermane në Luftën e Parë Botërore e propagonin po në stilin e amerikanëve të jugut: Wilhelmi i dytë nuk humbi për shkak se ishte në padrejtësi, porse amerikanët, rusët, francezët dhe e gjithë bota nuk e durronin dot Gjermaninë si fuqi epiqendrore të kontinentit. Gjeneralët Hindenburg dhe Ludendorf (kujtoni Lee dhe Jackson) ishin taktikët dhe strategët më të fuqishëm të LPB, ata personifikonin «njeriun heroik dhe të vrytitshëm me moral dhe karizmë hynore» (kështu shkruante ideologu nazist Alfred Rosenberg), kundërshtarët fituan se

ishin shumë e gjeneralët e tyre janë pjesë e krimit bolshevik që ishte duke përparë Evropën.

## 2. NË KAMPIN E HUMBËSVE

Në shoqërinë e sotme amerikane përkundër gjitha dallimeve të mundshme në mentalitet dhe me gjithë fërkimet diskursive ndërmjet jugut e veriut nuk mund të flitet më për ekzistencën e një kulture antiveriore në jug. Monumentet e vjetra që kujtonin ndarjen historike figurojnë vetëm si relikte interesante për nxënësit dhe studentët. Të rrallë janë ata amerikanë të sotëm që përulën para ndonjë statuje të sokulluar nga gëlasat e laraskave për tu përbetuar në emrin të kombit jugor amerikan. Në diskutet intelektuale zhvillohet një debat konform historiografisë objektive amerikane, e cila tashmë është bërë lektura e domsodoshme edhe për universitetet e kontinentit «plakë».

Me gjithë ulurimat e filozofit Peter Sloterdijk se Gjermania ende nuk është në gjendje për një metanojë kolektive (katarsis të singertë) dhe referatet skandaloze të shkrimtarit Martin Walser nëpër kisha (Fjalimi i tij famoz në Pauluskirche, 1998), të cilin e kanë lodhur monumentet grandioze mbi holokaustin, Gjermania është vendi, i cili më së pakti mund të akuzohet se praktikon një «the lost cause» kulturë.

Për shumicën e specialistëve të kësaj teme, kontributin madhor për shpëtimin e këtyre shoqërive nga mitet e tyre katastrofale dhe eutanazike e kanë dhënë elitat e tyre, të cilat me sukses dekonstruktuan memorien kolektive me fakte kokëforta, me çka ndihmuan në vetëdijësimin, pse jo shpëtimin, e masave nga hipnoza që ridhte si helm nga goja e miteve të rrejshme të historisë së tyre tragjike. Mite, të cilat veçse fundosnin edhe më shumë perspektivën e këtyre vendeve. Suksesi i elitave ama – kuptuar në këtë kontekst ato

nga shkenca e kultura – nuk do të ekzistonte, nëse politika, pra qeveritë e këtyre vendeve të mos kishin bërë çmos që shoqëritë e tyre të ndërtoheshin mbi shtyllat stabile të demokracisë, shtetit juridik, pluralizmit dhe lirisë kualitative të qytetarit.

### 3. KAUZA E DISFATËS SERBE

Gjendja në Serbi nuk dallon aspak nga ajo e viteve të shtatëdhjeta të shekullit 19, në Amerikën jugore. Pas fasadës së ngitur enkas për optikën e BE-së dhe institucioneve tjera ndërkombëtare, mbizotëron kultura e viktimës së poshtëruar nga mbifuqia e antiserbëve (komploti i perëndimit) të paskurpullt, të cilët nuk durrnin dot dominimin serb në Ballkan. Kryesisht shqiptarët dhe boshnjakët vazhdojnë të portretohen si etni të padenja për të qeverisur veten. Karaxhiçi dhe Mlladiçi (kujtoni Lee, Jackson, Hindenburg, Ludendorf) janë patriotët e mirëfilltë dhe të drejtë sepse kanë luftuar për kauzën serbe, gjeneralët e NATO-s (Wesley Clark dhe pasuesit e tij) janë kriminelët, sepse ia morën Serbisë territoret, ato vise të cilat nga kisha dhe politika janë monumentalizuar në nivelin e ndonjë «areali hynor» prej ku Zotit prodhon shpirtin serb, pr prej ku varret qenia apo mosqenia serbe (simbolika e «zembrës serbe»).

Serbia nuk e akcepton «katastrofën» e saj. Për fat të keq, ajo është larg gatishmërisë për ndonjë katarsis eventual. Ajo nuk krahasohet dot me rastin e amerikanëve jugorë, as me gjermanët e madje as me francezët që rëndë po ndahen nga aversioni i tyre historik ndaj fqinjëve të tyre gjermanë. Diskurset «intelektuale» serbe shkojnë (me përjashtime të izoluar) në favor të një kulture monumentalizimi të çdogjiëje që ka të bëjë me idenë e «luftës së shejntë të racës hynore, të shkelur padrejtësisht nga të fortit e tokës», gjë që indirekt

implikon atë lojën e «e djajve apokaliptikë» kundër «profetëve të evangjelizmit ortodoks».

Politika serbe sillet salloneve diplomatike po si ata ithtarët e Naçertanjes dhe varrësit e hutuar të idesë pansallviste pas LPB, të cilët ngarrendnin nëpër konferencat e Londrës, Berlinit dhe Vjenës për të bindur botën për shkeljen e sllavëve të Ballkanit (me të drejtë) nga hordhitë aziatiko-osmane.

Gati për çdo javë diku në ndonjë cep të Serbisë celebrohen momente heroike, shpalohe përmendore heronjshë të vrarë nga NATO, nga kroatët, nga boshnjakët dhe shqiptarët. Librat shkollorë e universitarë serbë janë identikë me ato të Sirisë – mesazhi i tyre qendror: asgjësimi tjetrit, ekzistenca e të cilëve rezikuaka lumturimin e botës me kulturën apo besimin serb apo sirian. «Zemrën» e anektuar padrejtësisht duhet rikthyer në «djepin e saj».

Përmbledhas: Urrejtja është zgjedhur si centrifugë mbijetimi. Nga aty absorbojnë serbët sot fuqinë e tyre për të shtypur çdo sinjal të ndërgjegjes që mund t'i detyronte para pasqyrës.

Frika nga akti i ndjesës; droja nga tmerri se një ditë grupi i atyre që janë zgjuar nga hipnoza e miteve të rrejshme do të bëhet shumicë dhe do t'iu kërkojë llogari qeverive të tyre për «punët e tokës», për problemet sociale, politike e ekonomike që sot është mjerimi i shtetasve serb, kanë shndrruar Jeremiçin dhe gjithë atë divizion politikanësh rreth tyre në robë agresivë të «katastrofës serbe», e cila po u varr prej këtyre të fundit, «përjetësisht» do të shkatrojë ardhmërinë e serbit të përdhunuar nga «lugetërit» e historisë së tij.

#### 4. KAUZAT KOSOVARE

Po aq lugetër të gjallë e të vdekur sa serbët kanë edhe shqiptarët. Kosovarët shtiren sikur ta kenë shporur urrejtjen nga fryma e tyre. Edhe ata japin maksimumin për t'u dukur



edhe më të vyeshëm për paqen e kontinentit se sa vetë bartësit tradicionalë të kësaj ideje brenda e BE-së. Edhe pas dymbëdhjetë viteve numri i atyre intelektualëve progresivë që shpartalluan atëherë idenë e metamorfozës kosovare ka mbetur i njëjtë. Në gishta mund të numërohen ata që ende nuk i janë dorëzuar luftës me lugetërit.

Kauza e humbur kosovare është paradoksale, kur kihet parasyshë fakti se ajo ishte fituesja e jo humbësja e luftës së fundit: Diskurset (përveç në do media të pavarura) «intelektuale» vazhdojnë me po të njëjtin ton të viktimës (njëjtë si në kohën para intervenimit të NATO-s) që ka mbijetuar falë pathyeshmërisë së racës së lashtë ilirike.

Po si nëpër Shumadi edhe nëpër Kosovë risitë më dominante arkitekturale (në shumë vende edhe të vetmet) janë përmendoret, varret dhe momentet që monumentalizojnë dhe hiperbolizojnë deri në aversion heroizimin dhe krenarinë, madje edhe të atyre personave që tragjikisht kanë eksploduar veten për shkak të mosdijes së përdorimit të armëve. E keqja e gjithë kësaj industrie onanizmi pseudopatriotik nuk qëndron në atë se përkrahet kultura e kujtesës historike (çka është e natyrshme gjithandej), porse shtabi i fabrikimit është Qeveria vetë. «Elita» pushtetore – si në Serbi – për shkak të varfërisë në resurse intelektuale që do të kishte kuptuar atë «procesin e domosdoshëm të metamorfozës», jep e merr për të legjitimuar veten duke (keq)përdorur varret, viktimat, heronjtë, tradhtarët, lugetërit dhe gjeneralët, të cilët – për nga volumi i krimit as që mund të krahasohen me kolegët e tyre serbë – po bastisëm fjalorët e militarizmit, kryesisht as gradën e «desetarëve» nuk do ta kishin merituar.

Pranë kësaj politike qeveritare defilojnë komandantët arkaikë të historiografisë shqiptare. Ata burra e ato gra, akrepi shkencor i të cilëve është bllokuar në kohën ndërmjet luftës së parë dhe asaj të dytë botërore. As pas 12 viteve nuk doli asnjë

tekst, asnjë libër që do të trajtonte në mënyrë sadopak objektive luftën mbrojtëse të kosovarëve gjatë gjenocidit të planifikuar e pjesërisht të realizuar serb në Kosovë. Literatura zyrtare nëpër shkolla e institute të arsimit vazhdon të mbetet ajo e prodhuara në formë klandestine dhe pa fije përgjegjësie, nga 1989 e këtej.

## 5. FORMULA «THE LOST CAUSE» SI PROGRAM QEVERTAR

Michael Geyer, bazuar në studimet e profesorit dhe historianit William Davis dokumentoi bindshëm se si elita politike nacionalsocialiste nga «kauza e humbur» (në kuptimin e teorisë së «the lost cause») i shtroi qilimin Gjermanisë për të përfunduar në një katastrofë edhe më të madhe, në atë të Luftës së Dytë Botërore. Përgjigja e tij – edhe pse e përmasave metafizike – është thjeshtë: çdo elitë nacionale që edhe në kushte paqeje programin e saj politik, shtetëror e kulturor e ndërton mbi bazat e katastrofës, humbjes, urrejtjes, pra mbi bazat e një historie jokritike e të padiferencuar monumentalizon krimin – pavarrësisht burimit të tij.

Konkretisht: Çdo qeveri që nëpërmjet monumenatlizimit të tragjeditë, dramave përpiket të legjitimojë pushtetin e saj përfundon detyrimisht në katastrofën e radhës.

Gjendet Kosova në rrugëtim drejt edhe një katastrofe tjetër? Jo në kuptimin klasik të fjalës. Kosovës nuk do t'i merret pavarësia. Kosova – po spekulojmë- nuk do të ketë më luftë fizike. Katastrofa e saj vazhdon sepse ajo injoroi shansin e saj historik dhe në vend të «metamorfozës progresive» vazhdimisht zgjedhë elitat e saja arkaike e të korruptuara (si shumica e vendeve ballkanike) të cilat operojnë duke u ushqyer nga formula e «kauzës së humbur». Pra e kanë bërë atë program politik. Katastrofa, si gjithmonë nuk do të

manifestohet në famën apo xhepat e klasës politike, por me të do të jetojnë ato shtresa që janë të detyruara të shtrihen e të çohen nga shtrati me urrejtjen që ua kanë implantuar në tru e shpirt lugetërit e tyre të gjallë e të vdekur. Tezën se kosovarët kuptuan më shpejtë se fqinjët e tyre se si funksionon bota jashtë gardhit të tyre mitologjik mund lirisht ta deponojmë në mndonjë epruvetë futuriste. (2012)

## *Ikonat e epokës që iku*

Historia e shekullit 20 nuk do të shkruhet më si deri tani – kështu të bindur zotohen akademitë e perëndimit. Ajo, për këtë arsye nuk do të jetë kronikë e fiksuar ekskluzivisht me personalitete të ndryshëm. Sundimtarët, figurat dhe kryeaktorët nuk do të përjashtohen, mirëpo as do të ëngjëllohen deri në atë stad saqë të besohet se pa ta s’ka histori fare. Veprimi synon t’ua marrë fuqinë miteve që edhe vetëm si përmendore të shërbejnë si frymëzuese ushtrish atentatore të çdo tendence për racionalitet, të mbysin çdo guxim që të shkuarën mëton ta perceptojë me objektivitet, jo më si zonë ku vërdallosen vetëm hyjnorë e virgjëresha të kombeve, por me tepër si arkiv ku gjejnë gjithçka.

*Paradigma nga Parisi* - Ky proces mortifikimi – evitimi i përshkrimit të fiksuar në mbretër dhe diktatorë – që e inicuan Karl Lamprecht, Marc Bloch, Lucien Febvre (sidomos L’École des Annales) ka së paku tri dekada që suksesshëm ka përfshirë pothuaj çdo shtab historiografësh të kontinentit. „La nouvelle histoire“, quhet me naze paradigma e modës, tashmë gëzon frytet e saj: historinë globale, atë transnacionale, analizën diskursive historike të plotë të zhanrit. Rezultati është vetë defekti: fiksimi vetëm me historinë e strukturës, bazës (nga poshtë-lart), për më tepër në faza të gjata (Fernand Braudel: longue durée) ecën drejt epizimit të shkencave historike; sundon interpretimi shpesh krejt qyqar pikërisht në shkrimin e historisë! Metoda nuk arriti të gjejë mesin e artë; t’i japë faktit autoritetin që ka duke ia integruar me sukses edhe „historinë e mentalitetit“, antropologjinë sociale. Ajo bëri po të njëjtin gabim të

historiografisë „klasike“: u përqëndrua vetëm në përshkrimin socioantropologjik të masave dhe me detyrim, me dhunë shkyçi bartësit (personalitetet në krye të proceseve) duke abstraktësuar edhe më shumë, gjë që domosdo është sikur qëllimisht t’ua lësh terrenin spekulimeve, legjendave. Irracionaliteti duket të jetë motor arsyetimi identitetesh në planin biogjenetik, politik, kulturor e nacional.

Prandaj kritika ndaj shkollës „parisiene“ është bërë edhe më e zhurmshe. Me të drejtë? Po. Madje edhe rasti i shqiptarëve kokëpakë dhe ta pahulumtuar nëpër epoka manifeston pamundësinë e pezullimit të personaliteteve gjatë përshkrimit të historisë, qoftë asaj globale e qoftë asaj transnacionale, rajonale e lëre më lokale.

*Nga Gjergji tek ...* - Është interesante që të kërkojmë personalitete të historisë shqiptare që kanë depërtuar nëpër shtigjet e historisë transnacionale, globale. Nuk ka histori mbi epokën osmane, Europën e mesjetës dhe atë të oksidentit ku nuk zë vënd **Gjergj Kastrioti i mbiquajtur Skënderbeu**.

Qoftë edhe minimalisht, mirëpo nëpërmjet tij argumentohet përplasja, rezistenca dhe këmbëngulësia e popujve europianë për të mos lejuar shtrirjen e perandorisë së sulltanëve përtej Vjenës. **Gonxhe Bojaxhiu, alias Nënë Tereza**, edhe pse rrallë jepet origjina e saj, edhe ajo nuk mungon si figura qëndrore, simboli i solidaritetit, humanitetit global në shekullin 20. Në çdo listë, respektivisht histori të shekullit që lamë pas, **Enver Hoxha** i përket klubit të liderëve, herë si diktator, herë si primat kokëfortë brenda krizave të Luftës së Ftohtë e herë si kukull pa pushtet as globalisht e as lokalisht. Këta janë personalitetet në rrafshin universal, nëpërmjet të cilëve shqiptarët kanë depërtuar për të mbetur pjesë e historisë globale.

Me **Ismail Kadarenë** braktisim zonat universale dhe hyjmë në ato lokale. Shqiptarët mezi presin që këtij klubi të

lartpërmendur t'i bashkangjitet edhe Ismail Kadareja. Simbolikisht ata këtë pranim të shkrimtarit të tyre e lidhin me çmimin Nobel. Gabim, sepse në historinë e letrarëve të mëdhenj as përfilllet shpërblimi me Nobelit si kusht themelor. Shpesh ai ka efektin e kundërt. Dyshojmë se Kadare – në historinë e letërsisë botërore – nuk do të ketë të njëjtin vend si ata më lart. Jo sepse nuk është një ndër shkrimtarët më të mirë të kontinentit, porse nuk ka shpikur asgjë relevante për historinë e letërsisë, filozofisë e as në letërsinë vetë. Konkretisht: të tillë ka tashmë ka gati shumica e kulturave aktuale. Në historinë shqiptare, pa dyshimin më të vogël ai do të jetë më i studiuar dhe më i lexuar edhe në të ardhmen.

Po në këtë stad lokal si personalitete të epokës (1945 – 2008) në histori do të jenë edhe **Adem Demaçi** si simbol i rezistencës shqiptare gjatë Jugosllavisë së Titos, **Ibrahim Rugova** si prirës procesesh shqiptare gjatë shkëputjes formale nga federate jugosllave drejt pavarësisë të Kosovës, **Hashim Thaçi** si prirës procesesh gjatë konkretizimit nëpërmjet luftës dhe të huajve të pavarësisë së vendit të tij dhe Sali **Berisha** si kyreprotagonist i transicionit shqiptar nga monizmi në pluralizëm. Këto personalitete – deshën apo jo klubet sot të acaruar shqiptare për ta përvetësuar historinë secili për vete – do të mbijetojnë nga epokat dhe do të studiohen gjithmonë qoftë edhe si simbole identifikuese për periudha të caktuara historike.

Është e pamundur të shkruash histori pa fakte. Ose është e mundur si deri më tani: duke interpretuar të krijosh legjenda që edhe vetë legjendat alivanosen nga imagjinata jote. Ekzistenca e liderëve brenda proceseve historike është fakt. E mundshme dhe e domsdoshme është që edhe historiografia shqiptare të bëhet objektive dhe të mos fiksohet vetëm në figurat mirëfilli, por t'i trajtojë ato më shumë si produkte të situatave, episodeve e epokave të caktuara pa u përpjekur t'i

shndrojnë në profetë. Nga francezët e „La nouvelle histoire“ ajo do të mësojë se çdo personalitet është produkt i një mase, strukture, mentaliteti, kulture, segmente të cilat duhet të zënë vend edhe më shumë se vetë figurat në shkrimin e historisë. (2014)

## *1960 – 2013: Epokë e artë e shqiptarësh?*

Historiani amerikan Eric Hobsbawm periudhën ndërmjet viteve 1945 – 1990 e kualifikon si «epoka e artë» e shekullit njëzet. Epokë, në të cilën ndodhën procese, të cilat për kah intensiteti dhe efekti sollën ndryshime të mëdha në aspektin politik, ekonomik e social të planetit. Si zhvillime konkrete, nëpërmjet të cilave ai argumenton tezën, ai përmend fundin e kolonizimeve në të ashtuquajturën «bota e tretë»; fundin e epidemive me zbulimet e reja shkencore në medicinë; shpërthimin e një lëvizjeje globale rinore, e cila i dha fund moralit liberal – konservativ; fundin e fshatarësisë feudale dhe fillimin e urbanizimit; revoltat studentore të 68; marshin e feminizmit për të siguruar votën politike; shkollimin e masave dhe aspekte tjera të këtij vertikalisiteti «civilizator».

### TEORIA

Nëse përpiqemi që teorinë e Hobsbawmit ta konfirmojmë ose hedhim poshtë duke marrë sekuenca a episode të caktuara të periudhës për të cilën ai flet do të ndeshemi me kontradikta të shumta, sepse jo në gjithë kontinentet ose në të dyja blloqet (komuniste e kapitaliste) do të ndeshim në zhvillimet shpresëdhënëse që liston.

Përkundrazi në botën e tretë vazhduan të ndodhin gjenocide – dhe atë si pasojë e konkurrencës së dy blloqeve, sot të rikonfiguruar në kulturosfera, me të njëjtin synim eksploatimi agresiv, industrial. Në bllokun komunist Bashkimi Sovjetik tregoi edhe njëherë dhëmbët duke shkelur në mënyrë brutale çdo përpjekje të Çekosllovakëve (Pranvera e Pragës) dhe hungarezëve për të demokratizuar shoqëritë e tyre, në Jugosllavi vazhdoi terrori që manifestohej po si në BS



me burgosje dhe shuarje me dhunë të demonstratave të shqiptarëve dhe kroatëve.

Krahasuar në këtë mënyrë, pra duke analizuar çdo proces veç e veç, atëherë teoria e Eric Hobsbawm – it është tejet romantike dhe optimiste, mirëpo në qoftë se masim proceset nga distanca e veçanërisht duke i shikuar ato si elemente të një procesi shekullor, siç bën autori i veprës «Epoka e ekstremeve – Historia Botërore e shekullit njëzet», atëherë jemi të detyruar t'i japim të drejtë autorit, sepse zhvillimet që fillojnë me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore e përfundojnë me rënien e të ashtuquajturit «Socializëm real», në krahasim me epokat tjera të Historisë së Njerëzimit janë më dramatiket dhe njëkohësisht më efektivet sa i përket ndryshimit të sistemit funksional global.

Shekulli njëzet është vërtet shekull i ekstremeve si në plan pozitiv ashtu edhe në atë negativ. Ekzistenca e këtyre dy poleve (negativ – pozitiv) është baza e spekulimeve që rezulton shpesh në mospranimin e tezës së Hobsbawm-it sa i përket «epokës së artë», sepse çdo proces – nëse ai shqyrtohet si njësi e veçantë – bartë në vetë më shumë çaste dramatike, negative e destruktive, sidomos sa i përket vuajtjeve dhe humbjeve që pëson humaniteti, se sa rezultatet pozitive e optimiste. Këtë aspekt sigurisht se as Hobsbawm nuk e mohon. Çka vlen dhe është kryesore për Hobsbawm është finaliteti dhe përshkrimi i analizës nga perspektiva e «zogut», siç i kualifikon ai studimet e tija, për të me rëndësi është që shekulli të vështrohet nga dy kënde themelore; nga distanca dhe globalisht. Se a qëndron apo jo teza e autorit kur analizojmë «historitë» e popujve e kombeve të veçanta do të shohim me rastin e Ballkanit, respektivisht kur do të ecim anatomisë së fatit të shqiptarëve.

A mund të flasim edhe popujt tjerë, përveç amerikanëve dhe eurperendimorëve, për një epokë kur gjithçka ka ecur

vertikalisht? Si është gjendja e shqiptarëve në «epokën e artë» të shekullit njëzet?

## FATUMI SHQIPTAR

Shqiptarët bëjnë pjesë poashtu në taborin e atyre popujve që vazhdimisht vajtojnë mbi fatin e tyre. Në realitet, një qëndrim të tillë atyre ua ka imponuar historia dhe rrethanat në të cilat ata vazhdimisht kanë qenë të detyruar të ekzistojnë, mbijetojnë. Kjo sa i përket psikologjisë së masave. As ajo e shkruara, pra prodhimi intelektual, rreth temës së këtij diskursi, nuk dallon në esencë nga «përshtypja e masave» ndaj historisë dhe gjithashtu përshkohet nga të njëjtat tone zhgënjimi, vuajtjeje dhe vaji prej viktime.

Nëse shikojmë historinë nga «perspektiva e zogut» siç na propozon historiani eurokomunist në moshë, atëherë vërejmë se shqiptarët gjenden në mesin popujve që më së shumti kanë përfituar në shekullin njëzet. Pse? Cilat janë arsyet që do të materializojnë një tezë të tillë, e cila supozon se shqiptarët e kanë pasur poashtu epokën e tyre të artë ndërmjet viteve 1945 – 1990, respektivisht 2013, kur dihet se pjesën më të madhe të këtij shekulli ata e kanë kaluar të robëruar nga bashkësia e popujve sllavë, kanë qenë të burgosur, diskriminuar e terrorizuar, kanë qenë të izoluar pa asnjë të drejtë themelore në sistemin stalinist e autokratik të Enver Hoxhës. Prej nga marrim guximin të filozofojmë se shqiptarët qenkan nga profiterët më të suksesshëm të shekullit kur ende na janë të gjalla parasysh skenat e gjenocidit dhe deplacimit masiv nga trojet e tyre autoktone?

Është logjike se tezën mbi «epokën artë» shqiptare nuk mund ta ndërtojmë vetëm duke u bazuar në disa stacione me finalitet pozitiv në fushën e të së drejtës politike të një populli. Nëse një epokë e tillë ekziston, nëse një proces i tillë vërtet ka

ndodhur atëherë ai duhet të ketë përshkuar të gjitha segmentet që përbejnë një kulturë, një etnikum, një popull, domethënë nëse pranojmë të ketë pasur epokë të artë atëherë ajo duhet të jetë manifestuar në të gjitha sferat e jetës: në jetën sociale, në kulturë, në ekonomi, në politikë e kështu me radhë.

## DIMENSIONI SOCIOKULTUROR

Pas viteve të 50- ta, përkundër kufizimeve të shumta në plan të të drejtave dhe lirive të njeriut, në Shqipëri fillon faza intensive e arsimit të masave; reduktohet dukshëm analfabetizmi; krijohet një divizion shkrimtarësh; në Moskë, Berlin dhe qendra të tjera të bllokut specializohen një numër i konsiderueshëm ekspertësh të fushave të ndryshme. Në të njëjtën kohë në pjesët tjera ku jetojnë shqiptarët, veçanërisht në Prishtinë, për një kohë të shkurtër ndërtohet sistemi edukativo-arsimor, hapen shkolla edhe nëpër fshatra. Fillimisht dhjetëra e pastaj edhe më shumë studiojnë universiteteve të Zagrebit dhe Beogradit. Hapet Universiteti i Tiranës, pas pakë kohësh edhe ai i Prishtinës. Ky i fundit qysh në vitin 1979 dispononte me nëntë fakultete dhe numëronte rreth 24 mijë studentë, nga të cilët rreth 18 mijë të përkatësisë kombëtare shqiptare.

Për herë të parë në historinë e tyre shqiptarët dispononin me institucione të arsimit dhe edukimit si popujt tjerë dhe nisin konkurrimin e tyre me të tjerët në prodhimin dhe absorbimin e dijeve në shkencat humane dhe ato ekzakte. Po në këtë start u hapën edhe mediumet e para publike si gazetat dhe radiot, filloi botimi i librave në gjuhën shqipe.

Ndoshta krijimi i institucioneve dhe reduktimi i analfabetizmit si procese në vete edhe nuk janë ndoshta aq spektakulare si merita autentike shqiptare, kur kemi parasysh

rrethanat tjera të asaj kohe (idealet e socializmit për arsimimin dhe internacionalizimin proletar) që detyronin edhe shqiptarët të ndërmarrin hapa të tillë, karakteristike në këtë kontekst është nga njëra anë shpejtësia me të cilën shqiptarët krijuan ato mekanizma dhe nga ana tjetër rezultatet, të cilat do ti radhisim më vonë në këtë diskurs, rezultate që kallëzojnë se si një popull i zhytur në analfabetizëm, arrin që për një kohë të shkurtër të integrohet në garë me etnitë tjera të zhvilluara sa i përket kulturës, e parasëgjthash sa i përket konceptimit të lirisë në sendiçin e konkurrencës së blloqeve ideologjike.

Shkollimi masave bëri që në hapësirat shqiptare të shpërthejë procesi i urbanizimit, i cili krahasuar me vendet tjera, nuk ndodhë vetëm në kufijtë e “shuarjes së fshatit” në favor të qytetit, por më shumë ai pati karakter të urbanizimit social, që do thotë se fshatarët mbetën në lokalitetet e tyre, por kombinuan sistemet e tyre polikratike me vlera të reja në modë si të qytetarisë. E vetmja shtresë që veçohet për nga lëvizja dhe mobiliteti ishte ajo e studentëve dhe intelektualëve, të cilët për shkak të domicileve të institucioneve detyroheshin të përqendroheshin në qendrat – qytetet e mëdha. Ky zhvillim ishte i rëndësishëm për “qytetarizimin” edhe të banorëve të vendeve që deriatëhere sundoheshin vetëm nga rite dhe zakone «primitive». Filloi fundi i mënyrës feudale së të jetuarit, nisi zbehja e pushtetit të fortë të patriarkalitetit (pjesërisht edhe matriarkalitetit) që pengonte prosperimin e familjes si njësi e lirë, plurale, poliindividuale vshoqërore. Distancimi nga stili feudal i të jetuarit për shqiptarët nuk donte të thotë vetëm largim nga mënyra arakike, kanunore e mesjetare e funksionimit, por më shumë edhe ikje nga mentaliteti dhe normat që atyre iu ishin imponuar nga pesëshkulli osmano-turk.

Kontrasti i këtij procesi, mund të shihet në lokalitetet ku një ndryshim i tillë ende nuk ka ndodhur ose gjendet në kacafytje me kohën dhe standardet aktuale. Shembull konkret: Maqedonia Perëndimore, ku procesi i arsimit nuk ndodhi në mënyrë institucionale si në Shqipëri e Kosovë vërehet se dominanca osmano-orientale ende nuk ka dhënë shpirt. Dizajni infrastrukturor i qilimave dhe minderëve, hierarkia familjaro-fisnore dhe struktura e rrjetit social në këto vise ende mbajnë në ballë stampën e epokës së ashtuquajtur «alla turka». Njeriu atje, së paku në pjesën dërrmuese të rajonit, – pavarësisht nga niveli intelektual dhe shkolla ku është formuar – ende funksionon sipas ligjeve të kopësë sektareske që priret nga imami gjysmëanalfabet. Me këtë nuk duam të hedhim tezën në etër se shqiptarët e Maqedonisë kanë mbetur «më primitiv» për shkak të besimit të tyre islam, porse ata, për shkak të pamundësisë (diksriminimit nga ana e systemit) të kyçen në procesin e modernizimit kanë mbetur rob të nivelit që iu është instaluar dhunshëm nga osmanët shekuj më parë.

Promotori i natyrshëm i qërrimit të hesapeve me vlerat dhe konvencionet e vjetra dhe të demoduara ishte rinia. Në krahasim me rinitë e vendeve të europërendimit, të cilat shkëputjen nga e kaluara e manifestonin në mënyrë antinome dhe që si shtylla të revolucionit kishte zgjedhur drogën, seksin dhe rok muzikën, rinia shqiptare për shkak të pamundësisë për të shpërthyer më tej se sa lejonin sistemet (komuniste) ku jetonin, pra duke pasur të pamundur që t'i bashkangjiten revolucionit sociokulturor panperëndimor ata detyrohen të investojnë kryesisht në rikonstruimin dhe modernizimin e identitetit kulturor, të cilin ata mendojnë se do ta mbrijnë nëpërmjet të së vetmeve armë që viteve të 60-ta kishin në dorë; arsimit dhe integritit në sistemin shoqëror e politik. Përderisa në Tiranë ky integrim prirej nga besimi në vlerat e

socializimit real, në Prishtinë qëllimi kishte motive krejtësisht të kundërta, integrim në favor të një destruksioni të mundshëm të sistemit, të cilin ata që në fillimet e tij e konsideronin si të huaj dhe diskriminues ndaj tyre.

Në të dyja sistemet «revolucionit» nuk do të ecë në drejtim të fitimit të autonomisë së individit dhe liberalizmit social si në Perëndim e SHBA, por në drejtim të krijimit të gjeneratave të kualifikuara për të përvetësuar zhvillimet që më vonë do të vënë në lëvizje sidomos shqiptarët jashtë kufirit të mbyllur egërsisht nga diktatura autokratike e Enver Hoxhës. Kjo rini e formuar në vrullin e ndryshimeve epokale dhe globale që inspirimin e konsumonte kryesisht nga shkolla postmaterialiste e Frankfurtit do të marr përsipër jo vetëm rikonstruimin e identitetit kulturor e social por edhe fatin politik të shqiptarëve në ish – Jugosllavi për dekadat që pasonin.

Revolucioni social e kulturor i Evropës së viteve të gjashtëdhjeta rrënjët i kishte në programin e marksizëm – leninizmit dhe bolshevikëve. Revoltat që shpërthyen në mbarë Evropën perëndimore, SHBA e gjetiu në botën kapitaliste gjatë vitit 1968 ishin kundërvënie ndaj riinstalimit të modelit të exliberalizmit të belle epoques që nuk përfillte gjithaq sigurinë sociale të klasës puntore dhe minoriteve tjera shoqërore. Shkolla e Frankfurtit, e cila konsiderohej me të drejtë si prirëse intelektuale e këtyre revoltave besonte në vlerat e revolucionit socialist të shkaktuar nga Lenini me kompani qysh në vitin 1917. Këtu qëndron edhe paradoksi pozitiv kur bëhet fjalë për elitën shqiptare jashtë Shqipërisë zyrtare: ata edhe pse – në krahasim me kolegët e tyre perëndimorë të cilët jetonin në sistemet liberal-demokratike – ishin banorë të sistemeve të socializmit real më shumë ishin të orientuar në vlerat e iluminizmit dhe liberalizmit (të cilin

koncept liberal e kishin të trashëguar nga Epoka e Rilindjes) se sa në atë të marksizëm – leninizmit.

Nga kjo?

1945 – 1950

Ky orientim prodemokratik politik e kulturor zanafillat e veta i ka – siç përmendëm më lartë në natyrën liberale të Rilindjes Shqiptare, por më shumë edhe në ngjarjet gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe pas saj. Në vitin 1945 del në shesh konkretisht se shqiptarët nuk ishin inkuadruar në luftën partizane kundër nazizmit për tu bërë me çdo kush pjesë e sferës komuniste, por për shkak të shpresës se përfundimisht do të fitojnë shtetin e tyre në kufinj të tij natyror. Që me kristalizimin e planeve të botës së kuqe mbi fatin e shqiptarëve, shumica e njësiteve partizane shqiptare të Kosovës dhe Maqedonisë do të transformohen në brigada rezistuese kundër komunistëve.

«Çlirimi i trojeve shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni» nis me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në këto vise nga ana e komunistëve jugosllavë. Viktimat shqiptare në mes të viteve 45 – 55 janë me mijëra, mbi 80 mijë shqiptarë detyrohen të ekzodojnë në Turqi dhe për të finalizuar këtë terror ndaj rezistencës shqiptare kundër komunizmit Rankoviçi ndërmerr masat më çnjerzore që mban mend historia e shqiptarëve të mbetur në ish-Jugosllavi.

Në Shqipëri diktatura merr kontrollin edhe më brutalisht në dorë. Për dallim me shqiptarët e Jugosllavisë, ku motivi nacional luan një rol kapital në luftën kundër diktaturës, rezistenca e antikomuniste në Shqipëri është e privuar nga ky justifikim. Numri i madh i internimeve, burgosjeve dhe likuidimeve megjithatë tregojnë për një rezistencë poaq kualitative ndaj diktaturës komuniste dhe dëshmojnë se ideali

liberal, i asistuar nga klerizmi, vazhdonte të mbetet rreziku numër një për diktaturën kuazikomuniste të Shqipërisë

Nën presionin e këtyre ngjarjeve ngriten gjeneratat e para shqiptare të pasluftës. Gjeneratat e vjetra, viktimat direkte të këtyre ndodhive, ishin prindët e të rinjve në shkollim e sipër, atyre që më vonë do të integrohen në ndërtimin e shoqërisë realsocialiste shqiptare e jugollave.

Në hapësirat e ish – Jugosllavisë asnjë komb tjetër deri atëherë nuk kishte vujatur më shumë nga diktaturat dhe asnjëri prej tyre nuk i kishte rezistuar më shumë se shqiptarët. Kjo është meritë epokale e shqiptarëve kundër diktaturave moniste. Që nga periudha e Skënderbeut kur shqiptarët luanin rolin dominant në pengimin e osmanëve për të kapërcyer Adriatikun, historia nuk njihte ndonjë akt tjetër të natyrës globale të drejtuar nga raca e kësulbardhëve. Lufta e shqiptarëve të Kosovës dhe Maqedonisë kundër sistemit në të cilin jetonin kishte një karakter të tillë, sepse në vitin 1945 asnjëri nga popujt e bllokut komunist nuk luftonte në mënyrë aq të organizuar kundër sistemit se sa shqiptarët, në asnjërin prej tyre komunizmi nuk festonte fitoren e tij duke shpallur gjendjen e luftës (përkundrazi) ndaj dy milionë banorëve të tij. Shqiptarët janë shkaktarët që përçojnë sinjalin në botë se integriteti i idealit komunist mund të vëhet në pikëpyetje dhe parasëgjithash se edhe ai nuk është i paprekshëm, siç besonin shumica e popujve në Lindje e Perëndim.

1950 – 1968

Pas një pauze, që ne e kualifikojmësi fazë të regjenerimit dhe rimobilizimit (1950 – 1968) shqiptarët sërish vëhen në lëvizje kundër sistemit. Në tetor dhe nëntor të vitit 1968, në të njëjtën kohë më lëvizjet studentore të Evropës që Hobsbawm i quan «revolucioni global kulturor e social» dhe disa muaj pas «Pranverës së Pragës» (21. gusht 1968), në të gjitha viset



shqiptare të ish –Jugosllavisë shpërthejnë demonstrata masive.

Për herë të parë këto demonstrata kanë karakter gjithshqiptar: ato nisin në Prizren, kalojnë nëpër Tetovë, Gostivar, Ulqin, Pejë, Prishtinë për të mbaruar sërish para ndërtesës së Lidhjes së Prizrenit.

Edhe pse historia zyrtare e shqiptarëve përpiket që ato demonstrata t'ia mvësh kryesisht Lëvizjes së mëvonshme për «Republikën e Kosovës», ato megjithatë – gjykuar nga parullat dhe deklaratat e protagonistëve të asaj kohe – në esencë ishin vetëm liberaliste (jo liberale). Kërkesat themelore të asaj janë ato për më shumë të drejta në shkollim (kërkesa për univerzitet) dhe për më shumë liri individuale e kolektive (e drejta për vetvendosje), pra ato janë më shumë revoltë ndaj diskriminimit jugosllav ndaj lirive dhe të drejtave të njeriut se sa – siç do të pretendohet më vonë – një luftë për të krijuar Republikën e Kosovës e në asnjë mënyrë për bashkimin me shtetin amë, me Shqipërinë. Individët dhe grupacionet ilegale me kërkesa të tilla janë tepër të vogla dhe pa ndonjë mbështetje konkrete të masave.

Autonomia e Kosovës dhe krijimi i Universitetit të Prishtinës janë vetëm rezultate të këtyre demonstratave e që shkojnë në konto vetëm të shqiptarëve. Këto demonstrata, mirëpo, vënë në lëvizje edhe shumë procese tjera. Dy vjet më vonë edhe kroatët kërkojnë më shumë autonomi (MASPOK). Rezistenca e nisur në Prizren rrezikonte të përlejë gjithë Jugosllavinë, kështuqë detyroi qeverinë jugosllave madje të ndryshojë kushtetutën e saj, duke u dhënë më shumë liri republikave dhe duke pranuar një varg lirishë të pazakonshme për shtetet e bllokut të të ashtuquajturit «socializëm real».

Natyrisht që popujt e tjerë të Jugosllavisë (përveç elitës kroate) me pakënaqësi e pranojnë faktin se shqiptarët kanë qenë promotori kryesor i destruksionit të bashkësisë jugosllave, demolim që çonte në drejtim të demokratizimit, pavarësisht të republikave e krahinave dhe demolimit të sistemit, përkundër fakteve se shqiptarët janë të parët që në mënyrë masive nisin dhe mbajnë gjallë këto procese der me rënien totale të jugosocializmit.

1981 – 2012

Faza e dytë e këtij procesi janë demonstratat e vitit 1981. Ato shpërthejnë më 11 mars në menzën e studentëve për kushte më të mira. Fillimi i këtyre demonstratave nuk dallon shumë nga ato të 68-va. Grupe të ndryshme kryesisht studentore, plurale dhe të atilla me prirje nacionalkomuniste përziejnë në masë parullat për «Kosovën Republikë», «Bashkim me Shqipërinë» dhe u japin demonstratave një ngjyrë krjetësisht tjetër nga ajo e revoltës sociale studentore e kulturore kundër sistemit. Janë këto grupe – të pakoordinuara ndërveti dhe me programe proenversite – që instrumentalizojnë masën dhe i «avansojnë» demonstratat nga rezistenca qytetare kundër sistemit në luftë për të drejtën e shtetëformimit të shqiptarëve nën Jugosllavi ose për bashkimin e tyre me Shqipërinë edhe më diktatoriale se shteti ku jetonin. Nuk janë të rrallë ata ekspertë që supozojnë se një pjesë e atyre organizatave kanë qenë edhe vetë «zbulime» e «celula» të shërbimit sekret jugosllav nën udhëheqjen e serbëve për të suspenduar kushtetutën e '74 në disfavor të shqiptarëve.

Pa u lëshuar në gjykime ndaj këtyre organizatave – gjë që as që është qëllimi i këtij diskursi – ato provokojnë një reagim të shtetit që nga shumica e ekspertëve botërorë do të konsiderohet si «fillimi i shkatrrimit të Jugosllavisë». Ngajrjet

e 1981 i përngjejnë një domino-efekti që çojnë në finalen siç e formulon shkrimtari dhe publicisti ungarez – jugosllav nga Vjena Milo Dor: «Shkatrimi përfundimtar dhe i vërtet i Jugosllavisë ndodhë me riokupimin e Kosovës nga policia dhe armata serbe në vitin 1989».

Nëse parashtrojmë pyetjen se sa e nxitën shqiptarët reagimin e egër millosheviçian, atë përgjigja duket kështu: shqiptarët e Kosovës më shumë se çdo bashkësi tjetër të ish-Jugosllavisë punuan për dekada për të prodhuar këtë reaksion, përndryshe besonin të mbeten përjetësisht nën diskriminimin permanent të «sllavëve», siç i quajnë ata joshqiptarët në jetën e tyre. Me të drejtë. „Historia“ iu dha të drejtë.

Me rënien e «perandorisë së kuqe» shqiptarët (jashtë Shqipërisë) e provuar me metodën kontinuitative të rezistencës dhe organizimit politik ilegal ose polikrat shpejtë jo vetëm që krijuan partitë e tyre, por edhe sisteme paralele shoqërore e shtetërore bënë (LDK në Kosovë). Organizim që frikësoi edhe më shumë shtabet hegjemoniste të fqinjve, të cilët reagues konform rrezikut që u kanosej. Nga ana tjetër organizatat ilegale, sidomos të instruktuarra e kontrolluara nga emigracioni politik shqiptar (LPK) shumë shpejtë kapën faktin se: rënia e realsocializmit dhe vala e demokracisë nuk janë apriori granacia se do të mundën të shpresojnë në zgjedhjen e çështjes së tyre nacionale dhe pavarësimin nga të tjerët. Kjo shpjegon edhe arsyen se pse qysh në vitet 1992 – 1993 LPK dhe organizata të spektrit të majtë në diasporë filluan me sajimin e programeve dhe strategjive që çonin drejt një konflikti të armatosur, drejt një lufte që e mendonin të paevitueshme. Në këtë periudhë qarqe të këtij spektri do të fillojnë edhe me kampanjat e tyre për të siguruar aleatët e tyre perëndimorën si dhe ata për asistencë logjistike e materiale. Me sukses. Në anën tjetër krahu paqësor i lëvizjes shqiptare (LDK) ishte në këtë drejtim i përçarë ose më saktë kundër një

luftë të armatosur sepse nuk besonte se shqiptarët të kenë potenciale të mjaftueshme për luftë dhe rrinin skeptik përballë «këshilla»-ve të CIA-s dhe shërbimeve tjera që nuk ishin më të interesuara të tolerojnë dominancën e paktit Moskë-Beograd-Arhinë në gadishullin ballkanik dhe kalkulonin për një dominancë tjetër të vijës shqiptare-kroate-çeko-polake.

Shikuar, analizuar pas mbylljes së shumë proceseve rezulton sikur shqiptarët qëllimisht të kenë lujatur me kartën e përçarjes në dy alternativa në atë të «krahut të luftës» dhe në atë të «krahut të pacifizmit», kështu duke ofruar dy platforma të domosdoshme, pa të colat nuk fitohet asnjë luftë: gjersa Ibrahim Rugova bindte diplomacitë botërore se nuk ka zgjedhje tjetër përpos pavarësisë dhe se shqiptarë vetë nuk dalin nga robëria në lirinë e merituar, LPK dhe UÇK i dëshmonin botës se shqiptarët ishin të vendosur edhe deri në vdekje që mos të mbesin nën administratën serbe. Konkretisht: ekzistenca e këtyre dy poleve – që vepronin jo me vetëdije, jo me dëshirën e tyre, madje duke u ndier ta luftojnë njëra tjetrën – ishte strategjia më efektive dhe e mençur dhe për nga forma e paparë ndër lëvizjet e djeshme dhe aktuale militante që kanë të njëjtat synime si kosovarët, respektivisht shqiptarët e Jugosllavisë – për shkak se e njëjta strategji vazhdoi suksesshëm edhe në Maqedoni.

Po mos të përfillnim kërkesat e metodës shkencore së shkruajrjes së historisë dhe të pranonim fenomenologjinë mbinatyrore si përcaktuese do të thonim se jo njerëzit zgjedhën çështjen e Kosovës, por një frymë, shpirt (siç besonin edhe filozofët deri dje të ketë një frymë supreme ahumane që dirigjon njerëzit pa dijen e tyre) panshqiptar që detyronte të punojnë njerëz drejt një synimi edhe pse urrenin e sabotonin njëri tjetrin.

## 2013 SI MËTUTJE

Sot, në vitin 2013, pas zgjedhjeve në Kosovë, pas rokadës politike në Tiranë dhe duke shpresuar se shqiptarët e Maqedonisë në pushtet mbajnë premtimet që dhanë maleve të Tetovës, ç'mund të themi? Pa hamendje dhe fakteplotë se ora deri sot punoi si kurrë tjetër për shqiptarët. A mundet që finalja të kthej gjithçka prapa? Po. Sepse dukshëm qeveritë shqiptare nuk dalin të kompletuara në dije, aftësi e kompetenca për të menaxhuar lirinë në atë mënyrë që së paku këtë festë fundviti ta përdornin edhe si manifestim të mbylljes së një epoke të suksesshme. Demokracia, shteti ligjor dhe i fortë janë ende larg realizimit konkret. Skamja, pabarazia sociale, pseudoshkencat, paperspektiva janë rreziqe të mund ta kthejnë shumëçka në ferr. Apo mendojnë primatët politikë se këto janë detyra që poashtu kërkojnë një epokë kohë? Jo. Pa realizimin sa më urgjent të tyre gjithë gjaku, djersa dhe munda shqiptar nëpër shekuj do të shkonin kot: Liria për një shoqëri nuk vjen ditën e fitores por atë ditë kur ajo shumicës ia jep ndjenjën ta ketë merituar atë, ta gëzojë atë. E bazuar në disponimin sociopsikologjik aktual të shumica shqiptare gjithë indikatorët mbarojnë në të njëjtin lumë: shqiptari ndihet ende i robëruar! Jo nga të huajt por nga vetja se nuk ia del si duhet.

### TEZA

Po shqiptarët janë fëmijë të një epoke të artë, sipas tezës së Eric Hobsbawm-it. Ora e historisë ka punuar edhe për ta dhe me një finale që edhe shumica prej tyre nuk e besonin se do t'i prekë, megjithatë me një dallim nga tjerët: shqiptarët për ta artëzuar epokën e tyre u dogjën, vuajtën, u shtypën dhe sakrifikuan më shumë se të tjerët, veçanërisht më shumë se

ata popujt që i analizon megahistoriani Eric Hobsbawm dhe shumë të tjerë si ai! (2013)

## EPILOG

### *Shqiptarët përtej blloqeve*

*Ndërmjet Orientit dhe Oksidentit*

Shqiptarët nuk janë as orientalë e as oksidentalë. Ata s'janë as myslimanë, as katolikë e as ateistë. Ata nuk janë nacionalistë, patriotë e as kozmopolitë. Ata kanë një identitet që përbashkon të gjitha këto në një habitus të vetëm praktik. Katër dhoma, pesë kultura dhe një sallon pikëtakimi: dhoma e të birit dridhet nga intensiteti veshplasës i muzikës. Nga shpeshësia e beats-ave dhe posteri paraderës ku formëgravuar lexohej «EC8OR» kuptuam se 20 vjeçari i përket divizionit të fansave të Patric Catani-t dhe Giona D'Orio-s, atyre dy themeluesve të *Digital Hardcore Band*-it me orientim ekstramajtist. Nga dhoma e djathtë mezi kap eterin një zë shqip. Brenda e bija si në trans dhe robotshëm riprodhon me gjoks bubullimat e «Ushtar kavajës» së Ilir Shaqirit. «Zoti u marroftë as namazin nuk mlatë ta bëj si duhet» ankohet nëna që shtanget kur na sheh në korridor. «O bir edhe hajdutet me u hy ktyne nuk e marrin vesh», kështu ajo. Na sjell në dhomën e pritjes. Salloni është i dekoruar me një portret të madh të Ibrahim Rugovës që shtrëngon duart e Papa Gjon Palit të II-të. «Hajt, hajt shko falu» e urdhëron patriarku të shoqen dhe «qy, qy ia prishëm namazin». Me një ligjëratë antiosmane dhe ca sqarime se klerikët katolikë janë etërit e bazave kulturore e identitare shqiptare na intimëzoi i zoti i shtëpisë me botëkuptimet e tij rreth botës, kombit dhe moraleve.

Nga kjo skenë disaminutëshe brenda një familjeje të vetme identifikojmë një diversitet tipik që mund t'ua mveshim si karakteristikë të gjitha shoqërive shqiptare.

Çka gjejmë këtu: Orientin, oksidentin, marksizmin, shqiptarizmin, myslimanizmin, katolicizëm, (ortodoksizëm), konservatizëm, patriarkalizëm simbiotik (praktika orientale me teori kanunore), art oksidental, dhe shumë të tjera në një.

Cili është identiteti i kësaj familjeje nëse do të donim ta fusnim në atë shabllonin oriental-okcidental?

*Gjurmëve të një debati historik* - Tonelata libra, pamflete dhe studime janë botuar viteve të fundit rreth dy blloqeve «kulturore» që e ndajnë globin në dysh: në orient dhe oksident. Intensiteti i diskursit, debateve është rigjeneruar sidomos pas harxhimit të «Luftës së ftohtë» si objekt studimi.

Tre «shkolla» kryesore vazhdojnë të dominojnë mbi polemikën historike të këtij konstelacioni: ajo *eurocentrike* që mbështetet në epërsinë e oksidentit duke marrë për bazë antikitetin «grek», industrializimin dhe iluminizmin; ajo e «*ex oriente lux*»-it (nga Lindja vjen drita) që kundërshton faktin se zhvillimi t'i ketë rrënjët në perëndim, sepse të gjitha shkencat ekzakte kanë origjinë nga lindja dhe; pala e tretë janë qortuesit kronik (*metakritikët*) të dy të parëve që kategorizimin e botës në këto dy blloqe e përjetojnë si doktrinë luftarake politike që në thelb është raciste.

Po t'i bëjmë një diagnozë konglomeratit të tezave, hipotezave dhe historive aktuale do të ndeshemi me faktin se në këtë drejtim hiçgjë nuk ka përparuar. Përveç terminologjisë, instrumenteve metodologjike dhe freskisë dizajnore opinionet t'i përkujtojnë ata ushtarët stoikë në filmin «Battle for the Planet of the Apes» (Beteja për planetin e majmunëve) të regjisorit J. Lee Thompson. Në fakt kemi të bëjmë me teori që nuk kanë arritur të shpëtojnë nga qelitë manastireske dhe beduineske të mesjetës:



*Shkolla e parë: Eurocentrikët* - Samuel P. Huntington («Përplasja e qytetërimeve»:1996) e shkruan një libër që përveç inventarit pasmodern lingusitik, në thelb nuk dallon aspak nga historitë e eurocentrikut, antisemitit (semitizmi këtu përfshijnë jo vetëm hebrenjtë por edhe etiopasit, arabët, maltezët, sirianet, për të përmendur vetëm të gjallët) dhe refuzuesit kategorik të demokracisë, kulturologut Jacob Christoph Burckhardt (Historia e Rilindjes italiane, 1860). Këtij tabori teorik i përkasin një numër i rëndësishëm i historianëve dhe kulturologëve më të rëndësishëm të botës perëndimore. Edhe pse jo në stilin frontal të Huntington-it me veprat e tyre si «Historia e filozofisë botërore» duke nis qëllimisht nga Athina dhe tendenca tjera të këtij lloji ata përforcojnë këtë ideologji që çdo të mirë e lidh kushtimisht me mitin e idesë evropiane.

*Shkolla e dytë: Apologjetët e përtejeuropës* - Pledoajetë pro-orientale, domethënë pjesërisht antieurocentrike, të bëra nga studiuesi amerikan me origjinë palestineze Edward Said («Orientalism»:1978) dhe bullgarja Maria Todorova («Imagining the Balkans»:1997) janë teori formëtraktati, të prira nga motivi marksist «ata nuk mund të përfaqësojnë veten, ata duhet përfaqësuar». Vepra që dalin si modifikime të inspiruara nga «Rënia e oksidentit» të Oswald Spengler-it (1923). Themi të modifikuara sepse si Said ashtu edhe Todorova të vetmin dallim nga ideatori i tyre kanë mosbesimin logjik në rënien e kulturës oksidentale, përndryshe forma e reflektimit mbetet e njëjta. Dhe më fisnikja në favor të autorëve të këtij poli është mosmohimi i vlerave të Iluminizmit evropian, zhvillimit aktual të lartë të kontinentit dhe ngecjes dramatike në kontinentet e tjera. Ky grup pretendon se «realitetet» orientale nuk janë vetë realiteti, porse janë veç sajesa oksidentale.

*Shkolla e tretë: Universalistët - «The Story of Civilisation»* (1935–75) e amerikanit me origjinë franko-kanadeze William James Durant hyn në llogarinë e përpjekjeve kolosale për ta rrëfyer historinë e qytetërimit pa trastën e doktrinave të këtyre dy blloqeve. Sot edhe pse bibliotekat janë të mbushura deri në frymëzënie me tendenca të ngjashme, ato nuk arrijnë të standardizohen seminareve universitare. Nga njëra anë për shkak të dominancës të politikave shtetërore në institutet e arsimit (gjithandej) dhe nga ana tjetër për arsye se shumica e akademikëve të fahut dhe karrierës nuk çlirohen dot nga opiumi i supermacisë. Nga ky kontekst mund të sqarohet edhe mospajtimi i veprave si «Ideas. A History From Fire to Freud» (Idetë. Një histori nga zjarri deri tek Freud-i [2005]) e docentit të Institutit Arkeologjik të Universitetit të Cambridg-it dhe shumë të tjerave të këtij lloji. Më shpejtë sensibilizohet opinionimi me libra luftëshpallës si ai i shkrimtarëve dhe gazetarëve Ilija Trojanov dhe Ranjit Hoskoté «Refuzim lufte – kulturat nuk luftohen, por shkrihen ndër veti» (Kampfabgabe. Pössenk 2007) se sa me studime serioze. Ky libër, i cili është konceptuar si debat i lirë me konservaorin anglosakson Samuel P. Huntington megjithatë thekson diçka që tashmë shkencërisht nuk ka si hidhet poshtë. Ai ripërmend një të vërtetë që përmbys muret mendore të blloqedashësve. Çfarë thonë dy autorët që ndërkaq s'mund të injorohet dot?

*Metakritikët:* Trojanov dhe Hoskoté thonë se e gjithë fama rreth bazave të filozofisë oskidentale mbi identitetin grek është një sajesë e doktrinave politike të «kontinentit të vjetër» këndeje Bosforit. Nëse autorët këtë e supozojnë për arsye se mbi 80% e filozofëve të parë që nga Tales-i nuk janë grekë, por me origjinë nga Azia e vogël (vise të Turqisë së sotme) si Mileti, Rodosi, Efesi, Elea dhe Ilioni, atëherë ata kanë të drejtë. Ashtu siç kanë të drejtë kur thonë se gjeometria,

arkitektura, numërimi (arab) janë shpikur nga kulturat e lashta përreth Nilit e më tutje, gjë që e pohonte edhe filozofi dhe eruditi britanik Betrand Russell ndërkohë që ricitonte veten; «Homeri si autor i pjekur ishte prodhim i Joniadës», duke patur parasysh këtu kulturat që atëbotë vendndodhjen e kishin në Turqi, Siri e më thellë Azisë. Autorët megjithatë nuk bëhen transparentë dhe «objektivë» deri në fund kur përheshtin faktin se fragmentet gati të pavlefshme të Talesit, Anaksiminit, Anaksimanderit me kompani nuk krahasohen dot me trashëgiminë e lënë nga Platoni dhe Aristoteli.

Trojanov dhe Hoskoté nënvizojnë edhe një detaj të rëndësishëm dhe që nga eurocentrikët arkivohet harrueshëm e me plotë dëshirë: rikthimin e mësimave të Platonit dhe Aristotelit në Evropë gjatë shekullit të 13-të nëpërmjet Albertus Magnus-it dhe Thomas Aquini-it. Këta dy mendimtarë kishtarë kishin krijuar një «fabrikë» përkthimesh të veprave të dy grekëve të lashtë me synimin e fisëm për t'i shpëtuar këta dy kolosë nga përvetësimi monopolik i tyre prej dijetarëve arabë e hebrej si Averroës (Ibn Rushd), Avicenna (Ibn Sīnā), Avicebron (Solomon ibn Gabirol) etj, të cilët në një traditë filozofike prej dy shekujsh përpiqeshin t'i bënin religjionet e tyre të përputhshme me mësimet platonike dhe aristoteliane.

Përkundër lëshimeve të shumta, tonit polemik dhe nivelit publicistik Trojanov dhe Hoskoté ia dalin të masivizojnë «të vërtetën» mbi heterogjenitetin e kulturave. Si facit libri na sjell tezën e teorikëve postkolonialistë si ajo e të urtit nga India Homi K. Bhabha («Lokalizimi i kulturës», 2000) i cili hibriditetin e kualifikon si identitetin më real të njeriut postmodern, pra atë të: «Individit si simbiozë e kulturës së ambjentit të vet jetësor me ato të “huajat”».

*Patosi neveritës* - Arsyeja përse debatet ballkanike dhe ato lart e poshtë orientit dhe oksidentit të religjioneve nuk e përfillin këtë bazë teorike, historike, është krejt e qartë: nga aspekti historik kombet, etnitë, kulturat lokale do të na dilnin si komorbiditete (përbashkim simptomash të sëmundjeve të ndryshme) politike. Edhe pse ky realitet ka bërë që idetë si ajo e kozmopolitizmit dhe universalizmit të jenë boshti dominant sidomos në arte dhe në reflektimet e prijësve globalë të mendimit, popujt as që e kanë ndërmend ta shuajnë OKB-në si instancë kombesh në favor të ndonjë organizate parimisht dhe thelbësisht veç njerëzish. Pragmatikët rendin, organizimin e popujve, e shohin si hierarkinë e domosdoshme për të evituar anarkinë dhe kaosin brenda planetit. Dakord. Mirëpo kjo s'duhet të pengojë që të gjithë këta ruajtës rendi të urrejnë faktin se të gjithë të të njëjtit prind janë, qoftë ai Adami, Ademi, homo sapiensi, majmuni apo ndonjë statujë prej balte që do ta kenë bërë skulptorët dinozaurë. Kjo do të jetë edhe arsyeja se përse historiografitë kombëtare me një patos neveritës nisin bisedat e tyre nga kati i mesëm i godinës historike, e jo nga baza, pra nga ai moment kur janë shfaqur për herë të parë, kjo përkundër çdo logjike strukturore e cila na mëson që çdo gjë ta hulumtojmë nga fillimi e jo nga bishti, ane apo ndonjë sferë të errësuar galaktike.

*Shqiptarët përtej e mbi bllloqet* - «Hajt bacë hajt. Shpejt ke mi i vu ata aparatet n'vesh», i thotë nikoqiri jonë të birit kur erdhi në tavolinë për të ngrënë drekë. «Po vallahi edhe neve na ke prish veshët» shton e ëma duke qeshur. «Primitvca», mbron motra vëllain. «A juve astronautë u kemi» mbron i shoqi të shoqen. «Ç'a po thu allahile», zgjohet dikur i biri nga ëndrrat. Qeshin të gjithë. Tërë kohën papushim.

Sado brutal që na u duk ai urdhëri nënçmues «Hajt, hajt shko falu», ai sakaq manifeston tolerancën e vullnetshme për

koekzistencë. Nikoqiri jonë ishte ithtar i flaktë i krishterimit, oksidentit. Nuk i shau myslimanët, mirëpo shihej qartë se nuk i preferon fort. Me gjithë patriarkalizmin e tij ai nuk i përzihej të shoqes në religjiozitetin e saj. I biri – gjatë bisedës rreth feve – dy herë bërtiti pa lidhje sikur ende të dëgjonte muzikën e tij: «leni ato përralla, në cilin shekull jetoni!» Fundekrye ateist. «O komunizmi na shpëton ne», bëri ai për t'ia theksuar më dukshëm vulën vetes. «Feja jonë asht shqiptaria», kështu pohon e bija me gojën e Vaso Pashës. Prapë të gjithë qeshën.

Atë që nuk janë në gjendje ta kuptojnë teorikisht shkencëtarët, mendimtarët, publicistët e përfolur më lart, atë që nuk e pranojnë shtetet, kombet dhe politikat lart e poshtë globit, e praktikon kjo familje totalisht hibride shqiptare e një fshati afër Malishevës kosovare si diçka krejtësisht të natyrshme. «Secili ka kryet e veta dhe vendos vetë se çka donë të bëjë me veten. Secili facebookun e vet», vë buzën në gaz dhe thotë nikoqiri duke ia marrë nga dora së shoqes rakinë e rrushit.

S'ka asnjë dyshim se harmonia e kësaj familje nuk vjen si pasojë e kompaktësisë së grupit, por nga respektimit i individit, me të «mirat» dhe të «këqijjat» e tij.

*Faciti: Hibriditeti* - Duket se po u zbulua ndonjë aparat që analizon strukturën e atomeve të individit, pa asnjë hamendje do të habitemi me faktin se asnjëri atom i turit tonë nuk është identik me fqinjën e tij; do të identifikojmë informacione nga të gjitha epokat dhe kulturat e mundshme, informacione që si komandantë dirigojnë sjelljet tona në përditshmëri – deshëm ne apo jo!

Në kushtet e sotme të globalizmit hiperdixhital mund të thuhet se teknika detyron paradigmat të ulin bishtin dhe jo anasjelltas. Në kulmin e zhvillimit dhe përparimit njerëzor ai, njeriu, është përballur me «realitetin» që iluzionisht mendon ta ketë nën kontroll; bota gjendet në majën e hibriditetit

kulturor dhe çdo sagë mbi identitetet kolektive kulturore  
përgënjeshtrohet nga xhingosja e identiteteve individuale.  
(2013)

*Xhemal Ahmeti* ka lindur më 1969. Që nga viti 1991 jeton në Zvicër. Përveç këtij libri ai ka botuar ndër të tjera në gjermanisht, shqip e frëngjisht edhe veprat «Shqiptarët në postmodernë», «Seleksion», «Paranoja» (roman), «Etnokracitë e Evropës Juglindore» e të tjera.